Kosova
VERIU
Sloveni
Kroaci
Romani
Serbi
Bosni che
Hercegovni
Republika
Federale e
Jugosllavise
Mali i Zi
Kosova
Bulgari
Maqedoni
Shqiperi
Itali
Greqi
SERBI
Novi Pazar
LEPOSAVIQ
REPUBLIKA
FEDERALE E
JUGOSLLAVISE
ZVECAN
MITROVICE
ZUBIN POTOK
MALI I ZI
Mitrovice
PODUJEVE
Vushtrri
VUSHTRRI
ISTOG
Skenderaj
SKENDERAJ
PRISHTINA
OBILIQ
Prishtina
KAMENICE
Peje
PEJE
KLINE
Glogofc
FUSHE
KOSOVE
GLLOGOFC
NOVOBERDE
Decane
DECANE
Lipjan
LIPJAN
GJILAN
Gjilan
RRAHOVEC
SHTIME
GJAKOVE
Rrahovec
Gjakove
SUHAREKE
Ferizaj
FERIZAJ
VITI
Prizren
SHTRPCE
KACANIK
SHQIPERI
PRIZREN
Kumanova
Kukes
Tetove
Shkup
0 km 20
DRAGASH
MAQEDONI
Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

NËN PUSHTETIN E URDHRAVE

Krimet e luftës në Kosovë

HUMAN RIGHTS WATCH

NEW YORK WASHINGTON LONDON BRUSSELS

Copyright © tetor 2002 by Human Rights Watch
All rights reserved.

Përktheu nga origjinali anglisht:
Mustafa NANO, Virgjil MUÇI

Foto e kopertinës: “I paidentifikuar”
Copyright © Fred Abrahams / Human Rights Watch
Kopertina: Rafael Jiménez
Përgatiti për shtyp: Olizana Pasko

Adresa të Human Rights Watch:
350 Fifth Avenue, 34th Floor, New York, NY 10118-3299
Tel: (212) 290-4700, Fax: (212) 736-1300, E-mail: hrwnyc@hrw.org

1630 Connecticut Avenue, N.W., Suite 500, Washington, DC 20009
Tel: (202) 612-4321, Fax:(202) 612-4333, E-mail: hrwdc@hrw.org

33 Islington High Street, N1 9LH London, UK
Tel: (171) 713-1995, Fax: (171) 713-1800, E-mail: hrwatchuk@gn.apc.org

15 Rue Van Campenhout, 1000 Brussels, Belgium
Tel: (2) 732-2009, Fax: (2) 732-0471, E-mail:hrwatcheu@skynet.be

Web Site Address: http://www.hrw.org

Listserv address: për t’u regjistruar në listën e Human Rights Watch për news e-mail, dërgo një mesazh të bardhë në: subscribe@igc.topica.com

Botime KORBI
Rruga “Mine Peza” 232/1/6.
Tel: + 355 4 249130
botimekorbi@hotmail.com

Human Rights Watch i është përkushtuar mbrojtjes së të drejtave të njeriut në mbarë botën.

Ne qëndrojmë krah viktimave dhe veprimtarëve për të parandaluar diskriminimin, për të përkrahur lirinë politike, për të mbrojtur qeniet njerëzore nga trajtimi çnjerëzor në kohë lufte, si dhe për t'i nxjerrë fajtorët para drejtësisë.

Ne hetojmë dhe dëshmojmë shkeljet e të drejtave të njeriut, ndërsa abuzuesit i bëjmë përgjegjës.

Ne sfidojmë qeveritë dhe të gjithë ata që ushtrojnë pushtet, për t'u dhënë fund praktikave abuzive, në mënyrë që të respektojnë të drejtën ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut.

Ne i bëjmë thirrje publikut dhe bashkësisë ndërkombëtare të përqafojë çështjen e të drejtave të njeriut pa bërë dallim.

Human Rights Watch

Human Rights Watch kryen hetime të rregullta, sistematike lidhur me abuzimet në fushën e të drejtave të njeriut në rreth shtatëdhjetë vende anë e kënd botës. Reputacioni që kemi fituar për zbulimet në kohë dhe të besueshme, ka bërë që të jemi një burim thelbësor informacioni për të gjithë ata që merren me të drejtat e njeriut. Në punën tonë ne trajtojmë praktikat e të drejtave të njeriut të ndjekura nga qeveritë pavarësisht nga regjimet politike, rreshtimet gjeopolitike dhe përkatësitë etnike apo fetare. Human Rights Watch mbron lirinë e bindjeve dhe të shprehjes, ajo është për një proces të ndershëm, trajtim të barabartë para ligjit dhe për një shoqëri civile të shëndoshë; ne dokumentojmë e denoncojmë vrasjet, zhdukjet, torturën, burgosjet arbitrare, diskriminimet si dhe gjithë abuzimet e tjera që cënojnë të drejtat e njeriut, tashmë të njohura ndërkombëtarisht. Synimi ynë është t'i bëjmë përgjegjëse qeveritë në qoftë se ato shkelin të drejtat e qytetarëve të tyre.

Human Rights Watch zuri fill në vitin 1978, me themelimin e sektorit për Europën dhe Azinë Qendrore (asokohe i njohur me emrin Helsinki Watch). Sot e kësaj dite, në gjirin e saj bëjnë pjesë sektorë që mbulojnë Afrikën, Amerikat, Azinë dhe Lindjen e Mesme. Veç këtyre, përfshin edhe sektorë tematikë: atë të armëve, të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e grave. Zyrat e Human Rights Watch ndodhen në New York, Washington, Los Angeles, Londër, Bruksel, Moskë, Dushanbe dhe Bangkok. Human Rights Watch është një organizatë jo qeveritare, e pavarur, e cila mbështetet financiarisht nga kontributet e individëve privatisht dhe fondacionet në mbarë botën. Nuk pranon financime nga qeveritë, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë qoftë tërthorazi.

Në ekipin tonë bëjnë pjesë: Kenneth Roth, drejtor ekzekutiv; Michele Alexander, drejtor i zhvillimit; Reed Brody, drejtor juridik; Carroll Bogert, drejtor komunikimi; Barbara Guglielmo, drejtor i financës; Jeri Laber, këshilltar i posaçëm; Lotte Leicht, drejtor i zyrës së Brukselit; Michael McClintock, zëvendësdrejtor i programeve; Patrick Minges, drejtor i publikimeve; Maria Pignataro Nielsen, drejtor i burimeve njerëzore; Jemera Rone, konsulent; Malcolm Smart, drejtor i programeve; Wilder Tayler, konsulent i përgjithshëm, dhe Joanna Weschler, përfaqësues pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Drejtorë rajonalë të Human Rights Watch janë: Peter Takirambudde, për Farikën; Jose Miguel Vivanco, për Amerikat; Sidney Jones, për Azinë; Holly Cartner, për Europën dhe Azinë Qendrore; dhe Hanny Megally, për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Drejtorët e sektorëve tematikë janë: Joost R. Hiltermann, për armët; Lois Whitman, për fëmijët; dhe Regan Ralph, për gratë.

Anëtarë të trupës së drejtorëve janë: Jonathan Fanton, kryetar; Lisa Anderson, Robert L. Bernstein, David M. Brown, William Carmichael, Dorothy Cullman, Gina Despres, Irene Diamond, Adrian W. DeWind, Fiona Druckenmiller, Edith Everett, Michael E. Gellert, Vartan Gregorian, Alice H. Henkin, James F. Hoge, Stephen L. Kass, Marina Pinto Kaufman, Bruce Klatsky, Joanne Leedom-Ackerman, Josh Mailman, Yolanda T. Moses, Samuel K. Murumba, Andrew Nathan, Jane Olson, Peter Osnos, Kathleen Peratis, Bruce Rabb, Sigrid Rausing, Orville Schell, Sid Sheinberg, Gary G. Sick, Malcolm Smith, Domna Stanton, John J. Studzinski dhe Maya Wiley. Kryetar themelues i Human Rights Watch është Robert L. Bernstein.

Përmbajtja

FALËNDERIME xv
HYRJE xix
FJALOR SHPJEGUES xxv

1. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT 3
Ofensiva e vitit 19993 3
Hierarkia dhe zinxhiri i komandave 10
Gjykata e Krimeve të Luftës 13
Abuzimet e UÇK-së 14
Roli i Komunitetit Ndërkombëtar 16

2. KONTEKSTI HISTORIK 19
Hyrje 19
Histori e shkurtër e konfliktit në Kosovë 20
Kosova në Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë 21
Kosova në vitet '90 28
Konflikti i armatosur i vitit 1998 40
Konkluzione 63

3. FORCAT NË KONFLIKT 65
Forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë 68
Ushtria Jugosllave (Vojska Jugoslavije) 70
Ministria Serbe e Punëve të Brendshme (MUP) 79
Paraushtarakët 91
Zinxhiri i komandave dhe ndarja e përgjegjësive 97

Struktura dhe strategjia e UÇK-së 105
Shtojcë: Gradimet e pasluftës të pjesëtarëve të policisë Serbe e të ushtrisë jugosllave 110

4. MARS-QERSHOR 1999. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM 115
Gjeografia e abuzimeve 122
Masakrat 126
Viktimat, të humburit e zhvendosja e kufomave 128
Vrasje të paramenduara 133
Përdhunimet dhe abuzimet seksuale 137
Dëbimet e dhunshme 142
Arrestimet e ndalimet arbitrare 147
Shkatërrimi i pronësisë private dhe xhamive 151
Ndotja e depozitave ujore 153
Grabitja e plaçkitja 155
Paraburgimet dhe puna e detyrueshme 157
Kosovarët si shqyt njerëzor 158
Minat tokësore 160

5. RAJONI I DRENICËS 165
Izbica 167
Rezalla 174
Poklek 176
Cikatova e vjetër 180
Ofensiva e 30 Prillit 186
Vërbofc 188
Shtutica 194
Baksi 197
Xhamia e Qirezit 199
Miniera e Shavarinës 203
Paraburgimi dhe marrja në pyetje në Gllogovac 207
Paraburgimi dhe puna e detyruar 209
Qyteti i Gllogovcit 211
Vrasja e civilëve 213
Paraburgimi e poshtërimi 215
Dëbimi i detyruar 218

6. KOMUNA E GJAKOVËS 223
Qyteti i Gjakovës 224
Faza e parë – nga 24 mars deri më 2 prill 228
Faza e dytë – nga 7 maj deri më 13 maj 235
Tërheqja 238
Meja 240
Motivi: vrasja e pesë policëve 247
Autorët e krimeve 248
Korenicë 250

7. KOMUNA E ISTOGUT 257
Burgu i Dubravës 258
Burgu 259
Bombardimi i NATO-s 260
Masakra 264
Zhvarrosjet 273
Autorët e krimeve 273

8. KOMUNA E LIPJANIT 277
Sllovi 287
Kriminelët 299

9. KOMUNA E RRAHOVECIT 301
Pastasel 302

10. KOMUNA E PEJËS 307
Qyteti i Pejës 317
"Spastrimi" 317
Plaçkitjet dhe Zjarrvëniet 319
Vrasja finale 320
Përdhunimet 324
Qyshk 325
Kuadër i përgjithshëm 327
Vrasjet 329
Sulmet në Zahaq dhe në Pavlan 341
Fajtorët 344
Lubeniq 355

11. KOMUNA E PRIZRENIT 359
Qyteti i Prizrenit 361
Lagjja Tusus 362
Lagjja Bilbildere 366

12. RRUGA PRIZREN-GJAKOVË 369
Bellaçerkë 370
Celinë 377
Krusha e Madhe dhe Krusha e Vogël 383
Krusha e Madhe 385
Krusha e Vogël 390
Xërxe 391

13. KOMUNA E SUHAREKËS 395
Qyteti i Suharekës 398
Bellanicë 409
Fshati në komunën e Suharekës 418
Tërrnje 428

14. KOMUNA E VUSHTRRISË 427
Studime e Epërme dhe Studime e Poshtme 429
Sulmi i datës 2 maj mbi vargan 429
Burgosjet dhe dëbimet 438
Të tjera vrasje 439
Burgu i Smrekovnicës 444

15. ANALIZË STATISTIKORE E SHKELJEVE 447
Kufizime të të dhënave 449
Zbulime të përgjithshme 451
Analizë e ekzekutimeve pa gjyq 452

16. FUSHATA AJRORE E NATO-s 471
E drejta humanitare ndërkombëtare dhe përgjegjshmëria 478
Standartet e aplikuar 475
Rastet e vdekjes së civilëve në Kosovë 477
Refugjatët në rrugën Gjakovë-Deçan 479
Civilët e shpërngulur në pyjet e Koricës 482

Bombardimi i burgut të Dubravës 485
Përdorimi nga NATO i minave kasetë 487

17. ABUZIMET PAS 12 QERSHORIT 1999 489
Hyrje 489
Sulmet mbi minoritetet 491
Dhuna e ushtruar kundër shqiptarëve etnikë 500
Përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare 502
Të burgosurit shqiptarë kosovarë në Serbi qysh nga fundi i luftës 508

18. PUNA E GJYKATËS KUNDËR KRIMEVE TË LUFTËS 518
Gjykimet kundër krimeve të luftës brenda vendit 522
Hetimet kundrejt NATO-s dhe UÇK-së 525

19. STANDARTET LIGJORE NË KONFLIKTIN E KOSOVËS 527
Hyrje 527
Kosova si një konflikt i brendshëm i armatosur 529
Aplikueshmëria e Nenit 3 të përbashkët dhe e Protokollit II 531
Neni 3 i Përbashkët dhe Mbrojtja e Palëve Jo Luftuese 534
Protokolli II dhe Mbrojtja e Personave jo Luftues 536
E drejta e brendshme Jugosllave 542

BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË 545
SHËNIME 547
INDEKS 618

FALËNDERIME

Një raport i këtyre përmasave nuk do të ishte i mundur pa pjesëmarrjen aktive të shumë njerëzve. Ky libër ka qënë një bashkëpunim i stafit, konsulentëve e vullnetarëve të Human Rights Watch me njerëz të tjerë që janë marrë me çështjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Projekti u koordinua nga Fred Abrahams-i, hulumtues me përvojë i Human Rights Watch. Hulumtimet paraprake në terren u drejtuan nga hulumtuesit e Human Rights Watch, të cilët vijojnë sipas rendit alfabetik: Fred Abrahams, Bogdan Ivaniseviç, Andre Lommen, Joanne Mariner, Martina Vandenberg e Benjamin Ward, si dhe nga konsulenti i Human Rights Watch, James Ron. Hulumtimi i mëtejshëm u drejtua nga asistentët e Human Rights Watch Sahr MuhammedAlly, Alexandra Perina, Kerry McArthur e Laura Rusu, si dhe nga aspirantët në fushën e hulumtimeve, Kristie Evenson e John Walkup.

Raporti u shkrua paraprakisht nga Fred Abrahams e Benjamin Ward, ndonëse shumë prej hulumtuesve të përmendur më sipër dhanë një kontribut redaksional të rëndësishëm. Joanne Mariner shkroi seksionet mbi Prizrenin dhe Pastaselën, Martina Vandenberg shkroi seksionet mbi përdhunimet, William M. Arkin, një konsulent ushtarak i Human Rights Watch, shkroi shumicën e kapitullit mbi NATO-n, dhe Kristie Evenson dha një dorë në seksionin mbi minat tokësore. Betsy Andersen, ndihmës drejtoreshë e departamentit për Europën dhe Azinë Qëndrore të Human Rights Watch dha një ndihmë të madhe për kapitullin “Konteksti Historik”.

Raporti i plotë u botua nga Susan Osnos, konsulente e Human Rights Watc, dhe Michael McClintock, zëvendës drejtor i programit të Human Rights Watch. Dinah Pokempner, këshilltar i përgjithshëm i Human Rights

Watch, ndihmoi në saktësimin juridik të raportit. Një këshillim juridik pro bono u dha bujarisht prej Craig Bloom-it e Jeremy Feigelson-it, që të dy të agjencisë juridike "Debevoise & Plimpton".

Hulumtimi e përpilimi i seksioneve të kontekstit historik të raportit u drejtua nga shumë anëtarë e ish-anëtarë të Human Rights Watch, të cilët filluan të punonin në Kosovë qysh më 1990. Përmendim këtu: Ken Anderson, Jeri Laber, Ivana Niziç, Vllatka Mihajlloviç, Julie Mertes, Gordana Igriç dhe Peter Bouckaert. Ky raport dhe puna në Kosovë si një e tërë nuk mund të çoheshin deri në fund pa përkushtimin e profesionalizmin e shumë personave të tjerë të Human Rights Watch, si: Ken Roth, drejtor ekzekutiv i Human Rights Watch, Lotte Leicht, drejtor i zyrës së Brukselit, Jean-Paul Mathoz, drejtor i komunikimit me qendër në Bruksel, Bessie Skoures, administrator i zyrës së Brukselit, Carroll Bogert, drejtor i komunikimit, Minky Worden, drejtor i komunikimit elektronik, Wilder Taylor, këshilltar i përgjithshëm, dhe Rachael Reilly, i cili drejtoi në Maqedoni gjatë luftës hulumtimin mbi trajtimin e refugjatëve. E një rëndësie të jashtëzakonshme ishte me mprehtësinë, pjekurinë e mënyrën e drejtimit në përpjekjet për ta çuar deri në fund këtë projekt, Holly Cartner, drejtor i Departamentit të Europës e të Azisë Qëndrore.

Hartat në këtë raport u skicuan nga Michael Miller. Fotografitë u morën nga pjesëtarët e Human Rights Watch Fred Abrahams, Peter Bouckaert, Joanne Mariner e Benjamin Ward, si dhe nga fotografët profesionistë Alban Bujari e Wade Goddard. Përsa i takon skicimit të hartave e fotografive, dha një ndihmë edhe Veronika Matushaj, redaktorja përgjegjëse për fotografitë dhe drejtuesja e shërbimeve kreative, e cila është pjesë e Human Rights Watch.

Asistentë të ndryshëm të Human Rights Watch, siç janë Alexandra Perina, Aleks Frangos, Rachel Bien, Kaura Rusu, Kerry McArthur, Skye Donald dhe Adam Bassine, dhanë gjithashtu një ndihmesë të paçmueshme. Alex Frangos ideoi e skicoi faqen "Kriza në Kosovë" në website-in e Human Rights Watch (www.hrw.org/campaigns/kosovo98/index.shtml), e cila pati 1,2 milionë vizitorë më 1999. Një numër i madh studentësh e vullnetarësh dhanë po kështu një kontribut të vlerësueshëm. Përmendim këtu Darja Radulloviç-Watkins, Cveta Popoviç dhe Erkan Ates.

Analiza statistikore e këtij raporti u drejtua nga një grup ekspertësh e

aspirantësh, shumë prej të cilëve punuan në mënyrë vullnetare në atë kohë. Dr. Patrick Ball, zëvendës drejtor i Projektit Shkencor mbi të Drejtat e Njeriut në Fondacionin Amerikan për Përparimin në Shkencë (inicialet në anglisht AAAS), ideoi e ndoqi analizën statistikore. Procesi i kodifikimit u kooordinua nga Rebecca Morgan, konsulente e Human Rights Watch. Dr. Herbert F. Spirer, asistent profesor në Universitetin e Columbia-s, profesor emeritus i Universitetit të Connecticut-it, dhe konsulent i AAAS-it, drejtoi analizën, prodhoi grafikat fillestare, e dha këshilla shumë të rëndësishme në momentet e duhura. Matt Zimmerman i AAAS-it prodhoi grafikat e diagramat finale. Rishikimi i tyre u realizua nga Dr. Fritz Sheuren e Tom Jabine. Nuk mungoi me ekspertizën e tij profesionale Dr. Wray Smith. Orët të tëra pune për hyrjen e regjistrimin e të dhënave janë të lidhura me emrat e vullnetarëve të mëposhtëm: Benedicte Benoit, Sabrina Ait-Aoudia, Mirela Gegprifti, Artan Kafexhiu, Haim Samuels, Miguel Morales, Yulia Dultcina, Sarah Millar, Aida Repak, Susana Kevorkova, Adam Greenfield dhe Jasmina Repak. Human Rights Watch i falenderon të gjithë për kohën që harxhuan e përkushtimin që falën.

Asnjë hulumtim në Kosovë nuk do të ishte i mundur pa bashkëpunimin e asistencën e grupeve dhe veprimtarëve të të drejtave të njeriut në Kosovë e në rajon, të cilët, krahasuar me organizata apo individë të huaj, punuan në kushte të një rreziku shumë më të madh. Falenderime të veçanta i shkojnë Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriut në Prishtinë dhe shumë filialeve të këtij Këshilli nëpër gjithë Kosovën, Qendrës së Ligjit Humanitar, Qendrës për Mbrojtjen e Grave e Fëmijëve, fondacionit Nënë Tereza, Komitetit të Helsinkit të Kosovës dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Shoqatës Kosovare të të Burgosurve Politikë, Qendrës Shqiptare të Këshillimit për Gratë e Vajzat në Shqipëri, dhe El Hilal-it në Shkup e Tetovë të Maqedonisë.

Shumë profesionistë – diplomatë, gazetarë, avokatë, veprimtarë humanitarë e të të drejtave të njeriut – dhanë një ndihmë të pallogaritshme në tërë këtë proces. Këtu, nuk është e mundur t'u përmendet emri të gjithëve. Human Rights Watch do të donte të falenderonte në mënyrë të veçantë personat e mëposhtëm: Nora Ahmetaj, Sevdie Ahmeti, Dejan e Dushka Anastasijeviç, Ardian Arifaj, Judith Armata, Tina Babaroviç, Agron Bajrami, Adem Bajri, Ilir Bajri, Fazlli Balaj, Sonja Biserko, Zoran Qirjakoviç, Vjosa Dobruna, Robin Ellis, Agim Fetahu, Sheri Fink, Josh Friedman, Carlotta Gall, Benedicte Giaever, Bukurie Gjonbalaj, Wade

Goddard, Dukagjin Gorani, Baton Haxhiu, Mayke Huijbregts, Ylber Hysa, Natasha Kandiç, Flamur Kelmendi, Kosovare Kelmendi, Nekibe Kelmendi, Asif Khan, Bajram Krasniqi, Andrea Lako, Ibrahim Makolli, Paul Miller, Fron Nazi, Lirije Osmani, Marta Palokaj, Jane Perlez, Paul Risley, David Rohde, Destan Rukiqi, Bexhet Shala, Milbert Shin, Eric Stover, Veton Surroi, Gjeraqina Tuhina, Volker Turk, Mark Vuksani, Mary Wyckoff dhe Ariana Zherka.

Human Rights Watch u është mirënjohës gjithashtu për asistencën e tyre organizatave të mëposhtëme: Misionit të OSBE-së për Verifikimin në Kosovë e Maqedoni, Misionit të OSBE-së në Kosovë, UNHCR-së së Shkupit e Prishtinës, organizatës Amnesty International, Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës, Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Shkup e Prishtinë, UNMIK-ut, KFOR-it dhe organit mediatik ABC News.

E fundit që duhet thënë, por jo më pak e rëndësishmja, është se Human Rights Watch punoi me një numër të madh përkthyesish të talentuar përpara, gjatë e pas luftës, të cilët bënë shumë më tepër se sa përkthimin e fjalëve, e për këtë arsye dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e këtij raporti. Human Rights Watch u shpreh mirënjohjen në mënyrë të veçantë për punën e bërë Fisnik Abrashit, Ylber Bajraktarit, Ilda Dacit, Virtut Gaceferit, Ilir Gocajt, Albana Kasapit, Adriatik Kelmendit, Garentina Krajës, Yllze Mustafës, Beni Qenas, Bujar Saitit, Birol Urcanit, dhe Mimoza Zabergjas. Shoferët Agron Musa dhe Malsor Krasniqi i bënë të sigurta ecejaket e udhëtimet e stafit të Human Rights Watch, duke grahur makinat nëpër rrugët e vështira të Shqipërisë së Veriut dhe të Kosovës. Shumë prej këtyre njerëzve morën në sy rreziqet e shumta, në funksion të mbledhjes së një informacioni të besueshëm mbi të drejtat e njeriut.

Hyrje

Qëllimi kryesor i këtij raporti është dokumentimi i krimeve të luftës të kryera nga forcat qeveritare serbe e jugosllave në Kosovë nga 24 marsi deri më 12 qershor të vitit 1999 – periudhë që përkon me kohëzgjatjen e fushatës së bombardimit të NATO-s mbi Jugosllavi. Nëpërmjet studimit të rasteve të hulumtuara mirë, si dhe nëpërmjet analizës statistikore rreptësisht shkencore, qëllimi është të jepet një dëshmi e besueshme e ngjarjeve të tmerrshme që kanë ndodhur, me shpresën se autorët e krimeve do të përfundojnë në bangon e të akuzuarve.

Në të njëjtën kohë, raporti evidenton faktin që sjellja abusive nuk u manifestua vetëm nga forcat qeveritare serbe e jugosllave. Për këtë arsye, raporti bën dokumentimin e dhunimit të ligjit ndërkombëtar humanitar nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si dhe nga ana e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO).

Duke patur parasysh që ka patur një përqëndrim të madh të vëmendjes mbi ngjarjet e Kosovës në vitin 1999, nuk është për t'u çuditur që studime të ngjashme që dokumentojnë dhunimin e ligjit ndërkombëtar humanitar në krahinë kanë dalë në dritë tashmë, përfshirë një vepër dy-volumëshe të Organizatës për Sigurimin e Bashkëpunimin në Europë (OSBE), si dhe raporte të shumta të organizatave jo qeveritare. Ne shpresojmë që ky raport të hapë ca më shumë terren duke dhënë edhe një dëshmi të gjerë e të hollësishme të krimeve të luftës në Kosovë, edhe një kontekst historiko-politik të konfliktit. Duke qënë i paisur me dëshmi të dorës së parë, ky raport u jep zë gjithashtu edhe viktimave të pafajshme të luftës.

Duke marrë shkas nga atmosfera e helmatisur në Kosovën e pasluftës me sulme të shpeshta mbi serbët e romët, dikush mund të pyesë nëse ky raport do t'u sjellë në kujtesë njerëzve krimet e shkuara dhe nëse do të

provokojë hakmarrje të mëtejshme. E vlen barra qeranë të gërmosh në këto ngjarje tragjike?

Së pari, është shumë e rëndësishme të bësh dokumentimin e historisë. Së bashku me raporte të tjera që kanë dalë në dritë deri tani, ky libër i titulluar *Nën Pushtetin e Urdhërave: Krimet e Luftës në Kosovë*, sipas shumë gjasave do të ndihmojë brezat e ardhshëm të kuptojnë më mirë konfliktin dhe rajonin. Së dyti, dështmitë e prezantuara këtu do t'u bëhen krah hetuesve të krimeve të luftës, ndërsa do të jenë të angazhuar në ngritjen e akuzave kundër udhëheqjes serbe e jugosllave, si edhe kundër pjesëtarëve të UÇK-së. Ndarja e përgjegjësive individuale mund të bëjë që të mos flitet për fajësi kolektive. Së fundi, disa segmente të shoqërisë serbe kanë demonstruar interes për të vlerësuar të shkuarën. Ky raport, me faktet e dhëna e analizat e bëra, mund ta lehtësojë këtë proces.

Raporti përfshin një kapitull të analizës statistikore, që është përgatitur së bashku me Programin Shkencor mbi të Drejtat e Njeriut të Fondacionit Amerikan mbi Përparimin në Shkencë (AAAS). Ky kapitull shtie në punë të dhëna të qëmtuara nga më shumë se 600 intervista të Human Rights Watch, me synimin për të shqyrtuar tendencat dhe tipologjinë e krimeve të kryera, gjë që nuk mund të dalë në pah nga informacioni i rrëfyer. Shifrat e diagramat ndihmojnë të bëhet trajtimi i raportimeve të dhunimeve në një mënyrë sistematike, si dhe e bëjnë të besueshëm argumentin, sipas të cilit fushata qeveritare serbe e jugosllave në kryerjen e krimeve, shkatërrimeve e "spastrimit etnik" ka qënë sistematike dhe e mirorganizuar.

Në kapitullin që bën fjalë mbi kontekstin historik të konfliktit, raporti bën një analizë të historisë e të abuzimit me të drejtat e njeriut, që sollën në konfliktin e armatosur. Një temë konstante është gatishmëria e komunitetit ndërkombëtar për të bërë një vesh shurdh e një sy qorr përballë këtyre abuzimeve në funksion të stabilitetit politik afatshkurtër, dhe mungesa e një strategjie perëndimore lidhur me fatin e rajonit.

Tre kapituj të tjerë janë të një rëndësie të madhe, ndonëse ata nuk zënë një vend të madh në raport. I pari merret me dhunimet pas hyrjes së NATO-s në Kosovë më 12 qershor 1999, kryesisht me abuzimet e kryera nga shqiptarët etnikë kundër popullsisë jo shqiptare – serbëve, romëve, goranëve e të tjerëve – dhe me pazotësinë, në dukje mosdashjen, e komunitetit ndërkombëtar për të mbrojtur këto popullsi. Kapitulli i Kontekstit Historik jep gjithashtu një material të rëndësishëm mbi krimet e luftës të kryera

nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës më 1998, përfshirë marrjen peng dhe ekzekutimet e atypëratyshme. Një kapitull tjetër merret me dhunimin e ligjit ndërkombëtar humanitar nga ana e NATO-s, dhe sidomos me dështimin e aleancës euroatlantike në minimizimin e dëmeve mbi civilë gjatë fushatës së bombardimit dhe me përdorimin e minave kasetë. Një raport më i plotë mbi bombardimin e NATO-s, *Vdekjet e Civilëve gjatë Fushatës Ajrore të NATO-s*, është publikuar nga Human Rights Watch në shkurt të vitit 2000.

Së fundi, raporti përmban një kapitull, ku jepen hollësi mbi standartet legale kombëtare e ndërkombëtare që u aplikuan në konfliktin e Kosovës, dhe një kapitull tjetër, ku përshkruhet puna e Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë.

Pa asnjë dyshim, dhunimet serioze të kryera nga shumë shqiptarë në ditët e sotme në Kosovë lypin një vëmendje urgjente. Përveç dokumentimit të bërë në këtë raport, Human Rights Watch ka dënuar në mënyrë të përsëritur këto abuzime, dhe në një mënyrë më të plotë tek një raport i botuar në gusht 1999, *Abuzimet Kundër Serbëve e Romëve në Kosovën e Re*. Ky raport megjithatë fokusohet kryesisht mbi krimet e kryera kundër shqiptarëve etnikë gjatë bombardimit të NATO-s – krime që ishin të shumta e të planifikuara me kujdes nga qeveria. Ashtu siç tregon ky raport, Kosova midis marsit e qershorit të vitit 1999 u ndodh nën një fushatë masakrash e dëbimesh, e cila ishte e koordinuar dhe e sponsorizuar nga shteti.

METODOLOGJIA

Human Rights Watch nisi të dokumentojë dhunimet e të drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 1990. Një radhë raportimesh të atëhershme dhe të viteve të mëpastajmë u bënë nga misionet në terren.

Natyra e hulumtimit ndryshoi në vitin 1998, kur filloi konflikti i armatosur. Katër misione të atij viti dhe të muajve të parë të vitit 1999, përfshirë një syresh në Shqipërinë e Veriut, u përqëndruan në dokumentimin e dhunimit të ligjit ndërkombëtar humanitar nga ana e të dy palëve në konflikt.

Më 28 mars 1999, katër ditë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, Human Rights Watch dërgoi hulumtuesin e saj të parë në Maqedoni, i ndjekur të nesërmen nga një tjetër i dërguar në kufirin midis Shqipërisë

e Kosovës. Gjatë gjithë periudhës së luftës, hulumtuesit u ndodhën në të dy vendet. Pati gjithashtu udhëtime të shkurtëra faktqëmtuese në Malin e Zi e në Bosnjë për të intervistuar refugjatët e dëbuar nga krahina, të cilët siguruan një mbulim më të plotë të ngjarjes. Kufizimet në marrjen e vizave të hyrjes dhe probleme të sigurimit nuk bënë të mundur futjen brenda në Kosovë.

Hulumtimi në përgjithësi pati dy synime: të identifikoheshin krimet e kryera dhe të tërhiqej vëmendja e opinionit publik mbi to, si dhe të asistoheshin hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës. Synimi i parë u realizua duke bërë në mënyrë metodike dokumentimin e klasifikimin e abuzimeve më të rënda nëpërmjet dëshmive të refugjatëve. "Kosovo Flashes" ishte një fletushkë pothuaj e përditshme, që njoftonte publikun me të rejat më të freskëta nga terreni. Disa raportime më të gjata e më të thelluara u botuan gjithashtu gjatë kësaj periudhe. Human Rights Watch asistoi hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës duke i njoftuar ata mbi krime të hamendësuara dhe duke u prezantuar atyre dëshmitarë potencialë.

I gjithë informacioni u mor nga dëshmi refugjatësh, pasi shtypi i huaj dhe monitoruesit e të drejtave të njeriut ishin dëbuar nga Jugosllavia. Lidhja logjike e deklaratave të dëshmitarëve dhe shkalla e lartë e përputhjeve të tyre me njëra-tjetrën mundësoi krijimin e një tabloje pak a shumë të saktë.

Më 13 qershor të vitit 1999, një i dërguar i Human Rights Watch hyri në Kosovë menjëherë pas trupave të NATO-s. Të paktën një ekspert i yni mbeti në krahinë për gjashtë muajt në vazhdim me synimin për të hetuar drejtëpërdrejtë natyrën e shtrirjen e krimeve. Strategjia konsistonte në përpjekjen për të shqyrtuar në thellësi e gjerësi ato incidente, të cilat ishin raportuar nga Human Rights Watch shumë kohë më përpara, siç ishin ato që ndodhën në Mejë, Gjakovë, Krushë e Madhe. Përveç kësaj, u morën në shqyrtim edhe vende të tjera, për të bërë të mundur në këtë mënyrë një përfaqësim të plotë gjeografik të abuzimeve.

Përpikmëria e dëshmive të refugjatëve ishte impresionante. Në gati të gjithë vendet e vizituara pas luftës nga Human Rights Watch, të dërguarit panë të konfirmuara faktet e rrëfyera prej refugjatëve në Shqipëri e Maqedoni, deri dhe emrat e moshën e viktimave. Në një fshat të komunës së Suharekës për shembull, u gjetën kufomat e dymbëdhjetë të moshuarve, dhe njëmbëdhjetë syresh në pusin e fshatit. Gjashtë javë më parë, gra

refugjate të të njëjtit fshat i kishin thënë Human Rights Watch se njëmbëdhjetë burra të moshuar ishin marrë nga policët serbë (personi i dymbëdhjetë ish ndaluar pasi ato ishin nisur). Emrat ishin po ata që ishin përmendur nga refugjatët.

Me kalimin e kohës, dolën në dritë disa incidente të paraportuar më parë. Egzekutimet në Sharavinë nuk ishin raportuar sepse dëshmitarët kishin mbetur në grackën që u ish ngritur në Drenicë. Masakra e burgut të Dubravës nuk ish bërë e njohur sepse të mbijetuarit ishin transferuar në burgjet e Serbisë. Human Rights Watch i gjurmoi këto raste e të tjera, ndonëse shumë incidente mbetën të pahetueshme për shkak të ngatërresës që u bë me vendet në të gjithë krahinën, ku ishin kryer mizoritë. Megjithatë, me disa përjashtime, si fjala vjen Kotlina, Kaçaniku, Llukarja, Dysi, Godeni dhe Belegu, pjesa tjetër e vendeve ku u kryen krimet më të mëdha janë të trajtuara në këtë raport. Në përgjithësi, incidentet në komunat e Podujevës e të Fushë Kosovës janë gjithashtu të trajtuara në këtë raport.

Si ndodh me të gjitha hulumtimet e kësaj natyre, edhe këtu gjenden kufizime të caktuara. Shpesh dëshmitarët e viktimat ndiheshin të bezdisur e të tronditur të kujtonin hollësi të ngjarjeve, për shkak të natyrës skajshmërisht traumatike të këtyre të fundit. Në disa raste, ata ishin instruktuar nga UÇK-ja të mos flisnin për disa ngjarje. Të gjithë këto vështirësi janë marrë në konsideratë. Janë intervistuar në këtë raport burime të shumëfishta për çdo ngjarje. Të gjitha faktet janë mbështetur të paktën nga një burim i dytë. Kur është gjykuar e nevojshme, burimet janë cituar në shënimet në fund të raportit. Përveç kësaj, të dërguarit e Human Rights Watch vizituan të gjitha vendet e përmendura në këtë raport, ku janë kryer masakra të mëdha, duke inspektuar provat e mbetura fizike.

Emërtimi i autorëve të supozuar të krimeve është bërë me kujdes jo të zakontë. Ndonëse shqiptarët e Kosovës shpesh nuk i njihnin torturuesit e tyre, disa emra janë përmendur megjithatë në këtë raport. Për secilin, të paktën tre burime të pavarura konfirmojnë pjesëmarrjen në krim.

EMRAT DHE TERMINOLOGJIA

Ka shumë konfuzion që vjen prej emërtimeve të fshatrave e qyteteve të Kosovës në gjuhën serbe e shqiptare, të cilat shpesh janë të

ndryshme, gjë që ndodh edhe me emrin e vetë krahinës ("Kosova" në shqip dhe "Kosovo dhe Metohija" në serbisht). Për hir të qartësisë e e njëtrajtshmërisë, Human Rights Watch jep variantin shqiptar e serb të emërtimit në citimin e parë që bëhet. Referenca të mëtejshme janë vetëm në gjuhën serbe, pasi kjo është praktika në gjuhën angleze (fjala vjen, Pristina e jo Prishtina). Emrat e personave janë të gërmëzuar në gjuhën amtare të personit në fjalë, me fjalë të tjera, të gjithë emrat shqiptarë janë të gërmëzuar në shqip. Për ta thjeshtuar çështjen, nuk janë përdorur theksat dhe diakritikat.

Republika Federale e Jugosllavisë - e përbërë nga Serbia e Mali i Zi – përmendet thjesht me emërtimin "Jugosllavia". Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë quhet "Maqedoni." Bosnjë-Hercegovina quhet "Bosnja".

Eshtë bërë kujdes të evitohen ngritje padish e pasoja të mundshme kundër dëshmitarëve e viktimave, të cilët kanë rrëfyer në këtë raport. Disa emra janë dhënë të plotë, ngaqë është menduar se nuk ka patur rrezik për këta persona, e megjithatë Human Rights Watch ka fshehur identitetin e shumë burimeve, edhe pse është dhënë leja për të përmendur emrin e plotë. Kështu, shumë emra dëshmitarësh e viktimash janë paraqitur ose me iniciale, ose tjetër për tjetër (në rastin e dytë ky fakt theksohet gjatë raportit). Dy fshatra, ku janë kryer përdhunime, nuk janë përmendur me emër.

Fjalor shpjegues

AK47/Kallashnikov	Armë gjysmë-automatike e prodhimit rus ose kinez
APC	Transportues i korracuar personeli
Arkan	Emri i vërtetë, Zeljko Raznjatoviç, udhëheqës i paraushtarakëve gjatë luftrave në Kroaci e Bosnjë-Hercegovinë. I akuzuar nga Gjykata Kriminale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (më 30 Shtator 1997 dhe publikisht më 31 mars 1999); i kërkuar nga Interpoli. I ekzekutuar në Beograd nga vrasës të panjohur, në muajin shkurt 2000
BE	Bashkimi Europian
CDHRF	Këshilli i Mbrojtjes së Lirive e të Drejtave të Njeriut, organizatë e të drejtave të njeriut me qendër në Kosovë
Çetnik	Term që vjen nga forcat serbe në Luftën e Parë Botërore nën komandën e Kosta Pecenac-it, dhe nga forcat serbe në Luftën e Dytë Botërore nën komandën e Drazha Mihajlloviç-it. Ky term, tanimë përçmues, përdoret për të identifikuar serbët nacionalistë të linjës së ashpër
DM	Deutschmark/Marka gjermane, e përdorur gjerësisht si një monedhë e fortë në Kosovë

Dora e Zezë	Grup paraushtarak serb
DU	Uranium i Varfëruar
ICRC	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
ICTY	Gjykata Kriminale Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë (e Kombeve të Bashkuara)
IDP	Person i Shpërngulur Brenda Vendit
IOM	Organizatë Ndërkombëtare për Migracionin
KFOR	Forca e Kosovës (NATO)
Kryqi Serb	Simboli Nacionalist Serb, që përmban një kryq dhe katër "S" cirilike të marra nga slogani "Vetëm Bashkimi i Shpëton Serbët" (Në serbisht Samo Sloga Srbina Spasava)
KVM	Misioni i OSBE-së për Verifikimin në Kosovë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LPK	Lëvizja Popullore e Kosovës
MTU	Marrëveshja Teknike Ushtarake
MUP	Ministria Serbe e Punëve të Brendshme (Në serbisht Ministarstvo Unustrasnjih Poslova)
MVDK	Misioni i Vëzhguesve Diplomatikë në Kosovë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare

OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë
OUP	Njësia e Punëve të Brendshme në Ministrinë Serbe të Punëve të Brendshme (Në serbisht Odeljenje Unustrasnjih Poslova)
PJP	Njësia e Policisë Speciale të Serbisë (Në serbisht Posebne Jedinice Policije)
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RFSJ	Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë
SAJ	Njësitë Antiterroriste Speciale të Serbisë (Në serbisht Specijalne Antiteroristicke Jedinice)
SDB	Shërbimi i Sigurimit Shtetëror (Në serbisht Sluzba Drazvne Bezbednosti)
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
Shqiponjat e Bardha	Formacion paraushtarak serb
SPS	Partia Socialiste e Serbisë (Në serbisht Socijalisticka Partija Srbije)
SRS	Partia Radikale Serbe (Në serbisht Srpska Radikalna Stranka)
SUP	Sekretariati i Punëve të Brendshme në Ministrinë Serbe të Punëve të Brendshme (Në serbisht Sekretarijat Unustrasnjih Poslova) të Kosovës
Tigrat e Arkanit	Formacioni paraushtarak serb i drejtuar nga “Arkan”

TMK	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNHCHR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Përkohshëm
VJ	Ushtria Jugosllave (Në serbisht Vojska Jugoslavije)
WFP	Programi Botëror i Ushqimit
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë

NËN PUSHTETIN E URDHRAVE

"I pa identifikuar"

© FRED ABRAHAMS / HUMAN RIGHTS WATCH

1

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Ky raport dokumenton tortura, vrasje, masakra, përdhunime, dëbime të dhunshme dhe krime të tjera lufte të kryera nga forcat qeveritare serbe e jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës prej 24 marsit deri më 12 qershor 1999, e cila është edhe periudha, në të cilën u zhvillua fushata ajrore e NATO-s kundër Jugosllavisë. Raporti nxjerr zbuluar një fushatë të koordinuar dhe sistematike për të terrorizuar, vrarë e dëbuar shqiptarët etnikë të Kosovës, e cila u organizua nga nivelet më të larta të qeverive serbe e jugosllave të asaj kohe.

Natyrisht, këto krime nuk u kryen larg syve të botës. Ky raport nënvizon kontekstin historik e politik të luftës, dhe është kritik ndaj reagimit të komunitetit ndërkombëtar gjatë dekadës së fundit, në harkun kohor të së cilës u përshkallëzua kriza. Tre kapituj dokumentojnë gjithashtu abuzimet e kryera nga kryengritësit shqiptarë të grupuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët rrëmbyen e vranë civilë gjatë e pas luftës, si dhe abuzimet e NATO-s, e cila dështoi në synimin për të minimizuar viktimat civile gjatë bombardimit të Jugosllavisë. Megjithatë, argumenti kryesor i raportit mbetet dhuna shtetërore e organizuar nga qeveritë serbe e jugosllave në vitin 1999 kundër qytetarëve shqiptarë të Jugosllavisë.

OFENSIVA E VITIT 1999

Ofensiva e qeverive serbe e jugosllave në Kosovë që filloi më 20 mars1999, vetëm katër ditë para se të fillonte bombardimi i NATO-s,

ishte një fushatë metodikisht e planifikuar dhe e mirëzbatuar. Shkarkime dhe emërime të rëndësishme në aparatin e sigurimit të Jugosllavisë nga fundi i vitit 1998, përfshirë kreun e sigurimit shtetëror serb dhe shefin e shtabit të përgjithshëm të ushtrisë, të bëjnë të mendosh se përgatitjet për ofensivën po bëheshin në atë kohë. Në fillim të vitit 1999, u vu re përqëndrimi ushtarak i konsiderueshëm në Kosovë dhe armatosja e civilëve serbë. Aksionet policore e ushtarake nga fundi i shkurtit dhe fillimi i marsit në rrethinat e Vushtrrisë e Podujevës, të emërtuara nga qeveria "stërvitja e dimrit" siguruan lidhjet hekurudhore e rrugore të veriut të Kosovës me Serbinë.

Më shumë se 80% e tërë popullsisë së Kosovës – 90% e shqiptarëve – u dëbuan nga shtëpitë e tyre.

Edhe ofensivat e mëparshme qeveritare ishin shoqëruar nga dhunime serioze të ligjit humanitar ndërkombëtar, por periudha e bombardimit të NATO-s solli sulme të papara mbi civilë dhe dëbimin e dhunshëm të më shumë se 850,000 shqiptarëve etnikë të Kosovës. Për herë të parë në konflikt, luftimet u spostuan nga zonat rurale në qytete.

Ndërsa fushata qeveritare duket se ka qënë një përpjekje për të dërrmuar UÇK-në, ajo, me të filluar bombardimi i NATO-s, mori një zhvillim tjetër. Ndërsa ofensiva kryesore po merrte rrugë, Presidenti i atëhershëm jugosllav Slobodan Milosheviç shfrytëzoi bombardimin e NATO-s për të zbatuar planin e mposhtjes së rebelëve dhe të bazave të tyre të mbështetjes popullore, si dhe për të dëbuar me dhunë një përqindje të madhe të popullsisë kosovare.

Askush nuk parashikoi shpejtësinë dhe shkallën e dëbimeve. Sipas komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR), brenda tri javësh nga fillimi i bombardimit të NATO-s mbërritën në vendet fqinjë 525,787 refugjatë. Ndërsa në tërësi, forcat qeveritare dëbuan nga Kosova 862,979 shqiptarë etnikë, ndërsa qindra mijra të tjerë u zhvendosën brenda për brenda, dhe këtu nuk llogariten ata që ishin zhvendosur para marsit 1999. Më shumë se 80% e tërë popullsisë së Kosovës – 90% e shqiptarëve – u dëbuan nga shtëpitë e tyre.

Zona të shquara për lidhje historike me UÇK-në u goditën më ashpër. Komunat e Gllogofcit dhe të Skënderajt në rajonin e Drenicës – djepi i UÇK-së – ishin skena të masakrave të shumëfishta mbi civilët, si dhe të paraburgosjeve arbitrare, torturave, shkatërrimit sistematik të shtëpive dhe të pronave të civilëve. Vrasjet në masë, dëbimet e dhunshme dhe

shkatërrimi i pronave të civilëve ishin gjithashtu një dukuri e rëndomtë në komunat jugperëndimore të Gjakovës, Rrahovecit dhe Suharekës, ku shumë fshatra mbështetën për një kohë të gjatë kryengritjen. Gjashtëdhjetë e pesë përqind e dhunimeve të dokumentuara nga Human Rights Watch ndodhën në pesë komunat e përmendura më sipër (shih Figurën 2 në kapitullin Analiza Statistikore e Dhunimeve).

Shpjegimet e abuzimeve në komuna të tjera janë më të komplikuara, e për këtë arsye, nuk arrijnë qartësisht tek e vërteta. Komunat e Pejës e Lipjanit, të cilët janë të banuara në mënyrë të konsiderueshme edhe nga popullsi serbe, na ballafaquan me dëbimin në masë të shqiptarëve etnikë, ndërsa vrasjet ishin më të lokalizuara, si fjala vjen në fshatrat e Sllovit, Ribarit, Lubeniqit, Qyshkut dhe në qytetin e Pejës. Ndonëse UÇK-ja ishte aktive në komunën e Pejës dhe e pranishme aty-këtu në perëndim të komunës së Lipjanit gjatë vitit 1998 e gjatë muajve të parë të vitit 1999, ka pak apo aspak dëshmi që flasin për lidhje të UÇK-së me disa prej fshatrave, ku ndodhën masakra. Vrasjet ishin një dukuri e zakonshme, ishin pjesë e operacioneve, në të cilat merrnin pjesë ushtarë, policë e paraushtarakë, e që synonin të terrorizonin popullsinë e ta shtrëngonin atë të linte Kosovën.

Fjala vjen, pati një prani të papërfillshme të UÇK-së gjatë vitit 1998 dhe muajve të parë të vitit 1999 në komunën veriperëndimore të Istokut, etnikisht të përzier. Megjithatë, në këtë komunë u vunë re dëbimet në masë të banorëve shqiptarë në drejtim të Malit të Zi, të cilat erdhën pas djegjes e plaçkitjes së shtëpive të tyre. Istoku ishte gjithashtu skenë e një prej ngjarjeve më të përgjakshme të luftës, kur forcat serbe vranë më shumë se nëntëdhjetë shqiptarë etnikë në burgun e Dubravës më 1 maj 1999, dy ditë pasi goditjet ajrore të NATO-s kishin sjellë vdekjen e nëntëmbëdhjetë të burgosurve.

Ka pak apo aspak dëshmi që flasin për lidhje të UÇK-së me disa prej fshatrave, ku ndodhën masakra.

Dëbimi i dhunshëm ishte i mirorganizuar, gjë që na bën të mendojmë se gjithçka ka qënë e planifikuar që më përpara. Fshatrat në zonat strategjike u spastruan, në mënyrë që të siguroheshin linja komunikimi e kontrolli të pjesës kufitare. Zonat që mbështesnin UÇK-në, por edhe zonat ku nuk kish prani të UÇK-së, u bënë pre e sulmeve të përbashkëta të policëve, ushtarëve e paraushtarakëve. Qytete të mëdhenj u spastruan duke përdorur autobuza, trena, dhe karvanë të gjatë me zetora u shoqëruan

në drejtim të kufirit. Refugjatët u shtrënguan të merrnin arratinë apo u transportuan drejt kufirit sipas një programi dëbimesh e deportimesh, i cili ishte i kooordinuar dhe i mirorganizuar.

Human Rights Watch dokumentoi gjithashtu praktikën e zakonshme të "spastrimit prej identitetit": refugjatëve të dëbuar për në Shqipëri, përpara se të lejoheshin të kalonin kufirin, shpesh u merreshin dokumentat e tyre të identifikimit apo detyroheshin të shkulnin patentën e drejtimit që ish e inkorporuar në makinë apo zetor. Përpara se të arrnin në kufi, shumë shqiptarëve iu shkatërruan dokumentat personale, gjë që të bën të mendosh se qeveria po përpiqej të bllokonte rikthimin e tyre.

Dëbimi në masë i shqiptarëve të Kosovës mund të ketë shërbyer për disa qëllime. Së pari, mund të ketë synuar ndryshimin e strukturës demografike të Kosovës – një politikë kjo e përmendur nga politikanë nacionalistë ekstremistë të të gjitha kohërave. Ndryshimet demografike mund të çonin në një ndarje eventuale të krahinës në dy pjesë, një për serbët e një për shqiptarët. Së dyti, mund të ketë synuar destabilizimin e vendeve fqinjë, Shqipërisë e Maqedonisë. Së fundi, mund të ketë synuar shpërqëndrimin e NATO-s, duke e detyruar këtë të fundit të harxhonte energji e mjete në vendet fqinjë, gjë që do të vështirësonte një pushtim nga toka të Kosovës, ose të paktën do ta bënte NATO-n më pak të vendosur në aksionet e veta. Nëse qëllimi ka qënë dekurajimi e përçarja e komunitetit ndërkombëtar, dështimi afërmendsh ka qënë i plotë, pasi pamjet e refugjatëve vetëm sa provokuan zemërimin e opinionit publik dhe rritën kërkesën për t'u hedhur në veprim.

Masakrat e qëllimshme e të pamotivuara nga asnjë ligj mbi civilë – ekzekutime jashtëgjyqësore – përbënin një element kyç të fushatës së "spastrimit etnik". Në të gjithë krahinën, civilë të cilët nuk ishin luftëtarë, përfshirë gra e fëmijë, u vranë nga policia serbe, nga ushtarët e Ushtrisë Jugosllave dhe nga forcat paraushtarake në stilin e ekzekutimeve arbitrare.

Masakrat e qëllimshme e të pamotivuara nga asnjë ligj mbi civilë – ekzekutime jashtëgjyqësore – përbënin një element kyç të fushatës së "spastrimit etnik".

Në përgjithësi, masakrat motivoheshin në tri mënyra. Së pari, t'i hapej rruga "spastrimit etnik" nëpërmjet kërcënimit e frikës. Së dyti, të vriteshin individë të dyshuar si luftëtarë apo si simpatizantë të UÇK-së, dhë në këtë pikë është e qartë vështirësia e identifikimit të personave të duhur. Tek

individët e kërkuar përfshiheshin udhëheqës të shquar politikë, veprimtarë të të drejtave të njeriut, dhe biznesmenë të suksesshëm. Së treti ishin vrasjet për hakmarrje: disa masakra u kryen pasi UÇK-ja kish shkaktuar viktima ndër forcat serbe e jugosllave.

Ka dëshmi të padiskutueshme, sipas të cilave janë dhunuar varret e janë zhvendosur kufoma nga ana e trupave serbe e jugosllave.

Ndonëse kanë filluar të dalin shifra të besueshme, numri i të vdekurve në Kosovë gjatë luftës mbetet gjithsesi i panjohur dhe është shndërruar në një argument të një debati jo të vogël. Nëpërmjet hulumtimeve të veta, Human Rights Watch dokumentoi 3,453 ekzekutime nga ana e forcave qeveritare serbe e jugosllave, por ky numër është vendosmërisht më i vogël se sa numri i vërtetë, sepse bazohet mbi vetëm 577 intervista (dhe këta të intervistuar nuk janë zgjedhur në mënyrë të tillë, që të lejojnë një ekstrapolim të të dhënave për gjithë Kosovën). Në të njëjtën kohë, numri sigurisht nuk është aq i madh, sa është lënë të kuptohet gjatë luftës nga zyrtarë të qeverive perëndimore e të NATO-s, kur është aluduar edhe për 100,000 të vdekur.

Deri më korrik të vitit 2001, Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi kish zhvarrosur afërsisht 4,300 kufoma, për të cilat është besuar se janë viktima të masakrave të kryera nga forcat serbe e jugosllave në Kosovë. Kjo shifër është sigurisht më e vogël se sa totali i të vrarëve nga trupat qeveritare. Ç'është më e rëndësishmja, ka dëshmi të padiskutueshme, sipas të cilave janë dhunuar varret e janë zhvendosur kufoma nga ana e trupave serbe e jugosllave, gjë që është konfirmuar në verën e vitit 2001 edhe nga qeveria serbe post-Milosheviç. Human Rights Watch dokumentoi përpjekje për të fshehur apo për të rivarrosur kufoma në Tërrnje, Gjakovë, Izbicë, Rezallë, Krushë e Madhe, Krushë e Vogël, Suharekë, Sllovinjë, Poklek, Kotlinë dhe Pastasel. Përveç kësaj, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, 3,525 persona, përfshirë serbë etnikë, rezultojnë të humbur nga konflikti.

Analiza statistikore e kryer nga Human Rights Watch dhe nga Fondacioni Amerikan për Përparimin në Shkencë (AAAS) nxjerrin në pah mënyra ekzekutimesh, që flasin për natyrën sistematike të fushatës qeveritare. Fjala vjen, në paraqitjen grafike të ekzekutimeve jashtëgjyqësore në kohë, bien në sy tri momente, siç mund të shihet në grafikun 5 të kapitullit mbi Analizën Statistikore të Dhunimeve. Grafiku, përsa kohë Human Rights Watch nuk bëri një zgjedhje të studjuar të të

intervistuarve, nuk është një pasqyrim i përsosur i masakrave. Megjithatë, natyra kulmore e grafikut, me tri rritje të skajshme për intervale shumë të shkurtëra kohe, na bën të kuptojmë që masakrat nuk ishin rezultat i një dhune rastësore nga ana e forcave qeveritare. Sipas shumë gjasave, ato ishin operacione të planifikuara e të zbatuara me kujdes, në përputhje me synimet strategjike të qeverisë.

Përdhinimi e dhuna seksuale ishin gjithashtu elementë të fushatës.

Në të njëjtën mënyrë, grafiku 6, 10, 14 e 15, i cili paraqet rrjedhën e ekzekutimeve jashtëgjyqësore nëpër komuna në varësi të kohës, tregon kulme të ngjashme të kurbave në intervale të shkurtëra të kohës. "Zdërhallja" vrastare nëpër komuna vërehet në periudha të caktuara kohe, gjë që do të thotë se ka egzistuar një urdhër strategjik për të kryer këto masakra në zona të kërkuara.

Përdhinimi e dhuna seksuale ishin gjithashtu elementë të fushatës. Përdhunimet e grave shqiptare nuk përbëjnë akte të rralla e të izoluara të kryera nga individë të veçantë, por ishin instrumenta për të terrorizuar popullsinë civile, për të zhvatur pará nga familjarët e për të shtrënguar njerëzit ta braktisnin Kosovën. Në total, Human Rights Watch gjeti dëshmi të besueshme për nëntëdhjetë e gjashtë raste të dhunës seksuale të ushtruar nga ana e ushtarëve jugosllavë, policëve serbë apo paraushtarakëve në periudhën e bombardimit të NATO-s. Eshtë e qartë se numri i vërtetë është shumë më i lartë.

Përgjithësisht, përdhunimet në Kosovë mund të grupohen në tri kategori: përdhunime në shtëpitë e grave, përdhunime të grave në rrugë e sipër për të lënë Kosovën dhe përdhunime në lokalet e paraburgimit. Në kategorinë e parë, forcat e sigurimit hynin në shtëpitë private dhe përdhunonin gratë në prani të anëtarëve të tjerë të familjes, në oborr, apo në ndonjë dhomë të veçantë brenda apartamentit. Në kategorinë e dytë, gra që shpërnguleshin brenda për brenda, që ecnin në këmbë apo mbi zetorë së bashku me familjet e tyre, ndaleshin, plaçkiteshin e kërcënoheshin nga ushtarët, policët e nga paraushtarakët. Nëse familjet nuk kishin pará të thata për të paguar, forcat e sigurimit i kërcënonin se do t'u rrëmbenin vajzat e do t'i përdhunonin; në disa raste, vajzat janë rrëmbyer edhe pasi familjet jepnin pará. Kategoria e tretë e përdhunimeve ndodhte në qëndra të improvizuara paraburgimi, siç mund të ishin shtëpi e ahure të braktisura.

Një dukuri e përhapur gjatë vitit 1999 ishte edhe shkatërrimi i pronave

të privatëve. Sipas një studimi të UNHCR-së në nëntor të vitit 1999, pothuaj 40% e të gjitha shtëpive të banimit në Kosovë rezultonin të dëmtuara rëndë apo krejt të shkatërruara. Komunat që njiheshin për lidhje të forta me UÇK-në u përballën me pasoja më të rënda, pjesërisht edhe prej faktit që sulmet kundër tyre kishin filluar qysh në vitin 1998. Pati zona, të cilat edhe pse nuk shquheshin si mbështetëse të UÇK-së, u goditën megjithatë, si fjala vjen qyteti i Pejës, ku më shumë se 80% e shtëpive të banimit u shkatërruan apo u dëmtuan rëndë.

Dëshmitarë e viktima të shumta i treguan Human Rights Watch se si forcat qeveritare, qoftë në shtëpitë e tyre, qoftë kur ishin në rrugë e sipër për të lënë Kosovën, u kishin zhvatur gjëra të çmueshme, përfshirë unaza martesore e automobilë.

Shkollat e xhamitë patën të njëjtin fat. Sipas një vlerësimi të Kombeve të Bashkuara, u vëzhguan 649 shkolla të Kosovës, dhe më shumë se një e pesta rezultonin të dëmtuara rëndë, ndërsa 60% e tyre ishin krejt të shkatërruara. Përveç kësaj, forcat serbe e jugosllave tentuan dhe arritën të nxirrnin jashtë përdorimit puset e burimet ujore në të gjithë territorin e Kosovës duke derdhur në to lëndë kimike, kafshë të ngordhura apo mbetje kufomash njerëzore. Human Rights Watch dokumentoi raste në katër fshatra, ku viktimat njerëzore ishin hedhur në burimet ujore apo në puse.

Dëshmitarë e viktima të shumta i treguan Human Rights Watch se si forcat qeveritare, qoftë në shtëpitë e tyre, qoftë kur ishin në rrugë e sipër për të lënë Kosovën, u kishin zhvatur gjëra të çmueshme, përfshirë unaza martesore e automobilë. Policë, ushtarë, e sidomos pjesëtarë të njësive paraushtarake kërcënuan individë të ndryshëm me vdekje, nëse këta të fundit nuk binin dakord të jepnin pará, rëndom marka gjermane. Një vjedhje e tillë është përmendur në mënyrë të përsëritur, madje edhe nga pjesëtarë të forcave të sigurimit, të cilët folën me median ndërkombëtare pas luftës. Për disa syresh, kjo ishte arsyeja që ata shkuan në Kosovë. Shumë vullnetarë thanë se ata ishin liruar nga burgjet në Serbi, me kushtin që të binin dakord për të shërbyer krahas policisë e ushtrisë.

Ky raport dokumenton gjithashtu dukurinë e detyrimit të të paraburgosurve për të hapur transhe apo për të pastruar bunkerë, si dhe atë të përdorimit të civilëve si shqyt njerëzor për të mbrojtur trupat nga

sulmet e NATO-s e të UÇK-së. Qeveria jugosllave vendosi gjithashtu mina tokësore antitank e antipersonel, sidomos në kufirin me Shqipërinë e Maqedoninë. Sipas shumë gjasave, kjo ishte edhe një masë që merrej për t'i bërë ballë tentativës për pushtim tokësor të Kosovës.

HIERARKIA DHE ZINXHIRI I KOMANDAVE

Forcat qeveritare të përfshira në konflikt ishin një kombinacion kompleks i policëve të Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme dhe i policëve specialë, i ushtarëve dhe njësive speciale të Ushtrisë Jugosllave, i forcave paraushtarake, i milicëve lokalë dhe i një shumëllojshmërie luftëtarësh të huaj. Që të gjithë vepronin nën urdhërat e qeverisë në Beograd.

Ushtria jugosllave kish komandën e përgjithshme gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s. Forcat policore e paraushtarake, në përputhje me ligjin, ishin nën urdhërat e ushtrisë. Sidoqoftë, duhet përmendur që zyrtarët e lartë të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme ushtronin një ndikim të madh në zhvillimin e fushatës. Ushtria kontrollonte rrugët e kufijtë kryesorë, duke koordinuar e lehtësuar procesin e "spastrimit etnik". Forcat policore e paraushtarake ishin drejtëpërdrejt më të përfshira në dëbimin e civilëve dhe shkatërrimin e fshatrave, ndërsa ushtria bënte vetëm mbështetjen me artileri. Pikërisht gjatë këtyre operacioneve burrat ndaheshin shpesh herë nga gratë e fëmijët, pyeteshin rreth UÇK-së, dhe ekzekutoheshin pa asnjë shkak.

Ushtria Jugosllave është nën komandën e Presidentit të Jugosllavisë, si në kohë lufte, edhe në kohë paqeje.

Sipas ligjit jugosllav, Ushtria Jugosllave (Vojska Jugosllavije, ose VJ) është nën komandën e Presidentit të Jugosllavisë, si në kohë lufte, edhe në kohë paqeje. Deri në tetor të vitit 2000, ky ishte Sllobodan Millosheviçi. Struktura kontrolluese e VJ-së është Këshilli i Lartë i Mbrojtjes, i përbërë nga Presidentët e Serbisë, Malit të Zi e Jugosllavisë, dhe i drejtuar nga Presidenti i Jugosllavisë. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë gjatë luftës ishte gjeneral Dragoljub Ojdaniç, i cili u emërua pas luftës për të shërbyer si Ministër i Mbrojtjes – pozicion që ai e mbajti deri në tetor të vitit 2000.

VJ-ja është e ndarë në tri armata. Armata e tretë e komanduar gjatë

luftës nga kol.gjen. Nebojsha Pavkoviç ishte përgjegjëse për Kosovën e Serbinë e Jugut. Deri në gusht të vitit 2001, Pavkoviçi ishte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave. Gjatë luftës, një shkallë më poshtë se Pavkoviçi ishte major gjen. Vladimir Llazareviç, i cili komandoi korpusin e Prishtinës së armatës së tretë, që ish e stacionuar në Kosovë. Nën urdhërat e Llazareviçit ishin pesë brigada, një njësi e policisë ushtarake, dhe një regjiment i aviacionit. Komandantët e strukturave të sapopërmendura janë emërtuar në kapitullin Forcat në Konflikt.

Struktura e Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (Ministarstvo Unustrasnjih Posllova, ose MUP), e drejtuar gjatë luftës nga Ministri Vllajko Stojiljkoviç, është më e komplikuar se sa ajo e VJ-së, e cila ka një zinxhir transparent komandash. Brenda MUP-it ishin policia e rregullt e Kosovës e komanduar nga Sreten Lukiç, policia speciale (Posebne Jedinice Policije, ose PJP) e komanduar nga Lejtënant gjeneral Obrad Stevanoviç, dhe forcat antiterroriste (Specijalna Antiteroristicka Jedinica, ose SAJ) të komanduara nga kolonel Zhivko Trajkoviç. Kolonel gjeneral Vlastimir Gjorgjeviç ishte kreu i sektorit të sigurimit publik të MUP-it, si dhe ndihmës i Ministrit të Punëve të Brendshme. Qeveria e re serbe i zëvendësoi Gjorgjeviçin e Stevanoviçin në janar të vitit 2001, por gradoi Lukiçin si shef të sigurimit publik si dhe si zv. Ministër i Punëve të Brendshme.

Ministria Serbe e Punëve të Brendshme përmban gjithashtu shërbimin e sigurimit të shtetit, apo policinë sekrete, e cila luajti një rol të dorës së parë në Kosovë. Përveç aktiviteteve të fshehta, siç ishin survejimi e gjurmimi i veprimtarëve politikë shqiptarë dhe i pjesëtarëve të UÇK-së, sigurimi i shtetit dislokoi njësitë e veta të operacioneve speciale, JSO-në (Jedinica za Specijalne Operacije), dhe ndihmoi organizata të ndryshme paraushtarakësh. E njohur edhe me emrat "Beretat e Kuqe" apo "Djemtë e Frenkit" (për t'i bërë homazh Frenki Simatoviçit, një personalitet i rëndësishëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili njihet si themeluesi i këtij grupi), JSO u komandua gjatë luftës nga Milorad Lukoviç, i njohur ndryshe me emrin "Legija". Deri në janar të vitit 2001, kreu i sigurimit shtetëror serb ishte kolonel gjeneral Radomir Markoviç. Ai u shkarkua nga fundi i janarit dhe u arrestua një muaj më vonë nga policia serbe për përfshirjen e tij në sulmin që ju bë më 1999 politikanit serb Vuk Drashkoviç. David Gajiç ish kreu i sigurimit të shtetit në Kosovën e gjatë luftës.

Së fundi, forca të ndryshme paraushtarake, ashtu si edhe mercenarë të huaj lufte, ishin aktivë në Kosovë, dhe ç'është më e rëndësishmja, ishin nën kontrollin e qeverisë qëndrore. Duke lënë mënjanë faktin, që këta të fundit përbënin forcat më të dhunshme në Kosovë, duhet thënë se aktiviteti kryesor i paraushtarakëve ishte plaçkitja dhe vjedhja.

Ndonëse kufijtë e saktë të komandave e kontrollit mbi këto forca paraushtarake mbeten të paqartë, bashkëpunimi i tyre me ushtrinë jugosllave e policinë serbe ishte evident. Pjesëtarët e forcave paraushtarake, të cilët folën pas luftës me shtypin ndërkombëtar, thanë se zyrtarët lokalë u jepnin atyre shpesh listat me emra shqiptarësh etnikë, të cilët ishin planifikuar të vriteshin. Shumë persona ishin liruar nga burgu, me kushtin që ata të luftonin në Kosovë. Në atë kohë, individë të veçantë në përbërje të ushtrisë apo policisë u përpoqën të sinjalizonin apo të merrnin në mbrojtje civilët shqiptarë që kërcënoheshin nga paraushtarakët, ndonëse kjo gjë ndodhte rrallë; më shpesh ndodhte që policët të bashkëpunonin ngushtë me njësitë paraushtarake, shpesh duke formuar një kordon rrotull komuniteteve të planifikuar për t'u sulmuar, ndërkohë që trupat paraushtarake nisnin të vepronin.

Njësi dhe grupe të ndryshme brenda MUP-it e bëjnë hierarkinë e komandave më pak të qartë se sa atë të VJ-së, ndonëse është e qartë se autoriteti më i lartë i MUP-it ishte Presidenti jugosllav Sllobodan Milosheviç. Sipas ligjit jugosllav, kur deklarohet gjendja e luftës, policia serbe është nën jurisdiksionin e ushtrisë jugosllave, gjë që e bënte Sllobodan Milosheviçin *de facto e de jure* komandant të policisë në periudhën e bombardimit të NATO-s. Zëvendës Kryeministri i atëhershëm jugosllav Nikolla Shahinoviç luajti gjithashtu një rol të rëndësishëm.

Gjeografia e natyra sistematike e krimeve në Kosovë e bëjnë të pagjasë që udhëheqësit serbë e jugosllavë të mos kenë qënë në dijeni mbi atë që ndodhte.

Ligji ndërkombëtar është i qartë kur flet për përgjegjësinë individuale kriminale të udhëheqësve, që organizojnë apo tolerojnë kryerjen e krimeve të luftës. Edhe autorët e drejtëpërdrejtë të krimeve, edhe udhëheqësit ushtarakë apo politikë, të cilët kanë urdhëruar kryerjen e krimeve, edhe ata që nuk kanë marrë masa për parandalimin e krimeve apo që nuk kanë ndëshkuar autorët, mund të konsiderohen përgjegjës.

Siç provon ky raport, gjeografia e natyra sistematike e krimeve në Kosovë

e bëjnë të pagjasë që udhëheqësit serbë e jugosllavë të mos kenë qënë në dijeni mbi atë që ndodhte, pavarësisht se këta kanë mbrojtur tezën e kundërt. Vetëm në shumë pak raste janë dënuar pjesëtarë të forcave të sigurimit për kryerjen e krimeve të rënda, siç është vrasja. Në të kundërt, periudha e pasluftës na ballafaqoi me gradime, shpërblime e emërime të personelit policor e ushtarak, ku u përfshinë edhe zyrtarët më të lartë, si Dragoljub Ojdaniç, Nebojsha Pavkoviç, Vladimir Llazareviç, Obrad Stevanoviç, Sreten Lukiç, Vlastimir Gjorgjeviç dhe Zhivko Trajkoviç, si dhe shumë prej komandantëve të brigadave të korpusit të Prishtinës. Një listë e plotë e të graduarve dhe e të shpërblyerve është përfshirë në shtesën e kapitullit Forcat në Konflikt.

GJYKATA E KRIMEVE TË LUFTËS

Pas një fillimi të ngadaltë në vitin 1998, Gjykata Kriminale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë bëri një hetim të plotë të krimeve të kryera në Kosovë. Më 27 maj 1999, Gjykata njoftoi se kish ngritur padinë më të bujshme e më domethënëse: Presidenti jugosllav dhe katër zyrtarë të tjerë të lartë u akuzuan për "vrasjen, persekutimin dhe deportimin e shqiptarëve të Kosovës" në periudhën nga 1 janari deri fund të majit të vitit 1999. Të paditurit e tjerë janë: Milan Milutoniviç, President i Serbisë dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, Dragoljub Ojdaniç, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, Nikolla Shahinoviç, zëvendës Kryeministër i RFJ-së dhe Vllajko Stojiljkoviç, Ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Hetimet e Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare mbi Krimet e Luftës, përfshirë edhe ato të kryera nga UÇK-ja, po vazhdojnë. Më 1 prill të vitit 2001, policia serbe arrestoi Milosheviçin me akuzën për korrupsion. Më 28 qershor, ai u transferua në Hagë. Deri në gusht të vitit 2001, të akuzuarit e tjerë kanë qënë të paarrestuar.

Gykata bëri gjithashtu një vlerësim të aksioneve të NATO-s gjatë luftës, duke arritur në përfundimin që nuk kish vend për të hetuar e ngritur akuza në këtë drejtim. Vlerësimi i Human Rights Watch mbi fushatën ajrore të NATO-s është disi i ndryshëm. Ndonëse Human Rights Watch nuk gjeti prova të krimeve të luftës të kryera nga NATO, u arrit në përfundimin që aleanca ushtarake euroatlantike dhunoi ligjin

ndërkombëtar humanitar duke marrë masa të pamjaftueshme për identifikimin e pranisë së civilëve, ndërsa bombardoheshin objektiva të lëvizshëm. Siç është nënvizuar më parë në një raport të Human Rights Watch të shkurtit të vitit 2000, të titulluar *Vdekjet e Civilëve gjatë Fushatës Ajrore të NATO-s*, bombardimi i NATO-s shkaktoi në të gjithë Jugosllavinë rreth 500 viktima civile. 55-60% e këtyre viktimave ishin kosovarë. Në këtë raport është kritikuar gjithashtu përdorimi nga ana e NATO-s i minave kasetë, ndonëse një gjë e tillë është e ndaluar në një konflikt të armatosur. Ashtu si në rastin e armëve çfarëdo që nuk kursejnë askënd, kur përdoren në zona urbane, edhe minat kasetë, për shkak të një shkalle të lartë gabimi, paraqesin një rrezik serioz për popullsinë civile. Nga 24 marsi deri më 7 maj të vitit 1999, u hodhën mbi Kosovë dhe mbi Jugosllavi rreth 1,500 mina kasetë.

ABUZIMET E UÇK-SË

Siç është paraqitur në kapitullin "Konteksti Historik", UÇK-ja ishte përgjegjëse për abuzime të rënda gjatë vitit 1998, përfshirë këtu rrëmbime e vrasje serbësh apo shqiptarësh të konsideruar kolaboracionistë. Në disa fshatra që ishin nën kontrollin e UÇK-së gjatë vitit 1998, rebelët dëbuan serbët etnikë nga shtëpitë e tyre. Disa prej atyre që mbetën rezultojnë të humbur dhe hamendësohet që janë rrëmbyer e janë vrarë nga UÇK-ja. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, nëntëdhjetë e shtatë serbë të Kosovës, të cilët rezultuan të humbur në vitin 1998, nuk e gjendën deri në 15 maj të vitit 2000.

UÇK-ja ishte përgjegjëse për abuzime të rënda gjatë vitit 1998, përfshirë këtu rrëmbime e vrasje serbësh apo shqiptarësh të konsideruar kolaboracionistë.

UÇK-ja paraburgosi nja tetëdhjetë e pesë serbë gjatë sulmit mbi Rrahovec më 19 korrik 1998. Tridhjetë e pesë syresh u lëshuan pak më vonë, por të tjerët mbetën të humbur deri në gusht të vitit 2001. Më 22 korrik 1998, UÇK-ja mori për një kohë të shkurtër nën kontroll minierën e Belacevacit pranë Obiliqit. Atë ditë u kapën nëntë serbë, dhe ata janë ende në listën e të humburve të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Në shtator 1998, policia serbe grumbulloi tridhjetë e katër kufoma të njerëzve, për të cilët u hamendësua se ishin kapur e vrarë nga UÇK-ja në

liqenin e Radonjicit pranë Gllogjanit. Midis viktimave kish edhe shqiptarë etnikë. Por abuzimi më i rëndë i UÇK-së u raportua përpara se të ndodhte kjo, dhe kish lidhje me vrasjen në muajin gusht të njëzet e dy civilëve serbë në fshatin Kleçkë, ku policia pretendoi se kish zbuluar pjesë kufomash dhe një furrë që përdorej për të kremuar trupat pa jetë. Mënyra se si u shpjegua ky pretendim i policisë, e lë disi të dyshimtë ngjarjen.

UÇK-ja, e cila u rrit në periudhën 1996-1999 nga një grup guerrilasish të shpartalluar në një lëvizje të armatosur të mirëorganizuar, mori pjesë në shumë luftime taktike, të cilat vunë në rrezik jetën e civilëve. Njësitet e UÇK-së zinin prita apo sulmonin pozicionet e policisë e të ushtrisë në fshatra të caktuara, e më pas tërhiqeshin, duke i lënë fshatarët nën mëshirën e hakmarrjes së mundshme. Masakra të vërteta shpesh ndodhën për këtë arsye, duke dhënë kështu një ndihmë në përhapjen e kauzës së UÇK-së dhe në internacionalizimin e konfliktit.

Elementë të UÇK-së janë gjithashtu përgjegjës për sulme të ndryshme në periudhën e pasluftës mbi serbë, romë dhe jo-shqiptarë të tjerë, madje edhe mbi shqiptarë etnikë, të cilët shiheshin si rivalë politikë. Menjëherë pas hyrjes së NATO-s në Kosovë pati djegje e plaçkitje sistematike të shtëpive të serbëve, romëve, pjesëtarëve të minoriteteve të tjera të Kosovës, si dhe dhunime të kishave e manastireve ortodokse. Kjo dhunë u shoqërua me kërcënime, të cilat synonin largimin e pakicave jo shqiptare nga Kosova. Deri nga fundi i vitit 2000, e kishin lënë krahinën më shumë se 210,000 serbë; shumica e tyre ikën në javët e para të pasluftës. Ata që mbetën ishin të përqëndruar në enklava mono-etnike, fjala vjen në Mitrovicë, Fushë Kosovë apo Graçanicë.

Menjëherë pas hyrjes së NATO-s në Kosovë pati djegje e plaçkitje sistematike të shtëpive të serbëve, romëve, pjesëtarëve të minoriteteve të tjera të Kosovës, si dhe dhunime të kishave e manastireve ortodokse

Ç'është më e rënda, prej 12 qershorit janë vrarë apo kanë humbur rreth një mijë serbë e romë. Sipas shumë gjasave, në incidentet e pasluftës janë përfshirë banda kriminale e individë hakmarrës. Sidoqoftë, elementë të UÇK-së janë përgjegjës për shumë prej këtyre krimeve. Dëshira për hakmarrje është vetëm një shpjegim i pjesshëm, pasi në një numër të madh sulmesh nuk duhet të anashkalohet një objektiv i qartë politik: largimi nga Kosova i banorëve jo shqiptarë në mënyrë që të përligjej më mirë kauza e shtetit të pavarur të Kosovës.

Vetë shqiptarët etnikë nuk mbetën jashtë vorbullës së kësaj dhune. Janë rrahur, rrëmbyer apo vrarë shqiptarë të akuzuar për "bashkëpunim" me autoritetet serbe, sidomos në komunat e Prizrenit, Gjakovës dhe Klinës. Sulmet kundër veprimtarëve politikë e partiakë, sidomos kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës, vazhduan edhe pas zgjedhjeve administrative të 28 tetorit 2000.

ROLI I KOMUNITETIT NDËRKOMBËTAR

Reagimi i ngadaltë i komunitetit ndërkombëtar është një nga shkaqet e përhapjes së dhunës së pasluftës; Kombet e Bashkuara dhe NATO nuk vepruan me vendosmëri qysh në fillim për të frenuar shpërnguljen e dhunshme dhe vrasjen e pjesëtarëve të popullsisë jo shqiptare, gjë që krijoi një precedent për periudhën pas 12 qershorit. Nga mesi i vitit 1999, nuk kish veçse një grusht policësh të Kombeve të Bashkuara, dhe në këtë mënyrë funksionet e policisë civile i morën trupat e KFOR-it të NATO-s, të cilët ishin të papërgatitur për këtë gjë. NATO ish e merakosur më shumë për të mbrojtur trupat e veta, se sa për të mbrojtur civilët. Dy vjet pas përfundimit të luftës nuk ish ndërtuar ende një system gjyqësor funksional, gjë që kontribuoi në krijimin e klimës, ku krimi nuk ndëshkohej.

Avazi i vazhdueshëm i dëgjuar nga Kombet e Bashkuara ishte se rezultatet e dobëta vinë nga mungesa e mjeteve e forcave. Eshtë e vërtetë që fondet janë të pamjaftueshme për të paguar policë, gjyqtarë e prokurorë, por pengesa kryesore ka të bëjë me mungesën e vullnetit politik. Zyrtarë të lartë të NATO-s e të Kombeve të Bashkuara e dinë shumë mirë që, njerëz të lidhur me ish-UÇK-në, përfshirë disa prej figurave të rëndësishme politike të Kosovës, janë të implikuara në dhunën kundër pakicave dhe në aktivitete kriminale, por zgjidhjes së kësaj çështjeje i është bërë bisht.

Perëndimi bënte sehir ndërsa UÇK-ja lindi e u rrit, ndërsa shteti jugosllav u përgjigj dhunshëm e ndërsa krahina shkoi drejt konfliktit të armatosur.

Gabimet e komunitetit ndërkombëtar lidhur me Kosovën fillojnë më herët. Në kapitullin "Konteksti Historik", ky raport bën një përshkrim të reagimit të komunitetit ndërkombëtar ndaj konfliktit qysh prej vitit 1990. Prej '90-ës deri në '98-ën, perëndimi dështoi në mbështetjen e lëvizjes

paqësore të shqiptarëve të Kosovës, veçantërisht duke e lënë çështjen e Kosovës jashtë axhendave diplomatike në kohën e luftës në Bosnjë e Kroaci. Perëndimi bënte sehir ndërsa UÇK-ja lindi e u rrit, ndërsa shteti jugosllav u përgjigj dhunshëm e ndërsa krahina shkoi drejt konfliktit të armatosur.

Faji kryesor lidhur me tragjedinë e Kosovës bie mbi ish-Presidentin jugosllav Sllobodan Milosheviç dhe mbi udhëheqjen e atëhershme serbe e jugosllave.

Gjatë gjithë kohës së konfliktit, komuniteti ndërkombëtar nuk arriti të merrte një pozicion të përbashkët për zgjidhjen e krizës. Sllobodan Milosheviç i shfrytëzoi këto mosmarrëveshje në favorin e vet. Ai merrej me një shtet, pastaj me një tjetër, e ndërkohë fitonte kohë për të organizuar fushatën e vet. Pjesëtarë të komunitetit ndërkombëtar i shfrytëzuan këto mosmarrëveshje gjithashtu, duke nxjerrë kështu mosveprimin e njërit apo tjetrit si shkak të krizës. Në institucionet, ku komuniteti ndërkombëtar dënonte fuqimisht dhunën, fjalët dhe reagimi simbolik rezultuan të pakuptimtë, afatet e vëna shtyheshin, kushtet e vëna harroheshin dhe sanksionet ose zbatoheshin përgjysëm, ose nuk zbatoheshin fare.

Raporti arrin në përfundimin që interesat e komunitetit ndërkombëtar në ruajtjen e status quo-së së arritur në Bosnjë dhe alergjia ndaj ndryshimit të kufijve ndërkombëtarë bënë që dhuna të shndërrohej në një luftë të armatosur. Nëse komuniteti ndërkombëtar do të donte të nxiste integritetin territorial në Ballkan, do të lipsej t'i mëshohej unitetit kombëtar mbi bazën e respektimit të të drejtave të të gjithë qytetarëve. Pikërisht respektimi i këtyre të drejtave ka munguar në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Ballkanit. Duke lënë të pasfiduara dhunën e abuzimet, u shkua drejt destabilitetit rajonal, gjë që komuniteti ndërkombëtar kish synuar të shmangte.

Së fundi, faji kryesor lidhur me tragjedinë e Kosovës bie mbi ish-Presidentin jugosllav Sllobodan Milosheviç dhe mbi udhëheqjen e atëhershme serbe e jugosllave, të cilët jo vetëm nuk kërkuan zgjidhje paqësore së bashku me shqiptarët e Kosovës, por hartuan e zbatuan një fushatë të dhunshme kundër kryengritësve të armatosur e kundër civilëve. Siç tregon ky raport, të gjitha dëshmitë nxjerrin zbuluar përfshirjen e tyre në krime të rënda lufte.

Fitorja elektorale e Opozitës Demokratike Serbe në zgjedhjet e vjeshtës së vitit 2000 hapi derën për ndryshime brenda shoqërisë serbe e jugosllave dhe për një zgjidhje paqësore të një konflikti të gjatë në rajon. Por stabiliteti jetëgjatë në Kosovë, Serbi e rajon nuk do të arrihet pa nxjerrjen e përgjegjësisë për krimet e kryera nga të të gjitha palët.

Shqiptar etnik në fshatin Ploçicë, shtator 1998 FOTO NGA WADE GODDARD

2

KONTEKSTI HISTORIK

HYRJE

Në vitin 1989, kur qeveria serbe i hoqi Kosovës statusin e krahinës autonome brenda Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, analistë e veprimtarë politikë të brendshëm e të jashtëm parashikuan përkeqësimin e gjendjes. “Fitil i ndezur”, “fuçi baruti”, dhe emërtime të tjera klishé u përdorën për të përshkruar perspektivën e konfliktit të armatosur në krahinën e Kosovës dhe në Jugosllavi.

Më tej, rreziku u bë i qartë çdo vit e më shumë, ndonëse luftrat që përfshinë pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë nuk u përhapën në Kosovë. Trajtimi i dhunshëm nga ana e qeverisë serbe i shqiptarëve të Kosovës u intensifikua, dhe shqiptarët etnikë, duke mos nuhatur ndonjë mundësi për përmirësimin e situatës, gradualisht humbën besimin tek politika jo e dhunshme që kishin ndjekur qysh prej vitit 1990. Nga fundi i 1996-ës, një grup guerrilasish të panjohur më parë dhe i quajtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) filloi të koordinojë sulmet kundër policisë serbe. Qeveria u përgjigj me forcë duke mos bërë dallim midis guerrilasve e pjesës tjetër të popullsisë, dhe kështu, cikli i dhunës zuri të marrë teposhtë.

Pavarësisht shenjave paralajmëruese të përsëritura gjatë dhjetëvjeçarit, komuniteti ndërkombëtar dështoi në parandalimin e një konflikti të parashikueshëm. Taktikat politike afatshkurtëra dhe të palidhura njëra me tjetrën morën përparësi mbi politikat strategjike afatgjata. Ndarjet dhe gara midis qeverive e organizmave ndërkombëtare bënë që veprimi i përbashkët të ishte i dobët dhe kuturú – karakteristika këto, që qeveria e Milosheviçit i shfrytëzoi me dinakëri.

Angazhimi serioz dhe i përbashkët erdhi vetëm pasi konflikti kish degjeneruar në një luftë të vërtetë. Në këtë moment, duke mos patur dhe

Të favorizuara nga bombardimet e NATO-s, forcat serbe e jugosllave bënë spastrimin etnik të më shumë se 850 mijë shqiptarëve të Kosovës, dhe vranë disa mijra të tjerë. Bombardimet e NATO-s i detyruan trupat qeveritare ta linin Kosovën, por më përpara ato trupa kishin kryer krime të rënda lufte, të cilat vazhdojnë ta helmojnë mjedisin e pas luftës në Kosovë.

Çfarë dëshmohet lidhur me të drejtat e njeriut në këtë raport përbën rezultatin e dështimit të perëndimit në administrimin e kësaj krize të pritshme. Dëbimet dhe vrasjet në shkallë të gjerë të serbëve e shqiptarëve, madje edhe pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, na japin një leksion të rëndësishëm: Nëse nuk veprohet, shtypja qeveritare dhe abuzimi me të drejtat e njeriut, veçanërisht kundër pakicave, mund të prodhojnë lehtësisht konfrontime të dhunshme, që sjellin abuzime akoma më të dhunshme. E thënë ndryshe, stabiliteti real dhe jetëgjatë në Ballkan nuk mund të kuptohet pa qeveri demokratike, që respektojnë të drejtat e njeriut.

Ka patur shumë debate mbi atë, se çfarë mund të bënte komuniteti ndërkombëtar për të ndaluar dhunën në Kosovë. Një fakt është i qartë: komuniteti ndërkombëtar mund të vinte në jetë masa ekonomike e politike kreative të tilla, që ato të frenonin sjelljen abuzive qeveritare kundër civilëve. Kostoja e masave të tilla do të kishte qënë me siguri më e vogël se sa kostoja e ndërhyrjes së NATO-s dhe e misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Çfarë vijon më poshtë përbën një kronologjí të krizës në Kosovë dhe një analizë të shanseve të pashfrytëzuara nga ana e komunitetit ndërkombëtar.

HISTORI E SHKURTËR E KONFLIKTIT NË KOSOVË

Duhet të kthehemi shekuj prapa për të kuptuar plotësisht marëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve dhe betejat e tyre në Kosovë. Të dyja palët e konsiderojnë krahinën qendër të mirëqënies së tyre kulturore e politike, dhe kanë dështmuar, se janë të gatshëm të bëjnë luftë për ta patur atë nën kontroll. Politika nacionaliste serbe e ka shndërruar mbajtjen e Kosovës dhe të trojeve të saj historike si një element bazë të saj. Konfrontimet e dhunshme kanë shenjuar historinë e

kësaj zone, ndonëse shqiptarët dhe serbët kanë qënë edhe aleatë në ndonjë luftë. Akuza të ndërsjellta për krime mizore në luftërat ballkanike, në luftën e parë dhe të dytë botërore, ashtu si edhe në beteja të mëparshme, kanë mjegulluar historinë e rajonit.

Megjithëse ky kontekst historik është i rëndësishëm për të kuptuar konfliktin, dhe megjithëse historia e rajonit luan një rol të madh në situatën e sotme, debatet historike janë të dorës së dytë në raport me zhvillimet e kohëve të fundit që kanë kushtëzuar luftën në Kosovë. Versione të përzgjedhura të historisë dhe ankime të së shkuarës përbënin një tokë pjellore për politikanë oportunistë të viteve '80 e '90, të cilët shtinin kështu në punë frikërat e zhgënjimet e shqiptarëve e të serbëve. Historia është keqpërdorur nga politikanë nacionalistë agresivë, të cilët kanë nxjerrë përfitime duke nxitur urrejtje, ksenofobí, militarizim, dhe së fundi, luftë.

Kosova në Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë

Pas luftës së dytë botërore, kushtetuta federale i përkufizonte shqiptarët etnikë në Jugosllavi më shumë si një "kombësi", se sa si një "komb" konstituiv të federatës, ndonëse si grup etnik ishin të tretët për nga numri i popullsisë. Ky ishte një status që dallonte nga ai i grupeve të tjera etnike më të rëndësishme – serbëve, kroatëve, bosnjakëve, sllovenëve dhe maqedonasve. Edhe kështu, në emër të "vëllazërisë e bashkimit" socialist, Jugosllavia i ruante në dukje të drejtat e pakicave, të cilat i përkisnin të gjitha grupeve etnike.

Historia është keqpërdorur nga politikanë nacionalistë agresivë, të cilët kanë nxjerrë përfitime duke nxitur urrejtje, ksenofobí, militarizim, dhe së fundi, luftë.

Kosova ishte rajoni më i varfër në Jugosllavi. Duke përjashtuar minierën zemërgjerë të Trepçës, pjesa tjetër e krahinës ish kryesisht bujqësore. Varfëria dhe nënzhvillimi në mes të gjitha grupeve etnike në Kosovë acaruan tensionet. Disa përmirësime erdhën pas demonstratave të studentëve nga fundi i viteve '60, siç ishin rritja e investimeve publike, hapja e universitetit të Prishtinës, dhe punësimi i shqiptarëve të Kosovës në administratën lokale.

Duke tentuar të bëjë një balancim më të mirë midis grupeve etnike të

vendit dhe një korigjim të pushtetit të Serbisë në kuadër të federatës, udhëheqësi jugosllav Josif Broz Tito ideoi një kushtetutë të re më 1974, nëpërmjet së cilës u dha më shumë autonomi dy rajoneve të Serbisë: Kosovës dhe Vojvodinës (kjo e fundit me një numër të madh hungarezësh etnikë). Megjithëse nuk arritën statusin e republikave federale të Bosnjës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë, dy krahinat u deklaruan "krahina autonome", gjë që bënte të mundur përfaqësimin e tyre në presidencën federale dhe u jepte të drejtën të kishin bankat e tyre qëndrore, polici të veçantë, parlament dhe qeveri rajonale. Shqiptarët etnikë u bënë kështu pjesë e disa qarqeve të elitës sunduese.

Shqiptarët etnikë, të cilët në vitin 1971 përbënin rreth 74% të popullsisë së Kosovës, morën shumicën e pozitave kyçe në pushtetin e krahinës, morën nën kontroll sistemin e arësimit, sistemin gjyqësor dhe policinë, ndonëse gjithçka ishte nën kontrollin e Titos dhe të Partisë Komuniste, e cila ishte forca politike sunduese e vendit. Universiteti në gjuhën shqipe i Prishtinës u hap më 1970 dhe pati përkrahjen e autoriteteve.

Ideja e autonomisë së Kosovës nuk u përqafua kurrë prej një segmenti të rëndësishëm të elitës sunduese serbe, e cila e shihte këtë autonomi si një kërcënim ndaj interesave e sovranitetit të Serbisë. Autonomia e Kosovës dhe e Vojvodinës, argumentonin disa, dobësonte pushtetin serb në Jugosllavi. Zërat kritikë u zbehën gjatë viteve '70, por rifilluan të gjallërohen pas vdekjes së Titos në vitin 1980. Një vit më pas, shqiptarët etnikë të udhëhequr nga studentët e universitetit, fillimisht shprehën pakënaqësinë ndaj kushteve të këqija të ushqimit e strehimit nëpër konvikte, e më pas dolën në rrugë për të kërkuar rroga më të larta, liri shprehjeje më të madhe, lirimin e të burgosurve politikë dhe statusin e Republikës brenda Jugosllavisë. Demonstratat e tyre u shpërndanë me dhunë nga ushtria jugosllave dhe nga policia federale, gjë që solli vdekjen e një numri shqiptarësh dhe arrestime të shumta. Disa të burgosur politikë të asaj kohe, së bashku me të rinjtë që u larguan nga Kosova për t'iu shmangur arrestimit, formuan më vonë grupet radikale të emigrantëve në Europën perëndimore, prej të cilave, pesëmbëdhjetë vjet më vonë lindi UÇK-ja. [1] Nga radhët e shqiptarëve etnikë, Beogradi mori e ngriti në drejtim një lidership të ri komunist.

Serbët etnikë dhe pakica të tjera, si turqit dhe romët, iu nënshtruan keqtrajtimit, kërcënimit, e ndonjëherë dhunës së ekstremistëve të shumicës shqiptare.

Trajtimi i pakicave joshqiptare

Nga fundi i viteve ’70 e fillimi i viteve ’80, serbët e Kosovës ankoheshin se keqtrajtoheshin e diskriminoheshin nga popullsia e udhëheqja e shqiptarëve etnikë, me synimin (kështu pretendonin serbët) për t’i shtrënguar ata ta linin krahinën. Sipas një raporti të hartuar nga e famshmja Akademi serbe e Shkencave dhe e Arteve më 1988, më shumë se 20 mijë serbë etnikë u larguan nga Kosova midis viteve 1981-1987. [2] Shqiptarët kishin pretendimin se serbët e linin Kosovën për arsye ekonomike, pasi kjo e fundit ishte krahina më e varfër jugosllave.

Serbët etnikë dhe pakica të tjera, si turqit dhe romët, iu nënshtruan keqtrajtimit, kërcënimit, e ndonjëherë dhunës së ekstremistëve të shumicës shqiptare. Qeveria e Kosovës e administruar prej shqiptarëve etnikë, nuk mori masat e nevojshme për të hetuar këto abuzime apo për të mbrojtur pakicat e Kosovës. [3]

Në të njëjtën kohë, popullsia e shqiptarëve etnikë rritej në mënyrë të qëndrueshme, pasi shqiptarët e Kosovës dalloheshin për lindshmërinë më të lartë në Europë, duke sjellë në atë që Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve e quante “presion i lartë jo vetëm mbi pasuritë në dispozicion, por gjithashtu edhe mbi grupet e tjera etnike”. [4]

Lulëzimi i nacionalizmit serb

Mesi dhe fundi i viteve ’80 u shenjua nga një gjallërim i dukshëm i nacionalizmit serb, sidomos në mesin e serbëve që jetonin jashtë republikës serbe. Këta gjithmonë e më shumë ndjeheshin të izoluar dhe të kërcënuar nga nacionalizmi që po ngrihej rreth tyre në Kroaci, Bosnjë e Kosovë. Më të zëshëm ishin serbët e Kosovës, të cilët ankoheshin për keqtrajtim nga ana e shqiptarëve etnikë.

Në shtator 1986, u botua një dokument i Akadamisë serbe të Shkencave dhe të Arteve, i cili trajtonte “çështjen serbe” në Jugosllavi. I njohur me emrin Memorandum, dokumenti sulmonte politikanët serbë që nuk bënin asgjë për të përballuar kërcënimet, sulmet, apo edhe “genocidin” kundër serbëve në Kosovë. Midis pretendimeve të nxehta të Memorandumit, ata deklaronin:

> Genocidi fizik, politik, ligjor e kulturor mbi popullsinë serbe në Kosovë dhe Metohí është një disfatë historike më e rëndë se sa ndonjë disfatë tjetër në luftrat për çlirim të zhvilluara nga serbët prej kryengritjes së parë serbe më 1804 deri në kryengritjen e vitit 1941. [5]

I kritikuar nga Presidenti serb i asaj kohe, Memorandumi pasqyronte një sentiment kolektiv, sidoqë të paartikuluar, të turmave popullore serbe. Me komunizmin që po dështonte si një ideologji, politikanët serbë zunë ta kontrollonin e ta përdornin këtë pakënaqësi për qëllimet e tyre politike.

Milosheviçi u kap fort pas kauzës së nacionalizmit, dhe ushqeu me këtë kauzë ambicjen e ngjitjes drejt pushtetit.

Asnjë politikan nuk e kuptoi këtë më mirë se sa Sllobodan Milosheviçi, i cili në atë kohë ishte shefi i Partisë Komuniste serbe. Si një aparatçik komunist dhe si një kanakar i Stamboliçit, Milosheviçi u kap fort pas kauzës së nacionalizmit, dhe ushqeu me këtë kauzë ambicjen e ngjitjes drejt pushtetit.

Më 24 prill 1987, Milosheviçi u dërgua t'i fliste një turme të madhe serbësh në Fushë-Kosovë, të cilët protestonin kundër keqtrajtimit prej shqiptarëve. Ai i bëri bashkë demonstruesit me thirrjen: "Askush nuk duhet të guxojë të ngrejë dorë kundër jush". Kjo frazë u përsërit disa herë nga televizioni shtetëror serb që ishte nën kontrollin e Milosheviçit dhe u shndërrua në një thirrje për unitet për nacionalistët serbë. Duke u konvertuar nga komunist në nacionalist, Milosheviçi vazhdonte:

> Ju duhet të qëndroni këtu. Kjo është toka juaj. Këto janë shtëpitë tuaja. Livadhet dhe kopshtet tuaja. Kujtesa juaj. Ju nuk mund ta braktisni tokën tuaj, ngaqë thjesht është e vështirë të jetosh, ngaqë mbi ju ushtrohet presioni i padrejtësisë. S'ka qënë kurrë pjesë e karakterit serb e malazez dorëzimi përpara pengesave, apo çmobilizimi kur është koha për luftë ... Ju duhet të qëndroni këtu për hir të paraardhësve e pasardhësve tuaj. Ndryshe, paraardhësit tuaj do të fëlliqen, ndërsa pasardhësit tuaj do të zhgënjehen. Por unë nuk po ju sugjeroj që ju të qëndroni, të duroni e të toleroni një situatë, me të cilën ju nuk jeni të kënaqur. Përkundrazi, ju duhet ta ndryshoni këtë situatë së bashku me pjesën progresive të popullit të këtushëm, të Serbisë e të Jugosllavisë. [6]

Milosheviçi përdori me vendosmëri populizmin e ri nacionalist për të eleminuar kundërshtarët e tij politikë, përfshirë Stamboliçin. [7] Media shtetërore, veçantërisht Radioja e Televizioni Serb (RTS), qëllimisht përhapte dezinformimin mbi abuzimet kundër serbëve në Kosovë, përfshirë përdhunimin e grave, dhe bënte fushatë për të nxitur krijimin e konservimin e imazhit negativ të shqiptarëve. Në dy vitet e mëpastajmë, tubime masive u mbajtën në Jugosllavi, dhe u quajtën "tubime të së vërtetës", gjatë të cilave Milosheviçi i bënte thirrje lavdisë serbe, dhe kërkonte ndryshime kushtetuese për të shfuqizuar autonominë e Kosovës. Në një prej këtyre tubimeve, Milosheviçi u shpreh:

> Ne do ta fitojmë betejën për Kosovën, pavarësisht pengesave që do të na duhet të kalojmë brenda e jashtë vendit. Ne do ta fitojmë pavarësisht nga fakti, që armiqtë e jashtëm të Serbisë, të ndihmuar nga ata të brendshëm, po komplotojnë kundër nesh. Ne u themi atyre , që ne nisim një betejë . . . me synimin për ta fituar atë. [8]

Shqiptarët etnikë organizuan grevat e protestat e tyre publike kundër shtrëngimeve e represionit që rriteshin në provincë. Ndryshe nga tubimet serbe, demonstratat shqiptare u shpërndanë shpesh me forcë, dhe shumë shqiptarë u arrestuan. Më 17 nëntor 1988, udhëheqja e partisë komuniste të Kosovës u shkarkua. Disa ditë më vonë, minatorët shqiptarë të minierës së Trepçës, afër qytetit të Mitrovicës, u hodhën në grevë. Më 25 nëntor, parlamenti federal miratoi amendamentet kushtetuese, të cilat hapën rrugën për ndryshimin e kushtetutës serbe. Azem Vllasi, kreu u partisë komuniste të Kosovës dhe përfaqësuesi politik i shqiptarëve të Kosovës në nivelin federal, u shkarkua.

Më 20 shkurt 1989, minatorët e Trepçës u hodhën në grevë përsëri për të kërkuar rikthimin në detyrat e tyre të udhëheqësve të partisë së Kosovës. Qeveria dislokoi trupat ushtarake dhe imponoi "masa speciale" në rajon, të cilat morën formën e ligjit të luftës. Në krahinë, në mënyrë të veçantë mes intelektualëve dhe udhëheqësve të shqiptarëve etnikë, mbizotëronte atmosfera e frikës. Republikat e tjera jugosllave, sidomos Sllovenia, zunë të protestonin kundër nacionalizmit agresiv serb.

Pas një tubimi masiv pro Milosheviçit në Beograd, Vllasi u arrestua më 2 mars. [9] Tri javë më vonë, u njoftua për një kushtetutë të re serbe. Asambleja kosovare – e përbërë kryesisht nga shqiptarë etnikë, por që ishte nën

presionin e drejtëpërdrejtë të Beogradit – i pranoi ndryshimet e propozuara kushtetuese, të cilat e rikthyen autoritetin e Beogradit në krahinë.

Ndërsa Beogradi festonte, shqiptarët e Kosovës i kundërshtuan me forcë ndryshimet. Më 28 mars 1989, policia hapi zjarr mbi turmën e

Pjesë nga fjalimi i Sllobodan Milosheviçit në Gazimestan të Kosovës, më 28 qershor 1989 (600 vjetori i betejës së Fushës së Mëllenjave midis serbëve e otomanëve)

Në kohën kur zhvillohej kjo betejë historike famëmadhe në Kosovë, njerëzit e kishin drejtuar shikimin nga yjet, duke pritur ndihmë prej tyre. Sot, gjashtë shekuj më vonë, njerëzit e kanë drejtuar shikimin përsëri nga yjet, por këtë radhë për t'i pushtuar ata. Në rastin e parë, ata mund t'i lejonin vetes përçarjen, urrejtjen e tradhëtinë, sepse jetonin në copëra më të vogla të ndërlidhura mes tyre me fije të dobëta. Tani, si njerëz të këtij planeti, nëse nuk janë të bashkuar e nëse nuk jetojnë në harmoni e solidaritet reciprok, ata nuk mund të pushtojnë qoftë edhe planetin e tyre – për planete të tjerë as që mund të flitet.

Për këtë arsye, fjalët që i kushtohen bashkimit, solidaritetit e bashkëveprimit midis njerëzve në dheun e mëmëdheun tonë nuk kanë në asnjë vend tjetër po atë domethënie të madhe që kanë këtu në fushën e Kosovës, e cila është simbol i përçarjes e tradhëtisë.

Në kujtesën e popullit serb, kjo përçarje ka qënë një faktor vendimtar për humbjen e betejës dhe për vuajtjet që Serbia ka hequr për gjashtë shekuj me radhë.

Edhe nëse s'do të ishte kështu, në një pikëpamje historike është e qartë se njerëzit e kanë konsideruar përçarjen si fatkeqësinë e tyre më të madhe. Prandaj është obligimi i popullit për ta larguar këtë përçarje, në mënyrë që të mbrojnë vetveten nga disfatat, dështimet dhe mbetjen në vendnumëro në të ardhshmen.

Në këtë vit, populli serb u bë i vetëdijshëm mbi nevojën e harmonisë mes vedi, si një kusht i domosdoshëm për jetën e sotme e të nesërme.

Unë jam i bindur që kjo vetëdijë e harmonisë dhe e bashkimit do të bëjë të mundur që Serbia, jo vetëm të funksionojë si një shtet, por të funksionojë edhe si një shtet i suksesshëm. Për këtë arsye mendoj se është kuptimplotë ta thuash këtë gjë në Kosovë, ku përçarja e qëmotshme e la prapa Serbinë për shekuj me radhë, e rrezikoi atë, dhe ku bashkimi i ripërtërirë mund ta çojë përpara atë, mund t'i kthejë dinjitetin asaj. Një vetëdijë e tillë përbën një nevojë elementare

protestuesve, duke vrarë të paktën 24 vetë. Ndonëse nuk përjashtohet mundësia që forcat qeveritare të jenë sulmuar e goditur, përgjigja shtetërore ishte e egzagjeruar dhe nuk kurseu njeri. Një raport i përbashkët i Helsinki Watch dhe i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat

për Jugosllavinë gjithashtu, pasi fati i saj është në duart e bashkuara të njerëzve të saj. Heroizmi i Kosovës na ka frymëzuar për gjashtë shekuj, ka ushqyer krenarinë tonë e nuk na ka lejuar të harrojmë se njëherë e një kohë kemi qënë një popull i madh, trim, e krenar, një prej popujve të paktë që mbetën të pamposhtur, edhe kur humbën.

Gjashtë shekuj më vonë, sot, ne jemi përsëri të angazhuar në beteja, ne po përballojmë përsëri beteja. Nuk janë beteja me armë, ndonëse një gjë e tillë nuk mund të përjashtohet. Megjithatë, pavarësisht nga lloji i betejave, ato nuk mund të fitohen pa vendosmëri, trimëri e sakrificë, pa cilësitë fisnike që kanë qënë të pranishme këtu në fushën e Kosovës në ditët e shkuara. Beteja jonë më e rëndësishme në ditët e sotme ka të bëjë me mirëqënien ekonomike, kulturore, politike e sociale, me afrimin më të shpejtë e më të suksesshëm drejt qytetërimit të shekullit të XXI-të. Për ta çuar deri në fund këtë betejë, ne sigurisht kemi nevojë për një heroizëm të një lloji tjetër, por ajo kurajo, pa të cilën asgjë e madhe dhe serioze nuk mund të arrihet, mbetet e pandryshuar, mbetet tepër e nevojshme.

Gjashtë shekuj më parë, Serbia mbrojti veten në mënyrë heroike në Fushën e Kosovës, por ajo mbrojti gjithashtu Europën. Serbia ishte në atë kohë bastioni që mbrojti kulturën e fenë europiane, shoqërinë europiane në tërësi. Prandaj sot është jo vetëm e padrejtë, por edhe johistorike e tejet absurde, të flasësh për Serbinë si pjesë e Europës. Serbia, si tani edhe në të shkuarën, është e ka qënë pjesë e Europës në mënyrë të vazhdueshme. Sigurisht, duke ndjekur rrugën e vet, duke ndjekur atë rrugë, e cila në një kuptim historik nuk bie ndesh me dinjitetin e saj. Në këtë frymë ne përpiqemi sot të ndërtojmë një shoqëri, të pasur e demokratike, dhe kështu do të kontribuojmë për mirëqënien e këtij vendi të mrekullueshëm, e këtij vendi që ka vuajtur padrejtësisht, e këtij vendi që në të njëjtën kohë ka kontribuar në përpjekjet e të gjithë popujve progresivë, e popujve që luftojnë për një botë më të mirë e më të lumtur.

I paharruar qoftë kujtimi i heroizmit të Kosovës!

Rroftë Serbia!

Rroftë Jugosllavia!

Rroftë paqja e vëllazëria mes popujve!

e Njeriut, arriti në ato kohë në përfundimin se " nuk mund të përligjej hapja zjarr me armë automatike mbi grumbullin e njerëzve". [10]

Duke kalëruar mbi një valë gjithmonë e më të fuqishme nacionalizmi, Sllobodan Milosheviçi u zgjodh President i Serbisë më 8 maj 1989, një post që ai e mbajti për tetë vitet e ardhshme, derisa ai u zgjodh President i Jugosllavisë më 23 korrik 1997 (këtë post e mbajti deri në tetor 2000).

Në korrik 1989, parlamenti serb miratoi ligjin e "kufizimit të transaksioneve të pronës", i cili është i pari në një seri ligjesh, që diskriminuan rreptësisht shqiptarët etnikë në Kosovë. Ligji ndalonte shqiptarët të shisnin pasuri të paluajtshme pa miratimin e një komisioni shtetëror special të drejtuar nga Ministria Serbe e Financave. Më 30 mars 1990, qeveria serbe financoi një program që synonte vënien e politikave qeveritare në Kosovë mbi baza ideologjike. I emërtuar në mënyrë ironike "programi për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe mirëqënies së krahinës autonome socialiste të Kosovës", ky program shpallte:

> Autonomia e Kosovës nuk mund të shërbejë si një ndjesë për keqfunksionimin e shtetit legal apo si një arsye për përsëritjen e trazirave separatiste e nacionaliste dhe tensioneve të vazhdueshme ndëretnike. Autonomia nuk mund të shpërdorohet në ndjekje të qëllimeve të papranueshme e të pazbatueshme, siç janë parandalimi i kthimit të serbëve dhe malazezve të zhvendosur me dhunë, dhe i të gjithë të tjerëve që duan të vinë e të jetojnë në Kosovë; nuk mund të shërbejë veçantërisht për ndonjë emigrim të mëtejshëm të serbëve e malazezve në Kosovë dhe shkëputjen e ndonjë pjese të territorit të republikës-shtet të Serbisë në mënyrë që të themelohej një shtet i ri brenda Jugosllavisë apo pa Jugosllavinë. [11]

Kosova në vitet '90

Shfuqizimi i autonomisë së Kosovës

Më 2 korrik 1990, anëtarët e një asambleje-parlament shpallën pavarësinë e Kosovës. Dy muaj më vonë, më 7 shtator, anëtarët e parlamentit që ishte shpërbërë më 5 korrik, u takuan fshehtas dhe miratuan një kushtetutë të re të Republikës së Kosovës. U zgjodh një

asamble ligjvënëse e një qeveri ilegale. Tri javë më vonë, më 28 shtator, asambleja serbe shpalli kushtetutën e re serbe, e cila shfuqizoi formalisht statusin e krahinës autonome, si për Kosovën, ashtu edhe për Vojvodinën.

Kushtetuta e re serbe ishte e rëndësishme sepse, duke shfuqizuar formalisht autonominë e Kosovës e Vojvodinës, Serbia merrte dy vende shtesë në presidencën jugosllave me tetë anëtarë. Në koalicion me partnerin e vet, Malin e Zi, "blloku serb" kontrollonte gjysmën e institucionit federal.

Në shtator 1991, shqiptarët e Kosovës mbajtën një referendum jo zyrtar mbi pavarësinë. Shqiptarët etnikë votuan gati unanimisht për pavarësinë nga Jugosllavia. Qeveria jugosllave refuzoi të njihte rezultatin e referendumit. Vetëm qeveria e Shqipërisë, në atë kohë e drejtuar nga partia komuniste, njohu pavarësinë e Kosovës. [12]

Abuzimet me të drejtat e njeriut në vitet '90

Kosova u shndërrua në një shtet policor të komanduar nga Beogradi. Një prani e fortë ushtarake serbe, e përligjur me nevojën për të luftuar "separatistët shqiptarë", kreu në vazhdim abuzime me të drejtat e njeriut. Dhuna policore, burgosjet arbitrare dhe troturat u bënë të zakonshme. Shqiptarët etnikë arrestoheshin, paraburgoseshin, burgoseshin e përndiqeshin thjesht për shkak të origjinës së tyre etnike, të bindjeve politike apo ngaqë bënin pjesë në organizata e institucione, të cilat ishin të "çkishëruara" apo shiheshin vëngër nga qeveria serbe. [13]

Një prani e fortë ushtarake serbe, e përligjur me nevojën për të luftuar "separatistët shqiptarë", kreu në vazhdim abuzime me të drejtat e njeriut.

Bazuar në një seri ligjesh diskriminuese, qindra mijra shqiptarë etnikë u pushuan nga puna në institucionet qeveritare e ndërmarrjet shtetërore. Në gusht 1990, parlamenti serb suprimoi pavarësinë e sistemit arësimor të Kosovës, hartoi programe të reja, dhe deklaroi administrimin në mënyrë të centralizuar nga Beogradi. Mësuesit shqiptarë u shtrënguan të nënshkruanin një deklaratë besnikërie. Ata që e refuzuan këtë deklaratë, u hoqën nga puna. Gjatë gjithë vitit 1990, qeveria mbylli shumicën e shkollave të gjuhës shqipe, dhe në janar 1991, ajo ndaloi pagesën për shumicën e mësuesve të shkollave të mesme shqiptare. Në tetor 1991, të gjithë mësuesit shqiptarë u shkarkuan nga puna; vetëm 15 profesorë

shqiptarë mbetën në universitetin e Prishtinës, dhe ata të gjithë jepnin leksione në serbisht.

Margjinalizimi i qëllimshëm ekonomik e social i shqiptarëve etnikë solli emigrimin e rreth 350 mijë shqiptarëve nga krahina përgjatë shtatë viteve të ardhshme. Ndërsa shqiptarët po shtrëngoheshin të linin Kosovën, qeveria e Milosheviçit inkurajoi ngulimin e serbëve në rajon. Më 1996, 16 mijë refugjatë serbë nga Bosnja e Kroacia u vendosën në Kosovë, jo gjithmonë me dëshirën e tyre. [14]

Qeveria jugosllave pretendonte se prania ushtarake dhe masat ligjore ishin të nevojshme për dy arsye: për të mbrojtur pakicat në Kosovë – kryesisht serbë e malazezë – dhe për të frenuar lëvizjen separatiste shqiptare. Një lëvizje e tillë, argumentonte qeveria, mund të kërkojë pavarësinë e Kosovës nga Jugosllavia, dhe bashkimin e mundshëm me Shqipërinë fqinje. Veprimet e qeverisë lidhur me këto dy shqetësime ishin ekstreme dhe çuan në dhunimin e të drejtave të njeriut.

Reagimi jo i dhunshëm i shqiptarëve dhe shteti paralel

Shqiptarët e Kosovës iu përgjigjën shfuqizimit të autonomisë me krijimin e shtetit të tyre paralel, i cili u deklarua, bazuar në referundumin e shtatorit 1991, i pavarur nga Jugosllavia. Deputetët shqiptarë të parlamentit të shpërbërë ngritën "underground" institucionet e qeverisjes, dhe shqiptarët e Kosovës refuzuan të njihnin shtetin serb.

Me fonde të dhuruara, u ngrit një sistem paralel i shkollave private. Përgjatë tetë viteve, fëmijët e shkollave dhe studentët e universitetit merrnin leksione në shtëpi private, në ndërmarrje të boshatisura dhe në ndërtesa shkollash të braktisura. Mësuesë, studentë dhe administratorë të shkollave private ndaloheshin dhe rriheshin nga policia dhe forcat e sigurimit. Fonde të grumbulluara për qëllime arsimimi konfiskoheshin nga policia. Zgjedhjet parlamentare "underground" të 24 majit 1992 konfirmuan Lidhjen Demokratike të Kosovës me moshë trevjeçare si partinë shqiptare më të fortë dhe Ibrahim Rugova, një personazh pak i njohur më parë, u zgjodh President. LDK-ja zgjeroi sistemin paralel dhe ngriti struktura të grumbullimit të taksave nga shqiptarët dhe nga komuniteti i diasporës vazhdimisht në rritje. [15] Rugova dhe kryeministri

Bujar Bukoshi përfaqësonin "Republikën e Kosovës" jashtë vendit.

Shfuqizimi i autonomisë së Kosovës dhe abuzimet që vijuan më pas nuk provokuan ndonjë përgjigje të fortë nga komuniteti ndërkombëtar, i cili ishte gjithmonë e më shumë i angazhuar me konfliktin në Slloveni, Kroaci e pastaj në Bosnjë. Në verën e vitit 1992, Konferenca për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë, sot Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE), dërguan misione në Kosovë, Vojvodinë e Sanxhak, por misionet u shtrënguan të ktheheshin prapa në korrik 1993, kur qeveria jugosllave refuzoi t'u ripërtërinte mandatin.

Në dhjetor 1992, pasi forcat speciale të policisë serbe imponuan sundimin e tyre në Kosovë, Presidenti i SHBA-ve, George Bush shpalli atë që më prapa u bë i njohur si "paralajmërimi i krishtlindjeve". Bushi i shkruante në një letër Presidentit Milosheviç, se Shtetet e Bashkuara "do të përgatiteshin për të përdorur forcën ushtarake" në rastin e një konflikti të shkaktuar nga veprimet serbe – një paralajmërim që u përsërit nga Clinton, disa muaj pasi ai fitoi zgjedhjet presidenciale. [16] Shqiptarët e Kosovës i interpretuan paralajmërimet si një mesazh, sipas të cilit Shtetet e Bashkuara do t'i merrnin në mbrojtje.

Jashtë çdo vlerësimi real të aftësive ushtarake të shqiptarëve, LDK-ja refuzoi ofertat e udhëheqjes kroate e boshnjake për të hapur një front tjetër ushtarak kundër Serbisë. [17] Ndërsa bënte thirrje për pavarësinë e Kosovës, LDK-ja predikonte rezistencën paqësore dhe nxiste shqiptarët të mbështesnin strukturat paralele.

Përjashtim bëri një përpjekje e vitit 1992 e 1993 për të ngritur një Ministri Kosovare të Mbrojtjes, të përbërë kryesisht nga ish-policë shqiptarë. Policia serbe e shtypi grupin që po lindte nëpërmjet arrestimeve të vitit 1993, dhe lëvizja e paarmatosur mbeti mjeti i vetëm i luftës deri në vitin 1996, kur u krijua UÇK-ja.

Shtetet e Bashkuara dhe qeveritë e Europës perëndimore inkurajuan fuqimisht shqiptarët etnikë të ndiqnin linjën e moderuar, duke u frikësuar se konflikti në Kosovë do të dilte jashtë kontrollit dhe do të pushtonte rajonin. Qëllimi primar ishte shmangja e një lufte në Kosovë, dhe rezistenca jo paqësore ishte, kështu besonte perëndimi, rruga më e mirë për ta arritur këtë.

Rugova u identifikua si avokati i parë i linjës së moderuar dhe mori për këtë mbështetjen e pakushtëzuar të qeverive perëndimore, sidomos të Shteteve të Bashkuara. Ai u ftua shpesh në takime të nivelit të lartë në Washington dhe në kryeqytete të Europës perëndimore, gjë që i solli

popullaritet në mes të publikut shqiptar fuqimisht properëndimor. Megjithatë, në të njëjtën kohë, qeveritë perëndimore asnjëherë nuk shprehën mbështetje për pavarësinë e Kosovës, ndonëse shumica e shqiptarëve të Kosovës besonin që perëndimi praktikisht bënte të kundërtën. [18]

Në një farë kuptimi, Rugova e Milosheviçi nxorrën përfitime nga njëritjetri. Milosheviçi toleroi Rugovën, sepse ky i fundit u shërbente shqiptarëve si një pus, në grykën e të cilit mund të zbraznin zhgënjimet e tyre, dhe u mundësonte shprehjen publike të vullnetit të tyre politik, ndërsa politikat e tij të rezistencës paqësore përjashtonin sfidën ndaj sundimit serb në krahinë. Shqiptarët vazhdonin gjithashtu t'i paguanin taksa qeverisë serbe. Në të njëjtën kohë, politikat represive të Milosheviçit përligjnin përpjekjet e shqiptarëve për pavarësi. [19] Perëndimi ndihej komod me këtë gjendje të gjërave, sepse kështu garantohej status quo-ja. Abuzimet me të drejtat e njeriut vazhduan, por Kosova mbeti jashtë faqeve të para të gazetave, ndërkohë që perëndimi po merrej me luftën në Kroaci e Bosnjë.

Në të njëjtën kohë, qeveritë e Europës perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara po përgatisnin një mbështetje të fuqishme politike e financiare për qeverinë e Sali Berishës në Shqipëri, pjesërisht për faktin që Berisha mbështeste Rugovën, dhe pjesërisht për faktin që premtoi të mos përzihej në çështjet e Kosovës e të Maqedonisë. Mbështetja e pakualifikuar për Berishën, pavarësisht abuzimeve të dukshme me të drejtat e njeriut kundër qytetarëve të vendit të tij, kontribuoi në destabilizimin eventual të Shqipërisë, gjë që, ndikoi negativisht në Kosovë. [20]

Ndërkohë, mijra shqiptarë të Kosovës po linin krahinën dhe po shkonin në Shtetet e Bashkuara e në Europën perëndimore për shkak të përndjekjes konstante apo frikës se mund të thirreshin nën armë nga qeveria jugosllave. Shumë prej këtyre njerëzve pa të drejtë vote e pa të drejta politike brenda e jashtë Kosovës, të paarësimuar dhe pa një punë të sigurtë, më vonë ju bashkangjitën kryengritësve.

Spiralja e dhunës

Një ndryshim i rëndësishëm erdhi pas konferencës së Dayton-it në dhjetor 1995, e cila shënoi fundin e luftës në Bosnjë. Shqiptarët e Kosovës

nuk ishin të ftuar në konferencë, ndërsa vetë Kosova nuk ishte në axhendën e bisedimeve. Kjo i la shumë kosovarë me përshtypjen, se perëndimi e kish harruar çështjen e Kosovës dhe se rezistenca e tyre paqësore nuk po funksiononte. Për më tepër, me njohjen ndërkombëtare të kufijve të rinj të asaj që u quajt "Republika Srpska", shqiptarët kuptuan se komuniteti ndërkombëtar udhëhiqej nga ngjarjet në terren dhe jo nga parimet shpirtmëdha të rezistencës jo paqësore, me fjalë të tjera, nga argumenti i forcës dhe jo nga forca e argumentit. [21]

Në fillim të vitit 1996, dhuna e organizuar për herë të parë u drejtua kundër civilëve e policëve serbë. Megjithëse para këtij momenti kish patur dhunë individësh të veçantë, sulmi i parë i koordinuar ndodhi më 11 shkurt, gjatë të cilit u hodhën granata në portat e kampit të refugjatëve serbë në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Suharekë e Vushtrri. Nuk pati të plagosur.

Më 21 prill 1996, një student shqiptar, Armend Daci, u qëllua dhe u vra nga një banor serb i Prishtinës, pasi, sipas këtij të fundit, Daci tentoi t'i futej me dhunë në makinë. Ditën tjetër u vranë katër serbë brenda një ore. [22] Po atë natë, në fshatin Shtimje, u vra polici Miljenko Buçiç, ndërsa një makinë policie u godit me mitraloz në rrugën që lidh Mitrovicën me Pejën, ku mbeti e vrarë një grua serbe, e cila ish nën arrest. Motivi i këtyre sulmeve u lidh me hakmarrjen për vrasjen e Dacit, por intervistat e pas luftës me liderë të UÇK-së dëshmuan se aksionet e 22 prillit kanë qënë të planifikuara qysh më parë.[23]

Në këtë klimë të një dhune në rritje, Milosheviçi lejoi qeverinë e Shteteve të Bashkuara të hapte një zyrë apo agjenci informimi në Prishtinë, lajm ky që u prit mirë nga shqiptarët e Kosovës, si shenjë e një angazhimi më të madh amerikan. Lajmi për zyrën, që konsiderohej gabimisht nga shumë shqiptarë si një Ambasadë, doli në fillim të shkurtit, ndërsa vetë zyra u hap në korrik 1996.

Shqiptarët kuptuan se komuniteti ndërkombëtar udhëhiqej nga ngjarjet në terren dhe jo nga parimet shpirtmëdha të rezistencës jo paqësore, me fjalë të tjera, nga argumenti i forcës dhe jo nga forca e argumentit.

Sulme të dhunshme mbi policinë serbe vazhduan gjatë gjithë verës deri në fund të vitit 1996, duke sjellë katër të vdekur e dy të plagosur. [24] Udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës dhe zyrtarë serbë mohuan se kishin të bënin me këtë dhunë, dhe akuzonin njëri-tjetrin, se po provokonin konfliktin. Rugova, në mënyrë jo shumë bindëse, ngriti pretendimin që sulmet ishin

realizuar nga policia sekrete serbe, me synimin për të provokuar hakmarrjen kundër shqiptarëve.

Ndërkohë, një organizatë e quajtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila ishte e panjohur më parë, mori përgjegjësinë për sulmet. Në letra që i faksoheshin medias, organizata kritikonte strategjinë "pasive" të lidershipit shqiptar dhe premtonte të vijonte me sulmet e saj, derisa Kosova të çlirohej nga sundimi serb.

Nga mesi i vitit 1996, u bë e qartë se ishte arbitrariteti dhe hakmarrja e shproporcionuar e policisë serbe dhe e forcave të sigurimit special kundër shqiptarëve etnikë, që provokonte sulmet e UÇK-së. Policia dhunonte shtëpitë private dhe paraburgoste shqiptarë etnikë pa urdhër nga prokuroria, shpesh duke i dhunuar ata fizikisht. Shumë vetë që udhëtonin në zonat, ku dyshohej se vepronte UÇK-ja, ndaloheshin, pyeteshin dhe rriheshin. Në tetor, policia arrestoi dyzet e pesë shqiptarë etnikë, të cilët, sipas policisë, ishin autorë të sulmeve.[25]

Në perëndim, Milosheviçi, për shkak të marrëveshjes së Dayton-it, vazhdonte të shihej si një partner i nevojshëm në kuadrin e stabilitetit rajonal. Shqetësimi në Washington dhe në kryeqytetet e Europës perëndimore ishte që Milosheviçi nuk duhej sfiduar në Kosovë, sepse ai ishte i nevojshëm për zbatimin e marrëveshjeve. Frika nga sulmet ndaj ushtarëve perëndimorë të dislokuar në Bosnjë për të monitoruar e imponuar zbatimin e marrëveshjes përforcoi ngurimin e perëndimit për të ndryshuar status quo-në në Kosovë. Abuzimet me të drejtat e njeriut u vlerësuan të pranueshme për hir të stabilitetit rajonal.

Nga mesi i vitit 1996, u bë e qartë se ishte arbitrariteti dhe hakmarrja e shproporcionuar e policisë serbe dhe e forcave të sigurimit special kundër shqiptarëve etnikë, që provokonte sulmet e UÇK-së.

Në të njëjtën kohë, prania ushtarake perëndimore në Bosnjë hezitonte të arrestonte personat e akuzuar për krime lufte nga Gjykata e Kombeve të Bashkuara për Krimet e Luftës, sidomos liderin e serbëve të Bosnjës Radovan Karaxhiç dhe gjeneralin Ratko Mlladiç. Arrestimi i tyre mund të ishte një mesazh, sipas të cilit, perëndimi nuk do të toleronte abuzim e dhunë të mëtejshme në Ballkan, gjë që do të shkurajonte forcat serbe në kryerjen e mizorive në Kosovë.

Zhvillim tjetër politik i rëndësishëm ishte ai i 1 shtatorit 1996, kur Rugova e Milosheviçi nënshkruan një marrëveshje shpresëdhënse mbi arësimin,

që parashikonte kthimin e pakushtëzuar në shkollat e gjuhës shqipe të të gjithë nxënësve, studentëve e mësuesve shqiptarë.[26] Detajet do të shqyrtoheshin nga një komision i përbashkët i përbërë nga tre serbë e nga tre shqiptarë. Pavarësisht tam-tam-eve ndërkombëtare, marrëveshja

Fëmijët shqiptarë në Kosovë e kishin të ndalur arsimimin në gjuhën amtare, pavarësisht nga marrëveshja e vitit 1996 ndërmjet Sllobodan Milloshevicit dhe Ibrahim Rugovës. 3+3 i referohet gjashtë anëtarëve të komisionit (3 serbë dhe 3 shqiptarë) të cilët duhej të merreshin me zbatimin e marrëveshjes.

VIZATIMI NGA JETON MIKULLOVCI - KOHA DITORE

nuk u zbatua kurrë, dhe nxënësit shqiptarë mbetën jashtë dyerve të ndërtesave shkollore. Dhuna, rrahjet dhe arrestimi i mësuesve shqiptarë dhe administratorëve të shkollave, vazhduan pa ndërprerje.

Dështimi i marrëveshjes së arësimit, duke mos sjellë asnjë përmirësim konkret në jetën e përditshme të shqiptarëve, ishte një goditje serioze ndaj politikave paqësore të Rugovës. Shqiptarët etnikë po humbisnin besimin tek premtimet gjithmonë e më shumë boshe, sipas të cilave perëndimi do t'i ndihmonte. Ngathtësia apo padëshira e perëndimit për të shpërblyer durimin dhe politikat paqësore të shqiptarëve me përmirësime konkrete, siç ishte p.sh. arësimi, bëri që komuniteti t'i afrohej alternativës ushtarake.

Në 31 shtator 1996, Kombet e Bashkuara hoqën sanksionet mbi Jugosllavinë, të cilat ishin në fuqi qysh prej majit 1992, dhe shumë shtete europiane rivendosën marrëdhëniet diplomatike me Jugosllavinë, të cilat ishin shkëputur gjatë luftës në Bosnjë. Vende të Bashkimit Europian, si Franca, Italia e Greqia i ringritën në një nivel të lartë marëdhëniet ekonomike.

Përjashtimi më i rëndësishëm ishte këmbëngulja e Shteteve të Bashkuara për mbajtjen e të ashtuquajturit "mur i jashtëm" i sanksioneve, të cilat, kryesisht mbajtën Jugosllavinë jashtë institucioneve ndërkombëtare financiare, siç ishte Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Sanksionet do të qëndrojnë derisa, shprehej qeveria amerikane, midis të tjerash, të zgjidhet çështja e Kosovës.[27]

Abuzimet me të drejtat e njeriut në krahinë u intensifikuan nga fundi i vitit 1996, ndërsa qeveria u përpoq të shtypte kryengritjen, që po merrte përmasa më të mëdha. Policia, ndërsa keqtrajtonte, e në ndonjë rast vriste, shqiptarët etnikë, vepronte pa patur frikën e ndonjë ndëshkimi ligjor. Abuzimi policor mori përgjithësisht tri forma bazë: rrahje nëpër rrugë e në vende të tjera publike, sulme të organizuara kundër veprimtarëve politikë shqiptarë, ose hakmarrje arbitrare ndaj sulmeve të UÇK-së.[28]

Publikisht, qeveria serbe vazhdonte të mohonte që egzistonte dhunimi i të drejtave të njeriut, dhe zyrtarët shprehnin nevojën për të mbrojtur sovranitetin e shtetit. Në korrik 1996, zëvendës Ministri Serb i Arsimit Rade Drobac i tha Human Rights Watch: "Gjendja e të drejtave të njeriut është e shkëlqyer në Kosovë. Shqiptarët kanë më shumë të drejta se kudo gjetkë në botë".[29] Në të njëjtën kohë, shqiptarët nuk hoqën dorë nga kërkesa për pavarësi të plotë, dhe UÇK-ja vazhdonte sulmet e saj.

Komuniteti ndërkombëtar ishte futur në kurth midis dëshirës së përgjithshme për të frenuar dhunën e qeverisë serbe dhe antipatisë për pavarësinë e Kosovës. Një Kosovë e pavarur, argumentohej atëherë, do të bashkohej me Shqipërinë, dhe eventualisht, me pjesën perëndimore të Maqedonisë, e cila banohet kryesisht nga shqiptarë etnikë. Më e pakta, një Kosovë e pavarur do të prishte balancën delikate midis maqedonasve etnikë e shqiptarëve etnikë në Maqedoni, e cila konsiderohej një shtet i ri e i dobët.[30] Shumë qeveri perëndimore i trembeshin gjithashtu precedentit, që pavarësia e Kosovës do të nxisë lëvizjet separatiste etnike në vende të tjera, fjala vjen, ato të baskëve e korsikanëve.

Duke zgjedhur një rrugë të mesme, komuniteti ndërkombëtar apeloi për përmirësimin e të drejtave të pakicave në Kosovë dhe inkurajoi në forma të ndryshme dialogun midis shqiptarëve e serbëve. Një zgjidhje politike që konsistonte në autonominë e Kosovës brenda Jugosllavisë, shpresonte perëndimi, ishte e arritshme, pavarësisht rritjes së dhunës e abuzimeve.

Në fund të vitit 1996, skena politike e Serbisë pësoi ndryshime. Në zgjedhjet administrative të 17 nëntorit, partitë e opozitës fituan në katërmbëdhjetë nga nëntëmbëdhjetë qytete të mëdha. Qeveria deklaroi "parregullsi të paspecifikuara" në zonat, ku partia në pushtet kish humbur, duke provokuar kështu për tetëdhjetë e tetë ditë me radhë organizmin e demonstratave paqësore nga ana e mbështetësve të opozitës dhe studentët, disa prej të cilëve u shtrënguan të përballonin dhunën e policisë.[31] Qeveria njohu rezultatin e zgjedhjeve më 22 shkurt 1997, por pa humbur pushtetin në planin kombëtar. Grindjet e brendshme dhe lufta për pushtet e dobësuan shumë shpejt mbështetjen për opozitën.

Megjithëse shumë qeveri perëndimore kritikuan manipulimet elektorale të vitit 1996 dhe dhunën e policisë, shumë shtete të tjera vazhdonin të mirëprisnin riintegrimin e Jugosllavisë në strukturat e organizmat ndërkombëtare. Në prill 1997, Bashkimi Europian i ofroi Jugosllavisë statusin e vendit të privilegjuar në marrëdhëniet tregëtare (gjë që favorizon një vend, duke krijuar kushte përfitimi në tregëtinë me shtetet e Bashkimit Europian), pavarësisht abuzimeve të vazhdueshme në Kosovë. Në 15 maj, Komisioni Europian miratoi një paketë ndihme për Jugosllavinë në vlerën e 112 milionë dollarëve amerikanë. Koncesione të tilla çuan dëm burimin e parë të forcës, me anë të të cilit komuniteti ndërkombëtar mund të ushtronte presion për përmirësimin e të drejtave të njeriut nën regjimin

e Milosheviçit, për zbutjen e represionit në Kosovë dhe për respektimin e marrëveshjes së Dayton-it.

Rritja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

UÇK-ja vazhdoi sulmet e saj kundër policëve e civilëve serbë në muajt e parë të vitit 1997, sidomos në zonat më rurale, ndonëse përmasat e grupit, struktura, lidershipi, mbetën një mister. Jehona e kryengritjes ishte e vogël për shkak të numrit të kufizuar të atyre që kishin shkuar nën armë.

Gjithçka ndryshoi me ngjarjet dramatike të vitit 1997 në Shqipëri. Në mars, të ashtuquajturat "skema piramidale" (të lidhura me pastrimin e parave dhe me veprimtari të tjera ilegale), lulëzimi i të cilave kish ndodhur nën hundën e qeverisë shqiptare, u shembën duke shkaktuar trazira në të gjithë vendin. Në anarkinë që vijoi, depot e armëve u grabitën dhe, në shumë raste, ishte qeveria që e lejoi këtë gjë. Më shumë se njëqind mijë armë të vogla, kryesisht pushkë automatike kallashnikov, ashtu si dhe armë të rënda, mund t'i bleje me pesëdhjetë marka gjermane. Shumë prej këtyre armëve gjetën rrugën për të shkuar matanë kufirit, në Kosovë.

Nga fundi i vitit 1997, rajoni qendror i Drenicës u njoh nga shqiptarët etnikë si "territor i çliruar", për shkak të pranisë së fuqishme të UÇK-së.



Demonstratat jo të dhunshme të studentëve në dimër të vitit 1997 u kundruan gjerësisht si shansi i fundit për protesta paqësore

VIZATIMI NGA JETON MIKULLOVCI - KOHA DITORE

Policia serbe guxonte të hynte në këtë zonë vetëm në orët e ditës.

Guerrilasit ende të paorganizuar mirë u shfaqën publikisht për herë të parë më 28 nëntor 1997, në ceremoninë mortore të mësuesit kosovar, Halit Gecaj, i cili u vra nga një plumb qorr gjatë luftimeve me policinë serbe në fshatin Llaushë. Përballë mbi njëzet mijë pjesëmarrësve, tre luftëtarë me uniformë e të maskuar të UÇK-së, dy prej të cilëve e hoqën maskën, i folën turmës. [32]

Në këtë kohë, studentët shqiptarë filluan të organizonin demonstrata paqësore në qytetet kosovare, duke kërkuar zbatimin e marrëveshjes mbi arësimin të '96-ës dhe rihapjen e universitetit në gjuhën shqipe. Shumë prej protestave jo të dhunshme u shtypën me forcë nga policia. Për një pjesë të madhe njerëzish, shqiptarë e serbë, lëvizja studentore paqësore ishte shansi i fundit për të shmangur konfliktin e armatosur në krahinë.

Komuniteti ndërkombëtar dënoi përdorimin e dhunës shtetërore në Kosovë, e nga ana tjetër theksonte respektimin e integritetit territorial të Jugosllavisë. Në të njëjtën kohë, shumica e qeverive të Europës perëndimore, si dhe Shtetet e Bashkuara, dënuan si "aksione terroriste" sulmet e UÇK-së. Një deklaratë e shkurtit të vitit 1998 e bërë nga grupi i kontaktit mbi ish-Jugosllavinë (Shtetet e Bashkuara, Gjermani, Francë, Rusi, Itali, dhe Mbretëria e Bashkuar) thosh midis të tjerash:

> Grupi i Kontaktit riafirmon angazhimin e tij në mbështetje të vlerave të të drejtave të njeriut, dhe dënon represionin e dhunshëm ndaj shprehjes paqësore të pikëpamjeve politike, përfshirë demonstratat paqësore, dhe dënon gjithashtu aksionet terroriste, përfshirë ato të së ashtuquajturës Ushtria për Çlirimin e Kosovës. [33]

Në fund të shkurtit, përfaqësuesi special i Presidentit Clinton, Robert Gelbart, vizitoi Jugosllavinë për të diskutuar, midis të tjerash, zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Gjatë një konference për shtyp në Prishtinë në 22 shkurt, ai deklaroi se "UÇK-ja, me aksionet që bën, është një grup terrorist. Unë kam qënë përgjegjës për politikat antiterroriste në qeverinë amerikane. Unë e njoh terrorizmin, kur ndeshem me të". [34]

Gelbard e theksoi përsëri këtë gjë në një konferencë për shtyp në Beograd, ku gjithashtu shpalli disa konçesione për qeverinë jugosllave për hir të bashkëpunimit në Bosnjë. I bindur që Milosheviçi përbënte një aleat të natyrshëm në zbatimin e marrëveshjeve të Dayton-it, Gelbard

tha se Shtetet e Bashkuara kanë qënë "veçantërisht të inkurajuara nga mbështetja që kanë marrë nga Presidenti Milosheviç", megjithëse (shtoi ai) "ne akoma kemi një numër të madh çështjesh, ku pikëpamjet nuk na puqen". Me qëllim që të inkurajojmë "një lëvizje të mëtejshme pozitive", Gelbard njoftoi se Shtetet e Bashkuara po rivendosnin marrëdhëniet diplomatike me Jugosllavinë, se Jugosllavia është e lirë të hapë një konsullatë në Shtetet e Bashkuara, se Jugosllavia është e ftuar t'i bashkangjitet Nismës për Bashkëpunim të Europës Juglindore, dhe se aeroplanët jugosllavë (JAT) do të gëzojnë të drejtën për t'u ulur në Shtetet e Bashkuara. Përsa i takon Kosovës, Gelbard tha:

> Pjesën më të madhe të dhunës, ne ia atribuojmë policisë, por ne jemi shumë të shqetësuar dhe dënojmë fuqimisht dhunën e papranueshme të kryer nga grupet terroriste në Kosovë, dhe veçantërisht nga UÇK-ja. Kjo e fundit është pa asnjë dyshim një grup terrorist. Unë refuzoj të pranoj çfarëdo lloj ndjese. Pasi kam punuar për vite me radhë në veprimtari antiterroriste, unë e di shumë mirë se, për të gjykuar një grup terrorist, për ta përkufizuar atë, mos i beso retorikës dhe shiko veprimet. Dhe veprimet e këtij grupi flasin vetë.[35]

Më vonë, Gelbardi i tërhoqi pohimet për UÇK-në, dhe grupi asnjëherë nuk u klasifikua në listën e qeverisë amerikane për organizatat terroriste.[36] Në atë kohë megjithatë, disa analistë e interpretuan deklaratën e Shteteve të Bashkuara si një dritë jeshile për Milosheviçin, i cili do të fillonte fushatën antiterroriste.

Konflikti i armatosur i vitit 1998

Masakrat e Drenicës

Pesë ditë pas komenteve të Gelbardit, qeveria serbe ndërmori një aksion të gjerë ushtarak në luginën e Drenicës, një kështjellë e UÇK-së. Më 28 shkurt e 1 mars, në përgjigje të pusive të UÇK-së ndaj policisë, forcat speciale sulmuan dy fshatrat fqinjë Qirez dhe Likoshan.Më 5 mars forcat speciale sulmuan fshatin qe ndodhej aty pranë të Prekazit dhe në mënyrë të veçantë shtëpinë e Adem Jasharit, që ish një anëtar i njohur i UÇK-së.

Jashari u vra së bashku me gjithë familjen e tij, duke përjashtuar një vajzë 11 vjeçare.[37] Gjithsej humbën jetën tetëdhjetë e tre vetë si pasojë e tre sulmeve, përfshirë këtu të paktën njëzet e katër gra e fëmijë.[38]

Ndonëse UÇK-ja ishte e angazhuar në luftime gjatë këtyre sulmeve, forcat speciale serbe hapën zjarr pa kursyer gratë, fëmijët dhe jo luftëtarët. Helikopterë e makina ushtarake, përpara se forcat policore të hynin më këmbë për të bërë ç'të mundnin brenda, kishin qëlluar mbi lagjet, shtëpitë, çatitë. Një grua shtatzënë, Rukie Nebihi, mori një plumb në fytyrë, dhe katër vëllezër të së njëjtës familje u vranë ndërsa ishin nën ruajtjen e policisë. Dhjetë anëtarë të familjes Ahmeti u ekzekutuan në grup nga policia.

Gjithsej humbën jetën tetëdhjetë e tre vetë si pasojë e tre sulmeve, përfshirë këtu të paktën njëzet e katër gra e fëmijë.

Policia serbe mohoi teprimet gjatë sulmeve dhe pretendoi se ata po ndiqnin "terroristët", të cilët sulmonin policinë. Një zëdhënës i policisë mohoi "mashtrimet e sajimet" e disa mediave lokale e të huaja rreth goditjeve që nuk bënin dalllim, dhe tha që "policia nuk ka përdorur e nuk do të përdorë kurrë metoda të tilla".[39]

Këto ngjarje në Drenicë shënuan fillimin e pjesës më dramatike të krizës së Kosovës. Nëse qëllimi i qeverisë ishte të shtypte kryengritjen që po lindte, kjo bëri efektin e kundërt: Sulmet brutale që nuk kursyen askënd radikalizuan popullsinë e shqiptarëve etnikë dhe shtoi radhët e UÇK-së. Shumë shqiptarë që kishin qënë të angazhuar me politikën jo të dhunshme të Rugovës apo lëvizjen studentore paqësore vendosën të bashkoheshin me UÇK-në, pjesërisht sepse ata shikonin kryengritjen e armatosur si mjetin e vetëm të mbrojtjes. Familje të ndryshme të armatosusra dhe grupe rajonale të UÇK-së aktive në Kosovë deri në këtë moment filluan të shkrihen në një, dhe një rezistencë popullore më e organizuar zuri të marrë formë.

Masakra e Drenicës shënoi fillimin e konfliktit në Kosovë edhe në kuptimin e respektimit të ligjeve të luftës. Pikërisht pas 28 shkurtit 1999 ndeshja nuk ish më një shqetësim i brendshëm, por një konflikt i brendshëm i armatosur, një prag, i cili me t'u kapërcyer, obligonte edhe forcat qeveritare, edhe kryengritësit e armatosur, të respektonin mbrojtjen e ligjit humanitar ndërkombëtar – rregullat e luftës. Në veçanti, artikulli 3, i përbashkët pët të katër konventat e Gjenevës të vitit 1949, Protokolli II i këtyre konventave dhe rregullat e zakonshme të luftës, do të aplikoheshin tash e tutje në rrjedhën e armiqësive në Kosovë.

Konflikti i Kosovës u klasifikua një "konflikt i armatosur" duke shkuar përtej standarteve të një klasifikimi të tillë. Me të shpërthyer konflikti i hapur, jurisdiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi, filloi të funksionojë edhe për Kosovën. I mandatuar për të ndjekur penalisht krimet kundër njerëzimit dhe dhunimet e ligjeve e rregullave të luftës në territorin e ish-Jugosllavisë, Gjykata, më 10 mars, deklaroi që jurisdiksioni i saj "mbulon dhunën e kohëve të fundit në Kosovë", megjithëse hetuesit e Gjykatës nuk bënë asnjë vizitë në krahinë gjatë katër muajve të ardhshëm.[40]

Ndërsa konflikti rritej, po kështu rritej edhe kryengritja. Paratë e komunitetit të diasporës, që më parë i jepeshin LDK-së, tani kishin ndërruar drejtim dhe shkonin tek fondi i UÇK-së, fond që ish i njohur me emrin "Atdheu na thërret". Gjithmonë e më shumë, shqiptarë me banim në Europën perëndimore, e më pas ata të SHBA-ve, bashkoheshin me kryengritjen.

Roli i komunitetit ndërkombëtar

Vrasjet në Drenicë tërhoqën vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar, pavarësisht këmbënguljes së qeverisë jugosllave, sipas të cilit ky konflikt ishte një çështje e brendshme. Komuniteti ndërkombëtar kritikoi dhunën e tepërt shtetërore në Drenicë, por përtej dënimeve verbale, pothuaj nuk bëri asgjë. Më 2 mars, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit James Rubin tha se Shtetet e Bashkuara ishin "tejet të tronditur nga incidentet e dhunës së kohëve të fundit" dhe kërcënoi se "muri i jashtëm" i sanksioneve mund të mbahej më këmbë derisa të vinte përmirësimi i gjendjes në Kosovë. Ai gjithashtu u bëri thirrje udhëheqsve kosovarë "të dënonin aksionin terrorist të së ashtuquajturës Ushtria Çlirimtare e Kosovës".[41]

Kërcënimi me sanksione e masa të tjera ndëshkuese mbeti në kuadrin e fjalëve.

Gjatë shtatë muajve në vazhdim, megjithëse dhuna shtetërore nuk reshti, kërcënimi me sanksione e masa të tjera ndëshkuese mbeti në kuadrin e fjalëve. U dhanë konçesione pas një progresi të parëndësishëm, dhe në këto kushte komandantët serbë, nën komandën e Milosheviçit, në shumë raste urdhëruan ushtrimin e dhunës.

Më 9 mars, Grupi i Kontaktit mbajti një takim në Londër dhe i la qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë dhjetë ditë afat për të përmbushur

serinë e kërkesave, pëfshirë këtu: tërheqjen e policisë speciale nga Kosova dhe ndalimin e aksioneve kundër popullsisë civile nga ana e forcave të sigurimit; lejimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe organizatave të tjera humanitare si dhe të përfaqësuesve të Grupit të Kontaktit dhe të përfaqësuesve të tjerë diplomatikë për të monitoruar situatën në Kosovë; dhe fillimin e procesit të dialogut me lidershipin shqiptar të Kosovës.[42] Grupi i Kontaktit shpalli që, nëse Presidenti Milosheviç ndërmerrte këto masa, do të rikonsideroheshin katër masat ndëshkuese që ishin kishin hyrë në veprim.[43] Nëse ai nuk do të binte dakord, grupi do të ndërmerrte masa të mëtejshme, përfshirë ngrirjen e aseteve dhe fondeve të qeverisë serbe dhe të Republikës Federale të Jugosllavisë jashtë vendit.

Ndërsa Milosheviçi e ngriti nivelin e dhunës, komuniteti ndërkombëtar i zbuti kushtet, pas përmbushjes së të cilave ai mund të konsiderohej në pikëpamje ndërkombëtare.

Në një lëvizje paralele, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve njoftoi më 13 mars, se po shqyrtonte dhënien e një shume prej 1, 075 milionë dollarë amerikanë për të mbështetur hetimet e Gjykatës së Krimeve të Luftës në Kosovë.[44]

Grupi i Kontaktit u ritakua jo pas dhjetë, por pas gjashtëmbëdhjetë ditësh, më 25 mars. Në ditët përpara takimit të 25 marsit, qeveria e Milosheviçit pakësoi disi sulmet policore në Kosovë dhe ra dakord të zbatonte marrëveshjen e arësimit, një kërkesë e kahershme kjo e komunitetit ndërkombëtar dhe një prej shumë masave të nevojshme për krijimin e klimës së mirëbesimit, e cituar në deklaratën e 9 marsit të Grupit të Kontaktit. Ndonëse nuk ishin të mjaftueshme për të bindur Grupin e Kontaktit të shfuqizonte masat e ndërmarra më parë, gjestet e Republikës Federale të Jugosllavisë nuk e lanë Grupin të ndërmerrte masa të tjera, duke i dhënë Milosheviçit kohë të mëtejshme. Grupi i Kontaktit ra dakord të takohej përsëri pas katër javësh, në mënyrë që të rikonsideronte situatën.[45]

Më 31 mars, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 1160, e cila dënoi dhunën e kryer nga të dy palët, bëri apel për një zgjidhje të negociuar, dhe imponoi një embargo armësh në Jugosllavi. Në prill 1998, Milosheviçi organizoi një referendum popullor, nëpërmjet të cilit, zgjedhësve do t'u duhej t'i përgjigjeshin pyetjes, nëse e pranonin ndërmjetësimin ndërkombëtar në konfliktin e Kosovës. Vota në favor të mospërfshirjes ndërkombëtare në këtë çështje ishte pothuaj unanime.

Takimi i Grupit të Kontaktit i 29 prillit synoi të krijonte hapësira të reja për komunikim midis komunitetit ndërkombëtar dhe qeverisë së RFJ-së. Duke theksuar se kushtet e vëna më 9 mars ishin të paplotësuara, Grupi i Kontaktit vendosi të kalonte tek ngrirja e aseteve. Ky veprim, i cili fillimisht kërcënonte Beogradin, nëse ky i fundit nuk përmbushte kushtet e vëna nga Grupi i Kontaktiti më 19 mars, përfundimisht u miratua nga Grupi i Kontaktit me një muaj e gjysëm vonesë. Nuk u implementua nga Bashkimi Europian deri nga fundi i qershorit, dhe kështu autoritetet jugosllave kishin mjaft kohë t'i tërhiqnin apo t'u ndërronin strehë fondeve, për të cilat bëhej fjalë. Grupi i Kontaktit premtoi gjithashtu të ndalonte investimet, nëse Milosheviçi nuk plotësonte kushtet e reja të 9 majit.[46] Këto kushte të reja ishin më të zbutura se sa ultimatumi i 9 marsit, ku shprehja "të tërhiqen njësitet e policisë speciale" u zëvendësua me shprehjen "të ndalohet represioni", dhe ku kërkesa për lejimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq e të organizatave të tjera humanitare nuk figuronte më. Ndërsa Milosheviçi e ngriti nivelin e dhunës, komuniteti ndërkombëtar i zbuti kushtet, pas përmbushjes së të cilave ai mund të konsiderohej në pikëpamje ndërkombëtare.

Gjatë çerekut të dytë të vitit 1998, UÇK-ja, e quajtur një "lëvizje për çlirim" nga shumica e shqiptarëve dhe një "organizatë terroriste" nga qeveria jugosllave, mori në një farë mënyre nën kontroll rreth 40% të territorit të Kosovës, përfshirë rajonin e Drenicës dhe zonën rreth Malishevës. Zëdhënësat e UÇK-së, ishin vazhdimisht prezentë përpara publikut, dhe flisnin për çlirimin e Prishtinës, dhe eventualisht, të Kosovës. Civilë serbë në zonat nën kontrollin e UÇK-së frikësosheshin, terrorizoheshin, rrëmbeheshin, shtrëngoheshin të linin banesat e tyre, në ndonjë rast vriteshin.

Nga fundi i Prillit dhe fillimi i Majit, UÇK-ja mori kontrollin e fshatrave në verilindje të rrugës kryesore që lidhte Deçanin me Gjakovën, duke ngritur shtabin në Glogjan. Serbët u dëbuan nga këto fshatra në drejtim të qytetit të Deçanit, ku tensionet ndëretnike ishin shumë të mprehta. UÇK-ja u duk se po përpiqej të hapte një korridor midis Shqipërisë e Drenicës.

Duke gjykuar në retrospektivë, shumë analistë besojnë se policia serbe dhe ushtria jugosllave e kanë lejuar qëllimisht shtrirjen e UÇK-së. Të vetëdijshëm që kryengritja lehtësisht e armatosur dhe e keqorganizuar nuk mund të mbante territore, forcat e sigurimit lejuan rebelët të përhapen në një territor sa më të gjerë. Forcat qeveritare nuk sulmuan, por

pozicionuan vetveten, si p.sh në kodrën e Suka Crmljanska-s pranë liqenit Radonjiç. Analistë të tjerë megjithatë, besojnë se një rritje e shpejtë e UÇK-së e kapi në befasi qeverinë serbe.

Pas pesë ditësh të ecejakeve intensive diplomatike të të dërguarit special të Shteteve të Bashkuara, Richard Holbrooke, Milosheviç e Rugova ranë dakord të takohen më 15 maj në Beograd, së bashku me katër përfaqësues të tjerë shqiptarë të Kosovës.[47] Si një lëshim për Milosheviçin, takimi u bë pa praninë e ndërmjetësve të huaj, gjë që kish qënë një kusht i hershëm edhe i komunitetit ndërkombëtar, edhe i shqiptarëve të Kosovës. Milosheviçi ra dakord të vazhdonte bisedimet dhe caktoi një ekip për këtë punë, i cili drejtohej nga Ratko Markoviç, zëvendës kryeministër i Serbisë. Pas takimit, zyra e Milosheviçit lëshoi këtë deklaratë:

> Presidenti Milosheviç vuri në dukje se vetëm me mjete politike – nëpërmjet një dialogu të drejtëpërdrejtë mbi baza parimore – mund të gjenden zgjidhjet paqësore, humane, të drejta e jetëgjata të problemit të Kosovës e Metohisë.[48]

Duke e konsideruar këtë një "kornizë për paketën e dialogut e të stabilizimit", siç u përcaktua në një deklaratë të Grupit të Kontaktit më 29 prill, takimi Milosheviç-Rugova e bëri komunitetin ndërkombëtar ta zbusë presionin. Në takimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Europian më 25 maj, ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të BE-së arritën në përfundimin që, në dritën e takimit Milosheviç-Rugova në Beograd, "masa e propozuar për të penguar investimet e reja në Serbi mund të mos konsiderohet".[49]

Atë javë, Beogradi ndërmori një ofensivë të gjerë përgjatë kufirit me Shqipërinë, ku u vunë re shkelje të ligjit humanitar ndërkombëtar. Për shkak të kësaj ofensive, shqiptarët e Kosovës hoqën dorë nga të gjitha negociatat.

Në të parin aksion të përbashkët të policisë speciale serbe dhe të ushtrisë jugosllave, forcat qeveritare sulmuan një numër qytetesh e fshatrash gjatë kufirit me synimin e vetëm të çpopullimit të rajonit dhe të dëbimit të UÇK-së. Deri atëherë, UÇK-ja kishte marrë armë e rekrutë të rinj nga Shqipëria. Ofensiva serbe kaq e rrufeshme, menjëherë pas takimit, dëmtoi popullaritetin e Rugovës mes shqiptarëve, por ai, së bashku me Bujar Bukoshin e botuesin e pavarur Veton Surroi, u ftua shpejt e shpejt në Washington për një takim me Presidentin Clinton, me qëllimin e mbrojtjes

së imazhit të tij.[50] Ofensiva ishte gjithashtu një dëshmi e taktikës tashmë të zakonshme të Milosheviçit: Fol për paqen e bëj luftën.[51]

Megjithëse ishte qartësisht një luftë midis qeverisë e UÇK-së, shumë fshatra, nga Peja në veri deri në Gjakovë në jug u bombarduan ashpërsisht pa marrë në konsideratë jetët e civilëve. Civilët, që u shmangeshin sulmeve u qëlluan në ndonjë rast nga snaiperat, dhe një numër ende i papërcaktuar njerëzish u paraburgosën. Në tre raste, helikopterë të markuar me emblemën e kryqit të kyq qëlluan mbi civilë. Mina kundër trupave u vendosën në pika strategjike gjatë kufirit me Shqipërinë, si dhe gjatë kufirit jugor me Maqedoninë. Shumë fshatra të rajonit u plaçkitën dhe shkatërruan në mënyrë sistematike dhe bagëtitë e fermerëve u asgjësuan, për t'u siguruar kështu që askush nuk do të mund të kthehej brenda një kohe të shkurtër. Pesëmbëdhjetë mijë vetë ikën në Shqipëri, ndërsa rreth tridhjetë mijë vetë ju drejtuan veriut, drejt Malit të Zi.[52]

Në të njëjtën kohë, Milosheviçi tentoi të konsolidojë pushtetin e vet në Serbi. Në maj 1998, parlamenti serb miratoi një ligj shumë shtrëngues

Rruga kryesore në Deçan, e shkatërruar nga trupat serbe dhe ato jugosllave gjatë ofensivës së ndërmarrë në maj-qershor 1998 përgjatë kufirit të Kosovës me Shqipërinë.

© PETER BOUCKAERT / HUMAN RIGHTS WATCH

mbi universitetin, që margjinalizonte akademikët e pavarur apo ata të orientuar nga opozita. Qeveria vazhdoi gjithashtu sulmin e vet ndaj mediave të pavarura duke refuzuar liçencat e transmetimit për shumë stacione radiofonike e televizive të pavarura.[53] Aleati politik i Milosheviçit nga Mali i Zi, Momir Bullatoviç, u caktua kryeministri i Jugosllavisë.

Prej takimit të ministrave të jashtëm të BE-së më 9 qershor, nuk mund të tolerohej më hedhja hi syve të komunitetit ndërkombëtar. Ministrat vendosën për ndalimin e investimeve në Serbi, dhe ranë dakord me një deklaratë që thosh:

> Presidenti Milosheviç mban një përgjegjësi të veçantë si kreu i qeverisë së RFJ-së në gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për çështjen e Kosovës. Ai nuk duhet të besojë që komuniteti ndërkombëtar do të mashtrohet nga retorika e paqes, kur e vërteta në terren është një repression gjithnjë e më i egër ….. Bashkimi Europian mbetet i gatshëm të marrë masa të tjera kundër Beogradit, nëse autoritetet e atjeshme nuk do të ndalojnë përdorimin e tepërt të forcës dhe nuk të do të ndërmarrin hapa në drejtim të një progresi politik të mirëfilltë. Për më tepër, BE-ja inkurajon organizatatat e sigurimit ndërkombëtar të vazhdojnë përpjekjet e tyre në këtë drejtim dhe të konsiderojnë të gjitha opcionet, përfshirë ato që mund të kërkonin autorizimin (e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) sipas kapitullit të VII-të.[54]

Më 11 qershor, ministrat e mbrojtjes së NATO-s autorizuan autoritetet ushtarake të NATO-s të zhvillojnë një varg opcionesh për "ndalimin dhe ndërprerjen e një fushate sistematike të represionit e dëbimit të dhunshëm në Kosovë". [55] Për një demonstrim të fuqisë ushtarake, NATO ra dakord të zhvillojë disa ushtrime ajrore mbi Shqipërinë e Maqedoninë fqinje. Stërvitja "fajkoi i vendosur", e zhvilluar më 15 qershor, u prezantua si një demonstrim "i aftësisë së NATO-s për të projektuar shpejt e shpejt forcë vepruese në rajon". [56] Aeroplanët fluturonin mbi Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, por jo mbi Shqipërinë veriore, ku ata mund të shiheshin nga forcat serbe dhe UÇK-ja.

Takimi i Grupit të Kontaktit më 12 qershor riafirmoi ngrirjen e aseteve dhe pengimin e investimeve (Rusia kundërshtoi) dhe premtoi masa shtesë, nëse do të mungonin reagimet e menjëhershme. Këto reagime ishin esencialisht po ato që ishin kërkuar për t'u vënë në jetë brenda dhjetë

ditësh më 9 mars, me përjashtim të faktit që, çfarë kish qënë njëherë një dialog i ndërmjetësuar ndërkombëtar dhe pastaj një " kornizë e paketës së dialogut dhe të stabilizimit", u bë "progres i shpejtë në dialogun me lidershipin shqiptar të Kosovës".[57]

Nja dyzet serbë gjithashtu u zhdukën në atë pak kohë, gjatë së cilës qyteti ishte nën kontrollin e UÇK-së

Duke fituar avantazh nga ndarja midis Rusisë dhe anëtarëve të Grupit të Kontaktit, Milosheviçi ra dakord të takojë më 16 qershor Presidentin Boris Jeltcin. Takimi Milosheviç-Jeltcin i përforcoi angazhimet jugosllave për të vazhduar bisedimet me shqiptarët e Kosovës, për të mos kryer veprime represive kundër popullsisë paqësore, për të garantuar liri të plotë lëvizjeje në gjithë territorin e Kosovës dhe për të mundësuar hyrjen e papenguar të organizatave humanitare. Deklarata e përbashkët e Milosheviçit dhe e Jeltcinit u formulua mbi bazën e mosrespektimit të rregullave, por kjo e çoi kohën e Milosheviçit në një pikë kritike, kur kërcënimet e NATO-s ishin më të fuqishme se sa kishin qënë në çdo kohë deri në këtë moment.

Një rezultat konkret i takimit të Jeltcinit ishte krijimi i Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (MVDK), i ngritur më 6 korrik 1998, dhe i cili kish mandatin të vëzhgonte e të raportonte mbi lirinë e lëvizjes dhe kushtet e sigurimit në Kosovë. I koordinuar nga ambasadorët e Grupit të Kontaktit në Beograd, Presidenca e Bashkimit Europian (Austria) dhe kreu i radhës i OSBE-së (Polonia), misioni përbëhej nga tre grupe: SHBA-MVDK, RUSI-MVDK dhe BE-MVDK, secili prej të cilëve kish skuadra që udhëtonin e monitoronin kudo nëpër krahinë. Në dhjetor 1998, MVDK-ja kishte një personel prej 400 vetësh në Kosovë; shumës syresh ishin ekspertë të mbrojtjes e të shërbimeve sekrete.

Anëtarët e MVDK-së në terren filluan të vendosnin kontakte me UÇK-në, si p.sh. pararoja e SHBA-MVDK-së në fshatin Dragobil, ku UÇK-ja kish një bazë operacionesh. Qeveria e Shteteve të Bashkuara gjithashtu mbajti kontakte publike me UÇK-në në muajin korrik, ndërsa negociatorët përpiqeshin të nxirrnin në treg një zgjidhje politike për "autonomi të rivlerësuar" brenda Jugosllavisë.

Ndërsa ofensiva e parë e qeverisë së RFJ-së e dëmtoi pjesërisht UÇK-në përgjatë kufirit me Shqipërinë, kryengritësit fituan territor në pjesë të tjera të Kosovës, sidomos rrotull Malishevës. Rritja e rebelëve gjatë pranverës e largoi mendimin e një aksioni ushtarak ndërkombëtar, pasi kjo do ta

përmbyste balancën në favor të pavarësisë së Kosovës. Deklaratat energjike të UÇK-së për "çlirimin e Prishtinës" apo edhe për bashkimin eventual me Shqipërinë e bëri komunitetin ndërkombëtar më hezitues në ndërmarrjen e veprimeve të tjera që mund të interpretoheshin si mbështetje për kryengritjen.

Pasi morën zemër, ofensiva e parë e madhe e UÇK-së filloi më 19 korrik, kur tentuan të kapnin qytetin e Rrahovecit. Ofensiva dështoi keq, sepse policia e rimori qytetin pas dy ditësh, ashtu si dhe Malishevën, fortesën e UÇK-së. Në luftimet për Rrahovecin, u vranë të paktën dyzet e dy shqiptarë etnikë. Dëshmitarët raportuan ekzekutime në masë dhe përdorimin e njerëzve si parzmore nga policia. Nja dyzet serbë gjithashtu u zhdukën në atë pak kohë, gjatë së cilës qyteti ishte nën kontrollin e UÇK-së, shumica e të cilëve mungonin edhe në gusht 2001 dhe hamendësohet se janë vrarë (shih më poshtë Seksionin mbi Abuzimet e UÇK-së më 1998).

Forcat qeveritare intensifikuan ofensivën e tyre gjatë korrikut, gushtit dhe shtatorit, pavarësisht nga premtimet e përsëritura të Milosheviçit për t'i dhënë fund ofensivës. Në mesin e gushtit qeveria rimori një pjesë të madhe të territorit, që më përpara mbahej nga UÇK-ja. E paaftë të mbronte popullsinë civile, UÇK-ja u tërhoq në kodrat e Drenicës dhe në xhepa sa në jug e në veri të Kosovës.

Abuzimet qeveritare të vitit 1998

Ofensiva qeveritare, e cila vazhdoi me të njëjtin ritëm pavarësisht dislokimit të MVDK-së, ishte një përpjekje e dukshme për të evituar mbështetjen e civilëve për rebelët. Forcat qeveritare sulmonin civilët, shkatërronin qytete në mënyrë sistematike, dhe shtrëngonin mijra njerëz të merrnin arratinë nga shtëpitë e tyre. Policët ishin parë në mënyrë të përsëritur të plaçkisnin shtëpitë, të shkatërronin fshatra tashmë të braktisur, të digjnin të vjelat, të thernin kafshët e fermave, si edhe të kryenin ekzekutime në masë; që të gjitha përbëjnë dhunim të rregullave të luftës. Shumica e atyre që u vranë apo u plagosën ishin civilë. Të paktën 250 mijë vetë ishin shpërngulur midis majit e shtatorit të vitit 1998, sipas UNHCR-së, shumë prej tyre gra e fëmijë. Rajoni i kufirit me Shqipërinë u godit veçantërisht ashpër, por në të njëjtën masë goditeshin zona ku UÇK-ja ishte aktive, si p.sh. Drenica e zona përreth Rrahovecit.

Qeveria e kufizoi lëvizshmërinë e agjencive të ndihmës humanitare, të cilat kërkonin të asistonin të shpërngulurit brenda për brenda. Në raste të ndryshme, policia pengonte praninë e tyre pranë popullsive në nevojë, konfiskonte rezervat e tyre, shqetësonte, madje sulmonte, punëtorët e ndihmës humanitare. Qeveria justifikonte këtë gjendje, duke argumentuar se shumë organizata humanitare kishin shpërndarë rezervat e tyre, ku përfshiheshin edhe armë, në duart e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Qeveria jugosllave vuri gjithashtu kufizime në punën e gazetarëve të vendit e të huaj, të cilët donin të raportonin mizoritë e kryera. Shumë gazetarë shqiptarë kërcënoheshin, paraburgoseshin, apo rriheshin nga policia. Radiove të pavarura e stacioneve televizive në gjuhën shqipe ju mohuan liçencat, ose në një rast, u mbyllën.

Media e pavarur në gjuhën serbe nuk ishte e përjashtuar nga trysnia shtetërore. Shërbimet e informacionit, gazetat, dhe stacionet televizive që përpiqeshin të raportonin në mënyrë objektive mbi Kosovën u etiketuan "tradhëtarë" dhe u kërcënuan nëpërmjet aksionesh ligjore. Një kornizë ligjore komplekse e kontradiktore në Serbi e bënte praktikisht të pamundur për stacionet radiofonike e televizive të pavarura të përfitonin një frekuencë transmetimi.[58] Ashtu si edhe në rastin e luftrave në Bosnjë dhe Kroaci, televizioni e radioja shtetërore shpërndanin qëllimisht dezinformacion dhe nxisnin imazhet e "armikut", gjë që synonte të ndizte pasionet në konflikt.

Një grua shqiptare nga Plocica, pranë shtëpisë së saj të shkatërruar nga forcat qeveritare në shtator 1998.
© PETER BOUCKAERT / HUMAN RIGHTS WATCH

Media ndërkombëtare që mbulonte Kosovën gjithashtu u ballafaqua me një numër të madh kufizimesh në punën e vet, duke filluar me mosdhënien e vizave për gazetarë të rëndësishëm, të cilët shteti i konsideronte "antiserbë". Një gazetar u deklarua "persona non grata" dhe një grup tjetër gazetarësh të huaj u rrahën apo u qëlluan nga policia.

Të paktën njëqind shqiptarë etnikë "humbën" në Kosovë midis shkurtit

e tetorit 1998, dhe rreth gjysma e tyre ishin parë për herë të fundit nën ruajtjen e policisë. Numri i saktë ishte e pamundur të përcaktohej, përderisa autoritetet jugosllave refuzuan të bënin publik numrin e njerëzve që kishin në paraburgim, një problem ky që vazhdoi edhe pas fillimit të bombardimit nga ana e NATO-s në mars 1999. Përveç kësaj, shumë shqiptarë të konsideruar "bashkëpunëtorë të serbëve" u rrëmbyen nga UÇK-ja.

Më shumë se 500 shqiptarë etnikë u arrestuan dhe u gjykuan me akuzën për kryerjen e "akteve terroriste". Në korrik e gusht, ndër individët e burgosur gjithnjë e më shumë përfshiheshin veprimtarë të të drejtave të njeriut, punëtorë të ndihmës humanitare,anëtarë të partive politike, doktorë, juristë, shumë prej të cilëve u sakatuan fizikisht. Përdorimi i torturës ndaj të burgosurve ishte një veprim i përhapur, dhe të paktën gjashtë vetë vdiqën për shkak të keqtrajtimit në burg.[59]

Trupat e Gentiana dhe Donieta Deliaj, shtatë dhe pesë vjeçare, të nxjerra nga një gropë në pyllin e Abrit të Epërm ku ato u vranë më 26 shtator 1998. Gjatë sulmit u vranë tetëmbëdhjetë anëtarë të familjes. © PETER BOUCKAERT / HUMAN RIGHTS WATCH

Ofensiva e qeverisë serbe e jugosllave përfundoi në fund të shtatorit me luftime të ashpra në rajonin e Suharekës e të Drenicës. Më 27 shtator, vëzhguesit e MVDK-së zbuluan trupat e njëzet e një civilëve shqiptarë të ekzekutuar në një pyll pranë fshatit Abri e Epërme. Të nesërmen, kërkues të "Human Rights Watch"-it dhe gazetarë vizituan zonën dhe dokumentuan vrasjet, ashtu si dhe ekzekutimin e trembëdhjetë burrave shqiptarë në një fshat fqinjë, Golubofc. [60] Masakra elektrizoi opinionin botëror dhe ndihmoi në rihapjen e një round-i të ri negociatash diplomatike të udhëhequar në Shtetet e Bashkuara.

Abuzimet e UÇK-së në vitin 1998

UÇK-ja gjithashtu kreu dhunime serioze të ligjit humanitar ndërkombëtar gjatë kësaj kohe, ashtu si edhe në fillim të vitit 1999,

përfshirë marrjen e pengjeve dhe ekzekutimet jashtëgjyqësore.[61] Më 21 qershor 2000, në Prishtinë, kryeprokurorja e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në Jugosllavi Carla Del Ponte njoftoi që "pesë episode" të krimeve të supozuara të UÇK-së ishin nën hetim nga Gjykata.

Në shumë fshatra në zonat e kontrolluara nga UÇK-ja, rebelët i dëbuan serbët etnikë nga shtëpitë e tyre. Në disa raste, serbë të moshuar mbesnin

Nga raporti i Human Rights Watch, Një Javë e Terrorit në Drenicë, shkurt 1999

Incidenti më i rëndë i dokumentuar në këtë raport ndodhi nga fundi i shtatorit 1998 në fshatin Abri e Epërme, dhe viktimë u bë familja e madhe me mbiemrin Delijaj. Abri e Epërme ishte një fshat, ku ishin vënë re luftime të ashpra midis forcave qeveritare dhe forcave të UÇK-së dhe ku gjetën vdekjen të paktën katërmbëdhjetë policë. Forcat e policisë speciale u hakmorrën duke vrarë njëzet e një pjesëtarë të familjes Delijaj, që të gjithë civilë, në pasditen e së shtunës, më datën 26 shtator. Katërmbëdhjetë vetë u vranë në një pyll aty pranë, ku ata ishin fshehur prej frikës nga bombardimet qeveritare, gjashtë prej të cilëve ishin gra të moshës 25-62 vjeç. Pesë nga viktimat ishin fëmijë të moshës 1,5-9 vjeç. Ndër tre burrat e vrarë në pyll, dy ishin mbi gjashtëdhjetë vjeç.

Human Rights Watch e vizitoi skenën më 29 shtator, ndërsa kufomat po nxirreshin nga pylli për t'u varrosur. Të katërmbëdhjetë viktimat ishin me rroba civile; Shumica ishin goditur në kokë nga një distancë e afërt, ndërsa disa kufoma ishin sakatuar. Në një rast, këmba e gjashtëdhjetë e dy vjeçares Hava Delijaj ishte prerë poshtë gjurit.

Përveç katërmbëdhjetë vetëve të vrarë në pyll, shtatë pjesëtarë të tjerë të familjes Delijaj u vranë nga forcat qeveritare pranë shtëpisë së banimit. Plaku autoritar i familjes, nëntëdhjetë e katër vjeçari Fazlli Delijaj, invalid, u gjet i djegur për vdekje në shtëpinë e tij gjithashtu të djegur. Habib e Hysen Delijaj u ekzekutuan që të dy nga policë serbë në prani të gruas e fëmijëve të Hysenit. Adem Delijaj u gjet pranë pyllit me fytin të prerë. Në javët e ardhshme, kufomat e dekompozuara të dy vajzave, Antigona e Mihane Delijaj, dhe i Hajriz Delijajt, u gjetën të masakruar në të njëjtën zonë të krimit. Një burrë, Sherif Delijaj, rezulton i humbur edhe sot e kësaj dite.

prapa ose ngaqë ishin shumë të moshuar për të marrë arratinë, ose ngaqë nuk donin të braktisnin shtëpitë e tyre. Disa prej tyre humbën dhe janë sipas shumë gjasave të vdekur. UÇK-ja gjithashtu sulmoi, vrau apo rrëmbeu shumë shqiptarë etnikë dhe romë, të cilët ajo i konsideronte "bashkëpunëtorë" me qeverinë jugosllave.

Sipas Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në Jugosllavi, nëntëdhjetë e shtatë serbë të rrëmbyer të Kosovës ende nuk gjendeshin më 15 maj të vitit 2000.[62] Sipas Qendrës së Ligjit Humanitar, e cila është një shoqatë e respektuar jugosllave e të drejtave të njeriut, 103 serbë humbën midis janarit e gushtit 1998, tridhjetë e nëntë prej të cilëve ishin parë për herë të fundit nën ruajtjen e UÇK-së. Qendra gjithashtu dokumentoi rrëmbimin e tre shqiptarëve të Kosovës nga ana e UÇK-së.[63]

UÇK-ja paraburgosi rreth tetëdhjetë e pesë serbë gjatë ofensivës në Rrahovec më 19 korrik 1998. Tridhjetë e pesë prej tyre u lanë më pas të lirë, por të tjerët nuk janë gjendur as në kohën që po shkruhet ky libër. Sipas Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në Jugosllavi, tridhjetë e nëntë serbë u zhdukën nga komuna e Rrahovecit më 17 e 18 korrik.[64] Më 22 korrik, UÇK-ja mori nën kontroll për një kohë të shkurtër minierën

Një serb etnik duke vështruar shtëpinë e tij të shkatërruar në Jelovac, pranë Klinës. Deri në qershor 1998 kur UÇK-ja rrëmbeu një serb dhe përzuri serbët e tjerë nga fshati, atje ishin dymbëdhjetë shtëpi serbe dhe njëzetë shqiptare.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

e Belacevacit pranë Obiliqit. Nëntë serbë u kapën atë ditë, dhe ata figurojnë të humbur në listën e gjykatës së Hagës.

Më 9 shtator policia serbe njoftoi se kish gjetur disa kufoma të njerëzve, të cilët, nga sa thuhej, ishin të vrarë nga UÇK-ja afër Glogjanit. Më 16 shtator, autoritetet zbuluan tridhjetë e katër trupa të vdekurish, njëmbëdhjetë prej të cilëve u identifikuan, dhe një pjesë syresh ishin shqiptarë etnikë. Para kësaj, abuzimi më i rëndë i kryer - kështu thoshin raportet - nga UÇK-ja, ishte ekzekutimi i njëzet e dy civilëve serbë në fshatin Kleçkë, në të cilin, në gusht policia pretendoi se kish gjetur trupa njerëzish të djegur dhe një furrë për të kremuar trupat. Mënyra se si u dëshmua, ngrinte megjithatë pikëpyetje serioze mbi vërtetësinë e asaj që thuhej.[65]

UÇK-ja, duke u transformuar ndadalë nga një grup guerrilasish të paorganizuar në një forcë të armatosur më serioze, nuk u qëndroi angazhimeve të saj të deklaruara, sipas të cilave do të respektonte ligjin e ligjet ndërkombëtare të luftës, dhe në deklaratat publike nuk linte të kuptohej se njihte disa prej principeve bazë të këtyre normave. Në të vërtetë, ekzekutimet u pranuan dhe u justifikuan në muajt e parë të luftës. Në një intervistë dhënë një gazete kosovare, zëdhënësi i UÇK-së Jakup Krasniqi tha:

Kafkë me një brimë të dukshme plumbi e gjetur në Klinë, ku autoritetet serbe zhvarrosën eshtrat e katër personave për të cilët ata deklaruan se ishin vrarë nga UÇK.

© PETER BOUCKAERT / HUMAN RIGHTS WATCH

UÇK-ja nuk është marrë kurrë me civilët, duke përjashtuar rastin kur ata kanë qënë në shërbim të ushtrisë e policisë dhe i kanë bërë dëme serioze popullit dhe çështjes kombëtare shqiptare. Ka patur raste kur ata janë rrëmbyer nga ana jonë, por u janë dorëzuar organizatave ndërkombëtare. Sigurisht, kur ata kanë qënë të pafajshëm.

Para së gjithash, të gjitha forcat serbe, pavarësisht nga fakti në janë policë, ushtarë apo civilë të armatosur, janë armiqtë tanë. Qysh prej fillimit, ne kemi patur rregullat tona të brendshme për operacionet e kryera. Këto rregulla kanë si kusht që UÇK-ja njeh Konventat e Gjenevës dhe konventat që përcaktojnë sjelljen gjatë luftës, edhe pse nuk ka patur shans për t'i nënshkruar ato, sido që do të kish dashur ta bënte këtë gjë. Ne nuk rrëmbejmë njerëz. Edhe kur disa njerëz kanë vuajtur, pjesa më e madhe e tyre kanë qënë kolaboracionistë shqiptarë dhe jo civilë serbë. Ne nuk kemi punë me civilët, dhe ne do t'i kthejmë prapa ata që i mbajmë si të burgosur të luftës. Disa ditë më parë ne i dorëzuam Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dy serbë me banim në Kroaci. Ata që janë kapur prej nesh, ose janë në listën e ekzekutimeve, ose janë ekzekutuar, por sidoqoftë, qëndrimi ynë është i ndryshëm nga ai i serbëve.[66]

Qëndrimi i ashpër i UÇK-së ndaj civilëve shqiptarë është gjithashtu impresionant. Fshatra të deklaruara "të çliruara" nga UÇK-ja shkatërroheshin vetëm pak kohë më pas nga forcat serbe, të cilat nxirrnin dufin e tyre mbi civilët, që nuk ishin tërhequr në kodra me UÇK-në. Pritat në pikat e kontrollit të policisë e ushtrisë, shpesh provokonin një përgjigje ndaj fshatit më të afërt, pavarësisht nga fakti, nëse ai fshat ishte apo jo bazë e UÇK-së. Nuk është e tepërt të mendohet se UÇK-ja, e bindur në agresivitetin e brutalitetin e dukshëm të forcave serbe, mund të ketë provokuar qëllimisht sulme kundër civilëve shqiptarë, dhe në këtë mënyrë, viktimat e pafajshme do të promovonin çështjen e tyre dhe do të afronin perëndimin, sidomos Shtetet e Bashkuara, tek konflikti. Në fund të fundit, UÇK-ja e nuhati përfitimin politik të viktimave civile.

Përgjigja e komunitetit ndërkombëtar

Përgjigja ndërkombëtare ndaj ofensivës së verës ishte dukshëm e dobët për shkak të përçarjeve të qëndrueshme brenda komunitetit ndërkombëtar.

Në Këshillin e Sigurimit, Kina e Rusia, që të dyja anëtare të përhershme me të drejtën e vetos, mendonin se konflikti ishte një çështje e brendshme që duhej të zgjidhej nga autoritetet jugosllave. Ky pozicion bllokoi efektivisht një përgjigje energjike të Këshillit të Sigurimit ndaj konfliktit.

Një nivel i ngjashëm përçarjeje u shfaq në Grupin e Kontaktit, ku Rusia në veçanti luajti rolin e mistrecit destruktiv, ndonëse rezistenca ruse u përdor në ato kohë nga shtetet perëndimore si një përligjje e inaktivitetit të tyre.

Gjatë gjithë ofensivës serbe e jugosllave, komuniteti ndërkombëtar dënoi abuzimet qeveritare, por nuk bëri asgjë për të penguar vazhdimin e ofensivës. Inaktiviteti i perëndimit la përshtypjen se po toleronte sulmet ndaj civilëve, dhe mund të jetë interpretuar nga Milosheviçi si një dritë jeshile për të vazhduar. Avokatët e inaktivitetit në perëndim supozonin që ofensiva mund t'i çonte shqiptarët e Kosovës në tryezën e negociatave. Një zyrtar i perëndimit u citua nga shtypi të thoshte se "ka një pikëpamje të përgjithshme, sipas së cilës kryengritësit e UÇK-së po maten me hijen e mëngjesit e janë fryrë ca si shumë, e për këtë arsye u duhen thyer hundët përpara negociatave".[67]

Pozicioni i Shteteve të Bashkuara u prezantua si duhet nga Sekretari i Mbrojtjes William Cohen, i cili tha se NATO "nuk është se nuk i shihte" trupat serbe e jugosllave që sulmonin civilë e përdornin forcë në mënyrë të shproporcionuar, por NATO nuk donte të hidhej në aksione, të cilat "mund të interpretoheshin si mbështetje në terren, qoftë morale, qoftë ushtarake, ndaj atyre që kërkonin pavarësinë", e me këtë nënkuptonte UÇK-në.

Para muajit shtator, masa e vetme e ndërmarrë nga Këshilli i Sigurimit e që përbënte një lloj kafshimi, kishte qënë rezoluta 1160, e miratuar më 31 mars 1998, e cila imponoonte një embargo të armëve për RFJ-në, gjë që u arrit me abstenimin e Kinës dhe pasi paralajmërimet e përsëritura të Grupit të Kontaktit ishin shpërfilluar. Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e miratuar më 23 shtator 1998 (përsëri me abstenimin e Kinës), shkoi pak më tej në dënimin e akteve të dhunës të kryera në Kosovë, duke riafirmuar embargon e armëve dhe, nën autoritetin e kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke kërkuar një ndërprerje të menjëhershme të luftimeve.[68]

Inaktiviteti i perëndimit la përshtypjen se po toleronte sulmet ndaj civilëve, dhe mund të jetë interpretuar nga Milosheviçi si një dritë jeshile për të vazhduar.

Rezoluta 1199 gjithashtu u kërkonte RFJ-së dhe lidershipit të shqiptarëve të Kosovës të nisnin dialogun e menjëhershëm e kuptimplotë dhe kërkonin që RFJ-ja të vinte menjëherë në jetë masat e theksuara në deklaratën e 12 qershorit të Grupit të Kontaktit. Rezoluta i bënte thirrje Presidentit të RFJ-së për të vënë në jetë angazhimet e tij të ndërmarra në deklaratën e përbashkët me Jeltcinin të 16 qershorit, midis të tjerash, heqjen dorë nga aksionet represive kundër popullsisë civile, angazhimin për kthimin e refugjatëve dhe garantimin e pranisë së plotë të Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës dhe të UNHCR-së. Rezoluta i bënte thirrje gjithashtu qeverisë së RFJ-së, lidershipit të shqiptarëve të Kosovës dhe gjithë të tjerëve për të bashkëpunuar me prokurorin e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës, dhe nënvizonte nevojën që autoritetet e RFJ-së të çonin në bangon e drejtësisë anëtarë të forcave të sigurimit të përfshirë në keqtrajtimin e civilëve dhe në shkatërrimin e qëllimshëm të pronave. Rezoluta deklaronte që Këshilli i Sigurimit do të merrte në konsideratë "aksione të mëtejshme dhe masa të tjera", nëse masat e kërkuara në dy rezolutat e saj nuk do të përfilleshin. Kufijtë porozë, një treg armësh i mirëorganizuar në Ballkan dhe masat e dobëta shtrënguese e bënë embargon të mbetet pa ndonjë efekt kushedi se çfarë.

Më 24 shtator, NATO ndërmori hapat e parë formalë drejt ndërhyrjes ushtarake në Kosovë, duke bërë publik një "akt paralajmërimi" me, së pari një opcion ajror të kufizuar, e së dyti, një fushatë ajrore të përshkallëzuar në Kosovë.[69]

Dislokimi i Misionit të Verifikimit në Kosovë

Masakra e 26 shtatorit në Abrinë e Epërme, në të cilën u vranë njëzet e një pjesëtarë të së njëjtës familje shqiptare mbolli interesimin e mediave kryesore të perëndimit dhe shërbeu si katalizator i një përgjigjeje ndërkombëtare më të unifikuar ndaj krizës. Me dimrin në prag, shqetësimi ndërkombëtar u fokusua gjithashtu tek 250 mijë shqiptarë etnikë të shpërngulur brenda Kosovës.

I dërguari i Shteteve të Bashkuara Richard Holbrooke fluturoi në Beograd për bisedime me Milosheviçin. Në të njëjtën kohë, pas vrasjeve në Abrinë e Epërme, policia serbe dhe ushtria jugosllave i dhanë fund

ofensivës së verës në fundin e shtatorit dhe filluan tërheqjen e pjesshme nga Kosova. Një gazetar serb shkruante, se me masakrën në Abrinë e Epërme, forcat qeveritare "mbyllën edhe derën, nga e cila duhej të dilnin".[70]

Pasi i dha fund ofensivës, Milosheviçi kish arritur shumë prej qëllimeve të tij, e për këtë bëri një farë tërheqje përpara Holbrooke-ut: pushimin e zjarrit, survejimin ajror të NATO-s për të verifikuar respektimin e rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe dislokimin e një misioni vëzhguesish të Organizatës së Sigurimit e Bashkëpunimit Europian (OSBE) i quajtur Misioni Verifikimit në Kosovë (MVK). Në janar 1999, MVK-ja kishte 2, 000 vëzhgues në terren, shumë prej të cilëve ishin perëndimorë me eksperiencë ushtarake. Zyrtarët e të drejtave të njeriut ishin gjithashtu të dislokuar në të gjithë krahinën për të monitoruar, dokumentuar dhe raportuar publikisht mbi dhunimet.[71] Një marrëveshje e mëvonshme e nxitur nga NATO i vendoste limite ushtrisë jugosllave dhe trupave të ministrisë së Punëve të Brendshme të lejuara në Kosovë. Disa orë përpara afatit të vendosur, qeveria jugosllave i përmbushi kërkesat.

Periudha nga fundi i tetorit 1998 deri në mars 1999 ishte e mbushur me provokime të vazhdueshme nga forcat qeveritare e nga UÇK-ja.

Rreth kësaj kohe, zhvillime të tjera në Serbi patën një impakt në Kosovë. Më 3 nëntor, Milosheviçi shkarkoi shefin e shtabit të përgjithshëm të ushtrisë jugosllave, Momcillo Perisiç, dhe e zëvendësoi atë me një luajalist të njohur, gjeneralin Dragoljub Ojdaniç. Kol. gjen. Nebojsha Pavkoviç, komandant i korpusit të Prishtinës u emërua komandant i armatës së tretë, e cila ishte përgjegjëse për Serbinë e Jugut dhe Kosovën. Nga fundi i tetorit, Milosheviçi shkarkoi edhe komandantin e forcave ajrore jugosllave, kol. gjen. Ljubisha Veliskoviç, dhe shefin e shërbimit të sigurimit të Serbisë, Jovica Stanisiç, i cili kish qënë një nga më të besuarit e Milosheviçit gjatë shtatë viteve të fundit.[72] Veliskoviçi u zëvendësua nga lejtënant kolonel Spasoje Smiljaniç. Stanisiç u zëvendësua nga Radomir Markoviç.

Arsyet e sakta të këtyre shkarkimeve mbeten të paqarta. Shumë analistë spekullojnë dhe thonë se individët e hequr nuk ranë dakord me politikat qeveritare në Kosovë, duke patur frikë se Milosheviçi po shkonte drejt një konflikti të drejtëpërdrejtë me perëndimin. Në veçanti, besohej se Perisiç kish paralajmëruar Milosheviçin kundër një konfrontimi të drejtëpërdrejtë me NATO-n (ashtu siç kishin nxjerrë argumenta kundër lidhur me

dislokimin ushtarak kundër demonstruesve në Beograd nga fundi i '96-ës dhe fillimi i '97-ës).[73] Zëvendësuesit u panë përgjithësisht si besnikë personalë të Molosheviçit, e rrjedhimisht si ndjekës të vijës së ashpër, d.m.th. si të nevojshëm për një ofensivë tjetër kundër UÇK-së.

Pavarësisht nga prania e MVK-së në Kosovë, periudha nga fundi i tetorit 1998 deri në mars 1999 ishte e mbushur me provokime të vazhdueshme nga forcat qeveritare e nga UÇK-ja. UÇK-ja kapi gjatë kësaj kohe dy gazetarë serbë dhe nëntë ushtarë të ushtrisë jugosllave (që të gjithë më vonë të lëshuar) dhe organizoi goditje periodike mbi postat ushtarake e policore, gjë që përbënte një përpjekje të dukshme për të provokuar qeverinë për një përgjigje në sytë e monitoruesve ndërkombëtarë. Siç e kanë pranuar më vonë komandantët e UÇK-së, ata përdornin qetësinë që krijonte prania e monitoruesve për të vazhduar mobilizimin, stërvitjen dhe sigurimin e armatimit. [74]

Forcat serbe e jugosllave gjithashtu u ripozicionuan gjatë kësaj kohe. Në mënyrë graduale gjatë janarit e shkurtit, ripërforcimet dhe armatimi i rëndë u futën prapë në Kosovë, gjë që e jep të detajuar një raport i OSBE-së për Kosovën me titull, *Siç është parë, siç është rrëfyer - pjesa I*.[75]

Më 13 dhjetor, ushtria vrau më shumë se tridhjetë shqiptarë etnikë

Gradime të figurave të rëndësishme nga fundi i vitit 1998 në strukturën e sigurimit serb e jugosllav

- Radomir Markoviç zëvendësoi Jovica Stanisiçin në detyrën e shefit të Shërbimit të Sigurimit të Shtetit Serb (policia sekrete)
- Dragoljub Ojdaniç zëvendësoi Momçillo Perisiçin në detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave
- Nebojsha Pavkoviç u gradua nga komandant i Korpusit të Prishtinës në komandant të Armatës së Tretë (mbulonte edhe Kosovën)
- Vladimir Llazareviç u emërua komandant i Korpusit të Prishtinës
- Ljubisha Stojimiroviç u emërua shef i Shtabit të Armatës së Tretë

gjatë kufirit me Shqipërinë, me pretekstin që ata po bënin kontrabandë armësh. Më 14 dhjetor, persona të armatosur të paidentifikuar sulmuan "Panda Café"-në në qytetin perëndimor të Pejës, duke vrarë gjashtë të rinj serbë. Më 23 dhjetor, ushtria e policia ndërmorën veprime ushtarake kundër UÇK-së pranë Podujevës, në Kosovën perëndimore, gjatë rrugës kryesore që lidh Prishtinën me Beogradin.

Më 25 shkurt, ushtria jugosllave lajmëroi fillimin e "stërvitjes së dimrit" në komunën e Vuçiternës, ku UÇK-ja kishte pozicione në mallet e Cicavicës gjatë rrugës Mitrovicë-Prishtinë (me baza në fshatin Pantinë). Luftimet, ashtu si dhe rrëmbimet e serbëve lokalë nga ana e UÇK-së, vazhduan gjatë shkurtit. Sipas një raporti të OSBE-së në Kosovë:

> Ndërsa konfrontimet e armatosura midis forcave serbe/jugosllave dhe UÇK-së vazhdonin në zonat e "stërvitjeve", u bë e qartë që këto "stërvitje" kishin një synim strategjik: për ushtrinë jugosllave (VJ) të siguronte rrugën kryesore dhe trasetë hekurudhore midis Mitrovicës e Prishtinës, duke e shtyrë UÇK-në të tërhiqej në kështjellat e saj në malet e Cicavicës.[76]

Në disa raste, "stërvitja" nënkuptonte bombardimin e fshatrave dhe dëbimin me forcë prej tyre të jo luftëtarëve. Luftimet midis ushtrisë dhe UÇK-së vazhduan ndërsa OSBE-ja iku nga zona e Vuçiternës më 19 mars. Sipas gjeneralit të Shteteve të Bashkuara Wesley Clark, NATO mendonte se Milosheviçi "po përgatitej për një ofensivë pranvere, që mund të synonte kështjellat e UÇK-së". Askush nuk e priste "deportimin e përgjithshëm të popullsisë etnike shqiptare". [77]

Gjatë përqëndrimeve ushtarake të të gjitha palëve, qeveria e Shteteve të Bashkuara ishte e angazhuar në diplomacinë e ecejakeve me synimin për të arritur një zgjidhje politike. Ambasadori amerikan në Maqedoni Chris Hill, duke punuar ngushtë me Richard Holbrooke-un, vazhdonin të merreshin me projektin e planit mbi autonominë substanciale të Kosovës brenda Jugosllavisë. Projekte të mëparshme u dogjën, pasi ato u përhapën e publikuan në gazetën kosovare *Koha Ditore*.

Një pikë e rëndësishme kthese erdhi më 15 janar 1999, kur pesëdhjetë e pesë shqiptarë etnikë u vranë në fshatin Raçak. Megjithëse sulmi ishte sipas disa gjasave i provokuar nga një pusi e UÇK-së tri ditë më parë, gjatë së cilës u vranë tre policë serbë, forcat qeveritare u përgjigjën duke

qëlluar mbi civilë, duke torturuar të arrestuar dhe duke kryer ekzekutime në masë.[78]

Masakra në Raçak ishte e mirëdokumentuar nga misioni i OSBE-së, dhe aty për aty e dënuar nga kreu e këtij misioni, diplomati amerikan William Walker. Qeveria jugosllave tha se viktimat ishin luftëtarë të UÇK-së të vrarë në luftime, dhe kërcënuan se do ta largonin Walker-in – i etiketuar "një përfaqësues dhe patron i separatizmit dhe i terrorizmit" – nga vendi.[79] Më 18 janar, kryeprokurores Louise Arbour të Gjykatës për Krimet e Luftës iu mohua hyrja në Kosovë, ndërsa ajo kish planifikuar të hetonte incidentin e Raçakut.

Masakra e Raçakut provokoi një indinjatë të madhe në publikun perëndimor dhe qeveritë perëndimore filluan të konsultoheshin mbi rrugët e mbështetjes së diplomacisë me forcën. NATO rriti kërcënimet e saj për veprime luftarake, nëse sulmet mbi civilë nuk do të reshtnin.

Konferenca e Rambujesë

Shqiptarët dhe serbët e Kosovës u thirrën me ngut në një *chateau* qeveritar në Rambuje të Francës, për të zhvilluar bisedime midis 6 e 22 shkurtit 1999. Ministrat e jashtëm britanik e francez bashkësponsorizuan bisedimet, me negociatorë nga Shtetet e Bashkuara, Austria (si kryetare e radhës e BE-së), dhe Rusia. Një delegacion i larmishëm i shqiptarëve të Kosovës, që përfaqësonte forca të ndryshme politike, zgjodhi Hashim Thaçin, lider politik i UÇK-së, si zëdhënësin e vet. Milosheviçi refuzoi të merrte pjesë dhe dërgoi presidentin serb Milan Milutinoviç të kryesonte një delegacion heterogjen të përfaqësuesve të etnive të ndryshme të Kosovës, por të parëndësishëm – një përpjekje kjo për të demonstruar qasjen multi-etnike dhe tolerante të provincës.

Pas dy javësh, negociatorët u prezantuan të dy palëve një marrëveshje interim, e cila parashikonte një autonomi substanciale dhe vetqeverisje për Kosovën si pjesë të Jugosllavisë, gjë që do të mbrohej nga një prani e fuqishme e NATO-s në terren. Statusi i final i Kosovës do të përcaktohej pas tre viteve nga një konferencë ndërkombëtare.

Delegacioni serb refuzoi të nënshkruante, duke deklaruar që Kosova ishte një pjesë integrale e Jugosllavisë. Disa pjesë të marrëveshjes, siç ishte prezenca e fortë e NATO-s në të gjithë territorin e Jugosllavisë dhe

autoriteti i NATO-s për të paraburgosur individë, përbënin një shqetësim të veçantë për delegacionin. [80] Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës, ndërsa ishte më i prirur ta mbështeste këtë marrëveshje, tha se ishte i nevojshëm miratimi i komandantëve rajonalë të UÇK-së, e cila ishte në të vërtetë një oganizatë me natyrë të decentralizuar. Konferenca u pezullua, ndërsa Thaçi u kthye në Kosovë për të marrë "po"-në e komandantëve për marrëveshjen. Konferenca u rimblodh në Paris më 15 mars. Tri ditë më vonë, nën një presion të madh nga perëndimi, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës bëri nënshkrimin e marrëveshjes.

Gjatë gjithë konferencës, forcat serbe e jugosllave u panë të pozicononin vetveten rreth kufirit të Kosovës me vetë Serbinë, një tregues i qartë ky – i çiftëzuar me intransigjencën e delegacionit serb – se po përgatitej një ofensivë ushtarake. Sipas OSBE-së, po bëhej "një organizim domethënës i forcave të ushtrisë jugosllave (UJ)" në të gjithë Kosovën.[81] Shumë vëzhgues besojnë se Milosheviçi as që e ka patur ndonjëherë në mendje të nënshkruante një marrëveshje; ai thjesht shfrytëzonte kohën për të përforcuar më tej trupat e tij, dhe në fakt ai fitoi tri javë, për shkak të nevojës së Thaçit për t'u konsultuar me komandantët brenda në Kosovë.

Raportimet e mediave ngritën më vonë pretendimin, sipas të cilit qeveria austriake kish paralajmëruar NATO-n përpara fillimit të bombardimeve se po përgatitej një ofensivë në shkallë të gjerë. Pretendimi u përsërit nga qeveria gjermane, e cila tha se operacioni ushtarak me titull "Patkoi" – një plan për të dëbuar shqiptarët nga Kosova – ishte projektuar gjashtë muaj përpara fillimit të luftës ajrore. [82] Sidoqoftë, një brigadier gjeneral në pension i ushtrisë gjermane deklaroi më vonë, se pretendimet për planin ishin të falsifikuara nga një raport i paqartë i shërbimeve sekrete me qëllim që të shmangej kriticizmi që rritej në Gjermani ndaj bombardimit.[83]

Misioni MVK i OSBE-së u tërhoq nga Kosova më 20 mars, pak përpara se të fillonte bombardimi dhe të përkeqësohej situata. Megjithëse vëzhguesit kishin frikë se do të mbaheshin si pengje, qeveria e mirëpriti, dhe nuk e pengoi tërheqjen e tyre. Atë ditë, sulmet kundër shqiptarëve të Kosovës filluan në disa pjesë të Kosovës, kryesisht në zonën e Drenicës e të Llapit afër Podujevës. Ushtarët jugosllavë, policia speciale serbe, paraushtarakët dhe forca të çrregullta të armatosura u derdhën në krahinë. Pa asnjë informacion lokal, civilët shqiptarë prisnin t'u ndodhte më e keqja.

Në një përpjekje finale për të shmangur bombardimin, i dërguari special i Shteteve të Bashkuara Richard Holbrooke shkoi në Beograd për të

takuar Milosheviçin dhe kërcënoi me goditje ajrore, nëse ai nuk nënshkruante marrëveshjen. Ai e la Beogradin duarbosh më 23 mars, dhe të nesërmen, goditjet ajrore të NATO-s filluan pa pritur miratimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

KONKLUZIONE

Kosova ishte kryefjala e mediave në 1999, por konflikti ishte i parashikueshëm qysh më 1989. Komuniteti ndërkombëtar nuk arriti të vinte në jetë masa preventive efektive, duke vepruar vetëm pasi kriza shkoi drejt një konflikti të armatosur.

Edhe pasi konflikti i hapur filloi, komuniteti ndërkombëtar dështoi, ndërsa nuk ndërmori hapa për të frenuar abuzimet serioze të kryera kundër civilëve në Kosovë. Gjatë gjithë vitit 1998, komuniteti ndërkombëtar dështoi në mënyrë të përsëritur në përpjekjet për të arritur një pozicion të unifikuar në zgjidhjen e konfliktit. Sllobodan Milosheviçi e shfrytëzoi këtë mungesë konsensusi në favorin e vet në një seri negociatash dypalëshe, duke blerë kështu kohë për të shkuar përpara me fushatën në Kosovë. Anëtarë të komunitetit ndërkombëtar nxorrën gjithashtu përfitime nga kjo përçarje: tregonin me gisht njëri-tjetrin si alibí për inaktivitetin. Kur komuniteti ndërkombëtar dërgoi një mesazh të fortë, me anën e të cilit dënonte palët në konflikt, fjalët dhe veprimet simbolike rezultuan të pakuptimta, me afatet të shtyra, me kushtet të papërmbushura, dhe me sanksionet të paaplikuara apo të tërhequra, ndërsa dhuna abuzive vazhdonte.

Përveç shqetësimit mbi stabilitetin e Bosnjës dhe mbështetjes për marrëveshjet e Dayton-it, qasja e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë u ndikua fuqimisht nga dëshira për të shmangur pavarësinë e krahinës. Rivizatimi i kufijve të Jugosllavisë, ishte (është akoma) problematik, mund të destabilizonte Malin e Zi, Bosnjën e Maqedoninë, ashtu si dhe mund të inkurajonte lëvizjet separatiste në pjesë të tjera të Europës dhe të botës.

Ky nuk është një shqetësim banal. Por interesi i komunitetit ndërkombëtar në ruajtjen e kufijve ndërkombëtarë nuk duhej të ngrihej mbi imperativin e frenimit të abuzimeve, përpara se këto të fundit të çonin në një luftë të hapur, duke sjellë mijra të vdekur dhe shumë të shpërngulur. Nëse komuniteti ndërkombëtar donte të stimulonte

integritetin territorial në Ballkan, ai duhej të kish ushtruar presion për unitetin kombëtar, që vjen nga respekti për të drejtat e të gjithë qytetarëve – një respekt që nuk vihej re në Kosovë e në pjesë të tjera të rajonit. Por duke kërkuar ruajtjen e kufijve nëpërmjet tolerimit të abuzimeve serioze u prodhua destabiliteti rajonal, të cilin komuniteti ndërkombëtar po kërkonte ta shmangte.

3

FORCAT NË KONFLIKT

Forcat e sigurimit të qeverisë serbe dhe asaj jugosllave janë një kombinim kompleks i institucioneve republikane e federale, së bashku me grupe klandestine të trupave të parregullta e të paraushtarakëve. Policia e ushtrisë jugosllave dhe forcat speciale të ushtrisë, njësitë antiterroriste të policisë serbe dhe policët specialë, forcat speciale të policisë sekrete, grupet paraushtarake, mercenarët ndërkombëtarë dhe serbët lokalë të armatosur kanë qënë të gjithë aktivë në Kosovë gjatë vitit 1998 e 1999, në operacionet e koordinuara nga Beogradi.

Forcat e ndryshme angazhoheshin shpesh në operacione të përbashkëta e në koordinim të ngushtë, dhe në ato kohë këmbenin uniformat me njëra-tjetrën. Shenjat e gradave nuk i mbanin gjithmonë në vende të dukshme, dhe shenjat personale ose numrat e identifikimit shumë rrallë ekspozoheshin. Shumë prej forcave qeveritare erdhën nga jashtë Kosovës. Kështu shqiptarët e Kosovës nuk e kishin të lehtë të identifikonin, qoftë individët, qoftë llojin e forcës që ata përfaqësonin, dhe këtu duhen shtuar edhe vështirësitë e vëzhgimit në një mjedis të dhunshëm e traumatizues.

Kishte përjashtime, sidomos në zonat ku shqiptarët e serbët jetonin pranë njeri-tjetrit, si për shembull në Pejë, Rrahovec, Lipjan apo në rrethinat e tyre. Për shkak të procedurave, pajimeve e uniformave të standartizuara, forcat e ushtrisë jugosllave ishin më të identifikueshme. Por ushtarët vinin zakonisht nga jashtë Kosovës, e për këtë shkak ishin të panjohur për popullsinë lokale.

Ushtria jugosllave, policia serbe dhe paraushtarakët ishin të gjithë përgjegjës për krimet e luftës në Kosovë. Sidoqoftë, në përgjithësi paraushtarakët u përfshinë më gjerë në abuzime të dhunshme, sidomos

*Shef i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë jugosllave gjatë luftës në Kosovë, gjeneral Dragoljub Ojdaniç (majtas), presidenti i Jugosllavisë Sllobodan Milloshevi*ç *(qendër), dhe komandanti i Armatës së Tretë gjeneral-kolonel Nebojsha Pavkoviç gjatë një ceremonie në Beograd, më 17 mars 2000. Pas luftës Milloshevi*çi *e emëroi Ojdaniçin ministër të mbrojtjes të Jugosllavisë ndërsa Pavkoviçin shef të shtabit të përgjithshëm. Milloshevi*çi *dhe Ojdaniçi janë dy nga të akuzuarit nga Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.*

FOTO AFP

në ekzekutime dhe përdhunime. Ndërsa njësitë policore e ushtarake nuk përjashtohen absolutisht nga përgjegjësia në këtë drejtim, paraushtarakët ishin rëndom më të angazhuar në vrasje arbitrare e dhunë seksuale.

Por forcat paraushtarake nuk kanë vepruar në kokë të vet. Përkundrazi, njësitë paraushtarake kanë vepruar në bashkëpunim të ngushtë me policinë, ushtrinë dhe policinë sekrete (i njohur si shërbimi i sigurimit të shtetit). Mund të ketë patur incidente specifike, ku njësitë apo individë paraushtarakë kanë dalë jashtë kontrollit, por dislokimi i përgjithshëm i njësive paraushtarake dhe koordinimi i tyre me sektorë të tjerë të aparatit të sigurimit ishin të planifikuara si komponentë të fushatës në Kosovë.

Njësitë paraushtarake kanë vepruar në bashkëpunim të ngushtë me policinë, ushtrinë dhe policinë sekrete.

Në përgjithësi, u duk që ushtria jugosllave ishte në komandë gjatë luftës, me policinë dhe paraushtarakët nën urdhërat e saj, megjithëse zyrtarë të rëndësishëm të Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme ushtruan ndikim të madh në fushatë. Ushtria kontrollonte rrugët dhe kufijtë kryesorë, duke koordinuar dhe lehtësuar "spastrimin etnik'. Policia e paraushtarakët ishin të përfshirë në mënyrë më të drejtëpërdrejtë në dëbimet e shkatërrimet e fshatrave, me mbështetjen e artilerisë nga ana e ushtrisë. Pikërisht gjatë këtyre operacioneve, burrat ndaheshin nga gratë e fëmijët, merreshin në pyetje lidhur me UÇK-në, dhe ndonjëherë ekzekutoheshin.

Sipas dëshmive të marra në të gjithë Kosovën, ishin ushtria e forcat e policisë speciale që rrethonin fshatrat dhe i bombardonin ato nga largësia. Pas kësaj, trupa të rregullta dhe forcat e policisë speciale futeshin në fshat, shkatërronin çfarë kish mbetur pa u shkatërruar dhe mblidhnin fshatarët në një vend të përbashkët. Burrat ndaheshin nga gratë e fëmijët për t'u marrë në pyetje lidhur me UÇK-në. Më anë tjetër, trupa të rregullta policore e paraushtarakë plaçkisnin fshatin, vidhnin ç'të mundnin nga duart e fshatarëve dhe digjnin dokumentat e tyre të identifikimit. Fshati binte pastaj në dorë të policisë, paraushtarakëve e milicisë lokale serbe, të cilët plaçkisnin e digjnin çfarë kish mbetur. Gratë, fëmijët dhe të moshuarit shpesh dëboheshin, ndërsa burrat që dyshoheshin për lidhje me UÇK-në ekzekutoheshin.

Nuk mungojnë shembujt, kur oficerë të policisë e ushtarë u bënin një trajtim njerëzor civilëve, madje, edhe i merrnin në mbrojtje. Në disa raste të dokumentuara nga Human Rights Watch, shqiptarët e Kosovës kanë

dëshmuar se si policë e ushtarë u kanë dhënë atyre ushqim e asistencë mjekësore, ose i kanë paralajmëruar ata të fshihen nga paraushtarakët që po afroheshin. Në një rast, oficerët e ushtrisë u përpoqën të hetonin deponimet e grave mbi abuzime seksuale [3]. Në një rast tjetër, një dëshmitar i masakrës së 30 prillit në Vërbofc (shih rajonin e Drenicës) tha se ai kish dëgjuar ushtarë të UJ-së, ndërsa u luteshin paraushtarakëve të mos qëllonin mbi civilë. [4] Por këta shembuj janë përjashtime. Më shumë se shpesh, policia e ushtria, jo vetëm toleruan dhe justifikuan sjelljen e paraushtarakëve, por u angazhuan edhe vetë në kryerjen e akteve kriminale. [5]

Strukturat e Sigurimit serb e jugosllav, sidomos sigurimi shtetëror serb, ishte fuqimisht i lidhur me aktivitetin kriminal në Kosovë dhe në pjesën tjetër të vendit, si p.sh. tregëtia ilegale e cigareve, armëve, drogës. "Vullnetarët" e luftës në Kosovë ndonjëherë rekrutoheshin drejtëpërdrejtë nga burgjet serbe. Fondet për policinë dhe ushtrinë vinin gjithashtu nga burime joortodokse brenda Serbisë, siç ishte Agjencia e Doganave Federale e drejtuar për një kohë të gjatë nga aleati i Milosheviçit, Mihalj Kertes, i cili u arrestua nën akuzën e shpërdorimit të fondeve publike në dhjetor të vitit 2000.

Seksionet që vijojnë përshkruajnë në mënyrë më të detajuar forcat e ndryshme që operuan në Kosovë, përfshirë ata oficerë përgjegjës, të cilët njihen tashmë. I gjithë informacioni është marrë nga burime të hapura, të cilat janë cituar. Dy burime zyrtare janë përdorur më shpesh: revista "Vojska", publikim zyrtar i Ushtrisë Jugosllave, dhe revista "Policajac", publikim zyrtar i Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme.

Përveç palëve në konflikt, ky seksion identifikon liderët politikë e ushtarakë në Serbi e Jugosllavi, të cilët patën nivelin më të lartë të përgjegjësisë mbi krimet e luftës të kryera në Kosovë (disa syresh nuk janë më në pozitat e tyre). Këta njerëz, jo vetëm udhëhoqën fushatën kundër shqiptarëve etnikë, por edhe me vetëdijë të plotë nuk bënë asgjë për të frenuar atë që po ndodhte. Janë gjithsesi përgjegjës për veprimet e mosveprimet e tyre.

FORCAT E REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË

Dy forcat kryesore ushtarake në Jugosllavi në vitin 1998 e 1999 ishin Ushtria Jugosllave (Vojska Jugosllavija, ose VJ) dhe Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë (Ministarstvo Unutrasnjih Posllova

ose MUP). Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Malit të Zi i mbeti besnike qeverisë malazeze dhe nuk është aktive në Kosovë.

Qysh nga koha kur u bë President i Serbisë më 1989, Sllobodan Milosheviç në mënyrë graduale e forcoi dhe e shtriu MUP-in mbi VJ-në dhe mbi policinë federale jugosllave. Të dyja këto të fundit ai i shihte si forcat më pak besnike. Mospajtimet midis MUP-it dhe VJ-së dolën në dritë lidhur me rezurset dhe prestigjin, të cilat i shkuan MUP-it. Një incident i madh lidhur me Kosovën ndodhi nga fundi i shkurtit e fillimi i marsit pas sulmeve të para të policisë në Drenicë, gjatë të cilave u vranë më shumë se tetëdhjetë vetë, përfshirë njëzet e katër gra e fëmijë (shih Kontekstin Historik). Një zyrtar i lartë i ushtrisë jugosllave që s'dëshironte të identifikohej, i cituar nga shtypi serb, kritikoi policinë për "mënyrën e saj tërësisht amatoreske", duke thënë që operacioni kish marrë "përmasat e masakrës", sepse policia "ju dorëzua emocioneve". [7]

Vetëm trupat e rregullta të policisë serbe, policia speciale, dhe ndoshta forcat speciale të sigurimit të shtetit ishin aktive në Kosovë në gjysmën e parë të vitit 1998. Ushtria, ndonëse ishte e pranishme në krahinë, ishte e kufizuar në detyrën e ruajtjes së sigurisë përgjatë kufirit me Maqedoninë e Shqipërinë. Kjo gjë ndryshoi në prill të vitit 1998, kur ushtria mori pjesë në veprime ushtarake në Kosovën jugperëndimore përgjatë kufirit me Shqipërinë. Ushtria e policia bashkëvepruan qysh nga ai moment, por në pjesën më të madhe të kohës, veprimet kundër UÇK-së gjatë vitti 1998 mbetën përgjegjësi e Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme.

Roli primar i MUP-it zuri të ndryshojë nga fundi i vitit 1998 dhe fillimi i vitit 1999, kur presidenti Milosheviç ndryshoi disa zyrtarë të rëndësishëm të policisë e ushtrisë, duke vënë në vend të tyre njerëz të tij besnikë. Midis ndryshimeve të tjera, Dragoljub Ojdaniç zëvendësoi Momcilo Perisiç [8] në detyrën e shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë jugosllave dhe Nebojsha Pavkoviç u gradua komandant i armatës së tretë të VJ-së, e cila ishte përgjegjëse për Serbinë e Jugut dhe Kosovën. Radomir Markoviç zëvendësoi Jovica Stanisiç në detyrën e shefit të shërbimeve të sigurimit serb (për më shumë hollësi, shih Kontekstin Historik). Nga fundi i marsit 1999, kur iu desh të përballonin sulmet e NATO-s, policia, ushtria, paraushtarakët dhe njësi trupash të parregullta koordinuan sulmet e tyre mbi UÇK-në dhe në mbrojtje nga goditjet ajrore. [9]

Duhet gjithashtu të vihet në dukje që sigurimi shtetëror serb luajti një rol shumë të madh në Kosovë gjatë gjithë viteve '90, duke monitoruar

qarqet politike të shqiptarëve të Kosovës, sidomos UÇK-në. Sigurimi shtetëror kishte gjithashtu njësi të operacioneve speciale të quajtura JSO (Jedinice za Specijalne Operacije – Njësi të Operacioneve Speciale), të cilat ishin aktive në Kosovë gjatë viteve 1998 e 1999.

Ushtria Jugosllave (Vojska Jugoslavije)

Sipas raportit të OSBE-së *Kosovo/Kosova: Siç është parë, siç është rrëfyer – pjesa I*, VJ-ja kish një personel total nga 85,000 deri në 114,000 vetë, me një forcë rezervë e cila arrinte deri në 200,000 vetë. Në Kosovë, gjendeshin përafërsisht rreth 15,000 trupa në fillim të vitit 1999, të cilët u bënë deri 20,000 nga fundi i prillit. Këtu nuk përfshihen 30,000 policët, paraushtarakët e trupat e parregullta, të cilat gjendeshin në krahinë.[10]

Emblema e Ushtrisë Jugosllave

Sipas kushtetutës jugosllave, VJ-ja është nën komandën e presidentit jugosllav qoftë në kohë lufte, qoftë në kohë paqeje. Presidenti është gjithashtu i veshur me fuqinë ligjore për të emëruar, graduar dhe shkarkuar zyrtarë e oficerë.[11]

Organi kontrollues i ushtrisë është Këshilli i Lartë i Mbrojtjes (KLB), kreu i të cilit është presidenti jugosllav. Anëtarët e tjerë të KLB-së janë presidentët e Serbisë e Malit të Zi. Sekretari i Këshillit ishte Sllavoljub Susiç. [12] Sipas medias serbe, KLB-ja rrallë është mbledhur, nëse është mbledhur ndonjëherë, për t'u konsultuar mbi Kosovën. Arësyeja është se sipas të gjitha gjasave Presidenti malazez Milo Gjukanoviç nuk do të kish rënë dakord me planet e Milosheviçit.[13]

VJ-ja është nën komandën e presidentit jugosllav qoftë në kohë lufte, qoftë në kohë paqeje.

Megjithëse Presidenti jugosllav ka të drejtën të komandojë VJ-në vetëm duke ndjekur vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, në të vërtetë Milosheviçi mori personalisht komandën e ushtrisë, ashtu siç bëri edhe me strukturat e qeverisë jugosllave. Në ato kohë, VJ-ja ndërmorri aksionet pa aprovimin e KLB-së, duke provokuar kritika atë forta nga ana e Presidentit malazez

Gjukanoviç. Në mars 1999, për shembull, kur VJ-ja rriti praninë e vet në Kosovë, Gjukanoviçi denoncoi aksionin dhe shpalli: "Çdo vendim i marrë nga Këshilli i Mbrojtjes (i Lartë) pa mua do të jetë jo ligjor". [14]

Organi kryesor i VJ-së është Shtabi i Përgjithshëm, i drejtuar gjatë luftës së vitit 1999 nga gjeneral Dragoljub Ojdaniç, i cili ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të VJ-së. [15] Zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm ishte gjeneral Svetozar M. Marjanoviç. [16]

VJ-ja është e ndarë në tri armata, ashtu si edhe në Flotë Ushtarake Detare, Forca të Mbrojtjes Ajrore dhe Shërbim i Kundërzbulimit (i njohur si KOS – Kontraobavestajna Sluzba). [17] Armata e parë mbulon Serbinë veriore, Armata e dytë mbulon Serbinë qëndrore dhe Malin e Zi, dhe armata e tretë mbulon Serbinë e Jugut dhe Kosovën. [18] Përveç kësaj, VJ-ja ka një korpus forcash speciale, i njohur si beretat e kuqe, tëcilat janë të trajnuara në mënyrë speciale për aksione antiterroriste. [19]

Armata e tretë, me vendqëndrim të shtabit në Nish, ishte e përbërë gjithashtu nga Grupi Taktik Timok, nga Korpusi i Nishit, Korpusi i Leskovacit dhe Korpusi i Prishtinës (të njohura si 52 korpuset). [20] Korpusi i Prishtinës, i cili mbulon Kosovën, përmban:

- Brigadën e 15-të të koracuar (Prishtinë), të komanduar nga Kolonel Mladen Cirkoviç. [22]
- Brigadën e 125-të të motorizuar (Kosovë Mitrovicë e Pejë), të komanduar nga kolonel Dragan Zivanoviç. [23]
- Brigadën e 549-të të motorizuar (Prizren e Gjakovë), të komanduar nga Kolonel Bozhidar Deliç. [24]
- Brigadën e 243-të të mekanizuar (Ferizaj e Gjilan), të komanduar nga kolonel Krsman Jeliç. [25]
- Brigadën e 52-të të artilerisë së kombinuar (Gjilan), të komanduar nga kolonel Radojko Stefanoviç. [26]
- Njësinë e 52-të të policisë ushtarake (Prishtinë) të komanduar nga major Zeljko Pekoviç. [27]
- Regjimentin e 83-të të aviacionit. [28]
- Regjimentin e 52-të të inxhinierëve (Krusec)
- Regjimentin e 311-të të mbrojtjes ajrore (Gjakovë)
- Batalionin e 53-të të rojeve të kufirit (Gjakovë)
- Batalionin e 55-të të rojeve të kufirit (Prizren)
- Batalionin e 57-të të rojeve të kufirit (Ferizaj)

Ushtria Jugosllave (VJ) - Struktura bazë e organizimit në Kosovë, mars-qershor 1999

Këshilli i lartë i Mbrojtjes
Presidenti i Jugosllavisë Sllobodan Millosheviç, kreu
Presidenti i Serbisë Milan Milutinoviç
Presidenti i Malit të Zi Milo Gjukanoviç

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave
Gjen. Dragoljub Ojdaniç, shef i Shtabit të Përgj.

Armata e Parë
(Serbia e veriut)
Gjeneral-kolonel Srboljub

Armata e Dytë
(Serbia qendrore & Mali i Zi)
Gjeneral-kolonel Radosav Martinoviç
pastaj Milorad Obradoviç

Armata e Tretë
(Serbia e jugut & Kosova)
Gjeneral-kolonel Nebojsha Pavkoviç

Bordi i shërbimit sekret
Gjeneral-kolonel Geza Farkas

Forcat speciale
(Beretat e Kuqe)
Gjeneral-major Ljubisha Stojimiroviç
(komandant në 1998)

Korpusi i Nishit
Negosav Nikoliç

Korpusi i Prishtinës
(korpusi i 52-të)
Gjeneral-major Vladimir Lazareviç

Korpusi i Leskovaçit

Brigada gardiste

Brigada e 63-të e parashutistëve
kolonel Ilija Todorov

Brigada e 15-të e korracuar
(Prishtinë)
Kolonel Mladen Cirkoviç

Brigada e 125-së e motorizuar
(Mitrovicë dhe Pejë)
Kolonel Dragan Zhivanoviç

Brigada e 72-të specjale
nën-kolonel Branisllav Lukiç

Brigada 549 e motorizuar
(Prizren dhe Gjakovë)
Kolonel Bozidar Deliç

Brigada e 243-të e mekanizuar
(Uroshevaç dhe Gjilan)
Kolonel Krsman Jeliç

Brigada 52 e përzier e artilerisë
(Gjilan)
Kolonel Radojko Stefanoviç

Njësia e 52-të ushtarake e policisë
(Prishtinë)
Major Zheljko Pekoviç

Brigada e korracuar

Njësitë anti-terroriste të policisë ushtarake

Kobrat (Kobre)

Skifterët (Sokolovi)

Gjatë luftës, armata e tretë u komandua nga kolonel gjeneral Nebojsha Pavkoviç, i cili u gradua në këtë pozicion në nëntor 1998 – në të njëjtën kohë Ojdaniç u bë shef i shtabit të përgjithshëm të UJ-së. [29] Deri atëherë, Pavkoviç kishte komanduar korpusin e e Prishtinës të armatës së tretë. Përpara Pavkoviçit, komandant i armatës së tretë ka qënë kolonel gjeneral Dushan Samarxhiç, ndërsa kolonel Mirko Starceviç ishte zëvendësi i tij.[30]

Korpusi i Prishtinës u komandua gjatë luftës nga major gjeneral Vladimir Lazareviç, i cili u emërua në këtë post në fund të vitit 1998 nga presidenti Milosheviç. [31] Në armatën e tretë gjendeshin edhe gjeneralë të tjerë si Ljubisha Stojimiroviç, shef i shtabit të armatës së tretë [32], Negosllav Nikoliç, komandant i korpusit të Nishit [33], Tomislav Mlladenoviç dhe Milan Gjakoviç.[34]

Korpusi i Prishtinës u dislokua në qytetet e mëposhtëm: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan. Forca totale e korpusit përbëhej afërsisht nga 15 mijë trupa. [35]

Dëshmitë e ndryshme na sugjerojnë se korpusi i forcave speciale të VJ-së ishte gjithashtu aktiv në krahinë gjatë konfliktit në Kosovë. Sipas zyrtarëve

Gjeneral-major Vladimir Lazareviç (majtas), komandant i Korpusit të Prishtinës gjatë luftës në Kosovë dhe gjeneral-kolonel Nebojsha Pavkoviç (djathtas), komandant i armatës së tretë gjatë luftës, duke përshëndetur ushtarët e Armatës Jugosllave në Pirot, Serbi, më 1 shtator 2000. Pas luftës në Kosovë, President Miloshevici e gradoi Lazarevicin komandant të Armatës së Tretë dhe Pavkoviçin komandant të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave.

FOTO AFP

perëndimorë të mbrojtjes e të shërbimeve sekrete të cituar nga *Washington Post*, njësia e 72-të e operacioneve speciale kryente veprime në malet e Rugovës në qershor 1999. [36] Komandanti veteran i korpusit të forcave

Intervistë me një ushtar

Gazetarët Stephen Smith dhe Michael Montgomery të radios amerikane "Works" intervistuan luftëtarë serbë, të cilët ishin aktivë në Pejë dhe në fshatrat përreth deri në qershor 1999. Dëshmitë e tyre mbi atë që ka ndodhur në Kosovë dhe në mënyrë specifike në fshatin Qyshk (shih komunën e Pejës) mund të gjenden në internet në adresën www.americanradioworks.org. Kjo intervistë me ushtarin Vaso (një pseudonim) u mor në Malin e Zi më shtator 1999. Vaso, një djalë që sapo i ka kaluar të tridhjetat, shërbeu në një njësi speciale taktike të armatës së tretë.

ARW: Ishte diçka e pazakontë që burrat të ekzekutoheshin në Qyshk?

Vaso: Ishte më shumë se e pazakontë, e në të njëjtën kohë ishte diçka normale. Ishte e pazakontë në kuptimin që kjo gjë, dua të them vrasja e njerëzve të paarmatosur, nuk është ajo që njerëzit janë të prirur të bëjnë.... Por ne niseshim atje me një qëllim të përcaktuar, të fitonim mbi terroristët. Unë nuk shkova të luftoja për arsye patriotike. Dhe tani unë pyes veten: Duhej të kisha qënë atje? Mos vallë isha një i marrë? Nëse unë do të kisha ditur çfarë di sot, ndoshta nuk do të kisha shkuar. Por këmbëngul në faktin që, kur ti jeton mes një traume të vështirë, është e vështirë t'i kuptosh gjërat. Unë eci nëpër rrugë, i vetëm. Eci gjithë ditën dhe mendoj. Ndonjëherë besoj se unë bëra mirë që shkova të luftoja, herë të tjera ndjej se kam bërë gabim. Çfarë unë kam parë atje është ende brenda meje. Unë ende arrij t'i shoh ata njerëz të pafajshëm duke vdekur. Unë shoh një ushtar që po vret një grua në sy të të shoqit e të fëmijëve të vet. Eshtë diçka që unë nuk mund ta harroj kurrë.

ARW: Çfarë ju thoshin oficerët lidhur me luftën, lidhur me shqiptarët?

Vaso: Ata na i jepnin këto leksione gjatë stërvitjes, por edhe në momente të tjera. Ata tregonin çfarë po na bënin shqiptarët, sa njerëz kishin vrarë këta të fundit. Unë nuk e di nëse kjo ishte e vërtetë, por ata na tregonin hollësira, na tregonin fotografi të trupave të gjymtuar, na

speciale, major gjeneral Ljubisha Stojimiroviç [37] u emërua shef i shtabit të armatës së tretë nga presidenti Milosheviç në fund të vitit 1998.[38] Zëvendësimi i tij si komandant i korpusit të forcave speciale është i panjohur.

Sipas revistës "Vojska", korpusi i forcave speciale në prill 1998 përfshinte:[39]

> tregonin lidhur me këtë apo atë fshat, ku serbët ishin vrarë apo ishin dëbuar nga terroristët shqiptarë. Unë nuk e di nëse këto ishin histori të vërteta, por ne gjendeshim të verbuar nga ata, nga gjithë ajo fushatë që zhvillohej kudo në Serbi. Media thoshte të njëjtën gjë, pikërisht të njëjtën gjë. Gjatë gjithë ditës ti ke një stacion, një kanal, një transmetues lajmesh, një burim informacioni, dhe ti ke gjeneralin tënd, dhe të gjithë ata flasin kundër shqiptarëve. Në këto kushte nuk ka gjasa që ti t'i pëlqesh shqiptarët, që ti t'i shohësh ata si qënie njerëzore.
>
> ARW: Çfarë mendoni ju nëse Gjykata e Hagës do të vendoste se gjithçka ka ndodhur në Qyshk është një krim lufte dhe do të përpiqej të dënonte përgjegjësit e këtyre krimeve?
>
> Vaso: Ata njerëz duhet të ndëshkohen. Unë jam dakord. Unë mendoj se kjo ka qënë një politikë e gabuar. Dhe Milosheviç, si personi që e krijoi këtë politikë, duhet të shkojë në Hagë. Unë nuk e dija çfarë po ndodhte kur unë shkova (në Kosovë). Por ata (regjimi i Milosheviçit) llogarisnin çdo gjë që ndodhte. Ai duhet të jetë i pari që duhet të shkojë në Hagë dhe gjatë gjyqit do të gjenden edhe të tjerët.
>
> ARW: Si ndjehesh kur shkon në shtëpinë tënde, në Serbi, dhe fjalosesh me njerëzit që mbështesin Milosheviçin, të cilët nuk besojnë se ka ndodhur ndonjë gjë e keqe në Kosovë?
>
> Vaso: Eshtë e tmerrshme. Unë mendoj se është një katastrofë për secilin që mendon në atë mënyrë. Unë jam përpjekur t'u shpjegoj njerëzve atë që kam parë, atë që ai (Milosheviçi) ka bërë. Unë kam shpjeguar politikat e dështuara, por unë nuk kam nerva e durim për të bindur të tjerët. Unë jam përpjekur t'u tregoj njerëzve atë që kam parë. Por çfarë mund t'i them unë atij që nuk më beson ...kjo është çmenduri. Pas kësaj, ose ai do të më vrasë mua, ose unë do të vras atë.
>
> ARW: Çfarë mendon familja jote (në Serbi)?
>
> Vaso: Familja ime mendon si unë. Janë ndikuar prej meje. Ata mendonin si njerëzit e Milosheviçit. Tani ata mendojnë krejt të kundërtën.... Për fat të keq, janë të shumtë ata që vazhdojnë të mendojnë si më parë.

- Brigadën e rojeve
- Brigadën e 63-të të parashutistëve, të komanduar nga lejtënant kolonel Ilija Todorov [40]
- Brigadën e 72-të speciale të komanduar nga kolonel Branislav Lukiç [41]
- Njësitë antiterroriste të Policisë Ushtarake - kobrat e fajkonjtë
- Brigadën e korracuar

Sipas Federatës së Shkencëtarëve Amerikanë (një organizatë joqeveritare e jofitimprurëse me qendër në Shtetet e Bashkuara), e cila ka monitoruar strukturën e sigurimit jugosllav, Fajkonjtë (Sokolovi) dhe Kobrat (Kobre) ishin njësi speciale të Policisë Ushtarake të Korpusit të forcave speciale. Këto njësi të trajnuara mirë u përdorën, sipas informacionit të shtypit, për operacione antiterroriste; Kobrat përbëheshin nga dy toga, me nga gjashtëmbëdhjetë vetë secila. [42] Sipas revistës "Vojska", përdorimi i tyre rregullohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të VJ-së. [43]

Ushtarët e rregullt të VJ-së zakonisht ishin të identifikueshëm nga uniformat ngjyrë gri të maskimit dhe nga simboli kuq e bardhë i shqiponjës me dy kokë mbi supe. Ushtarët kujdeseshin të dukeshin më të rinj – shpesh rekrutë.

Ishin të shumtë gjithashtu, vullnetarët që luftuan për VJ-në. Në një intervistë në gazetën serbe Veçernje Novosti, kolonel gjeneral Nebojsa Pavkoviç konfirmonte që "ishin rreth një mijë vullnetarë, veçse ata ishin nën komandën e kontrollin e rreptë të oficerëve tanë" [44] Prania e vullnetarëve është konfirmuar nga një dokument i gjetur prej Human Rights Watch në Pejë, i cili jepte listën e emrave të 12 vullnetarëve të ardhur nga Vojvodina. Dokumenti njëfaqësh i departamentit të administrimit të përgjithshëm dhe shërbimit publik në Debeljaca, në Vojvodinë, bën fjalë për lejimin e transportit publik pa pagesë prej Dubaljaca-s deri në Bubanj Potok dhe kthim për "vullnetarët e përmendur më poshtë" [45] Dokumenti nuk specifikon megjithatë, nëse personat e përmendur në listë ishin vullnetarë për t'u bërë pjesë e njësive ushtarake apo njësive paraushtarake.

Në një intervistë në gazetën Guardian (Londër), një vullnetar i VJ-së, i quajtur Milan Petroviç, thosh se ai kish shkuar në Kosovë për ta spastruar këtë të fundit nga shqiptarët, së bashku me dy mijë vullnetarë të tjerë. "Shumicës së tyre (shqiptarëve) u dhamë njëzet e katër orë kohë për t'u larguar", i thosh ai gazetës. "Shqiptarët e kamur (edhe ata, ju e dini, janë

të gjithë kriminelë), me televizorë satelitorë e me shtëpi të mëdha, ishte më e vështirë t'i dëboje. Por nëse ti këmbëngul, ata të gjithë shkojnë në fund të botës. Shqiptarët janë të gjithë frikacakë, ikin të gjithë me vrap si lepuj". [46] Sipas Petroviç-it, i cili në jetë ish një shofer kamioni, "një vullnetar në njëqind" kryente përdhunime dhe vrasje. Ai thosh:

> Nja gjashtë djem në njësinë time na dolën nga duart një natë dhe filluan të vrasin shqiptarë. Ata vranë tre-katër prej tyre, para se të



NATO shpërndau trakte si ky nëpër Kosovë si pjesë e një fushate oppsi (operacionesh psikologjike). Ky trakt tregon Brigadat që NATO besonte se ishin aktive në Kosovë. Brigada e 52-të e Përzier e Artilerisë bën pjesë në Armatën e Tretë nën juridiksionin e së cilës bën pjesë edhe Kosova. ARKIVAT E SHTYPIT TE NATO

fillonin të vidhnin plaçkat e shtëpive. Të nesërmen, ushtria erdhi dhe i mori me vete. [47]

Një vullnetar tjetër, i identifikuar me gërmën "K", u intervistua nga autorët e një dokumentari, që do të transmetohej në programin televiziv Frontline. Në intervistën e filmuar, ai thotë se vullnetarët ndiqnin në mënyrë rigoroze urdhërat e VJ-së:

Çdo veprim i yni bëhej pas një urdhëri .... me shkrim. Unë kisha parime. Unë shihja çdo urdhër përpara se të hidhesha në aksion. Ne kishim urdhëra për V., M., e G. (janë emra të koduar të fshtarave në Kosovë) .... ishin operacione "spastrimi" ato, në të cilat unë mora pjesë ....Ne kishim një urdhër për t'i qëlluar ata nga kodrat, dhe është pikërisht kjo që ne bëmë. [48]

Në të njëjtën kohë, "K' pranoi që disa vullnetarë dilnin jashtë kontrollit, ndonëse ai pretendoi se ata ndaloheshin nga komandantët e VJ-së. Ai i tha programit Frontline:

Kishte grupe njerëzish që donin të shkonin në aksione spastrimi me mendjen e tyre. Ky nuk është spastrim. Eshtë vjedhje, grabitje .... Në disa fshatra u veprua pa urdhër, derisa një gjeneral pa një prej aksioneve të paautorizuara. Ai urdhëroi ushtarët të ndaleshin, u tha të iknin sa më parë atyre që ishin vënë tashmë në rresht të frikësuar, pasi ai nuk mund t'i merrte më në mbrojtje. Kur filluan të pranoheshin vullnetarët, filluan të shfaqeshin në radhët tona edhe hajnat. Ti nuk mund të kontrollosh çdo gjë. Ne u kujdesëm që grupi i vullnetarëve, të cilët u bashkuan me ne për qëllime patritoke, njerëzit e mirë pra, të ndiqnin urdhërat për të mbrojtur vetveten dhe të vepronin kundër terroristëve.[49]

Sipas NATO-s dhe Departamentit të Shtetit amerikan, disa forca ushtarake të tjera jashtë korpusit të Prishtinës së armatës së tretë, ishin gjithashtu aktive në Kosovë në periudhën mars-qershor 1999. Më 7 prill, Departamenti i Shtetit nxorri një deklaratë, në të cilën u dhanë emrat e nëntë komandantëve të ushtrisë jugosllave (në vëmendje të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë), duke vënë në dukje, se "forcat e VJ-së dhe të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme po kryenin

krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë". [50] Midis këtyre emrave ishte edhe ai i kolonel Milosh Mandiç, komandant i brigadës së 252-të të korracuar, me garnizonet të vendosura në Kraljevo, Serbi.

Për një farë kohe gjatë luftës ajrore, NATO hodhi fletushka mbi Kosovë si pjesë e fushatës së operacioneve psikologjike (Psyops). Një fletushkë i adresohej brigadës së 78-të të motorizuar, brigadës së 211-të të korracuar, brigadës së 52-të të artilerisë së kombinuar (e njohur si pjesë e armatës së tretë), dhe brigades së 78-të të artilerisë së kombinuar, me anën e të cilave shprehej bindja e NATO-s, sipas së cilës këto brigada ishin gjithashtu aktive në Kosovë.

Sipas "*Jane's Defence Weekly*, besohej se një brigadë e përforcuar nga Korpusi i Nishit dhe një brigadë nga Korpusi i Leskovacit kishin lëvizur brenda Kosovës në datat 21 e 22 mars, vetëm pak ditë përpara fillimit të bombardimeve të NATO-s. Përveç kësaj, dy brigada të përforcuara, një prej të cilave nga armata e parë dhe tjetra nga armata e dytë besohej se kishin lëvizur brenda Kosovës në të njëjtën kohë. [51]

Numri i saktë i të vrarëve dhe të plagosurve të VJ-së mbetet i panjohur. Sipas ish-komandantit të armatës së tretë, Pavkoviç, gjatë bombardimeve të NATO-s u vranë 161 dhe u plagosën 299 ushtarë. Nëntë të tjerë rezultuan të zhdukur. Përsa i përket armatimit, Pavkoviç tha në një deklaratë të qershorit të vitit 1999, të botuar në Vojska, që NATO kish shkatërruar trembëdhjetë tanke të VJ-së, gjashtë mjete të blinduara lëvizëse, tetë mjete të artilerisë, nëntëmbëdhjetë kundërajrorë, dhe një radar. [52]

Ministria Serbe e punëve të Brendshme (MUP)

Struktura e Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (MUP) është shumë më e komplikuar se sa ajo e VJ-së, e cila përbëhet nga një hierarki transparente. Bollëku i njësive e grupeve brenda MUP-it e bën hierarkinë e saj më pak të dallueshme, ndonëse është e qartë se, sipas ligjit, autoriteti më i lartë i MUP-it gjatë luftës i përkiste presidentit të atëhershëm jugosllav, Sllobodan Milosheviç. Megjithëse ai nuk ishte de jure në majë të zinxhirit të komandave të MUP-it në kohë paqeje (ky post mbahej nga Ministri Serb i Punëve të Brendshme), ai ishte de facto komandant i padiskutueshëm i këtyre forcave. Sipas ligjit jugosllav mbi

mbrojtjen, në një situatë luftë, policia republikane vihet nën jurisdiksionin e ushtrisë jugosllave. Një situatë lufte egzistonte në Jugosllavi midis 24 marsit e 10 qershorit 1996.

Aparati i sigurimit i MUP-it është i ndarë në tri degë: shërbimi i sigurimit publik, shërbimi i sigurimit shtetëror (i njohur si SDB – Sluzba Drzavne Bezbednosti), dhe institucionet arësimore, siç ishte Akademia e Policisë. [53] Shërbimi i sigurimit publik ka njëmbëdhjetë departamente, përfshirë departamentin e policisë. Shërbimi i sigurimit shtetëror, ose SDB, është gjithashtu i njohur si policia sekrete. Gjendet gjithashtu një Ministri jugosllave e Punëve të Brendshme, e drejtuar nga Zoran Sokoloviç, por sipas të gjitha gjasave, ai dhe ministria federale luajtën një rol të kufizuar. [54]

Emblema e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë

Nga prilli i vitit 1997 deri në tetor të vitit 2000, ministër i MUP-it ishte Vlajko Stojiljkoviç, i njohur me emrin përkëdhelës "Deda" ("Babagjyshi"). Më 27 maj 1999, ai, së bashku me katër zyrtarë të tjerë të lartë serbë e jugosllavë, u akuzua nga Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve të Luftës për ish-Jugosllavinë për krime kundër njerëzimit të kryera në Kosovë. [55] Nga pikëpamja ligjore, Stojiljkoviçi përgjigjej përpara qeverisë serbe dhe parlamentit kombëtar. Nuk është e qartë se sa pushtet ushtronte ai de facto brenda ministrisë.

Deri në janar të vitit 2001, kreu i shërbimit të sigurimit publik ishte kolonel gjeneral Vlastimir Gjorgjeviç, i njohur me nofkën përkëdhelëse "Rodja" ("Kushëriri"), i cili ishte gjithashtu ndihmës i ministrit.

Një foto pa datë e Vlajko Stojiljkoviçit, ministri serb i punëve të brendshme gjatë luftës në Kosovë. Gjykata e Krimeve të Luftës akuzoi më 27 maj 1999 Stojiljkoviç, presidentin jugosllav Sllobodan Milloshevic, presidentin serb Milan Milutinoviç, kryeministrin jugosllav Nikolla Shahinoviç dhe komandantin e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Jugosllave Dragoljub Ojdaniç për krime lufte në Kosovë.

FOTO AFP

Gjorgjeveçi u zëvendësua nga Sreten Lukiç, i cili komandonte policët me uniformë në Kosovë gjatë luftës (shih më poshtë). Kreu i shërbimit të sigurimit të shtetit gjatë luftës ishte kolonel gjeneral Radomir Markoviç. Ky i fundit u shkarkua nga qeveria e re serbe më 25 janar të vitit 2001. Më 23 shkurt ai, së bashku me tre zyrtarë të tjerë të shërbimit të sigurimit shtetëror, u arrestua me akuzën e përfshirjes në aksidentin automobilistik të 1999-ës, ku mbeti i plagosur politikani i opozitës Vuk Drashkoviç dhe të vrarë katër shoqëruesit e tij. [56] Sipas website-it të MUP-it, www.mup.sr.gov.yu/domino/mup.nsf/pages/index-e (22 prill 2001), ndihmësit e tjerë të ministrit Stojiljkoviç, ishin: major gjeneral Nikola Curciç, zëvendës shef i shërbimit të sigurimit shtetëror dhe drejtor i Institutit të Sigurimit, lejtënant gjeneral Obrad Stevanoviç, major gjeneral Stojan Misiç, dhe major gjeneral Petar Zekoviç.

Deri në janarin e vitit 2001, kolonel gjeneral Obrad Stevanoviç komandonte departamentin e policisë të shërbimit të sigurimit publik. [57] Departamenti i nda në disa grupe të ndryshme: policia e rregullt, policia speciale dhe forcat speciale antiterroriste.

Njësitë e policisë speciale ishin zakonisht të njohura me emrin PJP (Posebne Jedinice Policije). Ato ishin më të specializuara, të trajnuara në mënyrë më intensive e të pajisura me armatim më të sofistikuar (mortaja e mitralozë të rëndë) se sa policia e rregullt. Sipas Federatës së Shkencëtarëve Amerikanë dhe një analisti të njohur të policisë së Beogradit, PJP-ja kishte në përbërjen e saj rreth 7,000 vetë, ndonëse numri i tyre mund të rritej aty për aty duke rekrutuar njerëz të policisë së rregullt. [58] Ministria e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar pretendoi megjithatë që PJP-ja kishte 5,000 anëtarë në vitin 1999, të shpërndarë në gjashtë detashmente në territorin e Serbisë, si edhe 8,000 rezervistë. [59] Besohej që Obrad Stevanoviçi, kreu u departamentit të policisë, komandonte gjithashtu edhe PJP-në.

Foto pa datë e gjeneral kolonel Vlastimir Gjorgjeviç, shef i shërbimit të sigurimit të shtetit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë gjatë luftës në Kosovë. FOTO "VREME"

Departamenti i policisë kishte edhe njësi speciale antiterroriste, të njohura si SAJ

Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP)-Struktura bazë në Kosovë, mars-qershor 1999



(Specijalna Antiterroristiçka Jedinica) dhe komandohej nga kolonel Zivko Trajkoviç. [60] Njësia komandohej nga Radovan Stojicic, a.k.a. Badza, i cili u vra nga një i panjohur në qendër të Beogradit më 1996.

SAJ-i kish tri njësi: në Batajnicë (afër Beogradit), Prishtinë e Novi Sad. [61] Njësitë ishin të paisura mirë dhe mbështeteshin nga njësi helikopterësh. Uniformat e tyre janë zakonisht të zeza, dhe emblema, sipas gazetës serbe Blic, ishte një shqiponjë e bardhë dykokëshe me një stemë të kuqe dhe me simbolin serb të katër C-ve. [62]

Serbia kish gjithashtu policinë e rregullt të shpërndarë në të gjithë Republikën, e cila ishte nën komandën e kolonel gjeneral Obrad Stevanoviç. Në Kosovë gjendeshin shtatë qendra të policisë rajonale, të njohura si SUP-a (Sekretarijat Unutrasnjih Poslova, ose Sekretariati i Punëve të Brendshme) në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, e Gjakovë. Secila prej këtyre SUP-ave ishte e ndarë në OUP-a (Odeljenje Unustrasnjih Posllova, ose njësia e Punëve të Brendshme) më të vegjël, në brendësi të të cilave ishin postat e policisë lokale në qytete e fshatra. Zëdhënësi i MUP-it në Kosovë ishte kolonel Ljubinko Svetiç.

Një figurë qëndrore e policisë së rregullt ishte Sreten Lukiç, i cili komandonte forcën në Kosovë. [63] Pozita e tij e saktë në zinxhirin hierarkik të MUP-it gjatë luftës mbetet disi e paqartë, ndonëse rëndësia e tij në krahinë është e padiskutueshme. Në dokumenta të ndryshme të MUP-it, ai përmendet si shef i shtabit të ministrisë së brendshme në Prishtinë. [64] Ai është gjithashtu i lidhur me Milan Lukiçin dhe Sredoje Lukiçin, që të dy të akuzuar nga Gjykata e Krimeve të Luftës për abuzime në Bosnjë [65], si dhe me Mikailo Lukiçin, ish-shefi i policisë sekrete në Bajina Basta. [66]

Në shumë raste, MUP-i e prezantoi Lukiçin në Kosovë si interlokutorin e vet kryesor me të huajt. Më 7 qershor 1998, Lukiç takoi një delegacion të madh të diplomatëve të huaj dhe të atasheve të mbrojtjes, të cilit po merrnin pjesë në turneun e organizuar nga qeveria jugosllave në Kosovën perëndimore pas ofensivës së parë qeveritare në shkallë të gjerë kundër UÇK-së. Në përgjigje të një pyetjeje të një diplomati holandez rreth vendndodhjes së fshatarëve, Lukiç tha: “Terroristët kanë evakuar të afërmit e të dashurit e tyre, gratë, fëmijë e prindërit e moshuar të tyre …”[67] Lukiç mohoi atë që pështpëritej, sipas së cilës, mijra civilë shqiptarë ishin shtrënguar ta linin vendin.

Një figurë qëndrore e policisë së rregullt ishte Sreten Lukiç, i cili komandonte forcën në Kosovë.

Disa gazetarë u morën me kronikën e turneut. Sipas një raportimi, Lukiç pretendoi që UÇK-ja u kish vënë qëllimisht zjarrin shtëpive të tyre. Dëmtimin e disa xhamive në atë zonë, ai e lidhi me "shpërdorimin e objekteve fetare gjatë të shtënave" nga ana e shqiptarëve". [68] Sipas website-it të MUP-it, Lukiç tha:

> Rreth 5,000 vetë e braktisën zonën gjatë rrugës. Por në vend të shkonin në Shqipëri, siç thonë disa media, ata iu drejtuan Gjakovës, Prizrenit, një pjesë syresh shkuan tek kushërinjtë e tyre që punonin në Europën Perëndimore, dhe një pjesë e madhe e atyre që banonin pranë kufirit shkuan tek kushërinjtë apo në drejtim të staneve malorë ku ata kullosnin bagëtinë në verë. Pas çblokimit të rrugës, u krijuan të gjitha kushtet, në mënyrë që njerëzit të ktheheshin në shtëpitë e tyre. [69]

Human Rights Watch vizitoi Shqipërinë e veriut në korrik 1999 për të intervistuar refugjatët, të cilët kishin lënë shtëpitë për shkak të ofensivës. Ata flisnin për bombardime fshatrash që s'kursenin askënd, për plaçkitje në masë, për djegjen e pronave private nga forcat serbe. Pesëmbëdhjetë mijë njerëz shkuan në Shqipëri dhe rreth 30 mijë u larguan në veri, drejt Malit të Zi.[70]

Lukiç ishte gjithashtu personi më i kontaktuar i policisë prej misionit vëzhgues të MVDK-së. Në një incident, më 21 gusht 1998, një skuadër e përbashkët amerikano-kanadeze e MVDK-së u ndalua dhe u paraburgos nga tre oficerë policie të dehur pranë Pejës (sipas raportit të brendshëm të MVDK-së të po asaj dite, i cili u pa nga Human Rights Watch). Pas abuzimit e kërcënimeve verbale për rreth tridhjetë minuta, skuadra e MVDK-së u lëshua. MVDK-ja amerikane kontaktoi menjëherë administratorin e Kosovës Veljko Odaloviç dhe "komandantin e MUP-it për krahinën, gjeneral Lukiç". Ky i fundit duhej të ish në Beograd sipas informacioneve, por Odaloviç kërkoi ndjesë e garantoi që personat përgjegjës

Foto pa datë e Kol. Obrad Stevanoviç, shef i Departamentit të Policisë të Serbisë gjatë luftës në Kosovë.

FOTO "VREME"

do të ndëshkoheshin. Tri orë më vonë, sipas raportit të MVDK-së, Odaloviçi njoftoi se oficeri i MUP-it, i cili ishte personi përgjegjës, u shkarkua, ndërsa masa kundër dy oficerëve tjerë ishte në diskutim e sipër. Ai gjithashtu tha që "Gjeneral Lukiç bëhej garant, që njësitë e MUP-it në terren do të këshilloheshin e instruktoheshin të mbanin disiplinën". [71] Kjo deklaratë dëshmon se rangjet e dosjet e MUP-it ishin nën kontrollin e shefave.

Emri i Lukiçit u shfaq përsëri në janar 1999, pas ekzekutimit të dyzet e pesë shqiptarëve në Raçak. Sipas *Washington Post*-it, qeveritë perëndimore kishin interceptuar biseda midis "ministrit të brendshëm serb gjeneral Sreten Lukiç" dhe zëvendës kryeministrit jugosllav Nikola Shainoviç (i cili u akuzua nga Gjykata për Krimet e Luftës më 24 maj 1999). Burime të besueshme perëndimore pretenduan që dy zyrtarë urdhëruan forcat e tyre "të vepronin rëndshëm". Në një seri bisedash pas sulmeve, Lukiç e Shainoviç besohet se kanë diskutuar rrugët për të fshehur masakrën. [72]

Pas rënies së Milosheviçit në tetor të vitit 2000, Lukiç u bë kreu i departamentit për çështjet e kufirit në ministrinë e punëve të brendshme, i cili merret me pasaportat e vizat. [73] Por më 30 janar 2001, qeveria e re serbe e emëroi atë shef të sigurimit publik të ministrisë, duke i zënë vendin Vladimir Gjorgjeviçit, si dhe zëvendës ministër të punëve të brendshme.[74]

Komandantët e SUP-ave rajonalë për Kosovën ishin nën urdhërat e Lukiçit. Komandanti i SUP-it të Gjakovës, i emëruar në fillim të vitit 1996, ishte Dragutin Adamoviç. [75] Komandanti i SUP-it të Pejës, i cili mbulonte komunat e Pejës, Klinës e Istogut, ishte kolonel Boro Vllahoviç. [76] Komandanti i OUP-it të Klinës, pjesë përbërëse e SUP-it të Pejës, ishte rreshter major Jovica Mikiç. [77] Lejtënant Vukmir Mircic ishte komandant i OUP-it të Deçanit. [78]

SUP-i i Prizrenit mbulon komunat e Prizrenit, Rrahovecit, Suharekës e Gorës, e secila prej këtyre komunave kish OUP-in e vet. Bazuar në një artikull të "Policajak"-ut në shkurt të vitit 1998, si dhe në shpërblimet e dhëna për oficerët e MUP-it pas lufte, komandanti i SUP-it të Prizrenit ishte kolonel Gradimir Zekavica (dhe lejtënant Millan Gjuriçiç ish shef seksioni i departamentit të policisë së SUP-it për Prizrenin). [79] Eshtë në fakt një informacion kontradiktor sepse, sipas "Policajac"-it, në janar 1999 u emërua shef i ri i SUP-it të Prizrenit kolonel Millosh Vojnoviç, i cili ishte gjithashtu ndihmës shef i departamentit të policisë në ministrinë e punëve të brendshme. [80] Por në shkurt 1998, shef i policisë në OUP-in e Suharekës

ishte lejtënant Dobrivoje Vitoseviç dhe nënlejtënant Radojko Repanoviç ishte zëvendësi i tij. [81]

SUP-i i Mitrovicës mbulon Mitrovicën, Leposaviqin. Zvecanin, Zubin Potokun, Vushtrrinë e Skënderajn, me OUP-e në Skënderaj, Leposaviq dhe Vushtrri. Kreu i SUP-it më 1998 (qysh prej vitit 1996) ishte kolonel Ljubinko Cvetiç, i cili më përpara kish qënë shef i policisë në Kragujevac e pak më vonë, një zëdhënës i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kosovë. Shefi seksionit të departamentit të policisë për Mitrovicën ishte lejtënant Milorad Radeviç. [82] Në OUP-in e Skënderajt, major Branko Jarediç ishte shefi, ndërsa kapiteni Milenko Bozoviç ishte komandant i policisë. [83]

SUP-i i Gjilanit mbulon komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitit e Novo Bërdos. Deri në janar 1999, shefi i SUP-it të Gjilanit ishte kolonel Vlada Miliceviç. Ky u zëvendësua në atë kohë nga kolonel Dushan Gavraniç, ish-shef i SUP-it në Zrenjanin (në Vojvodinë, Serbi). [84]

SUP-i i Prishtinës mbulonte Prishtinën, Gllogofcin, fushën e Kosovës, Lipjan-in, Obiliqin, dhe Podujevën. Shef i OUP-it të Gllogofcit ishte Petar Damjanac, dhe zëvendësi i tij ishte Nebojsha Trajkoviç ("Lutka"). SUP-i i Ferizajt mbulonte Ferizajn, Shtimjen, Shterpcen dhe Kaçanikun, dhe drejtohej nga Bogoljub Janicijeviç (sipas banorëve të Ferizajt)

Përveç këtyre shtatë SUP-ave, policë të veçantë e ndoshta njësi policie nga jashtë krahinës ishin gjithashtu aktive në Kosovë, siç e tregon lista e policëve të vrarë gjatë vitit 1998 e 1999, e cila gjendet në website-in e MUP-it. Në shtator 1998, për shembull, pesë policë u vranë në një incident mbi mina pranë Likofcit. Të gjithë ata ishin nga SUP-i i Novi Sad-it, ndonëse nuk është e qartë, nëse i përkisnin policisë së rregullt apo policisë speciale (qoftë të PJP-së, qoftë të SAJ-it). [85] Njësi policie nga Pozarevaci ishin sipas disa gjasave gjithashtu të angazhuar në Kosovë, siç ka rezultuar nga vrasja e një polici prej Pozarevacit, Milan Teniç, më 24 prill 1998 në Kosovë. [86] Policë nga Pançevo, Serbia, u vranë gjithashtu në Kosovë në vitin 1998. [87]

Brenda MUP-it ishin gjithashtu shumë grupe milicësh e rezervistësh lokalë, si për shembull "Munja" ("vetëtima") në Pejë, i cili ishte përgjegjës për masakrën në fshatin Qyshk, më 14 maj 1999 (shih komunën e Pejës). Grupi kish namin e dhunës e të kriminalitetit. Sipas anëtarëve të "Munja"-s, të cilët folën me gazetarë të kompanisë amerikane për dokumentarë radiofonikë "American Radio Works", Ushtria Jugosllave i furnizonte ata me ushqim e municion, si dhe me dokumenta udhëtimi, për t'u mundësuar kalimin e pikave të kontrollit. Një anëtar i Munja-s, i quajtur Branko, tha:

> Ne do të përpilonim një listë njerëzish, të cilët duhej të arrestoheshin. Nëse ata do të rezistonin, ne do t'i vrisnim. Disa shqiptarë paguan pará, në mënyrë që të liheshin të qetë. Ne e dinim cilët duhet të merrnim me vete e cilët jo. [88]

Ministria serbe e Punëve të Brendshme përmban gjithashtu shërbimin e sigurimit të shtetit (SDB), i njohur ndryshe si policia sekrete, e cila ishte e organizuar me drejtori e sektorë. Roli i sigurimit të shtetit, përgjithësisht në luftrat e ish-Jugosllavisë, e veçantërisht në Kosovë, duhet të mos nënvlerësohet. SDB-ja mbajti një rrjet të gjerë operativësh e operatorësh në Kosovë, midis të cilëve shumë shqiptarë etnikë. Komandantët e UÇK-së pretendonin që SDB-ja kishte infiltruar në mënyrë të suksesshme në disa raste në radhët e UÇK-së (ndonjëherë i përdornin këto pretendime për të justifikuar torturat dhe ekzekutimet në masë të shqiptarëve të dyshuar si spiunë).

Vidomir Salipur, polic në Pejë i cili u vra nga UÇK-ja më 8 prill 1999, në qendër në rreshtin mbrapa, me kapele. Mendohet të ketë qenë komandant i një milicie lokale në Pejë të quajtur "Munja"ose Ndriçimi, Salipuri njihej për sjelljen e tij të vrazhdë kundrejt shqiptarëve etnikë. Në të djathtë të tij gjendet një person që dëshmitarët e identifikuan si Nejbojsha Miniç, i implikuar në rrëmbimin dhe vrasjen e gjashtë anëtarëve të një familjeje në Pejë më 12 qershor (shih komuna e Pejës). Data dhe vendi i fotografisë janë të panjohura ashtu siç janë edhe identitetet e personave të tjerë.

© HUMAN RIGHTS WATCH

Gjatë fundit të vitit 1998 e gjithë vitit 1999, drejtor i Sigurimit të Shtetit ishte kolonel gjeneral Radomir Markoviç, i cili pak më përpara ishte kreu i SUP-it të Beogradit (Siç u përmend më sipër, Markoviçi u arrestua në shkurt 2001). Zëvendësi i Markoviçit ishte major gjeneral Nikola Curciç, i cili, sipas website-it të MUP-it të asaj kohe, ishte gjithashtu drejtor i Institutit për Sigurimin. Në Kosovë, kreu i SDB-së ishte David Gajiç. [89] Sipas Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, ishin tri qendra kryesore të SDB-së në Kosovë: Prishtinë, Prizren e Gjilan. [90] Sipas banorëve të Suharekës, kreu i SDB-së lokale në Suharekë ishte "Mishko" Niseviç (Shih komunën e Suharekës). Sipas banorëve të Gjakovës, kreu lokal i Sigurimit të Shtetit ishte Sreten Camoviç (shih komunën e Gjakovës).

"Djemtë e Frenkit vrasin çdo gjë. Besomëni mua, ju nuk do donit t'i shihnit ata".

-Polic serb

Radomir Markoviçi u emërua shef i SDB-së më 27 tetor 1998, duke zëvendësuar Jovica Stanisiçin, një besnik të vjetër të Milosheviçit. Ka spekullime, sipas të cilave shkarkimi i Stanisiçit është i lidhur me kundërshtimet e tij ndaj politikës në Kosovë. Disa analistë besojnë gjithashtu që Stanisiçi kishte mosmarrëveshje me gruan e fuqishme të Milosheviçit, Mira Markoviç, e cila ishte kreu i partisë "E majta e Bashkuar Jugosllave" (JUL).

Roli dhe organizimi i saktë i SDB-së mbetet në mjegull, ndonëse veprimtaria e saj vëzhguese e ushtarake në Kosovë janë të padiskutueshme, qoftë përpara, qoftë pas luftës. JSO (Jedinice za Specijalne Operacije – njësia e operacioneve speciale) ka qënë struktura më famëkeqe e SDB-së, e cila ka qënë shumë aktive në Kosovë. Komandanti i kësaj njësie gjatë luftës ishte Milorad Lukoviç, një person i njohur më shumë me emrin "Legija". [91] Sipas raportimeve të shtypit serb, Ulemeku ndryshoi mbiemrin e tij më 1997 nga Ulemek në Lukoviç. [92] Një figurë qëndrore në organizmin e JSO-së, në mos themeluesi i saj, ishte Franko "Frenki" Simatoviç: një nofkë e përbashkët për luftëtarët e JSO-së

Foto pa datë e Gjen. Kol. Radomir Markoviç, shef i Shërbimit të Sigurimit të Shtetit për Serbinë që nga fundi i 1998 deri në fillim të 2001.

FOTO "VREME"

ishte "Djemtë e Frenkit". JSO ndonjëherë thirrej "berretat e kuqe", gjë që shkaktoi shumë konfuzion, sepse korpusi i forcave speciale të VJ-së thirrej në të njëjtën mënyrë.

JSO shfaqej shpesh me uniformat e njësive policore apo ushtarake, dhe njiheshin për faktin se mbanin thika të mëdha dhe kapele të dallueshme cowboy-sash të stilit australian. Pjesëtarët e JSO-së kishin gjithashtu një nam të keq si të pamëshirshëm. Human Rights Watch intervistoi në Beograd një polic serb, i cili qëndroi gjashtë muaj në Kosovë gjatë vitit 1998, dhe sipas fjalëve të tij "Djemtë e Frenkit vrasin çdo gjë. Besomëni mua, ju nuk do donit t'i shihnit ata". [93] Një ushtar tjetër i VJ-së,

Intervistë e "American Radioworks" me "Millosh", i cili pretendonte se i përkiste djemve të Frenkit.

Millosh: Ne ishim një njësi speciale e policisë sekrete. Unë arrita në Kosovë pak javë përpara bombardimeve të NATO-s. Ne dëbuam shqiptarët nga zonat që ishin bazat më të fuqishme të luftëtarëve të tyre. Nuk i asgjësuam. Thjesht i dëbuam për të mirën e tyre. Dëmi më i paktë gjatë luftës ndodhi, kur arriti ushtria dhe u la dy orë në dispozicion për t'u larguar. Ata qëlluan shqiptarë me fat.

Kishte shumë terroristë shqiptarë. Ne kishim epërsi numerike mbi ta. Dhe, në këto rrethana, ushtritë më të fuqishme të botës fillojnë të të bombardojnë - është totalisht një situatë e jashtëzakonshme. Gjërat rrjedhin vetë.

Ne ishim një njësi speciale. Sa për grupet paraushtarake, unë i quaj ata gangsterë. Çdo gjë ishte nën kontrolllin tonë, ushtria e policia gjithashtu, ndërsa ata ishin gangsterë. E megjithatë, një farë kontrolli kishte edhe mbi ta. Të gjitha këto grupe kishin zonat e tyre, ku kryenin operacione, dhe ishin të lejuar të bënin çfarë të donin. Ata viheshin qëllimisht në vende të caktuara, e ndërkohë u thuhej të bënin atë që donin, me kusht që detyra të realizohej. Ishte detyra e tyre të vrisnin, të përdhunonin e të bënin atë që dëshironin.

Unë mendoj, se një njeri, i cili është i përgatitur të përdhunojë e të sakatojë civilë, të sulmojë një fshat thjesht për të masakruar civilë, një njeri i tillë pra, cilitdo komb që t'i përkasë, ai nuk i bën nder atij kombi. Unë do t'i likujdoja ata aty për aty. Pa gjyq. Thjesht, një plumb pas qafe.

i cili foli me Human Rights Watch në shtator 1998, tha mes të tjerash se JSO ka kryer operacione në kufirin me Shqipërinë përreth Deçanit. [94]

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, JSO dispononte nga 400-500 vetë, shumica e të cilëve ishin të rekrutuar nga forcat speciale të UJ-së. [95] Media serbe ka shkruar që JSO ishte një njësi e formuar në rrethana speciale, anëtarët e së cilës veshin "një laryshi uniformash me stema që zyrtarisht nuk përdoren as nga njësitë policore, as nga njësitë ushtarake në krahinë". [96] Revista "Vreme" pretendonte që JSO, e formuar më 1991, nuk kish më shumë se 300 anëtarë. I paisur me armët më të sofistikuara, ky grup trajnohej në Kula (afër Vërbas-it), i cili u bombardua nga NATO gjatë luftës, si dhe në kampe të tjera në afërsi të lumit Tara. [97] Raportime të pakonfirmuara pretendojnë se gjatë bombardimeve të NATO-s, JSO ishte e stacionuar në burgun e Dubravës në afërsi të Istogut, të cilin NATO e bombardoi më 19 e 21 maj (shih komunën e Istogut).

Origjina e Frenki Simatoviçit është enigmatike. Raportime të ndryshme mbi Kosovën i veshin atij funksionin e komandantit të operacioneve speciale të Sigurimit të Shtetit apo të ndihmës shefit të shërbimit të Sigurimit të Shtetit. [98] Një artikull mbi JSO-në i gazetarit beogradas Dejan Anastasijeviç dhe i Andrew Purvis (për Time.com) pretendon se Simatoviçi, fillimisht ishte një oficer i ri i shërbimeve sekrete jugosllave, dhe më 1991 u ngarkua me detyrën për të ngritur një forcë paraushtarake të lidhur ngushtë me aparatin e Sigurimit të Shtetit në Beograd, me anën e së cilës të vepronte në Kroaci. Artikulli mbyllet me këto fjalë: "Detyra e Simatoviçit ishte ngritja e një njësie të vogël ish-policësh, ish-të bugosurish dhe të tjerë të vetëshpallur vullnetarë, të cilëve do t'u duhej të përgjigjeshin vetëm përpara policisë sekrete serbe". [99]

Milorad Lukoviç (ose Ulemek) mbeti në krye të JSO-së pas rënies së qeverisë së Milosheviçit në tetor 2001, duke ngritur kështu dyshime rreth rolit të kësaj organizate pas ndryshimeve politike në vend. Gazetat serbe hamendësonin se Lukoviçi (ose Ulemek) i kish ofruar mbështetjen e besnikërinë e tij kryeministrit të ri serb Zoran Xhinxhiç. Sidoqoftë, më 6 maj të vitit 2001, Ministria Serbe e Punëve të Brendshme njoftoi se komandanti i JSO-së "Milorad Lukoviç" është pezulluar nga detyra për shkak të një incidenti të dhunshëm në një bar-disko të qytetit të Kula-s. Së shpejti do të merren masat disiplinore dhe do të fillojë ndjekja penale, njoftonte Ministria. [100] Sipas gazetës *Danas*, një grup i pjesëtarëve të JSO-së u mblodh në një klub për të festuar përvjetorin e dhjetë të JSO-së. [101]

Besohet gjithashtu, se SDB-ja serbe ka asistuar e armatosur forca paraushtarake në Kosovë, ashtu siç bënë në Bosnjë e Kroaci, ndonëse natyra e kësaj pune mbetet e paqartë. Ministria e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar ka këmbëngulur që Simatoviç ka një " histori të gjatë të organizimit, armatosjes e të drejtimit të paraushtarakëve në luftën e Bosnjës e tashti në Kosovë". [102]

Ata (paraushtarakët) operonin në Kosovë me miratimin dhe mbështetjen e vazhdueshme politike e logjistike të qeverisë

Në një intervistë, një ish-pjesëtar i Sigurimit të Shtetit serb i ka thënë "American RadioWorks"-it, që SDB-ja ka ndihmuar fuqizimin e komandave e të kontrollit mbi forcat paraushtarake në Kosovë nëpërmjet furnizimit me paisje të komunikacionit:

> Fillimisht, ne morëm urdhëra nga komanda e lartë për t'u lënë disa gjëra në dispozicion krerëve të grupeve paramilitare. Telefona të lëvizshëm, lidhje radiofonike, komunikime satelitore. Ata kishin marrë ndërkohë armë e municion nga ushtria. Komunikimi ishte i tillë, që ata mund të viheshin në kontakt të drejtëpërdrejtë me komandën në Prishtinë. [103]

Sipas komandantëve të UÇK-së, të cilët kanë folur me Human Rights Watch, SDB-ja kishte njohuri të plota mbi personalitetet e aktivitetet e UÇK-së, dhe kjo kryesisht prej informatorëve e të infiltruarve. Faktet bëjnë të besohet se qeveria serbe ishte shumë e vetëdijshme mbi lëvizjen militante të shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve '80 e '90, përfshirë aksionet e para të organizuara të UÇK-së më 1996.

Paraushtarakët

Në një intervistë dhënë gazetës serbe "Veçernje Novosti", ish-shefi i armatës së tretë, kolonel gjeneral Nebojsha Pavkoviç mohonte praninë e paramilitarëve në Kosovë. [104] Deklarimet e dëshmitarëve të mbledhura nga Human Rights Watch, raportet e OSBE-së dhe artikuj të shumtë të botuar në median ndërkombëtare bien ndesh me këtë pretendim. Struktura e kompozimit dhe e komandimit të grupeve të ndryshme

paraushtarake dhe lidhjet preçize që secila prej tyre kish me qeverinë serbe e jugosllave mbeten të paqarta. Por faktet dëshmojnë, që ata operonin në Kosovë me miratimin dhe mbështetjen e vazhdueshme politike e logjistike të qeverisë, dhe shpesh në bashkëpunim të ngushtë me trupat e rregullta. Gjenden vetëm pak fakte, në mos aspak, që flasin mbi përpjekje të qeverisë për të penguar operacionet e paraushtarakëve, pavarësisht raporteve të përsërituara e të besueshme rreth krimeve të kryera prej tyre.

Forcat paraushtarake, të cilat sipas shumë gjasave kanë qënë aktive në Kosovë, përfshijnë përveç të tjerash Tigrat e Arkanit, Shqiponjat e Bardha të Sheshelit dhe Delta-Force-ën e "Republika Srpska"-s, një grup i policisë së kësaj Republike. [107] Besohet se shumë prej këtyre grupeve ishin të armatosura e të organizuara me ndihmën e SDB-së. Në ndryshim nga çfarë ndodhi në Kroaci e Bosnjë, në Kosovë këto grupe paraushtarakësh ishin kryesisht të integruara brenda njësive të VJ-së e të MUP-it, gjë që të bën të mendosh se ato rrallë vepronin me kokën e tyre.

Sipas raportit të OSBE-së mbi Kosovën, Tigrat e Arkanit duhet të kenë patur një kamp stërvitjeje diku midis Leposaviqit e Mitrovicës, dhe këto forca sipas shumë gjasave vepronin rrotull Mitrovicës, Pejës, Gjakovës e Prizrenit. Delta-Force-a e "Republika Srpska"-s, sipas shumë raportimeve, vepronte në jug të Gjilanit në fillim të prillit. [108] Njësia e SDB-së e njohur si Djemtë e Frenkit është identifikuar shpesh me paraushtarakët.

Sipas dëshmitarëve, paraushtarakët vishnin lloj-lloj uniformash – ata shpesh ishin të dallueshëm prej mungesës së iniformës. Disa kishin kokat të rruara, ndërsa të tjerët ishin me flokë të gjata e me mjekër. Shpesh mbanin shalle e shami të zeza ose të kuqe, sakica në duar apo thika të gjata në brez.

Duke lënë mënjanë natyrën shumë të dhunshme, një prej veprimtarive kryesore të këtyre forcave ishte plaçkitja dhe vjedhja. Sipas raportit të OSBE-së, shumë paraushtarakë kanë shkuar në Kosovë nga mesi i shkurtit për për organizuar transportin për në Serbi të gjërave të vjedhura. [109]

Në ato kohë, policia ose ushtria përpiqeshin të lajmëronin apo mbronin civilët shqiptarë nga paraushtarakët, ndonëse edhe kjo ishte një gjë e rrallë. Një shqiptar, i cili në muajin maj u mor me forcë së bashku me një grup të burgosurish nga burgu i Lipjanit për në Prishtinë tha se një polic e mori në mbrojtje nga kërcënimet e paraushtarakëve. Ai i tregoi "Human Rights Watch"-it: "Kur po ktheheshim, ne u ndalëm nga paraushtarakët, të cilët donin të na vrisnin. Një oficer i policisë goditi me

kondakun e armës në kokë njërin prej paraushtarakëve. Ai na foli shqip, na dha ujë e na tregoi të fshiheshin në Prishtinë".[110]

Pas luftës, disa paraushtarakë folën me gazetarë të huaj rreth kohës së tyre në Kosovë. Njëri syresh i vetquajtur "Dragan" tha se ai luftonte në njësinë paraushtarake Pitbull Terrier, e cila përbëhej nga boksierë të qytetit të tij, nga Niksiqi i Malit të Zi, dhe këta kishin luftuar në Bosnjë. Dragan tha që grupi i tij vrau pesëdhjetë shqiptarë si ndëshkim për shtatë të zhdukur nga radhët e tyre.

Një reporter i *Wall Street Journal* intervistoi tetë paraushtarakë, mes të cilëve gjeje edhe kriminelë të liruar prej burgjeve për të luftuar, edhe nacionalistë serbë, që besonin se ishin vënë në mbrojtje të atdheut. Njëri prej tyre, "Tony", tha se ai kish luftuar së bashku me Tigrat e Arkanit. Zyrtarë lokalë të Kosovës, tha ai, i dhanë njësisë së tij një fletë të printuar kompjuteri, ku ishin emrat e pronat e shqiptarëve të kamur. Njësi të tjera gjetën listat e atyre që duhet të ekzekutoheshin. Një tjetri syresh, i identifikuar si "Malazezi", i ishte ofruar lirimi i parakohshëm nga burgu, me kusht që ai të shkonte të luftonte në Kosovë. Ai pranoi, dhe ndër njëzet e pesë të burgosur, gjashtëmbëdhjetë u bashkuan me të. Një i tretë i vetquajtur "Jacques" tha se njësia e tij vepronte mbi bazën e informacioneve të ushtrisë, të policisë, të serbëve lokalë dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë. [112]

Një artikull tjetër në shtypin amerikan, i bazuar në më shumë se një duzinë intervista me pjesëtarë të forcave paraushtarake, bënte me dije se njësitet vepronin me udhërat e Sigurimit të Shtetit, të MUP-it dhe të VJ-së. Si shpërblim për shërbimet e tyre, paraushtarakëve u lejohej të mbanin dhjetë përqind të asaj që ata vidhnin. Disa prej luftëtarëve i treguan gazetarit dokumenta zyrtarë të MUP-it, në të cilat jepeshin udhëzime për transportin e plaçkës së vjedhur nga Kosova në Serbi. Disa prej tyre mohuan urdhërat për të përdhunuar gratë, por pretenduan se komandantët e tyre nuk kishin bërë asgjë për t'i ndaluar. [113]

"American RadioWorks" prodhoi një seri programesh radiofonike mbi krimet e luftës në zonën e Pejës, veçantërisht mbi masakrën e kryer në fshatin Qyshk. Reporterët e kësaj radioje folën me pjesëtarët e milicisë serbe, dhe disa prej tyre pranuan të kenë marrë pjesë në këtë masakër. Një person, i identifikuar me emrin "Marko", tha se ai kish qënë i liruar nga një burg serb për të luftuar në Kosovë përkrah Tigrave të Arkanit. Ai tha:

Zaklinjem se

čašću roda i plemena i presvijetlog imen
srpskog,da ću se boriti protiv neprijate
tog naroda sve dok ne ostvarimo ovaj sv
cilj - oslobođenje Kosova -na bilo koj
sredstva i način.

Bez pogovora ću izvršavati sv
zadatke koje dobijem od pokreta,bilo i,b
cijenu života, jer taj život od ovog da
pripada SRP-u i srpskom narodu.

Zaklinjem se u svoj svetoj
crkvi, pred sjenima slavnih srpskih vit
sova i neka me natra mlijeko srpske sko
isdam i prekršim ovaj zavjet,neka mi sv
Bog i želja vjekova.

SLOBOD. ILI SMRT!!!

© HUMAN RIGHTS WATCH

Kjo formulë betimi u gjet pas luftës në Pejë. Nuk dihet, nëse "SRP" i referohet një grupi politik, një njësie paraushtarake, milicisë lokale apo ndonjë organizate tjetër.

BETOHEM

Në nderin e familjes e të fisit tim dhe në shenjtërinë e emrit të serbëve që do të luftoj kundër armikut të popullit tim, deri sa të arrijmë qëllimin tonë të shenjtë – çlirimin e Kosmet-it [Kosovës] – me çdo rrugë e çdo mjet.

Do të kryej pa kushte deri në një të gjitha detyrat që lëvizja do të më ngarkojë mua, edhe me çmimin e jetës sime, sepse jeta ime që nga kjo ditë i përket "SRP"-së e popullit serb.

E bëj këtë betim në kishën e shenjtë, nën hijen e kalorësve të famshëm serbë, dhe harram më qoftë qumështi i nënës serbe, nëse unë e tradhëtoj apo e dhunoj këtë betim. Zoti e dëshira e shekujve le të më gjykojnë mua!

LIRI A VDEKJE!!!

Formalisht, Arkani nuk erdhi në burg. Erdhi një prej njerëzve të tij, i cili kish një listë të burgosurish dhe dosjet e tyre. Të rekrutuarit nga burgu duhet të kishin prerjen e duhur. Ai më kërkoi nëse isha gati të shkoja në Kosovë ...dhe në këtë mes nuk kishim të bënim me vendimin e gjykatësit apo të drejtorit të burgut. Ishte vendimi i Arkanit. Ky i fundit bënte ligjin në Serbi.

Ne do të merrnim një listë me emra njerëzish, dhe secilin syresh ne duhet ta kapnim gjallë apo vdekur. Mua më ish ngarkuar detyra të arrestoja njerëz, dhe kisha lejen t'i vrisja ata, nëse do të ish e nevojshme. Mjaft të shohësh një djalosh, sjelljen e tij, dhe nëse ajo s'të pëlqen, mund ta vrasësh atë. Dua të them, nuk na kërkohej të shkonim të gjenim dikë midis atyre që shkaktojnë trazira ....

Ne bashkëvepronim shumë me njerëz të caktuar në radhët e MUP-it. Ishte një lloj këshilli krizash, dhe një pjesë informatash vinin prej andej. Listat erdhën të gjitha nga policia, autoritetet lokale, sepse ata e kishin mbledhur këtë lloj informacioni për vite e vite me radhë. Cilët ishin të pasurit, ku jetonin ata, cilët ishin të rëndësishmit, ku jetonin ata. Dhe ne kishim spiunë lokalë, të cilët na ndihmonin në operacione. Ne mund të përdornim banorët e një fshati, të cilët na shërbenin si kallauzë, na tregonin ku, si, pse, dhe ata, nëse ishin serbë, përfitonin kështu një dorë të mirë parásh. Ne kishim edhe spiunë shqiptarë. Magjypë gjithashtu. [114]

Në disa vende, serbët lokalë ishin pjesëmarrës në fushatën e "spastrimit", ndonëse kjo nuk mund të thuhet kurrsesi për gjithë popullsinë serbe të Kosovës. Një pjesë e serbëve lokalë ishin rezervistë të policisë, por ishin formuar gjithashtu edhe grupet e mbrojtjes së fshatrave. Disa fshatra serbësh të Kosovës i ishin ankuar qeverisë serbe në vitin 1998, ngaqë ishin të pambrojtur nga shqiptarët e armatosur. Qeveria ju përgjigj kësaj ankese, duke i armatosur këta individë e grupe. Serbët e armatosur lokalë kishin në dukje një lloj koordinimi me policinë, ndonëse disa prej tyre u bashkuan me forcat paraushtarake.

Megjithëse një pjesë e madhe e serbëve lokalë dalloheshin për një sjellje të dhunshme, nuk mungonin as ata që u gjendeshin pranë shqiptarëve. Rreth Pejës e Rrahovecit, për shembull, veçantërisht në afërsi të fshatit Hocë e Madhe (i banuar tërësisht nga serbë), serbë të armatosur morën pjesë në plaçkitjen e shkatërrimin e pronave private, si dhe në ekzekutime.

Sidoqoftë, veprimtaria më e zakonshme kriminale e serbëve lokalë ishte

plaçkitja e shtëpive të shqiptarëve, dhe këtë e bënin, pasi forcat e sigurimit e kishin boshatisur një zonë të caktuar dhe pasi popullsia ose ishte dëbuar ose kishte ikur. Ndoshta, dëshmia më domethënëse e plaçkitjes vjen nga ditari i një gruaje serbe nga Peja, e cila kish hedhur në letër vëzhgimet e saj gjatë luftës. Ditari, i gjetur pas lufte nga gazetarët e huaj, thotë:

> Thuhet se këta (plaçkitësit) janë patriotë, të cilët i dhunojnë shtëpitë e "shqiptarve" (fjalë përbuzëse për të treguar shqiptarët), dhe se ai që nuk vepron kështu qënka një tradhëtar. Le të më quajnë tradhëtare, por unë nuk do t'i njollos duart e mija. Unë kam frikë për të ardhshmen e fëmijëve, prindërit e të cilëve i mësojnë ata si t'i vjedhin, si t'i plaçkisin e si t'i djegin shtëpitë. Ç'do të dalë në dritë nga ky soj njerëzish në të ardhshmen? Çfarë kujtimesh do të ruajnë ata për fëmijërinë e tyre? Ata nuk luajnë futboll apo me patina. Loja e tyre konsiston në dhunimin e shtëpive, në grabitjen e asaj që mund të grabitet, dhe më në fund, me ndihmën e një litër vajguri e të një fije shkrepseje, në shkatërrimin e gjithçkaje.

Sipas shumë shqiptarëve, pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës, morën pjesë gjithashtu në krime, dhe kjo përbën përligjjen që i është bërë rëndom dëbimit të tyre nga Kosova e pas luftës. (Shih abuzimet pas 12 qeshorit 1999). Në të vërtetë, dëshmitë e mbledhura në këtë raport përfshijnë përshkrimin e shumë rasteve, në të cilët romët lokalë bashkëpunuan me policinë, ushtrinë apo paraushtarakët, qoftë duke shërbyer si kallauzë për ta, qoftë duke marrë pjesë aktivisht në kryerjen e krimeve. Por një pjesë e madhe e romëve ishin gjithashtu viktima të kësaj ofensive, dhe është katërcipërisht e gabuar të fajësosh komunitetin në tërësi për krimet gjatë luftës. Një numër i konsiderueshëm romësh u dëbuan drejt Shqipërisë e Maqedonisë. Të tjerë u vranë nga forcat e sigurimit qeveritar. Disa romë u detyruan nga forcat e sigurimit qeveritar të punonin, si për shembull grupi në Gjakovë që u urdhërua të ngrinte e të varroste trupat në qytet. Një raport i Qendrës së Ligjeve Humanitare thotë: "Policia serbe e autoritetet lokale i shtrënguan civilët romë, përfshirë edhe minorenët, të kallnin në varr trupat e civilëve shqiptarë dhe të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të hapnin transhe për ushtarët e të plaçkisnin e të shkatërronin pronat e shqiptarëve. [116]

Serbët e romët lokalë, të cilët kryen krime apo bashkëpunuan me forcat e sigurimit gjatë luftës, sipas shumë gjasave e kanë lënë Kosovën në

fillim të qershorit 1999, kur e lanë edhe forcat e tjera. Ata që mbetën, vepruan kështu sepse, ose besonin në pafajësinë e tyre, ose ishin tepër të moshuar e të varfër e nuk mund të lëviznin. Ata u përballën me kushtet tej mase të vështira në Kosovën e pas luftës, ku nuk mungonin dhuna, rrëmbimet dhe vrasjet (Shih abuzimet pas 12 qershorit 1999)

Së fundi, ka shumë raporte që dëshmojnë mbi pjesëmarrjen e të huajve në krah të forcave jugosllave e serbe, ashtu si edhe, në një masë më të vogël, në krah të UÇK-së. Nuk dihet nëse ndonjë prej këtyre individëve është paguar për shërbimet e tij. Human Rights Watch intervistoi më shumë se një duzinë dëshmitarësh, të cilët pohonin të kishin parë luftëtarë rusë së bashku me forcat serbe, ndonëse nuk ka ndonjë të dhënë që flet për përfshirjen e qeverisë ruse. Disa raporte të medias ndërkombëtare përshkruajnë gjithashtu praninë e luftëtarëve të huaj, jo vetëm nga Rusia, por edhe nga vende të tjera. [117] Në një artikull të një gazete izraeliane, Tel Aviv Yedi'ot Aharonot, ngrihej pretendimi se nja dyzet qytetarë izraelitë u bashkuan me "njësitë serbe të vullnetarëve të huaj", shumica e të cilëve vinin prej ish Bashkimit Sovjetik ose ishin veteranë të luftrave në Afganistan e në Çeçeni. [118] Një shtetas danez, i cili shpalli se kish luftuar në krah të forcave serbe në Kosovë u arrestua në vendin e vet, pasi i tregoi një gazete në Danimarkë, Extra Bladet, që ai kish marrë pjesë në "spastrimin etnik". Ai u lëshua më vonë për mungesë faktesh.

Zinxhiri i komandave dhe ndarja e përgjegjësive

Zinxhiri i komandave i ushtrisë jugosllave është publik. Siç ka rezultuar në këtë kapitull, komandantët lokalë në Kosovë u raportonin komandantëve të Korpusit të Prishtinës, të drejtuar nga major gjeneral Vladimir Llazareviç. Korpusi i Prishtinës i raportonte armatës së tretë, të komanduar nga kolonel gjeneral Nebojsha Pavkoviç, i cili nga ana e vet i raportonte Shtabit të Përgjithshëm, të komanduar nga gjeneral Dragoljub Ojdaniç. Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave ishte Presidenti Jugosllav Sllobodan Milosheviç, i cili drejtonte Këshilllin e Lartë të Mbrojtjes.

Zinxhiri i komandave të MUP-it është shumë më pak i qartë. Ndërsa është prezantuar në këtë kapitull një pjesë e madhe e hierarkisë de jure, gjenden ende hendeqe (të çara), të tilla si marëdhëniet midis sigurimit të

shtetit dhe forcave paraushtarake dhe roli i formacioneve të ndryshme të MUP-it. Ndoshta ka patur struktura shtesë komandash e kontrollesh brenda MUP-it e VJ-së.

Përveç kësaj, strukturat de jure të MUP-it nuk reflektojnë domosdoshmërisht realitetin de facto. Roli i Ministrit Serb të Punëve të Brendshme, Vllajko Stijiljkoviç, për shembull, është konsideruar nga vëzhguesit serbë e të huaj të strukturave të sigurimit serb, se ka qënë i dorës së dytë në raport me rolin e presidentit Milosheviç e ndoshta me atë të zv.kryeministrit jugosllav Nikolla Shahinoviç, i konsideruar nga shumë vetë si njeriu-kyç i Milosheviçit në Kosovë. [120] Linja të ndryshme komande e kontrolli midis sigurimit të shtetit, sigurimit publik, forcave paraushtarake e Presidentit, si dhe brenda tyre, janë ende të panjohura. Së fundi, metoda e struktura e bashkëpunimit midis MUP-it e VJ-së mbeten gjithashtu të paqarta, përfshirë këtu një qëndër të mundshme koordinimi në Prishtinë.

Pavarësisht nga kjo, rrethanat kundër lidershipit serb e jugosllav janë bindëse. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës është i qartë, kur bazohet tek përgjegjësia individuale për krimin përsa u takon liderëve, të cilët organizuan apo lejuan kryerjen e krimeve serioze. Artikulli 7 i Statutit thotë:

1. Një person që ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer apo është fajtor me të tjerët në planifikimin, përgatitjen apo ekzekutimin e një krimi, që i referohet artikujve 2 e 5 të këtij statuti, do të përgjigjet individualisht për krimin.

2. Pozicioni zyrtar i një personi të akuzuar, qoftë si kreu i shtetit apo i qeverisë, qoftë si një zyrtar përgjegjës i qeverisë, as nuk e shkarkon këtë person nga përgjegjësia për krimin, as nuk është arsye për një dënim më të butë.

Nikolla Shahinoviç, zv. Kryeministër i Jugosllavisë dhe zyrtar i lartë i Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) në një konferencë për shtyp në Beograd gjatë luftës në Kosovë, më 13 tetor 2000. Shahinoviç konsiderohej në masë si përfaqësues i Millosheviçit në Kosovë, në 27 maj 1999 akuzohet nga gjykata për krimet e luftës.

FOTO AFP

3. Kur aktet, të cilat i referohen artikujve 2 e 5 të statutit në fjalë, janë kryer nga një vartës, ky fakt nuk e shkarkon eprorin e tij nga përgjegjësia për krimin. Nëse eprori ka ditur apo ka patur arsye të dijë, që vartësi ka qënë duke kryer akte të tilla apo i ka kryer ato, dhe nuk ka marrë masat e nevojshme e të arsyeshme për parandalimin e akteve të tilla apo për ndëshkimin e autorëve, ai është përgjegjës për krimin.

4. Fakti që një person i akuzuar ka vepruar në zbatim të urdhërave të qeverisë apo të eprorit, nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia për krimin, por mund të merret në konsideratë zbutja e dënimit, nëse Gjykata Ndërkombëtare është e mendimit se kështu çohet drejtësia në vend. [121]

Me fjalë të tjera, edhe autori i drejtëpërdrejtë i një krimi, edhe liderët politikë apo ushtarakë, që kanë urdhëruar krimin, mund të ndiqen penalisht. Paragrafi i tretë shton se një epror jep llogari për krimin e kryer, nëse ai ose ajo nuk kanë marrë masa për të parandaluar akte të tilla apo nuk kanë ndëshkuar autorët.

Shtrirja dhe natyra sistematike e krimeve në Kosovë e bëjnë krejt të papranueshëm versionin, sipas të cilit udhëheqja serbe e jugosllave nuk kishin dijeni mbi krimet që po kryheshin, sidoqë ata këmbëngulnin në këtë version. Deklarata të shumta të ushtrisë apo qeverisë serbe e jugosllave demonstrojnë që udhëheqësit më të rëndësishëm ishin të informuar për situatën e sigurimit në Kosovë. Raportime të publikuara e të shpërndara nga media e nga organizata joqeveritare, përfshirë Human Rights Watch, dokumentonin në mënyrë të përsëritur abuzimet e forcave serbe e jugosllave.

Në fillim të luftës, më 26 mars 1999, për shembull, presidenti Milosheviç u takua me zyrtarë të lartë të ushtrisë e policisë, përfshirë Zoran Sokoloviç, ministër i Punëve të Brendshme i Jugosllavisë, Vllajko

Presidenti i Serbisë Milan Milutinoviç gjatë një konference për shtyp në Paris më 18 mars 1999. Milutinoviç u akuzua më 27 maj 1999 nga gjykata e krimeve të luftës për krime në Kosovë.

FOTO AFP

Stojiljkoviç, ministër i Punëve të Brendshme i Serbisë, Kolonel Gjeneral Vlastimir Gjorgjeviç dhe Radomir Markoviç, respektivisht shefa të sigurimit publik e të sigurimit të shtetit, si dhe Kolonel Gjeneral Geza Farkas, shefi i kundërspiunazhit të ushtrisë jugosllave. Në një deklaratë të dalë nga ky takim, qeveria tha:

"Çdo gjë atje ishte e orkestruar".

-Gjen. Nebojsha Pavkoviç

> Zyrtarët e sigurimit e të punëve të brendshme bënë me dije presidentin Milosheviç se të gjitha organet e shërbimit si dhe shërbimet e sigurimit po funksionojnë shumë mirë, dhe pjesëtarët e këtyre forcave po kryejnë detyrat e nevojshme në mënyrë efektive, të përgjegjshme e me profesionalizëm të lartë .... Eshtë vlerësuar që morali, ndërgjegja patriotike dhe gatishmëria e të gjithë efektivit të organeve të Punëve të Brendshme janë të nivelit më të lartë. [123]

Më 4 maj 1999, presidenti Milosheviç u takua midis të tjerëve edhe me gjeneral Ojdaniç, gjeneral Pavkoviç, major gjeneral Sreten Lukiç dhe presidentin serb Milutinoviç. Deklarata e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që doli pas takimit thosh: "U arrit në përfundimin që të gjitha detyrat që kishin të bënin me mbrojtjen e vendit, luftën kundër terrorizmit dhe vendosjen e sigurisë së përgjithshme në Kosovë e Metohi janë realizuar me sukses." [124]

Në një intervistë dhënë televizionit amerikan Frontline, në një prej transmetimeve show-news të pas luftës, gjeneralit Pavkoviç iu kërkua nëse gjatë bombardimeve të NATO-s ishte takuar me shefat e tij politikë, fjala vjen me presidentin Milosheviç. Më poshtë po japim shkëmbimin e disa batutave:

PAVKOVIÇ: Sigurisht, kam qënë i pranishëm si anëtar i shtabit të oficerëve madhorë në shumë raste, dhe unë mund t'ju them juve se vihej re ndjenja e bashkimit, si ndër anëtarët e shtabit, ashtu edhe në popull.

FRONTLINE: Ç'përshtypje ju jepte Milosheviçi?

PAVKOVIÇ: Ai është komandanti i përgjithshëm, dhe si i tillë, ai e njeh klimën politike e ushtarake shumë mirë. Ai na bënte optimistë, jo vetëm ne ushtarakëve, por edhe popullin.

FRONTLINE: Morët pjesë ju në planifikimin ushtarak të dëbimit të popullsisë nga Kosova?

PAVKOVIÇ: Jo, por unë isha në kontakt të vazhdueshëm me skuadrën

> që e bëri këtë planifikim. Asnjë vendim nuk mund të merrej pa pjesëmarrjen tonë. [125]

Përveç kësaj, të gjitha dëshmitë tregojnë se, me ndonjë përjashtim tek-tuk, njësitë policore, ushtarake e paraushtarake ishin nën një kontroll të rreptë, dhe vepronin vetëm me urdhëra të shkruara nga komandantët e tyre. Fakti që të gjitha forcat e sigurimit u tërhoqën nga Kosova në mënyrë të komanduar pasi u nënshkrua më 10 qershor Marrëveshja Teknike Ushtarake me NATO-n, është një dëshmi e mëtejshme që forcat ishin nën komandën e rreptë e efektive të eprorëve të tyre. Me të vërtetë, në një intervistë dhënë më 16 janar 2001 radios B92 së Beogradit, gjeneral Pavkoviç tha duke ju referuar operacioneve ushtarake, se "çdo gjë atje ishte e orkestruar". [126]

Ka gjithashtu dëshmi që provojnë, se postat e policisë lokale funksiononin gjatë luftës, duke iu kundërvënë kështu pretendimeve se strukturat e qeverisë ishin shpërbërë. Në Pejë, për shembull, policia mbajti regjistrime të kujdesshme të vdekjeve në qytet, duke ia atribuar shumicën e tyre "bombave të NATO-s" ose "akteve terroriste" të kryera nga UÇK-ja. [127] Dëshmitarë në pjesë të ndryshme të Kosovës i kanë treguar "Human Rights Watch"-it se ata kishin parë hetues të policisë që inspektonin skenat e krimit, fjala vjen në fshatin e Studimes pas vrasjes së familjes Gërxhalliu më 31 maj (shih komunën e Vushtrrisë)

Udhëheqja serbe e jugosllave duhet të ketë patur dijeni gjithashtu për aksionet e forcave paraushtarake që vepronin në Kosovë. Të paktën, udhëheqja kish dijeni për namin e këtyre forcave për shkak të brutalitetit të demonstruar në Kroaci e Bosnjë. Pavarësisht nga ky fakt, autoritetet, jo vetëm dislokuan paraushtarakët, por edhe i lejuan ata të vepronin në Kosovë, pa marrë ndonjë masë për të parandaluar krimet që kryheshin atje. Me këtë nam, të dërgoje një forcë paraushtarake nën urdhërat e disa liderve të caktuar është njësoj si të biesh dakord me dhunën e tepërt pa qënë nevoja të japësh një komandë për këtë gjë.

Kjo u pasqyrua në një intervistë në faqen 84 të një të vetshpalluri anëtar i "Djemve të Frenkit", dhënë radios amerikane *RadioWorks*. Në këtë intervistë, personi i identifikuar me emrin "Milosh", thotë:

> Ne (djemtë e Frenkit) ishim një njësi speciale. Por përsa u takon grupeve paraushtarake, unë i quaj ato banda. Çdo gjë poshtë policisë, ushtrisë

e nesh në zinxhirin hierarkik, ishte një bandë. Megjithatë, nuk është se nuk kishte kontroll. Këto grupe kishin zonat e tyre të veprimit. Ato lejoheshin të bënin atë që donin. Ato ishin vënë qëllimisht në vende të caktuara, dhe u ish thënë të bënin çfarë të donin në mënyrë që të realizonin detyrat e ngarkuara. Ish detyra e tyre të vrisnin, të përdhunonin e të pëlqenin çfarë ata pëlqenin. [128]

Me shumë pak përjashtime në nivelet e ulëta, pati disa raste, në të cilat qeveria e Milosheviçit ndëshkoi forcat e sigurimit për krime serioze, apo i vuri ata nën ndjekje penale. [129] Nga ana tjetër, periudha e pasluftës solli me qindra gradime e dekorime të personelit të policisë e ushtrisë, që kish shërbyer në Kosovë, përfshirë disa prej zyrtarëve të lartë. Një listë më e plotë e gradimeve e dekorimeve gjendet në shtesën e këtij kapitulli. Disa prej individëve më të shquar, të cilët u graduan për atë që bënë në Kosovë, janë:

- Dragoljub Ojdaniç, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, i graduar si gjeneral (katër yje), dhe menjëherë më pas, si Ministër i Mbrojtjes së Jugosllavisë (pozicion që ai e mbajti deri në tetor 2000).
- Nebojsha Pavkoviç, komandant i armatës së tretë, i graduar si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.
- Major Gjeneral Vladimir Llazareviç (me një yll), komandant i Korpusit të Prishtinës, i graduar si major gjeneral (me dy yje).
- Kolonel Boxhidar Deliç, komandant i Brigadës së 549-të të motorrizuar, i graduar si gjeneral me një yll.
- Kolonel Radojko Stefanoviç, komandant i Brigadës së 52-të të Artilerisë së Kombinuar, i graduar si Brigadier Gjeneral.
- Urdhëri i Flamurit të Luftës iu dha Brigadës së 243-të të mekanizuar, Brigadës së 211-të të korracuar dhe Brigadës së 15-të të korracuar.
- Presidenti Milosheviç i dorëzoi Urdhërin e Lirisë Gjeneralit të Ushtrisë Dragoljub Ojdaniç dhe Kolonel Gjeneral Nebojsha Pavkoviç, komandant i armatës së tretë.
- Presidenti Milosheviç i dorëzoi Urdhërin e Heroit Kombëtar këtyre brigadave të Ushtrisë: brigadës së 125-të të motorizuar (e marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Dragan Zivanoviç), brigadës së 549-të të motorrizuar (e marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Bozhidar Deliç), dhe brigadës së 37-të të motorrizuar (e marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Ljubisha Dikoviç).

- Urdhëri i Flamurit Jugosllav i Shkallës së parë iu dha kolonel gjeneral Vlastimir S. Gjorgjeviç, kreu i sigurimit publik të MUP-it, Obrad M. Stevanoviçit, kreu u forcave speciale të policisë, dhe Sreten Lukiçit, kreu u forcave të MUP-it në Kosovë.
- Obrad Stevanoviç dhe Sreten Lukiç u graduan major gjeneralë në polici.
- Ndihmësministrat e Punëve të Brendshme Nikola Curçiç, Stojan Misiç dhe Petar Zekoviç, u graduan gjithashtu.
- Urdhëri i Flamurit Jugosllav të Shkallës së Tretë iu dha kolonel Zhivko Trajkoviçit, komandant i SAJ-it.
- Urdhëri i Meritave për Çështje të Mbrojtjes e të Sigurimit i shkallës së Parë iu dha kolonel Dragutin Adamoviçit, SUP-i Gjakovës; kolonel Dushan B. Gavraniçit, SUP-i i Gjilanit; kolonel Gradimir R. Zekavica-s, SUP-i i Prizrenit; lejtënant kolonel Milan S. Xhuriçiçit, SUP-i i Prizrenit; dhe major Milenko M. Bozoviçit, komandant i policisë së Skënderajt.
- Presidenti Milosheviç dekoroi me Urdhërin e Flamurit Jugosllav Zoran Andjelkoviçin, president i Këshillit të Përkohshëm Ekzekutiv për Kosovën e Metohinë, Nikolla Shahinoviçin, zëvendës kryeministrin e Jugosllavisë, kolonel gjeneral Vlastimir Gjorgjeviçin, major gjeneral Obrad Stevanoviçin dhe major gjeneral Sreten Lukiçin.
- Dekorata e Flamurit Jugosllav të Klasit të Parë iu dha Vllajko Stojiljkoviçit, ministër serb i Punëve të Brendshme, dhe kolonel gjeneral Radomir Markoviçit, ndihmës ministër dhe shef i sigurimit të Shtetit.

Përveç këtyre gradimeve, deklaratat publike të Milosheviçit, në kohën që ishte President e më pas, çmonin forcat e sigurimit në mënyrë të përsëritur për aksionet e tyre në Kosovë, pa përmendur në asnjë rast krimet që u kryen. Më 25 nëntor 2000, në një kongres të jashtëzakonshëm të Partisë Socialiste Serbe, Milosheviç deklaroi se katër liderë të tjerë serbë e jugosllavë të paditur nga Gjykata për Krimet e Luftës, ishin "heronj kombëtarë". [130] Më 13 maj 1999, e njohur si "dita e sigurisë" në Serbi, Presidenti i atëhershëm Milosheviç e zgjeroi gjeografinë e përgëzimeve në adresë të të gjitha forcave të Sigurimit të vendit:

> Ju keni arritur suksese të mëdha në shtypjen e lëvizjes separatiste dhe bandave të saj terroriste në Kosovë e Metohi, e cila pati mbështetjen e

fuqive të huaja, që kryen gjithashtu mbi vendin tonë një agresion kriminal. Shumë pjesëtarë të institucioneve e shërbimeve të sigurimit dhanë jetën trimërisht në atë betejë dhe ata përbëjnë një shembull ndriçues të kurajos e ndershmërisë ndaj popullit e Atdheut të tyre.

Me ndjenjën tuaj të lartë të patriotizmit, ndershmërisë e profesionalizmit, ju keni dëmtuar forcat armike dhe i penguat ato të cënonin fuqinë e mbrojtjes sonë.

Duke ju përgëzuar në këtë ditë feste, dua t'ju shpreh bindjen time, që ju do të vazhdoni, ashtu si deri tani, me nder, me profesionalizëm, dhe me shpirtin e traditave liridashëse të popullit tonë, të kryeni detyrën në mbrojtje të sovranitetit, intergritetit territorial, pavarësisë e rendit kushtetues të Republikës Federale të Jugosllavisë. [131]

Pas luftës, u bë një farë diskutimi brenda Serbisë për krimet e kryera nga forcat e qeverisë, megjithëse kjo po ndryshon me rënien e qeverisë së Milosheviçit në tetor të vitit 2000. Dy persona, të cilët tentuan të paraqisnin çështjen në publik, ndërsa Milosheviçi ishte akoma në pushtet, u përballën me kundërveprimin e qeverisë. Më 26 qershor të vitit 2000, një gazetar i Agjencisë France Presse, i gazetës *Danas*, dhe i Institutit për Raportime të Luftës e të Paqes, Mirosllav Filipoviç, u dënua me shtatë vjet burg nga një gjykatë ushtarake për spiunazh dhe për përhapjen e informacioneve të rreme. Ai u lirua më 10 tetor. Filipoviç ka shkruar për rolin e forcave qeveritare në abuzimet kundër shqiptarëve të Kosovës. Në korrik të vitit 2000, një veprimtare e vendosur dhe e respektuar për të drejtat e njeriut, Natasha Kandiç, u kërcënua nga Ushtria Jugosllave me veprimin e ligjit, pasi ajo kundërshtoi dënimin që iu dha Filipoviçit dhe foli troç rreth "gjeneralëve të tmerrit (të VJ-së) që dërguan rekrutë të rinj të ushtronin dhunë në Kosovë". [132]

Megjithëse procesi i analizës së të shkuarës kërkon kohë për t'u bërë, disa hapa premtues janë hedhur brenda Serbisë që nga rënia e Milosheviçit. Media lokale ka filluar të raportojë më hapur – pa frikën e ndonjë ndëshkimi - mbi krimet e forcave serbe, një komision për hetimin e së vërtetës i ngritur nga presidenti jugosllav Vojisllav Koshtunica ka filluar të veprojë, ndërsa VJ-ja ka nisur proçedime legale kundër më shumë se 150 ushtarëve të VJ-së për aksionet e tyre në Kosovë. Rasti më i qartë ish, kur policia serbe arrestoi Sllobodan Milosheviçin me akuzën për korrupsion. Më 28 qershor ai u transferua në Gjykatën e Krimeve të Luftës në Hagë.

STRUKTURA E STRATEGJIA E UÇK-SË

Që nga Lufta e Dytë Botërore, grupe të vogla shqiptarësh militantë kanë kërkuar pavarësinë e Kosovës nga Jugosllavia, ndonëse veprimtaria e ndikimi i tyre kanë qënë minimal. Disa nga këto organizata, si p.sh. Lëvizja Popullore për Pavarësinë e Kosovës dhe më vonë Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, u fuqizuan në vitet '80-të, sidomos pas represionit qeveritar të vitit 1981. Një mbështetje për këto lëvizje ishin shqiptarët e Kosovës që jetonin jashtë vendit, ashtu si edhe aktivitetet ilegale të shqiptarëve të Kosovës në Ballkan e në vende perëndimore.

Gjatë gjithë viteve '90-të, shumica e popullsisë ndoqi politikën paqësore të Ibrahim Rugovës, por elementë përkrahës të militantëve ishin aktivë në disa zona, sidomos në Drenicë. Ndërsa represioni në Kosovë vazhdonte, lëvizja gradualisht filloi të zgjerohej dhe, siç e kemi bërë të njohur më sipër, grupet fillestare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po sulmonin më

Konferencë për shtyp e UÇK-së në Kosovë më 13 mars 1999. Të ulur janë Fatmir Lamaj (majtas), anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, Hashim Thaçi (qendër), anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe përfaqësues politik i UÇK-së, dhe Sulejman Selimi (djathtas), anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe komandant i trupave ushtarake. Një muaj më vonë, Selimi u zëvendësua nga Agim Çeku, komandant i përgjithshëm në trupat kroate.

FOTO AFP

1996 postat policore në Kosovë. Rrjedhja e armëve nga Shqipëria më 1997, pasi qeveria e atjeshme ra, e ndihmoi shumë kryengritjen që po lindte.

Një pikë kthese vendimtare erdhi me represionin policor në Drenicë në shkurt e mars 1998, në të cilën u vranë më shumë se tetëdhjetë civilë. Brutaliteti i qeverisë serbe radikalizoi komunitetin shqiptar. Pas kësaj, shumë fshatarë u rreshtuan me UÇK-në, së pari për shkak të zhgënjimit prej politikës jo të dhunshme të Rugovës, e cila rezultoi joefektive, së dyti sepse e panë UÇK-në mjetin e tyre të vetëm për mbrojtje. Në të njëjtën kohë, shumë fshatra në mënyrë të qartë nuk inkurajuan praninë e grupeve të armatosura, ngaqë trembeshin se kjo do të provokonte përgjigjen qeveritare, siç ndodhte rëndom.

Gjatë gjithë vitit 1998, UÇK-ja ishte thjesht një grumbull i paorganizuar fshatarësh të paarmatosur, shpesh të ngritura rreth një strukture familjare, pa një zinxhir të qartë komandash. Organizimi dominohej nga krahinarizmi i fuqishëm, gjë që rezultoi evidente në fraksionimin e kryengritjes pas luftës. Zonat operacionale ngritën fondet në pará, me anë të të cilave blinin armët e tyre.

Kjo situatë ndryshoi në mënyrë graduale gjatë vitit, ndërsa UÇK-ja siguronte një furnizim të qëndrueshëm me armë dhe organizonte vetveten mbi bazën e një strukture më të centralizuar. [133] Shqiptarët me përvojë nga Ushtria Jugosllave apo paraardhësja e saj në ish-Jugosllavinë, Ushtria Kombëtare Jugosllave (Jugoslovenska Narodna Armija, ose JNA), ngadalë-ngadalë iu bashkangjitën kryengritjes. Kontaktet me qeveritë perëndimore, kryesisht nëpërmjet Misionit të Vëzhgimit Diplomatik në Kosovë (MVDK) u fuqizuan. Periudha e pushimit të zjarrit nga dhjetori 1998 deri në mars 1999 u përdor për të fuqizuar komandën qendrore dhe për të riorganizuar operacionet. Qysh prej marsit 1999, UÇK-ja u bë një forcë kryengritëse më mirë e organizuar, megjithëse me personalitete të fuqishme në zona të ndryshme, të cilët nuk binin dakord gjithmonë me njëri-tjetrin. Një forcë e policisë ushtarake dhe gjykatat ushtarake u institucionalizuan më me vendosmëri në favor të burgosjes së kollajtë, dhe krahas kësaj, edhe struktura politike civile të cilat shpallën edhe dekrete në zonat nën kontrollin e UÇK-së.

Në vitin 1999, përfaqësuesi kryesor politik i UÇK-së ishte Hashim Thaçi (i njohur edhe si Gjarpëri), i cili përfaqësonte kryengritjen në negociatatat politike, siç ishin ato të Konferencës së Rambouillet-së në shkurt 1999. Në prill të këtij viti, Agim Çeku, ish brigadier gjeneral në Ushtrinë Kroate i lidhur

ngushtë me qeverinë e SHBA-ve dhe me ushtarakë amerikanë, u emërua kreu i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, dhe realisht ai u bë kryekomandanti ushtarak. [134] Ai zëvendësoi Sulejman Selimin (i njohur edhe si Sulltani). Të dy, Çeku e Thaçi ishin në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, organi kryesor vendimmarrës i përbërë nga tetëmbëdhjetë vetë, së bashku me anëtarë të tjerë të rëndësishëm të kryengritjes.

Nuk njihen raste që ushtarë të UÇK-së të jenë ndëshkuar për kryerje abuzimesh kundër civilëve apo forcave të qeverisë që nuk ishin më pjesë aktive në konflikt.

UÇK-ja ishte e organizuar në shtatë zona operative, dhe secila prej tyre kish komandantin e saj rajonal dhe shefin e Shtabit: Drenica (komunat Gllogofc, Skënderaj, Malishevë e Klinë), Shala (Mitrovica), Dukagjini (komunat Pejë, Prizren, Deçan e Gjakovë), Llapi (Podujeva), Nerodine (Ferizaj), Kaçanik e Pashtrik. Më të shquarit mes komandantëve rajonalë ishin Ramush Haradinaj në zonën e Dukagjinit, Ekrem Rexha (i njohur edhe si komandant Drini) në zonën e Pashtrikut, [136] Rustem Mustafa (i njohur edhe si Remi) në zonën e Llapit, dhe Sami Lushtaku në Drenicë. Secili rajon kish brigada e kompani, normalisht të ngritura mbi bazë fshati fshati apo një numri fshatrash. [137] Rexhep Selimi ishte kreu i shërbimit sekret të UÇK-së, që më vonë u bë i njohur si Shërbimi Informativ i Kosovës (SHIK).

Për shkak të ndarjeve rajonale brenda UÇK-së, ishte shpesh e vështirë të dallohej një zinxhir qëndror komandash. Madje, edhe brenda zonave operative, nuk ishte gjithmonë e qartë se sa kontroll ushtronin komandantë të ndryshëm mbi trupat e tyre.

Nga ana tjetër, gjatë rrjedhës së vitit 1998, struktura komandash me bazë rajonale apo qëndrore ishin gjithmonë e më shumë të dallueshme. Komandantë lokalë filluan aksione ushtarake dhe nxjerrjen e dekreteve në zonat, brenda të cilave ata ndiheshin përgjegjës. Policia e gjyqet ushtarake po funksiononin, ndonëse pa ndonjë rregull, në zonat nën kontrollin e UÇK-së. Shtabi i Përgjithshëm koordinoi aksione ushtarake dhe veprimtari politike në të gjithë Kosovën, dhe dëshmoi se ish një strukturë, e cila mundësonte transmetimin e vendimeve deri tek luftëtarët. Ai gjithashtu koordinoi mbështetje logjistike e financiare nga Shqipëria dhe nga diaspora shqiptare në Europën perëndimore e në Shtetet e Bashkuara.

Ndonëse shpesh hasen shembuj që dëshmojnë të kundërtën, nga fundi i vitit 1998 e fillimi i vitit 1999 luftëtarët e UÇK-së treguan disiplinë, plotësuan efektivat në pikat e kontrollit, duke bërë verifikimin e kartave

të identifikimit, dhe duke iu bindur urdhërave të komandantëve të tyre. Një zyrë e UÇK-së në Prishtinë (e lejuar nga autoritetet që të funksionojë) shpërndahu lejekalimi për të lejuar gazetarët e huaj dhe veprimtarët e të drejtave të njeriut të hynin në zonat nën kontrollin e UÇK-së.

Pavarësisht këtyre strukturave, nuk njihen raste që ushtarë të UÇK-së të jenë ndëshkuar për kryerje abuzimesh kundër civilëve apo forcave të qeverisë që nuk ishin më pjesë aktive në konflikt. Eshtë e qartë që në raste të caktuara, siç është ai i shtatorit të vitit 1998, kur u vranë nga forcat e UÇK-së tridhjetë e katër vetë në afërsi të Glogjanit, komandantët lokalë, nëse nuk e kanë urdhëruar vrasjen, duhet të kenë qënë të informuar mbi atë që ndodhi. Gjendeshin gjithashtu raste të raportuara, por jo të konfirmuara, në të cilët ushtarë të UÇK-së ndëshkoheshin nga komandantët e tyre, ngaqë abuzonin apo qëllonin mbi gazetarë të huaj.

Në intervista e deklarata publike, zëdhënësi i UÇK-së në mënyrë të përsëritur shprehu gatishmërinë e organizatës për të respektuar rregullat e luftës. Në një intervistë dhënë gazetës në gjuhën shqipe *Koha ditore* në korrik 1998, zëdhënsi i UÇK-së Jakup Krasniqi tha:

> Që nga fillimi, ne kishim rregullat tona të brendshme për operacionet tona. Këto rregulla kanë si kusht faktin, që UÇK-ja njeh Konventën e Gjenevës dhe konventa të tjera që rregulllojnë sjelljen në një luftë. [138]

Komunikata e UÇK-së nr. 51, e publikuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së më 26 gusht 1998, deklaroi që: "UÇK-ja si një ushtri e institucionalizuar dhe e organizuar po rritet çdo ditë e më shumë nga pikëpamja profesionale dhe po bëhet e gatshme të luftojë deri në fitore".[139]

Në nëntor 1998, përfaqësuesit e Human Rights Watch patën një takim me Hashim Thaçin e Fatmir Limajn në fshatin Banjë në afërsi të Malishevës për të diskutuar mbi angazhimin e UÇK-së për të respektuar ligjet e luftës në përgjithësi, dhe trajtimin e civilëve serbë të paraburgosur nga UÇK-ja në veçanti.

Ramush Haradinaj, komandant i përgjithshëm i UÇK-së për zonën e Dukagjinit, pas luftës u bë kryetar i partisë politike Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Këtu ai është duke folur në fushatë zgjedhore më 22 shtator 2000.
FOTO AFP

Përfaqësuesit e UÇK-së informuan Human Rights Watch që UÇK-ja ka një kod të sjelljes për ushtarët e saj, por ky kod nuk mund të bëhej publik. Ata thanë se për ushtarët që abuzonin merreshin masa disiplinore, por nuk u dhanë detaje lidhur me këtë.

Për shkak të organizmit të shkrifët, pjesëmarrjes së forcave të mbrojtjes territoriale dhe ecejakeve të shqiptarëve nga jashtë brenda e anasjelltas, ka qënë e vështirë të llogariteshin përmasat e vërteta të UÇK-së. Ndoshta, treguesit më të mirë të këtyre përmasave mund t'i japë Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM), e cila u mandatua pas lufte të regjistronte e të asistonte ish-luftëtarët. Sipas ONM-së, që prej marsit të vitit 2000, janë regjistruar 25 723 ish-luftëtarë, ndonëse është sigurisht e mundur që ky numër të jetë i egzagjeruar për shkak të joluftëtarëve që ishin në kërkim të asistencës. [140] Dihet që në radhët e UÇK-së kanë luftuar edhe disa vullnetarë ndërkombëtarë. [141]

Pas masakrës së Drenicës në mars 1998, mbledhja e fondeve për llogari të UÇK-së ishte e organizuar kryesisht nga diaspora shqiptare në Europë e në Shtetet e Bashkuara, dhe paratë shkonin në fondin "Atdheu ju thërret". Raportime të ndryshme në media kanë bërë gjithashtu një lidhje midis mbledhjes së fondeve të UÇK-së dhe trafikut të drogës, pastrimit të parave e kontrabandës. [142]

E paisur me një armatim të lehtë në raport me forcat serbe e jugosllave, UÇK-ja mbeti gjatë gjithë vitit 1998 e 1999 një forcë dinamike guerrilasish, duke zgjedhur sulmet kundër pikave të kontrollit të policisë e ushtrisë apo pusitë, dhe më pas tërheqjen e shpejtë. Ofensiva e vetme në shkallë të gjerë, një sulm në Rrahovec në korrik 1998, ishte një dështim i plotë, pasi qeveria rimori qytetin brenda dy ditësh.

Gjatë konfliktit, UÇK-ja u angazhua në taktika ushtarake, të cilat vunë në rrezik civilët shqiptarë; në mënyrë të veçantë, duke sulmuar pikat e kontrollit e patrullat serbe në afërsi të fshatrave shqiptare, civilët rezultonin të ekspozuar ndaj sulmeve hakmarrëse. Eshtë një fakt tronditës, që lufta e Kosovës gjatë vitit 1998 e 1999 u karakterizua nga masakra civilësh të bëra në dritë të diellit, siç ishin ato në Prekaz, Abri e Epërme dhe Raçak, të cilat shënuan pikat e kthesës së kësaj lufte. Ishte evidente që të gjitha këto krime u kryen nga forcat rëndom brutale serbe e jugosllave, por është e qartë që UÇK-ja ishte e vetëdijshme mbi përfitimin politik të masakrave të tilla të bëra në sytë e të gjithëve.

Një numër zyrtarësh e oficerësh të lartë të UÇK-së mbajtën pozita të

rëndësishme në Kosovën e pasluftës. Hashim Thaçi u bë kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës. Agim Çeku u emërua shef i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK), të cilat nuk janë gjë tjetër, veçse emërtimi i ri i UÇK-së në periudhën e pas luftës, në strukturat e së cilës disa ish-komandantë të tjerë të UÇK-së mbajnë poste të rëndësishme, siç është Sulejman Selimi. Ramush Haradinaj iku prej Trupave të Mbrojtjes së Kosovës në vititn 2000, dhe formoi një parti politike, Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Disa komandantë e luftëtarë të UÇK-së kanë vazhduar veprimtaritë e tyre ushtarake në Maqedoni në radhët e Ushtrisë Çlirimtare kombëtare.

SHTOJCË:
Gradimet e pasluftës të pjesëtarëve të policisë Serbe e të ushtrisë jugosllave

Më 13 maj 1999, presidenti i atëhershëm i Serbisë Milan Milutinoviç i dha Sreten Lukiçit (i identifikuar edhe si "lider i Shtabit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë") gradën e një gjenerali policie (me dy yje). Në të njëjtën kohë, Ministri i asaj kohe i Punëve të Brendshme Vllajko Stojiljkoviç gradoi shtatëdhjetë e dy oficerë dhe 307 nënoficerë të policisë. [143]

Më 7 qershor 1999, Presidenti jugosllav Milosheviç u shprehu mirënjohjen e mbështetjen 911 pjesëtarëve të MUP-it për "shtypjen e terrorizmit në Kosovë e për mbrojtjen e vendit nga agresioni". Midis atyre që u dekoruan, ishin tre gjeneralë, shtatëmbëdhjetë kolonelë, shtatëmbëdhjetë lejtënantë kolonelë, njëzet majorë, tridhjetë kapitena, dyzet e pesë lejtënantë, tridhjetëeshtatë nënlejtënantë, pesëdhjetë rreshterë majorë, 652 nënoficerë dhe dyzet pjesëtarë të strukturave të tjera të MUP-it. [144]

Një pjesë e lidershipit u nderua në mënyrë të veçantë. Urdhëri i Flamurit Jugosllav i shkallës së parë iu dha kolonel gjeneral Vlastimir S. Gjorgjeviçit, kolonel gjeneral Obrad M. Stevanoviçit dhe kolonel gjeneral Sreten D. Lukiçit.

Urdhëri i Flamurit jugosllav të shkallës së tretë iu dha kolonel Zhivko Trajkoviç, komandant i Forcave Antiterroriste. Urdhëri i Meritave për Çështje të Mbrojtjes e të Sigurimit iu dha kolonel Dragutin Adamoviç, kreut të SUP-it të Gjakovës (i emërtuar gjithashtu si SUP-i i Novij Sad-it) dhe rreshterit të Urdhërit të Parë, Vidomir N. Salipur, i cili ish i famshëm për

egërsinë e tij kundër shqiptarëve të zonës së Pejës (Shih komunën e Pejës).

Në qershor 1999, ish-Presidenti dhe "komandanti suprem" Sllobodan Milosheviç nxorri një dekret gradimesh, dekorimesh dhe emërimesh për tre mijë oficerë, nënoficerë, ushtarë e civilë, që kishin shërbyer në Ushtrinë Jugosllave. [145] Këtu u përfshi dhënia e urdhërave të Heroit Kombëtar për brigadat e VJ-së, si më poshtë: brigada e 125-të e motorizuar, brigada e 549-të e motorrizuar dhe brigada e 37-të e motorrizuar.

Midis gradimeve luksoze, Dragoljub Ojdaniçit iu dha grada e gjeneralit të ushtrisë. Vladimir Lazareviçi, komandant i Korpusit të Prishtinës dhe Ljubisha Stojimiroviç, shef i Shtabit të armatës së tretë, morën gradën e major gjeneralit.

"Për sukseset e shkëlqyera dhe rezultatet e jashtëzakonshme në drejtimin e komandimin e VJ-së në luftimet për mbrojtjen e lirisë e të sovranitetit të Atdheut kundër agresorëve", Urdhëri i Lirisë iu dha gjeneralit të ushtrisë Dragoljub Ojdaniç dhe kolonel gjeneral Nebojsha Pavkoviç. [146]

"Për manifestimin e trimërisë, vendosmërisë, vetmohimit, disiplinës dhe kryerjes së përgjegjshme të detyrave të luftës, në të cilën ata shërbyen si një shembull për pjesëtarët e tjerë të njësive të tyre", Urdhëri i Trimërisë iu dha major gjeneral Vladimir Lazareviç, komandant i Korpusit të Prishtinës. Lazareviç mori gjithashtu Urdhërin e Flamurit të Luftës së shkallës së parë vetëm dy muaj para se të merrte këtë dekoratë. Urdhëri i Trimërisë iu dha gjithashtu pjesëtarëve të armatës së tretë, si më poshtë:

- Brigadier gjeneral Milan D. Djakoviç, pjesëtar i armatës së tretë-Kolonel Milivoje P. Braniç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kolonel Zoran M. Jabllanoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kolonel Miloje R. Miletiç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kolonel Dragan S. Petroviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kolonel Radojko M. Stevanoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kolonel Veroljub J. Zhivkoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Lejtënant kolonel Simo R. Ivoseviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Lejtënant kolonel Stojan O. Konjikavac, pjesëtar i armatës së tretë
- Lejtënant kolonel Pera V. Petroviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Major Zoran M. Bojkoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Major Uros V. Nikoliç, pjesëtar i armatës së tretë
- Major Radivoje Dj. Paravinja, pjesëtar i armatës së tretë
- Major Ljubisav D. Stojanoviç, pjesëtar i armatës së tretë

- Kapiten i Urdhërit të Parë, Ljubisha S. Vucetiç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten i Urdhërit të Parë Zoran R. Raseta, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten i Urdhërit të Parë Boban R. Rajkoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten Dragan L. Lukiç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten Jovica M. Milak, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten Perica B. Nastasijeviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten Milos R. Raleviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten Cedo S. Trpkovski, pjesëtar i armatës së tretë
- Kapiten Sladjan D. Hristov, pjesëtar i armatës së tretë
- Lejtënant Boban S. Kuzmanoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Lejtënant Nikolla M. Mijatoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Nënlejtënant Nenad M. Popoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Rreshteri veteran i Urdhërit të Parë Radisha V. Iliç, pjesëtar i armatës së tretë
- Rreshteri veteran i Urdhërit të Parë Zheljko J. Alar, pjesëtar i armatës së tretë
- Rreshteri veteran i Urdhërit të Parë Branko N. Vukoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Rreshteri Aleksandar R. Rakoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Rreshteri i ri Ivan S. Niqiforoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Kaporal Branislav M. Fungerhut, pjesëtar i armatës së tretë
- Ushtar Dragan R. Beloseviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Ushtar Milan M. Bogdanoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Ushtar Veroljub M. Mijatoviç, pjesëtar i armatës së tretë
- Ushtar Sasha T. Pejiç, pjesëtar i armatës së tretë
- Ushtar Milinko M. Pendiç, pjesëtar i armatës së tretë
- Ushtar Nikolla R. Popoviç, pjesëtar i armatës së tretë

Më 7 korrik 1999, sipas "*Politica*"-s, u dekorua një grup tjetër nëpunësish të MUP-it, për "rezultate të dukshme të arritura në drejtimin e njësive të policisë, manifestim të trimërisë, vendosmëri e disiplinë në përmbushjen e detyrave të sigurimit duke frenuar terrorizmin në Kosovë e Metohi dhe në mbrojtje të Atdheut nga agresioni, me anë të të cilave ata vepruan si një shembull për individë e pjesëtarë të tjerë të policisë". [147] Në veçanti,

Urdhëri i Heroit Kombëtar iu dha brigadës së 124-t të ndërhyrjeve të njësive të policisë speciale. Urdhëri Flamurit Jugosllav i shkallës së tretë iu dha kolonel Zoran B. Simoviç, ish-komandant i Njësive Antiterroriste, dhe kolonel Zhivko T. Trajkoviç, komandant i njësive antiterroriste. Urdhëri i Meritës në Çështje të Mbrojtjes e të Sigurimit i Shkallës së Parë iu dha oficerëve të MUP-it në Kosovë, si më poshtë:

- Kolonel Dragutin R. Adamoviç – SUP-i i Gjakovës
- Kolonel Dushan B. Gavraniç – SUP-i i Gjilanit
- Kolonel Gradimir R. Zekavica – SUP-i i Prizrenit
- Nënkolonel Millan S. Gjuriçiç – SUP-i i Prizrenit (kreu i Departamentit të policisë)
- Major Milenko M. Bozoviç – Komandant i policisë së Skënderajt

Ish-Presidenti Jugosllav Sllobodan Milosheviç, me dekret, emëroi gjeneral brigade Radojko Stefanoviç në postin e komandantit të Korpusit të Prishtinës të armatës së tretë të Ushtrisë Jugosllave. Personi, i cili kish qënë në këtë post, gjeneralmajor Vladimir Lazareviç u gradua shef i Shtabit të Komandave të Armatës së Tretë. [148]

Shumë pjesëtarë të tjerë të VJ-së u graduan dhe u emëruan në poste të reja me dekretet e presidentit Milosheviç. Këto gradime e emërime përfshinin Negosllav Nikoliç, komandant i Korpusit të Nishit nga armata e tretë, i graduar gjeneral major , kolonel Bozhidar Deliç, komandant i Brigadës së 549-të të motorrizuar, i graduar gjeneral brigade, dhe kolonel Radojko Stefanoviç, komandant i brigadës së 52-të të artilerisë së kombinuar, i graduar gjeneral brigade.

Major gjeneral Ljubisha Stojimiroviç u emërua shef i shtabit të armatës së parë. Urdhëri i Flamurit të Luftës iu dha brigadave të mëposhtme:

- Brigadës së 243-të të mekanizuar
- Brigadës së 211-të të korracuar
- Brigadës së 15-të të korracuar

Presidenti Milosheviç gjithashtu paraqiti dekoratat më të larta të mundshme të Republikës Federale të Jugosllavisë – Urdhëri i Lirisë, Urdhëri i Heroit Kombëtar, Urdhëri i Flamurit Jugosllav dhe Urdhëri i Flamurit të Luftës i Shkallës së Parë – për komandantët e lartë të Kosovës.[149]

Urdhëri i Lirisë iu dha:

- Gjeneralit të Ushtrisë Dragoljub Ojdaniç
- Kolonel gjeneral Nebojsha Pavkoviç, komandant i armatës së tretë

Urdhëri i Heroit Kombëtar iu dha:

- Brigadës së 125-të të motorizuar të VJ-së; marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Dragan Zhivanoviç.
- Brigadës së 549-të të motorizuar të VJ-së; marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Bozhidar Deliç.
- Brigadës së 37-të të motorizuar të VJ-së; marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Ljubisha Dikoviç.
- Brigadës së 63-të të parashutistëve të VJ-së; marrë nga komandanti i brigadës; nënkolonel Ilija Todorov.
- Brigadës së 124-ët të ndërhyrjes policore; marrë nga komandanti i brigadës, kolonel Zharko Brankoviç.

Urdhëri i Flamurit Jugosllav iu dha:

- Zoran Andjelkoviçit, President i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm për Kosovën e Metohinë.
- Nikolla Shahinoviçit, zëvendës kryeministër i qeverisë jugosllave
- Vlastimir Gjorgjeviçit, kolonel gjeneral i policisë
- Obrad Stevanoviçit, major gjeneral i policisë
- Sreten Lukiçit, major gjeneral i policisë

Më 13 maj të vitit 2000, ditën e sigurisë, Presidenti Milosheviç dekoroi 135 pjesëtarë të MUP-it. Dekorata e Flamurit Jugosllav e klasit të parë iu dha ministrit serb të punëve të brendshme,Vllajko Stojiljkoviç, e ndihmës ministrit serb të Punëve të Brendshme dhe shefit të sigurimit të shtetit, kolonel gjeneral Radomir Markoviç. [150]

Më 5 korrik të vitit 2000, Presidenti serb Milan Milutinoviç gradoi disa prej zyrtarëve të lartë të ministrisë së punëve të brendshme. Ndihmës ministrat Nikolla Curçiç, Stojan Misiç dhe Petar Zekoviç morën gradën e major gjeneralit. [151]

4

MARS-QERSHOR 1999
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Më 24 mars 1999, ndërsa avionët e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior nisën fushatën e bombardimeve mbi Republikën Federale të Jugosllavisë, sytë e të gjithë botës u kthyen nga Kosova. Fillimi i luftës ajrore kundër Jugosllavisë ishte gjithashtu fillimi i periudhës më të përgjakshme në Kosovë qysh prej fundit të Luftës së Dytë Botërore. Në të 12 javët e mëpastajme, ushtria, policia e paraushtarakët jugosllavë dëbuan nga Kosova më shumë se 850 000 shqiptarë etnikë dhe nxitën shpërnguljen e brendshme të disa qindra mijra të tjerëve. Shumë prej tyre, tek detyroheshin të linin shtëpitë e tyre, u grabitën e u rrahën, ndërsa shtëpitë plaçkiteshin e digjeshin. Një numër i madh grash u përdhunuan. Mijra burra u ndaluan, dhe shumë prej tyre u ekzekutuan, e në disa raste së bashku me gratë, fëmijët e të moshuarit, ndonëse numri total i civilëve të ekzekutuar është ende i paqartë (shih më poshtë seksionin e viktimave). Në më shumë se 12 varre masive, forcat qeveritare u përpoqën të maskojnë dëshminë e trupave të shkatërruar e të sakatuar. Fushata e egër kundër civilëve shqiptarë u ndal vetëm pas tërheqjes së ushtarëve jugosllavë, policëve e paraushtarakëve serbë dhe pas hyrjes së trupave të NATO-s më 12 qershor 1999.

Shumë vëzhgues shënojnë datën e luftës ajrore të NATO-s si fillimin e fushatës serbe e jugosllave. Në të vërtetë, ndërsa 24 marsi solli një intensifikim të madh të fushatës, fillimi i operacioneve zuri fill katër ditë më parë, më 20 mars, kur monitoruesit e misionit vëzhgues të OSBE-së për Kosovën u tërhoqën *en masse* nga krahina. Shumë prej organizatave ndërkombëtare joqeveritare të mbetura në terren e larguan personelin e tyre në të njëjtën kohë. Largimi i misionit vëzhgues të OSBE-së dhe i veprimtarëve të asistencës ndërkombëtare, jo vetëm e privuan Kosovën

Nje plak shqiptar vëren shkatërrimet në fshatin Koshare

FOTO ALBAN BUJARI

prej dëshmitarëve më të rëndësishëm, por i dhanë fund gjithashtu efektit të frenimit që provokonte prania e verifikuesve të OSBE-së ndaj forcave qeveritare. [2] Sipas raportit të OSBE-së mbi punën e vet në Kosovë prej tetorit '98 deri në qershor '99, bazuar pjesërisht mbi intervistat e refugjatëve gjatë bombardimeve të NATO-s, "niveli i incidenteve të vrasjeve masive e arbitrare u rrit në mënyrë dramatike menjëherë pas largimit të Misionit Vëzhgues të OSBE-së, më 20 mars". [3]

Siç demonstron kapitulli "Konteksti Historik" i këtij libri, abuzimet pas 20 marsit 1999 përbënin një vazhdimësi e intensifikim të sulmeve mbi civilë, të shpërnguljeve, të shkatërrimit të pronave të civilëve të kryera nga forcat e sigurimit serb e jugosllav gjatë vitit 1998 dhe muajve të parë të vitit 1999. Prej marsit të vitit 1999, luftimet e goditja ndaj civilëve kishin shkaktuar rreth 1500-2000 viktima civilësh e luftëtarësh. [4] Më shumë se 200 mijë civilë shqiptarë ishin shpërngulur brenda për brenda, pothuaj 70 mijë shqiptarë kishin lënë krahinën e kishin gjetur strehë në vendet fqinjë e në Malin e Zi, dhe nja njëqind mijë të tjerë me kombësi jugosllave, kryesisht shqiptarë të Kosovës, kishin kërkuar azil në Europën Perëndimore. [6] Mijra fshatra të banuara nga shqiptarë etnikë u shkatërruan pjesërisht apo tërësisht, duke u djegur apo bombarduar. [6]

Fushata e organizuar nga shteti, e cila filloi nga fundi i marsit 1999, ishte megjithatë e ndryshme në gjerësi e intensitet nga dhuna që ish ushtruar gjatë vitit 1998 e fillimi i vitit 1999. Operacione më të hershme të forcave të sigurimit serb e jugosllav u drejtuan në zona dhe familje të Kosovës, të cilat ishin të lidhura me UÇK-në. Ndonëse aksionet e ndërmarra nga policët serbë e ushtarët jugosllavë në rajonin e Drenicës dhe Kosovën jugperëndimore ishin dallueshmërisht të egra (në kuptimin që u goditën civilë, gjë kjo e palejueshme nga ligjet humanitare ndërkombëtare), ato mund të kuptoheshin si një kundërkryengritje ndaj rebelëve të UÇK-së.

Operacionet që nisën nga fundi i marsit 1999 e tejkaluan kundërkryengritjen: forcat serbe e jugosllave realizuan një fushatë sistematike dhune dhe çpopullimi të detyruar, çfarë bëri që tetëdhjetë përqind e shqiptarëve civilë të shpërnguleshin nga shtëpitë e tyre. [7] Zona që nuk ishin shquar për ndonjë mbështetje ndaj UÇK-së dhe që i kishin shpëtuar dhunës së ushtruar në Drenicë e në Kosovën jugperëndimore, si Prishtina e Kosova Lindore, u goditën për të provokuar dëbimin masiv. Vrasjet e terrori kundër civilëve filluan të përfshijnë çdo zonë që kish lidhje historike apo të momentit me

UÇK-në, ashtu si edhe zonat pa lidhje të tilla. Shkurt, kundërkryengritja e lokalizuar u shoqërua me "spastrim etnik" sistematik.

Pavarësisht nga shkalla e shpërnguljeve gjatë vitit 1998 dhe muajve të parë të vitit 1999, shumë vëzhgues besojnë që Kosova, e banuar në masën 90% nga shqiptarët, nuk mund të konsiderohet e spastruar etnikisht në shkallë të gjerë, thjesht për faktin që dëbimi i një populli të tërë është praktikisht i parealizueshëm. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, të cilat janë etnikisht të përziera, dhe në zona të kontestuara të Kroacisë, ku asnjë grup etnik nuk përbën një shumicë absolute, dëbimi i një grupi etnik ishte një mjet i një grupi rival për konsolidimin e kontrollit në të gjithë territorin. Në të kundërt, Kosova me një shumicë dërrmuese shqiptarësh, kish përjetuar një rrjedhje të qëndrueshme të popullsisë serbe në dekadat e mëparshme, ndërkohë që Beogradi ish përpjekur të balanconte këtë dukuri të ikjes së serbëve me një ringulim në Kosovë të serbëve të Kroacisë. Përgjigja fillestare e ngadaltë e UNHCR-së dhe e NATO-s ndaj valës së refugjatëve që iu drejtuan Maqedonisë e Shqipërisë në fund të marsit e në fillim të prillit, është dëshmi e faktit, që vetëm pak njerëz të komunitetit ndërkombëtar besonin se qeveria e Sllobodan Milosheviçit do të tentonte "spastrimin etnik" në Kosovë. [8] Shumë vëzhgues besonin gjithashtu se Milosheviçi do të kapitullonte shpejt e shpejt, sapo të fillonin goditjet ajrore të NATO-s.

Nëse mprehtësia konvencionale ndër vëzhguesit perëndimorë këmbëngulte që ish pa gjasa një "spastrim etnik" në Kosovë, si shpjegohet atëherë dëbimi masiv sistematik i popullsisë shqiptare të krahinës prej forcave serbe e jugosllave midis marsit e qershorit të vitit 1999? Kishim të bënim me një plan të koordinuar apo me një reaksion spontan ndaj bombardimeve të NATO-s? Ndonëse vetëm Sllobodan Milosheviç e bashkëpunëtorët e tij të ngushtë e dinë shpjegimin e vërtetë të "spastrimit etnik" në Kosovë, disa teza të besueshme egzistojnë megjithatë.

Së pari, nga çfarë është parë, qeveria e Milosheviçit filloi të përgatiste një kundërkryengritje në shkallë të gjerë për të shtypur UÇK-në në shtator 1998, shumë kohë përpara se ndonjë të dyshonte mbi bombardimet e NATO-s, kur ofensiva e verës po shkonte drejt fundit (shih Kontekstin Historik). Pas çrrënjosjes së UÇK-së prej disa bastioneve të saj, e ndikuar nga kriticizmi ndërkombëtar në rritje dhe nga afrimi i dimrit, qeveria ndaloi ofensivën, dhe pranoi vëzhguesit e OSBE-së.

Midis tetorit e dhjetorit 1998, disa persona të rëndësishëm të aparatit të

sigurimit ose ishin spostuar, ose ishin graduar, përfshirë këtu shkarkimin e Jovica Stanisiçit, kreu i sigurimit të shtetit serb, dhe Momcillo Perisiçin, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Një luajalist, gjeneral Dragoljub Ojdaniç, zëvendësoi Perisiçin, dhe kolonel gjeneral Nebojsha Pavkoviç u emërua komandant i armatës së tretë, e cila kish nën përgjegjësi Serbinë Jugore e Kosovën. Këto ndryshime, së bashku me të tjerat në Ushtrinë Jugosllave dhe në Ministrinë Serbe të Punëve të Brendshme, të bëjnë të mendosh se po projektohej një strategji e re mbi Kosovën.

Operacionet që nisën nga fundi i marsit 1999 e tejkaluan kundërkryengritjen

Dhjetori 1998 e janari 1999 na ballafaqoi me një rritje graduale të forcave të sigurimit në Kosovë, duke dhunuar marrëveshjen me misionin e Vëzhgimit në Kosovë, por nuk pati ndonjë qëndrim të fortë kritik nga ana e komunitetit ndërkombëtar. Vrasja e dyzet e pesë shqiptarëve në Raçak provokoi një zemërim ndërkombëtar, por përqëndrimi i forcave serbe e jugosllave në Kosovë nuk u ndërpre. Sipas OSBE-së, grupet paraushtarake u vendosën në Kosovë në muajin shkurt për të mbrojtur rrugët e transportimit të gjithçkaje të grabitur. [9] Përqëndrimi i forcave vazhdoi gjatë negociatave në Rambouillet, Francë, përfshirë edhe armatimin e serbëve lokalë. Sipas OSBE-së, e cila kish akoma vëzhguesit e saj në Kosovë, më 6-23 shkurt u vu re "një përqëndrim domethënës i forcave të VJ-së në të gjithë Kosovën, duke mos lënë pas dore armatimin e civilëve dhe trajnimin e rezervistëve, mbërritjen e kundërajrorëve, ndërtimin e depozitave të mëdha të karburantit, përgatitjen e eksplozivëve shkatërrues përgjatë rrugëve kryesore në jug dhe një rritje të aktivitetit ushtarak ajror". [10]

Sulmet e para mbi bastionet e UÇK-së në zonat rurale filluan menjëherë pas largimit të Misionit Vëzhgues të OSBE-së, më 20 mars, dhe këtu u panë sulme të pamëshirshme mbi fshatra të tërë, që s'kursenin askënd. Sipas OSBE-së, theksi u vu gjithashtu në rrugët strategjikisht të rëndësishme në perëndim të Vushtrrisë që lidhin Kosovën me Serbinë.

Karakteri dhe intensiteti i fushatës ndryshoi në një farë mënyre pas fillimit të bombardimeve nga ana e NATO-s. Më 24 mars fillloi spastrimi total i qyteteve, siç ndodhi në Pejë, në jugperëndim të Kosovës, dhe më vonë në Prishtinë, si edhe djegja e qytetit të vjetër të Gjakovës. Më 24-26 mars u vu re një operacion agresiv për të siguruar kufirin jugperëndimor me Shqipërinë, në rrjedhën e të cilit pati një shpërngulje në shkallë të gjerë të popullsisë dhe vrasje të civilëve.

Ndërsa u mor vesh, që një fushatë e fuqishme kundërkryengritëse kish qënë e përgatitur përpara se të vepronin forcat e NATO-s, u duk qartë se qeveria e Milosheviçit i shfrytëzoi goditjet ajrore të NATO-s për të imponuar më tej terrorin mbi popullsinë shqiptare të Kosovës dhe për të dëbuar një numër të madh shqiptarësh nga krahina. Duke përdorur pretekstin e bombardimeve të NATO-s, qeveria ishte e lirë të lëshohej në një ofensivë në shkallë të gjerë mbi UÇK-në, si dhe të urdhëronte dëbimin e më shumë se 850,000 shqiptarëve të Kosovës.

Një shpjegim tjetër lidhet thjesht me një hakmarrje. Siç kanë demonstruar qindra refugjatë, forcat qeveritare në mënyrë të përsëritur u drejtoheshin atyre me fjalët: "shkoni tek NATO-ja!". Të paafta t'i përgjigjeshin fuqisë ajrore të NATO-s, forcat qeveritare u hakmorrën mbi popullsinë civile. Por natyra sistematike e dëbimeve e kundërshton këtë teori; në mënyrë të qartë, gjendej një plan i konceptuar mirë për "spastruar etnikisht" një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare. Hakmarrja nuk ish gjë tjetër, veçse një faktor shtesë për të motivuar trupat.

Një teori tjetër e besueshme lidhet me faktin që Beogradi ka synuar në mënyrë permanente të ndryshojë kompozimin demografik të Kosovës duke dëbuar shqiptarët – një strategji që është propozuar nga e djatthta ekstreme serbe, përfshirë ish-zëvendës kryeministrin serb Vojislav Sheshel. [11] Ky shpjegim përforcohet nga rrëfimet e shumta të refugjatëve, që arrinin në Shqipëri, pasi u ishin grisur apo konfiskuar dokumentat e pasi u ish marrë patenta e shoferit në kufi. I ashtuquajturi "spastrimi i identitetit" i dokumentuar nga Human Rights Watch e organizata të tjera, që kanë mbledhur dëshmi në Shqipëri, të bëjnë të besosh se ka egzistuar një përpjekje e Beogradit për t'i zhveshur shqiptarët e Kosovës prej shtetësisë e për t'ua bërë kështu të pamundur kthimin në shtëpi. [12]

Një shpjegim i dytë i "spastrimit etnik" është synimi i serbëve për të destabilizuar vendet fqinjë, Shqipërinë e Maqedoninë. Në mars 1999, shteti i ri i Maqedonisë me dy milionë banorë, 25% e të cilëve (të paktën) janë shqiptarë, konsiderohej si lehtësisht i destabilizueshëm, dhe në të njëjtën kohë, si vendi çelës në kuadrin e stabilitetit rajonal. Fluksi i madh i refugjatëve nga Kosova mund të prishte aty për aty balancën etnike, në mos mund të destabilizonte të gjithë vendin. [13]

Ndonëse Shqipëria nuk i kish këto tensione etnike, stabiliteti i saj kish qënë i kërcënuar në mënyrë të përsëritur në vitet '90 nga ndryshimet politike e ekonomike. Ardhja e më shumë se 400 mijë refugjatëve mund ta hidhte këtë vend të varfër në kaos e trazira.

Fatmirësisht, asnjë prej këtyre skenareve nuk u realizua. Nuk ka dyshim se mbërritja e rreth 260 mijë refugjatëve të Kosovës i tensionoi mjaft marrëdhëniet midis maqedonasve etnikë e shqiptarëve etnikë në Maqedoni. Politika qeveritare e avashllëkut dhe e hezitimit në pranimin e refugjatëve gjatë pranverës së vitit 1999, dhuna e aty-këtushme e policisë kundër refugjatëve dhe refuzimi periodik i qeverisë për të pranuar refugjatë të tjerë [14] krijoi zemërim midis shqiptyarëve të Maqedonisë. Në po këtë mënyrë, mbështetja që shqiptarët e Maqedonisë i bënin kauzës së shqiptarëve të Kosovës kalli frikën e një ndarjeje midis maqedonasve. Presioni i bërë nga udhëheqja e partisë shqiptare në koalicionin qeverisës, Partia Demokratike Shqiptare, si dhe prania e NATO-s, ndihmuan në mënyrë të sigurt të parandalohej një konflikt i hapur në Maqedoni në verën e vititi 1999.

Në Shqipëri, refugjatët u pritën krahëhapur. Pavarësisht nga kushtet e vështira ekonomike, sidomos në Shqipërinë e veriut, refugjatët u sistemuan në kampe refugjatësh dhe në shtëpi privatësh. Vendi, për shkak të një një fluksi të organizatave të ndihmave humanitare, NATO-s e medias, përjetoi një lloj boom-i ekonomik.

Strategjia për të destabilizuar Shqipërinë e Maqedoninë mund të merret si një shpjegim i tretë i "spastrimit etnik", sepse kështu do të dobësohej vendosmëria e NATO-s për të vazhduar luftën ajrore. Ishte e qartë qysh nga fillimi që disa anëtarë të Aleancës euroatlantike, si Italia, Franca e Greqia ishin disi të rezervuar kur binte fjala për goditjet ajrore. Beogradi mund të ketë shpresuar që lumi i refugjatëve do të bindte qeveritë e publikun se bombardimet e kishin përkeqësuar situatën, në mos kanë qënë këto bombardime që e kanë shkaktuar këtë fluks refugjatësh (Qeveria jugosllave në mënyrë të përsëritur pretendonte se refugjatët po iknin prej bombardimeve të NATO-s). Nëse ka qënë ky synimi i Beogradit, dështimi ishte i qartë: "spastrimi etnik" dhe nevoja për të risistemuar gjendjen u bënë përligjja më e fortë e aksioneve të NATO-s dhe ndihmuan të galvanizohej mbështetja midis aleancës e publikut në favor të bombardimeve. Mbulimi mediatik i dëbimeve risolli përpara syve të publikut imazhin e deportimeve naziste dhe ndihmoi të fuqizohej mbështetja ndaj NATO-s, sidomos gjatë periudhës së një kriticizmi të fortë mbi viktimat civile të shkaktuara nga NATO dhe mbi bombardimin e ambasadës kineze në

Gjendej një plan i konceptuar mirë për "spastruar etnikisht" një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare.

Beograd. [15] Kriza e refugjatëve i dha NATO-s dëshminë e madhe, që kjo ishte një luftë në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Shumë komentatorë kanë sugjeruar se dëbimi me forcë i popullsisë shqiptare të Kosovës ishte një përpjekje e Beogradit për të krijuar kushtet e një ndarjeje të Kosovës, me synimin që zonat në kufi me Serbinë në veri dhe pjesët lindore të krahinës të mbeteshin me Beogradin. Egzistenca e një plani të tillë mbetet sidoqoftë a paqartë, pasi dëbimet ishin normalisht më të mëdha në zonat ku vepronte UÇK-ja e jo sipas logjikës së mësipërme për ndarjen e Kosovës.

Më në fund, "spastrimi etnik" në dukje ish në shërbim të disa objektivave strategjikë ushtarakë. Fshatrat e zonave ku UÇK-ja ishte aktive, fjala vjen rrotull Podujevës, Malishevës e Gjakovës, u spastruan për shkak se ato ishin bërë një mbështetje e fuqishme logjistike për UÇK-në. Duke qënë se ish e vështirë të shquaje luftëtarët nga civilët, forcat qeveritare dëbuan të gjithë popullsinë nga këto zona, duke synuar kështu "kullimin e ujrave", në mënyrë që rebelët të ishin më të dukshëm. Përjashtimi i vetëm është rajoni i Drenicës, ku shumë civilë u ndaluan të largoheshin dhe u përdorën si parzmore njerëzore.

Dëbimi i refugjatëve në drejtim të Shqipërisë e Maqedonisë mund të ketë patur për qëllim edhe një angazhim të madh të NATO-s në këto vende, në mënyrë që të vështirësohej invazioni i mundshëm tokësor. Në mënyrë të ngjashme, kriza në Shqipëri mund të ketë qënë një përpjekje për të ndërprerë linjat e furnizimit e për të penguar inkursionet e pjesëtarëve të UÇK-së, të cilët ishin stacionuar në pjesën veriore të vendit.

GJEOGRAFIA E ABUZIMEVE

Përtej "spastrimit etnik" sistematik të Kosovës, disa pjesë të krahinës hoqën më keq – ekzekutime në masë të civilëve, përdhunime, tortura, dhe shkatërrimin e pronave të civilëve, duke i plaçkitur apo duke iu vënë zjarrin. Shumë prej këtyre zonave kishin nxjerrë zbuluar tashmë dhunën e ushtruar gjatë vitit 1998 e fillimit të 1999-s. Dokumentimi e analiza e abuzimeve në disa qytete e fshatra përbëjnë korpusin kryesor të këtij raporti (Shih analizën statistikore të dhunimeve dhe komunat më shumë të prekura nga këto dhunime)

Zonat, të cilat kishin qënë të lidhura historikisht me UÇK-në, u goditën më rëndë.

Zonat, të cilat kishin qënë të lidhura historikisht me UÇK-në, u goditën më rëndë. Komunat e Gllogofcit dhe Skënderajt në rajonin e Drenicës, djepi i UÇK-së, ishin skena të masakrave mbi civilë, ashtu si dhe të burgosjeve, të përdorimit si parzmore njerëzore si dhe të shkatërrimit të pronave civile (Shih rajonin e Drenicës). Duke përjashtuar dëbimin masiv prej qytetit të Gllogofcit, shumicës së banorëve të Drenicës iu ndalua largimi. Vrasjet masive, dëbimet dhe shkatërrimi i pronave civile ishin gjithashtu të zakonshme në komunat e Gjakovës, Rrahovecit, Prizrenit, dhe Suharekës në zonën e kufirit jugor, ku shumë prej fshatrave historikisht kishin mbështetur UÇK-në [Nuk ka raportime për dëbime apo vrasje masive mes popullsisë së sllavëve myslimanë në komunën e Dragashit]. Rajoni jugperëndimor, i lidhur ngushtë me Shqipërinë veriore, ishte burimi kryesor për armët, pajimet, dhe rekrutët e stërvitur të UÇK-së, dhe është pikërisht kjo pjesë e kufirit, nëpër të cilën u dëbuan për në Shqipëri mijra civilë në rrjedhën e disa javëve gjatë verës së vitit 1999. Masakrimi e terrorizimi i civilëve dhe shkatërrimi i shtëpive të tyre në këto komuna midis marsit e qesrshorit të vitit 1999 është i kuptueshëm, të paktën pjesërisht, si një vazhdim i përpjekjeve për të eleminuar bazat, ku UÇK-ja gjente mbështetje nga civilët qysh prej fillimit të '98-ës.

Shpjegimet e një përqëndrimi të abuzimeve në komuna të tjera të hetuara në detaje nga Human Rights Watch janë më komplekse e gjithsesi jo përfundimtare. Komunat e Pejës e të Lipjanit, të cilat kanë në mënyrë domethënëse popullsi serbe, u bënë objekt i dëbimeve masive, por vrasjet ishin të lokalizuara. Ndonëse UÇK-ja ish aktive në komunën e Pejës dhe e pranishme në pjesën më perëndimore të komunës së Lipjanit gjatë vitit 1998, nuk gjenden lidhje evidente midis UÇK-së dhe disa fshatrave, ku janë kryer masakra. Vrasjet mund të jenë bërë edhe për të terrorizuar popullsinë e mbetur e për ta shtrënguar për ta lënë Kosovën, pjesën më të madhe nga Peja për në Malin e Zi dhe një pjesë tjetër nga Lipjani për në Maqedoni. Sidoqë të jetë, familjariteti midis vrasësve e viktimave në këto komuna të përziera etnikisht i bën ato të dallueshme nga Drenica e Kosova jugperëndimore, ku shqiptarët nuk ishin të lidhur me dhunuesit e tyre. Kishte një prani të pakët të dhunës e të UÇK-së gjatë '98-ës në komunën e përzier etnikisht të Istogut, për shembull. Megjithatë kjo komunë u përball me dëbimet masive të shqiptarëve në drejtim të Malit të Zi dhe me shkatërrimet e plaçkitjet e shtëpive të tyre. Istogu ishte gjithashtu skena e një prej incidenteve më të përgjakshme, ku më shumë se nëntëdhjetë

shqiptarë në burgun e Dubravës u vranë nga kriminelë të panjohur në maj të '99-ës, dy ditë pasi bombardimet e NATO-s kishin shkaktuar rreth nëntëmbëdhjetë viktima në këtë burg (shih komunën e Istogut). Në krahun tjetër, masakrimi i më shumë se njëqind civilëve në komunën e Vushtrrisë, ndërsa fshtatrat rrotull Studimes u boshatisën me forcë e njerëzit u dëbuan për në Shqipëri, është i lidhur sipas shumë gjasave me praninë e luftëtarëve të UÇK-së në atë zonë. Shumë prej banorëve të Vushtrrisë u dëbuan gjithashtu, disa në drejtim të Shqipërisë e të tjerë të Maqedonisë.[16]

Në komuna të tjera të Kosovës, gjatë verës së vitit 1999 (ky raport nuk merret shumë me këtë periudhë), pamja është pothuaj po ajo, me dëbime masive të kombinuara me një numër më të kufizuar vrasjesh e abuzimesh. Në Kosovën veriore, komunat e Leposaviqit, Zvecanit e Zubin Potokut mbetën relativisht të paprekura, siç pasqyrohet në kapitullin mbi statistikat, një fakt që kryesisht i atribuohet popullsisës serbe që banonte në shumicë në to. [17] Komuna me shumicë shqiptare e Mitrovicës ishte me më pak fat. Kryeqëndra e përzier etnikisht, emri i së cilës i jep emrin komunës, është bërë qysh nga ajo kohë simboli më i fuqishëm i ndarjes etnike të pasluftës. Mitrovica ishte skena e konfliktit midis UÇK-së dhe forcave të sigurimit serb qysh prej 1998-ës. Si edhe gjetkë, largimi i OSBE-së u pasua nga një rritje e dhunës mbi shqiptarët dhe nga dëbimi me forcë në drejtim të Shqipërisë i shqiptarëve që jetonin në qytete me vetëm pak serbë. [19]

Luftime midis UÇK-së e forcave të sigurimit serb u bënë gjithashtu në komunën e Podujevës, në lindje të Mitrovicës, megjithëse ky rajon nuk është i pasqyruar aq sa duhet në këtë raport. Dhuna dhe masat shtrënguese që e shoqëronin këtë dhunë e që filluan në shtator 1998 i detyruan shumë prej banorëve të këtyre zonave t'i drejtoheshin Prishtinës në dhjetor të po atij viti. [20] Tensionet u rritën më tej në mars 1999, sidomos në qytetin e Podujevës, dhe shumica e popullsisë së mbetur u dëbua për në Maqedoni apo në kodrat përreth, ku një numër shumë i madh personash të shpërngulur gjetën strehë. [21] Në komunat e përziera etnikisht të Obiliqit dhe Fushë Kosovës ishin vënë re gjithashtu luftime sporadike gjatë 1998-ës, të cilat ishin të lidhura me pushtimin e minierës në fshatin e Grabovacit në komunën e Fushë Kosovës. [22]

Pas largimit të Misionit Vëzhgues për Kosovën, ngjarjet në Fushë Kosovë[23] e në Obiliq [24] ndoqën të njëjtën rrjedhë, d.m.th. një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare u dëbua drejt Maqedonisë. Stacioni hekurudhor në Fushë Kosovë u përdor gjithashtu si një pikë tranziti për nxjerjen me tren jashtë Kosovës

për në Maqedoni të dhjetra mijra shqiptarëve. Fshati Hadë u zgjodh si model ndëshkimi, ndoshta për shkak të lidhjeve me UÇK-në: pesë burra prej së njëjtës familje të fshatit u ekzekutuan dhe katër kufoma u hodhën në zjarr. [25] Pas një jave, e tërë popullsia e fshatit u detyruan të hipë në autobus dhe u nxorr jashtë për në Maqedoni e Shqipëri. [26]

Popullsia shqiptare e komunave lindore të Klinës e Deçanit iu nënshtrua gjithashtu nga fundi i marsit e fillimi i prillit dëbimit me forcë. Në Klinën e përzier etnikisht dhe e vendosur në perëndim të rajonit të Drenicës u vunë re gjatë vitit 1998 luftime midis UÇK-së e forcave të sigurimit serb e jugosllav. Shqiptarët e shumë prej komunave, në të cilat ata përbënin shumicën e popullsisë, u dëbuan për në Shqipëri më 31 mars e 1 prill 1999. [27] Në Deçanin e dominuar nga shqiptarët e që ishte bazë e veprimtarisë së UÇK-së, popullsia shqiptare iu nënshtrua një shpërnguljeje të brendshme para marsit 1999. Shumë prej banorëve të saj u përzunë me dhunë për në Shqipëri gjatë prillit të vitit 1999. [28]

Në mars 1999, konflikti në Kosovë u zgjerua, u thellua e përfshiu zona, të cilat nuk kishin vuajtur nën ndonjë dhunë të tepruar deri në atë moment, pasi lidhjet e tyre me UÇK-në kishin qënë të dobëta. Rasti më i mirë në këtë mes është kryeqyteti i Kosovës, Prishtina. Ndonëse kjo e fundit u kursye gjatë masakrës që u krye në perëndim të saj, në Drenicë, gjatë pranverës së'99-ës, një masë e madhe e popullsisë u dëbua drejt Maqedonisë në valën e parë të "spastrimit etnik" nga fundi i marsit e fillimi i prillit. Njoftimet thoshin se vjedhja e plaçkitja ishin të zakonshme, ndonëse pronat e privatëve u dogjën shumë më pak se sa në Pejë e Gjakovë. Komunat lindore të Gjilanit e Kamenicës patën të njëjtën fat: Ndonëse ato iu përvodhën vrasjeve e djegjeve, në prill e maj 1999, mijra banorë shqiptarë u shkulën nga shtëpitë e tyre, një pjesë e madhe e të cilëve u vodhën e ndaluan gjatë rrugës për në kufirin maqedonas. (Shumë pak dihet mbi atë që ndodhi në komunën e vogël të Novo Bërdos, e cila shtrihet në perëndim të Gjilanit dhe është e dominuar nga serbët)

Komunat pranë kufirit maqedonas nuk njiheshin për ndonjë lidhje me UÇK-në, ndonëse kufiri përdorej për kontrabandën e armëve dhe, për këtë arsye, ish në fokus të kundërkryengritjes jugosllave. Sidoqoftë, sapo konflikti mori përmasa më të mëdha, forcat e sigurimit serb e jugosllav nxituan të dëbonin apo të shpërngulnin popullsinë lag prej kufirit, ndërsa ka raportime që fshatrat u bombarduan e u dogjën. Një nga arsyet e këtij veprimi mund të ketë qënë frika prej invazionit tokësor të NATO-s

Komuna e Kaçanikut pranë kufirit me Maqedoninë ka qënë përgjithësisht e qetë gjatë vitit 1998. Sipas Misionit Vëzhgues të OSBE-së, UÇK-ja u fut në këtë zonë në shkurt 1999, ndërsa përplasje të armatosura midis UÇK-së e forcave të sigurimit serb e jugosllav pati në një numër fshatrash gjatë shkurtit e marsit. [29] Përpjekjet e Ushtrisë Jugosllave e policisë serbe për t'i dëbuar fshatarët për në Maqedoni filluan menjëherë pas largimit të misionit. Shumë banorë refuzuan të lëviznin, duke sjellë në një shpërngulje të brendshme kaotike, përpara se t'i shtrëngonin të linin Kosovën në prill 1999. [30] Pati një numër vrasjesh në këtë komunë, sidomos në fshatin e Kotlinës, ku 25 burra u ekzekutuan (disa prej tyre ishin pjesëtarë të UÇK-së), para se banorët të dëboheshin për në Maqedoni.[31]

Në mars 1999, konflikti në Kosovë u zgjerua, u thellua e përfshiu zona, të cilat nuk kishin vuajtur nën ndonjë dhunë të tepruar deri në atë moment, pasi lidhjet e tyre me UÇK-në kishin qënë të dobëta.

Komuna e Ferizajt, e vendosur në veri, gjithashtu u ballafaqua me dëbime masive pak javë pas ikjes së misionit Vëzhgues të OSBE-së. Nga mesi i prillit, mijra banorë të Ferizajt u gjendën të strehuar në kampe në Maqedoni, ndonjë një pjesë e vogël u nxor me dhunë për në Shqipëri. [32] Linja hekurudhore në qytetin e Ferizajt e shndërroi komunën në një pikë të rëndësishme tranziti për deportimin nga Kosova e Jugut për në Maqedoni. Komuna kufitare e Shterpces e përzier etnikisht vuajti në të njëjtën mënyrë shpërnguljen për në Kaçanik, sidomos gjysma e saj lindore dhe zona të tjera me popullsi kryesisht shqiptare. Pasi i rezistuan fillimisht dëbimit duke lëvizur nga njëri fshat në tjetrin, nga mesi i prillit 1999, banorët shqiptarë të komunës ishin pothuaj të gjithë në kampet e refugjatëve në Maqedoni. [33] Shumë prej shqiptarëve të komunës së Vitinës, e vendosur në lindje të Kaçanikut, mu në kufi, u dëbuan gjithashtu për në Maqedoni në fillim të prillit 1999.

MASAKRAT

Ekzekutime të shqiptarëve etnikë pati në të gjithë Kosovën. Siç e bën të qartë kapitulli statistikor, shumica dërrmuese e viktimave ishin meshkuj, ndonëse një numër femrash e fëmijësh pësuan të njëjtën fat. Në shumë raste, siç ishte më 1 prill me familjen Vejsa në Gjakovë, më

31 maj me familjen Gërxhalliu në Studimen e Poshtme. Më 26 mars me familjen Berisha në Suharekë, fëmijë të vegjël u vranë së bashku me të rriturit. Kapitulli statistikor na bën me dije se si masakrat përgjithësisht u kryen gjatë tri fushatave të veçanta (shih grafikun 5)

Thëniet e dëshmitarëve bëjnë fjalë për tre motive masakrash. I pari ish për t'i hapur rrugë procesit të "spastrimit". Në këto kohë ish një gjë e zakonshme që forcat e sigurimit të bombardonin një fshat, pastaj të hynin në të dhe të urdhëronin popullsinë shqiptare të largohej. Disa vetë mund të jenë vrarë për të mbejllë panik dhe për të përshpejtuar deportimin.

Thëniet e dëshmitarëve bëjnë fjalë për tre motive masakrash. I pari ish për t'i hapur rrugë procesit të "spastrimit"....Motivi i dytë ishte goditja e individëve të dyshuar si pjesëmarrës apo si të lidhur me UÇK-në....Një faktor i tretë ishte hakmarrja.

Motivi i dytë ishte goditja e individëve të dyshuar si pjesëmarrës apo si të lidhur me UÇK-në. Fshat pas fshati, forcat e sigurimit veçonin burrat nga gratë e fëmijët, dhe merrnin në pyetje burrat lidhur me kryengritjen, në ndonjë rast edhe duke i paraburgosur ata për disa ditë. Siç e konfirmojnë intervistat me dëshmitarë të mbetur gjallë, ashtu si edhe deklaratat e lëshuara nga forcat serbe e jugosllave pas luftës në median ndërkombëtare, burra të dyshuar për lidhje me UÇK-në vriteshin aty për aty. Një dyshim i tillë mund të bazohej ndonjëherë thjesht tek fakti, që dikush kish moshën e një luftëtari. Burrat shpesh detyroheshin të zhvisheshin, si për shembull në Bellaçerkë, për të hetuar nëse poshtë rrobave civile gjendeshin uniforma ushtarake, plagë lufte, apo shenja balte në duart e tyre, gjë që mund të merrej si tregues i pjesëmarrjes në luftime. Për sa kohë ish e vështirë të dalloheshin civilët nga pjesëtarët e UÇK-së apo rojet e fshatit, forcat qeveritare shpesh nuk e vrisnin mendjen gjatë dhe ekzekutonin menjëherë çdokënd që mund të kish një pamje kërcënuese.

Në raste të tjera, liderë politikë të rëndësishëm, veprimtarë të komunitetit, apo njerëz të kamur ishin veçantërisht objekt goditjeje. Siç bëhet e qartë në kapitullin "Forcat në konflikt", njësitë paraushtarake kishin shpesh me vete listat e atyre që duheshin vrarë, të cilat ishin përgatitur nga nëpunësit apo policët lokalë.

Një faktor i tretë ishte hakmarrja. Në raste të caktuara, si p.sh. në Mejë pranë Gjakovës apo në Tusus pranë Prizrenit, masakrat u kryen pasi UÇK-ja kish bërë goditje mbi forcat serbe e jugosllave. Masakrat në

Drenicë, Vërbofc, e Shtuticë u kryen nga fundi i prillit, menjëherë pasi NATO bombardoi uzinën e hekur-nikelit, brenda së cilës ishin vendosur forcat e sigurimit.

Së fundi, ndërsa shumica e dëbimeve e masakrave ishin të planifikuara, kishte gjithashtu raste, kur forcat, sidomos vullnetarët e paraushtarakët, dolën jashtë kontrollit. Anarkia e përgjithshme në Kosovë gjatë bombardimeve të NATO-s krijoi terren që kriminelët e banditët të grabisnin, plaçkisnin e të vrisnin të pafajshëm. Me ndonjë përjashtim, qeveria nuk bëri asgjë për t'i frenuar këta njerëz. Përkundrazi, paraushtarakët u dërguan në Kosovë, megjithëse ata njiheshin për brutalitetin e tyre. Madje, disa kriminelë u liruan nga burgu, pasi ata kishin rënë dakord të luftonin në Kosovë.

VIKTIMAT, TË HUMBURIT E ZHVENDOSJA E KUFOMAVE

Më shumë se dy vjet pas përfundimit të luftës, numri total i viktimave midis marsit e qershorit të vitit 1999 vazhdon të jetë i panjohur. Paqartësia lidhur me këtë çështje shpjegohet me shumë situata të pas luftës, e megjithatë, numri i të vdekurve mbetet një nga aspektet më të diskutueshme të luftës. Në fund të fundit, çfarë ka rëndësi nuk është vetëm numri i të vdekurve, por edhe fakti që një numër i madh civilësh kanë qënë të planifikuar për t'u ekzekutuar nga forcat e sigurimit serb e jugosllav.

Një arsye për polemikat mbi numrin e viktimave e përbëjnë pretendimet e egzagjeruara nga NATO e qeveritë e NATO-s gjatë luftës. Disa zyrtarë të Shteteve të Bashkuara, përfshirë edhe Sekretarin e Mbrojtjes William Cohen dhe të dërguarin special për krimet e luftës të Departamentit të Shtetit David Scheffer ishin të mendimit se numri i të humburve, të dyshuar edhe si të vdekur, shkonte deri në 100 mijë. [34] Shifra të tilla kontrastojnë me vlerësimet më të matura për të njëjtën periudhë të qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe të NATO-s, të cilat, bazuar në dëshmitë e refugjatëve, e çonin numrin e viktimave 3 000-4 000. [35] Pas luftës, shefi i administratës së Kombeve të Bashkuara për Kosovën, Bernard Kouchner, tha se "rreth 11,000 vetë" kanë vdekur, ndonëse më vonë, zyra e tij e shtypit bëri një vlerësim në shifra më të ulëta. [36] Sidoqoftë, sipas disa gazetarëve e oponentëve politikë të aleancës euroatlantike në perëndim,

pretendimet e paprovuara të zyrtarëve të lartë të qeverisë në pikun e luftës i shërbyen propagandës për të justifikuar ndërhyrjen e NATO-s. [37] Këto pohime ushqyen edhe kritikat e të majtëve ndaj politikës perëndimore lidhur me ish-Jugosllavinë, madje disa prej këtyre kritikëve vunë në diskutim faktin që eksodi i shqiptarëve u shkaktua nga forcat e qeverisë serbe apo që ishin kryer vrasje masive.

[Kishte] përpjekje të qeverisë serbe e jugosllave për të shkatërruar provat e për të zhvendosur kufomat.

Megjithatë, një arsye më e drejtëpërdrejtë për paqartësi në këtë mes janë përpjekjet e qeverisë serbe e jugosllave për të shkatërruar provat e për të zhvendosur kufomat. Edhe Gjykata e Hagës për Krimet e Luftës, edhe Human Rights Watch kanë dokumentuar raste kur kufomat janë zhvarrosur e janë zhvendosur nga vendi i krimit, në një tentativë të qartë kështu për të fshehur masakrën. Më 25 janar 2001, në një transmetim radiofonik të një dokumentari në Radion Publike Nacionale të Shteteve të Bashkuara, të titulluar "Fshehja e krimit", pretendohej që forcat serbe e jugosllave transportonin në mënyrë sistematike trupat e shqiptarëve të vrarë në kompleksin e minierave të Trepçës pranë Mitrovicës, ku shndërroheshin në hí. Sipas raportit që citonte luftëtarë serbë dhe "një zyrtar të informuar mirë të shërbimeve sekrete serbe", në Trepçë ishin kremuar 1 200- 1 500 kufoma. [38]

Pohime të besueshme mbi zhvendosjen e djegjen e kufomave patën një lloj konfirmimi në maj 2001, kur qeveria serbe njoftoi se një kamion i mbushur me tetëdhjetë e gjashtë kufoma ish shkarkuar gjatë luftës në Serbi, pranë lumit Danub – u tha se ishin trupat e civilëve shqiptarë të marrë nga Kosova. Një zyrtar i lartë i Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme njoftoi më 25 maj se Milosheviçi kish urdhëruar ministrin e atëhershëm Vllajko Stojiljkoviç të eleminonte "të gjitha gjurmët, të cilat të çonin tek ndonjë dëshmi e krimeve" në Kosovë. [39] Në korrik 2001, autoritetet serbe njoftuan zbulimin e katër varreve të tjerë në Serbi me rreth 1000 trupa shqiptarësh.

Deri në korrik 2001, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës kish zhvarrosur përafërsisht 4 ,300 kufoma, shumë më pak se sa 11,334 kufomat e raportuara fillimisht nga shqiptarët e Kosovës, gjë që ish besuar në Hagë.[40] Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, deri në prill 2001, numri i të humburve në konflikt ishte 3,525 dhe shumica dërrmuese e tyre ishin shqiptarë të Kosovës. [41]

Midis qershorit e nëntorit 1999, ekipet e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës çgroposën 2,018 kufoma nga 195 vendvarrime. Gjatë fazës së dytë të zhvarrimeve, midis prillit e nëntorit 2000, ekspertët ligjorë egzaminuan vendvarime të tjera e gjetën edhe 1,577 kufoma të plota e 258 mbetje kufomash. Në nëntor 2000, në fjalën e saj në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kryeprokurorja e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, Carla Del Ponte deklaroi se totali i përkohshëm ishte "rreth 4,000 kufoma apo mbetje kufomash të zhvarrosura". Duhet të nënvizohet megjithatë, që Gjykata Ndërkombëtare e Hagës nuk bëri dallim midis luftëtarëve e jo luftëtarëve, dhe që në disa zona UÇK-ja ishte e pranishme midis popullsisë civile (fjala vjen, në zonën e Vërbofc-Shtuticës të Drenicës gjatë ofensivës së 30 prillit, ku mbetën të vdekur dhjetra shqiptarë etnikë).

Janë me rëndësi sidoqoftë deklaratat mbi falsifikimin e varreve të bëra nga Del Ponte në dy fjalime të saj në Këshillin e Sigurimit, në vitin 1999 e 2000. Në 1999, pas zhvarrosjes së 2108 kufomave, ajo tha:

> Kjo shifër (2,108 trupa të vdekurish) nuk pasqyron domosdoshmërisht numrin total të viktimave, sepse ne kemi dëshmi të falsifikimit të varreve Gjendet një numër i konsiderueshëm vendesh, ku numri i saktë i kufomave nuk mund të llogaritet. Në këto vende, ka patur veprime për të fshehur provat e krimit. Shumë trupa janë djegur, por në këto vendvarrime, investigimi ligjor është sidoqoftë i pajtueshëm me deklarimet e bëra nga dëshmitarët në krim. [42]

Në një fjalim tjetër, Del Ponte theksoi se "Nuk do të jetë kurrë e mundur të marrim vesh shifrën e saktë të viktimave, për shkak të përpjekjeve të qëllimta për t'i djegur kufomat apo për t'i fshehur ato në rrugë të tjera". [43]

Gjykata Ndërkombëtare e Hagës ka zbuluar falsifikime varresh në Izbicë, Trepçë, Krushë e Vogël, e Cerkolez. Human Rights Watch, OSBE, dhe organizata të tjera që kanë dokumentuar dhunimin e ligjit humanitar dhe të drejtave njerëzore kanë mbledhur gjithashtu dëshmi të falsifikimit të varreve masive dhe të përpjekjeve të tjera për të fshehur dëshmi të masakrave të kryera nga forcat serbe e jugoslave përpara 12 qershorit 1999. Këto dëshmi flasin për zhvendosjen e kufomave, heqjen e tyre nga varret masive e vendosjen në varre individuale, djegjen e trupave, dhe zhvendosjen apo ndërrimin e veshjeve apo të shenjave personale, në mënyrë që të komplikohej procesi i identifikimit

Human Rights Watch grumbulloi dëshmi të besueshme lidhur me falsifikimin e varreve në Krushën e Vogël, Krushën e Madhe, Pastasel, Sllovinje, Poklek, Kotlinë, Rezallë, Izbicë, Tërrnje, e Gjakovë, ku të paktën shtatëdhjetë e shtatë kufoma u zhvendosën nga varreza e qytetit. Në Tërrnje, pranë Suharekës, u vranë më 25 mars nga forcat serbe 24-36

Dëshmi për zhvendosjen e kufomave

"Herët në mëngjes, dëgjova një kamion që vinte nga Leshani. I dëgjova ata të frenonin dhe të hapnin dyert metalike, dhe unë e dija që ata erdhën të merrnin kufomat. Unë i ndjeva kur filluan t'i ngarkonin, dëgjoja gjithashtu se si serbët ankoheshin për kutërbimin që lëshonin. Ata i ngarkuan të gjitha kufomat, dhe u ktheyn në Leshan .... Në mbrëmje, gjeta vetëm një xhaketë fëmijësh të harruar në oborr".

Intervistë e Human Rights Watch me N.B., Tërrnje, Kosovë, 29 gusht, 1999

"Më 24 prill pashë serbët të vinin e të merrnin kufomat. Erdhën dy kamionë civilë. Përveç kamionëve, ata përdornin një bulldozer të vogël. Ishin njerëz të maskuar, të paisur me takëme mjekësore. Ata morën kufomat në të dy kamionat për t'i çuar në Rrahovec. Të mos dish vendin ku janë fshehur kufomat, për ne është si të jenë vrarë për herë të dytë".

Intervistë e Human Rights Watch me T.K., Pastasel, Kosovë, 26 qershor 1999

"Katër ditë pas masakrës (në Krushën e Madhe), policia serbe arriti me buldozerë, me kamion, dhe me disa makina ushtarake. Ata mblodhën kufomat dhe i morën me vete. Nuk patëm mundësi t'i filmonim, dhe nuk e dimë se çfarë bënë me këto kufoma".

Intervistë e Human Rights Watch me R.E., Kukës, Shqipëri, 8 qershor 1999

"Dëshmi të falsifikimit, që duhet të bëhen të disponueshme, përbëjnë në fakt një dëshmi të plotë fajësie.... Nëse dikush mund të gjurmojë, prej nga ku erdhi urdhëri i falsifikimit, mund të na bëjë të arrijmë në përfundimin se ky veprim është kryer për të fshehur të vërtetën, gjë që vërteton fajësinë".

Ish-kryeprokurori i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës Louise Arbour i cituar nga Agence France Press, "Prokurori i Kombeve të Bashkuara i thotë Beogradit: "Mos falsifikoni dëshmitë", 21 janar 1999.

fshatarë. Katër ditë më vonë, një dëshmitar pa një person të paidentifikuar, i cili merrte kufomat me një kamion. Dëshmitari tha:

> Herët në mëngjes, dëgjova një kamion që vinte nga Leshani (Lesane, në serbisht). I dëgjova ata të frenonin dhe të hapnin dyert metalike, dhe unë e dija që ata erdhën të merrnin kufomat. Unë i ndjeva kur filluan t'i ngarkonin, dëgjoja gjithashtu se si serbët ankoheshin për kutërbimin që lëshonin. Ata i ngarkuan të gjitha kufomat, dhe u kthyen në Leshan.[44]

Në Sllovinje, Human Rights Watch vizitoi një vendvarrim të përkohshëm jashtë fshatit, në të cilin gjashtëmbëdhjetë viktimat e masakrës së 16 prillit ishin varrosur nga të afërmit të nesërmen (shih komunën e Lipjanit). Kufomat ishin nxjerrë me eskavator dhe ishin zhvendosur më vonë nga forcat e sigurimit serb, dhe të afërmit nuk kishin asnjë ide se ku kishin përfunduar. Në Poklek, rreth dyzet e shtatë viktima të masakrës së 17 prillit u gjuajtën fillimisht me mitraloz, përpara se granatat e dorës t'i bënin copë-copë në dhomën ku ishin shtrirë. (Shih rajoni i Drenicës) Shumë kufoma të tjera u nxorrën nga pusi në kopësht. Më në fund, shtëpisë ju vu zjarri. Të afërmit i treguan një eksperti të Human Rights Watch një kuti me kocka njeriu të mbledhura nga dhoma gjatë një vizite në vendngjarje në korrik 1999. Në fshatin Kotlinë, Human Rights Watch pa një pjesë pylli, ku forcat e sigurimit serb ishin përpjekur të fshihnin dëshmitë e masakrimit të njëzet e dy vetëve, duke i kallur trupat e tyre në gropa të thella natyrale dhe duke hedhur eksploziv brenda.

Janë bërë dy studime shkencore, të cilat merren me çështjen e numrit të shqiptarëve të vrarë. Studimi i parë, i botuar në qershor 2000 nga Qendra Amerikane për Kontrollin e Sëmundjeve, [45] është një analizë epidemiologjike e të gjitha vdekjeve në Kosovë gjatë viteve '98 e '99. Bazuar në vëzhgimet në familje dhe në shkallën e vdekshmërisë së paraluftës, ky studim arrin në përfundimin që 12 mijë vetë kanë vdekur si rezultat i "traumës së lidhur me luftën". Eshtë e rëndësishme të theksohet megjithatë që studimi përfshin vitin 1998 (kur ishin vrarë rreth 1 500 shqiptarë në konflikt), dhe nuk arriti të bënte dallimin midis civilëve e luftëtarëve.

Studimi i dytë, Political Killings in Kosova/Kosovo, i publikuar në tetor 2000 nga Iniciativa e Ligjit për Europën Qendrore e Lindore (CEELI) e American Bar Association dhe e American Association for the Advancement of Science (AAAS), arriti në përfundimin që midis 20 marsit e 12

qershorit 1999 ishin vrarë rreth 10 500 shqiptarë të Kosovës, ndërsa numri i saktë duhej të kërkohej në intervalin nga 7 449 deri në 13 627 vetë. [46] Raporti analizonte më tej kohëndodhjen e vendndodhjen e masakrave, duke treguar që masakrat ishin të lidhura ngushtë me fluksin e refugjatëve që dilnin nga Kosova (Shih Analizën Statistikore të dhunës).

VRASJE TË PARAMENDUARA

Përveç masakrave, ka patur përpjekje për të ekzekutuar edhe disa personalitete të rëndësishme të jetës shqiptare në Kosovë. Janë vrarë një numër politikanësh, doktorësh, veprimtarësh të të drejtave të njeriut, dhe figura të tjera publike, si dhe individë që kishin punuar për OSBE-në apo që kishin dhënë me qera shtëpitë e tyre për këtë organizatë.

Rasti i parë ishte vrasja e avokatit të mirënjohur të të drejtave të njeriut, Bajram Kelmendi, dhe e dy djemve të tij, Kushtrimit e Kastriotit, me moshë respektivisht tetëmbëdhjetë e tridhjetë e një vjeç. Bajrami ishte aktiv në Këshillin për Mbrojtjen e të drejtave e lirive të njeriut dhe gjatë vitit 1998 i kish dhënë informacion Gjykatës për Krimet e Luftës. Ai ish shumë i respektuar për aftësitë e tij si një avokat mbrojtës në gjyqe të shumta politike gjatë gjithë dekadës së fundit. [47] Së fundi, ai kish mbrojtur gazetën në gjuhën shqipe *Koha Ditore*, e cila akuzohej në gjyq për publikimin e një deklarate të përfaqësuesit politik të UÇK-së, Hashim Thaçi.

Natën e 24 marsit, që përkon me fillimin e bombardimeve të NATO-s, pesë policë me uniformë u futën me forcë në shtëpinë e Kelmendajve në rrugën "Vellusha" të Prishtinës. [48] Sipas gruas së Bajramit, Nekibe Kelmendit, edhe ajo një juriste e njohur, Kastrioti telefonoi policinë për t'u thënë se dikush ish futur me dhunë në shtëpi, por policët i mbyllën telefonin. Nekibja u përpoq të bënte të njëjtën gjë dhe ata nuk lanë as atë të fliste. Anëtarët e familjes u detyruan të shtriheshin barkas, dhe Bajramin e qëlluan në bark. Policët bënë një kontroll në shtëpi, por nuk vodhën ndonjë gjë. Rreth orës 1:30 pasdite, dolën e morën me vete Bajramin, Kushtrimin e Kastriotin, në makinën e këtij të fundit. Kushtrimit i thanë "të puthte fëmijët e tij për herë të fundit".

Nekibja u përpoq pa asnjë rezultat të merrte informacion për burrin në komisariatet e policisë dhe në spitalet e Prishtinës. Ajo kontaktoi gjithashtu Natasha Kandiç-in, drejtoresha ekzekutive e Qëndrës së Ligjit Humanitar,

një prej grupeve jugosllave më të respektuara të të drejtave të njeriut, e cila e publikoi këtë rrëmbim. Në mëngjesin e 26 marsit, Nekibja u informua se kufomat e Bajramit e të dy djemve të saj ishin gjetur në një distributor gazi në rrugën që lidh Prishtinën me Fushë Kosovën. Ishin vrarë që të tre.

Vrasja e Bajram Kelmendit dhe e djemve të tij terrorizoi Prishtinën dhe profesoratin shqiptar në Kosovë – dikush me një profil publik si politikan, dikush veprimtar i të drejtave të njeriut, gazetar, artist apo akademik. Në prishtinë u përhap paniku, pasi dyshohej se forca të papërgjegjshme do të likujdonin personalitete të jetës publike kosovare. Ndërsa ishin në pritje për të marrë lajme mbi vdekjen e Kelmendajve, shumë shqiptarë vendosën ta linin Kosovën.

Pothuajse në të njëjtën kohë, figura të tjera të shquara u vranë në pjesë të ndryshme të Kosovës. Më 25 mars, forcat e sigurimit serb hynë forcërisht në shtëpinë e mjekut të respektuar të Gjakovës, Dr. Izet Himës, dhe e vranë në sy të së shoqes. Një jurist i mirënjohur, Urim Rexha, dhe një udhëheqës i UÇK-së, Mark Malota, u vranë gjithashtu po atë ditë në Gjakovë (Shih komunën e Gjakovës). Dy veprimtarë të njohur të LDK-së

Përkujtime

BAJRAM (SOKOL) KELMENDI

KASTRIOT (BAJRAM) KELMENDI

KUSHTRIM (BAJRAM) KELMENDI

Avokati i parë i të drejtave të njeriut Bajram Kelmendi dhe dy djemtë e tij, Kastriot dhe Kushtrim, të vrarë nga forcat e sigurimit të Serbisë në natën e 24 marsit 1999.

FOTO "KOHA DITORE"

në Mitrovicë u vranë në rrethana të paqarta: Agim Hajrizi dhe Latif Berisha.

Më 27 mars, forca të paidentifikuara të sigurimit ndaluan sekretarin e LDK-së së Fushë Kosovës, së bashku me gruan e tij dhe një familje tjetër shqiptare që jetonte aty pranë. Sipas raportit të OSBE-së për Kosovën, burrat u rrahën kafshërisht në dhomat, ku ishin të paraburgosur. Ata u lëshuan më 28 mars, dhe sipas shumë gjasave morën rrugën për në Maqedoni. Më 4 prill, sekretari i LDK-së, të cilit nuk i përmendet emri në raportin e OSBE-së, vdiq nga plagët e marra në një spital të Tetovës, në Maqedoni. [49]

Ndoshta vrasja më e bujshme ishte ajo e Fehmi Aganit, një profesor dhe udhëheqës i LDK-së. Agani ish një politikan i respektuar nga shumica e njerëzve të angazhuar politikisht: nga partia e tij, UÇK-ja, negociatorët ndërkombëtarë, madje edhe nga interlokutorët e tij serbë. Gjatë shumë viteve, ai u pa si një lojtar shumë i rëndësishëm në politikën e LDK-së, dhe si një njeri, i cili ish vazhdimisht në kërkim të një zgjidhjeje paqësore të krizës. Inteligjenca e popullariteti janë motivet e mundshme të vrasjes së tij.

Rrethanat e vdekjes së Aganit mbeten të paqarta. Më 6 maj, Agani, së bashku me familjen e tij, tentoi të linte Kosovën me tren. Në kufirin me Maqedoninë, treni u kthye mbrapsht. Diku afër Fushë Kosovës, policia ndaloi trenin dhe urdhëroi të zbrisnin të gjithë. Dëshmi të ndryshme të botuara në shtyp thonë se Agani u mor ose në një autobus së bashku me burra të tjerë shqiptarë, ose i vetëm me policët brenda një makine private. Kufoma e tij u gjend të nesërmen buzë një rruge gjithë baltë, pranë Lipjanit. Qeveria serbe ngriti pretendimin se Agani është vrarë nga UÇK-ja, në mënyrë që ta pengonin të luante rolin e negociatorit midis Rugovës e qeverisë serbe. Një deklaratë e policisë e publikuar më 7 maj 1999, tha:

Hamendësohet se terroristët e të ashtuquajturës UÇK e kanë mbajtur Aganin të izoluar me synimin për të penguar

Fehmi Agani, profesor dhe anëtar drejtues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, u vra në rrethana të paqarta më 6 maj 1999, pasi u nxorr nga treni prej policisë serbe.

FOTO "ZERI"

Qendra e Ligjit Humanitar është një prej oganizatave më profesionale e më të respektuara të të drejtave të njeriut. Drejtoresha e kësaj organizate, Natasha Kandiç, shkruajti sa më poshtë me rastin e vrasjes së Bajram Kelmendit:

QENDRA E LIGJIT HUMANITAR
Natasha Kandiç

MBI VRASJEN E BAJRAM KELMENDIT
27 mars 1999

Është konfirmuar dje, në mëngjesin e 26 marsit, që Bajram Kelmendi dhe djemtë e tij janë vrarë. Një i afërm i familjes Kelmendi gjeti kufomat e tyre në stacionin e parë të gazit në rrugën që të çon nga Prishtina për në Pejë. Unë mësova për zhdukjen e tyre vetëm dy orë pasi ata ishin marrë me forcë nga shtëpia. Rreth orës 3.30 të pasdites, Nekibja, e shoqja e Bajramit, më telefonoi dhe fjalët e saj të para ishin: "Natasha, më kanë marrë Bajramin dhe fëmijët". "Kush Nekibe?" – e pyeta unë. Përgjigja e saj ishte shumë e specifikuar: "Pesë burra me uniforma të errëta, me stema të policisë e me pushkë tytëgjata në duar." Ajo kish dëgjuar të shpërthehej dera e jashtme dhe zëra që bërtisnin: "Keni pesë sekonda kohë në dispozicion për të dalë nga dhoma." Ndërsa ata ngjisnin shkallët për në katin e sipërm, Nekibja gjeti rastin për t'i telefonuar postës lokale të policisë. Ata e dëgjuan zërin e saj e nuk ia vunë veshin. Nuk shkuan. Ajo telefonoi edhe njëherë pasi Bajrami e djemtë e tij u morën forcërisht nga shtëpia. Këtë herë policia i mbylli telefonin…

Bajram Kelmendi. Një avokat i zoti përherë mes njerëzve. Mbrojtja që ai u bëri shqiptarëve të akuzuar të Ferizajt në gjykatën e rrethit të Prishtinës do të kujtohet si analiza më e mirë ligjore e politike e ngjarjeve në Kosovë. Unë kurrë nuk e kam parë atë aq të cënueshëm, sa në gjyqin e Pejës më 11 shkurt. Me shikimin e mjegulluar, ai dëgjonte Marijen dhe djalin e saj Miomir Pejuskoviç, serbë nënë e bir, tek dëshmonin në gjyq për fqinjët e tyre shqiptarë në fshatin Grabofc, të konsideruar "terroristë". Marija dhe djali i saj flisnin me mallëngjim për Avdiun, Sadriun dhe Syl Krasniqin, për ndihmën që ata u kishin dhënë në çdo rrethanë, sidomos kur situata në Kosovë u përkeqësua. Fqinjët shqiptarë i morën në mbrojtje ata, i inkurajuan, u thanë se gjërat do të normalizohen përsëri e se ata do të jetojnë së bashku, ashtu siç kishin jetuar gjatë dyzet viteve të fundit.

Nderimi im shkon për Bajram Kelmendin. Drejtësi për Bajramin dhe djemtë e tij! Drejtësi për Kosovën!

angazhimin e tij në negociatat midis Rugovës dhe qeverisë së Serbisë. Kur Rugova u nis për në Romë, ata nuk kanë patur interes për ta mbajtur më tej të izoluar, kështu që e vranë. Ky akt terrorist mund të interpretohet pa asnjë dyshim si një konfirmim i vendimit tashmë të shpallur të UÇK-së për të bërë të njëjtën gjë edhe me zotin Ibrahim Rugova. [50]

Personalitete të tjerë të mirënjohur, si Latif Berisha, kryetari i LDK-së në Mitrovicë, [51] Din Mehmeti, poet, dhe Teki Dervishi, shkrimtar, u vranë gjithashtu. [52] Më 24 mars, roja i gazetës "Koha Ditore" u qëllua dhe u vra nga policët, ndërsa këta të fundit tentuan të plaçkisnin zyrat e redaksisë.

Një grup tjetër shqiptarësh të kërkuar për t'u ekzekutuar ishin ata, që punonin me misionin e Vëzhguesve të OSBE-së. Sapo ky mision u tërhoq nga Kosova më 19 mars, zyrat e tij u plaçkitën e u dogjën, dhe një pjesë e madhe stafit shqiptar u kërkuan nga policët e paraushtarakët, me qëllimin për t'i rrahur apo për t'i vrarë. Rasti më i keq i hakmarrjes ndodhi në Suharekë kundër familjes Berisha, e cila i kish dhënë me qera OSBE-së dy shtëpi. Më 25 e 26 mars, forcat serbe vranë të paktën njëzet e katër anëtarë të familjes, mes të cilëve njëmbëdhjetë fëmijë të moshës nën gjashtëmbëdhjetë vjeç. (Shih komunën e Suharekës)

PËRDHUNIMET DHE ABUZIMET SEKSUALE

Përdhunime dhe forma të tjera të dhunës seksuale u përdorën në vitin 1999 në Kosovë si armë lufte apo instrument i një "spastrimi etnik" sistematik. [53] Përdhunimet nuk ishin akte të rralla e të izoluara të kryera nga individë të forcave serbe e jugosllave, por u përdorën qëllimisht si një instrument për të terrorizuar popullsinë civile, për të zhvatur pará nga familjet, dhe për të detyruar njerëzit të braktisnin shtëpitë e tyre. Përdhunimet ishin gjithashtu në funksion të synimit për të larguar me forcë shqiptarët nga Kosova.

Në total, Human Rights Watch gjeti dëshmi të besueshme për nëntëdhjetë e gjashtë raste të përdorimit të dhunës seksuale nga ana e ushtarëve jugosllavë, e policëve serbë dhe e paraushtarakëve, gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, dhe numri i saktë i rasteve të tilla është sipas gjasave shumë më i lartë. Në gjashtë prej këtyre rasteve, Human Rights watch pati mundësinë të bënte intervista e të hynte në

detaje më të intervistuarat. Human Rights Watch takoi dy gra të tjera, të cilat pranuan se ishin përdhunuar, por refuzuan të dëshmonin. Në fund, Human Rights Watch dokumentoi gjashtë raste të grave, të cilat ishin përdhunuar e më pas ishin vrarë.

Nëntëdhjetë e gjashtë rastet përfshijnë gjithashtu raportime të organizatave të tjera jo qeveritare, të vlerësuara si të besueshme nga Human Rights Watch. [54] Human Rights Watch bëri ç'është e mundur për t'i mbështetur këto dëshmi me intervista të dhjetra mamive, doktoreshave, dëshmitareve dhe aktivisteve lokale të të drejtave të njeriut e të të drejtave të grave. Eshtë e rëndësishme të theksohet që disa prej këtyre rasteve mund të jenë llogaritur dy herë nga organizatat lokale e ndërkombëtare. Pavarësisht nga ky fakt, Human Rights Watch beson se numri i saktë i grave të përdhunuar në Kosovë prej marsit deri në qershor 1999, ishte shumë më i lartë se nëntëdhjetë e gjashtë, pasi përgjithësisht viktimat shqiptare të dhunës seksuale nuk pranojnë të flasin për çështje të tilla. Në të njëjtën kohë, duhet të nënvizohet se Human Rights Watch nuk pati mundësinë të konfirmonte pohimet mbi egzistencën e kampeve të përdhunimit në Kosovë, fakt që u deklarua gjatë luftës nga qeveria e Shteve të Bashkuara, nga qeveria britanike dhe nga NATO.

Në përgjithësi, përdhunimet në Kosovë mund të grupohen në tri kategori: përdhunime të grave në shtëpitë e tyre, përdhunime gjatë shpërnguljes e përdhunime në dhomat e paraburgimit. Në kategorinë e parë, forcat e sigurimit hynin në shtëpitë private dhe përdhunonin gratë në prani të anëtarëve të tjerë të familjes, në oborr apo në një prej dhomave të shtëpisë. Në kategorinë e dytë, njerëz që shpërnguleshin brenda territorit të Kosovës, që udhëtonin më këmbë apo mbi zetorë, vazhdimisht ndaloheshin, plaçkiteshin e kërcënoheshin nga ushtarët jugosllavë, nga policët serbë apo nga paraushtarakët. Nëse familjet nuk kishin pará, forcat e sigurimit shpesh i kërcënonin, duke u thënë se do t'u merrnin vajzat me vete e do t'i përdhunonin; në disa raste, edhe pse familjet nuk nguronin të jepnin paratë që kishin me vete, vajzat e tyre rrëmbeheshin. Kategoria e tretë lidhet me përdhunimet në qëndra të ndalimit të përkohshëm, si në shtëpi apo ahure të braktisur.

Në një rast, i cili përfshihet tek kategoria e dytë, viktima e përdhunimit i tregoi Human Rights Watch se si ajo ishte zbritur nga zetori dhe ish tërhequr zvarrë nga një paraushtarak serb në dalje të fshatit Zhur, dhe

Vendet e treguara në këtë hartë bazohen në përllogaritjet e raportuara nga Human Rights Watch, Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat (Tiranë), Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Femijëve (Prishtinë), Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, Mjekët pa Kufij, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (Prishtinë), Qendra Ligjore Humanitare (Beograd dhe Prishtinë), si dhe nga burime të besueshme të dorës së parë si viktima dhe dëshmi të botuara në media. Human Rights Watch nuk mund të provojë besueshmërinë e këtyre përllogaritjeve. I gjithë informacioni i përdorur për përpilimin e kësaj harte buron vetëm nga dëshmi ose intervista të kryera drejtpërdrejtë me dëshmitarë ose viktima. Intervistat janë bërë nga përfaqësues të organizatave të sipërpërmendura, si dhe nga gazetarët.

KOSOVA

Incidente të raportuara përdhunimi shkurt-qershor 1999

Çdo simbol përfaqëson një incident të raportuar përdhunimi në Kosovë

Shënime:

1. Në shumë nga incidentet e raportuara dhe të paraqitura në hartë ka një numër të shumëfishtë përdhunimesh për të njëjtin vend.
2. Përveç incidenteve në hartë, janë raportuar edhe 16 incidente të tjera përdhunimi në lokalitete te panjohura në të gjithë Kosovën.
3. Lokalitetet e incidenteve të treguara në hartë janë ndryshuar për të ruajtur fshehtësinë e individëve por ndërkohë ruhet shpërndarja rajonale e incidenteve.

Italy

se si ishte përdhunuar në sy të dhjetra refugjatëve të tjerë. Viktima, një nënë tridhjetëvjeçare, që udhëtonte me të ëmën, me vjehrrën, dhe me dy fëmijët e saj, i tregoi Human Rights Watch:

> Na ndaluan dy serbë të veshur me uniformë. Një djalë i bëshëm me flokë të kuq më bëri zë të zbrisja nga zetori. Flokëkuqi erdhi afër zetorit dhe tha, "ti", duke bërë me gisht nga unë. Kur ai më tha të zbrisja nga zetori, unë nuk ju binda. Atëherë ai ulëriti, "Ti! Zbrit prej aty!" Djali im tre vjeçar po flinte në prehërin tim. Ai vazhdonte të ulërinte, "Zbrit prej aty! Zbrit prej aty!" Më tërhoqi poshtë dhe filloi të më shqyejë rrobat e trupit. Ai kish hapur tashmë pantallonat dhe kish nxjerrë penisin jashtë. Më grisi gjimbajtësen, dhe unë zura të bërtisja e të qaja. Serbi tjetër erdhi aty pranë dhe më drejtoi armën e tij automatike në gjoks. Unë kisha veshur çitjane, në mënyrë që ata të mendonin se isha e moshuar. Flokëkuqi mi hoqi çitjanet, duke më shqyer llastikun, dhe më tha të shtrihem. Më mori dhjetë marka që i kisha me vete. Ai i hoqi fare pantallonat e tij dhe më tërhoqi pas vetes. Ne ishim fare pranë zetorit, pranë kabinës së drejtuesit. Isha me menstruacione. Kur më hoqi të mbathurat, ai pa shtupat e gjakosura në to, dhe kështu ai nuk bëri seks me mua. Më rrotulloi, më shtrëngoi gjoksin me duar, dhe u përpoq të bënte atë punë nga prapa (përdhunim anal). Unë e tkurra trupin në maksimum, dhe ai nuk ia doli dot mbanë. Ndoshta u prish. Nuk e di, por pas tri apo katër minutash, ai më tha të hipja në zetor. [55]

Dëshmitarët e kësaj ngjarjeje, të cilët u ndodhën me të më 2 qershor 1999, e pasuruan dëshminë e viktimës me detaje të tjera. Drejtuesi i zetorit, i cili kaloi kufirin pak më vonë po atë ditë, ashtu si dhe pasagjerët, që ishin me të, konfirmuan përshkrimin e dy njerëzve me uniformë. Një dëshmitar i një skene përdhunimi, një djalosh tetëmbëdhjetë vjeçar nga Gjinoci i komunës së Suharekës, i tregoi Human Rights Watch:

> Ai e tërhoqi atë në asfaltin e rrugës dhe e përdhunoi në sy të të gjithëve. Vetëm njëri prej serbëve e përdhunoi atë. Serbi tjetër godiste gjindjen me kondakun e pushkës dhe bërtiste, "Qetësi, qetësi!" Ne të gjithë e kthyem shikimin në krahun tjetër. Kjo skenë zgjati tre apo katër minuta. Ai bëri gjithçka ngjitur me zetorin. [56]

Me ndonjë përjashtim, përdhunimet e dokumentuara nga Human Rights

Watch ishin përdhunime banditësh në grupe të vogla, shpesh dyshe. Në shumë raste, viktimat dhe dëshmitarët i identifikonin autorët si pjesëtarë të policisë speciale serbe, me uniforma blu apo blu të errëta, ose ushtarë të VJ-së, me uniforma të gjelbërta ushtarake. Megjithatë, shumica e rasteve të përdhunimit u kryen nga paraushtarakë serbë, të cilët vishnin uniforma të ndryshme dhe shpesh mbanin shami, thika të mëdha, flokë të gjatë e mjekër. Këto formacione paraushtarake bashkëpunonin ngushtë në të gjithë Kosovën me forca zyrtare të qeverisë, qoftë të Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme, qoftë të Ushtrisë Jugosllave (Shih forcat në konflikt).

Autoritetet serbe e jugosllave e dinin që paraushtarakët kishin kryer përdhunime e forma të tjera të dhunës seksuale në Bosnjë e Hercegovinë. Përveç kësaj, paraushtarakët ishin dislokuar apo lejuar të vepronin në Kosovë nga autoritetet serbe e jugosllave, pa marrë asnjë masë për parandalimin e kryerjes së krimeve të tilla të luftës.

Pjesëmarrja e forcave serbe e jugosllave në përdhunime e bën të pagjasë pretendimin se zyrtarët e lartë nuk dinin çfarë ndodhte. Përdhunimet kryheshin shpesh në praninë e me pëlqimin e oficerëve të ushtrisë. Disa viktima të përdhunimit i kanë raportuar këto krime si të lidhura me oficerë të Ushtrisë Jugosllave. Edhe sot e kësaj dite nuk ka ndonjë fakt, ndonjë arrestim apo ndëshkim, që të flasë për reagimin e Ushtrisë Jugosllave e të Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme kundër këtyre krimeve. Pavarësisht nga kjo shkujdesje e mungesë përgjegjësie në detyrë, shumë drejtues të policisë e ushtrisë që morën pjesë në fushatën e Kosovës, u dekoruan apo u graduan pas përfundimit të luftës.

Nuk ka ndonjë fakt gjithashtu, që të flasë lidhur me masa të marra nga Ushtria Jugosllave e nga Ministria e Punëve të Brendshme për të parandaluar përdhunimet apo forma të tjera të dhunës seksuale, siç mund të jenë fjala vjen nxjerrje urdhërash apo ndonjë paralajmërim se do të kish ndëshkime për këto krime, ndonëse kish ndonjë rast kur policë apo ushtarë merrnin në mbrojtje gra të sulmuara nga paraushtarakët. Për më tepër, ushtarë, policë e paraushtarakë i përdhunonin shpesh viktimat e tyre në prani të shumë dëshmitarëve. Përveç përdhunimeve në prani të të tjerëve, procesi i rrëmbimit të grave prej karvaneve të refugjatëve kryhej gjithashtu në sy të të gjithëve.

DËBIMET E DHUNSHME

Gjatë ’98-ës e muajve të parë të ’99-ës, ndodhi një shpërngulje e madhe njerëzish në Kosovë: më shumë se 200 mijë shqiptarë u zhvendosën brenda për brenda, rreth 70 mijë e lanë krahinën dhe u drejtuan për në vendet fqinjë e për në Mal të Zi, dhe njëqind mijë të tjerë me shtetësi jugosllave, shumica e të cilëve shqiptarë, kërkuan azil në Europën Perëndimore. [57] Por ashtu siç u bë e qartë nga diskutimi i mësipërm, disa vëzhgues perëndimorë besonin se Beogradi do të tentonte të dëbonte nga Kosova gjithë popullsinë shqiptare. Askush nuk mund të parashikonte shpejtësinë dhe shkallën e dëbimit: tri javë pas fillimit të goditjeve ajrore të NATO-s, numri i refugjatëve të Kosovës në vendet fqinjë ish 525 787. [58] Një muaj më vonë, më 12 maj, ky numër arriti në 781 618. [59] Në total, ushtria jugosllave, policia serbe e paraushtarakët dëbuan 862 979 shqiptarë të Kosovës, [60] ndërsa disa qindra mijra të tjerë u përballën me shpërngulje të brendshme. Këtu nuk llogariten të ikurit para muajit mars. [61] Këto shifra tregojnë që në fillim të qershorit 1999, më shumë se 80% e gjithë popullsisë së Kosovës dhe 90% e shqiptarëve etnikë ishin shpërngulur nga shtëpitë e tyre. Rreth 440 mijë refugjatë shkuan në Shqipëri dhe 320 mijë në Maqedoni (nga të cilët, 80 mijë u transferuan në vende të treta jo ballkanike). Mali i Zi priti rreth 70 mijë refugjatë, ndërsa Bosnja e Hercegovina më shumë se 30 mijë.

Flukset e refugjatëve nga marsi deri në qershor përgjithësisht ndoqën parimin e kufirit më të afërt. Banorë të gjysmës perëndimore të Kosovës përgjithësisht ju drejtuan kufirit jugperëndimor me Shqipërinë dhe banorët e gjysmës lindore përgjithësisht ju drejtuan kufirit juglindor me Maqedoninë. Afërmendsh, banorë shqiptarë të Mitrovicës, Vushtrrisë dhe zonave të tjera të Kosovës veriore përgjithësisht u dërguan në kufirin shqiptar. Shumë banorë të Pejës dhe të pjesës më perëndimore të Kosovës u drejtuan për në Mal të Zi, ndërsa një pjesë e banorëve të pjesës më lindore hynë fillimisht në Serbinë jugore, e më pas kaluan kufirin për në Maqedoni. Në disa zona u vu re një zhvendosje relativisht e ulët: Një kordon ushtarak dhe një mungesë gatishmërie për të braktisur vendin, bënë që vetëm pak njerëz nga rajoni i Drenicës ta

Ushtria jugosllave, policia serbe e paraushtarakët dëbuan 862 979 shqiptarë të Kosovës, ndërsa disa qindra mijra të tjerë u përballën me shpërngulje të brendshme.

linin Kosovën, në ndryshim nga ata që u dëbuan nga qyteti i Gllogofcit në ditët e para të majit. (Shih rajonin e Drenicës) Fakti i afërsisë me kufirin mund të krijojë përshypjen e ikjeve vullnetare, por thëniet e qindra refugjatëve të intervistuar nga Human Rights Watch e organizata të tjera në Shqipëri, Maqedoni e Bosnjë tregojnë të kundërtën.

Shpërngulja e popullsisë etnike shqiptare nga Kosova u krye nëpërmjet një niveli koordinimi e kontrolli, gjë që e bën të pamundur të besosh se nuk kishim të bënim me një dëbim sistematik të detyruar. Të paktën katër faktorë janë të një rëndësie të veçantë për të arritur në përfundimin që në Kosovë është aplikuar politika e "spastrimit etnik". Së pari është koha e mbërritjes së refugjatëve – refugjatët arritën në Shqipëri e Maqedoni nga të njëjtat zona e në të njëjtat data, dhe në kohë të ndryshme (sidomos gjatë negociatave) fluksi i refugjatëve u frenua apo u orientua nga njëri kufi në tjetrin. Së dyti, janë mjetet e nisjes: refugjatët u dëbuan në Maqedoni me tren, gjë që ndihmonte spostimin efektiv të mijrave njerëzve në ditë. Të tjerë, përfshirë ata që u dërguan në Shqipëri, të cilët nuk kishin mundësi të organizonin vetë transportimin, u morën me kamionë e autobuzë nga policia serbe. Për të lehtësuar dëbimin u përdorën pika grumbullimi. Së treti është përdorimi i kërcënimeve e i dhunës për të terrorizuar e shtrënguar popullsinë të ikte, dhe këtu kemi të bëjmë me një element qëndror të strategjisë së "spastrimit etnik", i vënë re shpesh gjatë luftrave në Bosnjë e Kroaci. Së katërti është strategjia e "fshirjes së identitetit": refugjatë të dëbuar për në Shqipëri shpesh u zhveshën nga dokumentat e identifikimit dhe u shtrënguan të dorëzonin patentat e drejtimit të makinave e zetorëve, para se të lejoheshin për të kaluar kufirin.

Duke u nisur nga fakti që 90% e refugjatëve kosovarë iu drejtuan kufirit shqiptar e maqedonas, analiza e njëkohshmërisë dhe tipologjia e dëbimit duhet të fokusohen domosdoshmërisht tek mbërritja në këto dy vende. Human Rights Watch kishte ekspertë të pranishëm në të dy këto vende prej javës së fundit të marsit deri në fundin e luftës (mesi i qershorit 1999). Ekspertët kishin mundësi të vëzhgonin kohëndodhjen dhe tipologjinë e arritjes së refugjatëve. Nëse refugjatët po iknin prej bombardimeve të NATO-s apo prej luftimeve midis forcave jugosllave e UÇK-së, dikush do të priste që refugjatët të mbërrinin të veshur si të mundnin e në kohë të ndryshme, në varësi të vendimeve të marra në përputhje me rreziqet që paraqiten. Në fakt, të gjithë refugjatët arritën të grupuar fshatçe e në bazë komune në Shqipëri e Maqedoni. Bënin

përjashtim rastet, kur një pjesë e banorëve drejtoheshin në Shqipëri e pjesa tjetër e të njëjtit vendbanim drejtoheshin në Maqedoni.

Ndonëse ata ishin nevojshmërisht të përzgjedhur, kronologjia e intervistave të Human Rights Watch na jep në një farë mënyre mekanizmin se si funksionon ky proces. Në Maqedoni, Human Rights Watch intervistoi kryesisht refugjatë të sapombërritur nga Prishtina në javën e parë (duke filluar nga 24 marsi). Në javën e dytë e të tretë pjesa më e madhe e të sapombërriturve ishin nga komuna e Kaçanikut dhe e Shterpces. Në javën e katërt, një numër i madh refugjatësh erdhën nga Gjilani. Në javën e pestë, të sapombërriturit ishin kryesisht nga komuna e Lipjanit. Po kështu në Shqipërinë e veriut, Human Rights Watch intervistoi shumë prej të sapombërriturve nga komuna e Prizrenit gjatë javës së parë; në javën e dytë, shumë refugjatë erdhën nga Suhareka e Gjakova, dhe në javën e tretë erdhi një fluks i madh nga Mitrovica e të tjerë nga Gjakova. Flukset e refugjatëve për në Maqedoni u frenuan në shumë raste, sidomos në fillim të qershorit, kur u negociuan detajet e një marrëveshjeje midis qeverisë jugosllave e NATO-s. Siç bën të ditur OSBE-ja, "fluksi i refugjatëve ishte gjithashtu i rregulluar, duke arritur që disa mijra të arrinin në pikat e kalimit të kufirit me Shqipërinë, me ish-republikën jugosllave të Maqedonisë dhe me Malin e Zi në ditë të caktuara, por pastaj vetëm një grusht refugjatësh të arrinin në pika kalimi të veçanta në ditët e mëvonshme.

Një përpjekje më sistematike e shqyrtimit të tipologjisë së fluksit të refugjatëve në drejtim të Shqipërisë, e drejtuar nga American Associaton for the Advancement of Science (së bashku me East-West Management Institute dhe Institute for Legal and Policy Studies), konfirmon këtë analizë. Studimi statistikor fillimisht shfrytëzoi të dhënat e mbledhura gjatë krizës nga doganierët shqiptarë në pikën kufitare të Morinës. Studimi arrin në përfundimin që "eksodi masiv i refugjatëve të Kosovës (për në Shqipëri) u zhvillua sipas tipologjive kaq të rregullta, sa ai duhet të ketë qënë i koordinuar". Raporti më tej krahasonte kohët e karakteristikat e dëbimit gjatë bombardimit të NATO-s, dhe konkludoi që "vetëm një pjesë shumë e vogël e shqiptarëve e lanë Kosovën si rezultat i drejtëpërdrejtë i këtyre bombardimeve." [63] (Shih Analizën statistikore të dhunimeve, ku bëhet një trajtim i mëtejshëm)

Mënyra se si shumë refugjatë e kanë lënë Kosovën tregon gjithashtu se më shumë kemi patur të bëjmë me një dëbim të organizuar se sa me një nisje spontane. Çpopullimi i kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, është një

rast i mirë në këtë mes. Pak ditë pas fillimit të goditjeve ajrore të NATO-s, policia e paraushtarakët serbë nisën në mënyrë sistematike të spastronin qytetet, në të cilët popullsia shqiptare përbënte shumicën. Dëshmitarët nga rrethinat e Kodrës së Trimave, Tashlixhës, Dragodanit e Dardanisë i kanë treguar Human Rights Watch që nga fundi i marsit, policë e paraushtarakë të maskuar shkuan derë më derë për t'u thënë banorëve të iknin menjëherë. M.B., një nënë e dy fëmijëve nga Tashlixhe tregoi se i kishin thënë: "Hajde, dil jashtë! Duhet të shkoni tek stacioni hekurudhor." Në disa raste njerëzve u ish thënë se do të vriteshin nëse nuk bindeshin. Një doktori dhe familjes së tij, njerëz të maskuar i kishin thënë: "Nëse nuk ikni brenda një minute, do t'iu vrasim të gjithëve." [65]

Pasi linin shtëpitë e tyre, njerëzit udhëzoheshin nga policia të shkonin në stacionin qendror hekurudhor të Prishtinës, ndërsa shumë të tjerë ikën me makinat e tyre. Anët e rrugëve ishin të blokuara nga policë e paraushtarakë të armatosur: një banor i Kodrës së Trimave tha se "kush tentonte të ndërronte udhë, kthehej mbrapsht me forcë nga policia." [66] Mijra banorë të Prishtinës u grumbulluan tek stacioni hekurudhor, ku policë të armatosur ruanin zonën, ndërsa njerëzit nguceshin në një tren pasagjerësh të drejtuar për nga kufiri maqedonas. Trenat ishin të mbushur përtej kapaciteteve: një refugjat tregoi se ai ish një nga njëzet e tetë vetët, të cilët u shtrënguan të ngjesheshin në një kompartiment që nxinte vetëm tetë vetë. [67] Shumë refugjatë përshkruan gjithashtu njerëzit që ngarkoheshin nëpër autobuzë e kamionë në stacionin hekurudhor, i cili ishte pika e vetme e grumbullimit të banorëve të Prishtinës, prej nga ku niste dëbimi. Refugjatë të intervistuar nga Human Rights Watch treguan të kishin parë policë që tërhiqnin zvarrë njerëz prej makinave, të cilët pastaj i rrihnin. Shumica tregonin që policët, e sidomos paraushtarakët, kërkonin pará të madhe për të lejuar kalimin e qetë, dhe vidhnin bizhuteri e makina. Përdorimi i pikave të grumbullimit, sipas refugjatëve, ish një praktikë që u ndoq edhe në qytetin e Gllogofcit, në stacionet qëndrore hekurudhore të Ferizajt e të Fushë Kosovës dhe në fshatin e Bellanicës të komunës së Suharekës.

Siç tregon shembulli i Prishtinës, dhuna dhe kërcënimet shpesh ishin të përdorura për të terrorizuar popullsinë e për ta shtrënguar atë ta linte Kosovën. Banorë të komunës së Lipjanit i treguan Human Rights Watch që masakra e parë në këtë komunë (në fshatin e Sllovinjes) i bëri ata nervozë. Pas masakrave të mëpastajme në Ribarin e Vogël dhe në Hallacin e Vogël u krijua një klimë frike, e cila nuk u la tjetër për të zgjedhur, veç

të iknin (Shih komunën e Lipjanit). Krisma armësh, kontrolle të policisë, djegje shtëpish, etj, e bënte më të lehtë vendimin e tyre për të ikur.

Dhuna dhe kërcënimet shpesh ishin të përdorura për të terrorizuar popullsinë e për ta shtrënguar atë ta linte Kosovën.

Në zona, të cilat kishin lidhje historike me UÇK-në, vrasjet dhe forma të tjera dhune ishin në funksion të një qëllimi të dyfishtë: të terrorizonin popullsinë dhe të eleminonin njerëz të lidhur me rebelët. Ajo që ndodhi në Gjakovë është domethënëse: një valë e terorit të organizuar në fillim të luftës la pas dhjetra të vdekur dhe mijra refugjatë, të cilët iu drejtuan Shqipërisë veriore (Shih komunën e Gjakovës). Kjo fushatë e parë dhune në Gjakovë filloi më 24 mars, kur NATO filloi sulmin e saj mbi Jugosllavi, dhe vijoi deri më 2 prill.

Në përputhje me parimet e "spastrimit etnik" në Bosnjë e Hercegovinë, personalitete të shquara, përfshirë doktorë, avokatë e politikanë, ishin objektivat e parë që duheshin asgjësuar – një strategji e hartuar për të terrorizuar pjesën tjetër të popullsisë, për të krijuar idenë se askush nuk e kish jetën të sigurtë e për të eleminuar figura të rëndësishme të jetës publike. Besohet se janë vrarë rreth 200 gjakovarë prej 24 marsit deri më 2 prill 1999, dhe shumë syresh u zhdukën gjatë operacioneve shtëpi më shtëpi, kryer prej ushtarëve jugosllavë, policëve serbë dhe paraushtarakëve.

Gjatë kësaj periudhe u dëbua një pjesë e madhe e popullsisë. Dëshmitarë të intervistuar nga Human Rights Watch në Shqipërinë e veriut – shumica gra – përshkruan dhunën e policisë, të ushtrisë e të paraushtarakëve, e cila i parapriu dëbimit. Shumë prej tyre pohonin të kishin parë grumbuj të vdekurish, ndërsa ishin duke ikur nga qyteti. [68] Sipas një gjakovari:

> Gjithçka ishte e mirorganizuar. Ata shkonin shtëpi më shtëpi. Disa ushtarë kanë për detyrë të shkatërrojnë shtëpi, ndërsa të tjerë kanë për detyrë të shoqërojnë njerëzit për në kufi. [69]

Konfiskimi i dokumentave të identitetit dhe i patentave të grahjes së makinës nga policët serbë e rojet e kufirit për të gjithë shqiptarët që linin Kosovën ishte një gjë e zakonshme, dhe tregon gjithashtu natyrën sistematike të dëbimit. Qindra refugjatë që kaluan kufirin për në Shqipëri, treguan se ishin detyruar të dorëzonin kartat e identitetit, pasaportat dhe çertifikatat e lindjes, të cilat shpesh griseshin në sy të tyre, para se

ata të lejoheshin të kalonin kufirin. Atyre që kalonin kufirin me makinë, iu dhanë kaçavida dhe u urdhëruan të çmontonin patentat e inkorporuara në makinë. Me refugjatët që u dëbuan për në Maqedoni u sollën ndryshe: ata lejoheshin të mbanin dokumentat, edhe pasi inspektoheshin nga policia serbe (Siç u bë e njohur në seksionin, ku u shpjegua "spastrimi etnik", kjo diferencë në sjellje lidhet me shpresën e qeverisë serbe, sipas së cilës, ata që dërgoheshin në Shqipëri mund të trajtoheshin si shqiptarë të Shqipërisë e mund të bllokoheshin në kthim. Ndërsa Maqedonia, sipas të gjitha gjasave nuk do të toleronte ngulimin e përhershëm të një numri të madh shqiptarësh të Kosovës.)

Me gjithë shpjegimet që mund të bëhen, praktika e "fshirjes së identitetit" nuk ish një iniciativë rastësore e zyrtarëve serbë në kufi. Pas luftës, kapica patentash e dokumentash të djegura u zbuluan në kufirin me Shqipërinë e gjetkë në Kosovë.

Secili prej këtyre katër faktorëve (njëkohshmëria e mbërritjeve, mjetet e përdorura për t'i larguar nga shtëpitë e tyre, përdorimi i terrorit dhe praktika e "fshirjes së identitetit") është tregues i qartë i faktit, që largimi nga Kosova i 860 mijë shqiptarëve në harkun e dymbëdhjetë javëve përbën një dëbim sistematik të detyruar. Të marra së bashku, e bëjnë këtë dëshmi të pakundërshtueshme. Prokurorja e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës nuk kish asnjë dyshim, kur zyra e saj përgatiti akuzën për Sllobodan Milosheviçin, Milan Milutinoviçin, Nikolla Shahinoviçin, Dragoljub Ojdaniçin dhe Vllajko Stojiljkoviçin (Shih Forcat në Konflikt). Akuza e parë thotë:

> Forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë e të Serbisë, në një mënyrë sistematike e të dhunshme dëbuan jashtë Kosovës e shpërngulën qindra mijra shqiptarë nga shtëpitë e tyre nëpër të gjithë krahinën e Kosovës. Për të lehtësuar këto dëbime e shpërngulje, forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë e të Serbisë kanë krijuar qëllimisht një atmosferë frike dhe shtypjeje nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimeve dhe akteve të dhunës.[70]

ARRESTIMET E NDALIMET ARBITRARE

Gjatë konfliktit të armatosur të vitit 1998 e të muajve të parë të vitit 1999, arrestimet e paraburgimet e shqiptarëve të Kosovës ishin diçka e zakonshme. Abuzimet fizike e torturimi i të ndaluarve ishin

veprime të përhapura. [71] Kjo praktikë u shpeshtua gjatë periudhës mars-qershor 1999. Mijra shqiptarë u burgosën gjatë bombardimeve të NATO-s. Shumë shpesh, burrat ndaheshin nga gratë dhe mbaheshin në qendra burgimi të improvizuara, si p.sh. në shkolla e fabrika, për një periudhë disaditore, gjatë së cilës ata rriheshin e pyeteshin për lidhjet e tyre me UÇK-në. Shumë burra u ndaluan për periudha më të gjata në burgjet e Smrekonicës, Lipjanit, Istogut (Dubravës) ose Prishtinës. Një pjesë e madhe e burrave të burgosur në fundin e luftës – 1000 deri në 2000 – u transferuan jashtë Kosovës, në burgjet e vetë Serbisë; deri në mars 2001,më shumë se 400 shqiptarë mbaheshin ende në burg.

Sa për të marrë një shembull, më shumë se 300 burra e gra u paraburgosën duke u marrë nga rrugët e nga shtëpitë e tyre në Gjakovë nga 7 deri në 11 maj, pas luftimeve në rrethinat e Cabratit midis forcave qeveritare e UÇK-së (Shih komunën e Gjakovës). Një numër grash u mbajtën përkohësisht në uzinën e elektromotorrëve në Gorenjë. Burrat u mbajtën në një vend të panjohur pranë qytetit e buzë rrugës që lidh Gjakovën me Pejën.

Shqiptarë etnik të intervistuar në maj 1999 si refugjatë në Shqipëri, ata ishin ndarë nga familjet e tyre dhe ishin burgosur në burgun e Smrekovnicës (shih komuna e Vuçitërrnës).

©JOANNE MARINER/HUMAN RIGHTS WATCH

Afro gjysma e burrave u liruan brenda gjashtë ditësh, por pjesa tjetër – nja 150 vetë – u transferuan në burgjet e Pejës, Lipjanit e në burgun e atëhershëm të Dubravës (NATO e bombardoi atë burg). Një pjesë e madhe e të burgosurve, në mos të gjithë, u transferuan në burgjet brenda Serbisë, pak para se trupat e NATO-s të hynin në Kosovë më 12 qershor. Më 22 maj 2000, një gjykatë në Nish u dha dënimet për akte terrorizmi 143 gjakovarëve, shuma e të cilave arrinte në 1632 vjet heqje lirie. Gjykata e lartë serbe i liroi ata më 23 prill 2001.

Më shumë se 300 shqiptarë, qysh prej prillit, u mbajtën në burgun e Prizrenit. Njëri syresh, i cili qëndroi dy muaj i burgosur, tregoi për trajtimin që u bëhej atyre në burg:

> Më futën menjëherë në burg; Asnjëherë nuk më çuan në stacionin e policisë. Atje ata më torturonin në mëngjes, drekë e darkë. Me të mbërritur atje, më goditën me shkopinj gome. Ata më godisnin në pëllëmbët e duarve dhe në pjesën e baqthit. Ishin më shumë se 300 shqiptarë atje. Sa herë që na sillnin për të ngrënë, ata nuk harronin të na rrihnin. Gjatë katër ditëve të para, ata më rrahën çdo ditë në hollin e burgut. Bashkëvuajtësit e tjerë i nënshtroheshin të njëjtit trajtim. [72]

Më 22 prill, në qytetin e Gllogofcit, policët bastisën rrethinat dhe ndaluan për shtatë ditë një grup të madh burrash në stacionin lokal të policisë (Shih komunën e Gllogofcit). Pothuaj të gjithë burrat u rrahën mu përballë shtëpive të tyre apo gjatë rrugës për në stacionin e policisë, dhe një pjesë u detyrua me forcë të këndonin këngë nacionaliste serbe. Shumica e të burgosurve u pyetën për UÇK-në, dhe pasi i mbajtën jo më shumë se një ditë, i lëshuan. Një muaj më vonë, qindra burra të Gllogofcit u burgosën dhe u mbajtën në bodrumet e dyqaneve të qytetit. Pjesa më e madhe e burrave u liruan pas tri ditësh, por vetëm pasi iu përgjigjën pyetjeve të hetuesve e pasi u rrahën me shkopinj, me bisht lopate e me objekte metalike. Rreth nëntëdhjetë burra u transferuan në Lipjan.

Në disa fshatra, gratë u mbajtën gjithashtu në burgje të improvizuara, fjala vjen nëpër ahure e shtëpi të braktisura, ku ato i nënshtroheshin abuzimit seksual apo përdhunoheshin (Shih seksionin mbi përdhunimet). [73] Vetëm pak gra janë mbajtur në burgjet e Kosovës, siç është doktoresha Flora Brovina, e cila u tranferua në Serbi pas luftës, e dënuar me dymbëdhjetë vjet heqje lirie, por e lëshuar në nëntor 2000 (Shih abuzimet pas 12 qershorit 1999)

Në maj, më shumë se 2000 burra shqiptarë të Kosovës u burgosën në burgun e Smrekonicës pranë Mitrovicës. (Shih seksionin mbi brugun e Smrekonicës në komunën e Vushtrrisë). Human Rights Watch intervistoi më shumë se një të tretën e këtyre burrave; të gjithë pohonin se ishin rrahur nga policia gjatë ndalimit, sidomos kur pyeteshin lidhur me UÇK-në. Kur u intervistuan si refugjatë në Shqipëri, ishin të dukshme në trupat e tyre shenjat e abuzimit fizik, si sy të nxirë, vurrata plagësh, gërvishtje të lëkurës, etj. Një pjesë e madhe e burrave ishin shtrënguar të nënshkruanin pohime, sipas të cilave ata ishin të lidhur me veprimtari terroriste, para se të lëshoheshin.

Ishin të dukshme në trupat e tyre shenjat e abuzimit fizik, si sy të nxirë, vurrata plagësh, gërvishtje të lëkurës, etj.

Human Rights Watch foli gjithashtu me ish të burgosur të burgut të Lipjanit, të cilat dëshmuan për rrahjet e për kushtet e këqija atje, dhe përmendnin midis të tjerash kordonët e policëve e të gardianëve, që godisnin të sapoardhurit. Një person nga Gllogofci, i cili u çua për pesëmbëdhjetë ditë në Lipjan, e më pas, më 10 qershor, u transferua në burgun e Sremska Mitrovicës, tha:

> Fillimisht, kur ne zbritëm nga autobuzi (në burgun e Lipjanit), ne duhej të ecnim tridhjetë metra midis dy kollonave me policë, dhe ata na qëllonin me shkopinj. Brenda na thanë të zhvisheshim, dhe ata na rrahën përsëri. Na çuan në një dhomë tjetër, ku gjendeshin rreth 500 të burgosur – në një holl të një pallati sporti. Ne qëndruam të gjithë së bashku. [74]

Një lokal tjetër paraburgimi ishte burgu i Dubravës pranë Istogut – burgu më i madh i Kosovës. Nja 900-1100 të burgosur, përfshirë tridhjetë serbë, u mbajtën atje në momentin që filloi bombardimi i NATO-s, por të burgosur të tjerë u transferuan në Dubravë (përfshirë 150 gjakovarë), disa prej të cilëve vinin nga burgjet e vetë Serbisë.

NATO bombardoi burgun më 19 e 21 maj, duke vrarë të paktën nëntëmbëdhjetë shqiptarë (Shih seksionin mbi burgun e Dubravës në komunën e Istogut). Më 22 maj, forcat e sigurimit serb rreshtuan afërsisht 1,000 të burgosur në oborr dhe qëlluan mbi ta me snaipera, me mitralozë e me granata nga muret e burgut e nga kullat e rojes, duke vrarë 70 vetë. Të paktën, një duzinë tjetër të burgosurish u vranë gjatë 24 orëve të ardhëshme, ndërsa rojet e burgut, policët specialë e ndoshta

paraushtarakët sulmuan të burgosurit, të cilët fshiheshin në ndërtesat, bodrumet e llagëmet e padëmtuara të burgut. Të plagosurit u morën me kamionë, ndërsa ata që mbetën u transportuan në burgun e Lipjanit, ku ata u rrahën. Më 10 qershor, ata u transferuan në burgjet e vetë Serbisë.

Më 10 qershor, dy ditë para se NATO të hynte në Kosovë, nja 2,000 të burgosur shqiptarë u transferuan nga Kosova në burgjet e Serbisë. Më shumë se 1400 syresh u liruan në kohë të ndryshme gjatë 1999-s, 2000-s dhe 2001-it, ku disa përfituan prej ligjit jugosllav të amnistisë, i cili u miratua në shkurt 2001. Dihej se deri në mars 2001, afro 400 shqiptarë ishin në burgjet serbe (Shih Abuzimet pas 12 qershorit, 1999).

SHKATËRRIMI I PRONËSIVE PRIVATE DHE XHAMIVE

Prej marsit në qershor 1999, ushtarët jugosllavë, policët serbë e paraushtarakët shkatërruan mijra shtëpi shqiptare në të gjithë Kosovën, duke përdorur për këtë qëllim artilerinë, buldozerët, eksplozivat dhe zjarrvënien. Sikur të mos mjaftonte kjo, pati plaçkitje gjithashtu. Në disa zona, sidomos në ato që shquheshin për lidhje të ngushta me UÇK-në, u shkatërruan fshatra të tërë. Një numër qytetesh, përfshirë Peja e Gllagofci, patën dëmtime të shumta. Dyqanet e bizneset e shqiptarëve, shkollat e xhamitë përbënin një objektiv konstant të strategjisë së shkatërrimit e të plaçkitjes. Përveç kësaj, në krahinë pati vazhdimisht ndotje të burimeve të ujit (Shih seksionin që vijon)

Këto aksione ishin vazhdimi i politikave të zbatuara në Kosovë nga forcat e sigurimit gjatë vitit 1998 e fillimit të vitit 1999, sidomos në rajonin e Drenicës, në komunën e Rrahovecit (sidomos në qytetin e Malishevës) e në komunën e Deçanit. [75] Një raport i UNHCR-së mbi shtëpitë e banimit i publikuar në nëntor 1998 demonstron, që shkatërrimi i shtëpive gjatë ’98-s ishte një dukuri e zakonshme. [76] Ky shqyrtim i UNHCR-së u përqëndrua në 285 fshatra, nga të cilat, 210 ishin prekur nga konflikti. Në këto 210 fshatra, me një popullsi prej 350 mijë banorë në periudhën e parakonfliktit, 28% e shtëpive – numri i saktë është 9,809 shtëpi – ishin tërësisht të shkatërruara. Një 15%-ësh tjetër i shtëpive (5,112) patën dëmtime të rënda, ndërsa 6,017 shtëpi të tjera ishin pak të dëmtuara. Në

zonat e përfshira nga konflikti, mbetën pa dëmtuar rreth 40% e shtëpive.

Një pjesë e madhe e shtëpive të padëmtuara në Kosovë u shkatërruan në vitin 1999. Sipas një raporti të UNHCR-së të nëntorit 1999, pothuaj 40% e të gjitha shtëpive të banimit ishin të dëmtuara rëndë (dëmtime të kategorisë III-të e të IV-t) ose krejt të shkatërruara (kategoria e V-të) [77]. Në 237,842 shtëpi që ishin në total, 45,768 janë dëmtuar rëndë dhe 46,414 janë të shkatërruara. Komunat e lidhura fort me UÇK-në nuk u goditën të gjitha në të njëjtën masë (ndoshta ngaqë pjesërisht ato filluan të sulmoheshin qysh në 1998): pothuaj gjysma e 12,887 shtëpive në komunën e Rrahovecit u dëmtuan rëndë (4,334 shtëpi) ose u shkatërruan krejt (1,943 shtëpi); në Suharekë, 4,552 shtëpi ishin të dëmtuara rëndë dhe 2,018 të shkatërruara tërësisht, që përbëjnë 55% të numrit total (11,622). Në rajonin e Drenicës, nga 17,340 shtëpi në total, 7,155 u dëmtuan rëndë dhe 6,209 u shkatërruan tërësisht, që përbëjnë 77% të numrit të përgjithshëm. Qyteti i Pejës gjithashtu u godit veçantërisht rëndë, ku u dëmtuan rëndë 1,590 e u shkatërruan 2,774, që së bashku përbëjnë më shumë se 80% e 5,280 shtëpive.

Shkolla e xhamí u sulmuan në mënyrë të ngjashme. Sipas një vlerësimi

Një xhami e shkatërruar në rrugën Prizren-Gjakovë, korrik 1999

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

të dëmeve nga ana e Kombeve të Bashkuara në 649 shkolla të Kosovës, rezultoi që më shumë se një e pesta e shkollave të shqyrtuara ishin të dëmtuara rëndë dhe më shumë se 60% ishin të shkatërruara tërësisht. [78] Pas qershorit 1999, Human Rights Watch vëzhgoi xhamitë e dëmtuara e të shkatërruara në Gjakovë, Pejë, Istog e Cirez (komuna e Skënderajt). Vizita në terren nga ana e Human Rights Watch gjatë verës së '99-s dëshmoi dëme ekstensive të dyqaneve e bizneseve në Suharekë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gllogofc e Gjakovë. Një raport i Mjekëve për të Drejtat e Njeriut në gusht 1999, mbi bazën e dëshmive të refugjatëve, dokumentoi 155 xhami të shkatërruara në të gjithë Kosovën.

NDOTJA E DEPOZITAVE UJORE

Një nga format më të bujshme të shkatërrimit të pronave civile e publike gjatë vitit 1998 e 1999 ishte praktika e përhapur e ndotjes së depozitave të ujit, e cila është e ndaluar nga ligjet e luftës. [80] Në të gjithë Kosovën, forcat serbe e jugosllave i bënin qëllimisht të papërdorshme burimet e ujit duke vendosur kimikate, kafshë të ngordhura, madje edhe kufoma njerëzish në ujë. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC), i cili drejtoi një operacion për higjienizimin e ujit në Kosovë, "besohet se nga 20 mijë puse të Kosovës, më shumë se gjysma u ndotën me kufoma kafshësh apo njerëzish, me plehra, ose thjesht u shndërruan në ujë i ndenjur prej mospërdorimit. Nga janari në shtator 1999, ICRC pastroi më shumë se 1,700 puse. [81]

Forcat serbe e jugosllave i bënin qëllimisht të papërdorshme burimet e ujit duke vendosur kimikate, kafshë të ngordhura, madje edhe kufoma njerëzish në ujë.

Human Rights Watch dokumentoi një numër fshatrash të Kosovës, në të cilët viktimat e masakrave ishin hedhur në depozita lokale ujore. Në një fshat të Suharekës – të cilit nuk i përmendet emri për shkak të përdhunimeve që ndodhën atje – njëmbëdhjetë vetë u vranë në prill 1999 dhe u hodhën në pus (Shih komunën e Suharekës). Siç u bë e njohur në diskutimin e mësipërm mbi viktimat, të paktën katër prej dyzet e shtatë anëtarëve të familjes Muqolli të ekzekutuar në fshatin e Poklekut në prill 1999, u hodhën në një pus në oborrin që i përkiste disa familjeve. Në një fshat tjetër të rajonit të Drenicës (nuk po e përmendim emrin e fshatit për të njëjtën arsye, pra për të ruajtur

identitetin e viktimave) u përdhunuan, u vranë e u hodhën në pus tetë gra. [82] Human Rights Watch i kanë ardhur gjithashtu dëshmi, sipas të cilave janë gjetur kufoma njerëzish në puset e fshatrave Strellci i Poshtëm e Dubovik të komunës së Deçanit, dhe Studenicë të komunës së Istogut. Dy puset në afërsi të fshatit Kotlinë, në të cilët, në prill 1999, u hodhën njëzet e tre vetë, e bashkë me ta, edhe granata dore, nuk u përdorën nga fshatarët për ujë. Duket se vendimi për të hedhur kufomat në pus kishte të bënte më shumë me një përpjekje për të fshehur krimin, se sa me synimin për të ndotur ujin.

Burime të dorës së dytë raportojnë gjithashtu që puset janë ndotur para e gjatë bombardimeve të NATO-s. Sipas një artikulli në Washington Post më 10 dhjetor 1998, të paktën pesëdhjetë e tetë fshatra informuan organizata të huaja ndihmash që puset e tyre përmbanin "qen, pula, kuaj të ngordhur, plehra, naftë, miell, detergjentë, bojra e ndotësa të tjerë." Në një fshat, Ovcarevo, 70% e puseve "ishin sipas shumë gjasave të ndotur." Pas bombardimeve të NATO-s, gazeta The Los Angeles Times citoi statistika të UNHCR-së mbi zonën e Gjakovës, sipas të cilave, nga dyzet e katër fshatra,

Një fshatar që shikon brenda një pusi ku forcat serbe hodhën trupat e njëmbëdhjetë njerëzve të vrarë.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

në tridhjetë e nëntë prej tyre, puset u ndotën me "kufoma njerëzish e kafshësh." Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriut në Pejë, kufoma njerëzish u gjetën në puset e fshatrave Llukë e Epërme, Banjë e Kosuriq. [85] Gazeta italiane *Corriere della Sera* raportonte gjithashtu mbi ndotjen e pusit në Llukën e Epërme, brenda të cilit një fshatar gjeti kufomat e trembëdhjetë të afërmëve e fqinjëve të tij, me moshë nga 12-17 vjeç. [86]

GRABITJA E PLAÇKITJA

Masakrat e dëbimi në masë në pranverën e vitit 1999 u shoqëruan shpesh edhe me grabitje e plaçkitje. Rëndom, shqiptarët plaçkiteshin para se të dëboheshin apo gjatë dëbimit nga Kosova. Ata që kundërshtonin kërcënoheshin me vdekje, ose u merreshin fëmijët deri në momentin që ata vendosnin të mos bëzanin. Në këto krime u implikuan paraushtarakë apo serbë me uniforma të paidentifikueshme, ndonëse shumë dëshmi flasin edhe për një implikim të policisë serbe. Fenomeni i grabitjes nuk u kufizua në zona të veçanta: ka shembuj të shumtë grabitjeje në rajone që shquheshin për lidhje të forta me UÇK-në e ku u kryen edhe masakra, si në Gllogofc, Suharekë e Pejë, por edhe në rajone ku nuk u vunë re masakra e shkatërrime të rënda, si në Lipjan, Prishtinë e Gjilan. Ashtu si në Bosnjë e Hercegovinë, grabitja e plaçkitja mund të kenë shërbyer si një motivim e shpërblim për paraushtarakët serbë, ndonëse gjeografia e shtrirë e abuzimeve dhe përfshirja në to e policisë, të paktën në disa raste, dëshmojnë bashkëfajësinë e shtetit. Nuk përjashtohet mundësia që ky i fundit të ketë përfituar nga plaçkitjet e kryera.

Një nga rastet më flagrante të grabitjes në masë ndodhi në fshatin Belanicë të komunës së Suharekës (Shih komunën e Suharekës). Më 31 mars, policët e paraushtarakët serbë hynë në fshat, nxorën forcërisht nga shtëpitë të gjithë banorët, i grumbulluan në një pikë së bashku me persona të tjetër të shpërngulur nga zonat aty rrotull. Më pas, paraushtarakët e policët serbë u kërkonin me insistim pará, kërcënonin me vdekje ata që kundërshtonin dhe fëmijët e tyre. Kërcënimet e tyre nuk kishin vetëm efekt frikësues: të paktën dymbëdhjetë shqiptarë u vranë. Një grua, e cila ishte në ato kohë në fshat, i tregoi Human Rights Watch:

Në një moment, policët iu afruan dikujt që qëndronte hipur në zetor. Ata

> i thanë: "Nxirr paratë!" Ai nuk kish pará. Ish nga fshati Ostruzak. Ata e tërhoqën zvarrë për ta zbritur nga zetori dhe e vranë. Kur ai nuk u dha asgjë, ata (katër policë) e kapën nga krahët e këmbët dhe e zbritën poshtë. E çuan prapa një shtëpie, dhe unë nuk mund të shihja më. Dëgjova një krismë arme dhe unë munda të shihja një prej policëve me armën e drejtuar që u zbraz mbi të. Ai nuk u kthye më tek zetori i tij. [87]

Në fillim të majit 1999, ndonjë javë përpara se të fillonte dëbimi masiv nga Gllogofci, banorëve të qytetit dhe të shpërngulurve nga zona të tjera iu desh të përballonin vizitat e vazhdueshme të policëve e paraushtarakëve serbë në shtëpitë e tyre, të cilat kërkonin pará e gjëra të tjera të çmuara (Shih rajonin e Drenicës). Në disa zona, kërkesat e paraushtarakëve për pará ishin kaq të shpeshta, sa banorët, në mënyrë të pazakontë, më 23 prill iu drejtuan policisë dhe kërkuan që ata t'i merrnin në mbrojtje. Policia i mori në ndonjë rast në mbrojtje, por në fakt bëri shumë pak për të frenuar këtë veprimtari kriminale, gjë që të bën të besosh tek bashkëfajësia e tyre.

Grabitjet kryheshin sipas një skeme të caktuar: një apo dy paraushtarakë, ose oficerë të policisë, hynin me dhunë në apartamentet private, ndonjëherë të maskuar, por gjithmonë të armatosur me armë automatike. Familjet të pushtuara nga paniku dorëzonin gjithçka me vlerë që kishin. Një pesëdhjetë e nëntë vjeçar nga Gllogofci, A.H., përshkroi atë që ndodhi, kur në fillim të majit, persona me "uniforma të gjelbërta e me shami të kuqe të lidhura në krahët e tyre" ia behën në një shtëpi të madhe të përbërë nga katër apartamente, në të cilën ai banonte së bashku me tri vëllezërit e tij:

> U nisëm dy ditë më parë rreth orës 9:00 apo 10:00, kur ata (policët) hynë në shtëpi dhe na kërkonin ... Ata na drejtuan armët .... Më kërkuan pará ... [pastaj], ndërsa donin të gjenin paratë, ata më detyruan të zhvishesha e më lanë në kanotiere e të mbathura. Njëri prej tyre më tha: "Nëse të gjejmë pará në trup, unë do të të vras ...." Morën vëthë e sende të tjera të praruara nga gratë ... Të nesërmen ...i morën tim vëllai dy radio e një aparat të vogël televiziv. [88]

Në ndonjë rast, gjatë grabitjes, policët e paraushtarakët kërcënuan fëmijët me thika e armë automatike, në mënyrë që të shtrëngonin prindërit të nxirrnin paratë. H.M., një dyzet e gjashtë vjeçar nga Gllogofci tha: "Një

javë para se të niseshim, (paraushtarakët) filluan të bënin ç'ishte e mundur për të vjedhur pará. Ndodhte që të të merrnin vajzën e të të thoshin "më jep paratë, përndryshe vajza do të mbetet me mua." [89] Një burrë tjetër nga Gllogofci rreth të gjashtëdhjetave tha që "paraushtarakët erdhën, morën fëmijët, u vunë thikat në fyt [dhe na kërcënuan me vdekjen e tyre], nëse nuk do t'u jepnim pará." [90]

Zona që nuk u prekën shumë nga masakra e nga shkatërrime në masë, ishin megjithatë objekt grabitjeje e plaçkitjeje.

Zona që nuk u prekën shumë nga masakra e nga shkatërrime në masë, ishin megjithatë objekt grabitjeje e plaçkitjeje. Banorë të Prishtinës treguan për grabitje të shpeshta, ndërsa nxirreshin forcërisht nga qyteti në ditët e fundit të marsit. Komuna e Gjilanit, e cila u prek më pak nga pasojat e luftës, nuk i shpëtoi dot grabitjes e plaçkitjes, ndërsa banorët e saj u detyruan forcërisht të merrnin rrugën drejt Maqedonisë. Në Malishevë ndodhi e njëjta gjë. Në mëngjesin e 16 prillit, pasi paraushtarakët me uniforma të gjelbëra e me stemën e shqiponjës së bardhë me katër "C" hynë në Malishevë, banorëve iu dha një afat prej dy orësh për ta lënë fshatin. Dy fshatarë u vranë në një fushë, ndërsa pjesa tjetër e fshatit u detyrua të bënte sehir masakrën. Pranë Gjilanit, fshatarët u rrahën, e më pas, iu grabitën makinat, paratë, bizhuteritë, e u kërcënuan me vdekje para se të lejoheshin të kalonin. Më vonë, në rrugën midis Gjilanit e Ferizajt, fshatarët u grabitën disa herë nga bandat e paraushtarakëve. Një fshatar tha se kolona e dëbuarve u ndalua nëntë herë midis Gjilanit e Kllokotit, një qytet nja dhjetë kilometra larg rrugës kryesore. Sa herë që ndaloheshin, fshatarëve u hiqej ndonjë pëllëmbë fytyrës, rriheshin e kërcënoheshin me vdekje, nëse ata nuk pranonin të dorëzonin të gjitha paratë e huaja, bizhuteritë e gjëra të tjera të çmuara. Disa dëshmitarë treguan se paraushtarakët i kërcënuan me shpërthimin e granatave të dorës, nëse nuk u plotësoheshin kërkesat. Sipas një dëshmitari: "ata morën granadat e dorës e zunë të na thoshin se do t'i hidhnin në mes të grumbullit të fëmijëve, nëse do të dilnin duarbosh."[92]

PARABURGIMET E PUNA E DETYRUESHME

Është tashmë qartësisht e dokumentuar, se midis marsit e qershorit 1999, forcat e sigurimit jugosllav e serb paraburgosën një numër të

madh burrash dhe i detyruan ata të hapnin transhe, të pastronin bunkerë apo të kryenin punë të tjera krahu. Një pjesë e madhe e punës së bërë nga krahët e të paraburgosurve ishte e lidhur me objektivat strategjikë të Ushtrisë Jugosllave. Rasti më i bujshëm ngjau në komunën e Gllogofcit gjatë majit e qershorit 1999. Human Rights Watch dokumentoi gjithashtu punën e detyrueshme të të paraburgosurve në komunën e Prizrenit gjatë prillit të vitit 1999, ku të paktën në dy raste, policët serbë e ushtarët jugosllavë i mblodhën burrat në qytetin e Prizrenit, i hipën nëpër makina e i çuan në kufirin shqiptar, ku ata u vunë në shërbim të brigadave të hapjes së transheve (Shih komunën e Prizrenit). Ka gjithashtu dëshmi për brigada të punës në Rrahovec, Suharekë e Gjakovë, ku në muajin prill 1999, romët u shtrënguan të hapnin transhe pranë kufirit me Shqipërinë. [93]

Human Rights Watch mori dëshmi të hollësishme të punës së detyrueshme nga grupe të burgosurish, të cilët u ndaluan tek xhamia e Cirezit, në Drenicë, më 31 prill 1999. Ndërsa një pjesë e madhe e të paraburgosurve u ekzekutuan në minierën e Shavarinës pranë Cikatovës më 1 maj 1999, pjesa tjetër u transferua në Gllogofc (Shih rajonin e Drenicës). Rreth shtatëdhjetë e gjashtë vetë prej të mbijetuarve u morën në Gllogofc nga policia serbe dhe u çuan më 5 e 6 maj në fshatrat Krajkovë, Vukovc e ;, dhe iu dorëzuan ushtarëve serbë. Sipas shtatë dëshmitarëve të intervistuar nga Human Rights Watch, burrat u detyruan të punonin për rreth gjashtë javë, deri në tërheqjen e forcave të sigurimit serb nga Kosova në mesin e qershorit. Detyra e tyre ishte hapja e transheve e pastrimi i bunkerëve. Dëshmitarët thonë se kish raste të rrahjes e torturimit të të burgosurve nga duart e ushtarëve, ndonëse një pjesë thonë se ata u ushqyen e u trajtuan më mirë nga ushtarët se sa nga policët e paraushtarakët serbë në Qirez Gllogofc.

KOSOVARET SI SHQYT NJERËZOR

Prej marsit deri në qershor 1999, forcat e sigurimit serb e jugosllav shtrënguan një pjesë civilësh shqiptarë të qëndronin pranë tyre apo të vendoseshin midis pozicioneve serbe e atyre të UÇK-së. Të dyja këto strategji u ndërtuan me synimin për të krijuar një shqyt njerëzor që do të mbronte forcat serbe e jugosllave nga sulmet e avionëve të NATO-s e të UÇK-së. Përdorimi i “shqyteve njerëzore” të tillë është i ndaluar nga

artikulli 28 i Konventës së Katërt të Gjenevës, e cila deklaron se "prania e një personi të mbrojtur nuk mund të përdoret për të siguruar pika apo zona të caktuara nga operacionet ushtarake."

Forcat serbe e jugosllave vendosën në Kosovë afro 50,000 mina anti-tank e anti-personel.

Në disa raste, përdorimi i shqyteve njerëzorë ishte i drejtëpërdrejtë, me civilë shqiptarë të detyruar të marshojnë në radhë përgjatë ushtarëve jugosllavë e policëve serbë, në mënyrë që të mbroheshin këta të fundit nga sulmet e avionëve të NATO-s e të UÇK-së. Human Rights Watch intervistoi dëshmitarë nga Suhareka, Klina, e Lipjani, të cilët rrëfyen se si ishin përdorur si shqyt njerëzor. Dëshmitarët i treguan OSBE-së që ata ishin të mbajtur si shqyt njerëzor në Djeneral Jankovic (në kufirin maqedonas), në komunën e Gjakovës, në Prishtinë dhe në rrugën midis Cirezit e Shtuticës. [94] Ekzistojnë dëshmi, sipas të cilave civilë shqiptarë të vrarë në pyjet e Koricës nga bombat e NATO-s kishin qënë të detyruar nga forcat serbe të mbeteshin atje si "shqyt njerëzor", por faktet janë ende të pamjaftueshme (Shih Fushata Ajrore e NATO-s). [95]

Ka prova gjithashtu edhe të përdorimit indirekt të shqyteve njerëzorë, nëpërmjet përpjekjeve për të krijuar barriera civilësh midis forcave të sigurimit serb dhe UÇK-së, si rrjedhim duke kufizuar zhdërvjelltësinë e UÇK-së për të sulmuar pozicionet serbe, apo për t'u mbrojtur nga ato pozicione. Shumë prej dëshmive vinë nga rajoni i Drenicës. Rasti i fshatit Cikatovës së Vjetër është një shembull i qartë (Shih rajonin e Drenicës). Një dëshmitar i këtij fshati i tregoi Human Rights Watch, se "ne ishim midis UÇK-së e Feronikelit. [Forcat serbe] filluan të granatonin nga Ferronikeli me synimin për të sulmuar ushtarët [e UÇK-së]." [96] OSBE-raporton një situatë të ngjashme në fshatin e Tërnocit në komunën e Skënderajt, ashtu si dhe në fshatin Belanicë të komunës së Suharekës. [97] Një dëshmitar nga Malisheva (komuna e Rrahovecit) i intervistuar nga mjekët e të Drejtave të Njeriut tha se ish pjesë e një grupi prej 500 civilësh, të cilët u mbajtën afër kufirit shqiptar dhe u përdorën si shqyte njerëzore nga ushtarët jugosllavë, ndërsa këta të fundit sulmonin një pozicion të afërt të UÇK-së.

MINAT TOKËSORE

Gjatë gjithë vitit 1998 e gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 1999, forcat serbe e jugosllave vendosën në Kosovë afro 50,000 mina anti-tank e anti-personel, sidomos përgjatë kufirit me Maqedoninë e Shqipërinë. [99] Po kështu, gjatë kësaj periudhe UÇK-ja vendosi mina në zonat që ishin nën kontrollin e saj. Përveç kësaj, përdorimi nga ana e NATO-s i minave kasetë gjatë të paktën gjashtë javëve të luftës ajrore solli vdekjen e disa civilëve dhe një numër predhash (UXO) të paplasura pas luftës, të shpërndarë gjithandej nëpër Kosovë e gjetkë në Republikën Federale të Jugosllavisë.

Minat dhe UXO-t përfaqësojnë trashëgiminë më vdekjeprurëse të konfliktit në Kosovë. Sipas Fondacionit të Veteranëve të Vietnamit me seli në Shtetet e Bashkuara, prej fundit të luftës deri në mesin e nëntorit 2000, si rezultat i aksidenteve me mina e predha të paplasura [100] u vranë 103 vetë dhe u plagosën 394. Pak a shumë e njëjta gjë thuhet edhe në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në korrik

Njw tabelw sinjalizuese minash nw rrugwn pranw Mitrovicws, korrik 1999

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

2000, ku nënvizohej se nga 12 qershori 1999 deri në korrik 2000 [101], si pasojë e minave e predhave të paplasura, u vranë 101 vetë e u plagosën 395 të tjerë. Qendra e OKB-së për Koordinimin e Aksioneve Antiminë (MACC), e cila u vendos në Kosovë pas luftës, raportoi që deri në korrik 2000 u çminuan dhe u pastruan nga predhat e pashpërthyera 1,1 milionë metra katrorë truall. [102] Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm vë gjithashtu në dukje që skuadrat e koordinuara nga MACC-u kishin pastruar 3,405 mina anti-trupa, 3,768 mina anti-tank, 3,066 mina kasetë dhe 9,327 elementë të predhave të paplasura. Përveç kësaj, gjatë së njëjtës periudhë KFOR-i kish pastruar më shumë se 16,000 shtëpi, 1,165 shkolla, dhe rreth 2,000 kilometra rrugë.

Qeveria jugosllave, një nga prodhuesit më të mëdhenj në botë të minave anti-trupa, nuk e ka nënshkruar traktatin e vitit 1997, që pengon përdorimin e minave tokësore, por zyrtarët jugosllavë kanë deklaruar që minat tokësore janë përdorur vetëm për qëllime stërvitjeje. [104] Në të vërtetë, minat tokësore u përdorën gjerësisht nga forcat jugosllave gjatë konfliktit të viteve 1998-99 si një mjet taktik kundër UÇK-së e NATO-s. Sipas

Në fund të shtatorit 1998, kjo makinë e ICRC ra në një minë anti-tank të vendosur nga UÇK-ja në një rrugë që çon në Likovac, bazë rajonale e UÇK-së në Drenicë. Një doktor shqiptar nga Kosova u vra dhe tre të tjerë u plagosën.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

raportit të vitit 2000 të Fushatës Ndërkombëtare për Ndalimin e Minave Tokësore, Ushtria Jugosllave vendosi fillimisht si barriera tokësore minëmbajtëse gjatë kufirit jugor me Maqedoninë. Forcat e Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme dhe paraushtarakët vendosën mina anti-trupa brenda e rrotull qendrave të populluara nga civilë. [105] Sipas një raporti të Trustit HALO, një grup jo fitimprurës çminimi, "Shumë fshatra po vuajnë prej minave rastësore të vëna me të vetmin qëllim: për të shkaktuar viktima civile e për shkurajuar kthimin e refugjatëve." [106] Sipas një raporti të një Agjencije amerikane të Zhvillimit Ndërkombëtar, më shumë se 900 shkolla kishin nevojë të pastroheshin nga minat. [107]

Në Marrëveshjen Teknike Ushtarake të nënshkruar nga NATO e nga Qeveria Jugosllave më 9 qershor 1999, autoritetet jugosllave ranë dakord "të shenjonin e të pastronin terrenet e minuara, kurthet e pengesat e minuara." [108] Ushtria jugosllave informoi NATO-n mbi 616 zona të minuara. Mina të vendosura nga paraushtarakët serbë mbetën megjithatë të paregjistruara, gjë që e bën të vështirë përcaktimin e vendndodhjes së tyre.[109]

E njëjta gjë është e vërtetë, kur flitet për minat e vendosura nga UÇK-ja. Dihet që UÇK-ja ka vendosur kryesisht mina anti-tank, por edhe shumë mina anti-trupa rrotull bazave të tyre rajonale, shtabeve e strehimeve të sigurisë së veçantë. Nga fundi i shtatorit 1998, një makinë e blinduar kanadeze e KVDM-së dhe një makinë e ICRC-së, u ndeshën në Drenicën qendrore mbi mina anti-tank të vendosura nga UÇK-ja. Një doktor shqiptar i Kosovës, Shpëtim Robaj, u vra, dhe tre vetë nga personeli mjekësor i ICRC-së u plagosën.

Minat kasetë të hedhura nga forcat e NATO-s gjatë fushatës ajrore gjithashtu përbënë një rrezik të vazhdueshëm për civilët në Kosovën e pas luftës. Forcat amerikane e britanike e kanë pranuar përdorimin e minave kasetë gjatë fushatës së bombardimeve. [110] Në maj 1999, Shtëpia e Bardhë nxorri një udhëzim për Pentagonin, me anën e të cilit kufizonte përdorimin e minave kasetë (të paktën nga ana e forcave amerikane), pasi si pasojë e sulmit të 7 majit me mina kasetë mbi një aeroport të Nishit, u vranë katërmbëdhjetë civilë dhe u plagosën njëzet e tetë të tjerë. (Shih Fushatën Ajrore të NATO-s). [111]

Sipas Fushatës Ndërkombëtare për ndalimin e minave tokësore, "Shtetet e Bashkuara hodhën 1,100 mina kaseta të tipit CBU-87/B, ku secila përmbante 202 minibomba BLU-97/B, dhe Mbretëria e Bashkuar hodhi 500 mina kasetë RBL/755, ku secila përmbante 147 minibomba 147 B1-755." [112] Për shkak të

normës së lartë të difekteve të submunicionit brenda minave kasetë – e vlerësuar tek 5 përqindëshi – këto minibomba në fakt bëhen mina tokësore anti-trupa.

Deri në korrik të vitit 2000, NATO ka furnizuar MACC-un e Kombeve të Bashkuara me informacione, që kanë të bëjnë me 33 vende, në të cilat janë hedhur mina kasetë, saktësisht rreth 1,392 kuti shpërndarëse minibombash [114]. Sipas NATO-s, "afro 30,000 minibomba individuale janë hedhur e nuk kanë plasur, gjë që e bën të nevojshme pastrimin e tyre." NATO vlerësoi që, deri më 4 korrik 2000, afërsisht 30% e njësive të minave kasetë janë pastruar. NATO ka përballuar kritika për ritmin e pastrimit të zonave me mina kasetë. Sipas BBC-së, deri në maj 2000, 40% e zonave me rrezik të identifikuar nuk kanë qënë të izoluara. [115]



Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

5

RAJONI I DRENICËS
Komuna e Gllogofcit dhe e Skënderajt

Drenica është një zonë kodrinore në Kosovën qendrore e banuar pothuaj krejt nga shqiptarë etnikë. Banorët e kësaj zone kanë një traditë të rezistencës së fuqishme ndaj fuqive të huaja, duke filluar me sundimin turk në Ballkan. Qysh nga 1997, shqiptarët kishin filluar t'i referoheshin Drenicës si "territor i çliruar", për shkak të pranisë së UÇK-së lokale. Qeveria e konsideronte Drenicën një shtrat të ngrohtë të "terrorizmit shqiptar".

Zona, e kufizuar nga malet e Drenicës në perëndim, përbëhet nga komunat e Gllogofcit dhe Skënderajt. Qytetet e Gllogofcit e Skënderajt janë qëndrat komunale respektive, ku është përqëndruar popullsia më e madhe e çdo komune. Para vitit 1998, të dyja komunat kishin pothuaj tërësisht një popullsi shqiptare. Fshatrat që rrethonin të dy qytetet janë vendlindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila filloi operacionet e armatosura në Drenicë në vitin 1996. Ato janë gjithashtu skena e disa prej abuzimeve më të rënda kundër civilëve në Kosovë. [1] Në operacionet që filluan në janar 1998, policia speciale serbe sulmoi fshatrat e Drenicës që ishin të lidhura me UÇK-në. Nga janari në mars, policia ndërmori sulme të shumëfishta të natyrës ushtarake në fshatrat Prekaz i Poshtëm, Likoshanë, e Cirez, duke përdorur mjete të blinduara dhe një helikopter.[2] Sulmet dhe luftimet e kësaj periudhe lanë tetëdhjetë e tre fshatarë të vrarë, përfshirë të paktën njëzet e katër gra e fëmijë, dhe ndihmuan të kristalizohet një opozicion i armatosur ndaj sundimit të Beogradit. Në maj, nja 300 forca të policisë speciale sulmuan fshatin e Poklekut të ri, një lagje e jashtme e qytetit të Gllogofcit. Dhjetë shqiptarë u paraburgosën gjatë sulmit; njëri prej tyre u gjend më vonë i vdekur, ndërsa nëntë të tjerët mungojnë edhe sot e kësaj dite.[3]

Konflikti me intensitet të ulët midis forcave qeveritare – policisë serbe – dhe UÇK-së vazhdoi deri në shtator 1998, kur vdekja e katërmbëdhjetë policëve në një betejë të ashpër provokoi një raprezalje të shumëfishtë, masakrimin e civilëve në fshatrat Abri e Epërme e Gollubofc, dhe ndalimin e torturimin e qindra shqiptarëve në postën e policisë së Gllogofcit. [4] Dislokimi i misionit të OSBE-së për verifikimin në Kosovë, i reduktoi, por nuk i eleminoi abuzimet kundër civilëve gjatë bastisjeve policore në fshatrat e zonës apo shpërnguljen e civilëve, e cila vazhdoi gjatë gjithë dimrit.

Policia serbe e paraushtarakët e mbështetur nga ushtria, në përpjekjet e tyre për të shkatërruar edhe UÇK-në, edhe bazat e saj të mbështetjes, spatruan çdo fshat nga popullsia civile.

Tërheqja e Misionit të Verifikimit të OSBE-së në marsin e vitit 1999 sinjalizoi një intensifikim të veprimtarisë ushtarake të policisë serbe në Drenicë. Nuk egzistonte më në fund një lloj kontrolli nga ana e monitoruesve ndërkombëtarë. Filloi stina e terrorit, ndërsa policia serbe e paraushtarakët e mbështetur nga ushtria, në përpjekjet e tyre për të shkatërruar edhe UÇK-në, edhe bazat e saj të mbështetjes, spatruan çdo fshat nga popullsia civile. Burrat u paraburgosën en masse dhe qindra syresh u ekzekutuan. Rrezja e masakrës nuk kapte vetëm ata që gjykoheshin potencialisht si luftëtarë, gjë që kish nisur me masakrat më të hershme në fshatin Abri e Epërme e Raçak (komuna e Shtimjes), ku gra e fëmijë të familjeve të personave të lidhur me UÇK-në, u vranë gjithashtu. Shumë prej masakrave ndodhën në ditët pas bombardimit nga ana e NATO-s të uzinës së Ferronikelit, pranë Gllogofcit, më 29 prill, kur mijra civilë u hipën forcërisht nëpër autobuzë dhe u dëbuan prej qytetit në drejtim të kufirit me Maqedoninë.

Abuzimet në zonën e Drenicës ishin kaq të zakonshme, sa një përshkrim i qartë i kalon caqet e një raporti si ky i yni. Vetëm pak fshatra u lanë të paprekur, dhe vetëm pak familje nuk patën viktima. [5] Për këtë arsye, ky kapitull do të përqëndrohet në mizoritë më të bujshme të kryera në periudhën mars-qershor 1999, në fshatrat Izbicë, Rezallë, Poklek, dhe Cikatovë e Vjetër; në ofensivën kryesore në zonën e Vërbofcit, Shtuticës, dhe Baksit, që pasoi bombardimin nga ana e NATO-s të uzinës së ferronikelit më 29 prill dhe pasojat e përgjakshme të saj; dhe në dëbimin e dhunshëm të mijra njerëzve nga Gllogofci, qyteti më i madh i zonës, gjatë javës së parë të majit.

IZBICË

Human Rights Watch intervistoi rreth dymbëdhjetë dëshmitarë të ngjarjeve të 28 marsit 1999, në Izbicë. Dëshmitë e tyre të çiftëzuara me imazhet satelitore të NATO-s dhe me filmimet video të prodhuara nga shqiptarë të Kosovës, dokumentojnë një prej masakrave më të mëdha të konfliktit në Kosovë. Numri i saktë i viktimave shqiptare mbetet i panjohur, ndonëse fshatarët, të cilët varrosën të vrarët, folën për 146-166 kufoma. Vrasjet janë përmendur në akuzën që është formuluar në ngarkim të Sllobodan Milosheviçit nga Gjykata e Krimeve të Luftës, ndërsa të tjerat janë bërë publike më 27 maj 1999. [6]

E vendosur rrëzë maleve dhe një gjysëm ore larg fshatit më të afërt serb, Izbica konsiderohej një strehë e sigurt për të shpërngulurit shqiptarë të zonave fqinje, pjesërisht për shkak të pranisë së UÇK-së brenda e në rrethinat e fshatit. Më 27 mars, qindra shqiptarë të kësaj zone u grumbulluan në Izbicë. Shumica ishin të ardhur pas fillimit të bombardimeve nga ana e NATO-s, kur forcat qeveritare filluan të bombardonin aty rrotull. [7]

Sipas të gjitha dëshmive, bombardimi i Izbicës filloi në natën e 27 marsit, ndërkohë që një grup prej të paktën pesëdhjetë ushtarësh, policësh e paraushtarakësh kish hyrë në fshat në mbrëmje. Pothuaj të gjithë të rriturit morën malet më 28 mars, duke lënë në fshat gratë, fëmijët e të moshuarit. H.D., një dyzet vjeçar nga Broçna, pranë Izbicës, tha:

> Ishin të paktën 30,000 vetë atë ditë në Izbicë. Ne besonim se gratë e të moshuarit do të liheshin në paqe, por për fat të keq nuk ndodhi kështu. Bombardimi me artileri erdhi nga të gjitha anët. Në mëngjes, të rinjtë, edhe unë bashkë me ta, shkuan në male. Unë u nisa rreth orës 10.00 paradite me djalin tim trembëdhjetë vjeçar. Një ditë më parë kishim sjellë familjen në Izbicë, dhe qëndruam gjatë gjithë natës jashtë. Isha aq i lodhur sa as bombardimi nuk më nxorri gjumin, dhe ish gruaja që më ngriti rreth orës 9.00. Kështu u larguam për në male. Bombat na binin pranë, ndërsa serbët po afroheshin. Isha rreth 200 metra larg, dhe përpiqesha të shihja atë që ndodhte. Serbët u afruan pranë grumbullit të njerëzve, ndërsa familja jonë u nguc mes zetorëve e makinave, të cilave më pas iu vu zjarri nga serbët. Unë nuk mund ta shihja më skenën, por mund të dëgjoja gratë e fëmijët që qanin. Ne nuk guxuam të ktheheshim e të shihnim çfarë po ndodhte; e dinim që mund të vriteshim nga snaiperat. [8]

Fshatarët braktisën shtëpitë e tyre për t'u grumbulluar jashtë në orët e para të mëngjesit të 28 marsit, ndërsa bombardimi me artileri vazhdonte. S.E., një njëzet vjeçare nga Izbica, babai, ungji e një kushuri i së cilës u vranë, i tha Human Rights Watch:

> Kur pamë serbët që po afroheshin, ne patëm frikë të qëndronim në shtëpitë tona. Ne – unë, nëna e babai, vëllai, motra, familja e motrës dhe vjehrra, gjithsej dhjetë vetë – u larguam me zetor në drejtim të një fushe aty afër (rreth 500 metra nga fshati). U bashkuam tek fusha me pjesën tjetër të familjeve të fshatit, të cilat kishin filluar t'i braktisnin shtëpitë e tyre rreth orës 4.00 të mëngjesit. Në orën 10.00, gjithkush ishte në fushë. Ishin mijra vetë, pothuaj të gjithë gra, fëmijë e të moshuar. Midis nesh ishin vetëm nja 150 burra.
> Me të mbërritur në fushë, secili zbriste nga zetori e bëhej grup me të tjerët. Ne kishim zgjedhur fushën, sepse donim të ishim së bashku; kishim frikë të qëndronim secili në shtëpinë e vet. Kështu, do të ishte e lehtë për serbët të na masakronin. Që nga fusha, ne mundëm të shihnim serbët që i vinin zjarrin shtëpive. Ata gjuanin në ajër dhe çirreshin me zë të lartë: na shanin neve e trembnin fëmijët. [9]

Dy gra, të cilat u ndeshën atë ditë me forcat serbe thanë që ata kishin vënë maska, kishin veshur uniforma në ngjyrë të zezë apo blu, dhe mbanin thika të mëdha. Të dyja gratë kujtuan se disa syresh mbanin maska të zeza skiatorësh, ndërsa të tjerët i kishin fytyrat të nxira me kalem grimi. [10] Një grua tjetër tregoi se tek një pjesë paraushtarakësh arriti të identifikojë zyrtarë të policisë lokale. [11]

Rreth orës 10.00, grupi i serbëve nisën t'i bien fshatit kryq e tërthor, duke shtrënguar të iknin ata pak banorë që kishin mbetur në shtëpi. Kush nuk mund të lëvizte, u vra. Motra e S.E.,-së, e cila u kthye në Izbicë tri ditë pas masakrës, tregoi:

> Më 28 mars, ditën e masakrës, serbët vranë një nëntëdhjetë vjeçar, Shaban Rexhepin. Ai ishte ulur mbi një rrogoz pranë shtëpisë së vet, e nuk mund të lëvizte; Serbët i vunë flakën rrogozit. Pashë kockat e tij; nuk kish mbetur asgjë prej mishit të tij.
> Familja e një gruaje të paralizuar e vendosi këtë të fundit në rimorkion e një zetori, e cila ishte e mbushur me shtroja. Serbët e gjetën atë, dhe

> i vunë zjarrin rimorkios. Gruaja ishte brenda. Emri i saj ishte Zyka Bajrami. Ishte rreth të shtatëdhjetave. Kjo ndodhi gjithashtu më 28 mars. [12]

Kur forcat e sigurimit serb arritën tek fusha, në orën 10.00, ata kërcënuan se do të vrisnin fshatarët e do t'u vinin flakën zetorëve. Përveç kësaj, kërkuan pará. S.E., babai i së cilës u vra më vonë, i tregoi Human Rights Watch:

> Ata na thanë ne "t'u jepnim pará, nëse donim të jetonim". Ata na thanë se mund ta kursenim jetën e e një familjeje duke u dhënë 1000 marka gjermane, ndërsa për një traktor 100 marka. Paguam të gjithë. Çdo burrë pagoi për familjen e vet. Babai im pagoi 1,100 marka gjermane. Pasi serbët morën paratë, ata qëlluan mbi gomat e të gjithë zetorëve, e dogjën gjithçka ishte ngarkuar në ta. [13]

Të gjithë dëshmitarët thanë se më tej, forcat e sigurimit serb ndanë mënjanë burrat nga gratë e fëmijët, i larguan gratë nga fshati, dhe ekzekutuan burrat me armët e tyre automatike. Ishte mesnatë. S.E., nëna e vëllai i saj i paralizuar, ishin pjesë e një karvani, që u largua forcërisht nga fshati. Ajo përshkroi se si forcat e sigurimit serb i shtrëngonin djemtë e rinj të ktheheshin tek fusha:

> Rreth orës 11.00, ata veçuan gratë nga burrat. Ne i pyetëm pse po e bënin këtë gjë. Me një ton që të kallte frikën na thanë: "qepeni gojën, mos bëni pyetje, ndryshe do t'ju vrasim juve." Fëmijët ishin të terrorizuar. Serbët vazhduan të çirreshin: "do t'ju vrasim juve, dhe Shtetet e Bashkuara nuk janë që t'ju shpëtojnë." Të gjitha gratë, nga frika, kishin mbuluar kokat me shami, kishin fshehur flokët e ballin. Serbët na flisnin me fjalë të fëlliqura, na thoshin "do t'i qimë të gjitha nënat shqiptare", dhe "të gjitha gratë shqiptare janë kurva."
>
> Ata morën burrat mënjanë, dhe i vunë në radhë nja njëzet metra larg nesh. Pastaj, na urdhëruan të merrnim rrugën për në Shqipëri. Ata thanë: "Ju keni kërkuar një Shqipëri të Madhe, dhe tani mund të shkoni atje." Ata qëllonin me armë mbi kokat tona. Zbatuam urdhërat e tyre dhe u vumë në lëvizje në drejtimin që na thanë, duke u larguar kështu nga burrat.

> Kur nuk ishim larguar as njëqind metra nga vendi i nisjes, serbët vendosën të ndanin nga grupi ynë djemtë më të rinj. Djemtë mbi katërmbëdhjetë vjeç i kishin mbajtur tashmë me burrat; tani ish radha e djemve mbi dhjetë vjeç. Me ne lanë vetëm fëmijët e vegjël, një të moshuar, i cili i kish humbur të dy këmbët, dhe vëllain tim sakat, i cili nuk mund të ecte për shkak të një meningjiti kurrizor.
> Kështu, ata morën edhe djemtë e moshës 10-14 vjeç për t'i çuar tek burrat. Nënat e këtyre djemve zunë të qanin; një pjesë u përpoqën të flisnin me serbët, por këta të fundit u dhanë nga një të shtyrë. Filluam të ecnim shumë ngadalë, pasi ishim të shqetësuar mbi atë që mund t'u ndodhte burrave tanë.
> Ndaluam kur dëgjuam armë që u shkrehën. Kthyem kokat të shihnim çfarë po ndodhte, por nuk ishte e mundur të dalloje burrat. Pamë vetëm djemtë e moshës 10-14 vjeç që po vraponin drejt nesh; kur i patëm mes nesh, i pyetëm çfarë po ndodhte. Ata ishin të tronditur; askush nuk mundi të fliste. Më në fund, njëri syresh arriti të thosh: "ata na lëshuan, por të tjerët i vranë."
> Në qëndruam atje ku ishim edhe për nja njëzet minuta. Po qanim të gjithë. Armët automatike vollën zjarr pa pushim për disa minuta; pas kësaj, ne dëgjuam të shtëna të shkurtëra, të çrregullta, edhe për nja dhjetë minuta të tjera.
> Pastaj, nja dhjetë serbë e zunë me ne. Ata thanë fjalë të ndyra, dhe na përsëritën atë që na i kishin thënë njëherë, "tani duhet t'ia mbathni për në Shqipëri – shpejt, ikni!" S'kishim zgjedhje tjetër, duhej të iknim.[14]

Dëshmia e saj u përforcua nga një grua tridhjetëvjeçare, e intervistuar veç, burri e djali i së cilës i shpëtuan vdekjes duke u fshehur në male:

> Tek fusha ne bëmë një grup të ngjeshur duke u ngucur tek njëri-tjetri. Burrat u ndanë nga gratë, dhe u morën prej aty. Pastaj u drejtuan nga ne, duke na thënë të shkonim tek rruga e asfaltuar. Ne dëgjuam krismat e të shtënave, por unë personalisht nuk mund të shihja asgjë. E gjitha ndodhi kur karvani arriti tek rruga kryesore, nja njëzet minuta pasi na ndanë nga burrat. Ishin gratë në fund të karvanit që na treguan se burrat tanë ishin vrarë; fjala u përhap tek të gjithë. [15]

Në ditët në vazhdim, burrat nisën të zbrisnin nga malet dhe disa prej

grave, që ishin nxjerrë forcërisht prej fshatit, u kthyen të kërkonin të afërmit. Tek fusha, ku ndodhi masakra, sipas të gjitha dëshmive, ata gjetën katër pirgje burrash të vrarë. Tre ishin tek fusha, dhe një pirg më i vogël ishte ca më tutje, rrëzë malit. Burrat që varrosën viktimat thanë se shumica e kufomave kishin shenjën e plumbit në njërën anë të kokës. Disa kufoma ishin të sakatuara rëndë.

H.D., e cila u fsheh në mal së bashku me djalin gjatë masakrës, ishte ndër të parat që zbuloi kufomat:

> Në ditën e katërt, për fat të keq, u ktheva në Izbicë. Them për fat të keq, sepse do të ishte më mirë të mos kisha parë atë që pashë. Ishte një masakër e tmerrshme. Pashë tim ungj, i cili u ekzekutua nga serbët. Pashë një prej hallave; ajo u dogj në kopësht. Pashë shumë viktima të tjera. Gjithsej, numri i të vrarëve ish 150. Shumica ishin të moshuar. Një kushuri i imi ishte rreth të nëntëdhjetave.
> Isha ndër të parat që zbulova kufomat. Kur zbritëm nga mali, ne gjetëm pirgun e parë të kufomave në një kullotë rrëzë malit. Ishin tre grupe të ndara kufomash tek fusha, burrat që ishin ndarë nga gratë, dhe disa kufoma nëpër shpatin e malit. Grupi i dytë i kufomave ishte përtej një përroi. Personalisht kisha dëgjuar krismat e automatikëve, që qëlluan mbi trupat e tyre. Kur dëgjova krismat, unë thashë me vete, "O Zot, po i vrasin të gjithë." Ishte mesditë. [16]

Një burrë tjetër nga Izbica, pesëdhjetë e dy vjeç, u fsheh gjithashtu në male, dhe u kthye për të kërkuar vëllain e vet. Përshkrimi i tij është pothuaj i njëjtë me atë të dëshmitarëve të tjerë, që ishin ndodhur atje:

> Pirgu i parë i kufomave ishte nja 200 metra larg nga zetorët, pranë shtëpive që ishin rrëzë malit. Pamë një grup tjetër pranë një rrëkeje me ujë, nja 20-25 metra larg nga grupi i mëparshëm; në këtë grup ishte kufoma e tim vëllai. Ishin njëzet e tre vetë në këtë grup.
> Grupi, ku gjendej vëllai im, kishte kufoma të katandisura si mos më keq. Disa prej tyre nuk mund të identifikoheshin. Ti duhej të identifikoje veshët e një burri: pjesa e sipërme e kokës nuk gjendej më. Shumica ishin qëlluar në kokë. Disa kishin vrima të vogla në njërën anë të kokës, ndërsa pjesa tjetër ishin krejt të shkatërruara.[17]

Dëshmia e dikujt që mbeti gjallë nga masakra, e publikuar nga Amnesty International, konfirmonte përshkrimet e vendndodhjes, të cilat u grumbulluan nga Human Rights Watch. I mbeturi gjallë rrëfeu, që burrat u ndanë në grupe, u çuan në vende të ndryshme, dhe u rreshtuan me shpinën të kthyer nga ushtarët. Forcat serbe qëlluan nga prapa me armë automatike, dhe burri në fjalë i shpëtoi vdekjes duke u shtirur si i vdekur.[18] Dëshmitarët e intervistuar nga Human Rights Watch mëtuan se njohin 6-16 vetë, të cilët i kishin shpëtuar pushkatimit në mënyrë të ngjashme.

Fshatarët, të cilët u kthyen në Izbicë, iu vunë punës për të varrosur viktimat. Sipas pjesëmarrësve të intervistuar nga Human Rights Watch, ishin 60-80 vetë ata që varrosën kufomat tek fusha në tre radhë. Varret ishin të cekët, afërsisht 60-90 centimetra të thellë, sepse fshatarët ishin të rraskapitur e punonin me nxitim. Emri i secilës viktimë që identifikohej shënohej mbi gurin pranë varrit dhe në një listë të përgjithshme.

Një burrë varrosi vëllain e vet, një viktimë të masakrës, dhe gruan e vajzën e vëllait, të cilat u vranë në incidentin e zetorit, ndërsa familjet po drejtoheshin tek fusha më 28 mars.

> … Ne organizuam një këshill burrash për të vendosur kohën e mënyrën për të varrosur kufomat. Gjashtëdhjetë deri në tetëdhjetë vetë nga ne filluam të hapnim varret të nesërmen. Të gjithë ne kishim qënë të fshehur nëpër male. Na u desh një ditë e tërë për të hapur varret. Katër-pesë kufoma mbetën pa u varrosur atë ditë, sepse koha nuk mjaftoi. Gjithë ditën kërkuam të gjenim pllaka gurësh, mbi të cilat donim të shkruanim emrat e të vdekurve. I varrosëm në një thellësi prej nëntëdhjetë centimetrash.

“Kur dëgjova krismat, unë thashë me vete, ‘O Zot, po i vrasin të gjithë.’”

I pashë të gjithë kufomat, kur ato i sollën. Ishin gjithsej 156 ose 157. Këshilli bëri një listë të të vdekurve. Çdo i vdekur kish një numër, që i korrespondonte numrit të varrit. [19]

Një grua nga Izbica, e cila u kthye në fshat më 31 mars dhe asistoi në varrim, i tha Human Rights Watch:

> Pashë tim’atë të vdekur. Familjet kishin sjellë kufomat në fshat prej malit ku ishin vrarë, nga një distancë më e vogël se një kilometër. Burri e nipi mbanin trupin e babait.

I pashë të gjitha kufomat. I numëruam. Ishte e tmerrshme. Ishin çuar tek fusha dhe ishin vënë në tri rreshta. Ata u varrosën në tri rreshta. Të afërmit e të vdekurve, shumica burra, ishin atje. Secila familje varrosi të vdekurin e vet. Çdo familje hapi vetë varret. Ishte kallaballëk i madh atje. Varret ishin të cekët. Ne duhej ta kryenim me nxitim atë punë.[20]

Në maj 1999, CNN transmetoi një film, dhe një kosovare, Dr. Liri Loshi, pretendoi se kish parë në këtë film skena të masakrës së Izbicës. Filmi tregon një numër të madh kufomash të përgjakura të veshur me rroba civile. Sipas doktoreshës, këta ishin shqiptarët e vrarë në masakrën e Izbicës. Dy dëshmitarë, të cilët ndihmuan të varroseshin të vdekurit i thanë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri Human Rights Watch, që dy fshatarë të zonës e kishin filmuar gjithçka, dhe të dy identifikuan personin, që më vonë i dha filmin Dr. Loshit.[21]

Imazhet satelitorë të NATO-s të marra më 15 prill 1999 dhe të transmetuara dy ditë më vonë, duket se konfirmuan tre radhët e varreve

Në kuadër të fushatës së informacionit, në 17 prill 1999 NATO shpërndau këto pamje satelitare të një fushe pranë Izbicës. Foto në të majtë është marrë në 9 mars. Në foton në të djathtë NATO pohon se ndodhen "deri në 150 varre" dhe është marrë në 15 prill.
ARKIVAT E NATOS

në fushën e Izbicës, të cilat përmbanin – sipas NATO-s – "më shumë se 150 varre." NATO krahasoi fotografinë e marrë në 9 mars 1999 – imazhi satelitor i së njëjtës fushë – që nuk tregon shenja të një toke të gërmuar.

Dëshmitari i cituar më sipër, H.D., i intervistuar nga Human Rights Watch më 9 qershor 1999, mëtoi që forcat serbe u kthyen në Izbicë në ditët e para të qershorit për të nxjerrë trupat, megjithëse ai nuk e pa këtë personalisht.[23] Gjykata e Krimeve të Luftës hetoi ngjarjen në korrik 1999, u bind për ekzistencën e 142 varreve, por nuk ishte në gjendje të gjente ndonjërën prej kufomave.[24]

REZALLA

Fshati i Rezallës është i vendosur në pjesën jugore të komunës së Skënderajt, pranë maleve të Drenicës. Nuk është ende e qartë nëse fshati ka patur lidhje të ngushta me UÇK-në. Sipas informacioneve, më 15 maj Rezalla u bë skenë betejash midis forcave të sigurimit serb e UÇK-së.[25] Cilido qoftë motivi, forcat serbe ia behën në fshat herët në mëngjesin e 5 prillit, hynë nëpër shtëpitë e fshatarëve dhe i dogjën ato, dhe urdhëruan popullsinë të linte fshatin. Një pjesë e madhe e burrave të fshatit ishin sipër në kodra në atë kohë, por sipas dëshmitarëve, pesëdhjetë e tre burra, të cilët ishin të pranishëm, u paraburgosën së bashku me gratë e fëmijët. Disa burra ishin nga fshati fqinjë i Morinës. Një prej dy personave që mbetën gjallë, X.X., (inicialet janë të rreme), një djalë gjashtëmbëdhjetë vjeçar, shpjegoi se si fshatarët u ndaluan:

> Herët në mëngjes, ata (policët serbë) rrethuan fshatin – ata ishin duke qëlluar me armë nga të gjitha drejtimet. Pastaj ata erdhën në fshat, hynë në çdo shtëpi, na nxorrën jashtë, e pas kësaj, u vunë zjarrin shtëpive. Na urdhëruan të shkonim drejt një kodre, duke na thënë "ju mund të shkoni tani tek [Hashim] Thaçi apo tek Clintoni." [Pastaj] na çuan në oborrin e shtëpisë së [H.D.,-së]. Na mbajtën atje nga ora 11.00 deri në orën 17.00 pasdite. Ata veçuan meshkujt me moshë 14-50 vjeç, dhe pasi na lidhën duart pas shpine, na rrahën.[26]

Dëshmia e personit tjetër që mbeti gjallë me emrin M.D., gjashtëdhjetë vjeçar, na bën me dije se, ndonëse burrat u morën në pyetje gjatë gjithë ditës, vendimi për t'i ekzekutuar ata ishin marrë që më përpara:

> Kur na çuan në oborr, filluan të na kontrollonin. Na thanë të nxirrnim çdo gjë që kishim nëpër xhepa. Mes nesh kish gjithfarësoji njerëzish – të moshuar, të verbër, të rinj. Së bashku me të tjerët, ata goditën edhe një djalë trembëdhjetë vjeçar. Kur u gjendëm të rrethuar, filluan të na merrnin në pyetje. Ne i dëgjuam kur thanë "mjaft i pyetëm, tani mund t'i ekzekutojmë." [27]

Dukej qartë se policët serbë ishin duke kërkuar një pretekst çfarëdo për masakrën. X.X. tha se një grup i forcave serbe hapën zjarr në drejtim të fshatit, ndërsa të tjerët u thoshin robërve shqiptarë se të shtënat vinin nga UÇK-ja. Për sa kohë që masakra ishte menduar për të mos kursyer askënd, ndoshta policët serbë shpresonin të përligjnin vdekjet e studjuara me shkëmbimin e zjarrit midis tyre dhe UÇK-së apo me plumbat qorrë nga të shtënat e UÇK-së. Sipas M.D.-së, "ata nuk mungonin të shtinin edhe kur ne ishim në oborr. Na thoshin se ushtria jonë po qëllonte mbi ne." [28] Cilido qoftë qëllimi që donin të arrinin forcat serbe, mbetja gjallë e X.X.-it dhe M.D.-së nuk lë asnjë dyshim mbi arsyet e vërteta të vdekjes së fshatarëve të Rezallës. Rreth orës 17.00, burrat u urdhëruan të viheshin në rresht për dy. X.X.-i e vazhdon kështu dëshminë e tij:

> Në orën 17.00, një grup tjetër policësh erdhi nga Morina [fshat]. Ata që ishin me ne deri në atë moment, u larguan në anën tjetër [të fshatit] në drejtim të Likofcit [fshat]. Policët që u larguan [në drejtim të] … Likofcit, filluan të shtinin, ndërsa të tjerët na thoshin se ishte UÇK-ja që qëllonte mbi ne. Më pas, ata morën gratë e fëmijët në drejtim të Likofcit dhe i dërguan në Skënderaj. Një burrë, i cili ishte i verbër, po përpiqej të merrte djalin e tij trembëdhjetë vjeçar, por ata ia morën nga krahët, e mbajtën aty, dhe zunë ta godisnin. Na urdhëruan të viheshim në rresht për dy, e po na drejtonin në rrugën për në Likofc. Pastaj sollën të tjerë, që u bënë bashkë me ne – nja tre a katër – nga shtëpi të tjera … Pasi policët sollën këta të fundit, filluan të përgatisnin armët e tyre. Njëri syresh shkoi tek çatia e shtëpisë së H.D.-së. Me ne ishin rreth tridhjetë policë. I pari që nisi të qëllonte, ishte ai që qëndronte mbi çati. Pas tij, filluan të tjerët. Unë u plagosa nga tre plumba. Qëlluan për gati një gjysëm rresht pa ndërprerje. Më pas, një tjetër syresh erdhi më pranë dhe nisi të shtinte me një automatik. Kur erdhi pranë meje, ai nuk kish më plumba. Kur u kthye me armë të rimbushur, ai nuk erdhi më pranë

meje, aty ku e kish lënë, por diku tjetër; për fat, nuk shtiu mbi mua. Pastaj, morën kamionat e zetorët, dhe ikën prej andej. Qëndrova ashtu si isha për nja dy orë të tjera, pasi kisha frikë të lëvizja.[29]

Ashtu si X.X.-i, edhe M.D.-ja mbeti gjallë, duke u shtirur si i vdekur. Ky i fundit shpjegoi se "ata na thanë të ecnim në të majtë. Ne ecëm rreth 100 metra. Policët ishin fshehur pas zetorëve. Unë nuk pashë më pas kësaj – unë mbeta i plagosur, dhe kaq." [30] Fillimisht, ishin katër vetë që mbetën gjallë. Përveç M.D.-së e X.X.-it, pesëdhjetë vjeçari Sadri Gashi e gjashtëdhjetë e tetë vjeçari Pajazit Kelmendi, që të dy, ishin gjallë pas masakrës. Asnjëri syresh nuk jetoi gjatë. M.D.-ja tha se Sadri Gashi, së bashku me vëllain e tij, u kapën dhjetë ditë më vonë dhe u vranë. Pajazit Kelmendi vdiq nga plagët katër ditë pas masakrës. M.D.-ja e X.X.-i janë të vetmit që mbetën gjallë. Për M.D.-në, vëllai i të cilit u vra gjatë masakarës, ngushëllimi i mbetjes gjallë u errësua nga humbjet: "Kur erdha në vete e u ftillova rreth asaj që kish ndodhur, mendova se të vdekurit ishin me fat, pasi unë nuk di më asgjë rreth familjes sime. Unë nuk di gjithashtu se si mbijetova. Unë isha me ta, tok me ta."[31]

Tmerri i Rezallës nuk mori fund me masakrën. Informacionet e luftëtarëve të UÇK-së na bëjnë me dije se nga fundi i majit, kufomat u nxorrën me buldozer nga varret e cekët tek fusha.[32] Duket se trupat e njerëzve brenda varreve i zëvendësuan me lopë të ngordhura. Gazetarët që vizituan vendin në qershor konfirmuan se varret nuk kishin kufoma njerëzish, por kafshë të ngordhura. M.D.-ja besonte se trupat e fshatarëve shtrihen poshtë atyre të kafshëve, ndonëse nuk u gjet asgjë nga hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës. Zhgënjimi i tij është i qartë: "Njerëzit po thonë se ata i kanë marrë kufomat prej andej, por unë nuk jam i kënaqur që gjërat ndodhën në këtë mënyrë. Secili dëshiron të gjejë eshtrat e babait, të djalit, etj. Ne e dimë që ata nuk jetojnë më, por duam të dimë megjithatë ku janë."[33] Ende nuk dihet ku janë kufomat e tyre.

POKLEK

Pokleku është një fshat relativisht i pasur i përbërë nga dy pjesë – i riu dhe i vjetri – i vendosur në rrethinat e Gllogofcit. Qysh prej marsit 1998, UÇK-ja kish qënë aktive në këtë zonë e rrotull saj. Gjatë

gjithë atij viti, fshati pësoi dëme të mëdha, por edhe dhunime të të drejtave të njeriut. Një vlerësim i dëmeve i bërë në emër të Bashkimit Europian nga Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit në janar 1999 nxorri në evidencë që ish dëmtuar 40% e 70 shtëpive të Poklekut të Ri, dhe 47,6% e 164 shtëpive të Poklekut të Vjetër. [34]

Dhunimi më serioz i të drejtave të njeriut gjatë vitit 1998 ndodhi më 31 maj, kur nja 300 forca të policisë speciale sulmuan Poklekun e Ri. Gjatë sulmit u zunë dhjetë shqiptarë që banonin aty; njëri prej tyre (Ardian Deliu) u gjet më vonë i vdekur, ndërsa nëntë të tjerët nuk janë gjetur ende.[35] Për shkak të pranisë së forcave serbe në Uzinën e Ferronikelit aty pranë, Pokleku mbeti një vend i rrezikshëm deri në mars 1999. Shumë fshatarë kishin lëvizur në drejtim të Gllogofcit apo të fshatit fqinj, Vasiljevo, pak kilometra më tutje. Një ekspert i Human Rights Watch vizitoi Vasiljevo-n në qershor 1998 dhe pa një pikë kontrolli të UÇK-së e forca të tjera.

Asnjë dhunim i bërë në Poklek apo rrotull Poklekut gjatë vitit 1998 nuk është i krahasueshëm me atë që ndodhi të shtunën, më 17 prill, 1999, në pjesën e vjetër të fshatit. Sipas dëshmive të shumta, midis të cilave edhe nga një i mbetur gjallë, të paktën dyzet e shtatë vetë u shtrënguan forcërisht të futen në një dhomë, dhe pastaj, mbi ta u qëllua. Numri i saktë i të vdekurve është i panjohur, ndonëse është e sigurtë se njëzet e tre fëmijë nën pesëmbëdhjetë vjeç mbetën të vdekur.[36]

Një ekspert i Human Rights Watch vizitoi vendin e masakrës – shtëpinë e Sinan Muqollit – më 25 qershor 1999. Shtëpia ishte në pjesën më të madhe e djegur, gjë që ishte thënë edhe nga dëshmitarët. Dhoma ku ndodhi masakra kishte shenja plumbash në mure dhe arka plumbash të kalibrave të ndryshëm në dysheme. Në bodrumin poshtë dhomës u gjendën njolla gjaku të thara, që kish rrjedhur nga tavani e muret, dhe një njollë e madhe gjaku të tharë ish në dysheme. Anëtarët e familjes, të cilët mbetën gjallë ekspozuan një kuti kartoni që përmbante disa prej eshtrave, që – sipas tyre – ishin mbledhur nga dhoma. Treguan gjithashtu një pus aty pranë, ku – sipas pretendimeve të tyre – ishin hedhur disa kufoma.

Human Rights Watch dëgjoi fillimisht për masakrën e Poklekut më 8 maj nga një pjesëtar i familjes Muqolli, F.M., i cili ish në Cegrane, një kamp maqedonas për refugjatët. Gruaja tridhjetë e nëntë vjeçare i tha Human Rights Watch që policët kishin sulmuar Poklekun më 17 prill, në një ditë me shi, rreth orës 6.00. Ajo tha:

Policët u sistemuan fillimisht në shtëpinë, ku banonin familjet Gorani. Masakra ndodhi nja 150 metra larg prej aty. Në orën 8.30, filluan të shtënat. Ne u larguam duke vrapuar tek fusha në drejtim të Gllogofcit. Ndërsa vraponim, ndalonim një çast për të pritur të tjerët që vinin pas nesh. Policët ishin me Zastava 101, jeep-a të bardhë, dhe Niva në ngjyrë gri. Ne arritëm më në fund në Gllogofc, por një grup i dytë prapa nesh u ndalua nga policët, dhe u morën mbrapsht.[37]

Të paktën dyzet e shtatë vetë u shtrënguan forcërisht të futen në një dhomë, dhe pastaj, mbi ta u qëllua.

F.M.-ja qëndroi në Gllogovac për tetë ditë para se të kthehej në Poklek. Kur ajo u kthye në fshat me një kushuririn e saj, katër pjesëtarë të grupit që ishin marrë prej policisë tetë ditë më parë, i treguan atë që kish ndodhur më 17 prill:

> Ata thanë se i çuan në shtëpinë e Sinan Muqollit. "Ju do të ndryshoni veshjet", u tha Sinani. "Ju do të mbeteni gjallë". Policët hynë dhe fëmijët zunë të qanin. Sinani u tha, "Mos qani, sepse ata nuk do t'ju ngasin juve." Policët numëruan gjashtëdhjetë e katër vetë, dhe thanë, "Mos ikni nga shtëpia, pasi ne ju kemi numëruar ju. Nëse ju doni që këta njerëz të mbeten gjallë, duhet të na sillni katër pjesëtarë të UÇK-së." Sinani u tha se ai kish dy djem në Gjermani dhe gratë e tyre janë këtu. Policët pyetën pse janë gjithë këto gra këtu. "Ku janë burrat?" pyetën ata.

Historia e F.M.-së u miratua nga një pesëdhjetë e pesë vjeçar, pjesëtar i familjes Muqolli, R.M.-ja, i cili u ndodh në shtëpinë e Sinanit dhe i shpëtoi masakrës. Dëshmia e tij e hollësishme dhe e rrëqethëse, bash si ju tregua Human Rights Watch, jepet e plotë më poshtë:

> Ndodhi diçka, të cilën ju nuk mund ta shihni njëherë tjetër. Mendoj se ishte 17 prilli. E shtunë. Ata (policët) erdhën nga kodra. Ata erdhën me tanke e me makina. Filluan të shtinin aty për aty. Nuk dinim ku të shkonim, por u përpoqëm të shkonim në Gllogofc. Ata na panë, dhe na u qepën me tri makina, deri sa na gjetën tek ajo shtëpia atje (tregon me gisht një shtëpi afër qytetit). Na thanë, "kthehuni prapa, sepse asgjë nuk do t'ju ndodhë në Poklek." Kur arritëm në fshat, ata filluan të shtinin në ajër.
>
> Ne u kthyem dhe u bëmë së bashku, katër vëllezër. Ishim shtatë vetë,

dhe donim të qëndronim së bashku. Ne qëndruam atje gjithë ditën. Në orën 17.00, ata erdhën. Sinani u hapi derën. Na thanë të dilnim jashtë. Të gjithë. Shkuam jashtë. Na pyetën nëse kishim armë. U thamë jo. Pastaj na thanë të shkonim brenda përsëri. Shkuam brenda. Pastaj, ai(sic) thirri Sinanin dhe Ymerin, i mori jashtë dhe i vrau. Gratë zunë të qanin. Unë po përpiqesha t'u thoja grave, "Jo, jo, ata vetëm sa po shtjenë në ajër." U kthyen pas pesë minutash. Ne ishim shumë. Fillimisht hodhën një bombë. Fëmijët e gratë filluan të qanin. Pastaj ai (sic) filloi të qëlloi me një armë automatike. Qëlloi për një kohë të gjatë. Në atë moment dëgjova një zë nga jashtë të thosh, "Hajde, lëri, ata janë të vdekur tashmë", por ai pa dikë të gjallë dhe zuri të shtjerë përsëri. E ndjeva që iku dhe po përpiqesha të dilja jashtë. U ngrita më këmbë dhe pashë një nga fqinjët e mij [H.M.], që ish plagosur; pashë një grua tjetër dhe vajzën e {S.M.], të cilat ishin plagosur gjithashtu. Nisa të ndihmoj ata që ishin plagosur. Isha i vetëm, së bashku me një fëmijë pesë vjeçar, i cili nuk ish plagosur.

Sende personale të personave të vrarë më 17 prill 1999 në shtëpinë e familjes Muqolli. Të paktën dyzet e shtatë vetë u vranë në shtëpi duke përfshirë njëzet e tre fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

© BENJAMIN WARD/HUMAN RIGHTS WATCH

Pesëmbëdhjetë apo njëzet minuta më vonë, unë pashë forcat e policisë që po vinin sërish e po hynin tek shtëpia e kushurinjve të mij. Kështu që vajzat po përpiqeshin të shkonin në fshat, por unë e H.M. nuk mundëm të shkonim në fshat, sepse po na shihnin nga Ferronikeli. Pas kësaj, forcat e policisë erdhën dhe filluan t'i vënë zjarrin shtëpisë.

Të paktën dyzet e shtatë vetë u shtrënguan forcërisht të futen në një dhomë, dhe pastaj, mbi ta u qëllua.

Atë mbrëmje, kur u bë terr, dolëm jashtë e pamë që ata kishin djegur shtëpitë. Jo një herë, por dy. U përpoqëm të shkonim në fshatin Vasiljevo. Atë natë qëndruam në Vasiljevo. U kthyem pas katër ditësh, dhe gjetëm Sinanin e Ymerin, të cilët ishin djegur e ishin hedhur në pus. Kishte të tjerë që ishin vrarë e ishin hedhur në pus. Ata gjetën nënën e Ymerit, e vranë dhe e hodhën po në pus. Ne po përpiqeshim të mos i dëmtonim kufomat e t'i fshihnim nga sytë e policëve. …Njëzet e tre vetë (apo më shumë) nga të vrarët ishin fëmijë të moshës 6-13 vjeç. Disa gra të moshuara rreth të gjashtëdhjetave u vranë gjithashtu. Unë humba një vajzë tre vjeçare, dy nipër – njëri tre vjeç, tjetri dhjetë muajsh – dhe një vajzë të rritur, njëzet e një vjeç. Atje mbetën gjithashtu një vajzë e një kushurirë, tre fëmijë të saj, dhe kunata.[38]

Duke ju përgjigjur pyetjes mbi identitetin e atij që qëlloi i vetëm mbi njerëzit brenda shtëpisë, për të cilin referimi gjatë dëshmisë ishte me "ai", R.M.-ja tha:

Nuk e njoha se kush ishte, por ishte me uniformë polici. Ishte po ai që na tha të dilnim jashtë e pastaj të futeshim prapë brenda. Po ai që hodhi kufomat në pus, po ai që hodhi bombën, po ai që shtiu. Ishte po i njëjti person që bëri gjithçka.

CIKATOVA E VJETËR

Fshati i Cikatovës së Vjetër, i cili shtrihet në veri-lindje të Gllogofcit, pak kilometra larg këtij qyteti, kishte në vitin 1991 një popullsi prej 1,300 banorësh, që të gjithë shqiptarë etnikë. Fshati ndodhet afër uzinës së Ferronikelit, e cila deri në fillim të 1998-ës kish shërbyer si bazë

operacionesh të forcave të sigurimit serb kundër kryengritësve të UÇK-së, që ishin aktivë në atë zonë.

UÇK-ja ishte në këtë fshat e rrotull tij gjatë gjithë vitit 1998 e gjatë muajve të parë të 1999-s, dhe forcat serbe kishin bërë dëme të mëdha në Cikatovën e Vjetër, shumë kohë përpara ofensivës së marsit 1999. Një vlerësim i dëmeve i bërë nga Kombet e Bashkuara më 2 nëntor 1998, arriti në përfundimin që ishte dëmtuar 60% e fshatit, nga të cilat 20% ishin dëmtime të rënda. [39] Në atë kohë, vetëm nëntëdhjetë shqiptarë jetonin në fshat, kryesisht për shkak të rreziqeve që vinin prej pranisë së afërt të garnizonit serb në uzinën e Ferronikelit dhe të betejave të vazhdueshme aty pranë midis forcave serbe e UÇK-së.

Human Rights Watch vizitoi Cikatovën e Vjetër më 25 qershor 1999. Banorët thanë se në fshat janë 114 shtëpi. 40-50% e fshatit ishte e shkatërruar keqas. Shumë shtëpi ishin djegur nga brenda, gjë që dëshmon se nuk ishin dëmtuar gjatë luftimeve, por ishin djegur qëllimisht. Disa struktura ishin gjithashtu të shkatërruara prej buldozerëve.

Sipas dëshmitarëve të fshatit e të Gllogofcit, sulmet qeveritare mbi Cikatovën e Vjetër filluan një të shtunë, më 20 mars, pesë ditë përpara se të nisnin bombardimet e NATO-s, kur operacionet ushtarake kundër pozicioneve të UÇK-së përreth fshatit zunë fill nga uzina e Ferrokromit. Një dëshmitar i fshatit, A.A.,[40] i tha Human Rights Watch: "Ne ishim midis UÇK-së e ferronikelit. [Forcat serbe] filluan të granatonin në drejtim të ushtarëve të UÇK-së që nga ferronikeli." [41] Një fshatar tjetër përshkroi shkëmbimin e vazhdueshëm të zjarrit atë ditë.

Fshatarët i treguan Human Rights Watch, se ata ishin këshilluar nga personeli i OSBE-së përpara se këta të iknin, që "nëse do të ndodhte më e keqja", fshatarët duhet të rivendoseshin në Gllogofc. Ndërsa sulmet vazhdonin më 20 mars, shumë fshatarë ndoqën këtë këshillë. Një pjesë e tyre arritën të futeshin në Gllogofc, por një grup i përbërë nga anëtarë të familjes së madhe Morina, u ndaluan nga policia pranë shkollës, ndërsa ata po përpiqeshin të linin fshatin. Një prej grave të kësaj familjeje, B.B., i tha Human Rights Watch:

> Ne u ndaluam nga tanket e policisë, ndërsa ishim përballë shkollës. Ata morën burrat dhe i ndanë nga ne, duke i pyetur ata nëse ishin ushtarë të UÇK-së. Pastaj na futën në shkollë – gratë e fëmijët në një klasë, e burrat në një klasë tjetër. Na mbajtën atje nga ora 7.00 deri në

> orën 15.00 pasdite. Ata na thanë, "nëse UÇK-ja do të shkrehë një armë gjatë kësaj kohe, ju do të vriteni që të gjithë." [Më pas], policët e ushtarët na lanë në klasat ku ishim dhe u nisën drejt maleve, ku ish UÇK-ja. Ata qëllonin nga ferronikeli me topa e predha. [43]

Dikur nga pasditja, ata u lanë të lirë që të gjithë, duke u thënë të ktheheshin në shtëpi. Të nesërmen, më 21 mars, rreth orës 13.00 arriti Kryqi i Kuq Serb, të cilët larguan nga fshati gratë e fëmijët që kishin mbetur aty. Një pjesë e madhe refuzuan të iknin pasi, thanë ata, Kryqi i Kuq Serb do të shpërngulte vetëm gratë e fëmijët, ndërsa këta të fundit nuk donin të linin prapa njerëzit e tjerë. Ata që u çuan në Gllogofc, qëndruan atje dhjetë deri në njëzet ditë, para se të kthehshin në Cikatovën e Vjetër. Një prej grave të evakuara për në Gllogofc nga Kryqi i Kuq Serb, B.B., e cila më pas u kthye në Cikatovën e Vjetër, tha se "Ne u kthyem në fshat dhjetë ditë më pas, pasi gjysma e familjes kish mbetur atje."[43]

Gjatë tri javëve në vazhdim, banorët e mbetur të Cikatovës së Vjetër panë se shtëpitë e tyre ishin plaçkitur nga policët e paraushtarakët. Sipas shumë dëshmitarëve, forcat e sigurimit serb grabitën vetura e zetorë të civilëve, me të cilat mund të lëviznin rrotull fshatit. Megjithatë, në pjesën më të madhe, banorët e mbetur u lanë të qetë gjatë kësaj periudhe, ndonëse ata ishin të trembur nga kërcënimet e bëra gjatë paraburgimit në shkollë.

A.A., një grua njëzet e nëntëvjeçare nga Cikatova e Vjetër, i shpjegoi Human Rights Watch se si më 14 prill, pasdite, tre oficerë policie hynë në shtëpinë e ungjit të saj për të bërë – kështu u besua – atë që quhej kontroll routine. Në mbrëmje, në orën 20.00, tre oficerat u kthyen, pasi kishin vënë maska të bëra me çarçafët e nderë jashtë shtëpisë. Gratë e vajzat ishin brenda në shtëpi, së bashku me një plak tetëdhjetë e dy vjeçar. Sipas A.A.-së, e cila ishte e pranishme, "ata ju qepën plakut, duke i thënë 'na jep pará ose flori, ose do t'ju vrasim të gjithëve." Ata kërkuan 500 marka gjermane. B.B., e cila ishte gjithashtu e pranishme, u përpoq të gjente 500 marka: "ne u thamë, nëse mund të dilnim e t'u kërkonim të tjerëve, pasi nuk kemi pará në shtëpi. Doli motra ime e u kthye me 300 marka. Pas kësaj, morën floririn që gjetën." Para se të iknin, njëri prej tyre e drejtoi gishtin nga një fëmijë një vjeçar, dhe sipas B.B.-së, tha: "Ju jeni gjallë falë këtij djali të vogël, ndryshe do t'ju kishim vrarë të gjithëve."

Grabitja e 14 prillit ishte paralajmërimi i një tmerri që do të vinte më pas. Në orët e para të së shtunës, më 17 prill, fshati u sulmua përsëri nga forcat serbe. Në mbrëmje morëm vesh se ishin vrarë njëzet e katër burra të familjes Morina. Një djalë shtatëmbëdhjetë vjeçar e një i moshuar u shtrënguan të merrnin pjesë në negociata me paraushtarakët e policët, të cilët u thoshin se, ose duhej pranonin të iknin bashkë me gratë e fëmijët, ose do të vriteshin. Ndoshta do të lejoheshin të iknin. Ata që mbetën gjallë këmbëngulnin që asnjë prej të vrarëve nuk ish anëtar i UÇK-së, ndonëse disa anëtarë të familjes ishin të deklaruar si ushtarë të UÇK-së, përfshirë dy vetë, të cilët vetëm u plagosën gjatë sulmit.

Para sulmit të 17 prillit, familja Morina, për t'u siguruar, ishte shpërndarë në disa shtëpi në një lagje të fshatit. Sipas deklaratave të gjashtë dëshmitarëve, shtëpitë u sulmuan në mëngjes herët nga katër drejtime: "nga Ferronikeli, nga shkolla, nga zona e pushtuar prej UÇK-së dhe nga nënstacioni elektrik." A.A. përshkroi çfarë ajo kish parë:

> Në orën 6.00 të mëngjesit filluan të dëgjohen krismat…. Ne nuk dolëm jashtë. Ishim të frikësuar nga krismat dhe s'kishim asnjë ide mbi çfarë po ndodhte me fqinjët tanë…. Rreth një orë apo një orë e gjysëm më vonë, ata erdhën tek shtëpia e tim ungji …. Kur na thanë të dalim jashtë, ne pamë që oborri ishte i mbushur me policë të armatosur. Dolëm jashtë të gjithë – burra, gra, fëmijë; ndërsa dilnim, ne gratë rrinim pas burrave.[44]

Dëshmitarja D.D., nënë e pesë fëmijëve, ishte në një shtëpi tjetër aty pranë. Ajo tha:

> Ata nisën një sulm të egër kundër fshatit në orën 5.30. Fëmijët tanë ishin ende në gjumë. Dëgjoheshin krisma armësh automatike dhe granatash. Mbi kokat tona binin copa xhamash të dritareve e copa tjegullash të çative. U shtrimë më dysheme së bashku me fëmijët… Ata hynë në shtëpi, shpërthyen derën dhe ia behën në dhomë. Na kapën nga krahët e na nxorën përjashtë me forcë. Nuk na lanë as të visheshim…[45]

Fshatarët përshkruajnë forca të llojllojshme policore, ushtarake e paraushtarake me uniforma të maskuara në ngjyrë blu apo të gjelbër

dhe helmeta hekuri në kokë. Një pjesë kishin edhe shami të kuqe, blu, të zeza apo të verdha të lidhur në krahët e tyre, të cilat mund të jenë përdorur për të fshehur stemën në uniforma apo identitetin e trupave që përfaqësonin. D.D. pretendoi që ajo pa emblemën e tigrit të qepur në uniforma dhe që trupat mbanin doreza të zeza pa gishtrinj. Nëse është e vërtetë, emblema e tigrit tregon praninë e tigrave të Arkanit, një grup i njohur paraushtarakësh. Dëshmitarët nënvizuan gjithashtu që forcat ishin të armatosura rëndë, me jelekë antiplumb, me armë automatike (në disa raste me bajonetë) dhe me granata.

C.C. përshkroi se si të zotët e shtëpive ishin nxjerrë jashtë. Burrat u ndanë nga gratë, tha ajo, dhe u rreshtuan me fytyrë nga muri i shtëpive aty pranë. Përderisa shtëpitë ishin ngjitur me njëra-tjetrën, por jo me mure të përbashkët, familjet ishin mbledhur në disa grupe, dhe dëshmitë tregojnë një mospërputhje në kohë midis operacioneve kundër secilit prej grupeve. C.C. i tregoi Human Rights Watch:

> Ata erdhën tek shtëpia jonë e bërtitën, "Dilni jashtë një nga një." Ne dolëm dhe morëm të ecnim në rrugë. Ishte edhe një grup tjetër që po ecte me ne. Trupat serbe që na shoqëronin ishin të gjithë të dehur dhe me helmeta hekuri në kokë. Ishin të skuqur në fytyrë dhe kishin shami të lidhura në krahët e tyre: të kuqe, blu e të zeza. Ne u trembëm. Më pas ndanë burrat nga gratë. Nuk na lanë të bisedonim apo të bënim diçka me njëri-tjetrin. Ishin të nervozuar, si të dalë mendsh. Nënat tona kërkonin të na merrnin në mbrojtje, por ata i godisnin dhe i largonin. Baballarëve u morën fëmijët e vegjël nga krahët. Motra ime i shtrëngonte dorën babait. Njëri prej tyre i tha asaj: "Lëshoji dorën atij e shko tek jot ëmë." Ajo nuk donte, kështu që ata e goditën në kokë me një qytë pushke. Sytë e babait u mbushën me lotë.[46]

Fshatarët përshkruajnë forca të llojllojshme policore, ushtarake e paraushtarake me uniforma të maskuara në ngjyrë blu apo të gjelbër dhe helmeta hekuri në kokë.

Masakra e parë ndodhi, ndërsa vazhdonte operacioni i boshatisjes së shtëpive dhe i ndarjes së burrave nga gratë. Forcat e sigurimit, sipas disa të afërmëve, kapën Avdil Morinën, ndërsa ky i fundit po përpiqej të largonte familjen e tij. Avdilit i kishin ngulur thikën në fyt, dhe më pas e kishin vrarë në prani të familjes. B.B., e cila dëshmoi vrasjen, i tha Human Rights Watch, "Ai

kish një plagë të madhe në fytin e tij; ata e prenë me thikë në qafë, i shtynë gruan dhe fëmijën, dhe e vranë."

Ndërkohë, gratë ishin urdhëruar të iknin nga fshati. Një dëshmitar tjetër, E.E., shpjegoi:

> Na çuan tek shtëpia e një fqinji. Nga ajo shtëpi ata morën katër burra. Nga shtëpia jonë morën tre – vjehrrin, xhaxhain e tij, dhe burrin tim. Të gjithë burrat u ndanë mënjanë. Vjehrra ime kërkoi të ndërhyjë …, por ata e hoqën me forcë dhe na thanë të shkonim në Gllogofc. Më pas, i çuan burrat në një vend më poshtë. Ndërsa ne ishim në rrugë, dëgjuam krismat e para. Nuk mund ta dija nëse qëllonin në hava apo jo, por dëgjova shumë krisma. Ne e morëm me mend që ata po vrisnin burrat tanë. Vjehrrës sime i ra të fikët.[47]

Pavarësisht përpjekjeve për t'i vrarë burrat larg syve të njerëzve, një grua, dëshmitarja A.A., pa tek u vranë njëmbëdhjetë burra rreth orës 8.00. Ajo i tha Human Rights Watch:

> Ata rreshtuan të gjithë burrat me fytyrë nga muri, dhe ne të tjerëve na urdhëruan të largoheshim që andej, por unë nuk shkova me të tjerët, [sepse] ne kemi vetëm një djalë. Gratë po bërtisnin dhe fëmijët po qanin, por ishte e kotë. Ata i çuan burrat tek oborri i një fqinji, [armët u shkrehën], dhe unë pashë ata të këputeshin për tokë. Fëmijët nuk donin të largoheshin prej andej – ata po qanin. Pasi i pashë ata të rrëzoheshin për tokë, unë fillova t'u bërtisja [të tjerëve]: "Ej, i vranë të gjithë." U dëgjuan shumë krisma…[48]

Disa prej anëtarëve meshkuj të familjes Morina, përfshirë një invalid të moshuar dhe një djalë të ri, ia dolën mbanë të shpëtojnë, por duke kaluar nëpër pika të një kontrolli të rreptë policor, ku u kërcënuan me vdekje. Më i riu, C.C., shpjegoi atë që ndodhi:

> Ata më morën edhe mua. Gjyshja ime nuk donte të më linte të shkoja me ta, por ata iu çorrën: "Largohu prej këtu, sepse nuk kemi për t'i lëshuar." Një oficer policie më tha, "Ik", por tjetri vendosi tytën e automatikut në gjoksin tim dhe m'u drejtua, "Ku po shkon?" Kjo skenë u përsërit tri herë. Më në fund ata folën mes tyre dhe vendosën të më

> linin të largohesha. Lanë edhe gjyshin tim gjithashtu. Nuk lanë njeri tjetër… Na bërtitën, "Ikni në Gllogofc". Ndërsa ne nuk po lëviznim, ata filluan të bënin si të çmendur. Ne u larguam pak më tej. Ata u thanë burrave të viheshin në rresht e të mbështeteshin tek muri. Më pas, zunë t'i shtynin vetë drejt murit – ata kishin armë. Unë nuk pashë se çfarë ndodhi, ndonëse isha pesë metra larg. Mendoj se pashë gjakun e tyre që rrithte.[49]

Ndërsa ecnin rrugës e arave të pluguara, grupi me C.C.-në e gjyshin e tij u ndaluan nga policia jashtë shkollës, në të cilën, shumë prej tyre ishin paraburgosur një muaj më parë. Fati i të dyve u vu edhe njëherë në diskutim. Sipas C.C.-së:

> Ata thirrën gjyshin dhe e pyetën për mua. Më ndanë nga rreshti, dhe mua mu desh të shkoja me ta. Më pyetën, "Pse ju lanë të iknit? Ata nuk duhej t'ju linin." Gjyshi im u tha, "Shokët tuaj atje poshtë e lejuan atë." Ata i bënë edhe disa herë të njëjtën pyetje, "Pse ata ju lejuan ju të iknit?" Gratë, nëna ime, gjyshja e të tjerë, po qanin për mua. Ata thanë, "Lëre të ikë, ai është i vetmi që ka mbetur, dhe është i ri." Pesëmbëdhjetë minuta më vonë, njëri prej tyre më tha të ikja. U nisëm drejt Gllogofcit.

Grupi u ndalua edhe njëherë në rrugën për në Gllogofc nga personeli ushtarak i uzinës së ferronikelit, dhe u përball me të njëjtat pyetje. Më në fund i lanë të vazhdonin rrugën për në qytet.

Ndonëse disa gra të moshuara u përpoqën disa herë të ktheheshin në fshat, në mënyrë që të gjenin e varrosnin kufomat e burrave të tyre, ato nuk u lejuan. Sipas A.A.-së, gratë "nuk mundën të shkonin përtej shkollës …Në përpjekjen e tretë për të shkuar në fshat, atyre iu tha, "Ne mund t'ju lejojmë juve të shkoni, por në shtëpitë tuaja ka policë dhe ata do t'ju vrasin."

OFENSIVA E 30 PRILLIT

Siç dëshmojnë masakrat e Rezallës, Cikatovës e Poklekut, aksionet e forcave të sigurimit serb në Drenicë, pjesërisht u projektuan për të kontrolluar shpërnguljen e popullsisë civile. Ndërsa disa fshatra u sulmuan më përpara dhe popullsia e tyre u shtrëngua të shpërngulej,

fshatra të tjerë u lanë relativisht të paprekur për të shërbyer si të ashtuquajturat "zona të lira", ku civilë në lëvizje mund të gjenin strehë. Strategjia e përqëndrimit të detyruar të popullsisë civile brenda pak fshatrave u komplikua nga përpjekjet për të krijuar barriera civilësh midis forcave të sigurimit serb e UÇK-së, në mënyrë që të kufizohej agresiviteti i sulmeve të UÇK-së apo të rritej siguria e pozicioneve serbe. Siç u bë e njohur më sipër, fshatarët e Cikatovës së Vjetër e panë veten peng të kësaj strategjie, ndërsa ata u shtrënguan të mbeten në fshatin e tyre, të futur në kurthin midis forcave serbe të dislokuara në Uzinën e Ferronikelit dhe të pozicioneve të UÇK-së që donin t'i sulmonin këto forca.

Siç u përmend më sipër, uzina e ferronikelit u përdor shpesh si bazë nga forcat serbe e jugosllave gjatë gjithë vitit 1998 e 1999. Gjenden raportime të pakonfirmuara, sipas të cilave, duke filluar nga marsi 1998, kompleksi i madh industrial e minerar u përdor gjithashtu si vend paraburgimi për shqiptarët. Personeli i OSBE-së që vizitoi uzinën në qershor 1999 pa atë që është karakterizuar në raportin e tyre si "dëshmi e mundshme e torturimit" të civilëve nga forcat e sigurimit serb, si për shembull, një shtyllë me gozhdë të ngulura në të dy skajet e saj.[50] Dëshmia e banorëve të zonës së Gllogofcit konfirmon në mënyrë të sigurt një prani të qëndrueshme të forcave të sigurimit serb gjatë marsit e prillit 1999.

Në natën e 29 prillit, avionët e NATO-s bombarduan uzinën e ferronikelit, duke shkaktuar atje dëme të mëdha. Numri i viktimave midis forcave serbe dhe përmasat e dëmit mbi kapacitetet ushtarake janë të panjohura. Sidoqoftë, reagimi i ushtarëve, policëve e paraushtarakëve serbë ishte i menjëhershëm, i qartë dhe i egër. Në mëngjesin e 30 prillit, forcat serbe sulmuan fshatrat e Shtuticës, Vërbofcit, Baksit e zonat përreth. Nja njëqind burra shqiptarë u vranë dhe më shumë se dyqind u burgosën gjatë operacionit.[51] Të burgosurit u çuan tek një xhami e shkatërruar pranë Cirezit dhe u mbajtën atje gjatë gjithë natës. Të nesërmen, ata u ngarkuan në kamionë për t'i çuar në burgjet e Gllogofcit e Lipjanit. Disa prej kamionëve u ndalën në minierën e Shavarinës pranë Cikatovës së Vjetër. Të paktën një qind burra u zbritën nga kamionët dhe u ekzekutuan. Të mbeturit gjallë u çuan në Gllogofc, ku u morën në pyetje dhe u rrahën për pesë ditë me radhë, përpara se të transportoheshi në tre fshatra, ku ata qenë të detyruar të punonin deri në muajin qershor. Besohet që numri përfundimtar i të vrarëve të jetë më shumë se dyqind.

Vërbofc

Më 30 prill, fshati i Vërbofcit dhe zona përreth ishin nën kontrollin e UÇK-së. Ndonëse zona ish sulmuar më parë nga forcat qeveritare, dëshmitarët e pranishëm në këtë zonë përshkruan fshatin dhe rrethinat si një "zonë të lirë", duke dashur të thonë që ishte një zonë, ku civilët shqiptarë nuk ndjeheshin të kërcënuar nga sulmet e forcave të sigurimit serb. Si rrjedhim, kishte një numër të madh njerëzish të ardhur nga fshatra të tjerë e që strehoheshin në zonën e Vërbofcit, përfshirë Glladno Sello, Tërstenik, Poljancë, Gllobar e Poklek. Një sulm që ju bë fshatit në fillim të prillit i kish shtrënguar banorët të iknin në pyll për një natë të vetme. R.K., një banor i Vërbofcit rrëfeu:

> Prilli ishte muaji më i keq, pasi u vranë shumë vetë. Do t'ju tregoj ju rastin e vrasjes së tim eti. Ai ishte tetëdhjetë e katër vjeç. Kur na sulmuan serbët, ne të gjithë u larguam, ndërsa ai qëndroi atje. Ata e vranë në oborr. Ne nuk mund të ktheheshim prapa atë mbrëmje. Na u desh të flinim në pyll. Kur u ktheva, e gjeta atë në oborr. E kishin qëlluar në kokë … Babai u vra më 7 prill, por shumë vetë u vranë më 30 prill…[52]

Uzina e hekurnikelit pranë Gllogofcit ishte përdorur si bazë nga forcat serbe dhe jugosllave në vitet 1998 dhe 1999. NATO bombardoi ndërtesën më 29 prill 1999. © BENJAMIN WARD/HUMAN RIGHTS WATCH

Sulmi i 30 prillit në Vërbofc filloi në të gdhirë. Gjashtë dëshmitarë të intervistuar në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri nga Human Rights Watch deklaruan që fshati u sulmua midis orës 5.00 e 7.00. Të gjithë dëshmitarët përshkruan se si fshati u rrethua. Duke patur parasysh praninë e UÇK-së në zonën e Vërbofcit, rrethimi i fshatit nga forcat e sigurimit përbën një veprim taktik. F.P., një banor njëzet e dy vjeçar i Vërbofcit, i cili e deklaroi veten si një pjesëtar të UÇK-së, tha:

> Fshati u rrethua nga të gjitha anët. Forcat erdhën nga drejtimi i Glladno Sello, Poljancës dhe Cirezit… Ofensiva filloi rreth orës 6.00 dhe vazhdoi deri në orën 16.00. Ata qëlluan me tanke e mortaja… [Në fshat] ishin vetëm dhjetë ushtarë [të UÇK-së]… pjesa tjetër ishin civilë. Shumica e ushtarëve ishin në pyll.[53]

F.P., i cili ishte "në pyll, duke kqyrur me dylbi", tha gjithashtu se rreth orës 3.00 pasdite, njësiti i tij kish ndeshur në pyll një pozicion serb, dhe kish luftuar me ta për gati një orë. Sipas R.N.-së, një banor shtatëdhjetë vjeçar nga Glladno Sello, i cili më 30 prill gjendej në pyllin pranë Vërbofcit, "një numër i vogël" prej njerëzve të vrarë në pyll ishin të UÇK-së." [54] R.N., tha gjithashtu se anëtarë të grupit, me të cilët ai ish fshehur në pyll, kishin me vete armë e dy palë dylbi, por pa thënë nëse ata ishin pjesëtarë të UÇK-së.

Megjithëse ishin të pranishëm një numër i madh civilësh e megjithëse shumë prej të vrarëve, midis të cilëve edhe të moshuar e të rinj, ishin civilë, prania e UÇK-së dhe pohimi i një ushtari të UÇK-së se UÇK-ja zhvilloi luftime me forcat e sigurimit serb ditën e masakrës, e ndërlikon analizën e kësaj të fundit. Numri më i madh i vrasjeve duket se ka ndodhur në vendin, të cilit dëshmitarët i referohen si "lugina e pyllëzuar". Dëshmia e M.H.-së, një burri njëzet e gjashtë vjeçar nga Pokleku, i cili ish strehuar në Vërbofc në atë kohë, na thotë se forcat serbe lanë një shteg ikjeje, i cili të çonte tek "lugina e pyllëzuar". Ai shpjegoi:

> Ne ishim të rrethuar. Ofensiva filloi rreth orës 5.00 të mëngjesit. Halla ime na zgjoi nga gjumi e na tha të iknim, pasi kishin mbërritur policët. Në kohën që e lamë Vërbofcin, pamë që kishte forca policore gjithandej. Pamë që kish vetëm një rrugë për t'u larguar. Dhe morëm të iknim nëpër atë shteg, që të çonte në mal. Ishte një lloj lugine me pemë … Ne

> mundëm të dëgjonim zërat e serbëve. Na rrethuan. Ishin nja dy kilometra larg nesh. Nisën të shtinin, por jo mbi ne. Kur na u afruan, zunë të shtinin mbi ne. Disa prej nesh u vranë – unë veç u plagosa. Im vëlla u godit në gjoks me tre plumba. Policët ndjenë se ai murmuriste akoma, u kthyen, dhe zbrazën mbi të nëntëmbëdhjetë plumba të tjerë. Pashë skenën, ndërsa ata qëllonin ...Një polic më kish hedhur vështrimin mua. Isha i mbuluar nga gjaku, dhe ndoshta ai mendoi se kisha vdekur. Qëndrova në atë vend për dymbëdhjetë orë rresht. U vranë gjithsej njëzet e nëntë vetë.[55]

S.G., një gjashtëdhjetë e dy vjeçar nga Vërbofci, u nda nga pjesa tjetër e familjes së vet, të cilët kishin vendosur të gjenin strehë në luginë:

> Ishte 30 prill. Mëngjes. Ora 6.00... Ishim akoma në gjumë, kur dëgjuam krisma nga të gjitha anët ...Pas jo më shumë se një gjysëm ore, të gjithë ata që banonin në shtëpitë e pjesës së sipërme të fshatit, po vinin teposhtë drejt luginës. Gra, fëmijë, e të moshuar drejtoheshin andej, ndërsa ne të rinjtë e burrat u drejtuam nga pylli.... Kur arritëm në pjesën e sipërme të pyllit, munda të shihja forcat që po vinin nga të gjitha anët, nga Gllobari, Tërsteniku, Cirezi, Shtutica dhe Glladno Sello. Ishim të rrethuar. U takova me një pjesë të refugjatëve [njerëz të shpërngulur], mes të cilëve ishte familja dhe nipi im. Askush nuk dinte çfarë të bënte. Si prind, isha përgjegjës për fëmijët e mij. U thashë atyre të largoheshin nga kodra. Ne menduam se ai vend [vendi ku fëmijët tanë u fshehën] ishte një lloj lugine, dhe në këtë mënyrë serbët nuk mund t'i gjenin atje. Por ata (forcat serbe) nuk lanë asnjë prej tyre të gjallë... Midis njerëzve që serbët kapën në luginë ishte edhe vëllai im. Një pjesë u çuan në një lagje të veçantë të fshatit. Që të gjithë u vranë.[56]

Nuk dihet nëse ishin urdhëruar të kufizonin numrin e vrasjeve apo nëse thjesht kishin lejen për të vrarë atë që donin, por fakti është që forcat serbe nuk i vranë të gjithë burrat shqiptarë që hasën në zonën e Vërbofcit. S.G. u kap nga ushtarët serbë të nesërmen në mëngjes, pasi kish kaluar natën në shtëpi dhe u çua i palënduar në Gllogofc, ku u paraburgos (Shih më poshtë seksionin mbi paraburgimet). Zënia rob nuk i jepte domosdoshmërisht fund rrezikut për të mbetur i vrarë, megjithatë. B.R.,

një banor dyzet e pesë vjeçar i Vërbofcit, i shpëtoi vdekjes për një qime, ndërsa ndërhyri të shpëtonte djalin e vet:

> Ishte 30 prill. Mëngjes. Ora 7.00. Forcat ishin brenda në fshat. Erdhën nga të gjitha drejtimet me të gjitha llojet e makinave. Ne, burrat, vendosëm të largoheshim… Ikëm në pyll. Unë isha me djalin tim. Djali im më i madh nuk qëndroi me ne. [Forcat serbe] e panë djalin (atë që ish me mua) në mes të shkurreve. E rrethuan dhe qëlluan në drejtimin ku ndodhej ai. Ata i thanë të thërriste shokët e tij, por ai nuk kuptonte sërbisht. Njëri prej serbëve tha se "ai po shtiret sikur nuk kupton sërbisht, më lini të qëlloj mbi të." Kur pashë se ata po bëheshin gati të qëllonin djalin, iu afrova atyre dhe u thashë se ai nuk kupton vërtet sërbisht. Na çuan pranë ujit e na thanë të hiqnim xhaketat. Na rrahën sa na zhdëpën. Njëri prej tyre, një komandant, pa disa shqiptarë të tjerë, kështu që ata morën djalin tim si peng, nëpërmjet të cilit donin të gjenin të tjerët. Njëri prej shqiptarëve kish një armë, dhe qëlloi vetëm njëherë në drejtim të paraushtarakëve. Tre policë vunë armët e tyre në supet e mij e filluan të qëllonin. Vranë dy vetë e kapën një të tretë, I.F.-në. Pashë se si e therën mu atje [bën shënjën e therjes në fyt]. Kur pashë se djali im ish në rrezik, u thashë policëve ta linin atë e të më merrnin mua.
>
> Nuk ma vunë veshin. Më goditën me një gur dhe me qytën e një pushke. Më dhanë një goditje me thikë në njërën dorë. Unë nuk e di se sa vetë ishin – ndoshta dhjetë a pesëmbëdhjetë. Na morën e na vunë në rresht. Sollën një person tjetër [V.B.], dhe i thanë të shkonte e të gjente armën, me të cilin kish qëlluar shqiptari. Ai gjeti vetëm një armë. Ata i thanë se ishin dy armë, dhe qëlluan mbi të. Isha vetëm dhjetë metra larg. Na urdhëruan të shkonim në drejtim të Cirezit. Përgjatë rrugës, ishte një grup tjetër policësh – policë specialë – dhe një tank. Policët specialë, kur na panë, zunë të na rrihnin. Njërin prej nesh, Ismet Prokshin, e lidhën prapa tankut. Më pas, ai u ekzekutua. Unë e pashë skenën…
>
> Djali im po më ndihmonte mua të ecja, sepse isha i mbuluar nga gjaku. Kisha një plagë në kokë, dhe nuk mund të shihja se ku po shkonim. Një kilometër përpara se të arrinim tek shkolla e Cirezit, unë rashë përtokë. Djali im donte të qëndronte me mua, por ata nuk e lejuan. Njëri prej tyre po thoshte, "përse nuk e vrisni atë." Një tjetër tha, "lëre, ai është pothuaj i vdekur." Menduan se do të vdisja, dhe më lanë …

> Ishte hera e fundit që pashë djalin tim. Ai u ekzekutua në Shavarinë.

Rrahja e B.R.-së dhe ekzekutimi i Ismet Prokshit nga ana e paraushtarakëve u konfirmua nga Z.Z. (inicialet janë të ndryshuara), një dyzet e katër vjeçar nga Poljanca, i cili u kap më 30 prill në rrethinat e Vërbofcit.[58] Sipas këtij personi, Prokshi, i cili ishte tashmë i plagosur, u godit për vdekje pasi dy avionë të NATO-s fluturuan mbi kokat tona atë pasdite. A.D., një njëzet e katër vjeçar nga Tërsteniku, u kap së bashku me B.R.-në. Ai konfirmoi fluturimin e avionëve të NATO-s dhe rrahjen e B.R.-së:

> Ata (forcat serbe) më kapën së bashku me [B.R.] dhe djalin e tij në orën 11.00. Fillimisht, ata zunë të na godisnin me gjithçka kishin në duar. Nuk e teproj të them se ata po kërkonin të më thernin. Njëri preej tyre kish një shami të kuqe në krahun e tij. Na çuan pranë një përroi e na thanë të shtriheshim për tokë…ata rrahën B.R.-në e djalin e tij. Na çuan në Shtuticë. Në rrugë e sipër u ndeshëm me një grup prej tridhjetë civilësh. Na urdhëruan të mbanim duart lart. Më morën kartën e identitetit dhe pasaportën. Kur u ktheva nga Anglia, e gjeta pasaportën në atë vend. Ishim gjithsej rreth gjashtëdhjetë vetë në Shtuticë. Pamë të vdekur atje. Pashë trupin e njërit prej kushurinjve të mij. Na thanë të shtriheshim për tokë dhe të zhvisheshim. Na lanë vetëm në bluzë me mëngë të shkurtëra… pastaj na urdhëruan të shkonim drejt xhamisë në Cirez. Ishte ora katër pasdite… Në rrugë e sipër për në Cirez e braktisën B.R.-në, sepse menduan që kish vdekur… Një paraushtarak donte të qëllonte mbi të, por një tjetër i tha, "lëre, ai ka vdekur tashmë."

Y.Y. (inicialet janë të ndryshuara), një mesoburrë nga Gllobari u kap gjithashtu pranë Vërbofcit.

> Ishte 30 prill. [Forcat serbe] na sulmuan nga Gllobari, Cikatova e Vjetër, Cirezi dhe nga drejtimi i Poljancës, Shtuticës, e Vërbofcit rreth orës 6.00 në mëngjes. Ishin më shumë se 5,000 vetë që qëndronin në pyll. Ne e quajmë atë vend "Fusha e Mollës". Nuk kishim armë, por ishte një numër i caktuar i pjesëtarëve të UÇK-së brenda [Vërbofcit]. Ishte një ditë e tmerrshme. Vranë shumë njerëz … Vërbofci ishte një zonë e lirë …Ishte ora 17.00. Kishim mbetur njëzet a tridhjetë vetë nga ne. [Forcat

serbe] erdhën pranë nesh. Pylli kish marrë zjarr. Kishte atje policë, ushtarë e paraushtarakë me maska. Na u afruan dhe na futën në rreth. Na lëshoi zemra. Na rrahën keq dhe na dërguan në një shtëpi të Vërbofcit rrëzë malit. Na thanë të hiqnim xhaketat. Disa prej nesh mbetën edhe pa pantallona … [pastaj] na morën e na çuan në xhaminë e Cirez-it.[60]

Dyzet e pesë vjeçari A.S., një banor i Baksit u kap në "Fushën e Mollës" po atë ditë, në orën 14.00. Sipas tij, ai dhe tetëdhjetë e pesë veta të tjerë, u urdhëruan të shtriheshin për tokë, dhe përpara se të çoheshin tek xhamia e Cirezit, u rrahën keqas.[61]

Z.K., një tridhjetë e shtatë vjeçar nga Glladno Sello, u kap gjithashtu nga forcat serbe së bashku me gjashtë të tjerë më 30 prill në vendin, që ai e quajti "lugina e pyllit", dhe u vunë bashkë me një grup të burgosurish prej tridhjetë a dyzet vetësh. Burrat, njëri prej të cilëve kish patur një armë e ndoshta kish qënë luftëtar i UÇK-së, u paraburgosën, u morën në pyetje lidhur me UÇK-në dhe u rrahën. Përpara se grupi të merrej e të përcillej për në Cirez, të paktën dy vetë u vranë dhe një i tretë u zhduk:

Ishte mëngjesi i 30 prillit, por unë nuk mund të kujtoj orën e saktë. Ne po largoheshim me nxitim. Krismat e tyre dëgjoheshin nga të gjitha anët, dhe merrej vesh se ata po na afroheshin… Ishim të futur në kurth, ndaj u dorëzuam. Ishim të gjithë në luginën e pyllit. Isha bashkë me gjashtë të tjerë, katër prej të cilëve ishin xhaxhallarët e dajallarët e mij dhe dy burra ishin nga Cikatova. U ndalëm zemërlëshuar … Ushtarë të tjerë erdhën pranë nesh. Njëri prej tyre na tha, "t'i jepnim gjithçka kishim me vete". I dhamë gjithçka – paratë, orët e dorës, xhaketat… Me duart lart na nxorrën në rrugë, ku kishte njerëz të tjerë, nja tridhjetë a dyzet frymë, të cilët ruheshin nga një serb i armatosur. Na spostuan edhe nja dyqind metra më tutje… Ishim në rresht për një… Ata po rrihnin [H.B.-në], sepse ai kish patur një armë. Më pas morën një person tjetër [B.B.-në], e çuan në një përrua, dhe e vranë. Ne nuk e morëm vesh …[çfarë i ndodhi] [H.B.-së]…Një prej ushtarëve serbë u kthye prapa i mbuluar në gjak, dhe u kërkoi të tjerëve t'i vinin gishtin njërit prej nesh, pasi – kështu tha ai – "njëri nga ata më takon mua." Në këtë kohë, ata vranë [S.], djalin e tim ungji. I dëgjova ata tek i tregonin njëri-tjetrit, se si e kishin vrarë atë. Pastaj erdhën tek ne e na thanë "ne

do t'ju vrasim të gjithëve." Zunë të godisnin me një shkop djemtë e rinj që ishin me ne. Më pas, na morën e na çuan në një shtëpi..., ku [ishte] një oficer së bashku me katër ushtarë. Na thanë "do t'ju thërrasim emër për emër." Ata kishin një listë të njerëzve të UÇK-së, por askush nga ne nuk ish në listë. Që aty na çuan tek Fusha e Mollës... Atje ishte një tank. Na thanë të zhvisheshim, dhe kështu me rrobat tona mbuluan tankun, pasi kishin frikë nga NATO. Na thanë të shtriheshim në tokë e na pyetën, nëse ne bënim pjesë në UÇK. [H.B.] ishte i plagosur rëndë. Ai nuk mund të nxirrte zë. Unë u godita me kondakun e një pushke, më pyetën për diçka, e pastaj më dhanë një grusht... Morën në pyetje secilin prej nesh. Më pas, sollën një grup tjetër atje – nja trembëdhjetë vetë – dhe bënë të njëjtën gjë edhe me ta, i morën në pyetje dhe i rrahën. Më në fund, na morën e na spostuan në drejtim të Cirezit.[62]

Shtutica

Fshati i Shtuticës u sulmua gjithashtu herët në mëngjesin e 30 prillit. Shtutica kish qënë sulmuar njëherë më 20 mars, kur banorët e saj u shtrënguan të shpërnguleshin për një javë në Cirez. Në fillim të prillit gjithashtu, gjatë një ofensive dyditore të policisë, fshatarët i lanë shtëpitë e tyre, të cilat mbetën të qeta e të braktisura për rreth tri javë. Disa dëshmitarë vunë në dukje që Shtutica e Vërbofci ishin të vetmit fshatra të asaj zone pa një prani të përhershme të forcave të Sigurimit gjatë muajit prill. Të shpërngulur nga Dashevci, Cirezi, e fshatra të tjerë aty rrotull, kërkuan të gjenin strehë në Vërbofc e Shtuticë. Kur fshati u sulmua më 30 prill, banorët, kryesisht meshkujt e të ardhurit nga fshatrat fqinj, iu drejtuan pyjeve aty pranë. Shumë prej burrave u kapën pak më vonë po atë ditë, u çuan në Baks, dhe më pas në Cirez. Banori i Shtuticës R.B., një dyzet e katër vjeçar, mezi mundi t'i shpëtonte vdekjes, kur grupi prej njëzet e pesë burrash, ku ai bënte pjesë, u sulmua në mes të pyllit:

Ishte mëngjesi i 30 prillit. Sapo isha zgjuar nga gjumi. Pamë që ishim të rrethuar. Filloi granatimi, kështu që na duhej të linim shtëpitë e të gjenim një vend më të sigurt.... Ndodheshin nja njëzet e pesë vetë diku atje jashtë... Gratë e fëmijët e fshatit ishin tek shkolla. Burrat ishin të moshës nga pesëmbëdhjetë deri në shtatëdhjetë vjeç. Gjatë ditës, forcat serbe na

u afruan gjithmonë e më shumë. Rreth orës 17.00, ata pothuaj na kishin arritur. Ishin ushtarë e paraushtarakë serbë. Shtinë mbi ne. Isha ndër të parët që u plagosa [në gishta].... Dëgjuam dikë që tha "mos shtini, jemi civilë." Vendosëm duart të lidhura pas kokës.... Pashë se më shumë se tetëmbëdhjetë vetë ishin vrarë. Shtatë prej nesh mundën të iknin prej atje –katër ishin të plagosur. Unë isha plagosur në gishta, në gjoks e në ijë [tregon vrimat e plumbave në xhaketë]. Kontrolluan rrobat tona për flori, për orë dore e për pará.... Pastaj shkuam në Baks... Kur arritëm atje, na urdhëruan të shkonim tek një shtëpi e të qëndronim shtrirë në dysheme.... Na rrahën me një shkop të rëndë. Kur dolëm jashtë në rrugë, pamë një numër civilësh, të cilët ishin arrestuar – ishin shumë, midis të cilëve tre vëllezër të mij dhe disa fëmijë. Morën shtatë vetë nga ai grup dhe i vranë. Ne dimë se ku janë varrosur ata. Serbët vijuan të na rrahin e të na këpusnin të shara... Na ndalën pranë xhamisë në Cirez. Erdhi një ushtar (ishte një zeshkan shumë i gjatë), dhe së bashku me ushtarë të tjerë, nuk rreshtnin së qëlluari mbi trupat tanë. Njëri prej tyre vrau një burrë mu pranë këmbëve tona, përballë nesh.[63]

A.A., një nëntëmbëdhjetë vjeçar nga po ai fshat, ishte në të njëjtin grup. Dëshmia e tij mund të përmblidhet si më poshtë:

Në mëngjes herët, Shtutica e Vërbofci u sulmuan. Kishte shumë të shpërngulur nga fshatra të tjerë dhe shumë banorë të tjerë vendas. Burrat vendosën të shkonin në pyll. Forca të shumta erdhën më këmbë apo me tank në drejtim të pyllit. Ata qëllonin në drejtimin tonë me mortaja e me tanke. Ishte ora 3.00 pasdite, kur ne u ndodhëm fare pranë Baksit... Rreth orës 17.00 ne u rrethuam nga forcat ushtarake. Në atë moment nuk ishim më shumë se tridhjetë vetë. Qëlluan mbi ne për gati pesë minuta rresht. Ishin pembëdhjetë apo njëzet metra larg nesh. Pati shumë të vdekur midis nesh – unë u plagosa në krahun tim të majtë. Ne thirrëm me të madhe "jemi civilë, mos qëlloni mbi ne." Krismat ndalën. Na zunë e na lëvizën tutje trupave pa jetë. Tim ungj ishte gjallë, por i plagosur. Ai u përpoq të çapitej, por nuk mundi. Kështu që ata e ekzekutuan në vend. Unë isha i plagosur në krahun tim të majtë. Ata po na thoshin të mbanim duart të lidhura prapa kokës, por unë nuk mundja...

Na kërkuan pará dhe na thanë të hiqnim xhaketat.... Na çuan në

> Baks, në oborrin e një shtëpie. U shtrimë për tokë me duart prapa kokës për rreth një orë. Më pas, ata na nxorrën jashtë oborrit, dhe unë pashë shumë civilë [shqiptarë] të tjerë. [Pastaj] na nxorrën në rrugën që të çonte në Cirez. Së bashku me tim atë, isha në fillim të rreshtit. Siç ju thashë, nuk mund t'i mbaja duart lart. Një ushtar erdhi afër meje dhe filloi të më provokonte me të shara. Unë nuk kuptoja sërbisht. Ishte babai im që më përkthente. Më pas, ai iu sul babait tim duke i thënë "pse ju kuptoni serbisht, ndërsa yt bir nuk kupton." [Ushtari] mori një granatë dore dhe donte të ma fuste në gojë, por një ushtar tjetër i tha ta linte në punë. Më vunë në fund të rreshtit. U dëgjuan ca të shtëna aty afër meje, por unë nuk pashë çfarë ndodhi.... Na thanë të shkonim në drejtim të Cirezit.[64]

Njëzet e dy vjeçari A.S., banor i Shtuticës, ishte me një grup tjetër i fshehur në pyll, dhe u kap në të njëjtën kohë. Megjithëse mbi këtë grup nuk u qëllua me armë, rrethanat e kapjes së tyre ishin të ngjashme. A.S. shpjegoi çfarë ai pa:

> Ishte 30 prill, e premte. Të nesërmen ata bombarduan ferronikelin. Ne u zgjuam përpara orës 5.00 të mëngjesit dhe e pamë veten të rrethuar. Vërbofci e Dashevci [ishin] gjithashtu të rrethuar. Të rinjtë ikën nga shtëpitë në drejtim të pyllit, duke lënë aty pjesën tjetër të familjeve. Ne u fshehëm në pyll. Dëgjuam krisma gjatë gjithë ditës. Ishte midis orës 16.00 e 17.00, kur [forcat serbe] na zunë. Erdhën me tank.... Ne ishim dyzet a pesëdhjetë vetë. Pasi na morën nga ai vend, na thanë të shtriheshim barkas me duart të lidhura prapa kokës. Aty për aty filluan të rrahin një pjesë prej nesh. Vranë një djalë, i cili nuk ish më shumë se trembëdhjetë vjeç. Më pas, na morën paratë e një pjesë të veshjeve, na vendosën në rresht e na çuan në Qirez.[65]

Çfarë të bie në sy është fakti që shumë prej shqiptarëve të kapur në Shtuticë e Vërbofc u janë marrë xhaketat dhe rroba të tjera. Sipas Z.K.-së, njërit prej të mbeturve gjallë, "ata na kërkuan të zhvisheshim, dhe me rrobat tona mund të maskonin tanket, pasi kishin frikë nga NATO."[66] Sigurisht është e mundur që, ndërsa shtëpitë e ndërtesat e punës u përdorën për të maskuar tanket e paisje të tjera ushtarake, rrobat mund të jenë përdorur për ta bërë sa më të vështirë për avionët e NATO-s

identifikimin e këtyre mjeteve. Një shpjegim tjetër mund të lidhet me përpjekjen e forcave të sigurimit për të dalluar shenja luftimesh, si fjala vjen uniforma të maskuara poshtë rrobave civile apo dërmishjen e supeve nga ngjeshja e armës në betejë e sipër.

Baksi

Siç kanë dëshmuar disa banorë të Shtuticës e të Vërbofcit, shumë prej të kapurve rob u çuan në fshatin Baks dhe më pas u dërguan në Cirez. Duket se Baksi ka shërbyer si një pikë grumbullimi për të burgosurit, përpara se këta të fundit të çoheshin në Cirez (gjë që përshkruhet hollësisht më poshtë). R.B. e A.A., që të dy nga Shtutica, përshkruajnë burgosjen e tyre në një shtëpi të fshatit Baks, përpara se të zhvendoseshin për në Cirez, së bashku me një grup civilësh shqiptarë. Përveç kësaj, banori i Shtuticës A.S., ashtu si dhe F.R., një tridhjetë e nëntëvjeçar nga Cirezi që kish qëndruar në Shtuticë, përshkruajnë burgosjen e pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë burrave në oborrin e një shtëpie në Baks. Sipas A.S.-së e F.R.-së, burrat e shtrirë në tokë u urdhëruan t'u bashkoheshin të sapoardhurve dhe të niseshin për në Cirez.

F.R.-ja identifikoi të zotin e shtëpisë:

> Kur ne mbërritëm në Baks, pranë shtëpisë së …[emri nuk tregohet], pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë civilë ishin të shtrirë për tokë me duart prapa kokës. Fillimisht, menduam se ata ishin të vdekur. Qëndruam aty për nja pesëmbëdhjetë minuta. Civilët e shtrirë u urdhëruan të ngriheshin në këmbë. Kuptuam se ishin të gjallë. Pastaj, ata u vunë përballë nesh [në rreshtin e të burgosurve]…. Morëm rrugën për në Cirez, me një tank që na shoqëronte. Kur mbërritëm tek shtëpia e …[emri mbahet i fshehur], [forcat serbe] na thanë të ndaleshim. Ata shtinë në drejtim të shtëpive aty pranë. Nuk morëm vesh se kundër kujt shtinin. Kur u kthyen, zunë të na godisnin me kondakët e pushkëve. Im atë dhe xhaxhallarët ishin pjesë e një grupi prej pesë personash, të cilët u urdhëruan të qëndronin aty. Pjesa tjetër u urdhërua të merrte rrugën për në Cirez. Katër vetë nga ata që mbetën na arritën më vonë, ndërsa i pesti, një burrë nga Dashevci ishte vrarë.[67]

Dëshmia e R.B.-së përshkruan ekzekutimin e shtatë prej shqiptarëve që u mbajtën si të burgosur në Baks. Këta të shtatë ishin pjesë e një grupi prej tetë personash, të cilët ishin ndaluar në rrethinat e Baksit nga paraushtarakët, pasi një polic serb ishte vrarë. Të tetë burrat u rrahën dhe u detyruan të mbanin trupin pa jetë të policit deri në Baks, ku ata ishin vënë në rresht dhe ishin ekzekutuar. I vetmi që mbeti gjallë, njëzet e dy vjeçari M.F., rrëfeu atë që kish hequr:

> Ishte 30 prill, një ditë e premte .... Isha me dy vëllezërit, me një nip, me një prej xhaxhallarëve dhe me tre kushurinj. Morëm për nga kodrat për të arritur në Baks. Ishte ora katër pasdite, kur u afruan paraushtarakët. Na rrethuan e na kapën. Na çuan tek një fushë e zunë të na rrihnin. Aty pamë kufomën e një polici të ri. Pasi na rrahën, na morën e na drejtuan për në Baks. Gjatë rrugës për në Baks, na ndalën e na rrahën përsëri, duke na thënë "ju jeni të UÇK-së? keni armë?" Ne nuk ishim të UÇK-së dhe nuk kishim armë. Ne po mbanim në krahë policin e vdekur. Kur mbërritëm në Baks, ata na thanë të tregonim cili prej nesh kish vrarë policin.... Na rrahën përsëri, duke na bërë të njëjtën pyetje. Ishin tridhjetë apo tridhjetë e pesë oficerë policie atje. Na thanë të largoheshim nja dy-tre metra. Njëri filloi të shtinte mbi ne. Zumë të vraponim. Disa të tjerë dolën nga tanku e po qëllonin mbi ne. Njëri prej vëllezërve e një kushuri, ishin të parët që mbetën të vdekur. Unë rashë në tokë. Isha plagosur në këmbë. Ata menduan se ne ishim vrarë që të gjithë, kështu që morën tanket dhe u larguan. Pasi kishin bërë nja 250 metra rrugë, dy prej tyre u kthyen dhe erdhën vërdallë për gati pesë minuta. Pastaj ikën. Unë u çova në këmbë, hodha një sy rreth e rrotull dhe pashë që të tjerët ishin të gjithë të vdekur.[68]

Ata menduan se ne ishim vrarë që të gjithë, kështu që morën tanket dhe u larguan.

M.F. i përshkroi paraushtarakët të veshur me "uniforma, por jo si ushtarë. Ata mbanin shaje në ngjyrë të gjelbër e kafe në kokat e tyre dhe shami të kuqe në krahë. Uniformat ishin të gjelbëra e të verdha." M.F. i tregoi një pjesëtari të Human Rights Watch vendin e hyrjes e të daljes së një plumbi në këmbën e vet dhe bëri një rrëfim koherent të ngjarjes. Ai, ishte nisur i plagosur për në Shtuticë, ku u ndihmua nga një i afërm.

Sipas Q.Q.-së (inicialet janë false), një dyzet e gjashtë vjeçar nga Dashevci,

Bexhet Shabani, njëzet e pesë vjeç, u ekzekutua nga paraushtarakët, në një ngjarje që s'kish lidhje me ndonjë masakër në grup.[69] A.S., një njëzet e dy vjeçar nga Shtutica, tha se kish parë në hyrje të Baksit "trupin pa jetë të një djali të ri në mes të rrugës". Q.Q. e shumë prej dëshmitarëve të tjerë të intervistuar, pretendojnë se pati ekzekutime të tjera në zonën e Baksit, por Huma Rights Watch nuk ish në gjendje të konfirmonte këtë gjë.

Xhamia e Qirezit

Shumë prej të kapurve rob në zonën e Baksit, Shtuticës e Vërbofcit, u çuan më 30 prill në xhaminë e Qirezit dhe u mbajtën atje gjatë gjithë natës. Xhamia, i cila është në qendër të fshatit, ish pretuar e djegur para marsit 1999. Human Rights Watch intervistoi dymbëdhjetë dëshmitarë, të cilët ishin të ndaluar në xhaminë e dëmtuar të Qirezit më 30 prill. Dëshmitarët janë nga fshatrat Baks, Qirez, Dashevc, Glladno Sello, Gllobar, Poljancë, Shtutica, Tërstenik, dhe Vërbofc, të cilët shtrihen

Më shumë se 170 burra të etnisë shqiptare u futën në këtë xhami në Qirez më 30 prill 1999, atje ata u pyetën dhe u keqtrajtuan. Ditën tjetër dy grupe u çuan pranë minierës së Shavarinës ku rreth 121 burra u ekzekutuan.

© BENJAMIN WARD/HUMAN RIGHTS WATCH

në një rreth me rreze pesë kilometra e me qendër në Qirez. Shumë prej tyre deklaruan që një shqiptar i quajtur S.K., ish urdhëruar të numëronte të burgosurit, dhe ai kish numëruar 176 burra brenda xhamisë. S.K. më pas u ekzekutua. Disa dëshmitarë i thanë Human Rights Watch që numërimi nuk përfshinte një grup më të vogël burrash, të cilët u mbajtën në katin e sipërm të xhamisë. Cilado që të jetë shifra e saktë, qëllimi i numërimit u bë i qartë të nesërmen në mëngjes, më 1 maj. Pasi kaluan gjithë natën në xhami, burrat u nxorrën jashtë në dy grupe, i pari rreth orës 8.00, dhe i dyti rreth mesditës. Disa u rrahën. Në të dy rastet, të burgosurit u ndanë më tej në grupe më të vogla dhe u urdhëruan të hipnin në kamionë. Përmasat e grupit dhe numri i kamionëve ishin saktësisht të llogaritur nga numërimi i bërë një natë më parë. Për secilin grup, ishin tre kamionë, dhe të burgosurit u ndanë në grupe të përbërë nga njëzet e tridhjetë vetë.

Duke u bazuar në të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, të cilët ishin të burgosur në xhaminë e Qirezit, rezulton që ata i ishin trembur ekzekutimit në atë moment. F.R., banori i Qirezit, i cili ish ndaluar në Baks, pasi kish lënë fshatin, ish pjesë e grupit të parë, që u nxorr jashtë xhamisë. Ai ish rrahur keqas, para se ta hipnin në grupin e parë të kamionëve:

> Ne mbërritëm në xhaminë e Qirezit. Na vunë në rresht për dy. Thirrën një djalë shqiptar, dhe ky filloi të na numëronte. Në atë moment, ata hipën një person mbi një tank, dhe e çuan nja njëqind metra larg nesh. Morën një rrip, dhe me të i lidhën kokën. E urdhëruan të ngrinte duart lart. Ai eci rreth dhjetë metra, dhe në këtë moment, e qëlluan dy herë. Na urdhëruan të futeshim në xhami. Ishim rreth 175 vetë. Shumë prej nesh ishin nga Qirezi, Baksi, Shtutica, e Vërbofci….[E kaluam natën atje]…. Të nesërmen në mëngjes, në orën 8.00…. na thanë të viheshim në rresht për dy e të rrinim me fytyrë nga muri …. Një orë më vonë, erdhën paraushtarakët….Ata na thanë se, kushdo që flet sërbisht, të dalë mënjanë. Dolën rreth njëzet vetë, të cilët i nxorrën jashtë [xhamisë]. I rrahën. Ne dëgjonim rënkimet prej dhimbjeve dhe të bërtiturat e paraushtarakëve. Ishte si të dëgjoje kafshë të egra. Na urdhëruan të dilnim jashtë derës dy e nga dy. Kur dola unë, një ushtar serb (apo ku e di unë çfarë ish) i tha tjetrit që unë isha një turk. Ai më gërvishti me një thikë në kokë. Një tjetër tha “ma lër mua atë.” Më çuan në qoshen e xhamisë. [Një tjetër] kish një thikë të madhe dhe zuri të të më shqyente

rrobat … Më shqeu xhaketën. Pastaj më vendosi thikën në stomak. Por një ushtar tjetër tha "mos e vrit atë", kështu që ai hoqi dorë nga veprimi që desh të bënte. Ndërsa po qëndroja atje, dikush më goditi më një copë xhami në kokë. Më thanë "ti je personi i dytë që do të vritesh." Unë po rrija në këtë mënyrë (tregon pozicionin) me duart prapa kokës. [Njëri prej tyre] më theu një nga gishtat … Im atë më pa të mbuluar nga gjaku …. [Pastaj] unë dhe një djalë tjetër u urdhëruam të hipnim në një kamion të verdhë. Fillimisht, ishin tre kamionë që u nisën për në Gllogofc … Ne ishim në kamionin e fundit.[71]

Nëntëmbëdhjetë vjeçari A.A., banor i Shtuticës, bënte pjesë gjithashtu në grupin e parë që u nxorr jashtë xhamisë më 1 maj, herët në mëngjes. Ai dëshmoi për ekzekutimin me armë të një shqiptari dhe për djegjen për së gjalli të një tjetri:

Na çuan në oborrin e xhamisë në Qirez. Një oficer filloi të godiste. Më pas, ai zuri një burrë nga Vërbofci dhe e ekzekutoi mú përballë meje. Kur hymë ne, gjetëm shumë njerëz në xhamí. Ata i thanë S.K.-së, një banori të Glladno Sellos, të numuronte sa vetë ishin. Më kujtohet që ishin 176 shqiptarë në xhamí. Natën e kaluam atje. Të nesërmen në mëngjes, në orën 7.00 apo 8.00, ata na nxorrën përsëri jashtë xhamisë. Na ndanë në grupe – një grup e vendosën tek varreza e xhamisë dhe tjetrin në pjesën e prapme të xhamisë. Ishin rreth njëzet ushtarë. Na thanë "Do t'j'u çojmë tek varret e reja të Muhametit." Më kujtohet që prapa nesh ishte një person i shtrirë për tokë, të cilin e dogjën të gjallë… Na thanë të qëndronim në gjunjë me duart prapa kokës dhe me vështrimin poshtë. Na kërkuan sërish pará…. Po përpiqesha të nxirrja paratë nga xhepi, por nuk mundesha ta bëja këtë vetëm me një dorë. Erdhi një ushtar me një thikë në dorë dhe më shqeu xhepin. Kisha veshur dy palë pantallona. Ndërsa po përpiqesha të zhvishja një palë, një ushtar më nxorri nga rreshti, dhe më pyeti pse kisha veshur dy palë pantallona. U thashë, "ngaqë ishte ftohtë e ngaqë kisha fjetur në pyll." Ata më thanë "ti je i UÇK-së."… Kërkova t'u shpjegoja se nuk isha ushtar i UÇK-së. Më thanë të kthehesha në rresht me të tjerët. Na hipën në një kamion. Ndërsa po i afroheshim kamionit, një ushtar më goditi në kokë me një shishe, ngaqë nuk munda të hipja në kamion ….sepse isha i plagosur. Unë nuk e di se si, por ia dola mbanë të hipja në kamion. Ishim njëzet shqiptarë aty.[72]

Një dëshmitar tjetër i grupit të parë, njëzet e katër vjeçari A.D. nga Tërsteniku, përshkroi gjithashtu djegjen e të burgosurve me gazolinë.[73]

Nuk është e qartë nëse qëllimi i operacioneve në Qirez ishte të identifikoheshin pjesëtarë të UÇK-së apo thjesht simpatizantë të saj midis të burgosurve. Nga pyetjet e kërcënimet që u bëheshin të burgosurve, mund të merret vesh që kërkohej të bëhej identifikimi i atyre që ishin rreshtuar me kryengritjen. Historia e Z.K.-së, një dëshmitar nga Glladno Sello që u kap në "luginën e pyllit", tregon që, cilatdo qofshin motiviacionet, argumenti i anëtarësisë në UÇK-së ishte i pranishëm gjatë paraburgimit në xhaminë e Qirezit (dhe më vonë). Z.K.-ja tha:

> Një major erdhi e kërkoi dikë nga ne që fliste serbisht. Një prej kushurinjve tanë [S.K.], mori rolin e përkthyesit (më vonë, ai u vra).... Ishte e premte. Na thanë të hynim në xhamí. Ai tha "të hënën, me përjashtim të pjesëtarëve të UÇK-së, ju të tjerët do të liroheni."...Natën e kaluam atje. Të nesërmen erdhën paraushtarakët. Ata na bërtitën e na kërcënuan me thika në duar. Erdhën brenda e filluan të na rrahin, por kur panë që ishim shumë, na nxorrën jashtë, na vunë në rresht pëballë murit, dhe na rrahën deri sa ramë për tokë. Pasi na rrahën për dhjetë apo tridhjetë minuta, njëri prej tyre (i cili kish komandën) na urdhëroi të zhvisheshim. Ata më goditën me një armë automatike. Pas kësaj (ai që kish komandën) u tha ta ndalnin dhunën. Aty ish një shqiptar i plagosur. Dy paraushtarakë e morën dhe i thanë "ju jeni i lirë, por më përpara duhet të na tregoni cili ndër këta të tjerët është anëtar i UÇK-së."...Ai shqiptari ishte shumë i frikësuar. Ai as që u bë merak se kush ish e kush nuk ish pjesëtar i UÇK-së, por u vuri gishtin disave prej nesh .... Midis të cilëve, edhe mua. U thashë që "unë nuk jam pjesëtar i UÇK-së." Ata thanë "të lutem, mos na gënje sepse, nëse na gënjen edhe njëherë, do t'ju vrasim." Sollën disa kamionë, dhe i nisën ca për Shavarinë, ca për në burgun e Lipjanit. Neve na thanë të ktheheshim brenda në xhami, e pas tri a katër orësh, ata erdhën e na morën ...[74]

Siç del nga dëshmia e tij, Z.K.-ja bënte pjesë në grupin e dytë të burgosurve që u mbajtën në xhami deri në orët e para të pasdites. Pavarësisht nga kjo diferencë, fati i mëtejshëm i të dy grupeve ishte po ai. Ata u ngarkuan në tre kamionë me shtretër të sheshtë (disa dëshmitarë nga secili grup thanë që kamionët ishin në ngjyrë të verdhë, por nuk

është shumë e qartë nëse u përdorën të njëjtët kamionë). Burrat u urdhëruan të shtriheshin në dyshemenë e kamionëve dhe pas çdo kamioni kish paraushtarakë të armatosur mbi makinat e tyre. Disa dëshmitarë thanë që paraushtarakët i shtrënguan ata të këndonin këngë serbe dhe i rrahën ata gjatë rrugës. Kamionët morën drejt qytetit të Gllogofcit, dhe të paktën, dy kamionë nga secili grup u ndalën në minierën e Shavarinës pranë fshatit Cikatovë e Vjetër. Miniera e mbidheshme është pjesë e kompleksit të ferronikelit. Më 1 maj, më shumë se njëqind të burgosur u zbritën nga kamionët në Shavarinë, u vunë në resht, dhe u egzektuan kohë pas kohe gjatë gjithë ditës.

Miniera e Shavarinës

Ndonëse u nxorrën jashtë xhamisë herët në mëngjes, grupit të parë ju desh të priste disa orë, derisa hipën nëpër kamionë. Një i mbetur gjallë i grupit të dytë tha se, grupi i parë i të burgosurve u mor nëpër kamiona rreth orës 11.00 paradite, gjë që konfirmohet nga një dëshmitar i grupit të parë, i cili tha se kamioni i tij kish mbërritur në Shavarinë rreth mesditës. Ndarja e të burgosurve në grupe më të vegjël dhe caktimi i një kamioni për secilin nëngrup duket se nuk është bërë sipas ndonjë kriteri të caktuar. Ndërsa ndarja në nëngrupe u bë rastësore, pasojat e rënda mbi ata që u përzgjodhën të hipnin në kamionin e dytë nuk ishin rastësore. I pari ndër tre kamionët u lejua të shkonte në drejtim të Gllogofcit e më tej për në Lipjan. Kamioni i dytë e i tretë u ndalën në Shavarinë. Burrat e kamionit të dytë u urdhëruan të zbrisnin nga kamioni dhe u vunë në rresht përgjatë kanalit të kullimit buzë rrugës dhe u pushkatuan. Të burgosurit e kamionit të tretë ishin dëshmitarë të masakrës.

Siç u bë e njohur më sipër, F.R., që bënte pjesë në grupin e parë të të burgosurve të nxjerrë nga xhamia, ishte në kamionin e fundit. Ai dëshmoi mbi disa prej ekzekutimeve në Shavarinë:

> Në shkuam në një vend të quajtur Shavarinë. Kamioni i parë nuk ndaloi, ndërsa i dyti po. Kamioni i tretë ndaloi gjithashtu, dhe ata na thanë të çoheshim në këmbë [dhe] na thanë të shihnim tek kamioni tjetër. Ata thanë "Kjo gjë do të ndodhë edhe me ju." Ata vranë pesë a gjashtë vetë disa metra larg nesh. Eshtë fare pranë ferronikelit – është një vend i

quajtur Shavarinë. Pastaj, me sytë e mij, unë pashë tim ungj të zbriste nga kamioni, së bashku me një shtatëdhjetë vjeçar tjetër. Ata ishin pranë njëri-tjetrit përballë ushtarëve. Ushtarët ishin nja dhjetë a dymbëdhjetë metra larg, thjesht duke parë në drejtimin e tyre. Kishte disa grupe njerëzish [numri i personave ishte i ndryshëm në grupe të ndryshme]. Fillimisht, ata pushkatuan grupet me pesë vetë – i pushkatuan një e nga një. Kur mbaruan me ta, filluan me grupet me pesëmbëdhjetë a gjashtëmbëdhjetë persona. Pas kësaj, një ushtar tjetër erdhi e shtiu mbi njerëzit, të cilët ishin rrëzuar për tokë fare pranë nesh. Nuk munda të shihja më. U dëgjua një shpërthim i vogël, dhe serbët zunë të talleshin me ne. Ne tashmë po prisnim radhën për t'u pushkatuar. Ishim me fat që nuk na zbritën nga kamioni …[pastaj] ata na çuan tek posta e policisë në Gllogofc…[75]

Fillimisht, ata pushkatuan grupet me pesë vetë – i pushkatuan një e nga një. Kur mbaruan me ta, filluan me grupet me pesëmbëdhjetë a gjashtëmbëdhjetë persona.

A.S., banor i Baksit, i cili u kap në Fushën e Mollës, ishte në të njëjtin kamion me F.R.-në. Dëshmia e tij nënvizon terrorin, të cilit ju nënshtruan të burgosurit e kamionit të tretë, ndërsa ata shihnin me sytë e tyre ekzekutimin e bashkëfshatarëve:

> Ata sollën tre kamionë, na futën brenda tyre e na bënë kokë më kokë. U nisën drejt Gllogofcit. Kur ne arritëm në Cikatovë, në Shavarinë, ata ndalën atje dy kamionë. Njerëzit e një kamioni u vranë të gjithë. I ndanë ata në tre grupe. Një pjesë [e forcave serbe] kishin gjerdanë të tërë me fishekë. Shtinë mbi ta, dhe ata ranë për tokë atje në atë gropë. Pastaj erdhi nga Gllogofci një makinë tjetër. Menduam se do të na vrisnin, por ata na çuan në Gllogofc.[76]

Grupi i dytë ishte jashtë xhamisë rreth mesditës, ndonëse deklarata të dëshmitarëve thonë se për disa orë rresht, atyre nuk iu tha të hipnin në kamiona. Mënyra e transportimit dhe e ekzekutimit të tyre ishte pothuaj identike me atë të grupit të parë. Të burgosurit u urdhëruan të ndaheshin në grupe më të vogla, para se të hipnin në tre kamionat. Kamioni i parë shkoi në Gllogofc, ndonëse fillimisht ai ndali në Shavarinë për 30-60 minuta, kohë e mjaftueshme kjo, që shumë prej tyre të dëgjonin krisma

armësh, pa parë assgjë megjithatë. Kamioni i dytë e i tretë ndalën gjithashtu në Shavarinë. Këtë herë njerëzit u zbritën nga kamionat, u vunë në rresht dhe u vranë. Disa mundën të shpëtonin. Dëshmia e tyre është e vetmja mënyrë për të ndriçuar ngjarjen e asaj mesdite.

Banori i Poljancës Z.Z., dyzet e katër vjeçar, i cili dëshmoi rrahjen për vdekje të Ismet Prokshit pranë Vërbofcit, ishte njëri prej atyre që mbetën gjallë. Ai përshkroi se si mundi t'i shpëtonte vdekjes:

> Na nxorrën jashtë xhamisë. Ishte ora 16.00, kur na hipën nëpër kamionë. Ishte 1 maj (Kishim kaluar një natë në xhami). Kamioni i parë përballë nesh mori rrugën për në Gllogofc. Unë isha në kamionin e dytë me katër paraushtarakë të armatosur me automatikë të drejtuar mbi ne. Na kërkuan të këndonim "Serbia, Serbia." Po shkonim në Shavarinë. Ata ndalën në kryqëzimin e dy rrugëve që të çonin në Dobrasevac e në Ferronikel. Unë nuk di gjë për kamionin tjetër, por në kamionin tim na ndanë në nëngrupe dhjetë vetëshe dhe na zbritën dhjetë e nga dhjetë ... Unë isha në nëngrupin e tretë, i cili përbëhej nga dymbëdhjetë vetë, kështu që kuptova se ishim gjithsej tridhjetë e dy vetë. Pranë meje ishte një djalë i quajtur ["Q.Q."]. I preka dorën atij, dhe ai e kuptoi që po i thoja t'ia fuste vrapit. Ai ishte i pari që tentoi të ikte me vrap që atje. U nisa pas tij. Ishin tre paraushtarakë të armatosur dhe shtatë të tjerë me mitralozë. Ishin njëzet metra larg nesh. Ata filluan të shtinin mbi ne, sapo ne nisëm të vraponim. U plagosa nga një plumb në shpatull. Pastaj thashë: "Pse nuk më vrisni dot mua? – Unë jam një robot – ju nuk mund të më vrisni." Ata na ndoqën për gati dy kilometra, duke shtënë mbi ne. Pas nja tre kilometrash, të shtënat nuk u dëgjuan më. Pashë një përrua [shkova drejt tij]. Isha i plagosur.... Tjetri, që ish me mua, po përpiqej të kujdesej për plagën. Ai më tha "ne duhet të ikim prej këtu e duhet të gjejmë një mjek."... qëndruam atje deri në të errur.... Në mbrëmje, unë shkova në Dashevc. Gjeta një mjek, i cili më dha ndihmën e parë.[77]

Q.Q. (inicialet janë tjetër për tjetër), një banor i Dashevcit, i cili ishte zënë rob në Shtuticë (Shih më sipër), qëndroi pranë Z.Z. (inicialet gjithashtu të ndryshuara), ndërsa po prisnin të ekzekutoheshin. Ndonëse më pak e hollësishme, dëshmia e tij shkon në të njëjtin drejtim me ato të të tjerëve, që mbetën gjallë:

> Na hipën nëpër kamionë. Nuk jam i sigurtë sa ishte ora – ndoshta 2.00 ose 3.00 pasdite…. Morëm rrugën në drejtim të Gllog-ut, dhe ata na rrahën gjatë gjithë rrugës. Na kërkuan të këndonim këngën "Serbia është e madhe." Na rrahën brenda në kamion, derisa arritëm në Shavarinë. Unë isha në kamionin e dytë. Kamioni i parë shkoi në Gllogofc. Të gjithë ata që ishin në kamionin e dytë e të tretë, ishin ekzekutuar. Mbetëm gjallë vetëm unë dhe një burrë nga Poljanca. Na zbritën nga kamioni grupe-grupe. Unë bëja pjesë në grupin e dytë, por munda të ikja së bashku me ["Z.Z."]. Nuk e di sa vetë u vranë, pasi nuk pashë asgjë. Besoj se është edhe një burrë tjetër nga Glladno Sello, që mbeti gjallë. Ne ishim me fat [që shpëtuam], sepse ata shtinë mbi ne për një kohë të gjatë…[78]

Human Rights Watch nuk ishte në gjendje të gjente ndonjë të mbetur gjallë nga kamioni i tretë. Dëshmia e Q.Q.-së dhe e të tjerëve thonë se kamioni i tretë nuk arriti asnjëherë në Gllogofc. Asnjë prej atyre që ishin në këtë kamion nuk është bërë i gjallë deri më sot.

Besohet se numri total i të vdekurve në masakrën e Shavarinës është 121. Ky është numri i kufomave të gjetura në të dy vendet. Dyzet e nëntë kufoma u gjendën në kanalin e kullimit në Shavarinë, ndërsa shtatëdhjetë e dy kufoma të tjera mes atyre që u ekzekutuan në Shavarinë u zhvarrosën pranë shkollës në Cikatovën e Vjetër. Deri në tetor 1999, ndër dyzet e nëntë kufoma të Shavarinës ishin identifikuar tridhjetë e shtatë, dhe ndër shtatëdhjetë e dy kufomat e shkollës së Cikatovës ishin identifikuar pesëdhjetë e shtatë. [79] Numri 121 eventualisht përfshin njëzet e katër personat - apo një pjesë syresh – të raportuar të ekzekutuar më 16 prill në Cikatovën e Vjetër, ndërsa besohet se kanë qënë nëntëdhjetë burra gjithsej në të tre kamionët për të cilët u fol më sipër. Megjithatë, siç është bërë e njohur, shifra 176 e atyre që u morën nga xhamia më 1 maj është diçka më e vogël se sa shifra reale, pasi një grup më i vogël të burgosurish të katit të sipërm të xhamisë – praninë e të cilëve e dëshmojnë disa vetë – nuk është llogaritur. Cilido që të jetë numri total, ekzekutimet në Shavarinë na ballafaqojnë me dëshminë më të pakundërshtueshme

Dyzet e nëntë kufoma u gjendën në kanalin e kullimit në Shavarinë, ndërsa shtatëdhjetë e dy kufoma të tjera mes atyre që u ekzekutuan në Shavarinë u zhvarrosën pranë shkollës në Cikatovën e Vjetër.

të natyrës sistematike të masakrave të kryera prej forcave të sigurimit serb gjatë pranverës së vitit 1999.

Paraburgimi dhe marrja në pyetje në Gllogovac

Ata, të cilët hipën në kamionët "e sigurtë" në Qirez, u çuan në Gllogofc dhe u mbajtën në paraburgim, u morën në pyetje, dhe u rrahën nga policia për pesë ditë të plota, dhe më pas u transferuan në vende të tjera paraburgimi apo në fshatrat pranë Gllogofcit, ku ata u vunë forcërisht të punonin. Të paktën një person u vra, ndërsa ishte i paraburgosur në Gllogofc. A.S. nga Baksi e pa burrin që u zgjodh për ta çuar drejt vdekjes. A.S.-ja dëshmoi: "Ishte një burrë nga Glladno Sello i ulur pranë meje. Një ushtar na u afrua e tha, "unë dua të vras njërin prej tyre", dhe kështu morën atë [burrin ngjitur me mua], e spostuan nja dhjetë a pesëmbëdhjetë metra më tutje dhe ne dëgjuam katër të shtëna."[80] R.B. nga Shtutica ishte gjithashtu i pranishëm. Ai shpjegoi atë që kish parë: "Një polic me një shishe alkoli në dorë na u afrua dhe tha, 'unë do të vras ndonjë shqiptar.' Policët që ishin atje, i thanë se mund të zgjidhte shqiptarin që dëshironte. Ai mori një burrë nga Glladno Sella të quajtur Topila. Ai e çoi tek një shtëpi e djegur, dhe ne dëgjuam katër të shtëna. Ai nuk u kthye më."[81]

Ata që ishin të paraburgosur në Gllogofc nuk kishin ardhur të gjithë nga xhamia. S.G., një burrë gjashtëdhjetë e dy vjeçar nga Vërbofci, i cili u kap rob jashtë shtëpisë së tij, ishte sjellë drejtëpërdrejtë në Gllogofc së bashku me tetëmbëdhjetë të burgosur të tjerë, banorë të zonës aty rrotull. Ata nuk u nganë me dorë deri në momentin që mbërritën në postën e policisë. Ata u rrahën egërsisht, ndërsa mbaheshin nën ruajtje policore dhe u mbajtën në paraburgim për pesë ditë të plota, derisa u transferuan në fshatra, ku ata u shtrënguan të punonin për forcat e sigurimit. S.G. shpjegoi atë që ndodhi me të mbërritur në Gllogofc:

> Na morën në Tërstenik e na çuan në Gllogofc. Ishin njëqind policë në oborrin e stacionit të policisë në Gllogofc. Në atë moment, numri i të burgosurve ishte vetëm nëntëmbëdhjetë. Shumë prej policëve mbanin në duar shkopinj e të tjerë kishin shufra hekuri. Filluan të na rrahin, [aq sa] shumë prej nesh humbën ndjenjat e u mbuluan nga gjaku. Një orë më vonë na çuan në një dhomë tjetër, ku ishin disa të burgosur të

> tjerë. Pasi na lanë edhe një orë tjetër aty, na thanë të dilnim jashtë. Na thanë të ktheheshim me fytyrë nga muri. U vumë në rresht për tre. Na rrahën pa pushim nga ora 12.00 deri në orën 17.00. Askush nuk e dinte se ç'do të bëhej me ne. Qëndruam atje pesë ditë pa ngrënë – na jepnin ujë vetëm njëherë në ditë. Në krye të pesë ditëve, na nxorrën jashtë stacionit të policisë. Në këtë moment ishim bërë dyqind vetë. Na thirrën një nga një e na morën në pyetje, vazhduan të na rrihnin, ndonëse unë vetë atë ditë shpëtova paq pa u rrahur. Na morën kartat e identitetit dhe na i kthyen prapë. Menduam se do të na lironin, por ata lanë të lirë vetëm një djalë trembëdhjetë vjeçar dhe një burrë shtatëdhjetë e pesë vjeçar…. Për fat të keq, [forcat serbe] i vranë që të dy në Gllobar…. Pastaj sollën dy kamionë e na thanë të hipnim - e na rrahën gjithë kohën. Na ngucën në kamionë, mbyllën dyert e na çuan në Llapushnik….[82]

Disa të burgosur u morën nga Gllogofci pothuaj menjëherë. Y.Y. (inicialet janë tjetër për tjetër), një banor pesëdhjetë e tre vjeçar nga Gllobari, i cili u kap në Vërbofc (shih më lart), u paraburgos në xhaminë e Qirezit, dhe pak më pas, me një kamion "të sigurt" u çua, duke kaluar në Shavarinë, në Gllogofc. Y.Y. u rrah dhe u mbajt për gjithë natën në Gllogofc. Ai konfirmoi lirimin e një të moshuari e të një djali, të cilët u vranë më pas në Gllobar. Përpara se të transferohej në burgun e Lipjanit, ai u çua në Prishtinë. Ai përshkroi çfarë ndodhi kur arriti në Gllogofc:

> Në kamionin ku isha unë, gjendeshin rreth njëzet vetë. Nuk vranë asnjërin prej atyre që ishin në kamion. Na çuan në stacionin e policisë në Glogofc, i cili është afër zyrave të bashkisë. Atje kish njerëz [të ndaluar] të tjerë. Së bashku, bëheshim pesëdhjetë vetë. Ata [policët] na rrahën me shufra hekuri, me shkopinj e me bisht lopatash. Na rrahën keqaz. Pasi ramë pa ndjenja në tokë, ata, për të na përmendur, na hodhën në fytyrë ujë, madje edhe benzinë [gazolinë]. Na thanë të çoheshim në këmbë e na rrahën përsëri. Në mbrëmje na sistemuan në kinemanë aty pranë, ku qëndruam deri të nesërmen. Ishim bërë tashmë gjashtëdhjetë vetë. Një ditë më vonë, ata [policët] na nxorrën jashtë, dhe disa civilë erdhën, na morën shënim emrat, datat e lindjes e na morën në pyetje një e nga një. Morën trembëdhjetë vetë nga ne, na hipën në makina policie, dhe na çuan në burgun e Prishtinës. Atje

> kaluam një natë të tërë. Ishte data 2 maj. Më 3 maj, na çuan në Lipjan me një kamion të madh. Ndër ne nuk kish vetëm banorë të Gllogofcit, por edhe të tjerë nga Podujeva e Prishtina. Në burgun e Lipjanit ne u rrahëm shumë rëndë. Unë kalova atje njëzet e gjashtë ditë....Ndonjëherë na jepnin një bukë, që duhej ta ndanim në pesë pjesë, por kjo nuk ndodhte çdo ditë. Ishim njëzet e katër vetë në një dhomë. Nuk na rrahën çdo ditë, por sidoqoftë, na rrahën. Nga të rrahurat, unë mora një plagë në gjoks...[83]

Më 26 maj, Y.Y. dhe gjashtëdhjetë të burgosur të tjerë u çuan me autobus në kufirin maqedonas, dhe u dëbuan nga Kosova. A.D., një njëzet e katër vjeçar nga Tërsteniku, dha pothuaj të njëjtën dëshmi, veçse shtoi se ish pyetur në qendrën e policisë në Prishtinë dhe në burgun e Lipjanit lidhur me UÇK-në.[84] Ai ishte pjesë e të njëjtit grup prej gjashtëdhjetë e një vetësh, të cilët u dëbuan më 26 maj. Marrja në pyetje dhe trajtimi i ndryshëm i këtij grupi na bën të mendojmë se autoritetet serbe ose dyshonin për lidhje të tyre me UÇK-në, ose i konsideronin më të rrezikshëm se sa ata të burgosur, të cilët punonin në fshatrat rrotull Gllogofcit.

Paraburgimi dhe puna e detyruar

Një pjesë e madhe e atyre të burgosurve në xhaminë e Qirezit, që mbetën gjallë, u transferuan më 5 e 6 maj nga Gllogofci në tre fshatra fqinjë. Shtatë prej të burgosurve të Qirezit të intervistuar nga Human Rights Watch deklaruan që ata ishin çuar me kamionë në fshatrat e Krajkovës, Vukofcit, dhe Poturkut dhe u lanë në dorën e forcave të sigurimit serb. Burrat u detyruan të punonin për gati gjashtë javë, deri në momentin e tërheqjes së forcave të sigurimit serb e jugosllav nga Kosova, në mesin e qershorit. Punët e kryera ishin hapja e transheve dhe pastrimi i bunkerëve. Dëshmitarët bënë të njohur incidente të rrahjes e të torturimit të të burgosurve nga duart e forcave qeveritare, ndonëse disa vunë në dukje se ishin ushqyer dhe, krahasuar me rastin kur ishin në duart e paraushtarakëve e policëve serbë në Qirez e Gllogofc, kishin përfituar një trajtim më i mirë.

R.B., një banor i Shtuticës, i cili mori shumë plagë plumbash gjatë ofensivës së 30 prillit, ishte midis atyre që u paraburgosën nga policia në

Gllogofc në javën e parë të majit. Më 6 maj, ai, së bashku me shtatëdhjetë e pesë vetë të tjerë, u çua në Krajkovë, dhe më vonë në Vukofc, ku ai u shtrëngua të punonte deri më 15 qershor. Ai i përshkroi kështu të zezat që kishin hequr:

Burrat u detyruan të punonin për gati gjashtë javë, deri në momentin e tërheqjes së forcave të sigurimit serb e jugosllav

Policia ushtarake erdhi pasdite e shoqëruar nga dy kamionë. Na hipën në kamionë – duke na shtrirë bythë më bythë. Na rrahën e na kërkuan të këndonim këngën "Kosova është Serbi." Nuk kishim asnjë ide ku po na çonin, derisa kamioni ndali në fshatin Krajkovë. Na sollën pak bukë dhe ujë, dhe na ndanë në tre grupe – dy grupe me nga njëzet e pesë vetë dhe i treti me njëzet e gjashtë. I njëzet e gjashti isha unë. Na hipën në karrocerinë e kamionit dhe na çuan në fshatin Vukofc. [Atje] na ndanë në pesë grupe – katër grupe me nga pesë vetë dhe i pesti me gjashtë. Atë ditë na thanë të gërmonim pranë bunkerëve. Një djalë i ri që ish me mua po më thosh "ne jemi duke hapur varret tanë', por unë i thashë të mos kish frikë, pasi nuk po bënim gjë tjetër, veçse po gërmonim një bunker. Në mbrëmje na vunë të gjithëve në të njëjtën dhomë….Në atë kohë na shanin e na rrihnin, sa herë që humbisnin ndonjë prej të tyreve në betejat me UÇK-në apo nga bombardimet e NATO-s. Na jepnin ushqim – duhej të punonim – por as që bëheshin merak, nëse ishim të plagosur apo jo. Për trajtim mjekësor as që bëhej fjalë. Kisha gishtat gjithë plagë, por nuk mund t'u thoja atyre që isha plagosur nga ushtarët. U thashë që isha plagosur nga policët.

Disa dëshmitarë i thanë Human Rights Watch, se ata ishin trajtuar më mirë nga ushtarët se sa nga policët e paraushtarakët.

Z.M.-ja, një shtatëdhjetë vjeçar, e pësoi ngaqë hëngri një copë djath [pa marrë leje]. Një ushtar e bëri të qëndronte më këmbë mbi dy kërcunj për dy ditë me radhë. Nuk i dhanë as ushqim. Pas kësaj, e zhveshën me zor, e futën në një fuçi me ujë, dhe e lanë atje për gjithë ditën. Një ditë tjetër, ushtari e lidhi këmbë e duar dhe e la ashtu - i dha vetëm pak bukë. Në mbrëmje erdhën disa ushtarë, njëri prej të cilëve kish tri rripa të kuq në xhaketën e tij…. Ai e zgjidhi Z.M.-në dhe zuri ta rrihte. Pas kësaj e lanë të flinte për tri ditë me radhë në dysheme. Sa herë që dyshonin se kish ndonjë rrezik – për mina fjala vjen – na detyronin të shkonim ne të parët…. Qëndrova në paraburgim për dyzet e shtatë ditë.[85]

Banori i Glladno Sellos Z.K., i cili bënte pjesë në grupin e njerëzve të paraburgosur në Vukofc, konfirmoi torturimin e Z.M.-së dhe faktin që grupi u shtrëngua të çante rrugën i pari, sa herë që dyshohej për rrezik minash. Z.K.-ja tha gjithashtu që në ditët e fundit të paraburgimit të tyre, ushtarët serbë kishin rrahur egërsisht S.G.-në, një ish-drejtor të PTT-së, për tri ditë me radhë. [86]

Ka dëshmi që thonë se jo të gjithë ushtarët ishin të prirur të silleshin çnjerëzisht me të burgosurit. Disa dëshmitarë i thanë Human Rights Watch, se ata ishin trajtuar më mirë nga ushtarët se sa nga policët e paraushtarakët, duke vënë në dukje se u jepej bukë dhe ushtrohej më pak dhunë. Historia e A.A.-së, një nëntëmbëdhjetë vjeçari nga Shtutica, ilustron diferencat në këtë drejtim. Pasi i shpëtoi një masakre kolektive në pyjet afër Vërbofcit, ku mori një plagë në krah, e pasi u rrah kafshërisht nga paraushtarakët në xhaminë e Qirezit e nga policët në Gllogofc, A.A.-ja u transferua në një pikë ushtarake paraburgimi, dhe atje përfitoi trajtim mjekësor. Ai shpjegoi çfarë i kish ndodhur të mërkurën më 5 maj, pasi u çua në Krajkovë: "Kur arritëm në Krajkovë ata më goditën në po atë krah [ku isha i plagosur]. Më çuan në disa shtëpi atje dhe më thanë të pastroja garazhet. Ishte një vend, ku sipas shumë gjasave, do të qëndronim gjatë. Të nesërmen u thashë se isha i plagosur. Nuk na trajtuan keq atje – nuk ishte e njëjta me atë që ndodhte në stacionet e policisë. Në mbrëmje, njëri prej tyre, ai që komandonte, solli një mjek për mua. I kisha plagët të pakuruara prej shtatë ditësh. Të nesërmen (të premten) më çuan në spitalin e Prishtinës .... Qëndrova atje për gjashtë javë."[87]

Qyteti i Gllogovcit

Qyteti më i madh në rajonin e Drenicës, Gllogofci, shtrihet në jugperëndim të Prishtinës, afro njëzet e pesë kilometra larg kryeqytetit. Para nisjes së luftimeve në Kosovë në mars 1998, Gllogofci kish një popullsi prej 12,000 banorësh, pothuaj që të gjithë shqiptarë etnikë. Megjithëse Drenica, si një bastion i UÇK-së, ishte një pikë fokale e konfliktit gjatë gjithë vitit 1998 dhe gjatë muajve të parë të vitit 1999, vetë Gllogofci, ashtu si shumë qyteza e qytete të Kosovës, nuk u prek nga luftimet apo dëmtimet. Policët serbë mbajtën vazhdimisht qytetin ndërsa stacioni i policisë u përdor shpesh si një qendër paraburgimi të shqiptarëve të arrestuar në

zonat përreth, sidomos gjatë ofensivës kryesore qeveritare në shtator 1998.[88] Abuzimi, arrestimet dhe rrahjet nga ana e policisë ishin një gjë e zakonshme deri në momentin që filluan bombardimet e NATO-s, më 25 mars 1999.

Operacionet e policisë serbe e ushtrisë jugosllave në fshatrat rrotull Gllogofcit filluan menjëherë pasi u largua Misioni i Verifikimit të OSBE-së në Kosovë, më 19 mars 1999. Aty për aty, shumë shqiptarë etnikë të zonave rurale ikën apo u dëbuan prej fshatrave të tyre dhe u drejtuan në Gllogofc.[89] Nga fundi i prillit, dyndja e personave të shpërngulur e rriti popullsinë e qytetit deri në 30 mijë dhe banorët strehuan një numër të madh të personave të shpërngulur në shtëpitë e tyre.

Ndërsa niveli i dhunës kundër civilëve në Gllogofc gjatë fushatës ajrore të NATO-s ishte më i ulët se sa ai i dhunës së ushtruar në fshatrat e së njëjtës komunë, dëshmitë e njerëzve përshkruajnë dhunimin e shumëfishtë të të drejtave të njeriut e të ligjit humanitar në qytezë pas marsit të vitit 1999. Sipas raportimeve, të paktën pesë deri në nëntëmbëdhjetë civilë u ekzekutuan nga policët serbë e nga forcat paraushtarake në qytezë. Banorët e Gllogofcit ju nënshtruan në mënyrë të përsëritur dhunës, paraburgimit, rrahjeve, kontrollit shtëpi më shtëpi, vjedhjes, e zhvatjes. Disa shtëpi, dyqane e biznese private u plaçkitën, u pretuan, dhe u dogjën.[90] U duk se bombardimi i uzinës së ferronikelit më 29 prill do të nxiste hakmarrjen kundër popullsisë civile nga ana e forcave të sigurimit serb në Gllogofc, gjë që filloi me ofensivën e menjëhershme të 30 prillit në zonën e Vërbofcit, Baksit e Shtuticës. Duke filluar nga 1 maji, në harkun e pesë ditëve, u dëbua shumica e popullsisë nga qyteza dhe u dërguan në kufirin maqedonas.

Dëshmi të banorëve tregojnë një prani të madhe edhe të policëve serbë, edhe të paraushtarakëve. Dëshmitë e marra u referohen vazhdimisht serbëve të armatosur si burra me flokë të gjatë e me mjekër, si dhe me shami të lidhura në kokat apo krahët e tyre. Një person tha se disa paraushtarakë, për t'u sajuar një rreng civilëve, mbanin në mëngët e tyre edhe shenja dalluese të UÇK-së. Disa banorë të Gllogofcit thanë se kishin parë pjesëtarë të Tigrave të Arkanit – çeta e paraushtarakëve e udhëhequr nga Zheljko Raznjatoviç, i akuzuar së fundi si kriminel lufte (Arkan) – por pretendimet e tyre mbetën të pakonfirmuara.

I vetmi person i identifikueshëm nga dëshmitarët ishte një zëvendës shef policie i njohur me emrin Lutka, që do të thotë "kukull" në serbisht. Emri i vërtetë i Lutka-s është Nebojsha Trajkoviç. Ky ish një polic i njohur në qytezë,

dhe banorët thanë se, në ndryshim nga shumë paraushtarakë, ai nuk u soll me egërsi, ndonëse u implikua në shumë vjedhje dhe ish organizatori kryesor i çpopullimit të detyruar në fillim të majit, duke u thënë shqiptarëve që duhet "të hipnin në autobuza ose të shkonin në këmbë në Shqipëri."[92]

Human Rights Watch vizitoi Gllogofcin më 25 qershor 1999, nëntë ditë pasi forcat e NATO-s kishin hyrë në qytezë. Shumë xhama dritaresh ishin të thyera, kish makina të djegura, dhe merrej vesh se kish patur një plaçkitje të madhe. Në qytezë ishin rreth pesëdhjetë shtëpi të djegura, shumica e të cilave ishin shtëpi private.

Vrasja e civilëve

Disa civilë u vranë edhe në Gllogofc gjatë prillit, ndonëse vrasjet ishin më të pakta se sa ato të kryera në fshatra. Human Rights Watch intervistoi më tepër se pesëmbëdhjetë banorë të qytezës si dhe një numër të personave të shpërngulur nga fshatrat përreth, të cilët ishin strehuar në qytezë. Shumica e të intervistuarve ishin në dijeni të 4-12 vrasjeve të kryera në Gllogofc, ndonëse njëri syresh pretendoi se u vranë nëntëmbëdhjetë vetë. Human Rights Watch pati mundësinë të konfirmonte nëpërmjet dëshmitarëve okularë vetëm vrasjen e Haxhi Selimit, Sokol Saitit dhe të dy burrave nga fshati i Banjicës. Një numër vrasjesh, thanë dëshmitarët, u kryen nga paraushtarakët dhe policët gjatë kontrollit dhe vjedhjeve shtëpi më shtëpi.

Menjëherë pas largimit të OSBE-së nga Gllogofci më 19 mars, sipas B.K.-së, banorit pesëdhjetë e dy vjeçar nga Gllogofci (dëshmitari nuk kujtonte datën e saktë), policia serbe ekzekutoi gjashtëdhjetë vjeçarin Haxhi Selimi dhe dy të shpërngulur nga fshati i Banjicës.[93] Ai shpjegoi se Selimi, një person i shpërngulur nga fshati i Negrovcës, ishte një nga dyzet personat që ishin strehuar në shtëpinë e tij në atë kohë. Tre oficerë të armatosur të policisë me uniforma të gjelbërta e me simbolin e shqiponjës së bardhë në xhaketat e tyre, erdhën në shtëpi rreth orës 10.00 paradite. Një prej oficerëve, i cili kish mustaqe dhe një lëkurë të zeshkët, kërkoi 2,000DM (afërsisht U.S. $1042), tha ai, ndërsa burrat në shtëpi u detyruan të dalin jashtë. Sipas B.K.-së, Haxhi Selimi u qëllua shtatë herë me tytën e armës të ngjeshur në trupin e viktimës, nga oficeri mustaqelli. Dy prej goditjeve u dhanë pasi Selimi kish dhënë shpirt, tha ai. Dëshmitari dëgjoi

gjithashtu të shtëna të tjera dhe më vonë pa trupat e dy burrave nga Banjica, të cilët ishin ekzekutuar nga i njëjti oficer policie në oborrin e një shtëpie ngjitur.

Një numër vrasjesh, thanë dëshmitarët, u kryen nga paraushtarakët dhe policët gjatë kontrollit dhe vjedhjeve shtëpi më shtëpi.

Në pasditen e vonë të 28 marsit, paraushtarakët hynë në shtëpinë e Sokol Saitit në Gllogofc, duke i kërkuar pará e gjëra të tjera të çmuara. A.H., një pesëdhjetë e tre vjeçar i shpërngulur nga fshati Domanek, i cili po qëndronte pranë shtëpisë së Saitit, i tha Human Rights Watch, që paraushtarakët kishin informuar banorët lokalë, edhe atë sigurisht, se ata ishin "njerëzit e Arkanit."[94] Ishin me uniforma të zeza, me grim të zi në fytyrat e tyre dhe me shami të lidhura rreth kokës. Sipas të njëjtit njeri, paraushtarakët shtinë mbi Seitin. Ai i tha Human Rights Watch, "E goditën në këmbë rreth orës 18.00. Ata e lanë aty të paprekur dhe nuk lejuan njeri t'i afrohet për t'i dhënë ndihmën e parë, deri sa ai vdiq prej humbjes së gjakut. Paraushtarakët qëndruan në shtëpinë e tij derisa ai vdiq, në orën 1.00 të mëngjesit." Ndonëse nuk dëshmoi pushkatimin, fqinji i Saitit ndihmoi në varrimin e viktimës po atë ditë më vonë. Ky njeri pretendoi se kish dijeni edhe për dymbëdhjetë vrasje të tjera, ndonëse ai nuk kish parë me sytë e vet ekzekutimin apo kufomat e tyre.

Një dyzet e katër vjeçar nga Gllogofci, A.G., i tha Human Rights Watch se dy shqiptarë etnikë u vranë në apartamentin e tyre. Ai nuk pretendoi se kish parë me sy atë që ndodhi por, ndërsa paraushtarakët po vidhnin apartamentin e tij, ai dëgjoi të shtëna një kat më sipër. Ai tha:

> Ata [paraushtarakët] hynë në apartamentin tim rreth orës 16.00. Ishte e premte, 20 prill. Ishin dy vetë, të veshur me uniforma të gjelbëra. Ne të shtëpisë ishim tetëmbëdhjetë vetë. Ata hynë dhe shtinë në drejtim të tavanit. Ata thanë, "Nxirrni gjithçka keni, pará, marka gjermane, flori, ora!" Na morën edhe unazat e martesës.
>
> Ne banonim në katin e katërt. Në apartamentin tjetër, ata vranë Brahim Shalën. Në shtëpinë e tij shkuan dy paraushtarakë të tjerë, dhe në dëgjuam një të shtënë. Ata thanë se e vranë atë, sepse ai kish veshur një qylaf [një kapuç i bardhë tradicional shqiptar, që mbahet nga të moshuarit]. Në katin e pestë vranë një tjetër – Hysen Morina – sepse ai pa drejt në sy policin. Ne dëgjuam të shtënat. [95]

Tetë banorë të tjerë të qytezës të intervistuar nga Human Rights Watch, tri gra e pesë burra, thanë se ishin në dijeni të vrasjes së nëntëmbëdhjetë civilëve të Gllogofcit aty nga fundi i marsit apo fillimi i prillit, ndonëse ata nuk kishin parë me sy as ekzekutimet, as kufomat. Ndër të vdekurit, sipas tyre, ishin tridhjetë e katër vjeçari Hysen Morina, i vrarë nga paraushtarakët gjatë një plaçiktjeje; Qazim Kluna (nga Pokleku); Sokol Hajrizi e Rrahim Krasniqi. Sidoqoftë, pohimet e banorëve këmbëngulnin që vrasje të tjera ndodhën gjatë kësaj periudhe, kryesisht gjatë vjedhjeve, plaçkitjes e pretimit. Pesë dëshmitarë thanë se përgjegjës për masakrat ishin paraushtarakët.

Paraburgimi e poshtërimi

Gjatë gjithë periudhës nga largimi i OSBE-së deri në dëbimin e popullsisë në fillim të majit, paraushtarakët e policët bënë vizita të shpeshta në shtëpitë e banorëve të Gllogofcit dhe të personave të shpërngulur. Deri në javën e tretë të prillit, këto vizita ishin të lidhura me vjedhjen e plaçkitjen, ndonëse kërcënimet me dhunë e trembën popullsinë, duke e detyruar ose të rrinte brenda shtëpive, ose të iknin që aty.

Më 22 prill, natyra e këtyre vizitave filloi të ndryshonte. Në harkun e një jave, çdo mëngjes, policë të rregullt kryen inkursione kundër banesave private dhe kontrolle shtëpi më shtëpi, gjatë të cilave grupe të mëdha burrash ndaheshin nga familjet e tyre dhe çoheshin në stacionin e policisë. Pothuaj të gjithë burrat u rrahën pranë shtëpive të tyre apo gjatë rrugës për në stacionin e policisë, dhe një pjesë u shtrënguan të këndonin këngë nacionaliste serbe.

Ndonëse rrahjet ndodhën në stacionin e policisë dhe në garazhet e policisë, ku u mbajtën të izoluar shumë prej tyre, një pjesë e të paraburgosurve nuk munguan të thoshin se në stacion, policët u sollën përgjithësisht në mënyrë korrekte, deri atje sa ofronin edhe cigare. Shumica e të paraburgosurve u morën në pyetje mbi lidhjet e tyre me UÇK-në, dhe më pas u liruan, pasi ishin mbajtur jo më shumë se njëzet e katër orë nën ruajtje. Trajtimi i tyre është në kontrast të thellë me trajtimin që iu bë grupit të të burgosurve të “Qirez”-it, të cilët u ndaluan nga policët në Gllogofc gjatë javës së parë të majit (shih më sipër).

Një tridhjetë e pesë vjeçar nga Gllogofci bënte pjesë në grupin e parë të të ndaluarve. Ai i tha Human Rights Watch:

> Policët erdhën në orën 8.00 të mëngjesit. Ishte 22 prill…. Na nxorën të gjithëve nga shtëpia…. Ndanë mënjanë burrat e moshës 14-60 vjeç dhe më një anë tjetër gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Na vunë përballë një muri dhe na kërcënuan se do të na vrisnin, duke na pyetur, "duhet t'ju vrasim apo jo?" Nëntëdhjetë përqind e burrave u rrahën, ndërsa nxireshin nga shtëpitë. Më pas na thanë të merrnim rrugën drejt stacionit të policisë. Na futën të gjithëve në garazhin e stacionit….[dhe] na thanë, "Ju nuk jeni më të sigurtë. Tani e tutje, do të jeni në dorë të ushtrisë…." Rreth orës 15.00, u liruan personat e fundit…. Pyetja që na u bë ishte, nëse kishim qënë pjesëtarë të UÇK-së.[96]

Kontrollet, rrahjet e ndalimet e 22 prillit u përsëritën gjatë gjithë javës. Më 24 prill, banorit të Gllogofcit (në qendër të qytetit, mu pranë stacionit të policisë), I.X., pesëdhjetë e nëntëvjeçar, iu bë një vizitë. Ai i tregoi Human Rights Watch:

> Dhjetë ushtarë e paraushtarakë erdhën në shtëpinë time rreth orës 8.00. Ata trokitën në derë. [Kur e hapa derën] më drejtuan armët dhe më urdhëruan të ngrija duart lart. Më nxorrën jashtë me gjithë familjen dhe na kontrolluan…. Rrahën burrat e plaçkitën shtëpinë. Më goditën dy herë brenda në shtëpi, ndërsa bënin kontrollin. Djemtë e mij u rrahën jashtë në rrugë dhe u çuan në stacionin e policisë.[97]

Ndonëse nuk u ndalua për shkak të moshës dhe ndonëse djemtë e tij u liruan shpejt, mesazhi i vizitës ishte i qartë: "Ata nuk do të na linin asnjë sekondë të qetë." I.X. tha: "Sa herë që ata hynin në shtëpi, ne tashmë ishim të përgatitur për vizitën e tyre."

Disa banorëve të Gllogofcit iu bënë vizita si nga ushtarët, ashtu edhe nga policët. Më 25 prill, rreth orës 9.00, policët i bënë një vizitë në shtëpi B.B.-së, një pesëdhjetë vjeçari nga Gllogofci. Burrat u vendosën në rresht me fytyrë nga muri. Më të rinjtë u çuan në stacionin e policisë, ku u rrahën. Po këtij personi iu bë një vizitë e dytë nga ushtarët. Ai i tha Human Rights Watch:

> Tri-katër ditë pas ardhjes së policëve, ia behën ushtarët rreth orës 1.00 pasdite, dhe zunë të na ngacmonin. Na morën kartat e identifikimit, dhe si kusht për të na i kthyer përsëri, na kërkuan 100 marka gjermane.

> Pasi paguam paratë, na i ridhanë kartat e identifikimit. Më pas, na kontrolluan nëpër xhepa.[98]

Inkursionet e ndalimet vazhduan më 28 e 29 prill, ditët kur NATO bombardoi për herë të parë uzinën e ferronikelit. Një person rreth të dyzetave, i shpërngulur nga Abri e Epërme, i cili qëndroi në qendër të Gllogofcit, përshkroi çfarë i ndodhi gjatë një operacioni në mëngjes:

> Policët erdhën rreth orës 8.00, më 28 prill. Na bënë kontroll … e na pyetën, nëse kishim armë. Bënë një kontroll të imtë në shtëpi, por nuk gjetën gjë…. Në orën 9.00, ne [tetëdhjetë e tre burra] u çuam në stacionin e policisë. Ishte një garazh. Na vunë me fytyrë nga muri e na thanë, "nëse ktheni kokën prapa, do t'ju qëllojmë."… U mbajtëm atje deri në orën 2.00 pasdite. Njerëz të tjerë u mbajtën atje tre ditë me radhë…Një inspektor i Ministrisë së Brendshme, i cili ishte i veshur me uniformë civile, na mori në pyetje në gjuhën shqipe…. Zëvendës shefi i policisë, "Lutka" [Nebojsha Trajkoviç] ishte gjithashtu i pranishëm, ndërsa më morën në pyetje mua. Ai tha, "Ne po ikim dhe ushtria do të zërë vendin tonë. Duhet të gjeni vend e të futeni. Nëse do t'ju gjejnë, do t'ju ekzekutojnë aty për aty."[99]

Një i ndaluar tjetër, R.M., i tregoi Human Rights Watch çfarë i ndodhi në stacionin e Policisë, në momentin që u bombardua uzina e ferronikelit. Ai tha:

> NATO zuri të bombardonte uzinën e ferronikelit rreth orës 2.00 pasdite. Ne u ndodhëm në stacionin e policisë, dhe një oficer i lartë me grada (yje) në supet e tij na tha, "Ju e kërkuat NATO-n, dhe shihni tashti se çfarë po na bëjnë." Ai goditi një pjesë prej nesh me bishtin e një lopate.[100]

N.B., një person tjetër, i cili u ndalua më 30 prill, shpjegoi se si u arrestua dhe se si policët reaguan ndaj tyre, kur u bombardua uzina e ferronikelit:

> Ata më morën më 30 prill, rreth orës 8.00 të mëngjesit. Isha në shtëpinë time, në qendër, kur nja nëntë policë e rrethuan shtëpinë. Ata morën të gjithë burrat nën të gjashtëdhjetat, të cilët bëheshin nja 150 vetë. Na çuan në stacionin e policisë. Gjatë rrugës për në stacion na rrahën

me bisht lopate. Ishin veprime normale për policët. Ne ecnim me duart tona të lidhura pas kokës dhe u detyruam të këndonim këngë serbe. Na vendosën në garazhin e makinave. Shumë prej nesh u liruan pas një orë e gjysëm, por nja dyzet të tjerë, përfshirë mua, na mbajtën atje. Qëndruam deri të nesërmen në orën 5.00 pasdite. Kur NATO sulmoi uzinën e ferronikelit, policët i kapi nervozizmi. Ata na rrahën. Më kapën prej flokësh dhe ma përplasën kokën në mur. Disa të tjerë u vunë në punë për të pastruar stacionin. Ata u rrahën gjithashtu.

Na vendosën në një dhomë të shtëpisë së kulturës, që është afër stacionit. Atje ishin dyzet vetë të tjerë, të cilët ishin ndaluar një ditë më përpara. Ata na thanë, "ju e kërkuat NATO-n dhe ja ku e keni tani." Nëntë vetë u morën më vete për t'u pyetur, por pak më vonë ata u liruan.[101]

Ngjarje të mëtejshme na bindin se këto operacione ishin preludi i dëbimit masiv të popullsisë: duke shtënë frikën mes popullsisë, forcat e sigurimit i hapën udhën largimit të dhunshëm të popullsisë nga qyteza.

Dëbimi i detyruar

Për një pjesë të banorëve të Gllogofcit, paraburgimi ishte një gjë që pritej nga momenti në moment. Një grup i vogël njerëzish që banonin në qendër të qytezës u informuan më 24 prill që po arrinin autobuzë, të cilët, në varësi të dëshirës, do t'i çonin në kufirin maqedonas. Ata ishin grupi i parë i banorëve që la qytezën, e cila kish qënë praktikisht nën rrethim qysh prej 19 marsit. Një prej banorëve, një njëzet e tre vjeçar, e kish mjaft të qartë çfarë do të ndodhte:

Të shtunën (24 prill) erdhën në shtëpitë tona dhe na thanë të dilnim jashtë. Ndërsa bënin kontrollin e shtëpisë, ata më morën mua, dhe më detyruan të mbaja hapur derën e shtëpisë. Policët goditën xhaxhain tim dhe mua…. Na morën e na nxorën në rrugë. Policët [në rrugë] ishin më të egër. Na kërcënuan se do të na vrisnin….I mblodhën burrat nga shtëpitë e tyre dhe na çuan tek stacioni i policisë. Atje na thanë, "nuk ka më siguri në qytezë. Dëgjuam në lajme që ne po ju mbajmë ju si pengje. Po ju sjellim autobuzë dhe do t'ju çojmë në kufirin maqedonas, nëse doni."

Më 26 prill, rreth orës 11.30, policët shkuan derë më derë në zonën qendrore të Gllogofcit, duke i lajmëruar banorët se ishin gati dy autobuza për në Maqedoni, dhe se ata ishin të lirë të iknin apo të qëndronin. Policët, midis të cilëve ishte sipas shumë dëshmive edhe Petar Damjanac, shefi i policisë së Gllogofcit dhe Nebojsha Trajkoviç, zëvendës shefi i njohur me emrin "Lutka", u parashtruan njerëzve alternativat e kufizuara që u mbeteshin. Sipas M.S.-së, një gruaje njëzet vjeçare me banim në Gllogofc, "Shefi i policisë erdhi së bashku me një oficer tjetër të policisë, dhe tha, "ne nuk ju detyrojmë që të ikni, por tash e tutje, komandën në këtë vend do ta ketë ushtria." [103] Ishin gati dyqind banorë, të cilëve iu tha se, nëse mbeteshin aty, jeta e tyre nuk ish më e garantuar, dhe se ata kishin në dispozicion vetëm pesëmbëdhjetë minuta për të marrë vendimin. Shumica vendosën të iknin, dhe hipën në njërin prej dy autobuzëve që prisnin, pasi paguan pesëdhjetë marka gjermane për person (fëmijët u përjashtuan nga pagesa). Më tej, pa asnjë problem, u transportuan drejt kufirit maqedonas, ku arritën në orën 4.00 pasdite. Transporti me autobuzë ishte i mirorganizuar nga autoritetet serbe: disa refugjatë thanë se rruga deri në kufi ishte pa pengesa, sepse autobuzët kishin një leje kalimi speciale nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila autorizonte transportin e sigurtë nëpër të gjitha pikat e kontrollit e të bllokimit gjatë rrugës.

Dëbimi masiv i banorëve të Gllogofcit dhe i personave të shpërngulur që gjendeshin në këtë qytezë filloi veç pesë ditë më vonë, më 1 maj. Koha e nisjes duket se është e lidhur me bombardimet e NATO-s mbi uzinën e ferronikelit dhe me ofensivën e 30 prillit kundër fshatrave Vërbofc, Shtuticë, Baks (shih më sipër seksionin mbi ofensivën e 30 prillit). Vijoi e njëjta mënyrë organizimi për dëbimin masiv, me autubuza që transportuan brenda pesë ditësh mijra njerëz në drejtim të kufirit jugor. Autobuzët shkuan ose drejtëpërdrejtë në kufirin maqedonas, ose në ndonjë rast, në stacionin hekurudhor pranë Fushë-Kosovës, ku bëhej tranziti për në Maqedoni. Të gjithë të rriturve, nëse ata çoheshin drejt e në kufi, u kërkoheshin 50 marka gjermane; nëse ndiqnin rrugën e tranzitit me tren, u kërkoheshin 25 marka gjermane. Si mënyrë pagese, në vend të parave pranohej edhe karburant. Përsërisim, që ishin policët e Gllogofcit ata që ishin përgjesës për informimin e popullit mbi lëvizjen e autobuzëve dhe për shoqërimin e njerëzve deri tek autobuzët apo tek trenat. Shumë dëshmitarë identifikuan zëvendës shefin e policisë të njohur me emrin "Lutka" si përgjegjësin e

... na rrahën me bisht lopate.

organizimit të dëbimit masiv dhe të informimit të banorëve me lajmin se policët "nuk mund të garantonin më jetën e tyre", pa harruar të theksonin se vendimi për të ikur ishte "fakultativ".

Të shtunën, më 1 maj, në orën 10.00, një grup personash të shpërngulur nga Cikatova e Vjetër dhe Poklekut, paguan 50 marka gjermane për kokë dhe u hipën autobuzëve për në Maqedoni. Sipas A.H., një pesëdhjetë e tre vjeçari të shpërngulur nga Domanek-u, po atë ditë, disa Land Rovers të bardhë e të blinduar lajmëronin orare të tjera nisjeje për në Maqedoni, me mesazhin : "Ne nuk mund t'iu mbrojmë ju, por rruga për të ikur drejt kufirit do të jetë e hapur, dhe askush nuk do t'iu prekë." Të nesërmen, ky person u nis për në qendër të qytezës, hipi në një nga të njëzet e pesë autobuzat, të cilët u nisën në orën 10.00 paradite.[104] Një shtatëdhjetë e tre vjeçar, i shpërngulur tjetër nga Glladno Sello i tha Human Rights Watch, që ai u nis po atë ditë dhe në po ato rrethana.

Shumë dëshmitarë identifikuan zëvendës shefin e policisë të njohur me emrin "Lutka" si përgjegjësin e organizimit të dëbimit masiv dhe të informimit të banorëve me lajmin se policët "nuk mund të garantonin më jetën e tyre"

Të nesërmen në mëngjes, të martën më 3 maj, policët bënë një vizitë në disa apartamente banimi në qytezë. Sipas një shtatëmbëdhjetë vjeçari, "Kush prej nesh kish kish një apartament në Gllogofc, nuk donte të ikte….[por] ata hynë me forcë në shtëpitë tona dhe na thanë të dilnim jashtë, pasi ushtarët kishin nevojë për apartamentet." [105] Kur ky djalë doli jashtë pallatit së bashku me familjen e tij, autobuzët po prisnin. Dy dëshmitarë të tjerë të intervistuar nga Human Rights Watch i lanë shtëpitë e tyre po atë ditë.

Sipas H.M.-së, një dyzet e gjashtë vjeçar nga Gllogofci, boshatisja e apartamenteve të banimit vazhdoi edhe më 4 maj. Ky i tha Human Rights Watch, "policët hynë në pallat në orën 9.00 paradite. Ata po shkonin pallat më pallat. Na bënin shenjë me dorë se duhej të iknim. Ishte një zëvendës shef me emrin "Lutka", i cili përgjigjej për evakuimin."[106]

Një dyzer e gjashtë vjeçar nga Gllogofci, i cili u tranferua po atë ditë tek stacioni i trenit pranë Fushë-Kosovës, pohoi të njëjtën gjë.

Ata [policët] po ecnin nëpër rrugë e po bërtisnin. Ishte ora 9.00 apo 10.00 paradite. "Dilni jashtë sa më shpejt të jetë e mundur, shkoni tek stacioni dhe hipni në autobus," - na thanë ata. Kështu që ne morëm

ushqim për fëmijët, plaçkë për të veshur e ikëm nga shtëpia. Tek stacioni, autobuzët po na prisnin të vendosur në rresht. Autobuzët bënin rrugën vajtje-ardhje për në Miloshevë (pranë Fushë-Kosovës), dhe prej andej, njerëzit hipnin në trena. Duhej të paguanim një biletë për çdo person të rritur, e cila kushtonte njëzet e pesë marka gjermane. Arritëm në Miloshevë rreth orës 5.00 pasdite. Na thanë të zbrisnim nga autobuzët, dhe policët na hipën aty për aty në tren. Nuk na lanë të iknim majtas apo djathtas – itinerari ishte i pëcaktuar nga dera e daljes së autobuzit tek dera e hyrjes së trenit. Prirtëm dy orë aty. Pasi na bënë njëzet persona së bashku në një kompartiment – ishim shumë të ngjeshur, më tej nuk patëm më probleme…Në tren kish eskorta policie…[107]

Deklarata të dëshmitarëve të tjerë, të cilët ikën më 4 maj, përforcojnë sa u tha më sipër. A.H.-së, një pesëdhjetë e nëntë vjeçari nga Gllogofci (saktësisht nga Domaneku), i cili iku në të njëjtën ditë, policët i thanë: "Kushdo që ka karburant e një mjet lëvizës të vetin, mund të ikë." Kisha pembëdhjetë litra naftë në zetorin tim, kështu që ata më lanë të hipja në autobus. Përndryshe, ata kërkonin pesëdhjetë marka gjermane." [108] Një tjetër, i shpërngulur prej Abrisë së Epërme tha se kish parë "pesëmbëdhjetë autobuzë në një zonë të hapur [në Gllogofc]. Atje kish më shumë se një mijë njerëz që prisnin."[109]

Sipas atyre që u detyruan të linin qytezën, dëbimet vazhduan më 5 maj, ndonëse në përmasa më të vogla. Në atë moment, shumica e banorëve dhe e të shpërngulurve ishin nisur. Aksioni policor në ditët e para të majit kish synuar vetëm dëbimin sistematik të popullsisë civile të Gllogofcit. Pas javësh të tëra poshtërimesh, kanosjesh, plaçkitjesh nga ana e paraushtarakëve e policëve, ashtu si dhe pas vrasjesh sporadike, pakësimit të furnizimit me ushqime, pranisë së rëndë ushtarake e policore dhe ndalimit të përkohshëm të qindra burrave, popullsia civile nuk kish rrugë tjetër, veçse të mos refuzonte ofertën për t'u nisur drejt Maqedonisë, sidomos kur ju thuhej që jeta e tyre nuk mund të garantohej më. Vetëm një numër i vogël njerëzish mbetën aty; shumica u shndërruan në refugjatë.



Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

6

KOMUNA E GJAKOVËS

Sipas të dhënave të UNHCR-së, popullsia e para luftës e komunës së Gjakovës kishte afërsisht 131,700 banorë, nëntëdhjetë e tre përqind e të cilëve ishin shqiptarë etnikë.[1] Për shkak të pozicionit gjeografik përgjatë kufirit me Shqipërinë, kjo zonë u përfshi në mënyrë të veçantë nga vorbulla e luftës gjatë vitit 1998 e gjatë muajve të parë të vitit 1999. UÇK-ja ishte aktive në fshatrat e komunës dhe e përdori rajonin kufitar për kontrabandën e amëve.

Abuzimet qeveritare morën përmasa më të mëdha me tërheqjen e misionit të Verifikimit të OSBE-së më 20 mars, por u intensifikuan në mënyrë dramatike pas fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s më 24 mars. Fshatrat kufitarë në veriperëndim të Gjakovës, në drejtim të Junikut, u shpopulluan. Personalitete të njohura shqiptare të qytetit të Gjakovës, përfshirë ata që kishin punuar me OSBE-në, gjurmoheshin për t'u vrarë, ndërsa qendra e vjetër e qytetit u dogj. Ashpërsia e veprimit qeveritar kundër civilëve në këtë qytet duhet parë përveç të tjerash si një raprezalje pas luftimeve në rrethinat e Cabratit midis UÇK-së e forcave qeveritare (shih më poshtë).

Shumë fshatra të komunës u goditën gjithashtu shumë rëndë.[2] Siç është shpjeguar më poshtë, më shumë se njëqind burra mungojnë qysh prej sulmit të 27 prillit në Korenicë. Po atë ditë, mijra shqiptarë të fshatrave në veriperëndim të Gjakovës, të vendosur në një kolonë të stërmadhe, u dëbuan me forcë në drejtim të Shqipërisë. Në fshatin e Mejës, burrat u ndanë nga kolona, dhe pothuaj 300 syresh mungojnë edhe sot e kësaj dite (verifikimi i fundit është bërë në prill 2001). Njëzet burra u ekzekutuan në Goden më 25 mars.

Meja ishte gjithashtu objektivi i i goditjes së NATO-s, dhe disa bomba

ranë mbi një kolonë shqiptarësh që zhvendoseshin brenda kufijve të komunës. Po atë ditë, pak më vonë, NATO bombardoi një kolonë tjetër të shpërngulurish pranë fshatit Bistrazhin.[3] (për hollësi të mëtejshme, shih Fushatën Ajrore të NATO-s)

QYTETI I GJAKOVËS

Ndër qytetet kryesorë të Kosovës, Gjakova ishte qyteti që ju nënshtrua dhunës më të madhe kundër civilëve. Ndonëse nuk u dëbuan të gjithë banorët e qytetit (100 mijë, ku përfshiheshin edhe 20 mijë persona të shpërngulur), kërcënimet e vrasjet shtrënguan pjesën më të madhe të popullsisë ta linin Gjakovën. Policët e paraushtarakët serbë, ashtu si dhe ushtarët jugosllavë, vranë vetëm në qytet midis 24 marsit e 12 qershorit rreth 200 vetë, ndërsa shumë të tjerë u vranë në fshatrat aty rrotull, si në Mejë e Korenicë. Nja 1200 persona të tjerë të komunës së Gjakovës rezultonin të humbur, të paktën deri në shkurt të vitit 2000. Nja 150 të tjerë u arrestuan gjatë luftës dhe u çuan në Serbi, ku u dënuan e u burgosën nga gjykatat serbe me akuzën për "akte terroriste", ndonëse shumë syresh u liruan më vonë.

Dhuna në Gjakovë ishte e mirorganizuar. Megjithëse vrasja e civilëve ish një ngjarje e përditshme, dhuna e shkatërrimi i shproporcionuar morën formë në periudha të veçanta dhe u dukën të mirëkoordinuara prej forcave të sigurimit. U organizuan gjithashtu do masakra masive, si për shembull ekzekutimi në mbrëmjen e 1 prillit i njëzet vetëve brenda një shtëpie, të cilët ishin të moshës 2-73 vjeç. Sipas shumë gjasave, banorë të njohur të qytetit, si avokatë, mjekë, veprimtarë politikë, kërkoheshin për t'u vrarë.

Ndër qytetet kryesorë të Kosovës, Gjakova ishte qyteti që ju nënshtrua dhunës më të madhe kundër civilëve.

Më aktivët në represionin ndaj Gjakovës ishin policët lokalë, policë nga pjesët e tjera të Serbisë, ushtarët, paraushtarakët, të cilët vepronin që të gjithë në mënyrë të koordinuar. Dëshmitarët identifikuan disa policë lokalë, ashtu si edhe disa serbë që banonin aty. Thanë gjithashtu se midis atyre që ndihmonin policinë për të identifikuar individë, sidomos veprimtarë politikë, biznesmenë të suksesshëm apo familjarë e të afërm të pjesëtarëve të UÇK-së, ishin edhe disa shqiptarë të Gjakovës.

Afërsia e Gjakovës me kufirin shqiptar ishte një faktor i rëndësishëm që motivonte intensitetin e dhunës. Malet aty rrotull përbënin një rrugë të zakonshme për infiltrimin e amëve e përforcimeve njerëzore në dobi të UÇK-së, gjë që e bëri qytetin nga pikëpamja strategjike shumë të rëndësishëm. Nga 7 deri në 11 maj, në Cabrat e në rrethinat e qytetit u zhvilluan luftime të ashpra shtëpi më shtëpi midis forcave qeveritare e UÇK-së – gjë që u pasua nga një dhunë intensive shtetërore kundër civilëve, si dhe nga paraburgosje të një numri të madh shqiptarësh.

Gjakova ishte e shquar gjithashtu për një traditë të rezistencës e për një ndjenjë të krenarisë kombëtare, dhe ky fakt sigurisht ndikoi në vendosmërinë e qeverisë për të ushtruar dhunë. Popullsia e qytetit – mbi 90% ishin shqiptarë etnikë – mbështesnin fuqimisht Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), partinë më të rëndësishme të shqiptarëve të Kosovës në vitet '90, dhe shumë të rinj të Gjakovës u bashkuan me UÇK-në gjatë vitit 1998 e 1999. Shqiptarët e Gjakovës besonin gjithashtu se mëria e serbëve me këtë qytet lidhej me namin e tij si një qendër intelektuale e kulturore në Kosovë.

Ngaqë rreth 25% e popullsisë mbeti në qytet gjatë luftës, dëshmitë nuk mungojnë, dhe një numër dëshmitarësh të besueshëm patën mundësinë të vëzhgonin plaçkitjen, djegjen, dhe masakrat që përfshinë qytetin. Midis dëshmitarëve gjenden një numër punëtorësh të bashkisë, të cilët u urdhëruan nga policët të zhvendosnin e të rivarrosnin viktimat. Faton Polloshka, shef i Drejtorisë së Punëve Publike për Bashkinë e Gjakovës, dhe ekipi i tij i përbërë nga tetë punëtorë, që të gjithë romë[4], kujtojnë shumë prej emrave të viktimave, datën e vendin e ekzekutimit të tyre, si dhe detaje të përgjithshme të ngjarjeve në Gjakovë. Kish vetëm pak vetë që bënin pjesë në personelin jo ushtarak, e të cilët mund të lëviznin lirisht nëpër qytet. Polloshka i tha Human Rights Watch:

> Çdo ditë kish dy, tri, katër apo pesë [vrasje].... Nëse ish vetëm një kufomë, ne shkonim me një makinë. Nëse ishin dy, shkonim me dy makina. Nëse ishin më shumë, ne shkoni me zetor.[5]

Polloshka e vartësit e tij thanë se policia serbe katalogoi në mënyrë sistematike të gjithë viktimat, si ndodhi edhe në rastin e Pejës. Ata thanë, se shumë prej viktimave u identifikuan dhe u fotografuan dhe se një hetues i gjykatës me emrin Marinkoviç ishte i pranishëm në vendin e masakrave.

Numri i përgjithshëm i viktimave në Gjakovë është i paqartë, përderisa shumë vetë rezultojnë akoma të humbur. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut vlerësoi numrin e të humburve në 1,200 vetë, dhe hartoi një listë me emrat, datat e lindjes, vendet ku ata u rrëmbyen, dhe emrat e personave të cilët informuan mbi gjithçka. Deri më 11 qershor 1999, kjo listë pati 948 emra, por më pas u shtuan nja 250 emra të tjerë. Këshilli kish gjithashtu një listë të 200 banorëve të bashkisë së Gjakovës të vrarë, midis të cilëve ishin edhe katërmbëdhjetë luftëtarë të UÇK-së.[6]

Washington Post-i udhëhoqi një studim të hollësishëm mbi masakrat në Gjakovë. Bazuar në informacionin e Faton Polloshkës, e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriut dhe e hetimit të vet të pavarur, gazeta e njohur arriti të hartonte një listë "të paplotë" të 199 të vrarëve në Gjakovë midis 24 marsit e 12 qershorit, 186 prej të cilëve janë të regjistruar me emër e mbiemër.[7]

Një pengesë për numurimin e të vdekurve ishin përpjekjet e autoriteteve për të spostuar apo zhdukur provën e krimit. Sipas Faton Polloshkës, si dhe sipas njërit prej pastruesve të rrugëve, të intervistuar veç e veç, shtatëdhjetë e shtatë kufoma që ishin varrosur në varrezat e Gjakovës në fillim të majit u zhvendosën pas 7 majit. Polloshka i tha New York Times-it që gati njëqind kufoma u hoqën nga varrezat më 22 maj.[8] Një punëtor tjetër i bashkisë, i cili kish punuar në varreza gjatë gjashtë viteve të fundit, i tha Human Rights Watch: "Kufomat u nxorrën nga varrezat. Ata erdhën me buldozerë. Unë nuk i pashë kur erdhën, por kuptova të nesërmen se ata kishin ardhur. E gjithë kjo ndodhi pas ofensivës së Cabratit."[9]

Më 24 qershor, Human Rights Watch vëzhgoi gjurmë gomash të gjera dhe truall të gërmuar pranë varrezave, prej nga ishin hequr kufomat. Një numër varresh të tjerë kishin shënimin "i paidentifikuar". Mbi një varr shkruhej: "çorape leshi, xhaketë të zezë dhe pantallona me rripa të bardhë." Sipas Polloshkës, gjatë luftës skuadra e tij gjithashtu varrosi kufoma në kopshte privatë në të gjithë qytetin.

Shtatëdhjetë e shtatë kufoma që ishin varrosur në varrezat e Gjakovës në fillim të majit u zhvendosën pas 7 majit.

Të gjitha dëshmitë nxjerrin në dritë bashkëpunimin e ngushtë midis forcave të ndryshme të sigurimit brenda e rrotull qytetit: policë, ushtarë e paraushtarakë. Banorët e Gjakovës mbanin si oficerin përgjegjës për qytetin Sreten Camoviç-in, i cili ishte kreu lokal i Sigurimit të Shtetit, ndonëse askush nuk e kish parë atë të kryente ndonjë krim. Milan

Stanojeviç, një kushëri i kryetarit të bashkisë së Gjakovës, Momcillo Stanojeviç, ishte kreu i policisë lokale. Sipas Polloshkës, ky vetë pati një bisedë të shkurtër me kryetarin e bashkisë Stanojeviç gjatë luftës: "Unë isha pranë kryetarit të bashkisë dhe e pyeta atë 'Çfarë po bëni? Nuk keni ndërmend të jetoni këtu pas gjithë kësaj?' Ai m'u përgjigj se 'urdhërat e tij vinin nga lart.'"[10]

Në një artikull të 30 prillit 1999, gazeta Washington Post bëri një raport mbi një pjesë të forcave jugosllave, të cilat ishin aktive në rajonin e Gjakovës. Duke cituar "raporte të shërbimeve sekrete amerikane", artikulli përmendte brigadën e 125-të të motorrizuar të Ushtrisë Jugosllave, të komanduar nga kolonel Srba Zdravkoviç;[11] brigadën e 252-të të korracuar, të komanduar nga kolonel Millosh Mandiç; dhe brigadën e 52-të të artilerisë së kombinuar, të komanduar nga kolonel Radojko Stefanoviç.[12] Kolonelët Mandiç e Stefanoviç konsideroheshin nga Departamenti i Shtetit amerikan në fillim të prillit si komandantë që vepronin në Kosovë.[13]

Shumë shqiptarë të Gjakovës folën gjithashtu për një familje shqiptare të zonës, me mbiemër Jakupi, e cila kish lidhje të hershme me policinë. Në

Varre në Gjakovë. Sipas dëshmitarëve, forcat serbe zhvarrosën dhe lëvizën të paktën shtatëdhjetë trupa në maj 1999.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

raportin e vet mbi Kosovën, OSBE-ja përmend gjithashtu familjen Jakupi, si e mandatuar nga policia për të kontribuar në "sigurimin lokal" gjatë vitit 1998 e 1999.[14] Shumë vetë në Gjakovë thanë se kjo familje ka ndihmuar policinë, të paktën duke i orientuar në Gjakovë e rrotull saj, gjatë bombardimit të NATO-s.

Të dhëna të mëtejshme lidhur me forcat qeveritare që ishin aktive në Gjakovë dolën në dritë nga gjyqi ndaj 143 shqiptarëve të Kosovës, të cilët u dënuan më 22 maj 2000 nga gjykata serbe me akuzën për terrorizëm (shih seksionin mbi të burgosurit kosovarë në Serbi qysh prej fundit të luftës në kapitullin Abuzizmet pas 12 qershorit 1999). Sipas gjykatësit Goran Petronijeviç, vendimi u bazua pjesërisht mbi dëshminë e kapitenit të Ushtrisë Jugosllave Radovan Bogavaç, i cili ish pjesëmarrës në aksionin e 7 majit 1999 në mbrojtje të një grupi policësh të sulmuar nga UÇK-ja në Gjakovë, si edhe mbi raportin e Ushtrisë Jugosllave lidhur me aktivitetin në zonën e Gjakovës. Megjithëse ky fakt nuk dëshmon pjesëmarrjen e kapitenit Bogavaç në krime lufte, ai dëshmon qartë që Ushtria Jugosllave ka qënë aktive brenda qytetit të Gjakovës.

Faza e parë – nga 24 mars deri më 2 prill

Vala e parë e dhunës filloi më 24 mars, kur NATO nisi sulmet e saj mbi Jugosllavi, dhe vijoi deri më 2 prill. Qytetit të lashtë historik të Gjakovës, përfshirë edhe xhaminë e Hamudi-t, iu vu zjarri, ndërsa vrasjet sporadike ndodhnin në çdo cep të qytetit. Më 25 mars, forca të panjohura të sigurimit hynë me forcë në shtëpinë e mjekut të respektuar, Dr. Izet Hima, dhe e vranë në prani të gruas së tij.[15] Sipas gazetës *Washington Post*, Faton Polloshka e mori trupin pa jetë të Dr. Himës në orën 5.00 pasdite dhe më pas, gjeti edhe kufomat e tre shqiptarëve të tjerë etnikë të vrarë po atë ditë: Kujtim Dullën, dyzet e katër vjeç, Qamil Zherkën, shtatëdhjetë vjeç, dhe djalin e tij Nexhdet, dyzet e një vjeç.[16] U vranë gjithashtu edhe banorët e njohur të qytetit të Gjakovës, Urim Rexha, avokat, dhe Mark Mallota, një udhëheqës i LDK-së, i cili i kish dhënë me qera shtëpinë e tij Fondacionit "Nënë Tereza".[17] Më 26 mars, serbë të armatosur shtinë e vranë gjashtë burra në një shtëpi në rrugën "Ymer Grezhda", përfshirë një klerik mysliman, Zenel Danën, dhe djemtë e tij Eminin e Fahriun. Këto ekzekutime janë cituar në akuzën që është ngritur

nga Gjykata e Krimeve të Luftës kundër Millosheviçit, Milutinoviçit, Shahinoviçit, Ojdaniçit dhe Stojiljkoviçit.[18]

Nga fundi i marsit, sipas gazetës *Washington Post*, u vranë në qytet tridhjetë e dy vetë.[19] Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në mars u vranë tridhjetë e një vetë.[20]

Gjatë kësaj kohe u dëbuan nga Gjakova një numur i madh njerëzish. Refugjatë të intervistuar në Shqipërinë veriore – shumica e të cilëve ishin gra – folën për djegjen e qytetit të lashtë dhe për dëbimin e tyre me dhunë nga ana e policëve, ushtarëve e paraushtarakëve. Shumë refugjatë pohuan të kishin parë, ndërsa ishin duke ikur, grumbuj kufomash të shpërndarë në rrethinat e Gjakovës.[21] Një refugjat nga Gjakova i intervistuar në Shqipërinë Veriore tha:

> Në Gjakovë pati të shtëna të shumta; njerëzit u vranë nga serbët, dhe të tjerët ishin të tmerruar. Ata as që i varrosnin kufomat…. Ushtarët na thoshin: "Shkoni në Shqipëri, kjo është toka jonë, jo e juaja." Dhuna në Gjakovë filloi më 24 mars. Në atë moment nuk kish atje ndonjë shenjë të pranisë së UÇK-së. Serbët filluan duke u vënë zjarrin shtëpive. Shumë prej tyre janë civilë serbë….Unë pashë shtatë kufoma në lagjen Qyli pranë Gjakovës, në pjesën veriperëndimore të qytetit, në rrethina. Viktimat i përkisnin dy apo tre familjeve të ndryshme. E gjithë lagjja u shkatërrua nga tanket që hynë aty më 25 mars.[22]

Refugjatët në Shqipëri dhe banorët e Gjakovës që u intervistuan pas kthimit, bënë fjalë për një situatë kaotike, ndërsa forcat e armatosura lëviznin lagje më lagje sipas një programi të caktuar. Një refugjat në Shqipëri tha, "Ishte çdo gjë e organizuar. Ata shkuan lagje më lagje. Disa ushtarë janë përgjegjës për shkatërrimin e gjërave, ndërsa të tjerë për shoqërimin e njerëzve në kufi."[23]

Një pjesë e dhunës së madhe ndodhi më 1 e 2 prill, kur u mor vesh se ishin vrarë pesëdhjetë e gjashtë vetë. Një aksion i bashkërenduar i policisë në dy rrugë fqinje të lagjes "Qerimi" – rruga Millosh Gilish e Sadik Staveleci – përfundoi me një numur të madh ekzekutimesh.

Sipas dëshmitarëve, të cilët thanë se lagjja kish organizuar burra për të vëzhguar zonën, forcat policore serbe filluan sulmin e bashkërenduar në dy rrugët e mësipërme në mesnatën e 1 prillit. Një grua, N.C., i tha Human Rights Watch:

Këta njëzet njerëz u vranë dhe trupat e tyre u dogjën në shtëpinë e Vejsave, rruga Milos Gilic, nr 163, Gjakovë

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

> Unë pashë flakë zjarri nga fundi i rrugës pranë xhamisë së Sofës. Një pjesë e tyre u afruan, ndërsa të tjerët prisnin në skajin tjetër të rrugës. Masakra e parë ndodhi pranë xhamisë, në familjen Lleshi, ku ish vetëm burri e gruaja. Më pas të njëjtin fat pësuan edhe Hysen Deda me gruan, vajzën dhe me djalin e tij pesë vjeçar. Më pas ata erdhën tek familja Vejsa, dhe njëzet vetë nga kjo familje, së bashku me disa të tjerë, u vranë. Më tej, ata shkuan tek familja Cana, ku vranë katër vetë.[24]

Dëshmitarja përmendi një polic – ajo besonte të bëhej fjalë për një zëvendës komandant – i cili jetonte në po atë lagje. Quhej Novak Pitoliç. Ndonëse ajo nuk e pa Pitoliçin gjatë natës së sulmeve, një fqinjë e dëshmitare okulare e sulmit, A.N., e intervistuar veç, pohoi se kish parë Pitoliçin atë natë.[25] Një burrë tjetër, një ish-polic që kish shërbyer në Gjakovë, konfirmoi që Pitoliç-i ishte një polic shumë aktiv në qytet, ndonëse ai nuk e kish parë atë të kryente ndonjë krim.[26]

Fqinji A.N., tha se sulmi filloi në mesnatë, midis orës 11.00 e 12.00. Ai kish parë nga një vrimë e baxhasë së çatisë, nga ku dukej gjithë rruga, dhe i tregoi Human Rights Watch:

> Unë e pashë Novak Pitoliçin, ndërsa dha dy herë një sinjal me çakmak. Në atë moment, një makinë e blinduar ndezi dritat e saj. Një makinë me dy policë dhe me drita të fikura ecte në rrugë. Dy policët zbritën e mbetën prapa. I pashë ata me mitralozë të vegjël pranë familjes së Fehmi Lleshit, dhe dëgjova zhurma, të bërtitura, dhe më pas, të shtëna.[28]

Mbështetur në dëshmitë e refugjatëve të strehuar në Shqipëri gjatë luftës, gazeta *Washington Post* rikonstruktoi atë që ndodhi atë natë në lagjen "Qerimi". Gazeta tha se policët lëvizën atë natë në rrugën "Sadik Staveleci", duke vrarë pesëdhjetë e katër vetë e duke djegur shumicën e shtëpive, duke kursyer vetëm shtëpitë që banoheshin prej serbëve lokalë.[29] Dëshmitarët besonin se policët ishin duke kërkuar Besim Bokshin, udhëheqësin lokal të LDK-së, por ai ia doli mbanë të ikte së bashku me 300 banorë të tjerë të lagjes.

Masakra më e egër ndodhi në fisin Vejsa, në rrugën "Millosh Giliç", nr. 163, ku u vranë njëzet vetë nga pesë familje të ndryshme, përfshirë dymbëdhjetë fëmijë të moshës nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, të cilët më pas u dogjën. Ekspertët ligjorë të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për Krimet

e Luftës gjetën gjymtyrë të njëzet kufomave, dhe kjo masakër është pjesë e akuzës së ngritur kundër Milosheviçit.[30]

Sipas N.C.-së ,në orën 12.00 arritën tek shtëpia e Vejsa-ve nja dhjetë policë. Burrat kishin ikur tashmë, duke përjashtuar këtu Hysen Gashin, i cili ishte i sëmurë mendor. Ata që mbetën ishin vrarë në kuzhinë, dhe më pas, shtëpisë i ishte vënë zjarri. Një djalë dhjetëvjeçar, emri i të cilit mbahet i fshehtë, mbeti gjallë. A.N., një fqinj, i tregoi Human Rights Watch:

> Kur ata erdhën në shtëpinë e Vejsave, unë dëgjova zërin e një miku serb, të quajtur Nenad Rajceviç dhe të pesë vëllezërve të tij. Unë i pashë ata. Ishin gjithsej tridhjetë apo dyzet policë. Të gjithë kishin veshur uniforma. Unë pashë civilë [serbë] gjithashtu. Ata shkuan tek shtëpia e Vejsave. Dëgjova që bërtisnin në atë shtëpi. Pashë që me ta ishte edhe Milosh Sepanoviç... Qëndruan vetëm pesë minuta. Dëgjova të thirrura e të shtëna. Pastaj shkuan tek Jonuz Cana dhe atje vranë të gjithë familjen, katër vetë në harkun e dy minutave.[32]

A.N. përshkroi Rajceviçin, i cili ishte një tridhjetë e gjashtë vjeçar nga Mali i Zi e punonte në një zyrë të postës qëndrore. Pesë vëllezërit e tij ishin: Tihomir, rreth dyzet e dy vjeç, Nenad, tridhjetë e gjashtë vjeç, Sasha, tridhjetë e tre vjeç, Ljubisha, tridhjetë e nëntë vjeç, dhe Miçko, tridhjetë e katër vjeç. Millosh Sepanoviç, dyzet e tre vjeç, u përshkrua si ish-mekanik që punonte në polici.

Vëllezërit Rajceviç dhe Sepanoviçi u përmendën gjithashtu nga N.C. Kjo e fundit i tregoi Human Rights Watch që kish parë vëllezërit Rajceviç në uniforma policie në ngjyrë blu, ndërsa ajo dhe familja e saj ishin futur në kolonën e personave të shpërngulur në Gjakovë. Human Rights Watch intervistoi gjithashtu një shqiptar tjetër etnik, një ish-polic në Gjakovë, i cili tha se Sepanoviçi kish qënë një polic aktiv gjatë luftës, dhe se ai ish një udhëheqës lokal në lagjen "Qerimi", ndonëse nuk ish një dëshmitar okular i aksioneve të tij. Ky konfirmoi gjithashtu që Novak Pitoliç ishte një polic i Gjakovës, por tha se nuk e kish parë gjatë kohës së luftës. [33]

Faton Polloshka i Ndërmarrjes së Punëve Publike në Gjakovë tha se ai ishte i pranishëm dhe ndihmoi, ndërsa po merrnin prej aty njëzet kufoma, si dhe tridhjetë vetë të tjerë të vrarë më 1 e 2 prill. Ai i tha Human Rights Watch: "Kufomat në shtëpinë e e Vejsave ishin krejt të karbonizuara.

Unë shkova të merrja batanije në spital, por ata nuk kishin më shumë se një copë. Nëntëmbëdhjetë trupa të karbonizuar u mbështollën me një batanije. U varrosën në tre varre. [34]

Viktimat ishin:

Hysen Gashi, 50
Valbona Haxhiavdija, 38
Rina Haxhiavdija, 7
Doruntina Haxhiavdija, 3
Egzon Haxhiavdija, 5
Shaindere Hoxha, 55
Flaka Hoxha, 15
Fetihe Vejsa, 60
Tringa Vejsa, 31
Dorina Vejsa, 11
Marigona Vejsa, 9
Sihana Vejsa, 7
Arlind Vejsa, 5
Rita Vejsa, 2
Mandushe Nuci, 52
Shirine Nuci, 73
Valbona Caka, 34
Delvina Caka, 7
Diona Caka, 2
Dalina Caka, 2

Masakra të një shkalle më të vogël ndodhën më 1 e 2 prill në pjesë të tjera të qytetit. Një dëshmitare, i cili i tregoi Human Rights Watch historinë e saj, ndërsa ishte refugjate në Shqipëri, tha se policia e shtrëngoi atë dhe

Dhomë ndenjjeje e gjakosur e një shtëpie në Gjakovë, në të cilën policia serbe ekzekutoi një grua dhe dy vëllezër të saj në 23 prill 1999. Një komshi i gjeti viktimat të gjunjëzuara mbi jastëkë.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

familjen e saj të linin shtëpinë në ditët e para të prillit. Burri i saj, Hajdari, pesëdhjetë e dy vjeç, u vra mu në rrugë, dhe ajo pa shumë kufoma të tjera, ndërsa linte qytetin. Ajo tha:

> Ata më nxorrën mua e fëmijët jashtë shtëpisë, por mbajtën burrin tim brenda. Më në fund e lanë edhe atë të dilte nga shtëpia, por ndërsa po ikte, ai u ndesh me tre policë në rrugë. Ishin policë specialë me fytyrë e gojë të maskuar. Ata ndalën edhe kunatin tim. I thanë të ndalonte e të luftonte me ta. Ndërsa unë po largohesha, ata i vranë në oborrin tonë. Ndoshta nja dhjetë minuta më vonë, kur gjithçka u bë pakëz më e qetë, unë u ktheva prapa dhe gjeta burrin tim të vdekur me një plagë plumbi mu në tëmth. Në rrugë, pashë rreth dhjetë vetë të vdekur, dhe njërin syresh me fytin të prerë. [35]

Vrasje sporadike pati gjatë gjithë muajit prill, ndonëse më të rralla se sa ishin në dy ditët e para të muajit. Sipas shifrave të dhëna nga gazeta *Washington Post*, nga 3 prilli deri më 6 maj u vranë tridhjetë e pesë vetë. Një grua i tregoi Human Rights Watch se si tre prej fqinjëve të saj, dy vëllezër e një motër, të cilët banonin në rrugën "Komuna e Parisit", nr. 86, në lagjen "Blloku i Ri", u vranë më 23 prill. Ajo tha:

> Më 23 prill, ata të tre [Teki, Agim dhe Femije Deda] po hanin drekë. Rreth orës 1.30 pasdite, disa nga ne banorët e lagjes panë policët të hynin në shtëpinë e tyre. Nuk ishin më shumë se pesëmbëdhjetë policë; ata hynë me forcë, duke shpërthyer derën. Unë e njoh njërin prej tyre: Nebojsha Obradoviç, rreth të dyzetave. Ai është një polic lokal prej Gjakove. Dëgjuam shumë të shtëna - ndoshta nja njëqind. Ishin të shtëna automatike. Vranë ata të tre, pastaj plaçkitën shtëpinë. U përpoqën të digjnin dhomën e ndëjtjes, ku mbetën trupat pa jetë.
> Prita disa orë përpara se të hyja në atë shtëpi. Isha ora 5.30 pasdite. Shkova me dy miq, një fqinjin tim e një vëlla të xhaxhait të viktimave. Porta e kopështit ishte hedhur në erë, dhe dyert e shtëpisë ishin thyer – ishin të hapura katërkanatash. Të tre trupat ishin bërë shoshë nga plumbat. Secili kish një pllangë të madhe gjaku poshtë vetes. Vëllezërit ishin vënë në gjunjë me kokë të ulur e ashtu ishin vrarë, njëri tek divani, tjetri tek një karrike. Motrën e gjetëm të shtrirë në shpinë, me fytyrë nga tavani. Kishin vrima plumbash në trupat e tyre; madje edhe në duar.[36]

Human Rights Watch bëri një vizitë në qershor 1999 në shtëpinë, ku

ndodhi kjo masakër. Pjesë të saj ishin djegur, por tri njolla të mëdha gjaku ishin ende të dukshme mbi divanët, ku të tri viktimat ishin vrarë. Gëzhoja plumbash ishin shpëndarë në të gjithë dhomën e ndënjes.

Faza e dytë – nga 7 maj deri më 13 maj

Vala e dytë e vrasjeve filloi më 7 maj, ditën kur në lagjen Cabrat nisën luftime të ashpra midis forcave qeveritare dhe UÇK-së. Sipas Hekuran Hodës, komandant i batalionit të II-të të brigadës 137-të të UÇK-së, luftimet, gjatë të cilave lanë jetën shumë luftëtarë të UÇK-së e shumë policë serbë, vazhduan deri më 11 maj.[37] Gazeta *Washington Post* tha se gjatë kësaj periudhe u vranë pesëdhjetë e shtatë civilë që s'kishin punë me luftimet.

Dëshmitarët i thanë Human Rights Watch se luftimet në Cabrat filluan rreth orës 9.00 të datës 7 maj. Nga ora 18.00, një turmë civilësh po linin zonën e luftimeve e po drejtoheshin në qendër të qytetit, kur forcat qeveritare i ndalën në urën e Taliçit-it. Burrat u ndanë nga gratë e fëmijët dhe u çuan në lagjen Mulla Jusuf, ku u ndanë në dy grupe dhe u ekzekutuan. Një banor i lagjes, i cili banon në rrugën "Zenel Lluzha", i tha Human Rights Watch:

> Unë nuk isha dëshmitar okular [i masakrës]. Isha brenda në shtëpi, kur dëgjova fillimisht hapat e grupit që po vinte dhe disa fjalë në gjuhën serbe. "Vihuni në rresht", thoshte një polic. Ai e përsëriti këtë disa herë. Ndërsa nga grupi nuk u dëgjua asnjë zë. Më pas u dëgjuan të shtëna. Ishin të shtëna armësh automatike, shumë të shkurtëra. Më pas, ata për t'u siguruar për rezultatin e masakrës, i dhanë nga një plumb të fundit secilës prej viktimave. Unë nuk e di se sa vetë ishin. Nga sa dëgjova, m'u duk se ishin dy ushtarë. Të nesërmen, unë pashë kufomat nga dritarja. Nuk munda të identifikoja asnjë syresh. Ishin njëmbëdhjetë kufoma, dhe njëri qëndroi gjallë edhe nja njëzet e katër orë të tjera, por pastaj vdiq. Ishin të gjithë burra. Kufomat qëndruan atje për nja dyzet orë, derisa policët erdhën dhe i morën me zetor me ndihmën e disa puntorëve të Cabratit. Dëgjova se një grup tjetër ish masakruar në rrugën aty pranë në të njëjtën kohë – nëntë vetë të vdekur dhe dy që kishin mundur të shpëtonin.[38]

Një tjetër, B.E., bënte pjesë në grupin e dytë të burrave që u morën në urën e Taliçit-it. Ai i tregoi Human Rights Watch se forcat e sigurimit ndanë mënjanë njëzet e gjashtë burra dhe i mbajtën për rreth njëzet minuta. Tre vetë të armatosur, dy prej të cilëve mbanin maska, bënin roje. Dymbëdhjetë burra, midis të cilëve edhe B.E.-ja, u çuan në një rrugë aty pranë, ku u ekzekutuan dy e nga dy. Ai tha:

> Dymbëdhjetë vetë nga ne i çuan tek rruga. Njëri prej tyre ishte i veshur me uniformë në ngjyrë të gjelbër, me një shenjë blu në supin e tij. Tjetri ishte me uniformë në ngjyrë blu. M'u dukën si vëllezër, pasi ngjanin shumë. Theksi i të folurës së tyre nuk ishte i ngjashëm me atë të serbëve të Gjakovës. Vetëm këta të dy ishin me ne.
>
> Na kërkuan dokumentat dhe pará. Pjesa më e madhe e grupit u dha dokumentat dhe paratë që kishin me vete. Njëri prej tyre, ai me uniformë blu, tha, "Le t'i japim fund kësaj pune, pasi grupi po pret." Tjetri donte të na spostonte pak më tutje dhe na urdhëroi të hapnim derën e një shtëpie. Ne ju bindëm, dhe dy prej nesh morën të futen brenda. Në këtë moment një djalë nga grupi ynë [Agim Efendia] tha "Mos e bëj këtë Dragan", pasi kish dëgjuar t'i përmendnin emrin. Ata i thanë, "Futu brenda", dhe e vranë. Në këtë moment, njëri prej grupit mundi t'ia mbathte.
>
> Agimi ishte ende gjallë, dhe Dragani tha "le të mos e lëmë të vuajë më shumë." Erdhi një tjetër nga ne që ish në kopësht, dhe ata i thanë atij e dy të tjerëve ta nxirrnin Agimin jashtë. Ai hyri brenda, ne dëgjuam të shtëna, dhe pritëm më kot; askush nuk doli më. Na urdhëruan të shkonim në kopësht dy e nga dy, dhe kështu i vranë. Mua dhe një djalë tjetër na lanë të fundit. Kur hyra në kopësht, pashë se të gjithë kishin vdekur. Ata na qëlluan edhe neve, pasi na thanë "kthehuni me fytyrë nga ana tjetër." Plumbat më zunë fillimisht në këmbë, pastaj në gjoks, në gishta, dhe dy plumba të tjerë përsëri në këmbë. Mora dymbëdhjetë plumba.
>
> Na kontrolluan se mos ish ndonjëri gjallë. Ndalën pranë meje – po më kontrollonin të fundit. Në atë çast mbajta frymëmarrjen dhe nuk bëra asnjë lëvizje. Ndjeva që po iknin e po thoshin se do të ekzekutonin të tjerë. Mbeta aty.[39]

B.E.-ja i tregoi Human Rights Watch vrajat e plagëve. Ai kish një që dukej si plagë plumbi në anën e djathtë të gjoksit, në gjurin e djathtë, në noçkën e këmbës së majtë dhe në gishtin e mesit të dorës së djathtë.

Dëshmitë e Faton Polloshkës nuk bien ndesh me historitë e treguara pak më sipër rreth masakrës së 7 majit. Pa ditur asgjë mbi çfarë u tha nga dy dëshmitarët, Polloshka i tha Human Rights Watch që brigada e tij e pastruesve të rrugëve hoqi dy grupe kufomash të burrave që "ishin ekzekutuar" më 7 maj në rrugën "Zenel Lluzha." Sipas Polloshkës, një grup përbëhej nga dymbëdhjetë kufoma dhe tjetri nga nëntë.[40] Diferenca midis dëshmisë së Polloshkës dhe dëshmisë së L.V.-së e B.E.-së për sa i takon numurit të viktimave është shumë e vogël, por dëshmia e Polloshkës përputhet në hollësi të tjera me atë që u tha nga dy të tjerët.

Më 7 maj, pati gjithashtu ekzekutime të personave të veçantë në zona të tjera të qytetit. Një grua, S.G., e cila banonte në rrugën "Masllan Shazivari" i tha Human Rights Watch që, më 7 maj nga ora 10.00, katër paraushtarakë hynë forcërisht në shtëpinë e saj dhe i vranë burrin, Ibrahimin. Ajo tha:

> U hapën dyert dhe hynë katër paraushtarakë. Erdhën nga shtëpia e fqinjit tonë. Aty për aty shtinë dy herë, njëherë në tavan, dhe herën tjetër në kuzhinë.... Ata kërkuan pará. Burri im u tha se nuk kishim pará. Ata e shtrinë në dysheme, ndërsa mua më thanë të dal jashtë. E vranë me tre plumba në shkallën e pestë të shkallares që të çonte në katin e dytë. Njëri prej plumbave e kish kapur në fytyrë. E kish mbuluar gjaku. Kur ata shtinë mbi të, unë isha në shkallaren e jashtme, disa hapa larg derës së shtëpisë. Kuptova se burri im kish vdekur, por ata nuk më lejuan mua të shkoja brenda.[41]

Human Rights Watch e vizitoi këtë shtëpi më 15 qershor 1999, dhe pa njollat e gjakut mbi shkallë, mu atje, ku sipas S.G.-së, ishte vrarë burri i saj. Sipas saj, pastruesit e rrugëve të Gjakovës e varrosën burrin e saj shtatë ditë më vonë në varrezat e qytetit – varri nr. 28.

Pas luftimeve në Cabrat, u ndaluan shumë burra e gra. Sipas Polloshkës dhe Këshillit Lokal për Mbrojtjen e Lirive e të Drejtave të Njeriut,[42] gratë u mbajtën për pak kohë në uzinën e elektromotorrëve të Gorenjës, në Gjakovë, dhe u lanë të lira. Burrat u mbajtën diku në periferi të qytetit, buzë rrugës Pejë-Gjakovë. Nja tridhjetë vetë u lanë të lirë pas gjashtë ditësh, por pjesa tjetër – numuri është i panjohur – u transferuan në burgun e Pejës.[43] Besohet se shumë prej tyre janë transferuar menjëherë në burgje të tjera të Serbisë, para se trupat e NATO-s të hynin në Kosovë

më 12 qershor. Ndërsa një pjesë e këtyre burrave figurojnë në listat zyrtare të të burgosurve (këto lista i ka qeveria serbe), të tjerët rezultojnë të humbur. Afro 1,200 burra të Gjakovës ishin të humbur deri një vit pas fundit të luftës.

Paraushtarakët hynë në pallatin e saj të banimit, ku gjendeshin afro 250 vetë, dhe abuzuan seksualisht me gjashtë vajza të reja.

Në maj të vitit 2000, 143 shqiptarë të Gjakovës u dënuan si grup nga një gjykatë serbe për kryerje të akteve terroriste. Avokatë e grupe të të drejtave të njeriut, siç është Qendra e Ligjit Humanitar, protestuan kundër mënyrës së zhvillimit të gjyqit dhe kundër dënimeve shumë të rënda. Më 23 prill të vitit 2001, Gjykata e Lartë Serbe, duke përmendur "dhunime themelore të proçedurave penale" dhe "dokumentim të gabuar e të paplotë të provave", i lëshuan të gjithë të pandehurit, duke i lënë në pritje të një rishikimi të akuzës nga ana e gjykatës së rrethit.[44]

Tërheqja

Një valë e fundit plaçkitjesh e djegjesh ndodhi në 10-12 qershor 1999, ndërsa forcat serbe e jugosllave po tërhiqeshin nga qyteti. Human Rights Watch konfirmoi disa tentativa përdhunimesh gjatë këtyre dy ditëve. Një dëshmitare i tregoi Human Rights Watch se si, më 12 qershor, paraushtarakët hynë në pallatin e saj të banimit, ku gjendeshin afro 250 vetë, dhe abuzuan seksualisht me gjashtë vajza të reja. Midis viktimave ish edhe motra e saj, e cila shpëtoi nga përdhunimi, pasi në atë moment ishte me menstruacione:

> Në orën 11.00 apo 11.30, ia behën gjashtë paraushtarakë me simbolin "ARKO" apo "ARKAN" [mbi uniformat e tyre]. Ata hynë në pallat. Fillimisht ata morën makinat tona, dhe me to shkuan në çdo banesë aty rrotull. Ishin rreth 250 vetë në pallatin tim. Ata morën nga çdo familje vajza të reja e të bukura. Unë isha së bashku me familjen e tim'eti. Pasi i dogjën shtëpinë, babai erdhi të strehohej në shtëpinë time. Ata i thanë babait t'u jepte të gjitha gjërat e çmuara që kishim, në mos, "unë do të marr vajzën tuaj." Ai [paraushtaraku] kish flokë të gjata të bëra bishtkali, një mitraloz të madh dhe një gjerdan me municion. Babai tha se nuk kish pará, dhe ata morën motrën time dhe

e çuan në një dhomë tjetër. Babai u tregoi një dokument, që tregonte se ai nuk mund të punonte, ndërsa ata e goditën. E çuan motrën në një dhomë tjetër të apartamentit, kyçën derën dhe i thanë asaj të zhvishej, "pasi ti ke fytyrën e dikujt që ka pará." Ajo është shtatëmbëdhjetë vjeç. Kur babai u ngrit në këmbë e tentoi të shkonte pas motrës, ata e goditën, ai u rrëzua dhe koka i ra mbi tavolinë. [Përpara kësaj], ata i dhanë babait një goditje të fortë në gjoks. Herën e dytë e goditën, kur ai shkoi të ndihmonte të bijën. Njëri prej tyre mori motrën, dhe dy të tjerë dolën jashtë me të. Dy të tjerë ishin në dhomë me ne. Babai u përpoq të ngrihej përsëri, dhe ata e qëlluan me grusht – ata kishin veshur doreza metalike. Ai u rrëzua dhe koka e tij u përplas në një tavolinë të vogël kafeje, me sipërfaqe xhami të trashë.

Mua më tha motra më pas çdo gjë lidhur me atë që i ndodhi, por edhe munda të dëgjoja, pasi vetëm një mur na ndante. Ajo dukej e zbehtë, dhe më pas i ra të fikët. Dukej sikur sapo kish riardhur në jetë pas vdekjes. Ajo qëndroi me ta dhjetë minuta, dhe mua m'u dukën si dhjetë ditë. Dëgjoja çfarë ndodhte nga muri, pasi muret ishin të hollë. U afrova tek dera, dhe dëgjova njërin prej tyre që i thosh, "ti je me menstruacione, dhe nuk vlen për asgjë." Dëgjova gjithashtu motrën që u përgjërohej, "Ju lutem, në keni perëndi e në keni motër a grua, mos më prekni."

Motra ime hoqi bluzën me mëngë të shkurtëra, por ata i thanë, "mos hiq atë, zhvishu nga mesi e poshtë." Ajo hoqi pantallonat e të mbathurat. Ishte me menstruacione. Ime'ëmë i binte derës e bërtiste "lëshojeni vajzën time." Ajo u dha atyre 100 DM – paratë e fundit që kish. Ndërsa i binte derës me forcë, ajo bërtiste, "unë kam 100 DM." Ata i thanë sime'motre, "ti je me menstruacione ….ti nuk vlen për ndonjë gjë. Dil jashtë." Motrës i ra të fikët, dhe për disa orë më pas, ajo nuk mund të fliste prej traumës e stresit.[45]

Përdhunimet në Gjakovë u konfirmuan edhe nga burime sekondare të besueshme. Dr. Sejfullah Hoxha, shef i Departamentit Gjinekologjik të Spitalit të Prishtinës, i tha Human Rights Watch se departamenti i tij kish trajtuar dy raste përdhunimesh gjatë luftës, njëra prej të cilave ishte nga Gjakova (tjetra ish nga Klina). Të dy gratë ishin përdhunuar nga më shumë se një njeri. Përdhunimet në Gjakovë, tha Dr. Hoxha, u bënë në rrugë midis 5 e 15 prillit.[46]

Abuzimet seksuale u dokumentuan gjithashtu nga një OJQ e besueshme shqiptare, Qendra e Këshillimit për Gratë e Vajzat, e cila

grumbulloi dëshmi të refugjateve gjatë luftës dhe dokumentoi njëzet e tetë raste përdhunimesh në Kosovë, si dhe disa raportime të pakonfirmuara mbi abuzime seksuale rrotull Gjakovës.[47]

Më 20 prill, NATO ngriti pretendimin se, sipas dëshmive të refugjatëve, forcat serbe kishin ngritur kampe të përdhunimit në hotelin "Karagac" të Pejës dhe në një bazë ushtarake pranë Gjakovës. As Human Rights Watch, as gazetarë të huaj nuk kanë mundur të konfirmojnë këto zëra, qoftë në Pejë, qoftë në Gjakovë. (shih Mars-Qershor 1999: Një panoramë e përgjithshme, seksioni mbi përdhunimet e abuzimet seksuale).

MEJA

Një prej masakrave më të mëdha në Kosovë u krye më 27 prill, në fshatin e vogël katolik të Mejës, i cili ndodhet disa kilometra në veriperëndim të Gjakovës. Numri i saktë i viktimave shqiptare mbetet ende i panjohur, ndonëse besohet se u vranë nja 300 burra, me moshë 14-60 vjeç. Vetëm pak kufoma janë zbuluar, por sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, deri më 15 maj të vitit 2000, mungonin 282 burra të Mejës të marrë nga forcat serbe.[50] Sipas shumë gjasave, masakra ishte një hakmarrje ndaj vrasjes në Mejë të pesë policëve serbë nga ana e UÇK-së, më 21 prill.

Human Rights Watch mori vesh për herë të parë për masakrën herët në mëngjesin e 28 prillit, ndërsa refugjatë të traumatizuar po hynin në Shqipëri nga pika e kalimit kufitar të Morinës.[51] Zetorat tërhiqnin rimorkio që mbanin sipër gra, fëmijë e të moshuar, të cilët treguan se si forcat serbe e jugosllave i kishin dëbuar më 27 prill nga fshatrat e tyre të Gjakovës, se si i kishin vendosur forcërisht në një kolonë që mori rrugën fillimisht drejt Mejës e më pas drejt pikës kufitare të Morinës në Shqipërinë veriore. Në Mejë, thanë ata, forcat policore e paraushtarake grabitën shumicën e shqiptarëve, mbajtën disa njerëz të cilët i zbrisnin nga zetorët e rimorkiot, dhe detyruan kolonën të vijonte rrugën drejt kufirit. Më vonë, po atë ditë, refugjatët që hynë në Shqipëri treguan që kishin parë burra në rresht përgjatë rrugës në Mejë. Në mbrëmje dhe gjatë ditëve të ardhshme, refugjatët thanë se kishin parë një numër të madh kufomash përgjatë rrugës në fshat.

Human Rights Watch vizitoi Mejën më 15 qershor, pasi NATO kish hyrë në Kosovë, dhe pa kufomat e dekompozuara të disa njerëzve,

dokumenta të djegur, dhe gjëra xhepi, të cilat sipas shumë gjasave u përkisnin viktimave që ishin vrarë aty, dhe gëzhoja plumbash. Një vizitë e dytë u bë më 25 qershor, duke bërë që numri gjithsej i intervistave lidhur me masakrën e Mejës të arrinte në më shumë se njëzet. Informacioni i marrë gjatë këtyre dy vizitave kishte të njëjtën përmbajtje që kishin patur edhe rrëfimet e refugjatëve dy muaj më parë.

Sipas të gjitha dëshmive rezultoi që herët në mëngjesin e 27 prillit, policia speciale serbe dhe njësi paraushtarakësh, së bashku me pjesëtarë të Ushtrisë Jugosllave, kish dëbuar në mënyrë sistematike të gjithë shqiptarët etnikë të fshatrave midis Gjakovës e Junikut – rajon ky që shtrihet përgjatë kufirit me Shqipërinë, dhe i njohur në gjuhën shqipe me emrin Reka e Keqe. Duke filluar rreth orës 6.00 të mëngjesit, forcat e sigurimit dëbuan me forcë banorët e fshatrave të mëposhtëm: Pecaj, Nivokaz, Dobrash, Sheremet, Jahoc, Ponashec, Rracaj, Ramoc, Madanaj, dhe Orize. Të gjithë dëshmitarët e intervistuar në këto fshatra, përfshirë edhe njerëz të tjerë nga zonat përreth që kishin kërkuar strehë gjatë muajit të shkuar, i thanë Human

Sende personale-çakmakë, kuti sigaresh, stilolapsa, një çels-në një fushë në Mejë, ku mendohet të jenë vrarë rreth 300 burra nga policia dhe paraushtarakët.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

Rights Watch që ushtarët dhe forcat speciale të policisë rrethuan fshatrat e tyre, grumbulluan banorët dhe i detyruan të merrnin rrugën që të çon në Gjakovë, disa në rimorkio të tërhequr nga zetorët dhe të tjerët në këmbë. Pas kësaj, një pjese të madhe të fshatrave iu vu flaka. Një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçare nga Dobrash i tregoi Human Rights Watch:

> Policët dhe ushtarët erdhën e na nxorën jashtë forcërisht. Ata u vunë flakën shtëpive. Ata kishin një spërkatës dhe një lloj pistolete që bënte flakë. Të gjithë banorët e Dobrashit e të fshatrave aty rrotull ikën nga shtëpitë e tyre. Ata mbajtën dy burra nga Dobrashi, Iber Hasanin dhe Avdul Avdulin [që të dy rreth të dyzet e pestave]. Policia na urdhëroi të largoheshim dhe ne dëgjuam të shtëna armësh automatike.[52]

Kjo dëshmi lidhur me atë që ndodhi në Dobrash, përfshirë edhe vrasjen e Iber Hasanit dhe të Avdul Avdulit, u konfirmua nga një intervistë e veçantë e një burri nga Sismani, i cili kish kërkuar strehë në Dobrash. Ai tha:

> Më 27 prill, rreth orës 6.30, ushtria, së bashku me policë e paraushtarakë, hynë në Dobrash. Iberi, unë e një djalë tjetër morëm rrugën për në pjesën e sipërme të fshatit, prej nga ku donim të iknim. Iberi tha, "Unë nuk mund të vij me ju, pasi kam frikë që do të më përdhunojnë vajzën time njëzet vjeçare, nëse nuk do të jem me të për ta marrë në mbrojtje." Kështu që ai u kthye në fshat. Unë dhe miku im qëndruam në mal të ndarë nga familjet tona. Familja ime më tregoi më pas, se ata kishin dëgjuar shumë të shtëna, kur ushtria hyri në fshat. Familja ime dhe familja e Iberit, së bashku me Avdul Avdulin, ikën nga shtëpia kuturu. Avduli dhe Iberi ishin ndarë nga familjet e tyre në rrugën e fshatit Dobrash, jo shujmë larg nga shtëpitë e tyre. Avduli vdiq pasi u godit me thikë, dhe më pas atij i gjymtuan trupin, ndërsa Iberin e vranë me një plumb në zemër. Unë i pashë kufomat më vonë. Familjet nuk i panë njerëzit e tyre të vrarë; serbët u kishin thënë atyre të iknin, e më pas i kishin vrarë.[53]

Një grua nëntëmbëdhjetë vjeçare nga fshati Orizë, babai i së cilës ishte rrëmbyer në Mejë pak më vonë, po atë ditë, i tha Human Rights Watch:

> Ne ishim në Ramoc atë mëngjes; nuk mund të qëndronim pranë Gjakovës, pasi rreziku ishte i madh. Një urdhër për të ikur erdhi në

> agim, nga ora 5.00. Policët na erdhën tek dera. Ata trokitën dhe thanë, "dilni nga shtëpia, sepse do ta djegim atë." M'u desh të ikja menjëherë me nënën time, me babain, dhe vëllain pesëmbëdhjetëvjeçar.[54]

Fshatarët e zonës u shtrënguan forcërisht të merrnin rrugën për në Mejë. Dëshmitë e tyre zbulojnë se si, në harkun e gjithë ditës, një numër i madh policësh e ushtarësh që ishin të pranishëm në një pikë kontrolli në qendrën e fshatit grabitën në mënyrë sistematike fshatarët e shpërngulur. Nuk u lanë gjë pa marrë. Një grua, tridhjetë e gjashtë vjeç, i tha Human Rights Watch:

> Kur ne arritëm në Mejë, serbët na ndaluan; donin pará e gjëra të çmuara. Kërcënuan fëmijët e mij, madje edhe një fëmijë kërthi. Ata kishin mjekra e kishin vënë maska. Morën gjerdanët, unazat, vëthët, kartat e identitetit, dhe së fundi, edhe çantat tona me plaçka. Na morën gjithçka që kishim me vete. Ata i hodhën plaçkat në një shkurrishtë. Na folën ashpër, dhe një grua e qëlluan me pëllëmbë.[55]

Një veprim ndjellakeq ishte ai kur forcat e sigurimit veçuan nga kolona qindra shqiptarë, dhe i morën me vete larg familjeve të tyre. Siç është bërë e njohur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 282 burrat e rrëmbyer në Mejë rezultonin të humbur deri më 15 maj të vitit 2000.[56] Një nëntëmbëdhjetë vjeçar, i cili arriti në Mejë midis orës 11.00 e 12.00 paradite, i përshkroi këtë skenë Human Rights Watch:

> Shumë njerëz ndiqnin kolonën me zetorët e tyre. Këmbësorët përgjithësisht u lejuan të kalonin, por një pjesë edhe u mbajtën. Ata [policët e paraushtarakët] ndalën zetorët dhe zunë të godisnin njerëzit me copa drush, duke thyer edhe xhamat e dritareve të zetorëve. Burrat, nja njëqind vetë, u ndaluan dhe u morën mënjanë tek një lëndinë afër rrugës. Policët çirreshin në drejtimin tonë, duke na urdhëruar të vazhdonim rrugën, dhe kështu ne lamë prapa krahëve nja njëqind burra. Nuk e dimë çfarë u bë me ta.

Një dëshmitare nga Nivokazi, e cila nuk e tregoi emrin e saj, tha se u nxorr jashtë fshatit Sheremet nga ora 8.00 e mëngjesit, më 27 prill, dhe së bashku me familjen e saj, arriti në Mejë me zetor nga ora 10.00 paradite. "Ata i zbritën burrat nga zetorët dhe i mbajtën", tha ajo. "Ishin rreth

dyzet vetë në zetorin tonë, dhe ata morën dymbëdhjetë burra. I mbajtën të gjithë burrat."[58] Një dëshmitare tjetër tha se burri i saj u zbrit nga qerrja, u bë bashkë me grupin e burrave në anë të rrugës, dhe të gjithë u detyruan të thërrisnin: "Rroftë Serbia! Rroftë Milosheviçi!"[59]

"Ishin rreth dyzet vetë në zetorin tonë, dhe ata morën dymbëdhjetë burra. I mbajtën të gjithë burrat."

Refugjatë të tjerë, të cilët udhëtuan në drejtim të Mejës atë ditë, konfirmuan që forcat e sigurimit zgjodhën nga kolona meshkuj të moshave 14-60 vjeç. Ray Wilkenson, një zëdhënës i UNHCR-së në Kukës, i cili ish në kufi, ndërsa refugjatët po hynin në Shqipëri, i tha Human Rights Watch që, në vlerësimin e tij, nja gjashtëdhjetë zetorë hynë në kufirin shqiptar më 28 prill, dhe "gjashtë vetë në shtatë" raportonin se disa burra ishin zbritur nga mjetet e tyre lëvizëse dhe ishin mbajtur.[60] Gazetarë, të cilët ishin në kufi në atë kohë i thanë Human Rights Watch që refugjatët thoshin në mënyrë të përsëritur, se të paktën nja njëqind burra ishin vrarë.

Refugjatët që kaluan nëpër Mejë midis orës 12.00 e 15.00 thanë se kishin parë një numër të madh shqiptarësh etnikë, ndoshta nja njëqind, të mbajtur nën ruajtje nga forcat e sigurimit. Një dëshmitar, një mësues tridhjetë e tetë vjeçar, i cili kaloi gjithashtu nëpër Mejë nga ora 13.00, i tha Human Rights Watch:

> Unë pashë një turmë të madhe njerëzish, të cilët ishin ndarë nga familjet e tyre: kishte burra të vjetër e të rinj. M'u dukën më shumë se 250 vetë. Ishin vënë të rrinin në gjunjë….paralel me rrugën në një pyll të vogël, rrëzë një kodre e cila ish nja tridhjetë metra larg rrugës. Ata ishin në qendrën e fshatit.[61]

Një dëshmitar tjetër, i cili ish në Mejë në të njëjtën kohë, u intervistua veç dhe konfirmoi të njëjtën gjë, duke shtuar se grupi i burrave ish vënë në gjunjë me duart e lidhura prapa shpinës dhe ish rrethuar nga ushtarët.[62]

Dëshmitarë të tjerë, të cilët ishin në Mejë në orët e para të pasditës, e rrëfyen këtë ngjarje, duke dhënë një pamje të ndryshme, sidomos përsa i takon numrit të të ndaluarve. Një grua dyzet vjeçare, e cila ish në Mejë rreth mesditës tha se ajo pa, "shtatëdhjetë burra apo më shumë" të ulur galiç me duart të lidhura prapa kokës, përgjatë një kanali që ecte paralel me rrugën. [63] Të gjithë dëshmitarët thanë se Meja ishte e mbushur me

policë e forca speciale të veshura respektivisht me uniforma në ngjyrë blu e të gjelbër. Shumë pjesëtarë të këtyre forcave kishin veshur maska të zeza skiatorësh, dhe të tjerë mbanin në kokë shami të kuqe, thanë ata. Disa raportuan se kishin parë shenja të kuqe dalluese në mëngët e ushtarëve, ku binte në sy shqiponja me dy koka, simboli i Jugosllavisë.

Disa refugjatë që kaluan nëpër Mejë atë pasdite thanë se kishin parë trupa njerëzish të vdekur pranë rrugës. Një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçare, e cila kaloi nëpër Mejë aty nga mesdita, pretendoi të kish parë nja pesëmbëdhjetë të vdekur në anën e djathtë të rrugës. Ajo i tha Human Rights Watch, "Në rrugë kishte njolla gjaku. Në anën e djathtë të rrugës ishin pesëmbëdhjetë burra. I numërova ata. Ishin të shtrirë me fytyrën poshtë, dhe pranë tyre dallohej gjaku i derdhur, ndërsa ata nuk bënin asnjë lëvizje."[64]

Një grua tjetër, që kish qënë në Mejë nga ora 13.00 tha:

> Ne pamë burra të rinj të vdekur, burra me duart e tyre të lidhura prapa kokës. Serbët na thoshin, "Shikoni çfarë u bëmë atyre. Dëshironi t'ju bëjmë të njëjtën gjë edhe juve?" Pashë shumë gjak të derdhur. Ishim të shock-uar, të traumatizuar. Ishin nja njëzet burra të rinj të vënë në një rresht çuditërisht të drejtë, të gjunjëzuar me fytyrat e ulura poshtë dhe me duart e lidhura prapa kokës. Serbët na thanë, "Shihni se ç'u kemi bërë këtyre burrave; na jepni paratë që keni me vete." Ishin në qendër të Mejës. Trupat ishin nja katër metra larg nga rruga, prapa disa kaçubave prej murrizi. Pashë disa njerëz të vdekur, të cilët ishin lënë ashtu kruspull; njerëz të tjerë na thanë se atyre u kishin marrë gjak.[65]

Refugjatët që kaluan nëpër Mejë në orët e vona të pasdites, thanë se kishin parë shumë kufoma të vdekurish në fshat. Një djalë tetëmbëdhjetë vjeçar dhe një vajzë nëntëmbëdhjetëvjeçare, u intervistuan së bashku, dhe thanë se kishin arritur në Mejë pasi kishin ecur më këmbë, rreth orës 17.30 dhe se kishin parë një kapicë të madhe kufomash nja tre metra larg rrugës që të çonte në qendrën e fshatit, në anën e djathtë të kësaj rruge. Trupat pa jetë, të hedhur e të plasur pa kujdes, zinin një sipërfaqe 4x4metra, dhe bënin një pirg më të lartë se një metër, thanë ata. Dëshmitarët pranuan se ishin shumë të terrorizuar dhe se ia kishin mbathur nga frika e policisë, gjë që i pengoi ata të krijonin një ide të saktë mbi numrin e të vdekurve. Duke bërë një llogari të njerëzve që rezultonin të humbur, ata mendonin se numri gjithsej i të vdekurve ishte nja treqind. Pesëmbëdhjetë burra të tjerë, thanë

ata, ishin ulur përtokë të mbështetur në pirgun e kufomave, ndërsa përballë kishin një grup të forcave të sigurimit.[66] Dëshmitarja femër tha:

> Ndërsa po ecnim nëpër Mejë, ne pamë nja 300 kufoma të bëra kapicë mbi njëri-tjetrin në një kullotë. Ishte një pirg i madh me kufoma të hedhura kuturu mbi njëra-tjetrën. Serbët nuk na lejuan të shihnim skenën; ata na thanë "shpejt, shpejt, shpejt."...
>
> Kufomat në Mejë ishin në një kullotë në të majtën tonë. Pirgu i kufomave kish përmasat e një tende të lartë pak më shumë se një metër, ku kufomat ishin kokë më kokë. Arrita të njoh dy burra të cilët ishin gjallë. Ishin nja pesëmbëdhjetë burra të tjerë të ulur e të mbështetur në pirgun e kufomave e përballë tyre qëndronin më këmbë serbët. Unë njoha Ramë Mehmetin dhe djalin e tij Mehmet Mehmetin.[67] Ata janë nga Brovina, por ne qëndruam së bashku me ta në një shtëpi të Ramocit. Ne ishim aty kur ata i zbritën nga zetori dhe i morën.[68]

Më 15 qershor, një i dërguar i Human Rights Watch inspektoi Mejën dhe

Kufoma e një shqiptari të vrarë më 27 maj 1999 nga forcat e sigurimit serb në Mejë.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

gjeti trupat e dekompozuar të shumë burrave. Trupat e dekompozuar ishin në anë të një fushe, pranë rrugës që të çon në Mejë. Një kufomë dhe gjysma e sipërme e një kufome tjetër u gjetën të paprishura në një anë të një përroske pranë fushës, nja tridhjetë metra larg rrugës. Dy kufoma të tjera ishin disa metra më tutje përroskës, dhe pjesa e poshtme e një kufome tjetër u gjet në fushë, po pranë përroskës. Të gjitha kufomat ishin në gjendjen e një degradimi të avancuar. Eshtrat e disa kufomave ishin të thyera, dhe gati të gjitha ishin pa kokë. Pranë njërës prej kufomave u gjetën copa të një lopate vozitjeje.

Një motiv i mundshëm i masakrës ishte pusia që UÇK-ja i bëri një makine të policisë një javë më parë.

Më pranë rrugës, përfaqësuesi i Human Rights Watch pa tre mullarë me kashtë e me pleh, poshtë të cilëve, sipas një fshatari, gjendeshin shumë kufoma. Fshatari deklaroi gjithashtu se kufomat e shumë burrave të vrarë në masakrën që u krye, ishin grumbulluar nga pastruesit e rrugëve, të cilët janë romë, gjë që përveç të tjerash kish ndodhur edhe në Gjakovë (shih seksionin mbi Gjakovën).[69]

Në fushë kishte pirgje dokumentash e mjetesh të tjera personale të djegura, si fjala bie paketa cigaresh, çelësa e fotografi familjare, të cilat sipas të gjitha gjasave u përkisnin atyre që ishin vrarë. Shumë gëzhoja ishin të shpërndara aty rrotull. U gjendën katër varre të hapur në një varrezë të vogël katolike në shpatin e një kodre, të cilat sipas një fshatari ishin varre të katër personave të vrarë gjatë masakrës.

Human Rights Watch shënoi emrat e dymbëdhjetë burrave, të cilët, sipas dëshmitarëve, u morën më 27 prill nga fshati i Mejës prej forcave të Sigurimit. Tetë prej tyre janë përfshirë në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq mbi të humburit qysh prej paraburgimit në Mejë më 27 prill. Në Mejë, fshatarët thanë gjithashtu se po atë ditë, ishin vrarë në fshat tetë burra. Emrat e këtyre të fundit janë në listën e të humburve të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, gjë që do të thotë se kufomat janë hequr nga vendi ku janë ekzekutuar.

Motivi: vrasja e pesë policëve

Një motiv i mundshëm i masakrës ishte pusia që UÇK-ja i bëri një makine të policisë një javë më parë, si pasojë e së cilës u vranë pesë policë. Dëshmitarë të shumtë të zonës aty rrotull i thanë Human Rights Watch që UÇK kish vrarë pesë policë, të cilët ishin brenda makinës

së tyre pranë qendrës së Mejës. Njëri prej policëve, Milutin Prasheviç, njihej nga shumë fshatarë të zonës.[70] Një fshatar nga Meja i tha Human Rights Watch:

> Të pestë [policët] u vranë, ndërsa ishin brenda një makine, një Opel Ascona në ngjyrë të kafenjtë. Pak minuta përpara se të vriteshin, ata erdhën tek ne, dhe na pyetën, "ku janë ata të UÇK-së?" Makinën e ngiste një polic shqiptar. Ata ikën dhe ne dëgjuam të shtëna me bazukë. Morëm vesh se polici shqiptar ishte nga Ratisi.[71]

Human Rights Watch e pa makinën, e cila ishte dëmtuar keqaz, të përmbysur në një anë të rrugës së fshatit, më 15 qershor 1999.

Burime të tjera përmendën gjithashtu vrasjen e policëve serbë. Marie Colvin, një reporter i gazetës londineze *Sunday Times*, dhe Ian Fisher i gazetës "New York Times", i thanë veç e veç Human Rights Watch se UÇK-ja u ish mburrur atyre lidhur me vrasjen në Mejë të një komandanti serb e të rojeve të tij të trupit, gjatë javës së tretë të prillit.[72] Fshatarët i treguan gjithashtu Jonathan Landay-it të periodikut "Christian Science Monitor" që sulmi në Mejë ishte "një hakmarrje për vrasjen e një oficeri të lartë të policisë, Milutin Prasheviç, dhe katër policëve të tjerë, nga ana e UÇK-së."[73]

Dhe me të vërtetë, në website-in e vet, Ministria Serbe e Punëve të Brendshme, përmendi emrat e tre policëve, të cilët u vranë në një "akt terrorist" në Mejë më 21 prill, përfshirë Prasheviçin, për të cilin ishte dhënë edhe fotografia. Lindur më 6 gusht 1968 në Vranic, Kosovë, Prasheviç -thuhej në website- punonte në polici qysh prej vitit 1990. Dy policët e tjerë të vrarë në Mejë, të cilët ishin identifikuar, quheshin Ljubograd Llazareviç, i lindur më 1 nëntor 1973, dhe Boban Llazoviç, lindur më 25 shkurt 1976. Ata punonin në polici respektivisht prej një e dy vitesh.

Autorët e krimeve

Dëshmitarët e intervistuar nga Human Rights Watch identifikuan disa prej policëve serbë, të cilët ishin në Mejë më 27 prill, ndonëse asnjë prej policëve nuk ish parë të kryente vrasje apo të bënte abuzime të

tjera. Tre vetë pretenduan se kishin parë një polic serb, të cilin ata e njihnin si "stari" (plakushi) në pikën e kontrollit, në ditën e masakrës; Dhe njëri prej këtyre dëshmitarëve besonte se emri i tij i vërtetë ish Milutin.[75] Një person tjetër, një fshatar nga rrethinat e Koronicës, i cili nuk ishte në Mejë, i tha Human Rights Watch që Stari ish një polic aktiv në zonë, dhe emri i tij ish Milutin Novakoviç.[76] Të tre dëshmitarët thanë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri se Stari, i cili punonte në Ponashevaç, ishte i gjatë, me një fytyrë të hajthme, me lëkurë të zeshkët, dhe me flokë të zinj. Ai është afërsisht dyzet vjeç dhe ka dy vëllezër. Një prej dëshmitarëve pretendoi që babai i Starit quhej Vuçko, dhe vëllai i tij Miladin, por kjo nuk u bë e mundur të konfirmohej.

Një dëshmitar identifikoi një polic tjetër, që ish në Mejë më 27 prill: një person që thirrej "Guta", i cili ish komandanti i policisë në fshatin Ponashevaç.[77] Fshatari nga Koronica i përmendur më sipër tha i intervistuar veç të tjerëve se Guta ishte komandanti i policisë së Ponashevaç-it. Emri i vërtetë i tij nuk dihet.

Përgjithësisht, dëshmitarët i përshkruan forcat serbe në pikën e kontrollit, si të veshur me uniforma në ngjyrë blu të errët apo të gjelbër. Disa prej tyre kishin maska të zeza, me të cilat mbulonin fytyrat e tyre, dhe disa të tjerë kishin shami të kuqe. Një grua përshkroi dy serbë, që rrëmbyen babanë e saj në pikën e kontrollit për armëmbajtje:

> Dy serbët mbanin maska të zeza, me të cilat mbulonin kokat e flokët e tyre; mund të shihje vetëm sytë e gojën e tyre. Ishte stili "ninxha". Kishin uniforma policie në ngjyrë blu të errët me shirita të kuq në krah, mu poshtë supeve. Më duket se i kishin në krahun e djathtë.[78]

Një grua tjetër, dyzet vjeç, dha këtë përshkrim:

> Serbët mbanin uniforma kamuflazhi, maska të zeza, doreza të zeza, dhe armë automatike. Mund të shihje veç gojën e dy sytë e tyre. Kishin shirita me ngjyra të flamurit serb, të cilët nuk ishin të qepur, por të varur. Disa prej tyre kishin kokën të mbuluar, disa të zbuluar. Disa të tjerë mbanin shami; nuk më kujtohet ngjyra. Disa kishin flokë të shkurtër, disa flokë të gjatë. Mbanin thika në duart e tyre: thika me teh të gjatë e të drejtë, të harkuara në njërin skaj, të gjera sa një krah

njeriu, dhe rreth 70 centimetra të gjatë....Ishte e frikshme t'i shihje. Ngisnin makina ushtarake, si dhe makina të vjedhura nga kosovarët.[79]

KORENICË

Në të njëjtën ditë që u krye masakra në Mejë, më 27 prill, forcat policore serbe dëbuan me dhunë banorët e fshatit fqinj, Korenicë. Korenica është një fshat pranë Gjakovës, me popullsi kryesisht katolike. Sipas fshatarëve, të paktën trembëdhjetë burra u vranë gjatë këtij aksioni dëbimi, dhe 120 të tjerë u rrëmbyen, dhe deri në gusht 1999, rezultonin të humbur.

Në qershor, ndërsa ktheheshin në Korenicë, fshatarët gjetën kufomat e trembëdhjetë burrave, dymbëdhjetë prej të cilëve pothuaj të djegura. Por një grup tjetër prej gjashtëdhjetë e shtatë vetësh nga Korenica rezultojnë të humbur, ashtu si edhe pesëdhjetë e tre fshatarë të tjerë nga zona përreth, të cilët ishin në Korenicë për të kërkuar strehë (njëzet e gjashtë prej tyre ishin nga Gushka, dhe njëzet e shtatë nga fshatrat e mëposhtëm: Duxhnje, Babai i Bokes, Brekoc, dhe Gjakovë.[80]

Përderisa asnjë dëshmitar okular nuk ka mbijetuar, mbetet e paqartë se çfarë ndodhi saktësisht me fshatarët e humbur apo se si trembëdhjetë burrat e Korenicës u vranë. Por, bazuar në intervistat e fshatarëve pasi u kthyen në qershor dhe në një inspektim të Human Rights Watch në Korenicë, mund të jepet një tabllo relativisht e qartë e dëbimit të dhunshëm dhe e ekzekutimeve masive nga ana e forcave serbe.

Sipas fshatarëve, forcat e sigurimit serb, fillimisht hynë në fshat më 4 prill. Pesë apo gjashtë policë, të drejtuar nga Aleksandër Micunoviç dhe Milutin Prasheviç (i cili u vra më pas në Mejë nga UÇK-ja – shih më sipër),urdhëruan të gjithë fshatarët të iknin nga Korenica, por pak më pas i lejuan ata të ktheheshin. Pas kësaj, fshati ishte i qetë deri më 27 prill, kur u kthye policia. Një fshatar, M.M., shpjegoi:

Fshatarët gjetën kufomat e trembëdhjetë burrave, dymbëdhjetë prej të cilëve pothuaj të djegura.

[Më 27 prill] në orën 6.00 ne dëgjuam të shtëna në krye të fshatit dhe pamë disa shtëpi në flakë. Në dy shtëpitë e para ishte qëlluar një nëntëdhjetë e gjashtë vjeçar, i cili më vonë u gjet i djegur – Kolë Palokaj. Ata [policët] vijuan të digjnin e të vrisnin deri në momentin që u afruan në qendër të fshatit. Unë isha në

> shtëpi me familjen time dhe me nja njëzet e pesë të shpërngulur nga fshatra të tjerë, gjithsej pesëdhjetë e tre vetë.[81]

Dëshmitari e familja e tij ikën nëpër fushën aty pranë dhe dolën në rrugë, dhe prej aty morën për në Mejë. Në Mejë, rreth orës 11.00, ata ndeshën në pikën e kontrollit të policisë, ku, sipas tyre, ata njohën disa policë të Gjakovës, ndonëse ata ishin të maskuar. Policët ndanë mënjanë dy vëllezër të familjes, me moshë tridhjetë e pesë e tridhjetë e gjashtë vjeç, si dhe katër burra nga Gushka, pesë burra nga Duxhnje, një burrë nga Brekoci, dhe dhjetë të tjerë nga Korenica. Deri në korrik, të gjithë këta rezultonin të humbur. Dëshmitari tha:

> Ata morën njëzet e dy burra, i detyruan të shtrihen barkas e të thërrasin "Serbia! Serbia! Sllobodani është prijësi ynë." Më pas, ata shtinë mbi kokat e tyre. Nuk pashë të vrisnin ndonjë, sepse ne na vunë të lëviznim në drejtim të Gjakovës.... Ne nuk kemi asnjë lajm nga asnjëri prej atyre njëzet e dy burrave.[82]

Një fshatar tjetër, Anton Dedaj, gjithashtu iku nga Korenica më 27 prill. Ai përshkroi skenën:

> Një numër i madh serbësh – ushtarë, policë e paraushtarakë – arritën në fshat me disa autobuzë, më 26 prill. Disa mbanin shami të kuqe në kokat e tyre apo të lidhura në krahë. Të nesërmen, herët në mëngjes, forcat serbe rrethuan zonën dhe filluan të digjnin shtëpitë. Një polic i zonës erdhi brenda në shtëpi [ku po rrija]; i zoti i shtëpisë e njohu atë dhe e ftoi për kafe. Polici tha. "tani, është tepër vonë për ju." Para se të vrisnin vëllain tim, i morën 9,00 DM.[83]

Një tjetër fshatar, Tom Dedaj, ishte në shtëpinë e tij, kur ia behën forcat serbe. Ai tha:

> Serbët, turlisoj serbësh, ushtarë, policë, policë të zonës, paraushtarakë, ia behën herët në mëngjes. Policët e zonës u dhanë informacion forcave të sigurimit. Pesë autobuzë të mbushur me serbë arritën në pjesën e sipërme të fshatit, dhe dy autobuzë të tjerë ishin pranë kësaj shtëpie. Kish shumë policë, një në çdo njëzet metra të rrugës, pothuaj në çdo qoshe. U rrethuan nja dhjetë fshatra. Ata na mashtruan; na thanë se

> po shkonin në Ponoshevac [një fshat fqinj]. Policët e zonës mbanin maska. Disa paraushtarakë mbanin pantallona të gjelbëra dhe bluza me mëngë të shkurtëra, me shami të kuqe të lidhur në krah.[84]

Tom Dedaj, së bashku me familjen, e lanë fshatin dhe ikën nëpër pyll. Atë mbrëmje, i tha ai Human Rights Watch, takoi Daniel Berishën, dyzet vjeç, një burrë tjetër nga Korenica, i cili ish goditur me armë atë mëngjes në noçkën e këmbës dhe në gju dhe ishte djegur në krahë. Berisha i tha Dedajt se policët e kishin kapur së bashku me katër meshkuj të tjerë të familjes së tij, dhe që të katër ishin vrarë në shtëpinë e Berishës. Ky i fundit mbijetoi për një trill të fatit dhe u zhduk në pyll.

Sipas Dedajt, Berisha i kish thënë atij, që forcat serbe arritën tek shtëpia e tij rreth orës 7.30, i nxorrën të gjithë njerëzit jashtë, dhe ndanë gratë e fëmijët nga burrat. Forcat serbe fillimisht ranë dakord të lejonin xhaxhain gjashtëdhjetë e tetë vjeçar të Berishës, Mark Berisha, që të ikte së bashku me gratë e fëmijët, dhe i thanë atij të merrte zetorin e të largohej. Kur ai u tha se nuk dinte të ngiste zetorin, ata e urdhëruan të kthehej në shtëpi e të ngjitej në katin e tretë, ku mbaheshin burra të tjerë.

Berisha i tha Dedajt se, kur burrat arritën në katin e tretë, ata filluan t'u luteshin serbëve për jetët e tyre. Një polic i zonës, për të cilin Berisha tha se quhej "Bajo", urdhëroi burrat të ktheheshin në shpinë, dhe më pas shtinë mbi ta nga një distancë shumë e afërt me një armë automatike. Dedaj, i cili rrëfente historinë e dëgjuar nga Berisha, tha:

> Serbët i vunë në rresht ata në katin e tretë. Xhaxhai i Danielit, së bashku me të tjerë, kërkuan njerëzillëk nga serbët. Ata u thanë "A jeni ju njerëz ashtu si edhe ne? A jeni ju humanë? Përse doni të na vrisni?" Ai bëri një lutje, dhe më pas bëri shenjën e kryqit. Bajo tha, "Eshtë shumë vonë tashmë për ju." Ai urdhëroi të ktheheshin me fytyrë nga ana tjetër, dhe qëlloi mbi ta nga afër me një armë automatike. Ata thanë, "Ju qifshim nënat, është vonë tashmë për ju."[85]

Berisha i tregoi Dedajt, që ai, pasi u godit dy herë në këmbën e tij, u rrëzua i pari, dhe u mbulua nga trupat e tjerë. Ai u shtir si i vdekur, ndërsa policët sollën batanije, të cilave u vunë flakën, dhe me to mbuluan trupat. Me t'u larguar policia, Berisha doli nga flakët, dhe ia mbathi në drejtim të pyllit, ku ai takoi Dedajn.

Të nesërmen, më 28 prill, Berisha u përpoq të ikte nga ky vend i fshehtë në pyll së bashku me fshatarë të tjerë, por u kap nga forcat e policisë së bashku me një burrë të quajtur Kolë Mërturi, me një grua e me disa fëmijë. Mërturi i tha më vonë Dedajt, që të gjithë këta, me përjashtim të Berishës, ishin lëshuar. Trupi pa jetë i Berishës u gjet të nesërmen nga një fshatar tjetër. Dedaj ndihmoi në varrimin e Berishës dhe i tha Human Rights Watch që, përveç plagëve të mëparshme, Berisha kish kaluar një natë të tërë në pyll dhe kish marrë edhe pesë plagë të tjera – dy në kokë e tri në gjoks. E varrosën në pyll, pranë vendit ku ish gjetur kufoma e tij.

Ai urdhëroi të ktheheshin me fytyrë nga ana tjetër, dhe qëlloi mbi ta nga afër me një armë automatike.

Më 16 qershor, një përfaqësues i Human Rights Watch inspektoi shtëpinë e Daniel Berishës, e cila ish plaçkitur e djegur. Në katin e tretë ishin kufomat tërësisht të djegura e me eshtra të thyera, dhe dukej se kishin qënë vetëm pesë vetë. Anton Dedaj, një kushuri i Tom Dedajt, i tha Human Rights Watch që trupat në shtëpi ishin të vëllait të tij Gjokë Dedaj, dyzet vjeç; xhaxhait të Gjokës e Antonit, Musa Dedaj, gjashtëdhjetë vjeç; djalit tetëmbëdhjetëvjeçar të Gjokës, Nikollë Dedaj; vëllait të të zotit të shtëpisë, Kolë Berisha, dyzet e tre vjeç; dhe xhaxhait të të zotit të shtëpisë, gjashtëdhjetë e tetë vjeçari Mark Berisha.

Pasi inspektoi të pesë trupat, përfaqësuesi i Human Rights Watch vizitoi shtëpitë më të djegura aty pranë, brenda të cilave u gjetën trupa, apo në një rast, copa të vogla eshtrash. Trupat ishin djegur, aq sa nuk njiheshin, por ishin të identifikueshëm nga të afërmit apo familjarët thjesht nga objektet personale të viktimave, si p.sh., gjyslykë, orë, gjerdanë, etj. Sipas Tom Dedajt, shtëpitë përmbanin:

- Shtëpia e parë – Gjergj Malan, pesëdhjetë e nëntë vjeç, dhe Pal Kabashin, dyzet e një vjeç;
- Shtëpia e dytë – Mire Palokajn, rreth dyzet e pesë vjeç (burri i së cilës, Musë Palokaj, rezulton u humbur);
- Shtëpia e tretë - Kolë Palokajn, tetëdhjetë vjeç, dhe Brahim Kamberin, rreth gjashtëdhjetë e shtatë vjeç.

Dedaj pretendoi gjithashtu se kish gjetur në pyllin aty pranë trupin e Dedë Sadriajt, një burrë me probleme psikike nga fshati i Nec-it, me moshë njëzet e tre vjeç.

Human Rights Watch vizitoi Korenicën për herë të dytë më 26 korrik,

ditën që fshatarët po bënin disa zhvarrime në varrezat e fshatit me ndihmën e italianëve të KFOR-it. Pasi një skuadër e minakërkuesve e deklaroi zonën të sigurt, fshatarët gjetën një kufomë, që ish mbështjellë me një batanije dhe ish varrosur. Sipas fshatarëve, banorë romë të zonës u kishin treguar atyre që kishin varrosur tridhjetë e katër vetë në Korenicë, aty nga 7 maji, dhe se më vonë, policia i kish zhvarrosur e i kish larguar në vend tjetër.

Human Rights Watch foli me një rom etnik, i cili tha se punonte si taksist për shërbimin funeral të shtetit. Ai tha:

> Isha i pranishëm, kur kufomat u gjetën dhe u varrosën. Çdo ditë ne gjenim disa trupa, pesë, gjashtë apo dhjetë. Duhej të vinin policët serbë për të na treguar se ku ishin kufomat. Kishte një procedurë shumë të saktë: policët fotografonin trupat, merrnin shënim emrin e të vdekurit, i vinin një numër kufomës, dhe e varrosnin së bashku me numrin. Ishin shumë të organizuar. Fotografonin, e nganjëherë i filmonin trupat, përpara se t'i varrosnin. Sektori im merrej me pastrimin e mirëmbajtjen e rrugëve, dhe na detyruan të bënim këtë punën tjetër. Na detyruan një javë pasi filloi bambardimi i NATO-s.
>
> Trupat që mund t'i identifikonim, i varrosnim në varrezat e fshatit të tyre. Trupa të tjerë që ishin pa kartë identiteti, i çonim në varrezat e këtij fshati [Korenicë]. Pashë shumë kufoma në Korenicë: një ditë ne gjetëm tetë [trupa] nën një urë, pranë rrjedhës së ujit. Janë rreth tridhjetë e pesë apo dyzet kufoma të varrosur në varrezat e Korenicës. Me përjashtim të një gruaje të moshuar, nuk kemi varrosur ndonjë grua tjetër. Trupat që kam parë unë, ishin të ekzekutuar me armë automatike. Ishte e tmershme t'i shihje ata. Njëherë, kam parë kufoma të djegura.[86]

Pikturë e gjetur në dyshemenë e shtëpisë të një familjeje katolike shqiptare në Koronicë, në të cilën u vranë pesë burra më 27 prill 1999.

© JOANNE MARINER / HUMAN RIGHTS WATCH

Dëshmi të fshatarëve të tjerë flasin gjithashtu për viktima të tjera në Korenicë. Një çift i martuar nga Shishman-i pranë Gjakovës, R.R. dhe S.R., i thanë Human Rights Watch që ata kaluan nëpër Korenicë më 27 prill. S.R. tha: "Pamë dymbëdhjetë trupa burrash të vdekur në Korenicë. Ishin të shtrirë përgjatë rrugës me duart e tyre të lidhur pas kokës. Ishte ora 13.00 apo 14.00 [më 27 prill].[87]



Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

7

KOMUNA E ISTOGUT

Istogu, krahasuar me komuna të tjera të Kosovës, ishte relativisht i qetë gjatë vitit 1998. Serbët përbënin 15%-20% të popullsisë së zonës, që arrinte në 50,000 banorë.

Tensioni u rrit në muajt e parë të vitit 1999, ndërkohë që UÇK-ja intensifikoi veprimtarinë e vet në Istog dhe policia serbe iu përgjigj në mënyrë të dhunshme. Gjatë bombardimeve të NATO-s, pati luftime të drejtëpërdrejta midis UÇK-së nga njëra anë dhe Ushtrisë Jugosllave e policisë serbe nga ana tjetër. Forcat paraushtarake ishin gjithashtu të pranishme në zonë. Sipas një inspektimi të UNHCR-së mbi gjendjen e shtëpive të banimit, rezultoi që nga 7,081 shtëpi të komunës së Istogut, 5,049 ishin ose të dëmtuara rëndë, ose krejt të shkatërruara, ndonëse nuk është e qartë se sa është pjesa e dëmit të shkaktuar nga bombardimet e NATO-s.[1]

Sipas OSCE-së, mijra shqiptarë etnikë të Istogut u dëbuan forcërisht nga shtëpitë e tyre dhe u drejtuan në fshatrat e Staradranit e Zabllaqit, të cilat ishin nën kontrollin e UÇK-së. Kur në muajin prill, UÇK-ja u tërhoq nga zona, forcat qeveritare grabitën e rrahën një numër të madh shqiptarësh, të cilët kishin shkuar në këto fshatra, si dhe kryen disa ekzekutime pa gjyq.[2]

Masakra e vetme e madhe në komunën e Istogut u krye në burgun e Dubravës, në lindje të qytezës së Istogut. Duke ju referuar veprimtarisë ushtarake të serbëve rrotull kësaj zone, NATO bombardoi burgun më 19 e 21 maj, duke vrarë nëntëmbëdhjetë të burgosur. Gjatë ditëve të mëvonshme, nëntëdhjetë e gjashtë të burgosur të tjerë u vranë nga forcat qeveritare.

Policët serbë në Istog ishin në varësinë e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Pejës (SUP), i cili mbulonte komunën e Pejës, Klinës e Istogut. Komandanti i SUP-it të Pejës gjatë luftës ishte kolonel Boro Vllahoviç.[3]

BURGU I DUBRAVËS

Një nga incidentet më të rënda të luftës ndodhi pra në burgun e Dubravës, qendra më e madhe e paraburgimit në Kosovë, ku pas bombardimit të NATO-s, të burgosurit u masakruan nga forcat e sigurimit. Ngaqë të gjithë ata që i shpëtuan masakrës u transferuan në burgjet e Serbisë, deri në momentin e përfundimit të luftës kur të burgosurit u liruan, nuk u gjendën dëshmi të besueshme.[4] Human Rights Watch foli veç e veç me dy të mbetur gjallë, të cilët dhanë dëshmitë e tyre mbi masakrën. Historitë e tyre përforcojnë dëshmi të tjera, të cilat janë shfaqur në shtypin shqiptar, serb e atë ndërkombëtar.[5]

Duke patur parasysh aktivitetin ushtarak serb e jugosllav në këtë zonë, NATO bombardoi burgun më 19 maj, e më pas më 21 maj, 1999, duke vrarë të paktën nëntëmbëdhjetë të burgosur shqiptarë dhe duke shkaktuar një kaos të madh në këtë qendër burgimi. Sipas qeverisë jugosllave, shumë të burgosur kërkuan të përfitonin nga kaosi dhe u përpoqën të arratiseshin nga burgu; rojet luftuan për të rivendosur rendin. Më 22 maj, oficerët e burgut urdhëruan rreth një mijë të burgosur të viheshin në rresht në oborrin e burgut. Pas pak minutash, mbi ta u shti nga muret e burgut dhe nga kullat e rojeve me mitralozë e granata, duke vrarë të paktën shtatëdhjetë vetë. Në njëzet e katër orët e mëpastajme, roje të burgut, policë specialë e ndoshta paraushtarakë sulmuan të burgosurit, të cilët ishin fshehur në ndërtesën, bodrumet e llagëmet e burgut, duke vrarë të paktën dymbëdhjetë vetë.

Nuk është tamam e qartë se sa të burgosur u vranë nga bombat e NATO-s dhe sa u vranë më pas nga rojet e burgut dhe nga forcat qeveritare. Po kështu nuk është e njohur në ç'masë të burgosurit tentuan arratisjen apo bënë rezistencë. Por dëshmitë e marra dhe hollësi të veçanta rreth kohës, vendit, etj, të bëra të ditura nga këto dëshmi, nuk lënë dyshim që forcat qeveritare serbe, e sipas disa gjasave edhe ato jugosllave, qëllimisht e pa asnjë shkak, vranë një numër të madh

shqiptarësh në burg, ndoshta më shumë se shtatëdhjetë, dhe plagosën shumë të tjerë. Qeveria jugosllave ngriti pretendimin se bombat e NATO-s vranë nëntëdhjetë e pesë të burgosur dhe plagosën 196 të tjerë.[6] NATO pranoi se kish bombarduar burgun, por asnjëherë nuk pohoi se kish shkaktuar të vdekur.

Burgu

I vendosur disa kilometra në lindje të Istogut, pranë kufirit me Maqedoninë, burgu i Dubravës kish tre pavione, secili prej të cilëve nxinte më shumë se një mijë të burgosur. Brenda mureve të kësaj qendre kish një vatër kulture, salla sportive, vatra shëndetësore dhe një hotel për vizitorët e burgut.

Pavarësisht nga ky komoditet i burgut, raportime të besueshme për tortura e abuzime dolën nga burgu i Dubravës gjatë vitit 1998 dhe muajve të parë të vitit 1999. Sipas OSBE-së, të paktën katër burra të burgosur vdiqën në duart e rojeve të burgut midis tetorit 1998 e marsit 1999. Avokatë mbrojtës raportuan për pamundësi kontaktesh me klientët e tyre në Dubravë, ndërsa Misioni i Verifikimit i OSBE-së në Kosovë nuk u lejua asnjëherë të hynte në burg.[7]

Ish të burgosur të burgut të Dubravës gjatë luftës, i thanë Human Rights Watch që, kur filloi bombardimi i NATO-s mbi Jugosllavi më 24 mars 1999, numri i tyre ishte 900-1,100, përfshirë nja tridhjetë serbë etnikë. Shumë të burgosur të tjerë u transferuan në Dubravë pas fillimit të bombardimeve ajrore. Një ish i burgosur, R.T., i transferuar në Dubravë më 30 prill, tha se rreth 165 shqiptarë etnikë nga Gjakova erdhën në Dubravë vetëm pak kohë pas kishte arritur ai vetë.[8] Kjo u konfirmua gjatë gjyqit të Nishit në Serbi, i cili u zhvillua gjatë muajit prill e maj të vitit 2000, ku u gjykuan 143 shqiptarë të arrestuar në Gjakovë në maj 1999. Këta të fundit ishin transferuar nga Gjakova në burgjet e Pejës, Lipjanit, e më në fund Dubravës.[9] Një ish i burgosur tjetër, Bajrush Xhemaili, erdhi në Dubravë nga burgu i Nishit më 29 prill.[10]

Bashkëvuajtës në burg thanë që Ukshin Hoti, një nga të burgosurit politikë më të spikatur të Kosovës, u lirua nga burgu i Dubravës në 16 maj 1999. Asknsh nuk e ka parë më atë që atëherë.

FOTO DHURUAR NGA SHUKRIE REXHA

Midis shqiptarëve etnikë në Dubravë ishte edhe njëri prej të burgosurve politikë më të famshëm të Kosovës, Ukshin Hoti, i cili ishte duke përfunduar vitin e fundit të dënimit me pesë vjet heqje lirie.[11] Tre dëshmitarë thanë se Hoti u lirua nga Dubrava më 16 maj, pasi dënimi i tij kish përfunduar. Vendndodhja e tij në ditët e sotme është megjithatë e panjohur, dhe shumë ish të burgosur e veprimtarë të të drejtave të njeriut kanë frikë se ai është i vdekur.

Autoritetet e burgut pretenduan që shumë prej të burgosurve shqiptarë në Dubravë ishin pjesëtarë të UÇK-së, përfshirë edhe njëmbëdhjetë komandantë.[12] Në nëntor 1999, Human Rights Watch intervistoi dy shqiptarë, të cilët kishin qënë në Dubravë gjatë bombardimeve të NATO-s, dhe që të dy pranuan se kishin qënë pjesëtarë të UÇK-së, por nuk dihet nëse pretendimi qeveritar është i vërtetë edhe për të burgosurit e tjerë.

Një prej ish të burgosurve, i cili foli me Human Rights Watch, A.K., (inicialet janë tjetër për tjetër) [13] tha se në mars 1999 ishin rreth 1,100 të burgosur në Dubravë. Ndërsa më përpara trajtimi në Dubravë ishte përgjithësisht i pranueshëm, tha ai, me të filluar bombardimet e NATO-s, rojet e burgut i rrihnin çdo ditë të burgosurit.[14]

Dëshmia e A.K.-së rreth ngjarjeve në burg përputhet plotësisht me çfarë i tha Human Rights Watch një tjetër dëshmitar, B.K. (inicialet janë të ndryshuara), i cili, ashtu si A.K., po vuante një dënim një vjeçar për "veprimtari terroriste antishtetërore."[15] Siç u deklarua më sipër, këta dy dëshmitarë thanë gjëra pak a shumë të njëjta me çfarë u tha nga katër dëshmitarë të tjerë, thëniet e të cilëve u botuan në shtypin shqiptar, serb e atë ndërkombëtar, duke na dhënë kështu një tablo të qartë e koherente të ngjarjeve në burgun e Dubravës në periudhën midis 19 majit e 25 majit.

Bombardimi i NATO-s

Sipas të gjithë dëshmitarëve, si dhe nga burimet e qeverisë jugosllave e të NATO-s, avionët e NATO-s bombarduan për herë të parë e pa paralajmërim burgun e Dubravës më 19 maj. B.K., i cili mbahej në pavionin C, i tha Human Rights Watch se mbi ndërtesën e burgut ranë katër bomba, dy prej të cilave në pavjonin C, një në pavjonin ngjitur dhe një tjetër në ndërtesën e drejtorisë së burgut. Ai tha:

> Kur bombardimi reshti, ne thirrëm rojet të hapnin dyert, por ata ia kishin mbathur. Kur pamë që ata kishin ikur, ne filluam të shpërthenim dyert. Kjo punë na mori nja një orë e gjysëm. Në pavjonin tonë vdiqën tre vetë dhe u plagosën pesëmbëdhjetë të tjerë. Serbët dërguan tre prej të plagosurve në Pejë. Ne dolëm jashtë, në një oborr të burgut. Ata erdhën pas dy orësh të merrnin kufomat.[16]

Zëdhënësi i NATO-s e pranoi bombardimin dhe tha se Dubrava ishte një "kamp stërvitjeje ushtarake."

A.K. pretendoi se katër apo pesë të burgosur u vranë në pavjonin B e C, dhe se disa të tjerë u qëlluan, ndërsa ata rravgonin në sheshin e burgut. Të dy ish të burgosurit, të intervistuar veç e veç, thanë se, me t'u mbledhur në oborr, të burgosurit u përpoqën të merreshin vesh me avionët e NATO-s që fluturonin mbi kokat e tyre, duke improvizuar me llampushka të ndezura fluoreshente fjalën "HELP".

Në Bruksel, zëdhënësi i NATO-s e pranoi bombardimin dhe tha se Dubrava ishte një "kamp stërvitjeje ushtarake." Në një konferencë për shtypin më 20 maj, major gjeneral Walter Jertz shpjegoi:

> Ajo [Dubrava] është një objektiv i rëndësishëm ushtarak; ne e dimë se ajo është një kompleks i sigurimit ushtarak, dhe ky objektiv është sulmuar nga që ishte një objektiv legjitim ushtarak dhe ne nuk kemi të dhëna që goditjet ranë në ndonjë vend tjetër apo që pilotët kanë gabuar shenjestrën. Mund të shtoj se ne përdorëm bomba me precision të lartë, dhe për ta thënë përmbledhtazi, ishte një kompleks i sigurimit ushtarak, një objektiv legjitim ushtarak.[17]

Sipas Ministrisë Jugosllave të Punëve të Jashtme, NATO bombardoi forcat e Ushtrisë Jugosllave e të Policisë Serbe në afërsi të burgut në orën 13.15, më 19 maj, duke vrarë tre civilë. Sipas raportimeve, tri bomba goditën burgun, duke vrarë dy të burgosur e një roje.[18]

A.K. e B.K., si dhe katër të burgosurit e tjerë, intervistat e të cilëve u botuan në shtyp, thanë që të gjithë se të burgosurit, i kaluan dy netët e mëpasshme duke fjetur jashtë, por gjithsesi brenda mureve të burgut. Më pas, më 21 maj, rojet e burgut urdhëruan të burgosurit të viheshin në rresht në oborr. Ndërsa ata ishin të grumbulluar, filloi një valë e dytë e bombardimeve të NATO-s. B.K. i tha Human Rights Watch:

> Më 21 maj, ata na vunë përsëri në rresht në oborr. Ishim të rrethuar nga strukturat policore të burgut. Rojet nuk shtinë mbi ne. Ne ishim ulur mbi bar, dhe ishim rreth nëntëqind vetë. Ata na thanë, "mos u trembni, NATO nuk do të bombardojë." Rreth orës 10.00 apo 11.00, avionët nisën të fluturonin. Predha e parë ra në kuzhinë. Të tjerat ranë aty pranë. Njëra prej tyre ra brenda mureve, mu afër nesh. Gjashtëmbëdhjetë vetë u vranë kur një masë dheu e gjerë nja pesë metra u bë copë-copë ngjitur me ne. Midis të vdekurve ishin: Fadil Bezeraj nga Rasiqi, Naim Kurmehaj nga Srellca e Epërme, Ali Kelmendi nga Kosoriqi, Çaush Ahmeti nga Sheremetaj dhe Mete Osmajaj nga Isniqi.
>
> Ata [NATO] bombarduan tri herë. Ne mbetëm të shtrirë atje gjithë ditën e ditës. Kur rojet ndjenë ardhjen e avionëve, ata ikën nga burgu. Mbetëm në oborr deri në orën 12.00, dhe vetëm atëherë u tërhoqëm nja treqind metra më tutje, gjithsesi brenda oborrit, ku kish më pak ndërtesa.... Nga ora 14.00, na u afruan nja katër roje të armatosura. Menduam se erdhën për të na vrarë, por avionët u dëgjuan përsëri, dhe ata ia mbathën andej nga erdhën. Ne fjetëm aty mbi bar atë natë...[19]

Bombardimi mbi Dubravë më 21 maj u konfirmua nga gazetarët perëndimorë, të cilët ishin shoqëruar për në burg nga autoritetet serbe po atë ditë, gjoja për të parë dëmet e bombardimit të NATO-s më 19 maj. Jacky Rowland, një korrespondent i BBC-së, përpara se të ikte nga burgu, ngaqë vazhdonin bombardimet e NATO-s, pa disa prej kufomave që kish shkaktuar bombardimi i 19 majit. Ai shkroi në gazetën *Scotland on Sunday*:

> Ne u endëm nëpër barin e oborrit të burgut, duke u ndalur pranë kufomave të mbuluara me batanije. Njëri ishte akoma gjallë, dhe trupi i tij i spërkatur nga gjaku mblidhej nga dhimbjet. Më pas, ne dëgjuam zhurmën e avionëve mbi kokat tona: bombarduesit ishin kthyer. Duhej të iknim. Ndërsa i dhamë gaz makinës së ndotur nga balta, bombat e para ranë mbi ndërtesën e burgut. Tri prej këtyre bombave ranë njëra pas tjetrës.[20]

Paul Watson i gazetës *Los Angeles Times*, i cili pjesën më të madhe të

luftës e kaloi brenda në Kosovë, ishte gjithashtu në Dubravë atë ditë. "Të paktën nëntë kufoma ishin të shpërndara mbi sipërfaqen e barit e nëpër shkurre", shkruajti ai. "Të gjithë kishin koka të rruara, gjë që tregonte se ishin të burgosur." Ai vazhdoi:

> Gjatë dy orëve para sulmit të mëngjesit [më 21 maj], i cili përfundoi në orën 10.20, dy shpërthime çanë pjesën e jashtëme të murit dhe lanë dy kratere të gjera në të dy anët e murit. Rojet e nervozuara jugosllave, të cilët po përpiqeshin të mbanin të burgosurit të mbyllur në oborr, s'ka gjë se sulmi vazhdonte, thanë se avionët e NATO-s po përpiqeshin të ndihmonin ikjen nga burgu të luftëtarëve të UÇK-së. Ishin të sigurtë mbi këtë synim të NATO-s.[21]

Watson citoi një person, Aleksandër Rakoceviç, të cilin e identifikoi si drejtor burgu: "Të burgosurit janë ende brenda mureve, dhe nuk mund t'i çojmë nëpër qeli, sepse NATO po bombardon gjithë ndërtesën.... Ndoshta një pjesë e tyre tashmë mund të kenë ikur, sepse muri është hapur në disa vende."[22]

Një artikull i agjencisë *Associated Press* nuk dha një dëshmi të besueshme të bombardimit të 21 majit, por pohoi se reporterët e saj "panë shtatë kufoma të gjakosura të mbuluara me batanije në oborrin me bar të burgut, ndërtesën e dëmtuar në disa vende, dhe rojet e armatosur e nervozë me armë automatike që përpiqeshin të frikësonin të burgosurit."[23]

Ashtu si edhe në rastin e bombardimit të parë të Dubravës, NATO e pranoi përsëri bombardimin e burgut, dhe pretendoi se ishte një objektiv legjitim ushtarak. Më 22 maj në mëngjes, në një njoftim të shkurtër, zëdhënësi i NATO-s Jamie Shea tha:

> Siç e dini tashmë, në Istog, Kosovë, forcat e NATO-s sulmuan një zonë të gazermave, e cila ish përdorur për një kohë të gjatë nga Ushtria Jugosllave dhe nga forcat e policisë speciale të MUP-it, si pjesë e operacioneve kundër UÇK-së dhe kundër civilëve kosovarë. Kjo zonë gjendet pranë një burgu, por unë dua të theksoj, ashtu siç bëra edhe dje, që fjala është për një zonë ushtarake. Burgu është pjesë e kësaj zone, por përbën vetëm një pjesë të vogël të një kompleksi të madh ushtarak.[24]

Gazetarët e huaj, të cilët vizituan Dubravën më 21 maj, nuk panë ndonjë veprimtari ushtarake në zonë, gjë që s'do të thotë megjithatë se trupat e paisjet ushtarake nuk ishin në afërsi të burgut, në kohën kur ndodhi bombardimi. Paul Watson shkroi që shtypi "nuk vuri re gjurmë të makinave apo paisjeve të rënda ushtarake aty rrotull, ndonëse ishte e vështirë të konfirmoje çfarë kish patur aty gjatë sulmeve të mëparshme."[25]

Disa nga ish të burgosurit pretenduan se, ndërsa NATO bombardonte, kishin parë veprimin e artilerisë kundërajrore, e cila ish instaluar diku afër burgut. Sipas një artikulli në gjuhën serbe të agjencisë së lajmeve *Beta*, ish i burgosuri Bajrush Xhemaili pretendoi të kish parë "kundërveprime konstante të artilerisë kundërajrore të instaluar në afërsi të burgut."[26] Ahmet Ahmeti, i cili i dha një intervistë të përditshmes në gjuhën serbe *Danas*, tha se në afërsi të burgut ishte instaluar një sistem i mbrojtjes ajrore.[27]

Qeveria jugosllave pretendoi që vala e dytë e sulmit ajror të NATO-s kish shkaktuar viktima të tjera civile. Më 21 maj, agjencia shtetërore e lajmeve *Tanjug* raportoi se si pasojë e sulmit të 21 majit ishin vrarë të paktën nëntëmbëdhjetë të burgosur dhe ishin plagosur dhjetë të tjerë, përfshirë edhe zëvendësdrejtorin Nexhmedin Kaliçanaj, dyzet e një vjeç. Këto ishin viktima të tjera, thosh raporti, që u shtoheshin dy të burgosurve të vrarë si pasojë e bombardimit të 19 majit.[28] Të nesërmen *Tanjug*-u raportoi se ishin vrarë rojet dhe nëntëmbëdhjetë të burgosur, si dhe ishin plagosur më shumë se dhjetë vetë.[29] Një raport tjetër i *Tanjug*-ut, po atë ditë, pretendoi se ishin vrarë "dhjetra të burgosur dhe rojet e burgut."[30]

Masakra

Të nesërmen e valës së dytë të bombardimit, më 22 maj, sipas të gjithë dëshmive që janë marrë, rojet e burgut urdhëruan të gjithë të burgosurit të grumbulloheshin në oborrin kryesor të burgut. B.K. shpjegoi atë që ndodhi më pas:

> Në mëngjesin e 22 majit, në orën 5.40, ne dëgjuam një zë nga megafoni i kullës së rojes. Një prej komandantëve thosh, "Vihuni në rresht pasi, për t'ju siguruar, duam t'ju transferojmë në Nish." Na vunë në rresht.

> Nga ora 6.10, na thanë se kishim dhjetë minuta kohë për t'u vënë në rresht. Rreshti nuk ishte një rresht i rregullt, por ishte i gjatë rreth 200 metra. Pas pak sekondash, ndërsa ne ishim 20-25 metra larg murit, ata hodhën tri apo katër granata dore. Në të njëjtën kohë, filluan të shtinin me predha granatëlëshuese, dhe me snajpera. Kush mundi, nuk kish ç'të bënte tjetër, veç të shtrihej prë tokë.[31]

Ata kishin predha dore granatëlëshuese, pushkë snaiperash, mitralozë, AK47-a, granata dore dhe mortaja. Na qëlluan nga të gjitha anët. Plumbat e bombat binin kudo e njerëzit hidheshin në erë.

A.K. tregoi një histori të ngjashme:

> Na thanë të viheshim në rresht në një fushë futbolli të shtruar me çimento dhe të rrethuar nga kullat e rojes. Nja njëqind vetë ishin në një rresht të vetëm. Qëndruam atje nja dhjetë minuta, derisa u vumë të gjithë në rresht. Më pas, një djalë i quajtur " Ace" hipi në një prej kullave dhe dha urdhër për të qëlluar. Ne pamë gjithçka në momentin e parë. Për rreth njëzet minuta u qëllua pa pushim nga sipër mureve pesë metra të lartë – ishte gjithçka e përgatitur. Ata kishin predha dore granatëlëshuese, pushkë snaiperash, mitralozë, AK47-a, granata dore dhe mortaja. Na qëlluan nga të gjitha anët. Plumbat e bombat binin kudo e njerëzit hidheshin në erë.[32]

Në një intervistë dhënë agjencisë së lajmeve *Beta*, Bajrush Xhemaili shpjegoi versionin e tij të sulmit të 22 majit: "Forcat serbe hapën zjarr nga kullat e vrojtimit të vendosura në pjesën veriore e perëndimore të mureve të burgut. Shtinë me pushkë snaiperash, armë automatike, hedhësa granadash që mbaheshin e komandoheshin në dorë. Sulmi zgjati gati tridhjetë minuta."[34]

U bë rrëmujë, dhe të burgosurit u përpoqën të gjenin strehë ku të mundnin në ndërtesat e ndryshme të kompleksit të burgut, në bodrume, apo në sistemin e llagëmeve. B.K. tha:

> Unë dhe një grup njerëzish ishim afër murit dhe ndjemë se ata po mbushnin armët. Unë thirra "O burra, mbathjani!" Kush deshi e mundi, zuri të vrapojë. Ne shkuam në bodrume, nëpër puseta, në kaldajë, në pavjone apo prapa ndonjë murane. Ata vazhduan të

shtinin. Në çdo kullë vrojtimi kish snaipera e armë automatike. Ata shtinë për rreth dhjetë-pesëmbëdhjetë minuta papushim.

Ne e kthyem prapa tek fusha në mes të ndërtesës për t'u marrë me të plagosurit. Pas një ore, po verifikonim kush kish vdekur. Ata ishin ende aty, por nuk shtinë më. Llogaritëm rreth nëntëdhjetë e shtatë të vdekur. Midis tyre ishin: Sahit Ibrahimi nga Kotradiçi, Agim Elshani nga Klina, Zahir Agushi, Iber Gergoci dhe Zeke Hasan Metaj nga Strellci. I bëmë bashkë të vdekurit dhe ashtu i mbuluam me batanije. Shkruajtëm në copa letre emrat e atyre që njohëm dhe ua ngjitëm në rrobat e tyre. Pas kësaj kërkuam ushqim për veten. U futëm në klinikën mjekësore për të marrë çfarë na lipsej në atë moment.[35]

A.K. shpjegoi:

Njerëzit morën vrapin. Ngaqë burgu është shumë i madh, ka shumë skuta ku të fshihesh. Hapëm grilën e një dritareje dhe kërcyem brenda nja pesë a dhjetë vetë.... U drejtuam tek ndërtesat e shkatërruara

Dyshekë të përgjakur të gjetur në burgun e Dubravës pas luftës. NATO bombardoi godinën më 19 dhe 21 maj 1999 ku, duke cituar veprimtarinë ushtarake në zonë, u vranë rreth nëntëmbëdhjetë të burgosur. Në ditët që pasuan forcat serbe vranë jo më pak se nëntëdhjetë e gjashtë të burgosur.

FOTO ALBAN BUJARI

dhe rrëmbyem gjëra e mjete për të mbrojtur veten. Që nga momenti që NATO goditi kuzhinën, kjo e fundit ishte lënë ashtu, dhe ne morëm ushqim e gatuam çfarë mundëm për vete.[36]

Nga njëzet e dy vetë të fshehur në qendrën kulturore, u vranë nëntë, një nga një.

Atë mbrëmje, thanë dëshmitarët, një grup i përbërë nga policë specialë e paraushtarakë hynë në burg e kërkuan të merrnin kontrollin e tij. Ky aksion zgjati rreth njëzet minuta, në harkun e të cilave u hodhën granata dore në ndërtesën e shkollës së burgut, duke vrarë të paktën dy vetë. Të burgosurit mbetën të fshehur gjatë gjithë natës, dhe një pjesë e tyre u përgatitën të mbroheshin me mjete rrethanore, me copëra orendish apo me vegla të kopështit.[37] B.K. tha:

Rreth orës 17.00 apo 18.00, disa paraushtarakë hynë në burg. Ata shkatërruan shkollën e burgut. Atë natë ata vranë gjithkënd që panë në llagëmet e burgut. Gjashtë deri në dymbëdhjetë vetë ishin fshehur në to. Ata hapën kapakët e pusetave dhe shtinë mbi ta.

Unë isha në pavjonin C. Të tjerë ishin në bodrumin e kuzhinës. Ne bëmë si bëmë atë natë, dhe shpëtuam. Morëm lopata, dërrasa, gjithçka mundëm, madje edhe këmbëza mobiljesh. Përgatitëm plaçka e rraqe, dhe unë mbusha dy bidona të mëdhenj me ujë. Kishim të plagosur në bodrumin e pavjonit tonë. Ishin rreth 120 a 150 të plagosur.

Atë natë, një person, njëzet e pesë vjeç, vari veten me litar. Një tjetër u gjet duke u varur në shkollë. Më 23 maj, rreth orës 5.00, ata filluan të shtinin e të hidhnin bomba. Nga njëzet e dy vetë të fshehur në qendrën kulturore, u vranë nëntë, një nga një. Zef Keqirajn nga Zhub-i e pa i vëllai tek e vranë. Kabeshi nga Zahaqi u vra gjithashtu.

A.K. shpjegoi çfarë ndodhi të nesërmen në mëngjes, rreth orës 6.00, kur hyri në burg një grup tjetër i forcave speciale. Ai i tha Human Rights Watch:

Ne ishim fshehur në bodrume e në dhoma të vogla, dhe nuk dinim në donin të na vrisnin apo të na merrnin prej aty. Unë pashë “Grga”-n, “Mladja”-n, dhe disa të tjerë nga Peja. Kur na zunë, na tërhoqën zvarrë nga flokët e na goditën në kokë. Së bashku me tetëmbëdhjetë të tjerë, isha prapa një tubi të sistemit të ngrohjes në bodrum. Ishim

> të fshehur. Fibra e xhamtë që mbështillte tubin na gërvishti e na bëri gjithë plagë. Njëzet e tetë vetë të tjerë erdhën, por nuk mundën të futeshin, pasi nuk kish vend. Në këtë moment forcat serbe na panë e na rrethuan. I pashë ata tek vinin me mitralozë, me thika të mëdha në duar, me të cilat qëlluan e goditën të njëzet e tetë personat që donin të futeshin në bodrum. Copra njerëzish e kufomash na u shfaqën përpara syve. Ata bënë një plojë të vërtetë. Në atë vend u vranë të njëzet e tetë personat, përfshirë: Zef Kqira, Lush Prelazi, Nikollë Bibaj, Jonuz Krasniqi dhe Arsim Krasniqi.

Naser Husaj, një i burgosur në Dubravë, i cili i rrëfeu historinë e tij "New York Times"-it, tha se ai, së bashku me një grup tjetër njerëzish, e kaloi natën i fshehur në lavanderi, poshtë kafenesë. Ai shpjegoi se policia e sulmoi ndërtesën në mëngjes me "predha granatëhedhëse, dhe shtinë nëpërmjet dritareve drejt e në bodrum." [38] Ndërsa bëri një vizitë në vend më 7 dhjetor, së bashku me Husajn, gazetarja e "Times"-it, Carlotta Gall, vuri re grahmat e vdekjes "që mbretëronin." Ajo shkroi:

> Dyshemeja me linoleum të gjelbër është ende me njolla gjaku, të cilat, në përpjekje për t'u fshirë e pastruar, janë hapur gjithandej. Zoti Husaj lëvizte i shpenguar nëpër terr, gjë që demonstronte familjaritet me dhomat e nëndheshme. Por edhe ai, zuri hundë e gojë me duar, ndërsa tregoi vendin ku ai kish parë gjashtë vetë të vrarë në një korridor.[39]

Një i burgosur tjetër, Remzi Tetrica, i tregoi historinë e tij të përditshmes kosovare *Kosova Sot*. Lidhur me sulmin në mëngjesin e 23 majit, ai tha:

> Më 23 maj, në orët e para të mëngjesit, paraushtarakët kryen një masakër. Ne u sulmuam përsëri me të njëjtin arsenal armësh, bash si një ditë më parë. Ata vranë shumë të burgosur nëpër qeli, në bodrume, në dhoma, ku t'i gjenin. Plagosën gjithashtu shumë të tjerë. Unë u plagosa nga një bombë dore. Po atë ditë, u vra Xhemail Alimani.... Personalisht di se janë vrarë 108 vetë dhe janë plagosur nëntëdhjetë e tetë të tjerë.[40]

Pak më vonë, po në mëngjes, forcat e sigurimit rimorën kontrollin mbi

burgun, dhe nxorrën një ultimatum për të burgosurit, me anë të të cilit u kërkonin atyre të dilnin nga ku ishin fshehur brenda pesëmbëdhjetë minutash. Duke mos patur zgjidhje tjetër, të burgosurit dolën, dhe u mblodhën në sallën e sportit të burgut, e cila ishte ende e padëmtuar. Sipas dëshmitarëve, ushtarët e Ushtrisë Jugosllave ishin të pranishëm në atë moment, dhe demonstruan një sjellje më miqësore me të burgosurit, duke u dhënë atyre cigare në emër të "Miki"-t – ky i fundit u identifikua nga dy të intervistuar si drejtori i burgut, ndonëse ata nuk e njihnin emrin e tij të plotë e të vërtetë. A.K. pretendoi që njohu një polic nga Peja me nofkën "Bata."

Të plagosurit u morën me makina dhe u hoqën prej aty, ndërsa të burgosurit që mbetën u transportuan me dhjetë autobuzë për në burgun e Lipjanit në Kosovën jugqëndrore. A.K. dhe Bajrush Xhemaili thanë se të sapoarriturve në burgun e Lipjanit u duhej të ecnin midis dy kordonave me policë, që mbanin në duar bastuna dhe shufra metalike, me të cilat godisnin mbi të burgosurit që kalonin mes tyre.[41]

Në mëngjesin e dhjetë qershorit, pasi NATO e Ushtria Jugosllave kishin nënshkruar Marrëveshjen Tenike Ushtarake, e cila i dha fund luftës, të gjithë të burgosurit shqiptarë në burgun e Lipjanit u transferuan në burgje të tjerë të Serbisë, si në Sremska Mitrovica, Nish, Prokuplje, apo Pozarevaç. Sipas Qendrës së Ligjit Humanitar me seli në Beograd, në tetor 1999, të burgosurit e plagosur të Dubravës u mbajtën në burgjet e Sremska Mitrovicës, Zabelës e Nishit.[42]

Human Rights Watch intervistoi lidhur me transferimin tre të burgosur të tjerë, të cilët në atë kohë kishin qënë në burgun e Lipjanit, dhe dy burra që kishin qënë në Dubravë. Të gjithë thanë se të burgosurit i kishin duart të lidhura dhe kështu u transferuan me autobuzë jashtë Kosovës. B.K. tha:

> Më 9 qershor, ata na zgjuan nga gjumi në orën 22.00. Na lidhën me litar dhe na vendosën në grupe prej pesëdhjetë vetësh. Ne nuk mund të uleshim. Ata filluan të tërhiqen e të qëllojnë në ajër. Kishim frikë se do të na vrisnin. Më 10 qershor, nga ora 6.00 deri në orën 12.00 na mbajtën pa bukë e pa ujë. Na futën në autobus me kokat e ulura poshtë. Gjysma jonë ishin në hapësirat midis sediljeve. Bënte ftohtë. Kush lëvizte, hante ndonjë goditje kokës. Me ne, në çdo autobus ishte një shofer e dy policë. E kuptuam se policët e ushtarët serbë po

> tërhiqeshin nga Kosova. Arritëm në Nish, ku qëndruam gati një orë brenda në autobus. Na zgjidhën duart e na rrasën në burg.[43]

Në burgun e Nishit u ndalën edhe të burgosur të tjerë, por pak më vonë ata u morën përsëri dhe u çuan gjetkë. B.Z., një djalë tetëmbëdhjetë vjeçar, i cili nuk kish qënë në burg në Dubravë, i tha Human Rights Watch:

> Më 10 qershor ne na nxorrën jashtë nga burgu i Lipjanit. Fillimisht na thanë se do të shkonim në Nish. Pastaj na thanë se atje nuk kish vend, kështu që ndërruam autobus, dhe u nisëm në një drejtim tjetër. Unë isha në autobuzin e parë me duart e lidhura prapa. Autobuzi ishte plot. Na çuan në Sremska Mitrovica. Ishim rreth 300 vetë.[44]

Të gjithë ish të burgosurit e intervistuar nga Human Rights Watch ishin liruar midis shtatorit e dhjetorit 1999, ngaqë në përgjithësi dënimi i tyre kish përfunduar. Por deri në prill 2001, të paktën shtatëdhjetë shqiptarë të Kosovës ishin ende në burgjet serbe, dhe midis tyre ishin edhe disa që kishin mbetur gjallë nga masakra e Dubravës. (Shih seksionin mbi të Burgosurit Shqiptarë të Kosovës në Serbi pas 12 qershorit 1999).

Numri i saktë i të burgosurve, rojeve e policëve të vrarë në Dubravë nga bombardimi i NATO-s mbetet i panjohur. Pasi raportoi fillimisht se më 21 maj ishin vrarë të paktën nëntëmbëdhjetë të burgosur, shifrat e qeverisë jugosllave zunë të rriteshin në harkun e katër ditëve, por pa thënë megjithatë se kish patur të vrarë ndër të burgosurit që donin të arratiseshin apo nga përplasjet midis të burgosurve e rojeve. Përkundrazi, autoritetet serbe i lidhën vdekjet me bombardimin, por shifrat e raportimi nuk përputhen aspak me dëshmitë e marra nga shqiptarët e mbetur gjallë. Një raportim i *Tanjug*-ut më 25 maj 1999 thosh se "në bombardimin disaditor të Institutit të Riedukimit në Istog, vdiqën 100 të burgosur dhe u plagosën 200 të tjerë."[45] Më 27 maj, "*Tanjug*"-u citonte Vlladan Bojiç, një hetues të gjykatës së rrethit të Pejës, i cili thosh se nëntëdhjetë e gjashtë kufoma ishin nxjerrë nga

Deri në prill 2001, të paktën shtatëdhjetë shqiptarë të Kosovës ishin ende në burgjet serbe, dhe midis tyre ishin edhe disa që kishin mbetur gjallë nga masakra e Dubravës.

gërmadhat dhe se dyzet të plagosur ishin në një gjendje shëndetësore kritike.[46] Më 29 maj, qeveria jugosllave deklaroi që "numri i viktimave në Institutin e Riedukimit të Istogut po rritet. Nga 196 të plagosur nga bombardimi i këtij Instituti, vdiqën tre persona të tjerë dhe u gjetën shtatë vetë nën gërmadha, ndërsa kërkimi i të vdekurve vazhdon."[47] Më 30 maj, *Tanjug*-u raportoi që u gjetën shtatë kufoma nën gërmadha, dhe numri i të vdekurve gjithsej shkon në nëntëdhjetë e tre.[48] Shifrat e fundit të qeverisë jugosllave u publikuan në një raport të muajit korrik të Ministrisë së Punëve të Jashtme i titulluar "Krimet e NATO-s në Jugosllavi: të dhëna dokumentare, 25 prill-10 qershor 1999." Raporti thosh se bombat e NATO-s kishin vrarë nëntëdhjetë të burgosur dhe kishin plagosur 196.

Me qëllim që të ndërtonin një kauzë të tyre mbi faktin, që të gjithë të burgosurit ishin vrarë nga bombat e NATO-s, autoritetet serbe shoqëruan përsëri më 24 maj një grup gazetarësh të huaj në burgun e Dubravës. Duke raportuar për BBC-në, Jacky Rowland tha se burgu ishte goditur edhe njëherë që nga vizita e parë e gazetarëve më 21 maj. Ajo raportoi se "një ndërtesë vazhdonte të digjej akoma, ndërsa dhoma e ngrënies dhe një numër i madh qelish ishin të dëmtuara rëndë."[50] Sidoqoftë, nuk ish shumë e qartë për Rowland-in se si kishin vdekur viktimat në burg:

> Duke vëzhguar çdo qoshe të burgut, ne numëruam dyzet e katër kufoma, gjysma e të cilave dukej se ishin viktima të bombardimit të parë të ditës së premte [19 maj], dhe ata ishin ende të shtrirë në bar të mbuluar me batanije. Më tej, ne na çuan në një nga dhomat e një blloku qelish, ku gjetëm njëzet e pesë kufoma. Dukej se viktimat ishin shqiptarë etnikë, disa prej të cilëve kishin koka të qethura, dhe disa të tjerë kishin flokë të gjatë. Një çift kufomash kishin pantallonat e tyre të zbathura deri tek gjunjtë. Ne na thanë se ata kishin vdekur midis së premtes e së shtunës, ndonëse nuk ish shumë e qartë se si ata kishin gjetur vdekjen apo se si u gjetën të gjithë në një dhomë relativisht të padëmtuar.

Një reporter tjetër, i cili vizitoi burgun më 24 maj, Daniel Williams i *Washington Post*-it, hodhi dyshimin gjithashtu mbi versionin qeveritar të vdekjeve:

> Këtë herë, versioni zyrtar, sipas të cilit ishin bombat e NATO-s ato që shkaktuan viktimat, nuk përputhej me atë që reporterët panë në realitet, ku njëzet e pesë shqiptarë të vrarë ishin në mes të sheshit. Kufomat ishin bërë kapicë në një sallë pushimi ngjitur me klinikën. Duke përjashtuar një dhomë ngrënieje, e cila ishte shndërruar në gërmadhë, nuk dukej ndonjë dëmtim tjetër prej bombash në brendësi të burgut, dhe asnjë prej të vdekurve të fundit nuk të jepte përshtypjen se kish humbur jetën nga ndonjë bombardim. Asnjë kufomë nuk ishte e mbuluar nga pluhuri që mbulonte dyshemenë e dhomës së ngrënies.[51]

Williams-i vizitoi Dubravën përsëri më 12 qershor, pasi trupat e NATO-s kishin hyrë në Kosovë. Ai shkroi:

> Me t'u futur brenda, nuk na u desh shumë kohë për të kuptuar se gjëra të rënda kishin ndodhur – gjëra që s'kishin asnjë lidhje me bombardimin. Tek klinika, ku ishin të shtrirë njëzet e pesë kufoma, gjendeshin dyshekë e jastëkë të vënë në rresht e që zinin gjysmën e sallës, gjë që unë nuk e kisha vënë re më parë. Disa kishin vrima plumbash dhe gjak të tharë nëpër jastëkë, në vendin ku normalisht mbështetet koka. Vëreheshin vrimat e plumbave dhe stërpika gjaku nëpër mure. Në një qoshe të një zyre gjendej e varur një kopje e betimit të Hipokratit.
>
> Në një bllok qelish, vrimat e plumbave kishin dëmtuar muret e brendshëm dhe vëreheshin njolla gjaku nëpër dyshekë. Në fund të pjesës së rrethuar, pirgje me tesha ishin hedhur mbi pleh bagëtish. E përsëri, mure me shenja plumbash. Dyshekë e tesha ishin hedhur nëpër gropat e pusetave të hapura.[52]

Duke vizituar burgun në fillim të nëntorit me ish të burgosurin Naser Husaj, Carlotta Gall e *New York Times*-it pa prova që flisnin për ekzekutimin e njerëzve brenda ndërtesave e bodrumeve të burgut. Ajo shkroi:

> Dhe në bodrumet e ndërtesave, gjaku është ende në dysheme, vrimat e plumbave kanë gjurmët e tyre në mure, dhe gropëzat e shpërthimit të granatave duken qartë në dysheme.... Në bodrumin e një qendre kulturore, nën tubat e sistemit të ngrohjes dhe makineritë e larjes

industriale, gjetëm të shpërndara mjete vdekjeprurëse: lopata, copa metalike të mprehta, hunj dhe copa tubash metalikë, të mbështjella me rrecka, në mënyrë që të mbërtheheshin më mirë nga një dorë njeriu. Stërkala gjaku të tharë janë ende në dysheme dhe në plaçkat e hedhura. Dy gropëza të bëra nga granatat e dorës janë të dukshme në dysheme.[53]

Zhvarrosjet

Më 13 gusht, një skuadër ekspertësh ligjorë të Spanjës filloi të zhvarrosë trupa në nëntëdhjetë e shtatë varre, që u gjetën jashtë fshatit Rakosh, pranë burgut të Dubravës.[54] Një këshilltar ligjor i Gjykatës për Krimet e Luftës mbi ish-Jugosllavinë, Karl Koenig, pretendoi që trupat ngjanin "të ishin aty që nga 26 apo 27 maj." Të gjitha varret kishin të njëjtin shënim përsipër, "KPD", gjë që në serbisht do të thotë Kaznevo Popravni Dom; thënë në shqip, kompleksi i riedukimit penal. Në raportin e vet të 10 dhjetorit të vitit 1999, i cili u paraqit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, kryeprokurorja e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës Carla Del Ponte tha se nëntëdhjetë e shtatë kufoma ishin gjetur në afërsi të fshatit Rakosh, ndonëse nuk u dhanë hollësi mbi shkakun e vdekjes së tyre.

Autorët e krimeve

Mbetet ende e paqartë se kush kishte përgjegjësi të drejtëpërdrejtë në masakrën e Dubravës. Sidoqoftë, nga disa dëshmi të njerëzve e të shtypit, është hapur sadopak rruga drejt së vërtetës.

Sipas një artikulli të *Washington Post*-it, Ministri i atëhershëm i Drejtësisë serbe Dragoljub Jankoviç, pretendoi që "njerëzit e tij" nuk kishin përgjegjësi për atë që kish ndodhur në Dubravë midis 19 e 25 majit, duke dashur të nënkuptojë me "njerëzit e mij" Ministrinë Serbe të Drejtësisë. Artikulli tha se "Ai [Jankoviçi] nuk e di çfarë ndodhi gjatë bombardimeve, dhe lë të kuptohet që, nëse ka ndodhur ndonjë krim, ai është kryer prej të tjerëve – policisë speciale, paraushtarakëve – të cilët duhen ngarkuar me përgjegjësi."[56]

Gazetari Paul Watson, i cili e vizitoi Dubravën më 19 dhe 21 maj, citoi një zyrtar të burgut, Aleksandër Rakoceviç, të cilin e identifikoi me drejtorin e burgut. Ish të burgosurit i thanë Human Rights Watch se ata njihnin disa pjesëtarë të personelit të sigurimit të burgut, ndonëse ata nuk njihnin emrat e tyre të plotë. Të dy ish të burgosurit që folën me Human Rights Watch thanë se drejtori i burgut njihej me emrin "Miki", dhe ish një burrë me lëkurë të zeshkët, i cili fliste një shqipe të shkëlqyer. Sipas A.K., zëvendës drejtori njihej me emrin "Ace", dhe ai ish një prej atyre që dhanë urdhër të hapej zjarr mbi grumbullin e të burgosurve më 22 maj. A.K. e B.K. pretenduan të njëjtën fakt, sipas të cilit, pas bombardimit të NATO-s më 19 maj, rojet e burgut kishin liruar e armatosur disa të burgosur serbë. Të dy dëshmitarët thanë se ata panë disa prej tyre të ktheheshin në qeli e të sulmonin shqiptarët, me të cilët kishin qënë si të burgosur deri në atë moment.

Së fundi, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pretenduar se është në zotërim të informaciove të tjera lidhur me masakrën e Dubravës. Në një

Nëntëdhjetë e shtatë varre jashtë fshatit Rako pranë burgut të Dubravës ku besohet se janë varrosur trupat e të burgosurve të vrarë fillimisht nga bombardimet e NATO-s dhe më pas nga forcat serbe të cilat sulmuan ndërtesën. "NN"do të thotë "emër i panjohur" dhe "KND" "Kazneno Popravni Dom (kompleksi i riedukimit penal)

© BENJAMIN WARD/HUMAN RIGHTS WATCH

intervistë me Human Rights Watch, zëdhënësi i UÇK-së Faton Mehmeti Ramusij tha se UÇK-ja disponon dokumenta të policisë serbe, të cilat e trajtojnë masakrën si rezultat të bombardimit të NATO-s. Emrat e katër policëve, të cilët thuhet se hartuan raportin iu dhanë Human Rights Watch, ndonëse dokumenti origjinal nuk u pa.[58]


VERIU
Vushtrri
Vushtrri
Skanderaj
Sitnice
Obiliq
Obiliq
Gllogofc
Prishtina
Prishtina
Fushe Kosovë
Fushe Kosovë
Lumi i Gracanicës
Gllogofc
Sitnice
Hallac i Vogel
Lipjan
Lipjan
Rrëzar i Vogel
Slivovë
Gjilan
Shtime
Shtime
Ferizaj
Ferizaj
Suhareke
Viti
0 km 5
JUGOSLLAVI
Lipjan
KOSOVA
SHQIPERI
MAQEDONI
Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

8

KOMUNA E LIPJANIT

Komuna e Lipjanit ndodhet në Kosovën qendrore. Rruga kryesore që lidh Prishtinën me Shkupin, kalon fare pranë qytetit të Lipjanit, që është edhe kryeqendra e komunës. Krejt ndryshe nga komunat fqinje si ajo e Gllogovacit dhe e Shtimljes, përgjatë vitit 1998, Lipjani nuk do të ishte në qendër të veprimtarisë së UÇK-së apo të operacioneve represive të forcave serbe të sigurimit, ndoshta nisur edhe nga fakti se është e përbërë nga popullsi etnikisht e përzjerë, gjë që konsiston në një numër të madh serbësh, si dhe në një popullsi të konsiderueshme kroatësh etnikë dhe rromësh. E megjithatë, pothuajse menjëherë pasi nisën sulmet ajrore të NATO-s, trupat ushtarake dhe policore serbe zunë të hynin e të sulmonin fshatrat e banuara nga shqiptarë etnikë, duke i shtrënguar banorët e tyre të shpërnguleshin drejt zonave fqinje. Shpërnguljet në masë do të pasoheshin nga zjarrvënie dhe plaçkitje të shtëpive dhe pronave të shqiptarëve në atë komunë. Edhe pse Lipljani nuk do të përjetonte gjith'ato masakra ashtu siç pësuan në Gllogovac apo Suharekë, në mes të prillit, në tri fshatra të kësaj komune – Sllovi, Ribar i Vogël dhe Hallac i Vogël, do të ndodhnin një numër i madh vrasjesh. Bie fjala, në Sllovi, më 15 dhe 16 prill do të vriteshin të paktën tridhjetë e pesë njerëz. Së fundi, javën e mbrame të prillit dhe javën e parë të majit të vitit 1999, mijëra banorë të krahinës së Lipjanit do të hipeshin me përdhunë nëpër trena dhe dëboheshin në drejtim të Maqedonisë, ndërkohë që pjesa tjetër do të merrte rrugën e Shqipërisë.

Pavarësisht nga fakti se komuna e Lipjanit nuk ishte një nga qendrat e veprimtarisë së UÇK-së, në periudhën ndërmjet marsit dhe qershorit të vitit 1999 mbi të do të përqëndrohej në mënyrë të konsiderueshme vëmendja e forcave serbe të sigurimit. Mëse tridhjetë dëshmitarë nga kjo

krahinë të intervistuar nga Human Rights Watch do të dëftonin rreth sulmeve të kryera kundër një numri të madh fshatrash, ndonëse disa fshatra do të kurseheshin dhe nuk do të bëheshin objekt i mësymjeve të drejtpërdrejta. Mesa duket objektivi i sulmeve ka pasë qenë përqëndrimi i popullsisë në një zonë të vogël, para se të dëboheshin më pas nga Kosova. Në fund të marsit, fill pasi kishin nisur sulmet ajrore të NATO-s do të ndërmerreshin një sërë ofensivash. Mësymjet e mëpasme, ato gjatë muajit prill, synonin të mbanin larg nga vatrat e tyre fshatarët që u orvatën të ktheheshin, teksa masakrat e kryera në një sërë fshatrash shërbenin për të terrorizuar banorët e komunave e kësisoj t'ia mbathnin për në Maqedoni.

Pak ditë pasi kishin nisur sulmet ajrore të NATO-s, shqiptarët që banonin në qytetin e Lipjanit do të shtrëngoheshin të braktisnin shtëpitë si pasojë e djegies së banesave dhe kontrolleve derë më derë nga forcat policore serbe, ndërsa në mënyrë të tërthortë ata i druheshin përqëndrimit në shkallë të madhe të forcave serbe të sigurimit brenda në qytet, menjëherë pas largimit të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë. Tridhjetë e tre vjeçari A. L. banor i Lipjanit do ta përshkruante kësisoj klimën e frikës që sundonte në qytet dhe që e shtrëngoi atë dhe familjen e tij të largohej nga qyteti:

> Unë jetoja në një ndërtesë në qendër (të qytetit). Më 23 mars më shumë se njëqind policë kishin zënë vend në zyrat e administratës për bujqësinë, jo më larg se katër metra nga banesa (apartamenti) jonë. Të mërkurën, më datë 24 mars, u ndjemë të frikësuar kur pamë lëvizje të shumta të forcave policore dhe atyre ushtarake, përpara ndërtesës. Aty nga ora 3 mbasdite u shtrënguam (nga frika) të merrnim fëmijët dhe të shkonim në shtëpinë e nipit tim që banon në rrethinat, rreth 300 metra larg qytetit. Aty qëndruam dy ditë. Më 28 mars, rreth orës 9 të darkës, në qytet nisën të shtënat dhe djegiet e shtëpive të shqiptarëve. Shtëpitë e djegura nisën t'i qasen gjithnjë e më pranë asaj tonës. Rreth orës 10 të darkës pamë nga dritarja (e shtëpisë) shtatë oficerë policie që ndodheshin jo më shumë se pesë metra larg. Për fatin tonë të mirë... ata u drejtuan nga shtëpia e fqinjit që ishte e zbrazur. Për tri minuta, gjithë sa ishim në shtëpi, shtatëmbëdhjetë frymë, u larguam. Me fëmijët në krah, i ramë mes për mes një fushe të baltosur dhe shkuam në një fshat që ndodhej dy kilometra më larg. Kur mbërritëm në fshatin Banulle ishte ora 1 e mëngjesit.[1]

A. I. dhe familja e tij e lanë Banullen më 8 prill dhe morën për në drejtim të Llugagjit, një fshat shtatë kilometra më në jug, i cili shërbeu gjatë kohës së luftës si strehë për shumë familje të shpërngulura nga komuna. Aty do të qëndronin disa javë, para se të ktheheshin në Lipjan më 24 prill. Rrugës së kthimit për në Lipjan, A. I. tok me familjen e tij do të kalonin edhe një javë tjetër në shtëpinë e nipit, para se të largoheshin për në Maqedoni. Javën e fundit të prillit një pjesë e mirë e banorëve të Banulles u larguan në drejtim të Maqedonisë, pas një ultimatumi që policia iu kishte drejtuar banorëve të fshatit "që të dorëzonin të gjitha armët", si dhe pasi policia dhe trupat paraushtarake kishin djegur e plaçkitur një pjesë të shtëpive të fshatit.[2] Të intervistuar nga OSBE-ja, banorët e Lipjanit do të përshkruanin të njëtin kuadër të aksioneve të policisë dhe zjarrvënieve në qytet në fund të marsit, si dhe të dëbimeve të banorëve shqiptarë.[3]

Ata zunë të shtinin me pushkë automatike dhe armë kundërajrore. Kishim vetëm pesë minuta që të linim fshatin.

Fshatrat në lindje të Lipjanit do të bëheshin objekt i operacioneve që ndërmerreshin nga Babushi, një fshat serb që ndodhej në pjesën më veriore të komunës së Ferizajt. Fshati fqinj Babush i Muhaxheres në jug të Lipjanit, i banuar kryesisht nga shqiptarë etnikë, do të bëhej objekt i sulmeve të forcave serbe me armë automatike dhe granata, po atë mbrëmje që nisën sulmet ajrore të NATO-s, duke shkaktuar braktisjen e fshatit nga banorët. Disa javë më pas, teksa disa nga banorët ishin kthyer, fshati do të sulmohej sërish me armë automatike. Ndonëse fillimisht banorët ishin shpërngulur në Gadimen e Epërme, një fshat aty pranë, i cili gjithashtu kishte pasë qenë sulmuar, pak ditë pasi kishin nisur sulmet ajrore, banorët e Babush i Muhaxheres gjetën më në fund strehë në fshatin e Llugagjisë, që ndryshe nga pjesa më e madhe e fshatrave të zonës aty rreth e qark, nuk para ishte trazuar.[4] S. S. një burrë tridhjetë e gjashtë vjeç do t'ia përshkruante kështu Human Rights Watch atë çka kish përjetuar:

> Ditën e parë të sulmeve ajrore ndjeheshim fort të kënaqur, por ndërsa sulmet ajrore filluan në orën 8 të darkës, në mesnatë ranë mbi fshatin tonë granatat e para që vinin nga Babushi i serbëve, që ndodhet dy kilometra larg. Banorët janë të gjithë serb – ata ishin fqinjët tanë … Deri atë mëngjes kur pamë krateret dhe e kuptuam që predhat kishin

> ardhur nga Babushi. Të gjithë ata që kishin fëmijë të mitur i shpunë fshatra të tjerë. Të mitë i shpura në Gadime. Ishte dita e dytë e sulmeve ajrore (25 mars) … Afro dhjetë ditë apo dy javë pasi (kishin nisur) bombardimet e NATO-s, kur u kthyem në shtëpitë tona, papritur vumë re një kolonë me dhjetë a trembëdhjetë tanke që hyri (në Babushin e Muhaxhereve) pa paralajmërim. Ata zunë të shtinin me pushkë automatike dhe armë kundërajrore. Kishim vetëm pesë minuta që të linim fshatin. S'mundëm të marrim asnjë plaçkë. S'arrita të marr as pasaportën. Paskëtaj shkuam në Llugagji.[5]

Më 26 prill pasi mori vesh për vrasjet masive në fshatrat e Sllovisë, Ribarit të Vogël dhe Hallacit të Vogël (shih më poshtë), S. S. vendosi ta shpinte familjen në Maqedoni. Ai e shpjegoi kështu vendimin e tij: "Nuk qe puna se u trembëm nga masakra që ndodhi në Sllovi … por kur dëgjuam që kishte ndodhur edhe në Ribar (të Vogël) dhe Hallac (të vogël) atëherë po që na hyri frika. Ishim të paarmatosur dhe fëmijët ishin të tromaksur, kështu që s'na mbetej rrugë tjetër veçse të iknim."[6]

Fshati Gadime e Ulët do të bombardohej nga Babushi pak ditë pasi nisën sulmet e NATO-s. Një dëshmitar nga Gadime e Vogël i intervistuar nga Human RightsËatch do ta përshkruante kështu mbërritjen e banorëve nga Cernille, një fshat në veri të Ferizajt, pranë Babush i Muhaxhere, "pesë apo gjashtë ditë pasi NATO kishte nisur bombardimet."[7] Ai do të shprehej "atë natë s'vumë gjumë në sy, ngaqë kur bombardimet e NATO-s të rreshtnin, ata (forcat serbe) do të granatonin fshatin tonë". Disa ditë më vonë (rreth datës 1 prill), aty nga mesdita, forcat serbe hynë në Gadime e Ulët të shoqëruar me tankse, duke shkaktuar largimin e fshatarëve në drejtim të një lumi që ndodhej aty pranë. Pasi u siguruan se trupat gjendeshin atje thjesht për të gjetur një strehë ku të fusnin kryet nga bombardimete NATO-s, një pjesë e banorëve u kthyen po atë ditë, por do të largoheshin sërishmi rreth orës pesë të pasdites, në kohën kur në fshat mbërriti ushtria serbe me pesë tanke, të cilët, sipas dy dëshmitarëve, zunë të shtinin në ajër. [8] Një pjesë e fshatarëve u shpërngulën në Gadimen e Epërme, në lindje, disa në Smollus, në veri dhe, të tjerët në Gllogovc, një fshat pranë Lipjanit. Ndonëse edhe Gadime e Epërme do të sulmohej në fund të marsit, duke detyruar një pjesë të banorëve të largoheshin në drejtim të Smollusës, pjesa më e madhe e fshatarëve ose qëndruan ose u kthyen, siç raportojnë banorët e Babush i Muhaxhereve dhe ata të

Gadimes së Ulët, të cilët u strehuan atje në mes të prillit, sëbashku me një numër të madh personash të shpërngulur nga fshatrat e tjerë.[9] E megjithatë, trupat policore serbe dhe paraushtarake hynë edhe në Gadimen e Epërme më 16 apo 17 prill, rreth orës 1.30 të pasdites, duke urdhëruar gjithkënd që ndodhej në fshat të largohej për në Shqipëri brenda dy orësh.[10]

Disa nga fshatarët do të ishin gjatë gjithë kohës në lëvizje për pjesën më të madhe të prillit. M. L. një tridhjetë e gjashtë vjeçar nga Gadime e Ulët do ta përshkruante kështu rravgimin e vet:

> Nëntë ditë pasi kishin nisur bombardimet na u desh të lëviznim për të parën herë (afërsisht më 2 prill). Milicët u dukën rreth orës 2 pasdite dhe pasi bënë një patrullim me tankse u larguan. Pas dy orësh ata u kthyen dhe na detyruan të largoheshim. Asnjëri prej nesh nuk u lejua të merrte veturat apo traktorët … U shtrënguam të shkonim në Smollus. S'kaloi një javë dhe ata ia çatisën në Smollusë në orën 6 të mëngjesit – dëgjuam të shtënat. Ishin (po ata) milicë që kishin ardhur edhe në Gadime. Në krye na thanë se askush s'kish për të na prekur. Paskëtaj u kthyen pas nja dy a tre orësh dhe na thanë "ky vend nuk është më i sigurt për ju. Duhet të largoheni nga Smollusa." Kështu që morëm rrugën e kthimit për në Gadime, ku mbërritëm rreth orës 3 pasdite, por nuk hymë nëpër shtëpitë tona. Ata i kishin vënë zjarrin dhe djegur gati gjysmën e fshatit. Qëndruam aty njëzet e katër orë deri sa milicët ia behën sërish dhe na thanë "nga ora 1 deri më 3 të pasdites gjithsecili duhet të largohet, duke përfshirë edhe ata të Gadimes së Epërme." Kështu që u larguam dhe shkuam në Llugagji. Por edhe atje nuk qëndruam më shumë se dy ditë ngaqë vendi ishte i mbipopulluar. Ndaj u kthyem mbrapsh në Smollusë. Në Smollusë qëndruam një javë dhe paskëtaj morëm rrugën e kthimit për në Gadime, pasi një komandant policie i kishte thënë një bashkëfshatarit tonë që tashmë s'kishte asnjë problem për t'u kthyer. Por kur u kthyem të shtënat nuk pushuan gjatë gjithë natës, ndërkohë që u dogjën edhe tri shtëpi. Dy netë më pas u larguam për në Maqedoni.[11]

Fshatrat e Marevcës dhe të Gllavicës do të mësyheshin disa javë më pas. Sipas S. S. tanket e instaluar në Babush i Muhaxhereve do të rivendoseshin në fshatrat e Gllavicës dhe Marevcës rreth orës 4.30 të

mëngjesit, një javë pasi ata kishin hyrë. S. S. u shpreh se ai e dinte këtë gjë ngaqë rruga nga Babush i Muhaxhereve për në Gllavicë kalon përmes Llugagjisë dhe ai kishte dëgjuar zhurmën e tankseve.[12] Ky njoftim përputhet me dëshimnë e Q. F., një grua nga Marevce, e cila i dëftoi Human Rights Watch se fshati ishte mësyrë herët, mëngjesin e 15 prillit, saktësisht tri javë pasi banorët e Babush i Muhaxhereve kishin braktisur fshatin e tyre. Q. F. e përshkroi kështu sulmin:

Pesëmbëdhjetë burra u ekzekutuan ndërsa një grua u dogj e gjallë mbi traktorin e saj, nga dora e paraushtarakëve.

> Ofensiva serbe nisi herët në mëngjes, para se të lindte dielli. Veshët na zunë zhurmën e tankeve që vinte nga fshati Babush. Kur ata hynë në fshat, mundëm të dëgjonim të shtënat. Zhurma dhe frika na zgjuan e sakaq dolëm në oborr. Kur nisën të shtinin u shtrimë përdhe. Askush nuk qe qëlluar. Ne bëheshim nja dhjetë vetë. Plumbat fluturonin mbi kryet tona. (Ata kishin) një numër të madh tankesh, mjete transporti të blinduar dhe automjete civile. Paskëtaj këmbësorët zbritën nga pjesa e sipërme e fshatit. Ata u drejtuan për në Gllavicën e Epërme dhe fqinjët tanë urdhëruan të braktisnin shtëpitë. Paskëtaj situata sikur u qetësua. (Fshatarët) e Gllavicës dhe Marevcës u larguan, ndërsa në atë pjesë të fshatit ku ndodheshim ne qëndruam deri rreth orës 3 të pasdites. Më pas u duk një tanks dhe një automjet i blinduar, të cilët nisën t'u vinin zjarrin shtëpive në Gllavicë. Pasi dogjën të gjitha shtëpitë në Gllavicë, ata iu kallën zjarrin shtëpive në pjesën e sipërme të Marevcës. Vetëm paskëtaj ne u larguam dhe shkuam në Llugagji.[13]

Q. F., e cila ishte shtatzanë, menjëherë paskësaj vendosi të udhëtonte për në Maqedoni, për shkak të "frikës se gjithçka mund të ndodhte sërish."[14]

Po atë ditë që fshatrat e Marevcës dhe të Gllavicës u sulmuan, trupat policore dhe paraushtarakët serbë hynë në fshatin e Sllovisë, ku ekzekutuan tetëmbëdhjetë banorë shqiptarë, ndërsa të tjerët i urdhëruan të shkonin në Smollusë, që ndodhej aty pranë (shih më poshtë). Një ditë më pas, më 16 prill, paraushtarakët rrethuan një numër të madh banorësh që ishin strehuar në kodrat pranë fshatit dhe i ndanë burrat nga gratë. Sipas dëshimtarëve, pesëmbëdhjetë burra u ekzekutuan ndërsa një grua u dogj e gjallë mbi traktorin e saj, nga dora e paraushtarakëve. Në të

hyrë të majit, disa nga banorët u larguan për në Maqedoni, ndonëse pjesa më e madhe gjetën strehë në fshatrat aty pranë ose u fshehën nëpër kodra. Sëbashku me fshatrat e Ribarit të Vogël dhe Hallacit të Vogël (shih më poshtë), fshati Sllovë do të pësonte abuzimet më të rënda gjatë kohës së luftës në mbarë komunën.

Fshatrat e Topliçanit dhe të Gllogofcit, në jug të Lipjanit, nuk do të sulmoheshin mirëfilli, por gjatë muajve mars e prill do të vizitoheshin shpesh nga forcat serbe të sigurimit, duke ngjallur kësisoj një klimë frike e pasigurie, gjë që do t'i shtynte një pjesë të mirë të banorëve të merrnin udhën e Maqedonisë. Të dy këto fshatra do të bëheshin viktima të djegieve, plaçkitjeve dhe dhunës së ushtruar nga policia dhe trupat paraushtarake. Sipas F. P., kërcënimet në Topliçan nisën fill pas sulmeve ajrore të NATO-s: "Së pari, ata dogjën tri shtëpitë ku kishte pasë qendruar OSBE-ja. Kjo ndodhi katër ditë pasi kishin nisur sulmet ajrore të NATO-s. Afro një javë pas sulmeve, ata zunë të plaçkisnin shtëpitë."[15] Përfundimisht, më 22 prill, F. P. e shpuri familjen e vet në Maqedoni me tren, "për shkak të frikës dhe për hir të fëmijëve".

Në Gllogoc, djegiet e shtëpive dhe grabitjet do të shoqëroheshin nga kërcënime dhe shantazhe të gjithëfarësojshme. Ditët e para të prillit, banorët e Gllogocit u shtrënguan të braktisnin shtëpitë për një orë e gjysmë, teksa policët i plaçkisnin dhe më pas iu vinin zjarrin. Sipas dëshimsë së L. M., një njëzet e pesë vjeçari po nga ky fshat: "Policët hynë në Banullë. Paskëtaj ata erdhën edhe në fshatin tonë. Kjo do të ndodhte rreth tri javë më parë (përafërsisht më 6 prill). Na u desh t'i linim shtëpitë dhe të zhvendoseshim rreth njëqind metra më tutje, në mënyrë që të mos lëndohej njeri."[16] Në kohën kur M. L. dhe fshatarët e tjerë u kthyen nëpër shtëpitë e tyre, ata panë që policët "kishin djegur njëzet e pesë shtëpi dhe kishin paratë dhe gjithçka tjetër që mund t'iu kishte zënë dora." Familja e dyzet vjeçarit A. A. do të bëhej viktimë e një dhune të përshkallëzuar, që do të arrinte kulmin me marrjen peng të së bijës për ta liruar kundrejt një shume parash:

> Atë ditë që ata iu vunë zjarrin shtëpive tona ishte e shtunë. Pas gjashtë ditësh ata u kthyen dhe më morën makinën. Tri ditë para se të largoheshim më morën peng vajzën – duhej të ishte e premte ose e shtunë. Ne ndodheshim brenda në shtëpi dhe ora duhej të ishte 9 e mëngjesit. Ata e grabitën vajzën ndërkohë që ajo ishte jashtë duke luajtur … Kishin

> një furgon të bardhë. Ishin civilë serbë, të gjithë të armatosur … Ata më thanë "na jep para ose do ta vrasim fëmijën." Iu dhashë njëmijë Deutsche Marks dhe një varëse të artë. Pas gjymë ore ma liruan vajzën dhe u larguan. Pas një ore ia mbërriti policia. Iu kallzova çka kish ngjarë. Ata i njihnin fort mirë se cilët ishin, por shtrireshin sikur s'dinin gjë dhe më kërkuan të përshkruaja makinën etj.[17]

A. A. dhe familja e tij e lanë Gllogocin dhe u nisën për në Maqedoni ditën e hënë, më 26 prill. Kur e pyetëm, pse u largua, ai u përgjigj: "Ishte një panik i jashtëzakonshëm. Çdo minutë e humbur, më pas mund të ishte tepër vonë." Sipas pohimeve të dëshmitarëve të tjerë të mbledhura nga OSBE-ja në Maqedoni, pjesa më e madhe e banorëve të Gllogocit kishin mbërritur në të njëjtin përfundim, aty nga fundi i muajit prill.19

Më 18 prill, forcat serbe të sigurimit ndërmorën një sërë ofensivash kundër fshatrave në perëndim të Lipjanit. Sipas B. B., një tridhjetë e tre vjeçari nga fshati Bujanc, në jug-perëndim të Lipjanit, pranë rrugës Lipjan – Shtimje, i intervistuar nga Human Rights Watch, fshati do të bëhej objekt i një sulmi me mortaja ose granata, mëngjesin e datës 18 prill.[20] Një dëshmitar nga fshati fqinj i Topliçanit tha se, rreth orës 6 të mëngjesit, kishte parë predhat që binin mbi Bujanë dhe që vinin nga fshati fqinj i Staro Graçkos, një fshat i banuar kryesisht nga serbë e që ndodhet në veri të Bujanës.[21] Si pasojë e sulmit, të rinjtë e fshatit Bujanë u larguan në drejtim të kodrave të fshatit Varigovë, ndërkohë që një pjesë e pleqve të fshatit qëndruan në qendër të fshatit. Sipas B. B.-së dhe dëshmitarëve të intervistuar nga OSBE-ja, përgjatë ofensivës Bujana do të vuante edhe pasojat e djegievedhe plaçkitjeve në masë.[22] Gjithashtu më 18 prill objekt sulmi do të bëhej edhe një fshat tjetër aty pranë, Krajishtë, sipas dëshmisë së një gruaje tridhjetë e pesë vjeçare nga ai fshat: "të djelën, në orën 6 të mëngjesit, fshati ynë u sulmua nga tre tankse. Të gjithë banorët e fshatit u larguan aty për aty."[23] Sipas dëshmitares, ditën e sulmit u vranë tre banorë të fshatit, një meso grua, një djalë adoleshent, si dhe një grua tjetër te të njëzetat.[24] Pasi kaluan pesë ditë në kodrat pranë fshatit Varigovë, si dhe pasi bashkëfshatarët e tyre e serbë iu thanë se kthimi ishte pa rrezik, fshatarët u kthyen në Krajishtë. Vendimi i një pjese të madhe fshatarësh për t'u larguar në Maqedoni disa ditë më pas, ngjan të jetë marrë më fort nga frika e kthimit të forcave serbe sesa nga ndonjë incident specifik.

Fshatrat e Ribarit të Vogël dhe Hallacit të Vogël u sulmuan më 18 dhe 19 prill. Të dy këta fshatra që shtrihen pak a shumë tri kilometra larg njëri-tjetrit, ndodhen pranë fshatit të Rufcit të Ri, banorët e të cilit edhe pse qëndruan, nuk u kursyen dhe patën fatin të pësonin të njëjtën dhunë që u ushtrua mbi fqinjët e tyre. Afërsia e Rufcit të Ri me dy fshatrat e tjerë, iu hoqi fshatarëve çfarëdo dyshimi për atë çka mund të kishte ndodhur aty pranë. Y. S., një njëzet e tetë vjeçar nga Rufci i Ri, do t'i përshkruante kështu përjetimet e datës 18 prill:

> Ndodhesha në shtëpi në Rufcin e Ri tok me familjen time kur ndodhën incidentet në Ribarin e Vogël dhe Hallacin e Vogël. Ishte ditë e djelë kur ndodhi masakra në Ribar. Të shtënat e para i dëgjuam në 6.15 të mëngjesit. Në orën 7 nisën të ngrihen fjollat e para të tymit nga shtëpitë … atëkohë zunë edhe gratë kujën. U shtrënguam të dilnim nga shtëpitë … Rreth orës 8 apo 9, ne, burrat, shkuam atje (Ribaren e Vogël), mos iu jepnim ndonjëfarë ndihme. I ramë fshatit kryq e tërthor … Gjetëm disa njerëz të plagosur. Gjithsejt katër vetë – një burrë të moshuar, një grua të moshuar dhe dy djem të rinj (rreth të njëzet e pesave). Kështu pra, u munduam t'i ndihmonim. Pas një ore, gruaja vdiq … S'na zuri syri kërrkënd tjetër.[25]

Pavarësisht nga garancitë e marra prej fqinjëve të tij serbë se, sulmi mbi Ribarin e Vogël nuk ka kurrsesi për të ndodhur në Rufcin e Ri, vizitat shtëpi më shtëpi nga ana e paraushtarakëve që kërkonin para, si dhe djegia e një shtëpie në Hallacin e Vogël, aty pranë, ia mbushën mendjen Y. S. –së që të largohej. Kështu që ai e shpuri familjen në Dobrajën e Madhe për një javë. Y. S. u përpoq të kthehej rishtazi në Rujcin e Ri, por pas dy netësh, do të nxirrej jashtë nga paraushtarakët, duke e detyruar t'ia mbante për në Llugagji, para se detyrohej me përdhunë të merrte trenin, më 4 maj, për në Maqedoni.

Frika për Y. S.-në dhe familjen e tij, e lindur nga sulmi mbi Ribarin e Vogël, rezultoi të ishte fort mirë e bazuar. Mëngjesin e datë 18 prill, forcat serbe duke përfshirë këtu tankse, policë dhe paraushtarakët hynë në fshat. Sipas pohimeve të një numri të madh dëshmitarësh okularë, paraushtarakët do të shtinin si të tërbuar mbi këdo që iu shihte syri, duke lenë të vrarë rreth njëzet e katër apo njëzet e shtatë persona, pa bërë dallim, gra, fëmijë e të moshuar.[26] J. K. një dyzet vjeçar, banor i Ribarit të

Vogël do ta përshkruante kështu atë çka kish parë me sytë e tij:

> Masakra ndodhi të djelën, më 18 prill, në orën 6 të mëngjesit. Katër formacione të ndryshme paraushtarakësh mbërritën bashkë me tankset. Ata ekzekutuan gjithkënd që iu zinte syri në rrugë nga shtatë (vjeç) deri më tetëdhjetë e shtatë (vjeç) ... Nuk bënin dallim as për moshën as për seksin. Pjesa më e madhe e njerëzve të vrarë do të ekzekutoheshin me një plumb të vetëm në qafë, zemër apo në ballë. Dogjën nëntëmbëdhjetë shtëpi dhe qëndruan dy ditë në fshat ... Erdhën pa paralajmërim ... Një forcë prej afro shtatëdhjetë vetësh hyri në fshat me një numër të vogël tanksesh dhe APC-shë. Në krye (të kolonës) ishte një tank me top, pas tij vinin dy APC dhe pas tyre një kamion i mbushur me paraushtarakë, të cilët zbritën nga kamioni dhe u shpërndanë nëpër fshat ... Sapo trupat hynë dhe nisën të shtënat, njerëzit zunë t'ia mbathin. Unë shkoja derë më derë dhe iu thoja njerëzve të dilnin pa humbur kohë. Për gjysmë ore krejt fshati u zbraz ... Arrita të shoh gjithçka. Pashë një njeri që e qëlluan në zverk. Pashë një tjetër që e qëlluan në zemër. Një grua që ishte me mua e qëlluan nga pas. I pashë pothuajse të gjithë që qëlluan, përveç katër ...[27]

J. K. do të rendiste emrat e tetëmbëdhjetë personave nga fshati që ishin ekzekutuar, duke përfshirë këtu edhe një vajzë shtatë vjeç e një djalë katërmbëdhjetë vjeç, si dhe gjashtë vetë të shpërngulur nga fshati Vërshec në pjesën perëndimore të komunës së Lipjanit. J. K. i përshkroi paraushtarakët të veshur "me kapele dhe uniforma nga më të ndryshmet", duke përfshirë edhe kapele çetnikësh, kapuçë leshi, shami të kuqe të lidhura në krye, si dhe uniforma kamuflazhi të blerta pa shenja të identifikueshme."[28] J. K. u kthye në fshat pas një jave, por e gjeti "fshatin të djegur e të shkatërruar". Pas pak kohësh, ai do të largohej në Maqedoni.

J. K. do të rendiste emrat e tetëmbëdhjetë personave nga fshati që ishin ekzekutuar, duke përfshirë këtu edhe një vajzë shtatë vjeç e një djalë katërmbëdhjetë vjeç.

Fshati fqinj i Hallacit të Vogël u sulmua një ditë më pas. Mëngjesin e datës 19 prill, paraushtarakët serbë hynë në fshat dhe ndanë burrat nga gratë. Paraushtarakët iu kërkuan para dhe paskëtaj ekzekutuan

të paktën njëzet burra. Një dëshmitar i intervistuar nga Deutsche Presse Agenteuer tha se kishte qenë një nga të trembëdhjetë burrat të rreshtuar pas murit të një shtëpie dhe qe qëlluar.[29] Teksa ai dhe një burrë tjetër shpëtuan duke u shtirë si të vdekur, njëmbëdhjetë vetë u vranë. Sipas të njëjtit dëshmitar, po atë ditë u qëlluan për vdekje edhe nëntë burra të tjerë të fshatit. Dëshmitarët, të intervistuar nga OSBE-ja (midis tyre mund të jetë edhe i njëjti person i përmendur nga ne, pak më parë), e përshkruan të njëjtën ngjarje saktësisht me të njëjtat terma, duke përfshirë këtu edhe pushkatimin e njëmbëdhjetë vetëve; gjithashtu, ata ofruan informacion shtesë dhe rreth disa vrasjeve të tjera.[30] Ndonëse pjesa më e madhe e detajeve janë të njëjtë në të gjitha rrëfimet e bëra, disa dëshmitarë mëtonin për njëzet ekzekutime të kryera, ndërsa të tjerët për njëzet e një.[31] Shpjegimin për këtë mospërkim mund ta gjejmë në pohimin e bërë nga një grua e moshuar nga fshati Suhodoll, e cila u intervistua nga gazeta *Boston Globe* në qershor 1999.[32] Gruaja, e cila kishte pasë qenë e pranishme në fshat në kohën kur ishin kryer vrasjet, do të thoshte se forcat serbe i kishin kërkuar një burri rrom po nga ai fshat, t'i ndihmonte në groposjen e kufomave, detaj ky që e patëm hasur edhe në kallzimet e dëshmitarëve të tjerë, dhe pasi rromi s'kishte pranuar ta bënte një gjë të tillë, serbët e kishin vrarë edhe atë. Një pjesë e mirë e dëshmivë na bëjnë të ditur se trupat e viktimave ishin varrosur në një varr të përbashkët, por diku aty nga fillimi i majit ishin zhvarrosur dhe më pas rivarrosur në varre të veçantë, sipas të gjitha gjasave për të zhdukur çdo gjurmë rreth natyrës së vërtetë të vdekjes së tyre, siç do të vinin re të huajt që do të vizitonin fshatin pas luftës.

SLLOVI

Disa nga mizoritë më të mëdhaja në mbarë komunën e Lipjanit, do të ndodhnin pikërisht në fshatin e Sllovit. Sllovi, që shtrihet përafërsisht tetë kilometra në lindje të Lipjanit, para luftës ishte një fshat i përzjerë, dhe përmbante 500 shtëpi shqiptarësh dhe gjashtëdhjetë serbësh. Para marsit të vitit 1999, marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve në këtë fshat, përcaktoheshin të mira. Me sa dukej, fshatarët nuk ishin të

Me sa dukej, fshatarët nuk ishin të përfshirë në veprimtarinë e UÇK-së.

përfshirë në veprimtarinë e UÇK-së dhe, për më tepër, gjë krejt e pazakontë në Kosovë, shumë nga serbët e fshatit, veç serbishtes flisnin edhe shqip. Por, dhuna që ndodhi ditë me radhë përgjatë muajit prill e shpërbëu bashkësinë; vetëm në datat 15 e 16 prill, u ekzekutuan të paktën tridhjetë e pesë shqiptarë. Të mbijetuarit u shpërngulën në fshatrat fqinje dhe shumë vijuan më tej, për në Maqedoni. Teksa aty nga fillimi i qershorit lufta po i qasej fundit, dy vëllezër që u kthyen parakohe, u mbajtën rob dhe u rrahën. Njëri prej tyre do të vdiste nga plagët e marra. Sot e kësaj dite bashkësia në fshatin e Sllovit është copë e thërrime: pothuajse nuk ka familje shqiptarësh që të mos ketë një a më shumë të vrarë; të gjithë serbët dhe pjesa dërrmuese e rromëve e kanë braktisur fshatin; një dyzinë shtëpish të shqiptarëve dhe po aq të serbëve janë djegur dhe rrafshur, kurse kisha ortodokse e fshatit është shndërruar në gërmadhë.

Tensionet në fshatin e Sllovit do të rriteshin menjëherë pas largimit të ekipit të monitorimit të OSBE-së më 20 mars dhe fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s, katër ditë më pas, ndërkohë që shqetësimi i shqiptarëve në fshat vinte duke u rritur lidhur me përkeqësimin e gjendjes së sigurisë, si kudo në mbarë Kosovën. Më 14 prill 1999, këto shqetësime do të bëheshin tashmë, pjesë problemeve të shtëpisë. Sipas F. B.-së, një shqiptari tridhjetë e tetë vjeçar nga ky fshat, një transportuesh i blinduar trupash do të hynte në fshat rreth orës 4.30 të pasdites dhe do të largohej pa shkaktuar ndonjë incident.[33] Një tjetër shqiptar, po nga ky fshat, do t'i thoshte Human Rights Watch se, po atë mbrëmje, kishte parë një bashkëfshatarin e vet serb hipur mbi një automjet ushtarak. [34] Të dy burrat do të pohonin se, mbrëmjen e 14 prillit, bashkëfshatarët e tyre serbë i kishin këshilluar fqinjët shqiptarë, si dhe funksionarin e zyrës lokale të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), se të nesërmen do të hynin tankse në fshat, por kjo gjë "nuk do të kishste kurrfarë pasojash", sepse tankset po lëvizeshin thjesht për t'iu shmangur bombardimeve të NATO-s.[35]

Rreth orës 4 a 5 të mëngjesit të datës 15 prill, në Sllovi hynë gjashtë tankse. Sipas dëshmitarëve, forcat që i shoqëronin ishin një kombinim i policisë, me trupat ushtarake dhe paraushtarake, një pjesë e të cilëve mbanin maska. Fshatarët ngulmojnë se disa nga paraushtarakët ishin banorë të Sllovisë.[36] Sipas raportimeve, gjatë gjithë atij mëngjesi, përveç disa ushtarëve dhe paraushtarakëve, që kishin vizatuar katër C-të (një simbol serb i katër shkronjave S të alfabetit cirilik në trajtën e

kryqit) në dyert dhe dritaret e shtëpive, fshati do të ishte i qetë deri rreth orës 1.30 të pasdites, kur një numër i madh dëshmitarësh raportojnë se, kishin dëgjuar të shtëna armësh dhe kishin parë tym e flakë të dilnin nga shtëpitë e djegura në krahun verior të fshatit (pranë rrugës që të shpie në Lipjan). Menjëherë paskëtaj, fshati do të pësonte viktimat e para: Fatishe Dubova, një grua nëntëmbëdhjetë vjeçare do të goditej në oborrin e shtëpisë, ka të ngjarë nga një snajper. Sipas disa dëshmitarëve, Hedije Krasniqi, një grua pesëdhjetë e dy vjeçare, do të qëllohej në rrugë, pranë shtëpisë, nga një distancë e afërt, rreth orës 2 të pasdites. Më pas, radha për të vdekur do t'iu vinte burrave të familjes Gashi, banesat e të cilëve ishin në të hyrë të fshatit, përballë shkollës. Z. G., një farefisi i tyre që ndodhej e pranishme në atë moment, do të rrëfente se si kishte parë "forca nga fshatrat e Gustericës dhe Dobratinës veshur me uniforma ushtarake" si dhe persona të tjerë "që mbanin maska dhe veshur me uniforma policie." Ajo e përshkroi kështu atë çka kishte përjetuar gjatë ekzekutimit të kushërinjve të saj:

Vetëm njëri prej tyre hapi zjarr, pasi i bënë shenjë me dorë.

> Ne ndodheshin të gjithë në shtëpi, kur serbët ia behën. Ishin të veshur me uniforma policie dhe mbanin maska. Pasi trokitën në derë, hynë brenda. Ora duhej të ishte 2 e pasdites. Na thanë të dilnim nga shtëpia se do t'i kallnin zjarrin. Kur dolëm jashtë, ata hoqën mënjanë burrat dhe na thanë neve (grave dhe fëmijëve) të shkonim në Smollushë. Im shoq s'donte të ndahej … por ata e shkëputën me zor … Atëherë njëri prej tyre tha "si thoni, të djeg shtëpinë apo të vras këta?" Tjetri iu gjegj "më mirë vrit një herë këta, pastaj merru me shtëpinë" … Sakaq nisëm të thërrasim "mos e bëni këtë gjë", por ata s'na e vunë veshin. Vetëm njëri prej tyre hapi zjarr, pasi i bënë shenjë me dorë. Nuk e njoha kush ishte. Ishte thatanik, me flokë dhe mjekër të kuqërremtë. Kishte veshur uniformë policie dhe duhej të ishte te të njëzetat, por jo më shumë se tridhjetë vjeç.[37]

Sipas Z. G.-së, pesë anëtarë meshkuj të familjes Gashi u ekzekutuan në oborrin e shtëpisë: Murati gjashtëdhjetë e tre vjeçar, Enveri dyzet vjeçar, Omeri tridhjetë e katër vjeçar, dy djemtë e tij, Bekim Haziri njëzet e tre vjeç, nipi i tij, si dhe gjashtëmbëdhjetë vjeçari Arben Gashi, i biri i Enverit.

Z. G. do të deklaronte se një numër serbësh, banorë të Sllovisë, ishin përfshirë në vrasjen e kushërinjve të saj (shih më poshtë). Bash në atë orë ose pak a shumë në të njëjtën orë, Rifat Gashi dhe kushëriri i tij Milaizim do të goditeshin për vdekje nga një snajper. Tri dëshmitarë i thanë Human Rights Watch se dyzet e gjashtë vjeçari Rifat Gashi dhe njëzet e dy vjeçari Milaizim, u vranë nga një snajper në oborrin e shtëpisë së tyre, në pasditen e 15 prillit.[38] Gjatë këtij sulmi do të plagoseshin gjithashtu edhe tri vajza të kësaj familjeje. Dy nga dëshmitaret e intervistuara nga Human Rights Watch, kishin ndihmuar për varrosjen e dy kushërinjve të tyre në varre të përkohshëm.

Ndërkohë banorët shqiptarë ishin urdhëruar nga policët dhe paraushtarakët serbë ta linin fshatin dhe të vendoseshin pranë Smollushës. Sipas I. N. një grua te të gjashtëdhjetat, "Dëgjuam të shtëna pushkësh jashtë, në anën tjetër të fshatit. Dolëm nga shtëpia dhe një oficer serb na bëri shenjë me 'gishtin e madh ngritur lart', për të na thënë që duhet të largoheshim. E pyeta se ku duhej të shkonim dhe ai na tha se duhej të shkonim në Smollushë. Kishte veshur një uniformë të blertë, jo laramane, si ushtarët."[39] Një numër burrash të moshuar s'pranuan t'i braktisnin shtëpitë. Pesëdhjetë e nëntë vjeçari, Adem Bytyqi, ditën e 15 prillit qëndroi në shtëpi, por pesë ditë më vonë u gjet i vdekur në një fushë nga i vëllai. Avjaz Gashi, një burrë gjashtëdhjetë e dy vjeçar, gjithashtu refuzoi të largohej dhe, më pas, u gjet i vdekur në oborrin e shtëpisë.

Një memorial i viktimave në Sllovinjë, ku forcat serbe vranë të paktën tridhjetë e pesë fshatarë të etnisë shqiptare më 15 dhe 16 prill 1999.

© BENJAMIN WARD / HUMAN RIGHTS WATCH

Disa nga banorët kishin vendosur të largoheshin sapo nisën të shtënat. Pjesa më e madhe ia dolën mbanë të dilnin nga fshati gjallë, ndërsa disa u ekzekutuan tek orvateshin të largoheshin. Një dëshmitar, M. B., pa Gafur Hysenin kur policët e zbritën nga traktori i tij dhe e qëlluan.[40] Një tjetër dëshmitar nga fshati Gadime do t'i kallzonte Human Rights Watch se si paraushtarakët kishin zbritur nga traktori nipin e tij, Faik Krasniqi, dhe e kishin qëlluar në sytë e fëmijëve.[41] Një dëshmitar i tretë, F. G., do të pohonte se i kishte parë kufomat e të dyve. Ramadan Kryeziu, njëzet e nëntë vjeçar, ishte ndaluar nga policia në kohën që ishte duke dalë nga fshati dhe, më pas, ishte lejuar të vijonte rrugën. Më vonë, Kryeziu ishte gjetur i vdekur, sipas dëshmisë së një numri dëshmitarësh, duke përfshirë këtu edhe atë të të atit.[42] Tre pleq të fshatit ishin gjetur të vdekur pranë shtëpivë të tyre. Kufomat e shtatëdhjetë e tre vjeçarit Mehmet Sopa, tetëdhjetë e shtatë vjeçares Shehide Sopa dhe gjashtëdhjetë e katër vjeçares Qamile Sopa do të gjendeshin në një stallë kuajsh me plagë thikash në trup. Kushërinjtë kishin parë gjurmë gjaku në oborrin e shtëpisë. Pra, më 15 prill, do të vriteshin gjithë-gjithë tetëmbëdhjetë banorë të Sllovisë. Latife Kryeziu, një grua dyzet e shtatë vjeçare që ishte plagosur më 15 prill, do të vdiste pak ditë më vonë në Smollushë.

Ndërkohë që një pjesë e fshatit mori në drejtim të jugperëndimit, për në Smollushë, të tjerët, duke përfshirë një numër të madh burrash, u larguan në drejtim të lindjes, për kah fshati Zhegofc, në një vend kodrinor të quajtur "Lugu i Demës". Lugu konsiston në një fushë të madhe të rrethuar nga pyje, që lidhet me një fushë më të vogël në një rrafshnaltë. Fshatarët e shkuan natën në lug, duke fjetur nën qiell të hapur, teksa binte shi. Sipas njërit prej fshatarëve "atë natë zumë të flasim e të shohim se kush kish vdekur dhe kush mungonte."[43] Banorë nga fshatra të tjerë kishin gjetur strehë aty pranë. Sipas vlerësimeve të një dëshmitari, mëngjesin e 16 prillit ndodheshin në lug rreth 800 vetë. Fshatarët do ta shkonin mëngjesin duke ngritur streha të përkohshme, sistemuar mjetet e transportit dhe sajuar vende për të gatuar. Rreth orës 2 të pasdites, në majë të lugut u shfaqën paraushtarakët serbë. Ja se ç'do t'i kallzonte Human Rights Watch, S. B., një burrë gjashtëdhjetë e dy vjeç:

> Në orën 2 të pasdites, ata ia behën nga sipër kodrës dhe na shtrënguan të merrnim (më të poshtë kodrës). Pylli ishte rrëmbushur me ushtarë

> dhe paraushtarakë. Dhjetë prej tyre na u qasën fare pranë dhe nisën të shtien … Na thanë të bënim tatëpjetë (kodrës). Njëri prej tyre me armën në dorë na tha të nxirrnim paratë, letrat e njoftimit, florinjtë e gjithë ç'kishim me vete. Tjetri zuri të rrëmonte në gjërat tona për të parë mos kishim fshehur gjë … Pastaj ndanë trembëdhjetë persona dhe i urdhëruan të ngrinin duart lart … Dikush më qëlloi në shpatull dhe sakaq u shemba përtokë. Një nga një nisën t'i qëllonin të rinjtë (meshkujt) me grushta dhe kondakët e pushkëve … Më pas na urdhëruan të veçoheshim nga gratë dhe fëmijët. Gratë dhe fëmijët i urdhëruan të zinin vend në shesh (poshtë në fushë). Ndërsa ne, burrat, na urdhëruan të shkonim në krahun tjetër. Paskëtaj na bënë zë të ngjiteshim lart në pyll, duke na bërtitur gjatë gjithë kohës "deshët NATO-n, le të vijë NATO tani e t'ju ndihmojë."[44]

F. B. njëzet e nëntë vjeçar, farefis i S. B., gjithashtu i pranishëm, do t'i thoshte Human Rights Watch:

> Të shtënat ishin të dendura dhe fare pranë nesh. Rreth orës 2 të pasdites, forcat serbe hynë në fushë nga dy krahë – nga sipër dhe nga poshtë. Ishte hera e parë që po i shihnim … Në panik e sipër, ngritëm duart lart që dorëzoheshim. Na thanë të ngjesheshim njëri pas tjetrit … Dhe që aty na shpunë në një rrafshultë. Teksa po zhvendoseshim, një person u vra – ishte një burrë që nuk donte të braktiste gruan e sëmurë. Nipi im nëntëmbëdhjetë vjeçar ishte lënduar ngaqë të rinjtë silleshin pa pushuar përqark duke u orvatur të fshiheshin. Ndodheshim të gjithë në rrafshultë. Pesë serbë të armatosur, të veshur me uniforma të errta ushtarake, qëndronin kundruall nesh. Të gjithë ishin të moshës nga tridhjetë deri në dyzet vjeç. Ai që na foli shqip, mbante në fytyrë një maskë të zezë. Pjesa më e madhe e trupave serbe ndodheshin 300 metra më poshtë, në një tjetër fushë.[45]

Çdonjëri nga dëshmitarët do të përshkruante konfiskimin e dokumentave dhe të parave nga forcat serbe të sigurimit.

F. G. do të konfirmonte vrasjen e Jonuz Pacollit, burrit që kishte pasur gruan të sëmurë.[46] Sipas F. G.-së, "abuzimet e mëdha nisën" pas ekzekutimit të Jonuz Pacollit.[47] Çdonjëri nga dëshmitarët do të

përshkruante konfiskimin e dokumentave dhe të parave nga forcat serbe të sigurimit, ndërkohë që sendeve ushqimore, traktorëve dhe mjeteve të tjera të transportit iu vu zjarri. Sipas F. G.-së, "njëri prej tyre nisi të derdhte benzinë mbi gjithçka. H.-së (një fshatar) iu desh t'i kallte zjarrin gjërave." Pasi kishte vënë më parë gjashtë burra në rresht, po ai që e kishte shtrënguar H.-në t'i kallte zjarrin sendeve ushqimore dhe mjeteve të transportit, iu bënte zë njerëzve të dilnin nga rreshti. F. G. i tha Human Rights Watch se, ai e nxori të parin (person) nga rreshti dhe e rrahu, ndonëse jo aq rëndë. I dyti – Gazmendi (Zeqir Hetemi) u urdhërua të zbathte këpucët – dhe ata zunë ta shkelmonin. E rrahën për vdekje. Të tretit i kërkuan të zhvishej dhe paskëtaj nisën ta godasin. Dhe e gjithë kjo në sy të grave e të fëmijëve."[48]

A.B. gjithashtu i pranishëm kur ndodhën rrahjet, na ofron një rrëfim të ngjashëm:

> Pastaj ata hoqën mënjanë gjashtë burra dhe zunë t'i rrahin, njërin pas tjetrit, në një farë feje që s'më kishin zënë sytë kurrëmëparë. Më kujtohet një djalë i ri – që nuk jeton më – njëri prej serbëve i tha të zbathte atletet – paskëtaj i dha një shkelm në fytyrë, ndërsa shoku i tij e shkelmonte në kokë ... Mbaj mend edhe një rast tjetër. I bënë zë po të njëjtit person – ishin tre policë a paraushtarakë që i lidhën rripin e një automatiku rreth e qark kokës dhe ndërkaq nisën ta shtrëngojnë me sa fuqi kishin. Kur e liruan dhe i thanë të kthehej në rresht me duart lart, i plasi gjaku që i rridhte nga balli poshtë nëpër gjithë fytyrën, ngaqë ia kishin handakosur lëkurën si mos më keq.

Isak Bytyqi do të ishte personi i dytë që do të qëllohej për vdekje. Dyzet e pesë vjeçari Bytyqi kishte pasë qenë polic në kohën e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, gjë që, sipas të gjitha gjasave e bënte atë të dyshuarin kryesor si të lidhur me UÇK-në. Sipas kushëririt të tij A. B., "tre a katër serbë me uniformë erdhën. Njëri prej tyre ngjante të qe shefi – ishte rreth të dyzet e pesave dhe mbante mustaqe. Ai pyeti se kush qe Isak Bytyqi ... E dëgjova kur i tha (Isakut) "ti je komandanti i këtyre burrave." Pjesën tjetër të bisedës (që vijoi për afro tre minuta) nuk arrita ta dëgjoj. Paskëtaj e nxorrën para automjetit dhe në këtë çast dëgjova të shtëna armësh – nuk mund të shija gjë sepse isha në pjesën e sipërme të fushës.[49] S. B., vëllai i Isakut do ta gjente trupin, po

atë ditë, vonë. Sipas S. B.-së, Isak Bytyqi "ishte qëlluar nga mbrapa kokës, pas veshit të majtë."[50]

Pas vrasjes së Isak Bytyqit, forcat policore dhe paraushtarake serbe morën gratë, fëmijët e të moshuarit dhe i zbritën nga kodra në rrafshultë, duke lenë vetëm të rinjtë në rrafshnaltë. Sipas dëshmitarëve, H., i cili, më parë ishte urdhëruar t'iu vinte zjarrin automjeteve, ishte nxjerrë sërish nga rreshti. Pasi e rrahën keqazi i thanë se "do të merrte një plumb në lule të ballit." Kur e urdhëruan të kthehej mbrapsh në rresht, H. ia mbathi nëpër shkurre, ndonëse u ndoq nga pas nga dy paraushtarakë që shtinë në drejtim të tij. Pasi i morën në pyetje burrat për identitetin e H.-së, ata shtinë në drejtim të burrave që ishin në rresht nga pjesa e poshtme e kodrës, duke vrarë në vend Fatmir Bytyqin, Gazmend (Zeqir) Hatemin dhe Heset Lekiqin, si dhe duke plagosur një të katërt. Burrave të tjerë të fshatit iu thanë të vraponin në drejtim të pyllit. Sipas S. B.-së: "Ata iu thanë burrave që kishin mbetur, të futeshin në brendësi të pyllit. Kur nisëm të rendnim, ata zunë të shtien.[51] Sapo filluan krismat e armëve, njerëzit u hapërdanë nëpër pyll. A. B. përshkruan se teksa vraponte kish dëgjuar "të shtënat e armëve dhe degët që binin", gjë që mund të ishte si pasojë e plumbave qorr që godisnin pemët. Ata që arritën të shpëtojnë u fshehën në pyll.

Rreth orës 6 a 7 të mbrëmjës së po asaj dite, të mbijetuarit u kthyen në vendin e fushimit, të tërhequr nga kuja e grave dhe e fëmijëve, si dhe të shtyrë nga ankthi për të marrë vesh rreth fatit të familjeve të tyre. Fshatarët zunë të kërkojnë nëpër për pyll për të gjetur trupat e atyre që kishin mbetur të vrarë. Të plagosurit u mbartën në fushim dhe iu dha ndihma e parë. Mëngjesin e ditës së nesërme, pasi kishin kaluar një natë nën strehëzën e mushamave plastike dhe automjeteve që kishin shpëtuar nga zjarri, fshatarët kishin arritur të mblidhnin gjithë kufomat. Përveç trupave të pesëmbëdhjetë burrave që ishin qëlluar në fushë e në pyll, u zbulua edhe trupi i shtatëdhjetë e katër vjeçares, Halime Gerbeshi. Me sa duket, Gerbeshi ishte djegur për së gjalli, ndërkohë që kish pasë qenë e fshehur nën mbulesën plastike, kur i kishin vënë zjarrin traktorit mbi të cilin ndodhej. Me qëllim që kufomat të varroseshin sa më shpejt të qe e mundur, u vendos të hapej një varri madh, i përbashkët dhe i përkohshëm. Disa nga fshatarët, duke përfshirë edhe një politikan lokal, u rrekën t'i bindnin fshatarët për të kundërtën, me argumentin se kjo gjë do të dëmtonte hetimet që do të zhvilloheshin më pas, lidhur me rrethanat e

vdekjes së tyre. E megjithatë, fshatarët nuk ndryshuan mendim, por rrëmihën një varr të përbashkët dhe përpiluan një listë me emrat dhe moshën e të vdekurve (të cilën e trefishuan për çdo rast, po qe se personi që do të mbante listën mund të vritej apo të kapej). Rreth orës 1 të pasdites, të datës 17 prill, trupat e të vrarëve u varrosën pas një ceremonie të thjeshtë mortore.

Banorët e Sllovisë ndenjën të fshehur në kodra edhe tri ditë të tjera, para se të përpiqeshin të ktheheshin në fshat. Më 20 e 21 prill, një pjesë e banorëve u kthyen në fshat. Njëkohësisht, fshatarët që kishin gjetur strehë në Smollushë, ishin ftuar nga fqinjet e tyre serbë të ktheheshin në fshat. Brenda pak ditësh që ata ishin kthyer, të shtënat e armëve dhe djegiet e shtëpivë të shqiptarëve, i shtynë banorët shqiptarë ta braktisnin fshatin për të gjetur strehë sërish në Smollushë, e cila, pas gjithë gjasave kishte qenë e mbetej një vend i sigurt, edhe pse i mbipopulluar. Por edhe këtë herë nuk munguan viktimat: Latife Kryeziu, një grua dyzet e shtatë vjeçare, e cila kish mbetur e plagosur në fshat më 15 prill, vdiq nga plagët e marra, në Smollushë. Pjesa e mbetur e fshatarëve, që deri më atë kohë ishin strehuar nëpër kodra, morën gjithashtu në drejtim të Smollushës, kësisoj, aty nga fundi i prillit, pjesa më e madhe e banorëve shqiptarë të Sllovisë që kishin arritur të mbijetonin (si edhe të disa fshatrave të tjerë) do të strehoheshin në atë vend.

Aty nga fundi i prillit disa prej fshatarëve iu ishte bërë ftesë nga policia të ktheheshin në Sllovi. Motivi kryesor i ftesës ngjan të ishte organizimi i rivarrimit të tetëmbëdhjetë fshatarëve që ishin vrarë nga trupat policore dhe ato paraushtarake në Sllovi, më 15 prill. Sipas H. K.-së, të tetëmbëdhjetë kufomat të vendosura fillimisht në një varr masiv ishin zhvarrosur nga ushtarët serbë dhe vendosur në një shkollë të Sllovisë.[52] Fshatarët shqiptarë ishin udhëzuar nga policia të shkonin në shkollë, të identifikonin kufomat dhe më pas të merreshin me rivarrimin e të afërmëve të tyre. Pas të gjitha gjasave, logjika zyrtare e kësaj sipërmarrjeje ishte maskimi i rrethanave të vdekjes, ndonëse prania e farefisit të të vrarëve i komplikonte edhe më tej punët. Sipas Z. G.-së, kufomat ishin zhvarrosur pas vizitës që kishte kryer "një doktor nga Beogradi."[53] Një sërë dëshmitarësh të intervistuar nga Human Rights Watch, kishin marrë pjesë në rivarrimet e kryera në fund të prillit.

Me të përfunduar rivarrimi, fshatarët u urdhëruan të largoheshin

nga fshati. Sipas S. B.-së, forcat serbe iu dhanë këtë ultimatum: "Çdonjëri lypset të largohet. Këdo që do të na zërë syri pas orës 6 të pasdites, do ta vrasim."[54] Të gjithë banorët e kthyer, u larguan përsëri në drejtim të Smollushës, Gadimes dhe Lipjanit. Një numër personash të intervistuar nga Human Rights Watch, hipën në trenat e mbingarkuar të drejtuar në kufi me Maqedoninë, jashtë Lipjanit, eventualisht për të përfunduar në kampet e refugjatëve në Maqedoni. Pjesa më e madhe e tyre nuk u kthyen më, veç pas tërheqjes së plotë të forcave serbe dhe hyrjes së KFOR-it në qershor.

Trupat e shtatëmbëdhjetë banorëve të Sllovisë, dikur të varrosur në Lugun e Demës, s'janë gjetur.

Aty nga fundi i majit, të shtatëmbëdhjetë trupat e varrosur përkohësisht në një varr të përbashkët, në Lugun e Demës, do të zhvendoseshin.[55] Sipas njoftimeve të pakonfirmuara, më 25 maj, trupat u zhvendosën me buldozerë nga forcat serbe të sigurimit dhe më pas u ngarkuan nëpër kamionë. Asnjë nga fshatarët e intervistuar prej Human Rights Watch, nuk i kishte parë kufomat të zhvarroseshin nga buldozerët apo të ngarkoheshin nëpër kamionë, përveç njërit që do të dëshmonte për praninë e tij përgjatë ekzumimit. Gjatë një vizite të kryer më 23 korrik nga Human Rights Watch në vendndodhjen e varrit, u vu re se dheu ishte trazuar, si dhe u gjetën copëza teshash, gjë që mbështeste dëshminë e fshatarit. Gjithashtu, raportimet për ekzumime të kryera nga forcat serbe kudogjetkë në Kosovë, për të fshehur gjurmët e ekzekutimeve, e përforcojnë dëshminë e mësipërme. Veç një gjë është e sigurt, trupat e shtatëmbëdhjetë banorëve të Sllovisë, dikur të varrosur në Lugun e Demës, s'janë gjetur edhe sot e kësaj dite, ndaj dhe dhembja që kjo gjë iu ka shkaktuar të afërmve të tyre është e përnjëmendtë.

Pjesa dërmuese e banorëve shqiptarë të Sllovisë nuk do të ktheheshin në vatrat e tyre, deri sa forcat serbe të sigurimit të mos tërhiqeshin nga mesi i qershorit, fill pasi trupat e KFOR-it hynë në Kosovë, më 12 qershor. Disa nga banorët e moshuar që kishin gjetur strehë në fshatrat aty pranë, u orvatën të ktheheshin më herët, por pasojat do të ishin tragjike. Më 3 qershor, S. S. dhe vëllai i tij dyzet e pesë vjeçar Shefkiu, u kthyen në Sllovi. Herët në mëngjes, të dy burrat do të ndaloheshin nga paraushtarakë të panjohur dhe u shpunë në shkollën e fshatit, ku u mbajtën për disa orë. Aty u morën në pyetje dhe u rrahën paprerazi nga paraushtarakët dhe disa ushtarë. Të dy vëllezërit u akuzuan si informatorë të NATO-s

dhe u pyetën për vendndodhjen e telefonit satelitor, që kinse ata zotëronin. Çdo përgjigjeje mohuese nga ana e tyre, serbët do t'i përgjigjeshin me dru. Aq keq do të rriheshin sa Shefkiu, që e kishte njërën veshkë të sëmurë, do të vdiste një orë pasi i kishin liruar.

S. S. do t'ia përshkruante kështu Human Rights Watch arrestimin e tyre:

> Ata (paraushtarakët) na ndaluan, rrëmihën nëpër xhepat tanë dhe kontrolluan për armë. Na lidhën duart, na shtrënguan të hipnim në makinë dhe na çuan në shkollë. Ne ishim mësues dhe serbët (e fshatit) iu thanë atyre që ne qemë spiunë. Atëherë ata zunë të na pyesnin për telefonin, duke na thënë "thërrisnin NATO-s që t'ju ndihmojë." Paskëtaj, ata nisën të na torturonin. Ishin gjithsejt pesë vetë – tre paraushtarakë dhe dy ushtarë … Im vëlla dhe unë ndodheshim në të njëjtin vend dhe rriheshim në të njëjtën kohë. Dy oficerët – paraushtarakët – bënin pyetjet. Pasi ata u larguan, erdhën tre të tjerë dhe zunë të na rrihnin … Na bënë gjashtë pyetje dhe të gjashta herët na goditën. Marrja në pyetje ishte më e gjatë (sesa rrahjet. Ne do të pyeteshim) çdo herë për afro njëzet minuta … Të tre ata sëbashku na rrihnin në të njëjtën kohë.[56]

Të dy burrat do të mbaheshin të arrestuar deri rreth orës 11.45 të paradites, deri kur u duk qartë se Shefkiu ishte duke iu vdekur në duar si pasojë e rrahjeve. Sipas S. S.-së "Kur panë se im vëlla ishte duke vdekur, ata thanë 'Largohuni tani! Ikni! Ikni prej këndej!"[57] Paskëtaj të dy vëllezërit u larguan nga shkolla më këmbë dhe morën për nga shtëpia e tyre në fshat. S. S. vijoi më tej, "ishim në rrugë e sipër kur im vëlla vdiq. Shkova te fqinjët dhe iu tregova ç'më kishte ngjarë. E morëm dhe e shpumë trupin e tij në oborrin e njërit prej fqinjëve. Ai vdiq pas një ore (që ishim liruar) – po ecnim fare ngadalë drejt shtëpisë sime. Ishte ora 12.30 e pasdites kur ai dha shpirt – na u desh një orë ta bënim rrugën më këmbë (që nga shkolla)."[58] Kur u pyet për arsyen e vdekjes së Shefkiut, S. S. u përgjigj, "Im vëlla vdiq ngaqë ata e goditën tepër keq te veshkat."[59]

Shefkiu u plandos përdhe dhe vdiq jashtë shtëpisë së P. F.-së. Për pasojë, veç S. S.-së, P. F. ishte i pari që pa kufomën e Shefkiut. Ai i tha Human Rights Watch se më 3 qershor, rreth orës 1 apo 2 të pasdites, "Unë isha në këtë shtëpi (vendi i zhvillimit të intervistës) me time bijë dhe pashë S.-në në oborrin tim duke thirrur 'O Perëndi, më vranë vëllanë.'

Mora ca drunj dhe një karrocë të vogël dhe shkova te vendi (ku ndodhej trupi i shtrirë). E mora trupin dhe shkova në varrezat e fshatit ku ndodhej tim vëlla dhe atje e varrosëm … S. qëndroi këtu ngaqë ishte i plagosur."[60] Kur e pyetëm të përshkruante gjendjen në të cilën qe katandisur trupi, P.F. u shpreh "kur e pashë unë trupin kishte disa plagë. Njërën faqe e kishte të mavijosur, po kështu edhe njërën anë të trupit. Munda të vë re të nxira në të gjithë trupin e tij – dhe te këmbët. Po nuk pashë gjak."[61]

Disa ditë më pas, vetë P. F. do të kapej dhe burgosej në shkollë, pas vrasjes së një polici. Gjatë kohës që u mbajt i burgosur, ndaj tij u ushtrua presion që të lëshonte dëshmi të rreme se kish qenë ai që e kishte vrarë njeriun që kish pasë ndihmuar të varrosej. Sipas P. F.-së:

> Milicët erdhën dhe më shpunë në shkollë rreth orës 11.00 të paradites. Kishin mbathur çizme të gjata, ishin të veshur me uniformë dhe mbanin jelekë kundërplumb. Më pyetën se kush e kishte vrarë Shefkiun. Dhe unë iu përgjigja "policët dhe ushtarët". Në fund m'u desh të pranoja që e kisha vrarë unë, edhe pse nuk isha unë (vrasësi). Donin të më frikësonin. Ndaj dhe nxorën thikat (nga këllëfi) … (Njëri prej tyre) m'u kanos, duke më thënë "Do të të vras vëllanë dhe vajzën po qe se nuk na tregon se ku janë (fshehur) njerëzit nëpër male." I thashë "Nuk di asgjë."[62]

P. F.-në do ta pyesnin gjithashtu edhe për UÇK-në. Ai mëton se gjatë kohës së burgosjes dy civilë serbë nga fshati i tij kishin qenë të pranishëm gjatë gjithë kohës dhe, edhe pse nuk e kishin rrahur, ia kishin përplasur kryet pas murit. Human Rights Watch vuri re shenjën e një të çare në kokën e P. F.-së, gjë që përputhej me mëtimin e tij të mësipërm. Ndonëse ushtarët që e morën në pyetje e shtrënguan me përdhunë të pranonte se e kish vrarë ai Shefkiun, gjithsesi ata nuk ia dolën mbanë t'i merrnin një rrëfim të nënshkruar para se të mbërrinin policët në shkollë dhe të urdhëronin lirimin e P. F.-së.

Një ditë pasi u largua nga fshati, S. S.-në do ta merrte për t'u kuruar në kodra një mjek i UÇK-së. Afro tri javë pas torturave, Human Rights Watch do të vërente shenjat mavi që kishin nisur të zbeheshin, si dhe lëkurën të dëmtuar gjithandej në trupin e S. S-së, gjë që shkonte e përputhej krejtësisht me dëshminë e tij për të rrahurat. Pjesa tjetër e familjes do të kthehej në fshat e pacënuar, më 9 qershor.[63]

Kriminelët

Dëshmitarë të ndryshëm nga Sllovia do të përshkruanin tri lloje forcash që kishin vepruar në fshat e rrethina midis prillit dhe qershorit – policët, ushtria dhe paraushtarakët.[64] Pas të gjitha gjasave, ushtria ka luajtur një rol më pak aktiv në dëbimin dhe vrasjen e civilëve, krahasuar me policët dhe paraushtarakët. Ajo që të bie në sy është fakti se, policët dhe paraushtarakët përmenden më shpesh në rrëfimet e dëshmitarëve. Ngandonjëherë dëshmitarët ngatërrojnë policët me paraushtarakët, gjë që mund të lidhet me mëtimet e tyre se, bashkëfshatarët serbë nga Sllovia kishin veshur uniforma policie për të marrë pjesë në aktet e dhunës.

Siç ndodh ngaherë, identifikimi i kriminelëve do të rezultonte një ndërmarrje e vështirë për dëshmitarët. Nëntë serbë nga Sllovia do të përmendeshin me emër nga dëshmitarë të ndryshëm si pjesëmarrës në vrasje, dëbim me forcë dhe zjarrvënie në fshat, por Human Rights Watch nuk do të ishte në gjendje të vërtetonte pjesëmarrjen e tyre. Gjithsesi, disa oficerë policie do të identifikoheshin me emër e mbiemër nga një numër dëshmitarësh nga Sllovia. Z. Tosiç (emri nuk na është i panjohur) komandant policie nga Lipjani, do të identifikohej nga katër dëshmitarë si person që kishte qenë i pranishëm në Sllovi në kohën e kryerjes së mizorive më 16 dhe 17 prill. Ndonëse dëshmitarë të ndryshëm nga fshati i Sllovisë dhe ai i Topliçanit mëtojnë se, Tosiç ishte përfshirë në akte të ndryshme si zjarrvënie dhe detyrimin e civilëve të linin fshatin, një tjetër dëshmitare, D. N., që e përshkroi Tosiçin si "person përgjegjës", i tha Human Rights Watch se, ai kishte ndërhyrë për t'i shpëtuar bashkëshortin nga pushkatimi prej paraushtarakëve më 16 prill.[65] Milivoje Pejiç, zëvendës shef i policisë në Janjevo, do të përmendej me emër nga katër dëshmitarë, si një nga komandantët që kishin qenë të pranishëm në Sllovi, gjatë vrasjeve të kryera më 16 prill. Një oficer i tretë policie nga fshati i Sllovisë, i identifikuar si "Tomçe, i biri i Miliçit" do të përmendej me emër nga dy dëshmitarë të intervistuar prej Human Rights Watch, si person që kishte qenë i pranishëm në fshat përgjatë muajve prill dhe maj.

Disa oficerë policie do të identifikoheshin me emër e mbiemër nga një numër dëshmitarësh nga Sllovia



Michael S. Miller/ Human Rights Watch, 2002

9

KOMUNA E RRAHOVECIT

Me një veprimtari të rregullt të UÇK-së në këtë krahinë gjatë gjithë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, komuna e Rrahovecit do të ishte vatër e tensioneve dhe e dhunës, si para ashtu edhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Përafërsisht 90 përqind e komunës banohet nga shqiptarë etnikë dhe në të ka vetëm një fshat, Hoçë e Madhe, të banuar kryesisht nga serbë.

Më 19 korrik të vitit 1998, UÇK u përpoq të zotëronte qytetin e Rrahovecit. Policia do ta rifitonte kontrollin mbi qytetin dy ditë më pas dhe sakaq nisi një ofensivë që zgjati gjithë stinën e verës, gjatë së cilës serbët rimorën bazën e UÇK-së në Malishevë, si dhe një pjesë të konsiderueshme të territorit në mbarë Kosovën, që UÇK e kish deklaruar të "çliruar". Civilë serbë dhe shqiptarë u vranë në betejën e Rrahovecit, ndërsa një dyzinë njerëzish rezultojnë ende të zhdukur edhe sot e gjithë ditën.[1]

Krimet e luftës, si vrasjet dhe rrëmbimet e civilëve, do të vijonin nga të dy krahët përgjatë gjithë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, teksa objektiv kryesor i UÇK-së do të qenë civilët serbë në Hoçën e Madhe.[2] Gjatë bombardimeve të NATO-s, shqiptarët etnikë nga kjo komunë do të njihnin fshatarë serbë nga Hoça e Madhe mes trupave që kryen ekzekutime në shkallë të gjerë të civilëve shqiptarë të kësaj krahine.

Gjatë sulmeve ajrore qyteti i Rrahovecit do të përjetonte dëbime të dhunshme dhe vrasje sporadike. Krimet më të rënda do të kryheshin në periudhën ndërmjet 24 dhe 26 marsit, në pjesën jugperëndimore të komunës, midis Bellaçerkës dhe Piranës, përgjatë kufirit administrativ me komunën e Prizrenit. Për shkak se këto fshatra u mësynë gjatë një ofensivë të vetme, ato do të trajtohen si një njësi në kreun mbi rrugën Prizren-Gjakovë. Krimi më i madh i kryer në komunën e Rrahovecit, larg

rrugës, do të ishte vrasja e më shumë se njëqind njerëzve në Pastasellë, siç është dokumentuar edhe më poshtë.

Policia serbe e Rrahovecit varej nga Sekretariati i Punëve të Brendshme, ose thënë ndryshe SUP, të Prizrenit (i cili mbulonte komunat e Prizrenit, Rrahovecit, Suharekës dhe Dragashit). Koloneli Gradimir Zhekavica ishte komandanti i SUP-t të Prizrenit, të paktën deri më janar 1999, ndërkohë që nëntogeri Millan Gjuriçiç ishte kreu i seksionit të departamentit të policisë të SUP-it, në Prizren.[3] Sipas revistës së policisë, të janarit 1999, koloneli Millosh Vojnoviç u caktua komandanti i ri i SUP-it në Prizren, duke shërbyer në të njëjtën kohë edhe si asistent shef i departamentit të policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. [4] Por, nisur nga medaljet e dhëna oficerëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme pas luftës, rezulton se Zhekavica ishte komandanti i SUP-it të Prizrenit në vitin 1999 (shih forcat në konflikt).

Në gusht të vitit 1999, trupat e KFOR-it arrestuan ish-kryetarin e bashkisë së Rrahovecit, Angjelko Kolasinac, tok me më shumë se një dyzinë serbësh të Rrahovecit. Më 14 qershor 2001, gjykata e distriktit të Prizrenit e gjykoi Kollasinacin dhe një serb tjetër nga Rrahoveci, Çedomir Jovanoviçin, për krime lufte kundër popullsisë civile të Rrahovecit dhe i dënoi ata përkatësisht me pesë dhe njëzet vjet burg. Sipas Qendrës Ligjore Humanitare që monitoroi gjyqin, të akuzuarit nuk patën një gjykim të drejtë.

PASTASEL

Njëqind e gjashtë shqiptarë etnikë u ekzekutuan njëherazi dhe pa gjyq më 31 mars 1999, në Pastaselë, një fshat i vogël, pranë qytetit të Rrahovecit. Human Rights Watch e vizitoi fshatin më 26 qershor 1999, duke intervistuar tre nga trembëdhjetë të mbijetuarit e masakrës, si dhe një person tjetër që kishte ndihmuar për varrosjen e kufomave. Ky i fundit foli për një operacion ushtarak të mirëbashkërenduar në fshat, që do të pasohej me përzënien nga fshati të grave dhe vrasjen e burrave. Përleshjet e mëparshme midis UÇK-së dhe forcave qeveritare, në fshatin aty pranë të Drenocit, mund të kishin precipituar në një plojë. [5]

Njëqind e gjashtë shqiptarë etnikë u ekzekutuan njëherazi.

Pesëdhjetë e shtatë vjeçari B. K. është një nga të mbijetuarit që i përshkroi ngjarjet në mënyrë të detajuar. Ai shpjegoi se si një numër i

madh forcash serbe të sigurimit, duke përfshirë këtu edhe paraushtarakët me shami të kuqe në krye, e sulmuan Pastaselin më 31 mars, duke vënë në përdorim tanket, artilerinë dhe mortajat. "Dy tanke ishin vendosur lart në kodër; katër tanke erdhën dhe hynë në fshat, ndërsa një tjetër zbriti poshtë aty ku ndodheshin edhe njerëzit," tha B. K.[6] Fshatarët e Pastaselës, të cilëve iu ishin bashkangjitur edhe një numër banorësh nga fshatrat përreth – mbi 2000 vetë gjithë-gjithë – gjetën strehë në një fushë aty pranë, më të poshtë kodrës së Pastaselës. Rreth orës 3 të pasdites, ata iu dorëzuan paraushtarakëve që i kishin rrethuar, duke tundur në drejtimin e tyre beze të bardha.

Trupat serbe ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët, kontrolluan në trup gratë dhe iu konfiskuan paratë dhe sendet e çmuara. Burrat ishin pothuajse të gjithë mbi pesëdhjetë e pesë vjeç, ngaqë të rinjtë ishin larguar nëpër kodra. Rreth orës 4.30 të pasdites gratë u përzunë nga fshati nën komandën "Shkoni në Shqipëri!"

Pasi gratë u larguan, forcat serbe urdhëruan burrat të zbraznin xhepat dhe iu vodhën disa mijëra marka gjermane që iu gjetën në to. "Ne iu përgjëruam atyre të kursenin jetët tona," tha T. K., pesëdhjetë e katër vjeç, një nga të mbijetuarit. "Ne iu dhamë atyre gjithë paratë që kishim, në mënyrë që mos të na vrisnin." [7] Serbët iu konfiskuan fshatarëve gjithashtu edhe letërnjoftimet. B. K. tha se kur i morën dokumentat, serbët i thanë atij: "Letërnjoftimet s'kanë për t'ju hyrë në punë atje ku do të shkoni."

Forcat serbe ndanë një grup prej shtaë, tetë të rinjsh për t'i marrë në pyetje dhe rrahur egërsisht, duke dashur të dinin nëse ata bënin pjesë në radhët e UÇK-së. Paskëtaj grupi i të rinjve u rreshtua diku aty pranë dhe u qëllua me armë automatike nga shtatë a tetë anëtarë të forcave serbe të sigurimit, të cilët, sipas mendimit të dëshmitarëve, ishin paraushtarakë. "Serbët ishin veshur me uniforma kamuflazhi policie në ngjyrë të gjelbër. Në kapele mbanin shenja të shndritshme metalike; se ishin shenja të forcave të Arkanit apo të Shesheljit, për këtë nuk jemi të sigurt," tha T. K. Një tjetër grup prej afro njëzet e pesë burrash u shpunë buzë një rrëpire dhe u vranë në të njëjtën mënyrë.

Copa teshash dhe këpucë ishin hapërdarë rreth e qark rrëpirës mes shkurreve, ku edhe ishin kryer vrasjet.

"Ata u kthyen të vendi ku ndodheshim dhe na pyetën nëse kishim parë çfarë kishte ndodhur, duke na thënë se 'edhe ju për atje jeni nisur,'" tha B. K. Në llogari të fundit, katër grupe, secili i përbërë nga njëzet e pesë

deri në tridhjetë vetë, do të shpihej në buzë të rrëpirës dhe atje do të ekzekutoheshin me armë automatike.

Një nga hulumtuesit e Human Rights Watch do të fliste më vete me të mbijetuarit e grupit të dytë, të tretë e të katërt, të cilët, më 26 qershor 1999, e shpunë hulumtuesin në fushën ku kishin pasë qenë mbledhur fshatarët, si dhe në rrëpirën aty pranë ku qenë ekzekutuar burrat. Çdonjëri nga të tre personat bëri një përshkrim të hollësishëm e të qëndrueshëm për ngjarjet e asaj dite. Në vendngjarje nuk kishte shenja të dukshme gjaku, por copa teshash dhe këpucë ishin hapërdarë rreth e qark rrëpirës mes shkurreve, ku edhe ishin kryer vrasjet. "Unë rashë para se të nisnin të shtënat," do të shpjegonte B. K., i cili bënte pjesë në grupin e katërt. Dhe vijoi: "Dy të vrarë ranë sipër meje. Unë nuk bëra asnjë lëvizje. Pas nja dy minutash, dikush tha, shtjerë përsëri dhe unë u qëllova. Ndenja i fshehur nën trupat për afro njëzet minuta të tjera, deri sa u sigurova që ata ishin larguar; paskëtaj, ia mbatha më të poshtë kodrës."[8] Njëri nga hulumtuesit e Human Rights Watch pa të gërvishturën e plumbit në mollaqen e majtë të B. K.-së, si dhe ndërresat e përgjakura që kish pasur në trup asokohe.

Forcat serbe u kthyen në Pastaselë për të zhdukur dëshmitë fizike të krimeve.

Një tjetër person me inicialet B. K., gjashtëdhjetë vjeç – kushëri i B. K.-së së mëparshëm – do t'i shpëtonte gjithashtu vdekjes. "Ata (trupat serbe) nuk ishin nga këto anë, ndaj dhe nuk e njihnin terrenin," na shpjegoi ai. "U tregova më i shkathët se ata dhe rrëshqita mbrapa ca shkëmbinjve."[9] Gjithë-gjithë do të shpëtonin nga masakra trembëdhjetë vetë, duke përfshirë edhe vëllain e vogël të B. K.-së, ndërsa vëllai i tretë, M. K., pesëdhjetë vjeç do të mbetej i vrarë.

Tre të mbijetuarit do të tregonin se, një ditë më pas, serbët do të nxirrnin nga zgafella rreth njëzet-njëzet e pesë kufoma dhe do t'i digjnin në një nga shtëpitë e fshatit. Burrat e fshatit që varrosën më vonë atë çka kish mbetur nga kufomat, do të pohonin se pas djegies, trupat ishin katandisur në atë gjendje sa nuk njiheshin, dhe veç ca kocka iu kishin mbetur.

Trupat serbe do ta braktisnin fshatim po atë ditë, duke mos i ngarë kufomat që kishin mbetur në fund të rrëpirës, rreth shtatëdhjetë e pesë a tetëdhjetë. Fshatarëve të kthyer do t'u lypseshin dy ditë t'i mbartnin kufomat në majë të kodrës, në një vend pranë xhamisë së fshatit, ku edhe do të varroseshin. Para se varrimi të përfundonte, paraushtarakët serbë u kthyen rishtazi në fshat, duke i shtrënguar banorët të largoheshin

nëpër male. Çka kishte mbetur nga varrimi do të riniste po atë ditë që serbët u larguan; dhe do të përfundonte më 3 prill. "Ishim jashtëzakonisht të frikësuar, ndaj dhe nxituam që t'i varrosnim sa më parë," do të pohonte R. K., një fshatar që ndihmoi në hapjen e varreve.[10]

Katër ditë pas varrimit, një tjetër sulm serb mbi fshatin i shtrëngoi fshatarët të largohen sërish, ndërkohë që trupat serbe e pushtuan përkohësisht fshatin.[11] "Çdo ditë e këqyrnim fshatin për të parë në qoftë se serbët ishin larguar," tha T. K., i cili shpjegoi se ata përdornin dylbi për të vëzhguar lëvizjet e serbëve.

Më 11 prill 1999, NATO transmetoi pamje të marra gjatë një fluturimi me karakter zbulues i kryer më datë 9 prill, përmes të cilave shpalosej vendndodhja e një varri masiv në Pastaselë. Fotografia tregonte dy linja të gjata paralele, çdonjëra prej tyre e përbërë nga një dyzinë pirgjesh dheu të pashtruar; kjo u çiftua me një tjetër që zëdhënësi i NATO-s tha se ishte një fotografi më e hershme e të njëjtit vend, në të cilën nuk të zinte

Më 11 prill NATO shpërndau foto satelitare të një vendi në Pastasel ku mendohej të ish një varr masiv. Dy javë më vonë, sipas dëshmitarëve, forcat serbe i zhvendosën trupat.

BURIMI: DEPARTAMENTI I SHTETEVE TE BASHKUARA

syri pirgje të freskët dheu të saporrëmihur.[12] Dëshmia e varreve masive ishte përmendur gjerësisht në median Perëndimore.[13]

Pothuaj dy javë pas publikimit të fotografive, forcat serbe u kthyen në Pastaselë për të zhdukur dëshmitë fizike të krimeve. T. K. i tha Human Rights Watch se, përafërsisht më 24 prill, ai kishte parë individë të paidentifikuar të ekzumonin trupat, duke përdorur një traktor të vogël për gërmuar në vendndodhjen e varrit. "Mbanin maska dhe ishin veshur me pajisje mjekësore," tha ai. "Trupat i ngarkuan në dy kamionë civilë që i nisën në drejtim të Rrahovecit."[14] *Panorama*, një program lajmesh i BBC-së, reporterët e së cilës e vizituan Pastaselën menjëherë pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, siguruan video, të cilat, siç u tha, ishin xhiruar nga fshatarë shqiptarë, që e kishin monitoruar zhvarrosjen e kryer prej serbëve nga një kodër mbi vendndodhjen e varrit. Videoja tregon një kamion të madh dhe policë e punëtorë me veshje mbrojtëse në punë e sipër pranë xhamisë. BBC-ja do të deklaronte se hetimet e kryera prej saj do të përcaktonin se disa prej trupave të zhvarrosur ishin shpënë në fshatin Xerxe, në jugperëndim të Rrahovecit, ku edhe ishin rivarrosur në varrezën e fshatit.[15]

Sipas *Agence France Presse*, më 24 prill, e përditshmja holandeze *Algemen Daglabed* do të botonte një artikull që hidhte hijen e dyshimit mbi vërtetësinë e pohimeve të NATO-s për varrin masiv në Pastaselë.[16] Një ekspert hartash holandez, i cituar nga gazeta, mëtonte se fotografitë ajrore të Pastaselës shpalosnin një sërë pasaktësish. Ç'është e vërteta, artikuj që vinin në dyshim pohimet mbi vrasjet në Pastaselë, do të vijonin të qarkullonin edhe shumë kohë pasi përshkrimet e drejtpërdrejta të të mbijetuarve të masakrës do të bëheshin të njohura.[17] Intervistat dhe inspektimet në vendngjarje të kryera nga vetë Human Rights Watch, do të konfirmonin faktin se masakra kishte ndodhur ashtu siç ishte raportuar fillimisht, dhe se qeveria në krye i kishte groposur kufomat dhe më pas i kishte zhvendosur.

Kur Human Rights Watch do të vizitonte Pastaselën, në qershor të vitit 1999, fshatarët i kallzuan vendvarrimin pranë xhamisë së fshatit. Një pjesë e gardhit që rrethonte vendin qe shkallmuar; në brendësi të vendit mund të shihej një sipërfaqe trualli i së cilës nuk qe i rrafshtë e i sheshuar. Fshatarët, duke folur për të afërmit, trupat e të cilëve ishin 7
zhdukur, e shihnin atë vend të brengosur. "Fakti që nuk dimë se ku janë fshehur trupat e tyre është për ne njëlloj sikur t'i kenë vrarë për herë të dytë," deklaroi T. K., duke shprehur atë çka ndjenin edhe gjithë të tjerët.[18]

10

KOMUNA E PEJËS

Më shumë se çdo krahinë tjetër në Kosovë, komuna e Pejës ka një kuptim të veçantë për serbët. Kjo krahinë është streha e një sërë objektesh të rëndësishme të ortodoksizmit serb, duke përfshirë këtu Patriarkanën e shekullit të gjashtëmbëdhjetë të Pejës, që ndodhet jo fort larg qytetit të Pejës. Para vitit 1999, serbët përbënin përafërsisht 15 përqind të një komune me 150.000 banorë.

Duke pasur një popullsi të përzierë, qyteti i Pejës do të ishte tejet i tensionuar qysh nga fillimi i konfliktit të brendshëm të armatosur, në mars të vitit 1998. UÇK-ja ndodhej në kodrat në perëndim dhe në malësitë në jug-lindje, kësisoj një sërë pritash do të ngriheshin kundër policisë, sidomos përgjatë rrugës në jug të Pejës që shpie në drejtim të Deçanit dhe Gjakovës. Në verë të vitit 1998, do të zhvilloheshin luftime të ashpra midis UÇK-së dhe trupave serbe në fshatin e Loxhës, fare pak kilometra nga qendra e qytetit. Për të parën herë gjatë asaj lufte, trupat qeveritare vunë në përdorim aeroplanët për të sulmuar UÇK-në.[1]

Gjendja në qytet do të bëhej dukshëm më e tensionuar pas 14 dhjetorit 1998, kur vrasës të panjohur hapën zjarr dhe vranë gjashtë të rinj serbë në Kafe Panda.[2] Policia iu përgjigj duke organizuar kontrolle në Zatër dhe Kapeshnicë, në rrethinat e kafenesë, duke i lejuar vetes abuzime me një pjesë të madhe të banorëve shqiptarë. Dimri, deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s, do të bëhej dëshmitar i rrahjeve të shumta të shqiptarëve etnikë, si dhe i një numri vrasjesh enigmatike. Qeveria do të thoshte se ishte UÇK-ja që i vriste shqiptarët, ngaqë ata i qëndronin besnikë qeverisë.

Gjatë bombardimeve të NATO-s, qyteti i Pejës nuk do të përjetonte atë shkallë të lartë dhune siç do të ndodhte në qytetet e tjerë. Ndërkohë që në fshatrat rreth e qark qytetit do të ndodhnin vrasje në shkallë të gjerë, si në Lubeniq, Qyshk, Pavlan dhe Zahaq – sipas një grupi lokal për të drejtat e njeriut, numri i të vrarëve do t'i kalonte të pesëqindët [3] – dhe ndoca



Michael S. Miller/ Human Rights Watch, 2002

incidenteve serioze brenda në qytet, në përgjithësi Peja do t'i shpëtonte vrasjeve masive, siç do të ndodhnin në qytetë të tjerë, bie fjala në Gjakovë.

Efektiviteti i policisë në fushatën e 'spastrimit etnik' në qytet është një nga shpjegimet. Sipas një vlerësimi, brenda javës së parë të luftës 90 përqind e shqiptarëve etnikë banorë të Pejës, do të dëbohej forcërisht. Operacioni i "spastrimit etnik" do të ishte ndër më mirë të organizuarit në Kosovë, me autobusë që rrinin në pritje në qendër të qytetit për t'i marrë njerëzit dhe transportuar në jug, në drejtim të Shqipërisë.

Shqiptarët etnikë në këtë krahinë janë në gjendje të sigurojnë informacion të vlefshëm rreth individëve që kanë kryer krime.

Një tjetër ndryshim që ka Peja me komunat e tjera është se, falë faktit që ka një popullsi të përzierë, shqiptarët etnikë në këtë krahinë janë në gjendje të sigurojnë informacion të vlefshëm rreth individëve që kanë kryer krime, si dhe të hedhin vështrime ndriçuese rreth strukturave të ndryshme policore dhe ushtarake, që kryen operacione gjatë luftës. Në disa raste, shqiptarët do të njihnin fqinjët e tyre serbë që kishin marrë pjesë në plaçkitje qoftë si civilë qoftë në përbërje njësive ushtarake që kishin kryer ekzekutime. Bazuar në dëshmitë e tyre, Human Rights Watch ka identifikuar me sukses disa nga individët të përfshirë në plaçkitje, keqtrajtime dhe vrasje që ndodhën në pjesë të ndryshme të qytetit, si dhe në fshatrat përqark. Një fragment, po në këtë kapitull, rreth fshatit Qyshk, është veçanërisht i gjatë dhe i detajuar ngaqë disa prej kriminelëve janë identifikuar me emër dhe fotografi.

Nga burime në Pejë që dëshironin të mbeteshin anonimë, Human Rights Watch siguroi kopje të një dokumenti zyrtar të Ushtrisë Jugosllave, me shënimin "Sekret Ushtarak, Tepër Konfidencial", i nënshkruar nga nënkoloneli Dushko D. Antiç. Edhe pse autenticiteti i dokumentit nuk mund të verifikohet me siguri, koka, numri i protokollit dhe vula përkojnë me dokumentat zyrtarë të ushtrisë. Ky dokument i datës 30 mars 1999, i vendos të gjithë organet qofshin ato republikane apo komunale të Pejës nën kontrollin e ushtrisë dhe bën fjalë për "zhvendosjen e një pjese të popullsisë nga Departamenti Ushtarak i Pejës." Duke folur me gjuhë ligjore, të gjithë aksionet në Pejë vendoseshin nën autoritetin e Ushtrisë Jugosllave.

Nënkoloneli Antiç është gjithashtu edhe autori i një ditari të gjetur në krahinën e Pejës, i parë nga veprimtarë jugosllavë të të drejtave të njeriut, si dhe gazetarë të huaj, i cili besohet se është autentik. Sipas Natasha Kandiç nga Qendra Humanitare e Ligjeve, një nga grupet jugosllavë të të drejtave të njeriut më të besueshëm, libri, të cilin ajo e ka parë, është nënshkruar nga Antiç dhe regjistron veprimtaritë ushtarake në krahinën e Pejës pas 24 marsit të vitit 1999.[4] Siç është përshkruar në Forcat e Konfliktit, komandant i Sekretariatit për Punët e Brendshme të Pejës, që mbulon

edhe komunat e Pejës, Klinës dhe Istogut ishte koloneli Boro Vllahoviç.[5]

Ka një shumicë dërrmuese dëshmish që policia, trupat speciale të policisë dhe paraushtarakët kanë vepruar në bashkëpunim të ngushtë me ushtrinë në krahinën e Pejës. Në një sërë intervistash dhënë gazetarëve të huaj, zyrtarë të policisë dhe ushtrisë, si dhe anëtarë të trupave paraushtarake, kanë folur për veprimtaritë e tyre të bashkërenduara. Një zyrtar, pa emër, i Ushtrisë Jugosllave, i tha një reporteri, "Ushtria jugosllave në mënyrë të ndërgjegjshme dhe e vendosur i ka mbrojtur (paraushtarakët)."[6]

Por në mënyrë më të drejtpërdrejtë, dëshmitarë nga Peja dhe zonat përqark saj, kanë folur vazhdimisht rreth aksioneve të dhunshme të paraushtarakëve, që lejoheshin të vepronin përkrah ushtrisë. Ashtu si në Qyshk, ushtria merrej me sigurimin e çdo perimetri të fshatit të sulmuar ose kontrollonte rrugët kryesore, ndërkohë që grupe të vogla të milicisë mësynin, duke kryer abuzime serioze përgjatë aksioneve të tyre. Në Pejë as ushtria as policia nuk ndërhynë në ndonjë rast t'iu ndalnin dorën paraushtarakëve gjatë aksioneve të dhunshme.

Në krahinën e Pejës kanë vepruar një numër i larmishëm grupesh paraushtarake, një pjesë e tyre të lidhur me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Një prej këtyre grupeve quhej "Ndriçimi" (Munja) dhe drejtohej nga një polic i quajtur Vidomir Salipur. Salipuri, siç njihej në Pejë, do të vritej nga UÇK-ja më 8 prill (shih certifikatën e vdekjes). Në njoftimin publik për vdekjen e tij kumtohet se ai ishte anëtar i PJP (Posebna Jedinica Policije, ose Njësisë Speciale të Policisë), si dhe të një grupi të quajtur OKB (mendohet të jetë Operativni Grupa ose Grupit Operativ). Grupet e tjera që do të përmendeshin në mënyrë të vazhdueshme nga banorët e Pejës përfshijnë edhe Dorën e Zezë, Tigrat e Arkanit, si dhe Shqiponjat e Bardha të Zëvendëskryeministrit serb Vojisllav Sheshelj, ndonëse ne zotërojmë vetëm dëshmi anekdotike të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të këtij grupi në abuzime.

Edhe civile serbë do të merrnin pjesë në këto abuzime, veçmas në plaçkitjen dhe djegien e pronave të shqiptarëve. Dëshmitarë të ndryshëm nga qyteti i Pejës kanë raportuar se kanë parë fqinjët e tyre duke mbartur orendi private, madje një pjesë e tyre kanë qenë pjesëmarrës në aksionet e grupeve të milicisë. Pjesë nga ditari i një gruaje serbe nga Peja, që përshkruante veprimtaritë e serbëve lokalë, janë cituar më sipër, në kreun Forcat e Konfliktit.

Dokumenti që vijon, i datës 30 mars 1999, i vendos gjithë autoritetet qeveritare të komunave të Pejës, Istogut, Klinës dhe Deçanit nën komandën e Ushtrisë Jugosllave. Hyrja gjithashtu i referohet një urdhëri nga "Komanda Supreme" për "zhvendosjen e një pjese të popullsisë."

Достављено: 01.IV.99 г. у 17 часова

1КОМАНДА ВОЈНОГ ОДСЕКА ПЕЋ
Стр.пов.бр. 69-1
Дане,30.03.1999.године

ВОЈНА ТАЈНА
СТРОГО ПОВЕРЉИВО

Функционисање живота
и рада у Зони одговорности
ВОд-а Пећ,НАРЕЂЕЊЕ.-

Бранислав Вуковић

На основу Наредбе Врховног Команданта о проглашењу ратног стања, те пресељења дела становништва из зоне одговорности ВОд-а Пећ, а у циљу правилног функционисања укупног живота у зони одговорности ВОд-а Пећ,

Н А Р Е Ђ У Ј Е М:

1.- Сви Републички и општински органи власти стављају се под команду ВОд-а Пећ, и то на територијама општина: Пећ, Исток, Клина и Дечане.
На територији општине Ђаковица одговорна команда гарнизона Ђаковица.

2.- За општину Пећ формирати штаб састава (овај штаб је претпостављени и штабовима општина Исток, Клина и Дечане)
- Командант штаба: командант ВОд-а Пећ
- заменици команданта: Јово Поповић, начелник Пећког округа и Симеон Радовић председник извршног одбора општине Пећ.
- чланови штаба по виталним областима функционисања живота и рада:
а)- За снабдевање становништва животним намирницама:
Бијелић Томо, директор ДД "17 Новембар", а његов заменик Томовић Небојша, начелник одељења тржишне инспекције.

б)- За здравство становништва
- примаријус ДР Вујошевић Драгутин директор здравства Пећ а његов заменик примаријус Др. Војислав Поповић.

в)- За комунална послова и асанацију територије у случају дејства штг
Влаховић Слободан, директор јавног комуналног предузећа, а његов заменик Здравковић Милисоје директор дирекције за градњу.

г)- За привредне делатности:
професор доктор Слободан Јокић, директор"застава"а његов заменик Меденица Данило, директор "Пећке Пиваре"

д)- За снабдевање и расподелу нафних деривата, Кнежевић, директор "Југопетрола", а његов заменик Лазовић Бранко, управник бензинске пумпе "Југопетрола"

ђ)- За информисање јавности,
Зечевић Драгана, главни и одговорни уредник радио " Метохије", а њен заменик Дивић Весна, дописник РТС.

ж)- За правосуђе:
Гојковић Радомир, председник Окружног суда Пећ,
а његов заменик, Миладин Поповић окружни тужилац.

з)- За прикупљање материјалних добара расутих деловањем штг
Бранислав Вуковић, координатор финансијске полиције, а
његов заменик Небојша Давић шеф одељења трајне инспекције
Пећког округа.

и)- За јавни превоз и транспорт:
Радош Радуловић, директор ДД "Аутопревоз", а његов заменик
Новица Антић, Републички инспектор друмског саобраћаја.

ј)- За збрињавање расељених лица дејством штг:
Томислав Лакићевић, секретар општинске организације СПС
Пећ, а његов заменик, Олга Обрадовић, директор центра за
социјални рад.

љ)- За јавни ред, мир, сузбијање криминала, гашење пожара
и друге задатке из надлежности МУП-а:
начелник МУП-а Пећ а заменик начелник полиције МУП-а Пећ.

3.- У општинама Исток , Клина и Дечани формирати исте сваке штабове под командом команданата ВТОд-е а у општини Дечане под командом председника општинског већа Ђурковић Милисија. Исти су у обавези да донесу Наређење о формирању штабова у својим зонама одговорности које ми у писаној форми доставити дана 31.03.1999.године до 16,00 часова.

4.- Начелник МУП-а Пећ, својом наредбом регулисаће јавни ред, мир, спречавање крађе разбијања објеката, злостављање грађана, гашење евентуалних пожара и сузбијању свих криминалних радњи коју ми у писаној форми доставити дана 31.03.1999.године до 16,00 часова.

5.- Начелник одељења НО својом наредбом регулисаће питање заштите становништва од ваздушних удара (узбуњивање, обавештавање, склањање људства у склоништа) и друга питања за заштиту становништва а исту ми доставити не узнд дана 31.03.1999.године до 16,00 часова .

6.- Чланови штаба општине Пећ реферишу ми свакодневно у 09,00 часова о проблемима, предлозима за решавање истих и појавама чије деловање може имати негативног утицаја на одбрамбену способност становништва.

7.- Команданти штабова општина Исток, Клина и Дечани свакодневно у 11,00 часова извештавају ме по питањима из тачке 6, овог наређења.

8.- У командовању са свим штабовима у општинама Пећ, Клина, Исток и Дечане ангажовати:
мајора Гојковић Ранка, рез. мајора Дашић Илија, кІн Булатовић Дејана, кІн Ивчић Милана и кІн Радослава Арсенијевића.

9.- Ова Наредба ступа на снагу дана 31.03.1999.године у 8,00 часова и ће се строго придржавати до укидања исте. У случају не извршења или пропуста у извршавању задатака из ове Наредбе важе ратни закони СРЈ.

ДА/АЕ

К О М А Н Д А Н Т
потпуковник
Ђорђе Д. Антић

ВОЈНИ ОДСЕК
ПЕП

Shtabi i Departamentit të Ushtrisë së Pejës
Str. Pov. No. 612 – 1
30 mars 1999.

SEKRET USHTARAK
TEPËR KONFIDENCIAL

Funksionimi i përditshëm i jetës dhe i punës në zonën që ndodhet nën përgjëgjësinë e Departamentit Ushtarak të Pejës. URDHËR.
Branisllav Vukoviç
(me shkrim dore)

Në bazë të urdhërit të Komandantit Suprem, për shpalljen e gjendjes së luftës dhe shpërnguljen e një pjese të popullsisë nga zona e përgjegjësisë e Departamentit Ushtarak të Pejës, me qëllim funksionimin korrekt të jetës në të gjitha fushat në zonën nën përgjegjësinë e Departamentit Ushtarak të Pejës,

UNË LËSHOJ KËTË URDHËR:

1.– Gjithë organet qeveritare republikane dhe komunale do të vendosen nën komandën e DU (departamentit ushtarak) të Pejës në komunat që vijojnë: Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan. Shtabi i garnizonit të Gjakovës është përgjegjës për territorin e komunës së Gjakovës.
2.– Për komunën e Pejës të formohen shtabe (këto shtabe duhet të konsiderohen sipërore kundrejt shtabeve të komunave të Istogut, Klinës dhe Deçanit):
   — Komandant i shtabit: komandanti i DU të Pejës.
   — Zëvendëskomandant i shtabit: Jovo Popoviç, shef i rajonit të Pejës dhe Simeon Radoviç, shef i këshillit ekzekutiv të komunës së Pejës.
   — Anëtarë të shtabit në zonë lidhur me aspektet jetike të funksionimit të jetës dhe punës së përditshme:
      a) – Përgjegjës për furnizimin me ushqime të popullsisë: Tomo Bijeliç, drejtor i DD "17 nëntori" dhe si zëvendës i tij, Nebojsha Tomoviç, shef i sektorit për inspektimin e tregut.
      b) – Për shëndetin e popullsisë
         Shefi i stafit të spitalit Dragutin Vujosheviç, MD, drejtor i departamentit të shëndetsisë së Pejës dhe si zëvendës i tij, shefi i stafit të spitalit Vojisllav Popoviç, MD.

c) – Përgjegjës për shërbimet komunale dhe pastrimin në rast të një aksioni stg Sllobodan Vllahoviç, drejtor i ndërmarrjes komunale, dhe si zëvendës i tij Milivoje Zdravkoviç, shef i departamentit të ndërtimit.

d) – Për çështjet ekonomike:

Prof. Dr. Sllobodan Jokiç, drejtor i "Zastava"-s, dhe si zëvendës i tij Danillo Medenica, drejtor i "Peçka Pivara"

e) – Për furnizimin dhe shpërndarjen e derivatëve të naftës, Knezheviç, drejtor i "Jugopetrol"-it, dhe si zëvendës i tij Branko Llazoviç, administrator i stacionit të naftës të "Jugopetrol"-it.

f) – Për shpërndarjen e informacionit publik,

Dragana Zhezheviç, kryeredaktore e radiostacionit "Metohija", dhe si zëvendëse e saj Vesna Daviç, korrespondente e RTS.

g) – Për administratën gjyqësore:

Radomir Gojkoviç, Kryetar i Gjykatës komunale të Pejës dhe si zëvendës i tij Milladin Popoviç, prokuror i rrethit.

h) – Për mbledhjen e të mirave materiale të shpërndara si pasojë e një aksioni të stg: Branisllav Vukoviç, koordinator i policisë financiare, dhe si zëvendës i tij Nebojsha Daviç, përgjegjës për inspektimin e tregut në komunën e Pejës.

i) – Për transportin publik:

Radosh Raduloviç, Drejtor i "Autoprevoz", dhe si zëvendës i tij Novica Antiç, inpektor i trafikut.

j) – Për përkujdesjen ndaj të pastrehëve si pasojë e aksioneve të stg:

Tomisllav Lakiçeviç, sekretar i organizatës së PSS për komunën, dhe si zëvendës i tij Ollga Obradoviç, drejtoreshë e qendrës së shërbimeve sociale.

k) – Për rendin publik, qetësinë dhe parandalimin e veprimtarive kriminale, marrjen e masave në rastet e rënieve të zjarrit, si dhe të çështjeve të tjera që hyjnë në sferën e përgjegjësisë së MUP (Ministrisë së Punëve të Brendshme):

I ngarkuari për Pejën i MUP, dhe si zëvendës i tij zëvendës shefi i departamentit të policisë për Pejën.

3. – Në komunat e Istogut, Klinës dhe Deçanit të ngrihen të njëjtat shtabe nën komandën e komandantit të VTO, ndërsa në komunën e Deçanit nën komandën e kryetarit të këshillit komunal Milivoje

Gjurkoviq. Personat e sipërpërmendur janë përgjegjës për nxjerrjen e një urdhëri me shkrim lidhur me ngritjen e shtabeve në zonat përkatëse nën përgjegjësinë e tyre, urdhëra që do të më paraqiten jo më vonë se data 31 mars 1999, ora 16.00.

4. – I ngarkuari për Pejën i MUP nëpërmjet këtij urdhëri do të rregullojë sigurimin publik, rendin, parandalimin e vjedhjeve, shkatërrimin e objekteve publike, keqtrajtimin e qytetarëve, parandalimin e djegieve të mundshme dhe çrrënjosjen e gjithë veprimtarive kriminale. Ky (urdhër) do të më paraqitet mua, në formë të shkruar, jo më vonë se 31 mars 1999, ora 16.00.
5. – Nëpërmjet këtij urdhëri shefi i seksionit të NO do të rregullojë çështjen e mbrojtjes së civilëve nga sulmet ajrore (inkursionet ajrore, informimet, sistemimin e njerëzve në strehimet kundërajrore), si dhe të gjitha problemet e tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e civilëve dhe do ta paraqesë atë (të shkruar) për ta mbikëqyrur, jo më vonë se data 31 mars, ora 16.00.
6. – Anëtarët e shtabeve të komunës së Pejës do të raportojnë tek unë, çdo ditë, në orën 09.00, rreth problemeve dhe masave për zgjidhjen e tyre, si dhe për të gjitha çështjet e tjera që mund të kenë një ndikim negativ në aftësinë mbrojtëse të popullsisë.
7. – Komandantët e shtabeve të komunave të Istogut, Klinës dhe Deçanit do të raportojnë tek unë, çdo ditë, ora 11.00, lidhur me të gjitha çështjet e përmendura në pikën 8 të këtij Urdhëri.
8. – Personat e ngarkuar për drejtimin e shtabeve të komunave të Pejës, Klinës, Istogut dhe Deçanit janë si më poshtë:

   Major Ranko Gojkoviç, Major në rezervë Ilija Dashiç, Kapiten i Klasit të Parë Dejan Bullatoviç, Kapiten i Klasit të Parë Millan Iviçiç dhe Kapiten i Klasit të Parë Radosllav Arsenijeviç.
9. – Ky urdhër hyn në fuqi më datë 31 mars, ora 08.00 dhe do të zbatohet në mënyrë strikte derisa të shfuqizohet. Në rast moszbatimi ose shpërfilljeje në ekzekutimin e detyrave të dala nga ky urdhër, do të zbatohet ligji për gjendjen e luftës në fuqi në RFJ.

KOMANDANT
Nënkolonel
Dushko D. Antiç
(firma)
(vula) Departamenti Ushtarak i Pejës

QYTETI I PEJËS

"Spastrimi"

Dhuna kundër popullsisë etnike shqiptare në qytet, nisi menjëherë pas bombave të para të NATO-s, më 24 mars. Një ditë më pas, lagjja e Zatrës e ndjekur nga ajo e Kapeshnicës dhe më pas Dardania ishin "spastruar". Sipas raportit të pranisë së OSBE-së në Kosovë, policia do të vinte në shënjestër veçanërisht ish-punonjësit e OSBE-KVM, ndërsa civilë serbë plaçkitën zyrat e OSBE-së në Pejë. [7]

Kësisoj të gjitha lagjet ishin spastruar, teksa banorët ishin urdhëruar të mblidheshin në një vend grumbullimi në qendër. Policia ishte marrë me organizimin e autobusëve që do të shpinte popullsinë në jug, në Prizren dhe më pas në Shqipëri. Një pjesë e popullsisë ishte shtrënguar të udhëtonte më këmbë drejt veriut, në Mal të Zi. Më 29 mars, shumica dërrmuese e popullsisë etnike shqiptare ishte shtrënguar të linte qytetin.

Gjatë kësaj kohe ndodhën gjithashtu edhe disa vrasje, qartazi për të ngjallur frikë dhe përshpejtuar çpopullimin e qytetit. Ngjarjet më mizore ndodhën në lagjen Dardania, ku, sipas Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, dyzet e një njerëz u vranë më 27 mars.[8] Human Rights Watch nuk i verifikoi rast pas rasti dëshmitë për këto vrasje, por kërkimet e përgjithshme në Pejë dhe në Dardani konfirmuan përafërsisht numrin dyzet e një.

Një person i tha Human Rights Watch se si ishte vrarë fqinji i tij i pasur, Namik Bilali. Ai tha:

> Fqinji im, Namik Bilali u qëllua natën e 26-27 marsit. Ishte një nga njerëzit e pasur të Pejës dhe banonte ngjitur me mua. Serbët donin të grabisnin gjithçka që ai zotëronte. Ata trokitën në derën e shtëpisë së tij, i ranë ziles dhe i kërkuan para. Naimiku u tha që nuk kishte para, kështu ata e qëlluan me armë me silenciator. [9]

Një tjetër person që refuzoi ta jepte emrin i tha Human Rights Watch:

> Të shtunën, më 27 mars, ca fqinjë serbë erdhën dhe më thanë "duhet të largohesh." Ishin që të gjithë të armatosur. Ata shkuan derë më derë në shtëpitë e shqiptarëve duke iu kërkuar para dhe na thanë që të

largoheshim. Sipas tyre një jetë njeriu vlente 1000 marka gjermane. Në qoftë se ne kishim aq para për të paguar, atëherë mund të jetonim. Kushërinjtë e mi dhe fëmijët e tyre u vranë. Njëri prej tyre quhej Mustafa Lajci dhe ishte pesëdhjetë e pesë vjeç, ndërsa dy djemtë e tij, Halili dhe Florimi ishin njëzet dhe shtatëmbëdhjetë vjeç. Tjetri ishte Adem Lajci, gjashtëdhjetë e pesë vjeç, ndërsa dy djemtë e tij Ganiu dhe Myftari ishin njëzet e pesë e tetëmbëdhjetë vjeç. Mustafai dhe Ademi ishin vëllezër dhe jetonin ngjitur me njëri-tjetrin.[10]

Shqiptarë të tjerë etnikë të intervistuar në kampet e refugjatëve, shpjeguan se si ishin përzënë me përdhunë nga Peja. Njëri prej tyre i tha Human Rights Watch:

Serbët erdhën në qilarin tonë të djelën, më 28 mars. Na drejtuan armët dhe thanë: "Ku janë të tjerët?" Kishim pesë ditë që ishim fshehur në qilar, pa lëvizur nga vendi. Kishim dëgjuar të shtënat dhe ishim të frikësuar se mos ata vinin në qilar dhe na vrisnin …
Na mblodhën në qendër të qytetit, na kontrolluan, na morën pasaportat dhe paratë, në ato raste kur gjetën, si dhe arturina, gjerdanë. Paskëtaj na kërcënuan dhe na mallkuan. Pritëm afro dy orë e më pas na ngarkuan në autobuzë. Kur autobuzët nuk kishin më vende, i shtrëngonin njerëzit të ecnin më këmbë. Kur ra nata, ne ishim ende në Pejë. Një pjesë të njerëzve i sistemuan nëpër shkolla. Ndërkohë që njerëzit largoheshin, serbët shtinin për të ngjallur panik. Disa njerëz u orvatën t'ia mbathnin nga turma dhe të fshiheshin nëpër shkolla. Ishte diçka e tmerrshme; frika dhe paniku ndjehej gjithandej, një gjë e pabesueshme. S'vinim gjumë në sy, nuk pushonim dot. Njerëzve iu kishin vjedhur edhe automjetet.[11]

Një tjetër person, Bujar Tabaku, na tha:

I fusnin njerëzit në autobuzë. Ishin autobuzë të kompanive private nga Kosova, që ishin marrë në zotërim nga ushtria. Shoferët e autobuzëve ishin që të gjithë policë. Kishin veshur uniforma të gjelbra dhe mbanin maska të zeza. Kishte edhe disa civilë të armatosur. Për mendimin tim, civilët ishin nga Peja dhe ndihmonin në organizimin e punës me autobuzët.[12]

Pas "spastrimit" të qytetit, qeveria e përqëndroi vëmendjen kah fshatrat rreth e qark Pejës. Fshati i parë për t'u "spastruar" ishte në luginën e Baranës, e cila shtrihet në juglindje të Pejës. Një sërë fshatrash, si Rasiq, Broliq dhe Vranoc u shpopulluan forcërisht qysh javën e parë të prillit. Gjatë kësaj kohe u "spastruan" edhe fshatrat përgjatë rrugës Pejë-Prishtinë, në lindje të Pejës. Vetëm tri fshatra përgjatë kësaj rruge – Qyshk, Zahaq dhe Pavlan – do të përbënin një përjashtim të rëndësishëm. Të tri ata nuk do të prekeshin deri më 14 maj, kohë kur ndodhën një numër vrasjesh në masë (shih më poshtë). Ende mbetet e paqartë, përse këto tri fshatra u anashkaluan në fillim të prillit dhe, befas, në mes të majit u goditën aq rëndë.

Plaçkitjet dhe Zjarrvëniet

Plaçkitje dhe zjarrvënie ndodhën në të katër anët e qytetit, shpesh edhe nga dora e qytetarëve serbë. Në radion dhe televizionin e kontrolluar nga shteti, qeveria serbe do të mëtonte se dëmtimet në qytet ishin kryer nga bombardimet e NATO-s. Një anëtar i Kishës Ortodokse Serbe, At Jovani, që punonte në Patriarkanën e Pejës pas luftës, do të ripërsëriste këtë pretendim dhe i tha Human Rights Watch se Peja ishte bombarduar nga NATO-ja. [13] E megjithatë një tjetër anëtar i kishës, At Sava, pikturoi një kuadër të ndryshëm gjatë një interviste dhënë revistës në gjuhën serbe "Nin". Në këtë intervistë, ai u shpreh:

> Ne besojmë se e vërteta do të shpaloset plotësisht. Numrin e saktë të njerëzve që u vranë, sa varre masive ekzistojnë, ku ndodhen … Rreth të gjitha këtyre do të mësojmë në ditët që vijnë. Tashmë kjo nuk është çështje propagande, por provash materiale që janë gjetur për çdo ditë – raporte, foto, filma që janë xhiruar në vendngjarje, si dhe një numër i madh kufomash – për fat të keq, kryesisht grash dhe fëmijësh. Populli serb duhet ta mësojë këtë të vërtetë tragjike. Më e keqja ka ndodhur pikërisht në zona si ajo e Pejës, që është një qytet krejtësisht i shkatërruar, jo për shkak të bombardimeve të NATO-s, por si pasojë e zjarrvënieve dhe shkatërrimit sistematik të pronës. Të gjithë ata që

Pjesa më e madhe e pazarit, në qendër të Pejës, do të plaçkitej dhe digjej në mënyrë sistematike.

> kanë banuar atje, por edhe ata që kanë ardhur e kanë parë atë çka ka ndodhur, e dinë mirë pse-në. Kjo është e vërteta e hidhur rreth Kosovës dhe Metohisë, një e vërtetë për të cilën një numër i madh njerëzish nuk janë ende të gatshëm për të folur, por gjithsesi një e vërtetë me të cilën populli serb duhet të ballafaqohet dhe të bëjë atë që lypset bërë.[14]

Pjesa më e madhe e pazarit, në qendër të Pejës, do të plaçkitej dhe digjej në mënyrë sistematike, qysh në fillim të prillit. Shumica e xhamive të komunës, gjithashtu do të shkatërroheshin. Sipas zyrës lokale të bashkësisë islamike, nga tridhjetë e një xhamitë në mbarë komunën, trembëdhjetë do të rrafshoheshin, ndonëse tre prej tyre ishin shkatërruar qysh në vitin 1998 (njëra në Logjë, tjetra në Rausiq dhe e treta në Vranoc). Xhamitë e tjera në një mënyrë ose tjetër do të shfytyroheshin, ca me mbishkrime dhe ca me dëmtime të pjesshme.[15] Më 19 korrik 1999, Human Rights Watch vizitoi arkivin treqind vjeçar të Bashkësisë Islamike, i cili ishte djegur e rrënuar.

Vrasja finale

Një nga ngjarjet më të hidhura në Pejë, ndodhi më 12 qershor, teksa trupat serbe dhe ato jugosllave, ashtu si dhe pjesa më emadhe e popullsisë serbe po përgatiteshin ta braktisnin Kosovën. Njerëz të armatosur, të cilët besohet se i përkisnin grupit paraushtarak të quajtur Munja, vranë në një shtëpi gjashtë anëtarë të familjes, duke përfshirë këtu edhe fëmijë të moshës pesë, gjashtë, shtatë, dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë vjeç. Veç katër vetë mbijetuan, njëri prej të cilëve ishte një djalë tetë vjeç, që u shtir si i vdekur. Një nga burrat e shtëpisë e morën me vete dhe më pas u gjend i vdekur.

Ky incident ka të bëjë me dy familje, emrat e të cilave janë mbajtur të fshehtë për t'i mbrojtur nga ndonjë raprezalje të mundshme. Kryetari i njërës prej familjeve, të cilin ne do ta quajmë këtu Agim, i tha Human Rights Watch se, më 12 qershor, rreth orës 8.30 të mbrëmjes, ai dëgjoi tri të trokitura në portën e oborrit.[16] Para se të shkonte të hapte portën, tri njerëz të armatosur e të veshur me uniforma, kaptuan murin. Porta u hap dhe pesëmbëdhjetë a njëzet vetë hynë në oborrin e shtëpisë. Tri vajzat e Agimit do të merreshin në pyetje për pesëmbëdhjetë minuta në një dhomë më vete, paskëtaj Agimi u nxorr nga shtëpia dhe jashtë ai pa pesë a gjashtë

automjete që po prisnin. Prej andej atë e shpunë në shtëpinë e Ibrahimit, që ishte miku i tij më i ngushtë.

Sipas Agimit, trupat e ushtrisë kishin zënë vend në një shtëpi përkundruall asaj të Ibrahimit. Ibrahimi u nxor nga shtëpia dhe u fut në një xhips ku ndodhej edhe Agimi, i cili ndërkohë që kish qenë duke pritur jashtë shtëpisë së Ibrahimit, ishte goditur në kokë dhe në trup. Më pas të dy burrat u shpunë në shtëpinë e Agimit.

Në një intervistë të kryer më vete, Ibrahimi i kallzoi Human Rights Watch të njëjtën ngjarje, por nga këndvështrimi i tij.[17] Më 12 qershor, rreth orës 9 të darkës, disa burra të armatosur me uniformë, kaptuan portën e shtëpisë së tij. Në atë kohë, ai ndodhej në shtëpi me të shoqen, vëllain, kunatën, tre fëmijët e të vëllait dhe katër të tijët, si dhe me të ëmën e moshuar, e cila ishte uloke.

Njerëzit e armatosur kërkuan para dhe Ibrahimi iu dha atyre 3000 marka gjermane si dhe disa arturina. Paskëtaj Ibrahimi dhe i vëllai u urdhëruan të dilnin jashtë. Aty ata panë Agimin, të cilin e kishin rrahur, duke pritur brenda në një xhips. Prej andej ata i shpunë në shtëpinë e Agimit.

Dëshmitarë identifikuan njeriun në të djathtë si Nebojsha Miniç, të njohur si "Mrtvi" ("Vdekja"). Ai është implikuar në rrëmbimin dhe vrasjen e gjashtë anëtarëve të një familjeje më 12 qershor në Pejë. Në të majtë është Vidomir Salipur, një polic nga Peja i cili mendohet të ketë qenë kreu i bandës Munja. Ai u vra nga UÇK më 8 prill 1999. Data dhe vendi i fotos janë të panjohura.

© HUMAN RIGHTS WATCH

Ibrahimi tha, pesë a gjashtë njerëz të armatosur erdhën në shtëpinë e Agimit, tok me të tre burrat. Ata kishin veshur uniforma të gjelbra të ushtrisë, shami të zeza të lidhura në qafë dhe qenë armatosur me pushkë automatike, granata dhe shishe molotov. Midis tyre ishte Nebojsha Miniç, kriminel i njohur dhe prijës i paraushtarakëve në Pejë, i cili njihej me nofkën Mrtvi (Vdekja). Të dy si Agimi ashtu edhe Ibrahimi e njohën atë asokohe, por edhe në fotografitë e botuara në këtë raport. Ata e përshkruan atë si lëkurëzeshkët me tatuazhe në gjithë pjesën e sipërme të trupit, duke përfshirë këtu edhe një të vdekur në gjoks.

Miniç e pyeti Ibrahimin se sa para kishte prurë me vete. Ibrahimi i tha 3000 marka gjermane dhe Miniçi ia ktheu se ai do t'i numëronte vetë paratë dhe po qe se do të dilnin mangut, kishte për ta vrarë. Atëherë Ibrahimi i tha se mund të shkonte përsëri në shtëpi dhe të merrte para të tjera, kësisoj ai u kthye në shtëpi dhe i dha në dorë Miniçit edhe 4900 marka gjermane që i kish pasë fshehur.

Pasi Ibrahimi iu dha edhe shtojcën e parave, të armatosurit i urdhëruan njerëzit e familjes të uleshin të gjithë tok në një divan. Siç kujton Ibrahimi, ata i thanë kunatës të shkonte me ta në dhomën ngjitur. Ata e shpunë atë në banjë, ku ajo u përdhunua nga një burrë me mjekër të vogël. E ëma uloke e Ibrahimit që ndodhej në dhomën ngjitur, i dëgjoi ata tek i çirreshin nuses: "Brzo! Brzo!" (Shpejt! Shpejt!). "Ata e çnjerëzuan," do t'i thoshte më vonë e ëma, Ibrahimit.

Njerëzit e armatosur e kthyen mbrapsh kunatën dhe e ulën në divan me pjesën tjetër të familjes; më pas hapën zjarr. Ibrahimi do të shpjegonte:

> Ai nisi të qëllonte. Unë bashkë me djalin tim të vogël kërcyem jashtë dhe më pas u hodhëm nga ballkoni. Gruaja ime e larë në gjak doli në ballkon dhe thirri "ju lutem, ndihmoëni." Unë vrapova bashkë me djalin dhe shkuam te fqinjët. E lashë djalin tek ata. Shkova te Sllavka (një fqinjë serbe), por ajo nuk ma hapi derën. Paskëtaj prita të shihja se çfarë do të ndodhte dhe i pashë kur u larguan. Në këtë kohë, hodhën dy granata. U fsheha në bar. Kur dolën, shtinë në drejtim të shtëpisë. Hyra brenda dhe pyeta nënën çfarë kish ndodhur. Ajo më tha, nuk e di, por diçka lëviz. Atëherë pashë, djalin e tim vëllai, katër vjeç, që kish mbijetuar. Gruaja ime ishte plagosur rëndë. Ajo qe hequr osh deri te shtëpia e fqinjit e mbuluar në gjak. Edhe vajza e tim vëllai ishte plagosur, por nuk arrita ta marr vesh, veç të nesërmen në mëngjes. E

shpumë në spital, por mjeku na tha se kishte humbur shumë gjak. E operuan, por ajo do të vdiste.

Të vrarët ishin Vjollca, 28 vjeç (e përdhunuar dhe më pas e vrarë); Rena, 7; Nita, 5; Hajri, 13; Dardane, 12; Agron, 6; dhe Musai, 31 vjeç (i marrë me vete nga serbët e armatosur dhe i gjetur i vdekur pesë ditë më pas).

Ndërkohë që po ndodhte e gjithë kjo, Agimi ishte ulur me njerëzit e armatosur, mes tyre edhe Miniçi. Aty ishin të pranishëm dhjetë nga anëtarët e familjes së tij, do t'i thoshte ai Human Rights Watch, si dhe Musai, vëllai i Ibrahimit, të cilin e kishin marrë nga shtëpia e Ibrahimit. Më pas, Musain e larguan edhe prej andej. Trupi i tij do të gjendej pas pesë ditësh në lagjen e Kalasë, me fytin e prerë.

Miniçi, me sa duket në një moment reflektimi, i kishte thënë Agimit, "Kohë të vështira, o plak. E gjithë kjo bën pjesë në spastrimin e brendshëm të qytetit." Ai piu kafenë që i ofruan njerëzit e familjes dhe, sipas Agimit, do t'i tregonte për urdhërat që kish marrë. Agimi do të kujtonte:

> Kur morën Musën, Miniçi tha, "Siç e sheh, o plak, familja tënde dhe ajo e Musës, duhet të ekzekutohen." Ai më tha, "Po i ndryshojnë urdhërat çdo gjysmë ore." Ai më tha, "Më vjen keq që po ta them, por familja e Ibrahimit është ekzekutuar, likuiduar." Ai tha, "Ti ishe i pari në listë, por për fat të keq, na u desh të vrisnim më parë familjen e Ibrahimit." I thashë, "të lutem, shpëto jetën e fëmijëve të mi." Ai ma ktheu se do t'i kursente deri në mëngjes.
>
> Miniçi kishte një radio. Ata natë ai kish veshur një kanotiere të gjelbër, pa mëngë. I pamë krahët e mbushur me tatuazhe. Një njërin nga krahët kishte një thikë, një sëpatë dhe një granatë. Në gjoks kishte të vizatuar një njeri të vdekur. Dëgjuam njerëzit që flisnin me të përmes radios. Dëgjuam vetëm "qyteti është i sigurt. Askush nuk hyn apo del nga qyteti. Jeni të sigurt. Bëni ç'të doni." I dëgjuam këto fjalë, kur ata ishin ende në shtëpinë tonë.

Njerëzit e armatosur e lanë shtëpinë e Agimit, me përjashtim të Miniçit dhe të një tjetri. Atëherë Miniçi dhe personi tjetër i thanë Agimit se duhej t'i çonin dy vajzat e tij "te majori". Sipas Ibrahimit, Miniçi u betua mbi kryqin që mbante në qafë se asgjë e keqe nuk do t'u ngjante vajzave. Ato u larguan për afro një orë dhe kur u kthyen nuk qenë keqtrajtuar, gjithnjë

sipas Ibrahimit dhe dy vajzave që u intervistuan nga Human Rights Watch në praninë e të atit. Ato thanë që të dy burrat u rrekën t'iu mbushnin mendjen që të kryenin marrëdhënie seksuale, por ato s'pranuan dhe kështu ata i kthyen në shtëpi.

Mëngjesin e ditës së nesërme, u shfaq te shtëpia e Agimit me një polic serb që e kishte mik, të cilin shqiptarët me dashamirësi e thërrisnin "Kapllan". Sipas Agimit, Kapllani i rrëfeu rreth planit për të ekzekutuar familjen e tij dhe e kështilloi t'ia mbathte, kështillë që ai e ndoqi.

Po atë ditë, Ibrahimi varrosi pesë anëtarë të familjes, që ishin vrarë me ndihmën e katër policëve, emrat e të cilëve janë mbajtur të fshehtë, për t'i mbrojtur nga ndonjë raprezalje e mundshme.

Motivet e vrasjeve janë të paqarta, megjithëse plaçkitja mund të jetë njëra prej tyre. Por si Agimi ashtu edhe Ibrahimi mëtojnë njerëzit e armatosur i njihnin me emër, ndaj dhe ata besojnë se ishin vënë në shënjestër për arsye të caktuara. Një nga shpjegimet e ofruara nga Ibrahimi ishte se, Musai, vëllai i tij, para pak kohësh, ishte kapur duke u përpjekur për t'ia mbathur në Mal të Zi. Sipas Ibrahimit, në fund të majit, Musai i kishte paguar një polici serb të quajtur Zharko Bačkoviç, 3000 marka gjermane, për ta nxjerrë atë tok me familjen nga Kosova. Ata ishin kapur në rrugë e sipër dhe Musai kishte kaluar një javë në burg. Pas të gjitha gjasave, edhe Bačkoviçi duhej ta kishte pasur pisk, ngaqë qe përpjekur të ndihmonte një familje shqiptare. Ibrahimi dhe Agimi besojnë se vrasjet ka të ngjarë të jenë një përpjekje nga ana e tij për të larë veten në sytë e kolegëve, por kjo i ngjan më shumë një spekullimi. Fakti që familja duihej që ishte e pasur, mund të jetë një tjetër mundësi.

Përdhunimet

Përdhunimi i kryer në ngjarjen e përmendur pak më sipër do të ishte rasti i vetëm i dhunës seksuale të vërejtur në Pejë drejtpërdrejt nga ana e Human Rights Watch, ndonëse dëshmi rrethanore na shtyjnë të besojmë se një numër i madh grash janë përdhunuar brenda dhe jashtë qytetit. Një mjek gjinekologjist në Pejë i tha Human Rights Watch se, pas luftës, ai kishte asistuar ndërprerjen e shtatzanisë së tri grave nga Peja, të cilat, sipas mendimit të tij, kishin pasë qenë përdhunuar.[19] Refuzimi i grave për të folur rreth përdhunimeve dhe dhunës seksuale e bën tejet të

vështirë konfirmimin e akuzave. (Shih mars-qershor 1999: Një vështrim i përgjithshëm.)

Më 20 prill, NATO do të deklaronte se, sipas dëshmive të refugjatëve shqiptarë nga Kosova, forcat serbe e jugosllave kishin hgritur kampe përdhunimi në Gjakovë dhe0 Pejë. Gjithnjë sipas refugjatëve, në Pejë "serbët kishin grumbulluar një numër grash të reja shqiptare dhe i kishin shpënë në hotel Karagac, ku komandanti lokal kishte përpiluar një listë me emrat e ushtarëve të tij dhe i lejonte sipas radhës të kalonin një natë në hotel."[20]

Në raportin rreth krimeve të luftës në Kosovë, Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara, do të përmendte akuzat rreth kampeve të përdhunimit në Gjakovë e Pejë. [21] Kapitulli i raportit mbi Pejën, citon si të vetmin burim të vetin, një artikull të *New York Times* të 22 qershorit, rreth përdhunimeve. Gjithsesi, artikulli i më sipër cituar përmend "zyrtarët e Departamentit të Shtetit" si burimin origjinal të të dhënave të tyre.[22]

As Human Rights Watch as edhe ndonjë gazetar i huaj do të ishte në gjendje të konfirmonte praninë e kampit të përdhunimit në hotel Karagac.[23] Sipas OSBE-së, UÇK-ja e inspektoi hotelin Karagac në kohën që ata hynë në Pejë, rreth datës 12 qershor. Një zëvendës komandant i brigadës lokale të UÇK-së i tha OSBE-së se, ata kishin gjetur prezervativë të përdorur dhe të linjta grash në dhomat e hotelit.[24]

Qyshk

Mëngjesin e datës 14 maj 1999, forcat serbe të sigurimit, zbritën në fshatin e vogël të Qyshkës, fare pak milje larg në lidje të Pejës. Duke iu druajtur raprezaljeve, një numër i madh burrash u larguan në drejtim të kodrave pranë fshatit, teksa pjesa tjetër e banorëve do të mblidhej forcërisht në qendër të fshatit. Sipas të dhënave, gjatë grumbullimit të popullsisë në pjesë të ndryshme të fshatit, mbetën të vrarë dymbëdhjetë burra.

Rreth orës 8.30 të mëngjesit, forcat e sigurimit të veshura me uniforma të gjelbra nga të ushtrisë, me fytyra të ngjyrosura dhe maska, i ndanë gratë, fëmijët dhe të moshuarit nga pjesa e mbetur e burrave që s'ia kishin dalë të largoheshin. Më shumë se 200 banorë të fshatit do të kanoseshin dhe plaçkiteshin në mënyrë sistematike me gjith'ka iu gjendej: para, arturina dhe sende të tjera të çmuara. Letrat e njoftimit do t'iu griseshin.

Tridhjetë e dy burra nga mosha nëntëmbëdhjetë deri më gjashtëdhjetë

e nëntë vjeç u ndanë në tri grupe dhe u çuan në tri shtëpi të ndryshme, ku u detyruan të qëndronin në rresht. Në çdonjërën nga shtëpitë, njerëzit e armatosur i breshëruan ata me zjarrin e armëve automatike. Në njërën nga shtëpitë, një nga personat e armatosur i qëlloi me pistoletë trupat e plandosur përtokë. Të tri shtëpive iu vu zjarri dhe u lanë të shkrumbohen.

Rasti i fshatit Qyshk ka dy karakteristika të veçanta që ia vlen të hetohen në mënyrë të hollësishme. E para, në çdonjërin prej tri grupeve, pati nga një të mbijetuar. Tre burra, thjesht për hir të fatit, ia dolën të hiqeshin zvarrë dhe të dilnin nga shtëpitë e djegura, pa plagë të rënda. Të tre ata, por edhe shumë të tjerë që ishin të pranishëm atë ditë, i rrëfyen Human Rights Watch, historitë e tyre.

E dyta, ndërsa shqiptarët etnikë të fshatrave në Kosovë zakonisht nuk janë në gjendje të bëjnë dallimin midis ushtarëve, trupave speciale të policisë dhe paraushtarakëve, pa zënë ngoje raste kur mund të identifikojnë individë të veçantë, në këtë rast ka dëshmi të pakundërshtueshme që e drejtojnë gishtin mbi disa njerëz të përzierë në krime lufte. Banorët lokalë janë të bindur në faktin se, serbë etnikë nga zonat aty pranë ishin të përfshirë në këtë ngjarje. Një pjesë e njerëzve të armatosur iu ishin drejtuar shqiptarëve me emër dhe iu patën kërkuar sende të vyera konkrete.

Fshatarët identifikuan në fotografi dy individë që ata mëtojnë se ishin të pranishëm në Qyshk më 14 maj – Sreçko Popoviç dhe Zvonimir Cvetkoviç – si dhe një person të tretë – Slavisha Kastratoviç – e cila kishte qenë e pranishme në fshatin Zahaq, atë ditë kur ishin vrarë nëntëmbëdhjet burra. Ndonëse për asnjë nga individët e identifikuar nuk ka fakte të kenë hapur zjarr mbi shqiptarët etnikë, prania e tyre në Qyshk dhe në Zahaq, më 14 maj, do të thotë se ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë kriminelët, si dhe komandantët e njësisë. Ky informacion ka

Fshatarët identifikuan në fotografi dy individë që ata mëtojnë se ishin të pranishëm në Qyshk më 14 maj

të ngjarë të jetë i paçmuar për Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës në ish-Jugosllavi, si dhe për gjykatat serbe, të cilat, pas rënies së Millosheviçit në tetor 2000, mund të nisin procedurat për gjykim të personave përgjegjës. Dëshmia fotografike është trajtuar më poshtë, në kapitullin mbi kriminelët.

Motivet e vrasjeve në Qyshk, si dhe sulmet e kryera po atë ditë në Pavljan dhe në Zahaq, mbeten të paqarta. Nuk ka dëshmi që të flasin për veprimtari të dendur të UÇK-së në ato fshatra si në vitin 1998 ashtu

edhe më 1999. Gjithashtu nuk ka të dhëna për policë apo ushtarë të vrarë në ato zona gjatë bombardimeve të NATO-s, gjë që të të shtyj të mendosh se një motiv i mundshëm ka qenë hakmarrja. Ka një shpjegim të bërë nga fshatarët se, fshati Qyshk ishte vendbanimi i Hasan Çekut, të atit të Agim Çekut, kreut ushtarak të UÇK-së. [25] Hasani dhe vëllai i tij Kadriu ishin midis të vrarëve në Qyshk, më 14 maj. Një banore e fshatit Qyshk i tha Human Rights Watch se policët i dëftuan asaj një fotografi të Agim Çekut dhe thanë: "Gjithë këtë po e bëjmë për shkak të këtij."[26] Kjo thënie mbështetet edhe nga dëshmi të dhëna Komitetit të Juristëve për të Drejtat e Njeriut, një grup për të Drejtat e Njeriut me qendër në Shtetet e Bashkuara. Në një video të xhiruar në kuadër të Projektit mbi Dëshmitarët i këtij Komiteti, anëtarë të familjes Çeku dëshmuan se forcat e sigurimit pyetën në mënyrë specifike për babain e Agim Çekut, para se ta vrisnin.[27]

Duke lënë mënjanë motivet, vrasjet në Qyshk, Pavljan dhe Zahaq ishin të lidhura e të bashkërenduara. Kjo nuk ishte dhunë e ushtruar kuturu, nga ca horra në radhët e forcave serbe të sigurimit. Ashtu siç kishte ndodhur edhe në fshatra të tjerë në mbarë Kosovën gjatë luftës, Ushtria Jugosllave merrej me masat e sigurisë në periferi të luftimeve, duke instaluar postblloqe në pika kyçe të rrugëve, ndërsa trupat speciale të policisë dhe paraushtarakët hynin nëpër fshatra për të vrarë dhe kryer "spastrime". Në qoftë se autorët kryesorë të krimeve në rastin e Qyshkës do të ishte milicia lokale apo ndonjë njësi speciale e policisë, për të mos thënë të dyja, nuk ka pikë dyshimi se ata i kishin bashkërenduar punët tok me policinë lokale dhe autoritetet ushtarake.

Ka edhe dëshmi të tjera që flasin për një angazhim të drejtpërdrejtë të Ushtrisë Jugosllave në sulm. Nga një numër burimesh është raportuar se kanë parë dokumente të ushtrisë që bënin fjalë për një prani ushtarake rreth e qark fshatit Qyshk, pak kohë para 14 majit. Një gazetar perëndimor ka deklaruar se ka parë dokumenta të Ushtrisë Jugosllave që urdhëronin për "spastrimin" e fshatit.

Për të mbrojtur identitetet e dëshmitarëve dhe të mbijetuarve, inicialet e tyre janë ndryshuar.

Kuadër i përgjithshëm

Qyshkë është një fshat i vogël rreth pesë milje në lindje të Pejës, pranë rrugës kryesore Pejë-Prishtinë dhe ka afro dyqind shtëpi

dhe 2000 banorë. Në fshat jetonin edhe tri familje serbe, të tria me mbiemrin Jasoviç, si dhe një familje malazeze me mbiemrin Bojoviç. Sipas shqiptarëve etnikë banorë të fshatit, marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve kanë qenë të mira. Familjet e banorëve jo shqiptarë u larguan nga Kosova, kur trupat serbe dhe jugosllave u tërhoqën nga provinca më 12 qershor.

Sipas fshatarëve, në fshatrat Qyshkë, Zahaq dhe Pavljan nuk ka pasur kurrëndonjëherë veprimtari të UÇK-së, ndonëse disa prej burrave në moshë për armë ishin anëtarë të UÇK-së, që zhvilloi luftime në komunën e Pejës, duke përfshirë këtu edhe fshatin Logjë. Rrethinat e fshatit Qyshkë nuk kanë qenë skenë e luftimeve midis trupave qeveritare dhe UÇK-së, si në vitin 1998 ashtu edhe më 1999. I vetmi incident që njohim ndodhi në Zahaq, më 22 dhjetor 1998, kur policia vrau një shqiptar etnik, Sali Kabashi dhe arrestoi pesë të tjerë në rrethana krejt të diskutueshme. Qeveria serbe tha se, policia u ndodh nën zjarr kur po kryente arrestimin,[28] ndërsa burime nga shqiptarët etnikë pohojnë se Kabashi u ekzekutua në vend.[29]

Gjatë bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi më 1999, fshatrat e Qyshkës, Zahaqit dhe Pavljanit fillimisht nuk do të trazoheshin, edhe pse pjesa më e madhe e fshatrave rreth e qark tyre, ashtu si edhe qyteti i Pejës, duke nisur nga 25 marsi do të "spastroheshin" në mënyrë sistematike. Siç është përmendur tashmë, deri më 29 mars, më shumë se 90 përqind e popullsisë së Pejës ishte nisur për kah veriu, në drejtim të Malit të Zi, në këmbë, ose për në jugperëndim, në drejtim të Shqipërisë, me autobuzë. Gjithashtu në harkun kohor mars-prill, një sërë fshatrash përgjatë rrugës Pejë-Prishtinë do të zbrazeshin nga shqiptarët etnikë, me përjashtim të Qyshkës, Zahaqit dhe Pavljanit. Për ç'arsye nuk u "spastruan" edhe ato asokohe, nuk dihet. Një teori e paprovuar është se, banorët e këtyre fshatrave paguanin për t'u mbrojtur forcat lokale të sigurimit.

Forcat speciale të policisë shkuan tri herë në Qyshkë para sulmit të datës 14 maj për të kontrolluar për armë dhe për të kërkuar para dhe ndonëse dogjën capak shtëpi, e vërteta është se askush nuk u lëndua apo u vra dhe askujt nuk iu kërkua të linte fshatin. Vizitën e parë do të kryenin më 17 prill, ora 4 e pasdites, por trupat hynë vetëm në lagjen Kristal. Sipas thënieve të fshatarëve për Human Rights Watch, ata dogjën se katër se shtatë shtëpi.

Katër ditë më pas, rreth orës 12 të mesditës, forcat e sigurimit hynë në Qyshk, Zahaq dhe Pavljan. Dëshmitarët i thanë Human Rights Watch se

ata ishin veshur me uniforma të gjelbra kamuflazhi, ndërsa një pjesë e tyre kishin kapele të blerta *cowboy*. Po sipas fshatarëve, ata iu thanë të mos shqetësosheshin. "Shkoni nëpër shtëpia. Askush s'ka për t'ju prekur me dorë. Jeni të sigurt," iu paskëshin thënë ata. Një ditë më pas, trupat u kthyen sërish në Qyshkë dhe kontrolluan për armë. Një numër dëshmitarësh thanë se disa prej fshatarëve dorëzuan armët që kishin pasur në zotërim deri më atë kohë. Sipas raportimeve, Syl Gashi dorëzoi një pushkë gjuetie, ndërsa i vëllai një pistoletë. Po kështu veproi edhe Brahim Lushi edhe pse kishte leje për armëmbajtje. Policët i morën Syl Gashit makinën e tipit BMË dhe 1200 marka gjermane.

Aksioni i policisë i datës 14 maj u duk qartë që ishte "më agresiv" se vizitat e mëparshme, thanë një numër i madh fshatarësh. Qysh nga fillimi u pa qartë se objektivat e forcave dhe urdhërat e eprorëve shkonin përtej një kontrolli rutinë për armë.

Vrasjet

Ofensiva e 14 majit filloi pa kurrfarë paralajmërimi rreth orës 7 të mëngjesit, kur një numër i madh trupash speciale të policisë dhe paraushtarakë, hynë në Qyshkë nga drejtimi i Pejës. Fshatarët i thanë Human Rights Watch se, ata dëgjuan breshëri armësh automatike rreth asaj ore dhe panë se disa shtëpi në skaj të fshatit po digjeshin. Pjesa më e madhe e të rinjve dhe mesoburrave u larguan në kodrat aty pranë nga frika, siç kishin vepruar edhe më parë gjatë inkursioneve të policisë në Qyshk, ndonëse një pjesë e tyre vendosën të qëndronin pranë familjeve.

Policët vërshuan nga perëndimi në drejtim të lindjes, duke i shtrënguar njerëzit drejt qendrës së fshatit. Disa prej fshatarëve u nisën me vullnet të lirë drejt qendrës, siç tha një grua, ngaqë menduan se do t'i nisnin në drejtim të Shqipërisë dhe se "do të ishte më e sigurt për ta të mblidheshin në një vend të caktuar."[30] Sipas vlerësimeve, dymbëdhjetë burra u vranë ndërkohë në pjesë të ndryshme të fshatit, duke përfshirë ndër ta edhe Hasan Çekun.

Projekti i Dëshmitarëve i Komitetit të Juristëve të të Drejtave të Njeriut do të intervistonte dy dëshmitarë për vrasjen e Hasan Çekut. Të dy burrat dëshmuan rreth ngjarjes duke u regjistruar në një video, transkiptimi i së cilave u bë i mundur edhe për Human Rights Watch. Njëri prej dëshmitarëve tha:

Ata (forcat e sigurimit) pyetën se kush ishte babai i Agim Çekut, se ai ishte i madh tashmë, se ai kishte sjellë NATO-n këtu dhe se tashmë ata do të na eliminojnë. … Ata e morën Hasanin, e lanë të ikte dy herë dhe liruan bagëtinë. Herën e fundit që ai u kthye, ata kishin therrur njërën nga lopët. Ata e qëlluan Hasanin në vend dhe i kallën zjarrin. Unë iu qasa pranë dhe e pashë Hasanin të vdekur dhe këmbët që po i digjeshin.[31]

Sipas vlerësimeve, dymbëdhjetë burra u vranë ndërkohë në pjesë të ndryshme të fshatit, duke përfshirë ndër ta edhe Hasan Çekun.

Dëshmitari tjetër ofroi këtë dëshmi për Projektin e Dëshmitarit:

E dinim që ata ishin duke vrarë familjarët e oficerëve shqiptarë. Mendoja se ishte thjesht çështje kohe para se të na vrisnin të gjithëve. Ata na hoqën mënjanë, pa e ditur se kush ishte babai i Agimit, duke pyetur për të. (Hasani) bëri përpara. Ata i thanë të merrte familjen dhe ndërkohë neve na ndanë. Ata e morën (Hasanin) për të gjetur një fotografi të Agimit, ndërkohë morën në pyetje mua dhe kunatën time. Ata na pyetën se kur e kishim parë për herë të fundit (Agimin). Ku? Por ndërkaq ne e kishim vendosur se të ndodhte çfarë të ndodhte, s'kishim për ta pranuar kurrë që kishim pasur ndonjë farë kontakti me të. Po i thashë atin që kurrë, kur në atë moment (Hasani) solli fotografinë, ku kisha dalë unë me Agimin. Ai më njohu, por unë e mohova. Ai më tha se isha me fat ngaqë kisha një fëmijë me vete. Ata më kërkuan t'iu shkoja pas dhe t'iu tregoja se e kujt ishte shtëpia në anën tjetër të rrugës. Atëkohë dëgjova të shtënat. Vrapova, por im ungj, nuk më la të shihja (Hasanin) të vdekur.[32]

Pavarësisht nga vrasjet e para që kishin ndodhur, disa burra vendosën të qëndronin pranë familjeve. Njëri prej tyre, një tridhjetë e tetë vjeçar, i quajtur B. B. ndenji me afro dyzet pjesëtarët e familjes së tij, duke përfshirë këtu të ëmën dhe fëmijët. Ai dha këtë shpjegim për Human Rights Watch:

Kur i pashë (trupat serbe) pranë shtëpisë, dukeshin tepër agresiv, ndaj dhe vendosa t'ia mbath. Tatëpjetë rrugës pashë disa të rinj që më thanë se, ata (forcat serbe) kishin vrarë tre burra. Vendosa të hidhesha në lagjen ku ndodhej familja Gashi. Kur shkova atje fola me disa pleq që

> kishin vendosur të rrinin e të prisnin ardhjen e ushtarëve. Menjëherë paskësaj erdhën familjet Lushi dhe Kelmendi – gra, burra dhe fëmijë.[33]

B. B. dhe fshatarë të tjerë të intervistuar veç e veç, i thanë Human Rights Watch se një grup prej afro 200 shqiptarësh etnikë të atij fshati do të rrethoheshin shpejt e shpejt nga rreth njëqind forca të sigurimit. Të gjithë dëshmitarët thanë se, trupat kishin veshur uniforma të gjelbra tip ushtrie. Të gjithë i kishin fytyrat të maskuara në një farë mënyre, ose i kishin ngjyer me të zezë ose mbanin maska, ndërsa një pjesë kishin lidhur shami të zeza në kokë ose mbanin kapele të gjelbra, tip cowboy.

Të gjithë fshatarët besonin se një pjesë e anëtarëve të forcave të sigurimit ishin nga zona e Pejës, bie fjala nga fshati i Gorazhdecit i banuar nga serbë etnikë, të cilin e ndan nga fshati Qyshk lumi i Bistricës. Me sa dukej, disa nga anëtarët e forcave i njihnin një numër të pakët shqiptarësh personalisht, sikurse i thanë fshatarët Human Rights Watch, meqenëse ata kërkuan sende specifike, bie fjala si "çelsat e Mercedesit tënd". Një grua që kish pasë qenë në lidhje të ngushtë me forcat e sigurimit i tha Human Rights Watch:

> Ata kishin veshur uniforma të blerta kamuflazhi. Shumica e tyre kishin lidhur në krye shami, dy mbanin kapele ndërsa të tjerët qenë krye zbuluar. Të gjithë i kishin lyer me bojë fytyrat. Kësisoj ne mund të shihnim vetëm sytë e tyre, e për pasojë nuk mund t'i njihnim. Por ishte mëse e qartë që disa prej tyre na njihnin neve. Në Qyshkë është një shkurtabiq, një pijanec, të cilin njerëzit e venë në lojë. Një pjesë e ushtarëve zunë të talleshin me të, dhe nga mënyra se si e bënin shihej qartë që e njihnin… Po kështu ca prej ushtarëve do t'i thoshin dikujt: "Dorëzo çelsat e Mercedesit!" ose "Na jep çelsat e furgonit!" Kështu pra, ata e dinin fort mirë se kush ishte filani dhe çfarë kishte në pronësi.[34]

"Unë mendoj se ata ishin nga këto anë sepse i njihnin njerëzit me emra dhe iu kërkuan makinat. Disa prej tyre i njoha nga fytyra."

Fshatari B. B. i tha Human Right Watch: "Unë mendoj se ata ishin nga këto anë sepse i njihnin njerëzit me emra dhe iu kërkuan makinat. Disa prej tyre i njoha nga fytyra."[35] Për hollësi të mëtejshme rreth identitetit të anëtarëve të forcave të sigurimit, shih më poshtë.

Pasi turma e fshatarëve ishte mbledhur në qendër të fshatit, njëzet e

nëntë burra i hoqën mënjanë dhe i ndanë nga gratë dhe fëmijët. Paskëtaj i gjithë grupi do të plaçkitej e zhvishej sistematikisht nga sendet e çmuara. B. B. do të shpjegonte:

> Ata na urdhëruan të zbraznim xhepat dhe të nxirrnim gjithë sendet e çmuara – para, argjendurina dhe arturina. Pasi i dhanë fund kësaj, urdhëruan dy fëmijë, njëri trembëdhjet e tjetri katërmbëdhjetë vjeç. Njërit i thanë të mblidhte letër njoftimet, ndërsa tjetri sendet e çmuara. Njeriu që (më pas) do të na ekzekutonte, iu vuri thikën në fyt fëmijëve dhe tha, "nxirrni gjithë ç'keni". Pastaj qëlluan pranë këmbëve të fëmijëve dhe mbi kokë.[36]

C. C. pesëdhjetë e shtatë vjeç, ishte kapur gjatë kohës që po përpiqej t'ia mbathte nga fshati dhe ashtu si të tjerët ishte shtrënguar të mblidhej në qendër të fshatit. Ai i tha Human Rights Watch:

> Gruaja e tim vëllai ishte njëzet metra larg. I thanë të ndalonte dhe i vunë tytën e automatikut në qafë. I morën 850 marka gjermane. Njëri prej tyre më shau dhe më qëlloi me shputë në fytyrë. "Pse si kujtoni ju, kurrë s'ka për të pasur demokraci për ju," më thoshin. "Këtu është Serbi. As Amerika as NATO s'kanë punë këtu." Paskëtaj na shpunë në varreza. Familjet Gashi, Lushi dhe Kelmendi ishin atje, sëbashku me disa miq nga fshatrat Logjë, Graboc, Rausiq dhe Gorazhdec … Sakaq nisën ta ndanin gratë, fëmijët dhe pleqtë nga burrat e rinj në moshë. Unë nuk i njoha dot nga pjesa më e madhe e tyre mbanin maska ose i kishin zhyer fytyrat me bojë të zezë. Na vodhën; mua më morën 200 marka gjermane. Morën ç'gjetën, ora dore, dokumenta, të cilat i dogjën, florinj dhe arturina.[37]

Një tjetër grua që ishte e pranishme e quajtur D. D. i tha Human Rights Watch se, gratë dhe fëmijët i mbajtën në qendër të fshatit për afro një orë. Ajo tha:

> Ushtarët po merrnin nga ne ç'të gjenin: para, cigare, ora dore, sende të çmuara … Njëri nga ushtarët nxori një thikë dhe zuri ta lëpijë në sytë tanë. Pastaj ia vuri një fëmije në fyt. Një nga fëmijët e mi, im bir tre vjeç, më shpëtoi nga duart dhe ia dha vrapit në drejtim të grupit të

burrave, ku ndodhej im shoq. Ushtarët i shtinë përtokë pranë këmbëve të tij për ta ndaluar.[38]

Një tjetër grua, A. A. e vërtetoi rrëfimin e mësipërm dhe shtoi:

Ne (gratë) po rrinim në shesh. Një nga ushtarët na tha se, ata kishin marrë urdhër t'i vrisnin të gjithë fshatarët, por ata do t'i kursenin gratë e fëmijët. Pastaj na pyeti: "Ku doni t'ju shpiem, në Shqipëri apo në Mal të Zi?" Ne nuk iu përgjigjëm.[39]

Pasi i zhveshën nga dokumentat dhe sendet e çmuara, forcat e sigurimit hoqën mënjanë nga grupi prej tridhjetë e dy burrash, dymbëdhjetë vetë dhe i shpunë në një shesh, midis shtëpive të Ajet dhe Haki Gashit. Ata të dymbëdhjetë i drejtuan për nga shtëpia aty pranë e Syl Gashit. Çka ndodhi më pas është përshkruar shumë saktë në dëshminë e C. C., që ndodhej në atë grup:

Katër prej tyre, tre ushtarë dhe një polic, erdhën me ne. Njëri nga ata të katër kishte një mitraloz dykëmbësh, ndërsa të tjerët kishin automatikë të zakonshëm. Na vunë pas murit. Njërin, një ushtar në moshë të re, e kishin lënë te dera. Ai tha, "Ne do t'i ekzekutojmë familjet tuaja te varreza. Në qoftë se doni të shpëtoni kryet, na jepni gjithë paratë që keni." Ne i thamë se nuk na kishin mbetur më para dhe ju mund të bëni me ne çfarë të doni.

Atëherë ai na tha se do të fliste me kolegët e tij për të parë se çdo të bënte me ne. Ata folën me një ëalkie-talkie me komandantin e tyre, por unë nuk i dëgjova se ç'thanë. Sakaq ai u dha te dera me automatik në dorë. Ne ishim të gjithë pas murit me duart lart. Ai tha, "Në emër të Serbisë, ju të gjithë do të pushkatoheni."

Ibër Kelmendin e kisha në krah të majtë. Ai është i sëmurë nga zemra dhe kur i dëgjoi fjalët e serbit, vdiq në vend dhe ra mbi mua. Edhe unë u shtira sikur kisha vdekur. Ai hapi zjarr dhe të gjithë u vranë, me përjashtim të një djali. Ai qëlloi edhe një herë mbi atë person – nuk e njihja se kush ishte. Unë isha plagosur në pjesën e sipërme të këmbës. Një tjetër ushtar erdhi dhe qëlloi përsëri, më pas një i tretë e zbrazi gjithë karikatorin e automatikut, më pas një i katërt. Unë isha i gjallë, i fshehur nën Ibro Kelmendin dhe tim vëlla.

Ata i mallkuan shqiptarët dhe pastëktaj i kallën zjarrin shtëpisë. Thyen xhamin e një dritareje dhe si i vunë zjarrin një dysheku e vendosën atë mbi trupat e të vrarëve. Pasi i zhvendosa trupat që kisha përsipër, dola jashtë. E ndava mendjen se ishte më mirë të më vrisnin sesa të digjesha i gjallë, kështu që kërceva nga dritarja. Eca kështu rreth 100 metra dhe u fsheha. I fshehur ndenja nga ora 10 e paradites deri në orën 5 të pasdites.[40]

"Në emër të Serbisë, ju të gjithë do të pushkatoheni."

Human Rights Watch e inspektoi shtëpinë e Syl Gashit më 16 korrik. Nga shtëpia kishin mbetur vetëm muret, gjithçka në pjesën e brendshme ishte djegur krejtësisht. Syri të zinte fragmente kockash të hapërdarë mes trarëve të karbonizuar të çatisë dhe traversave të drunjta që ndodheshin në dysheme.

B. B. kishte pasë qenë midis atyre që kishin qenë duke pritur jashtë portës së oborrit. Ai i tha Human Rights Watch se, të shtënat u dëgjuan pas dy-tri minutash që ata patën marrë grupin e parë dhe sakaq e kishte kuptuar se i kishin vrarë të gjithë. Ai i tha Human Rights Watch:

Policët u kthyen, folën me sho-shoqin dhe iu kërkuan ca djelmoshave rreth pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç të shkonin me gratë e fëmijët. Më pas, na ndanë dy grupe. Kur na morën (njëmbëdhjetë vetë), një djalë nuk dinte nga të shkonte, ndaj ata e qëlluan me qytën e pushkës dhe i thanë "Shko këndej!" Ata na thanë t'i vendosnim duart mbi krye dhe të ecnim shpejt. Rrugës për të mbërritut këtu (shtëpia e Sahit Gashit), njëri prej tyre tha, "vendosini këtu." Një tjetër ndërhyri e tha, "Nuk është mirë t'i vendosim këtu sepse do të qelbin dynjanë." Kështu shkuam në shtëpinë e Sahit Gashit.

Në krye na thanë të qëndronim pranë banjës. Fillimisht mendova se do të na ekzekutonin këtu, por njëri prej tyre me gjoksin e mbushur me gjerdanë me fishekë – 12.7 mm – tha, "Jo, futuni në këtë odën këtu." Ishin fare të qetë. Na shanë e na nëmën, por pa ulëritur. Thashë me vete, si mund të na vrasin kur janë kaq të qetë. Hymë në kuzhinë. Atëkohë pashë automatikun të villte zjarr dhe rashë në të mëngjër. Mendova që të gjithë ishin vrarë, ndërsa unë s'kisha marrë as edhe një plagë. Ai hapi zjarr me breshëri, tri herë. I njëjti person u zhvendos në anën tjetër të dhomës dhe shtiu sërish mbi ata që tashmë qenë plandosur

> në dysheme. Edhe tri herë të tjera. Një plumb më qëlloi në këmbë. Plumbi më kishte zënë në këmbën e majtë, nën gju. Paskëtaj plumbi më zuri në këmbën e djathtë, mbi gju. Plumbi i tretë më preku kërcirin e këmbës së djathtë dhe theu kockën.[41]
>
> Më pas ai nxori pistoletën dhe qëlloi mbi gjashtë a shtatë persona, por ndërkohë unë nuk shihja gjë ngaqë i kisha sytë e mbyllur. Dhe gjithçka mbaroi. Pllakosi heshtja. Prita dy tri minuta dhe pastaj dalëngadalë hapa sytë. Kur pashë që rreth e qark s'kishte njeri, u ktheva në të djathtë dhe vura re Isuf Shalën që kishte vdekur. Edhe Arian Lushi që ishte në të djathtën time kish vdekur. Të gjithë kishin vdekur.
>
> Nga dritarja pashë pesë policë dhe ndërkaq njërin prej tyre duke ardhur. U shtriva me sytë gjysmë të mbyllur për të parë se çfarë ishte duke bërë. Ai futi kryet në odë, hodhi diçka dhe shumë shpejt nga ai sendi nisi të dalë tym i zi. Pas pak sekondash nuk mund të mbushesha dot me frymë. Atëherë thashë me vete do të bërtas se po mbytesha dhe në heshtje thoja "o Perëndi, të lutem, ndihmomë" dhe u ngrita e shkova te dera. E mendova që do të vritesha, por më mirë ashtu se të digjesha i gjallë.
>
> Shkova në dhomën tjetër dhe u hodha nga dritarja. Kur kërceva jashtë pashë makinat e tyre. Njëri kishte një Gulinov të madh. Kishin automjete civile, kamionë, traktorë, por edhe automjete ushtarake.[42]

Ashtu si shtëpia e Syl Gashit, edhe ajo e Sahit Gashit do të digjej dhe më 15 korrik kur Human Rights Watch e vizitoi, i kishin mbetur vetëm muret.

E. E. ishte në grupin e fundit e përbërë nga nëntë vetë, duke pritur jashtë portës së oborrit, ditën e vrasjeve. Në një intervistë të shkurtër dhënë Human Rights Watch, ai konfirmoi se grupi ishte shpënë në shtëpinë e Demë Gashit dhe ishte ekzekutuar atje. Ai kishte shpëtuar i paplagosur. Por gjatë bisedës mbërritën fotografitë e njerëzve të vrarë të familjes së tij, si dhe atyre të familjeve fqinje, që do të shërbenin për ceremoninë e planifikuar të zhvillohej në Qyshk, një ditë më pas, më 18 korrik, duke e bërë krejtësisht të papërshtatshëm momentin për të vijuar më tej intervistën.

Gjithsesi disa gazetarë të huaj folën deri në detajet më të imta me E. E. rreth përvojës së tij. Në një artikull të botuar në numrin e datës 28 qershor të *Time*, citohet çka ka thënë i mbijetuari, rreth asaj që ngjau pasi forcat e sigurimit e shpunë në shtëpinë dy katëshe:

> Isha bashkë me tetë vetë të tjerë. Kur hymë në korridorin e shtëpisë,

> një nga ushtarët e VJ (Ushtrisë Jugosllave) na dha një çakmak dhe na tha të digjnim shtëpinë. Kur u përkula të marr çakmakun, nisën të shtënat. Unë zura të hiqem zvarrë, pa e kthyer kokën mbrapsh.[43]

Human Rights Watch foli edhe me A. A., mbesën e E. E.-së, e cila ndodhej në Mal të Zi, si refugjate. Ajo i tha Human Rights Watch se e kishte takuar ungjin natën e 14 majit, pranë fshatit Qyshk dhe riprodhoi atë çka i kish thënë ai asokohe:

> Në muzg, im ungj erdhi dhe na tha se burrat ishin ndarë në tre grupe dhe shpënë në tri shtëpi të ndryshme. Ai kishte qenë i pari që kish hyrë në njërën nga shtëpitë. Njëri nga ushtarët i kishte dhënë një çakmak dhe urdhëruar t'i vinte flakën perdes në dhomë. Kur ai qe përkulur t'i vinte zjarrin perdes, kish dëgjuar breshërinë e automatikut. Atëherë kërceu nga dritarja dhe ia mbathi.[44]

Ngjarjet e përshkruara nga të tre të mbijetuarit do të konfirmoheshin edhe nga individë të tjerë në fshatin Qyshk, më 14 maj, duke përfshirë edhe grupin e grave që ndodheshin në afërsi të vendndodhjes së forcave të sigurimit, para se të nxirreshin nga fshati, pak a shumë në të njëjtën kohë që grupi i parë i burrave kishte marrë drejtimin nga shtëpia e Syl Gashit. Sipas thënieve të disa prej grave, teksa po largoheshin atyre iu zuri veshi të shtëna, por ato nuk ishin në gjendje të përcaktonin se nga ç'drejtim vinin. A. A. i tha Human Rights Watch:

Thashë me vete, si mund të na vrasin kur janë kaq të qetë.

> Ndërkohë që po dilnim nga fshati, ushtarët nisën të qëllojnë në drejtim tonë, por vetëm për tokë. Për shkak të zhurmës dhe frikës që ndjemë, nuk qemë në gjendje të përcaktonim me saktësi se kundër kujt shtinin dhe nga ç'vend vinin të shtënat. Ndoshta në të njëjtën kohë shtihej nga disa drejtime, por ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim prejardhjen.[45]

Gratë dhe fëmijët e fshatit u ngarkuan në traktorë dhe u shoqëruan nga trupat serbe për në fabrikën e baterive të Trepçës aty pranë, në rrugën që lidh Pejën me Prishtinën. Një nga gratë që ndodhej në këtë grup, i tha Human Rights Watch, se në një postbllok pranë fabrikës, takuan

komandantin e stacionit të policisë së Pejë-Kliçinës. Ai u befasua kur pa gjith'ato gra e fëmijë, i pyeti se kush i kishte nisur atje dhe i ktheu mbrapsh në drejtim të fshatit Qyshk, të shoqëruar nga disa burra në tri vetura civile, një Audi gri dhe dy Zastava. D. D. tha:

> Ushtarët i vunë zjarrin shtëpisë së Saliut. Çatia zuri të shembej. Paskëtaj ata na hypën mbi traktorë dhe kuaj. Rreth orës 10 të paradites, ata na mblodhën të gjithë neve – gra, fëmijë dhe ca pleq – përballë fabrikës së Trepçës, e cila ndodhet midis Qyshkës dhe qendrës së Pejës. Ndërkohë që po largoheshim, dëgjuam të shtënat. Rrugës për në fabrikë, ushtarët nuk e hapën pothuajse fare gojën.
>
> Ne qëndruam për katër orë përballë Trepçës. Policët e atjeshëm na thanë të ktheheshim andej nga kishim ardhur, në Qyshkë. Kur iu afruam fshatit, pamë shtëpitë e djegura. Unë hyra në shtëpinë e Ram Binakut. Në njërën nga dhomat pashë kufomat e shkrumbëzuara. Pjesa më e madhe e tyre ishte e pamundur që të njihej. Gratë njohën copëza sendesh që iu përkisnin bashkëshortëve të tyre, si çakmakë, ora dore, çelsa... Ma merr mendja se Skënder Dervishi ishte djegur i gjallë. E them këtë ngaqë pranë trupit të tij pashë gjurmë në shesh, sikur dikush kishte gërvishtur sipërfaqen me thonj. Më ra të fikët.[46]

Një tjetër person, F. F., tridhjetë e pesë vjeç, u largua në drejtim të kodrave në kohën kur mbërritën forcat e sigurimit, por u kthye po atë ditë në mbrëmje vonë për të zbuluar shumë nga kufomat, duke varrosur tridhjetë e pesë nga dyzet e dy viktimat. Ai i tha Human Rights Watch:

> Ne u larguam rreth 300 metra nga fshati, ku është një kodër e pyjëzuar. Pamë shtëpitë të digjeshin dhe dëgjuam të shtënat e britmat e njerëzve. Më pas, forcat serbe u larguan. Rreth tridhjetë a dyzet e pesë minuta më vonë, (E. E.) erdhi. Vumë re që nuk ishte mirë. E pyeta ç'kishte ndodhur. Ai s'fliste dot, por vetëm përgjigjej, "Ç'na gjeti! Ç'na gjeti!" duke mbajtur kryet me duar. Qe shfytyruar i tëri.[47]

F. F. tha se, E. E. iu kallzoi burrave që ndodheshin në kodër që njerëz ishin vrarë në fshat, por ai ishte tepër i traumatizuar për t'iu shpjeguar ngjarjen. Rreth një orë më vonë, F. F. dhe një burrë tjetër i quajtur Ajet, shkuan në Qyshk për të parë çfarë kish ngjarë. Rrugës për në fshat, ata panë Zoran

Jasoviç, një civil serb etnik që banonte në Qyshk, duke valëvitur flamurin jugosllav para një shtëpie të djegur, pas të gjitha gjasave për t'iu bërë të ditur forcave të sigurimit se ai ishte serb. Ai nuk i pa shqiptarët etnikë dhe më pas u largua prej andej. F. F. shpjegoi atë ç'ngjau më pas:

> Ai (Jasoviçi) u largua dhe ne morëm për nga shtëpia. Unë hyra brenda dhe pashë turpat që po digjeshin. Ishte shtëpia e Demë Gashit. Nuk i identifikova trupat, madje as nuk i numërova. U kthyem në pyll dhe unë e ftova Sadik Gashin të vinte me ne. U kthyem sërish dhe u munduam të shuanim zjarrin. Trupat ishin larguar në atë kohë. Asnjë nga anëtarët e familjeve tona nuk ndodhej aty qark ...
>
> Pashë shtëpinë e djegur të Sylë Gashit dhe një numër viktimash të djegura. S'mund t'ju them se sa njerëz gjendeshin aty brenda, për këtë do të ishte më mirë të flisnit me një dëshmitar okular. Vendosa të inspektoj çdo shtëpi. Në shtëpinë e Ahmet Gashit gjetëm trupat e djegur, por nuk ia dolëm të fiknim zjarrin. Në shtëpinë e Ajetit pamë dy trupa të tjerë të djegur: Sylë Gashi dhe Skënder Gashi ... Më pas shkuam në shtëpinë e Sali Gashit. Aty pamë trupin e Ibish Gashit të bërë shoshë nga plumbat. Pranë rrugës vumë re një plevicë të çukërmuar nga plumbat. Hapa derën ngadalë, shumë ngadalë dhe pashë Qaush Lushin të vdekur. Ishte vrarë nga një mitraloz 7.9 mm.

Human Rights Watch inspektoi plevicën ku qe raportuar vdekja e Qaush Lushit. Ajo ishte një ngrehinë e vogël, e drunjtë në anë të rrugës. Në derën ballore ishin dhjetë vrima plumbash, ndërsa në murin e brendshëm ishin nëntë vrima plumbash (shih fotografinë në të majtë). Ekspertë kriminalistë danezë që krejt rastësisht ndodheshin në atë kohë në vendngjarje duke ekzaminuar për hesap të Gjykatës së Krimeve të Luftës në ish-Jugosllavi, i thanë Human Rights Watch se ata kishin mbledhur dëshmi

Një nga fshatarët në Qyshk që panë trupin, tha se forcat e sigurimit serb vranë në këtë plevicë më 14 maj 1999 Qaush Lushin. Një ekspert danez i kriminalistikës që ekzaminoi në korrik vendin gjeti dhjetë vrima plumbash dhe gjurmë gjaku njerëzor.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

konkrete gjaku njerëzor në brendësi të plevicës. Ata thanë se kishin gjetur dy plumba, një në brendësi të plevicës dhe i dyti ngulur në një pemë. Pas të gjitha gjasave i përkisnin kalibrit 7.6 mm.[48]

Fshatarët e Qyshkës i thanë Human Rights Watch se Qaush Lushi ishte njeriu më i pasur në fshat dhe ai qe shtrënguar t'u jepte policëve 10.000 marka gjermane para se ai dhe i biri, Osmani, të vriteshin. Në një artikull të botuar në Time që bënte fjalë për vrasjet në Qyshk, thuhej se Lushi u kthye nga shtëpia me paratë për t'ua dhënë policëve për të gjetur të birin tashmë të vdekur. Paskëtaj atë e futën me përdhunë në plevicë, ku edhe e vranë.[49]

B. B. konfirmoi se policia e kishte në shënjestër Qaush Lushin. Ai i tha Human Rights Watch:

> Ata (forcat serbe të sigurimit) thanë, "Doni të keni shtet? Ne jemi 11 milion serb, kështu që në qoftë se doni të keni shtetin tuaj, shkoni dhe kërkojini ndihmë Clinton-it dhe Blair-it. Tani lypini ndihmë NATO-s. Qaushi tha

Një ceremoni përkujtimore e mbajtur në Qyshk më 18 korrik 1999 për të dyzet e një burrat shqiptarë të vrarë në fshat nga forcat e sigurimit serb më 14 maj. Fshatarët mbajnë në duar fotografi të të vrarëve.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

Lista e të vrarëve në fshatin Qyshk më 14 maj 1999

1. Muse Gashi, 64
2. Emin Gashi, 60
3. Brahim Gashi, 60
4. Ibish Gashi, 56
5. Halil Gashi, 55
6. Syle Gashi, 49
7. Jashar Gashi, 47
8. Ahmet Gashi, 35
9. Skënder Gashi, 37
10. Ramë Gashi, 60
11. Xhafer Gashi, 42
12. Brahim Gashi,56
13. Selim Gashi, 42
14. Haki Gashi, 38
15. Iber Kelmendi, 52
16. Skënder Kelmendi, 46
17. Besim Kelmendi,36
18. Erdogan Kelmendi, 19
19. Brahim Kelmendi, 40
20. Demë Kelmendi, 41
21. Mentor Kelmendi, 23
22. Avdi Berisha, 64
23. Rasim Rama, 40
24. Muhamet Shala, 50
25. Hasan Çeku, 69
26. Kadri Çeku, 68
27. Sefedin Lushi, 41
28. Osman Lushi, 47
29. Xhafer Lushi, 46
30. Skënder Lushi, 44
31. Avdulla Lushi, 60
32. Ukë Lushi, 57
33. Ramiz Lushi, 41
34. Qaush Lushi, 51
35. Arian Lushi, 20
36. Gani Avdylaj, 42
37. Hasan Avdylaj, 40
38. Isuf Shala, 50
39. Emrush Krasniqi, 49
40. Ismet Dinaj, 32
41. Zeqir Aliaj, e panjohur

> "Ne e kemi shtetin." Njëri prej tyre tha "Në kohën që unë isha duke ju mbrojtur, ju vutë para e u pasuruat." Dy herë ata e çuan Qaushin në shtëpinë e vet dhe kur ai erdhi te ky oborr (pranë shtëpisë së Azem Gashit), ata shtinë mbi kryet e tij. Qaushi u kthye me makinën e vet.[50]

F. F. i tregoi Human Rights Watch çka kish ndodhur një ditë më pas, më 15 maj, pasi ai dhe bashkëfshatarët e tij e kishin kaluar natën në pyll:

> Ditën tjetër, familjet që kishin fjetur në shtëpinë Kelmendi, Ajeti, Milaimi dhe unë, vendosëm të varrosnim kufomat sepse nuk donim që familjarët e tyre t'i shihnin të katandisur në atë gjendje. Unë propozova dhe vendosëm të rrëmihnim një varr të përbashkët sepse ishte tepër e rrezikshme të himbisnim kohë duke mihur shumë varre të veçantë. Disa gra e fëmijë erdhën dhe sakaq

e kuptuan që burrat e tyre ishin vrarë e djegur. Ato më pyetën "ku është filani e fisteku." Unë iu thashë, "cilido që nuk ndodhet këtu ka vdekur."

Ne gjetëm tridhjetë e një trupa dhe i varrosëm të gjithë tok me dy kufoma të padjegura, atë të Ibish Gashit dhe Qaush Lushit … (Një ditë më pas) ra një shi i rrëmbyer. Vendosëm që Skënderi, Ajeti, Milaimi dhe unë të shkonim e të merrnim me një vig, dy trupa të tjerë, njëri ndodhej pranë shtëpisë sime dhe aty pamë një plak që po këqyrte trupin e xhaxhait tim, Brahimit, që e kishin vrarë me një plumb në zemër. E morëm edhe atë dhe e çuam te varri i hapur. Më pas shkuam të kërkojmë trupin e fqinjit tonë, Rasimit … E gjetëm në oborrin e shtëpisë. Trupin e kishte plot me plumba. Në oborrin e shtëpisë kish qenë ekzekutuar edhe një person tjetër, Met Shala, por trupin e tij tashmë e kish marrë i vëllai.[51]

Ne gjetëm tridhjetë e një trupa dhe i varrosëm të gjithë tok me dy kufoma të padjegura.

Aty nga pasditja grupi i grave, fëmijëve dhe pleqve qe kthyer në Qyshkë. Persona me uniformë i vendosën anëtarët e tri familjeve – Lushi, Gashi dhe Kelmendi – në shtëpinë e Shaban Binakut. Ata, si dhe të gjithë ata që ia kishin dalë mbanë t'i shpëtonin mësymjes, qëndruan në fshat ose në një pyll aty pranë deri në përfundim të luftës.

Sulmet në Zahaq dhe në Pavlan

Vrasjet në Qyshkë janë në qendër të këtij seksioni. Por shihet qartë se ofensiva e 14 majit përfshinte edhe sulmet mbi fshatrat fqinje të Zahaqit dhe Pavlanit, si pjesë e një aksioni të bashkërenduar. Dëshmitë na shtyjnë të mendojmë se, në mos të gjitha, të paktën një pjesë e forcave të angazhuara në mësymje do të merrnin pjesë në sulmin mbi dy fshatra. Shumë dëshmitarë i thanë Human Rights Watch se, forcat e sigurimit u shpërngulën në drejtim të Zahaqit dhe Pavlanit pas masakrës së kryer në Qyshkë.

Zahaq

Banorët e Zahaqit, një fshat me afro 140 shtëpi, i thanë Human Rights Watch se, policët kishin ardhur edhe para 14 majit në Zahaq, në dy a tri

raste, thjesht për të kërkuar para. Pasi filluan bombardimet e NATO-s, policët dhe paraushtarakët ishin vendosur në prona private pranë fshatit, duke përfshirë shitoret përgjatë rrugës Pejë-Prishtinë, dhe në shtëpinë e Xhemail Ramës.

Policët mbërritën më 14 maj, rreth orës 8 të mëngjesit. Një pjesë e madhe e njerëzve ia mbathën nëpër kodra, por disa prej tyre u kapën pa dalë nga fshati. Sadri Gashi, Fatos Gashi dhe Valdet Gashi, sipas të dhënave janë vrarë pikërisht në këtë kohë. Trupat që sipas përshkrimeve i përkisnin policisë dhe paraushtarakëve, iu kërkuan fshatarëve të largoheshin në drejtim të Pejës me traktorë apo në këmbë, me urdhërin e prerë për të "shkuar në Shqipëri."[52]

Një tjetër grup paraushtarakësh e ndaloi karvanin në udhë e sipër dhe hoqi mënjanë 14 burra. Pjesa tjetër e grupit vijoi rrugën në drejtim të fabrikës së baterive të Trepçës, pranë Pejës, por ata do të ndaloheshin atje nga policia rreth orës 1 të pasdites dhe pasi u mbajtën për pak kohë, u kthyen mbrapsh dhe u nisën për në Zahaq. Sipas fshatarëve, rreth orës 5 të pasdites karvani kaloi te vendi ku ishin ndaluar të katërmbëdhjetë burrat. Ata nuk panë kufoma, por më vonë dëgjuan nga fshatarë të tjerë, se pengjet ishin vrarë në një hendek pranë rrugës.

Me t'u kthyer në Zahaq, forcat e sigurimit i plaçkitën fshatarët e karvanit dhe më pas i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Burrat u urdhëruan të dorëzonin gjithë paratë që kishin me vete në qoftë se nuk donin të ekzekutoheshin. Pasi të gjithë sendet e çmuara ishin dorëzuar, forcat e

Lista e të vrarëve në Zahaq, më 14 maj 1999

1. Ismet Hyseni, 41
2. Sabit Hyseni, 31
3. Naim Hyseni, 38
4. Agim Hyseni, 28
5. Bajrush Hyseni, 24
6. Shpend Hyseni, 31
7. Shaban Rama, 45
8. Sadri Rama, 50
9. Faton Rama, 24
10. Valdet Rama, 36
11. Demë Hatashi, 28
12. Shaban Neziri, 41
13. Zenel Neziri, 67
14. Fehmi Gjukiqi, 23
15. Hysen Gjukiqi, 21
16. Bekim Delia, 21
17. Zyber Smajlaj, 26
18. Shaban Smajlaj, 23
19. Gëzim Cukaj, 19

sigurimit u larguan. Fshatarët do të qëndronin nëpër kodra për më shumë se një muaj, duke u kthyer në fshat vetëm për t'u furnizuar me ushqime, deri ditën kur forcat e NATO-s hynë në Kosovë, më 12 qershor. Numri i përgjithshëm i burrave të vrarë në Zahaq, më 14 maj, do të arrinte në nëntëmbëdhjetë vetë. Në kohë të ndryshme gjatë luftës do të vriteshin edhe nëntë të tjerë, por Human Rights Watch nuk ndërmori hetime për këto vrasje.[53]

Pavlan

Sipas dëshmisë së fshtarëve, forcat e sigurimit hynë në Pavlan më 14 maj, rreth orës 10.30 të paradites.[54] Pjesa më e madhe e burrave e braktisën fshatin ngaqë kishin dëgjuar që njerëz ishin ekzekutuar në krahinë. E megjithatë dyzet e gjashtë banorë të fshatit u kapën, duke përfshirë këtu edhe gjashtë burra. Pasi policia iu mori letërnjoftimet, ata mbajtën gjashtë burrat e të tjerët i lanë të shkojnë. Pasi ata u lanë të largohen, fshatarët thanë se dëgjuan tri breshëri të shtënash. Kur u kthyen në Pavlan, po atë mbrëmje, ata gjetën trupat e gjashtë burrave të vrarë në shtëpinë e djegur të Zymer Gashit.

Human Rights Watch e vizitoi shtëpinë dykatëshe të Zymer Gashit, më 17 korrik 1999. Ajo ishte krejtësisht e djegur dhe përveç mureve nuk kish gjë tjetër më këmbë. Në një mur, në katin e dytë, përkundër derës, gjendeshin katërmbëdhjetë vrima plumbash. Fshatarët kishin mbledhur fragmente kockash, të cilat i kishin futur në një qese plastike dhe varur në mur, mbërthyer me gozhdë.

Fshatarët i thanë Human Rights Watch se Aishe Gashi, dyzet e tre vjeç, kishte pasur kontakt të drejtpërdrejtë me forcat e sigurimit, ngaqë e fliste mirë serbishten. Sipas tyre, kur policët u kthyen në Pavlan në fund

Lista e të vrarëve në Pavlan, më 14 maj 1999

1. Zyber Gashi, 70
2. Niman Gashi, 56
3. Shaban Kelmendi, 52
4. Haxhi Dreshaj, 41
5. Brahim Nikqi, 55
6. Hatixhe Nikqi, 55
7. Alush Selmanaj, 46
8. Zenun Shala, e panjohur
9. Muqe Lulaj, e panjohur
10. Xhejrone Nikqi, e panjohur

të majit, pas masakrës, Aishja u tha atyre se ajo i njihte që ata ishin nga ajo zonë. Aishja do të vritej në rrethana të panjohura, më 8 qershor.

Gjithë-gjithë trembëdhjetë njerëz do të kapeshin dhe vriteshin nga forcat serbe në Pavlan, gjatë bombardimeve të NATO-s, dhjetë prej tyre më 14 maj. Të tjerët do të vriteshin më 5, 8 dhe 10 qershor.

Fajtorët

Siç është vënë në dukje, shqiptarët etnikë kanë pasur vështirësi në identifikimin e fajtorëve dhe abuzuesve kundrejt tyre. Sipas rastit, individë të veçantë ose ndonjë shef policie janë identifikuar, por përgjithësisht dëshmitarët dhe viktimat kur flasin për abuzuesit e tyre përdorin terma të përgjithshëm si "paraushtarakët" ose "ushtarët".

E megjithatë, lidhur me abuzimet në rajonin e Pejës ofrohen një sërë mundësish të reja për identifikimin e fajtorëve, ngaqë krejt ndryshe prej disa krahinave të tjera të Kosovës, shqiptarët e këtushëm kanë pasur kontakte të rregullta e në nivele të ndryshme me shumë prej serbëve etnikë që kanë jetuar në këtë vend. Vetë Peja, vendndodhja e Kishës Ortodokse Serbe, ka pasur një popullsi serbe të konsiderueshme, ashtu si edhe disa prej fshatrave të saj, si Gorazhdec dhe Nakille.

Një pjesë e mirë e banorëve shqiptarë të Qyshkës besonin se, forcat e sigurimit që mësynë fshatin më 14 maj kishin në radhët e tyre edhe serbë etnikë nga ajo zonë. Siç është përshkruar edhe më sipër, me sa duket forcat e sigurimit i njihnin disa nga shqiptarët e fshatit. Fshatarë të tjerë i thanë Human Rights Watch se, njerëzit e forcave të sigurimit flisnin serbisht me një aksent të pastër kosovar, krejt ndryshe prej serbëve të Serbisë së jugut apo nga Beogradi. Një banore e Pavlanit tha se ajo kishte njohur në radhët e trupave që shkuan në fshatin e saj, disa prej serbëve që ishin nga ato anë, ndonëse nuk ua dinte emrat. "Njëri prej tyre ka pasë punuar si portier në Dhomën e Bylmetit, atje ku shesin qumësht e djathë," tha ajo.[55]

Në një sërë intervistash me fshatarët, dolën në pah një numër përshkrimesh fizike të personave të ndryshëm. Një grua, H. H. e përshkroi kështu njeriun që ajo mendonte se kish komanduar në Qyshkë (ngaqë ai fliste në ëalkie-talkie): afërsisht gjashtë këmbë të gjatë, pak të shëndoshë dhe rreth të dyzetave. Kishte flokë të zinj e të qethur shkurt, të rruar anash me një xhufkë të bardhë në majë, tha gruaja. Mbante mjekër, vende-vende

të thinjur dhe kish veshur uniformë ushtarake, por pa kapele.[56] Fshatarë të tjerë e përshkruan komandantin me mjekër me ngjyrë të hapur. B. B. i tha Human Rights Watch: "Një tip me mjekër të shkurtër, vende-vende të thinjur, ngjante si komandant, ngaqë ishte ai që urdhëronte." [57]

E megjithatë, dëshmia më bindëse vjen nga identifikimi i bërë prej dëshmitarëve njëzet e një fotografive të siguruara nga Human Rights Watch, të cilat paraqisnin njerëz të armatosur e të veshur me uniformë, që ngjan të ishin pjesë e njësive ushtarake ose të tjera, policë rezervistë, forca speciale, milicisë lokale apo trupave paraushtarake. Dy individë nga të fotografive do të njiheshin e identifikoheshin nga një numër i shumtë dëshmitarësh, si persona që kishin qenë të pranishëm në Qyshkë, më 14 maj, ndërsa një person i tretë ishte parë në Zahaq, po atë ditë. Po kështu do të identifikoheshin edhe disa persona të tjerë, edhe pse pa qenë të akuzuar se kishin qenë në Qyshkë, më 14 maj, ndërsa plot të tjerë nuk u identifikuan fare.

Human Rights Watch i siguroi fotografitë më 16 korrik nga administrata komunale në Pejë, e cila asokohe drejtohej nga ish-anëtarë të UÇK-së. Fotografitë paraqesin individë të ndryshëm dhe grupnjerëzish që kanë marrë poza ushtarake. Në disa prej tyre shohim njerëz të veshur me uniforma ushtarake që janë duke pozuar në një fushë ose fshat. Në të tjerat shohim njerëz me gjithë pajisjet ushtarake dhe armë automatike që kanë dalë para shtëpive të djegura ose me tri gishtat lart, që përshëndetja e nacionalistëve serbë. Zyrtarët e UÇK-së i thanë Human Rights Watch se, fotografitë ishin gjendur në shtëpitë e serbëve etnikë në rajonin e Pejës, pasi trupat serbe dhe jugosllave ishin tërhequr nga Kosova, më 12 qershor. Human Rights Watch do të siguronte gjithashtu edhe dy grupe fotografish të tjera të datës 6 maj 1999 nga fshatarët e Zahaqit, ku nga shenjat që kanë në krah personat e dalë në to, duket qartë që janë anëtarë të forcave speciale të policisë. Fshatarët i thanë Human Rights Watch se, i kishin gjetur këto fotografi në shtëpinë e një serbi në Nakille.

Human Rights Watch i skanoi fotografitë, i hodhi në një kompjuter laptop dhe më pas ua tregoi fshatarëve në Qyshkë, Zahaq dhe Pavlan, si dhe banorëve të Pejës, për të parë nëse njihnin apo mund të identifikonin ndonjë nga individët në fotografi. Human Rights Watch nuk mund të konfirmojë autenticitetin e fotografive, meqenëse origjina e tyre, mënyra e përftimit dhe pronësia janë të panjohura. Fakti që fotografitë ishin siguruar nga UÇK-ja, së cilës i intereson të identifikojë serbë si kriminelë të mundshëm

lufte, e rrit gjithsesi dyshimin rreth vërtetësisë së tyre. Por edhe sikur fotografitë të kenë qenë të falsifikuara, as që mund të vihet në dyshim fakti se disa nga fshatarët e intervistuar nga Human Rights Watch i identifikuan një pjesë të personave në fotografi – dhe është krejtësisht e pangjashme që kjo të ishte diçka e bashkërenduar midis fshatarëve dhe njerëzve të UÇK-së. E vërteta është se, Human Rights Watch ia kërkoi fotografitë UÇK-së dhe nuk qe se kjo ishte një iniciativë e vetë UÇK-së, madje pa u dhënë atyre të kuptonin se këto foto do t'iu tregoheshin fshatarëve të asaj zone.

Rezultatet e hetimit të Human Rights Watch janë si më poshtë: Një person ishte njohur nga gjashtë fshatarë të ndryshëm, të intervistuar veç e veç, të cilët thanë se e kishin parë në fshatin Qyshk, më 14 maj. Pesë prej tyre e identifikuan atë në fotografinë nr. 1 (i dyti nga e majta), dhe vetëm njëri prej tyre do të shprehej "Jam 90 përqind i sigurt që ka qenë atje." Të tjerët ishin mëse të sigurt në përgjigjet e tyre. Dy nga të intervistuarit thanë se, personi në fotografi kishte qenë komandant në Qyshkë, më 14 maj, ndërsa një i tretë që gjithashtu e kishte identifikuar praninë e tij në fshat tha se, "mund të kish qenë komandant," me të cilën nënkuptohej se ishte ai personi që drejtonte anëtarët e tjerë të grupit dhe fliste në walkie-talkie. [58]

Fotografia nr. 2 (personi në të djathtë) dhe ajo nr. 3, tregojnë të njëjtin person edhe pse ai është i rruar. Një nga të pesë dëshmitarët që e njohu atë në fotografinë nr. 1, tha se, njeriu në të djathtë, në fotografitë nr. 2 dhe nr. 3 ishte i njëjti person dhe se forcat e sigurimit e thërrisnin atë "Popa". Një tjetër dëshmitar, i cili nuk reagoi për fotografinë nr. 1, tha se njeriu në të djathtë në fotografinë nr. 2, kishte qenë në Qyshkë, më 14 maj dhe kish shkuar në shtëpinë e Demë Gashit ku ishin vrarë tetë vetë. "Ai nuk kishte mjekër," tha dëshmitarja. Kur pa fotografinë nr. 3, dëshmitarja pohoi se, ky person kishte qenë me trupat serbe që vizituan fshatin Qyshk në prill dhe se asokohe ai mbante mjekër. Sipas saj, ai "tundi pushkën automatike dhe tha 'veç kësaj nuk i shpëtoni.'"

Përveç faktit që kishin dëgjuar nofkën e tij "Popa", asnjë nga dëshmitarët nuk ia dinte emrin personit të identifikuar prej tyre në fotografi: ata vetëm sa pohuan që ai kishte qenë i pranishëm në Qyshk. Emri i tij, Sreçko Popoviç, do t'i bëhej e ditur më parë Human Rights Watch nga njerëzit e UÇK-së lokale, por më vonë do të konfirmohej edhe nga dy gazetarë amerikanë që kishin qenë gjithashtu duke hetuar për krime lufte në rajonin e Pejës dhe që kishin përdorur të njëjtin takëm fotografish për të identifikuar fajtorët. Sipas Stephen Smith dhe Michael Mongomery nga American RadioWorks,

radiostacion ky që kish transmetuar një sërë emisionesh rreth krimeve të luftës të kryera në fshatin Qyshk dhe në Kosovë në përgjithësi, "Premtimi për Drejtësi" kish qenë emisioni i transmetuar në Radion Publike Kombëtare në Shtetet e Bashkuara në vitet 2000 dhe 2001, të tre njerëzit e intervistuar prej tyre – një shqiptar etnik dhe dy serbë etnikë – e kishin identifikuar Popoviçin me emër kur kishin parë fotografinë nr. 3.[59] Veç kësaj, Smith dhe Montgomery kishin gjetur edhe pesë persona të tjerë, të cilët nuk ia dinin emrin Popoviçit, por pohonin praninë e tij në Qyshk, më 14 maj. Dy prej tyre e konsideronin Popoviçin si komandant.[60]

Një tjetër person i identifikuar si i pranishëm në Qyshk, më 14 maj, është Zvonimir Cvetkoviç. Një dëshmitar mëton ta ketë parë Cvetkoviçin në Qyshk atë ditë, madje edhe të ketë folur me të. Dëshmitari e identifikoi menjëherë atë në fotografinë që paraqet një grup njerëzish para një kamioni, fotografia nr. 4 (Cvetkoviçi ndodhet në cep në të djathtë), duke

FOTO 1: *I dyti nga e majta njihet si Sreçko Popoviç, për të cilin dëshmitarë të shumtë thanë se ishte anëtar i forcave të sigurimit serb që më 14 maj ekzekutuan dyzet e një burra në Qyshk të Kosovës. I treti nga e majta është identifikuar si Sllavisha Kastratoviç i cili është parë më 14 maj me focat e sigurimit serb në Zahaq të Kosovës ku u ekzekutuan nëntëmbëdhjetë burra të tjerë. Ajo ç'ka ata dinë për ngjarjet dhe anëtarët e tjerë të njësive të tyre do t'i bënte ata dëshmitarë të vlefshëm për Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish Jugosllavinë. Identiteti dhe veprimtaria e burrave të tjerë në fotografi është e panjohur ashtu sikurse dhe data e vendi i fotografisë.*

© HUMAN RIGHTS WATCH

u shprehur, "S'do mend që e njoh Zvonkon. Kemi pasë jetuar në të njëjtën rrugicë." Më vonë, Human Rights Watch do të siguronte edhe një kopje të pasaportës së Cvetkoviçit, e cila ugjendj në Petrans, në ndërmarrjen e kamionave në Pejë, ku ai kishte punuar. Fotografia e pasaportës (fotografia nr. 5) përkon me personin që është në cepin e djathtë në fotografinë që paraqet një grup burrash. Një tjetër dëshmitar, F. F. i tha Human Rights Watch se e kishte parë Zvonko Cvetkoviçin në Qyshkë, më 14 maj, por pohoi se ia kish mësuar emrin më vonë, dhe duhet thënë se ai nuk i pa fotografitë që ndodheshin në duart e Human Rights Watch. Gjithsesi, Smith dhe Montgomery kishin hasur në dy njerëz që, veç e veç, e kishin identifikuar Cvetkoviçin me emër në fotografinë e bërë në Petrans. Të dy ata do të shpreheshin se e kishin parë atë në fshatin Qyshk, më 14 maj.[61]

Bazuar në gjithë këto identifikime, Human Rights Watch beson se tashmë ekziston një dëshmi e fortë që vërteton praninë e Sreçko Popoviçit dhe Zvonko Cvetkoviçit në fshatin Qyshk, më 14 maj. E megjithatë, lypset thënë se nuk kemi dëshmi se si njëri ashtu edhe tjetri, kanë qenë

FOTO 2: *Burri në të djathtë është identifikuar si Sreçko Popoviç (shih FOTO 1). Data dhe vendi i fotografisë janë të panjohura ashtu sikurse dhe identiteti i burrave të tjerë.*

© HUMAN RIGHTS WATCH

pjesëmarrës në mënyrë të drejtpërdrejtë në ekzekutimin e dyzet e një vetëve. Mund të themi që ata të dy kanë qenë të pranishëm, tok me forcat e sigurimit, në kohën që u kryen ekzekutimet, si dhe u dogjën shtëpitë e u plaçkitën pronat private. Tek e fundit, të dy këta persona, zotërojnë një informacion të çmuar rreth krimeve të kryera, duke përfshirë këtu edhe emrat e komandantëve, ndaj për këtë arsye, ata duhet t'i nënshtrohen hetimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës në ish-Jugosllavi (ICTY).

"S'do mend që e njoh Zvonkon. Kemi pasë jetuar në të njëjtën rrugicë."

Dy shqiptarë etnikë nga Zahaqi të intervistuar veç e veç, thanë se kishin njohur Sllavisha Kastratoviçin në fotografinë nr. 1 (i treti nga e majta, pranë Sreçko Popoviçit), si një nga anëtarët e forcave të sigurimit që kishin qenë të pranishme në Zahaq, më 14 maj. Njëri nga burrat, që mëtonte se kish marrëdhënie të rregullta me serbët lokalë për shkak të punës së tij, tha se Kastratoviçi ishte nga Gorazhdeci dhe se kish punuar në ndërmarrjen e tregtisë, Pik. Ndërsa tjetri u shpreh se e njihte Kastratoviçin personalisht. Ai i tha Human Rights Watch: "Më 14 maj e pashë Sllavisha Kastratoviçin. Madje ai më foli. Më pyeti si isha. 'Më vjen mirë që i ke djemtë gjallë,' më tha. Fëmijët e mi janë ende të vegjël."[62]

FOTO 3: *Burri në të majtë është identifikuar si Sreçko Popoviç (shih FOTO 1dhe FOTO 2). Data dhe vendi janë të panjohura.*
© HUMAN RIGHTS WATCH

Një tjetër person nga fshati Qyshk, H. H., do ta shquante Kastratoviçin në fotografinë nr. 1, ndonëse nuk ia dinte emrin. Ajo i tha Human Rights Watch se ai kishte qenë në Qyshk më 14 maj, por edhe në disa raste të tjera në prill, kur forcat e sigurimit kishin ushtruar kontroll në fshat.[63] Pohimet e tre dëshmitarëve nga Qyshka dhe Zahaqi, na ofrojnë të dhëna që në aksionet e datës 14 maj, si në njërin ashtu edhe tjetrin fshat, janë angazhuar të njëjtat forca.

Një tjetër emër që do të shfaqej e rishfaqej gjatë intervistave ishte ai i Vidomir Salipur, i njohur pothuajse

nga gjithkush në Pejë dhe fshatrat rreth e qark, thjesht e shkoqur si Salipur. Intervistat dhe bisedat me një dyzinë banorësh të Pejës do t'i mëshonin faktit se Salipuri kishte reputacionin e njeriut të dhunshëm. Si anëtar i departamentit të policisë së Pejës, ai ishte i njohur për dëshirën e tij të papërmbajtur për të rrahur e torturuar shqiptarët etnikë në burg apo në rrugë qoftë. Veprimtarë lokalë të të drejtave të njeriut, gazetarë, njerëz të UÇK-së, por edhe qytetarë të thjeshtë të Pejës, i thanë Human Rights Watch se Salipuri ishte gjithashtu kreu i një grupi të milicisë lokale apo grupi paraushtarak, të quajtur Munja ose "Ndriçimi", që ishte në të njëjtën kohë edhe nofka e Salipurit.[64] Pas të gjitha gjasave, grupi përbëhej nga serbë lokalë, një pjesë e të cilëve ishin efektiv i forcave policore ndërsa të tjerët ishin civilë. Po t'i hedhim një sy shpalljes së vdekjes së Salipurit (shih fotografinë nr. 6), një kopje e së cilës u sigurua nga Human Rights Watch, ai u vra nga UÇK-ja më 8 prill 1999:

FOTO 4: *Në këtë foto shihet një burrë i identifikuar si Zvonimir Cvetkoviç (i pari djathtas) me një grup burrash të tjerë të panjohur të kompanisë së kamionave Petrans në Pejë të Kosovës ku punonte Svetkoviç. Ai është parë me uniformën e forcave të sigurimit serb më 14 maj në Qyshk ku u ekzekutuan dyzet e një burra shqiptarë. Identiteti i burrave të tjerë është i panjohur dhe nuk dihet që ata të jenë implikuar në veprimtari ushtarake. Data e fotografisë është gjithashtu e panjohur.*

© HUMAN RIGHTS WATCH

Me pikëllim të thellë njoftojmë familjen dhe miqtë se i dashuri ynë
Salipur Vidomir – "Ndriçimi"
(1970 – 1999)
dha jetën në mënyrë heroike, më 8 prill 1999, në të 29 vit të jetës së tij, duke mbrojtur Tokën e Shenjtë Serbe në duart e terroristëve shqiptarë.
Varrimi do të zhvillohet nesër, më 11 prill (Pashkët), në varrezat Dobriloviq, në orën 13.00.
Procesioni niset nga shtëpia …

PËRSHËNDETJA E FUNDIT NGA KOLEGËT DHE OFICERËT E NJËSIVE "OPG" DHE "PJP" – DEPARTAMENTI I POLICISË SË PEJËS



FOTO 5: *Kjo fletë e pasaportës së Svonimir Cvetkoviçit u gjend nga një gazetar amerikan në mes të muajit korrik 1999 në një nga zyrat e braktisura të shoqërisë së kamionëve në Pejë të Kosovës.*

© HUMAN RIGHTS WATCH

"PJP" i referohet forcave speciale të policisë në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Posebna Jedinica Policije ose Njësia Speciale e Policisë). OGP ka të bëjë me Operativna Grupa, pra me Grupin Operativ, megjithëse nuk është e qartë se në ç'mënyrë ky grup ishte i përfshirë në strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Fakti që Salipuri, një polic serb, ishte anëtar i një njësie të milicisë bashkë me civilë serbë, ka të ngjarë në grupin Munja, të jep të kuptosh se Ministria e Brendshme ishte në dijeni të veprimtarisë së milicisë lokale dhe mund t'i ketë organizuar e bashkërenduar ato më 7 qershor 1999. Presidenti Millosheviç do ta dekoronte Salipurin pas vdekjes, tok me 911 punonjës të tjerë të Ministrisë së Brendshme, me Urdhërin e Shkallës së Parë për Merita të veçanta në Çështjet e Mbrojtjes dhe Sigurisë, "për luftën kundër terrorizmit" në Kosovë.[65]

Human Rights Watch do të arrinte të siguronte dy fotografi të Salipurit, tok me një grup burrash me uniformë e të armatosur (fotografitë nr. 7 dhe nr. 8). Në fotografinë nr. 8, shihet Salipuri i ulur në gjunjë, në radhën e parë, majtas, duke mbajtur një flamur shqiptar. Identiteti i personave të tjerë është i panjohur.

FOTO 6: *Njoftim i vdekjes së Vidomir Salipurit.* © HUMAN RIGHTS WATCH

Në fotografinë nr. 7, ndodhet më këmbë, në mesin e radhës së dytë e mban në krye kapele, para asaj që që duket si një flamur që shenjon kufirin shqiptaro-jugosllav. Në të majtë të tij, ndodhet personi i identifikuar si Nebojsha Miniç, nga dy dëshmitarë, të intervistuar veç e veç, i cili ka qenë i implikuar drejt për drejt si prijësi i një bande që do të plaçkiste e më pas vriste gjashtë anëtarë të një familjeje, nga mosha pesë deri më njëzet e tetë vjeç, në Pejë, më 12 qershor (shih më sipër, kapitulli Një vrasje finale). Dy njerëz që thanë se kishin pasur kontakte të drejtpërdrejta me Miniçin, i thanë Human Rights Watch, se ai e ka trupin të mbushur tatuazhe që paraqesin një thikë, një sëpatë dhe një granatë në parakrah, ndërsa në gjoks ka të vizatuar një të vdekur. Gjithashtu në fotografinë nr. 7, njeriu i skajuar në të majtë, në radhën e parë, do të identifikohej në mënyrë të pavarur nga dy vetë, si dhe nga disa burime të UÇK-së, me emrin "Milan", i njohur si mik i Salipurit, ndonëse kundër tij nuk do bëheshin akuza specifike. Identiteti i personave të tjerë në fotografi është i panjohur.

FOTO 7: *Vidomir Salipuri me kapele në kokë në qendër të rreshtit të sipërm. I pandehur si kreu i milicisë lokale të Pejës i quajtur "Munja" ose "Ndriçimi", Salipuri kishte namin e njeriut me sjellje të vrazhdë kundrejt shqiptarëve etnikë. Në të majtë të tij gjendet Nebojsha Miniç. Koha dhe vendndodhja e fotografisë janë të panjohura, ashtu siç janë të panjohura për ne edhe identitetet e personave të tjerë.*

© HUMAN RIGHTS WATCH

Gjithashtu ekzistojnë disa dëshmi për përfshirjen e Ushtrisë Jugosllave (VJ) në sulmet e kryera mbi fshatrat Qyshkë, Pavlan dhe Zahaq. Autoritete lokale të UÇK-së në Pejë, i thanë Human Rights Watch në korrik, se kishin shtënë në dorë një bllok shënimesh, që sipas tyre i përkiste një oficeri të VJ. Shënimet në bllok, thanë ata, bënin fjalë për një rrethim nga ana e ushtrisë së zonës së Qyshkës, para se të ndodhnin vrasjet e 14 majit.

Menjëherë paskësaj, Natasha Kandiç, nga Qendra Ligjore Humanitare me seli në Beograd, publikoi një raport ku përmendej blloku i shënimeve të togerit të VJ, që asaj ia kishin tregur autoritet lokale të UÇK-së në Pejë.[66] Kandiç shkruante se blloku:

> (Rr)egjistr(onte) veprimtaritë ushtarake në komunën e Pejës pas 24 marsit. Në një shënimk të datës 11 maj thuhej se, fokusi i veprimtarive ushtarake duhej të zhvendosej në Qyshkë dhe rrethinat e saj.

FOTO 8: *Vidomir Salipuri majtas në gjunjë në rreshtin e parë. Koha dhe vendndodhja e fotografisë janë të panjohura, ashtu siç janë të panjohura për ne edhe identitetet e personave të tjerë.*

© HUMAN RIGHTS WATCH

Gjithashtu, shtabi lokal i UÇK-së në Pejë, kishte një dokument me shënimin konfidencial që mbante firmën e kolonelit të ngarkuar me drejtimin e brigadës së 125-të.[67]

Një artikull i mëpasëm i botuar në shtypin Perëndimor do të pohonte Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve të Luftës kishte gjetur një dokument të Ushtrisë Jugosllave që urdhëronte "spastrimin" e Qyshkës. Një gazetar i USA Today do të raportonte se, kish shqyrtuar një bllok shënimesh me mbështjellëse plastike të zezë, të mbërthyer me tri unaza, i cili përmbante një urdhër të drejt për drejtë të shtypur në një shkresë të ushtrisë dhe që përmbante vulën e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave në Beograd. Në këtë urdhër thuhej, "Objektivi i aksioneve ushtarake duhet të jetë spastrimi i Qyshkës dhe i fshatrave e i terrenit përrreth."[68] Në artikull thuhej se, hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës e kishin gjetur bllokun e shënimeve më datë 2 korrik, pranë selisë së braktisur të një shtabi ushtarak në Kosovë.

LUBENIQ

Për shkak të afërsisë me vijën kufitare të Shqipërisë dhe një veprimtarie të dendur të UÇK-së në këtë rajon, fshati i Lubeniqit, në jug të Pejës, do të ishte vazhdimisht në fokus të vëmendjes dhe aksioneve të policisë përgjatë viteve 1998 dhe 1999. Sipas OSBE-së, Lubeniqi ishte në të njëjtën kohë edhe vendbanimi i njërit prej komandantëve lokalë të UÇK-së.[69]

Sipas fshatarëve të Lubeniqit, në periudhën midis 24 marsit dhe 10 qershorit 1999, më shumë se tetëdhjetë fshatarë do të vriteshin nga forcat serbe në një numër incidentesh të ndryshme. Më 10 korrik, kontigjenti italian i KFOR-it, njoftoi për praninë e një varri masiv të mundshëm që përmbante 350 kufoma, por më pas ky njoftim rezultoi i pavërtetë. Deri më sot, hetues të gjykatës kanë zbuluar vetëm nëntë trupa në tre vendvarrime të ndryshme rreth e qark fshatit, ndërkohë që Human Rights Watch ka marrë raporte që flasin për mbi tetëdhjetë vrasje tip ekzekutimi në rajon gjatë gjithë këtij harku kohor.[70]

Incidenti i parë i njohur në Lubeniq ndodhi më 25 maj 1998, kur dy policë serbë ranë në një pritë të UÇK-së dhe u plagosën, në rrugën Pejë-Gjakovë,

fare pranë fshatit.[71] Paskëtaj forcat e policisë, para se të hynin në Lubeniq e granatuan dhe kur hynë në fshat ndanë burrat nga gratë, duke ekzekutuar nëntë burra.[72] Më 29 maj i gjithë fshati mori arratinë, kryesisht në Shqipëri, për shkak të ofensivës së pranverës të ndërmarrë nga trupat qeveritare.

Atë ditë u vranë afro gjashtëdhjetë e tre persona, edhe pse shifrat lëvizin.

Sipas OSBE-së, në janar të vitit 1999, në Lubeniq jetonin 650 shqiptarë dhe 120 serbë.[73] Gjatë fushatës së NATO-s, incidenti më i rëndë do të ndodhte më 1 prill. Sipas një numri të konsiderueshëm dëshmitarësh, atë ditë u vranë afro gjashtë e dhjetë e tre persona, edhe pse shifrat lëvizin. Të paktën njëzet e pesë vetë, prej të cilëve nëntë vetëm nga Lubeniqi, u vranë një javë më pas, në malet në perëndim të vendit.

Sipas njërit prej pleqve të fshatit, që foli me Human Rights Watch, më 1 prill u vranë gjashtëdhjetë e tre burra, ndonëse dëshmitarët dhe të mbijetuarit që folën me gazetarët, mëtonin se numri i të vdekurve ishte afro tetëdhjetë.[74] Tetë dëshmitarë okularë folën me një numër të ndryshëm gazetarësh të huaj, të cilët, më pas do të shkruanin në shtypin anglofon. Artikujt e tyre janë jashtëzakonisht konsekuent. Gjashtë nga këta dëshmitarë i panë vrasjet me sytë e tyre, një tjetër dëgjoi të shtënat teksa po largohej tok me një grua dhe fëmijët dhe i teti pa trupat serbe duke zhvendosur trupat.

Të gjithë dëshmitarët, pa përjashtim, thanë se forcat serbe arritën në fshat më 1 prill, rreth orës 7 të mëngjesit. Një dëshmitar pohoi se, një person i panjohur nga Peja i kishte paralajmëruar një natë më parë, se trupat paraushtarake kishin planifikuar të hynin në fshat.[75] Në kohën kur serbët mbërritën, një pjesë e fshatarëve u larguan në drejtim të maleve aty pranë, ndërsa ata që mbetën në fshat u urdhëruan të mblidheshin në një vend. Më pas, burrat u ndanë nga gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Këta të fundit u urdhëruan ta linin fshatin më këmbë. Paskëtaj burrat u morën në pyetje për armë dhe dy prej tyre u qëlluan në sytë e gjithë grupit. Menjëherë pas kësaj, forcat e sigurimit – njëri nga dëshmitarët tha, tre prej tyre – hapën zjarr mbi grupin. Nëntë nga fshatarët mbijetuan.

Njëra nga gratë që u përzu nga fshati më këmbë, i tha *London Times*:

> Ata iu thanë grave dhe fëmijëve të shkonin në Shqipëri, sepse siç thanë ata, ne gjithmonë e kishim dëshiruar këtë gjë … Na u desh t'i

linim burrat pas dhe kur dolëm në rrugën kryesore, dëgjuam të shtënat. Atëherë e kuptova që diçka e tmerrshme kish ngjarë. Më vonë, kur mbërritëm në Shqipëri, mësova që im atë kishte vdekur.[76]

Një nga të mbijetuarit i tha Chicago Sun Times, "Ata ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët e iu thanë të shkonin në Shqipëri. Paskëtaj ekzekutuan dy burra nga fshati në sytë tanë dhe nuk kaloi shumë e nisën të qëllojnë mbi ne, duke përdorur gjithë arsenalin e armëve."[77] Një dëshmitar mëtonte të kish parë "trupa të parregullta" që morën kufomat me traktorë.[78]

Sipas dëshmive të siguruara nga gazetarët, nëntë të mbijetuarit, një pjesë e të cilëve ishin të lënduar, u hoqën zvarrë deri në një pyll aty pranë dhe prej andej u ngjitën në mal. Një djalë gjashtëmbëdhjetë vjeçar, vdiq nga plagët. Pjesa tjetër ia doli të kalonte në Shqipëri.

Disa prej atyre që i shpëtuan ekzekutimit do të sulmoheshin një javë më pas në mal. Sipas plakut të fshatit që foli me Human Rights Watch, nga fshati Lubeniq u vranë nëntë burra gjatë sulmit në mal, si dhe katërmbëdhjetë vetë nga fshati Buqan, tre nga Kruseci dhe një nga Prilepi. Pjesa më e madhe e trupave nuk janë gjetur edhe sot e kësaj dite, tha plaku. Numri i madh i minave që ndodhet në atë zonë, i ka parandaluar fshatarët dhe hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës, të bëjnë kërkime për të përcaktuar numrin përfundimtar të viktimave.

Një nga të mbijetuarit që ishte në mal, i tha një gazetari të *Associated Press*, "Ne u sulmuam nga të gjitha anët ... Ata rrokullisën njerëz nga shkëmbinjtë e thepisur poshtë në përrenj."[79] Një tjetër i mbijetuar i tha *Irish Times*, "U ngjitëm në mal, zbritëm nga mali dhe humbëm gjithë-gjithë nëntë njerëz. Katër prej të cilëve ishin gra dhe dy fëmijë. Kudo që shkonim na qëllonin."[80]

E gjithë zona rreth e qark Lubeniqës kish pasur një veprimtari të dendur të UÇK-së përgjatë tetëmbëdhjetë muajve që iu paraprinë vrasjeve të 1 prillit, gjë që mund të ketë qenë njëri nga motivet e këtyre ekzekutimeve. Veç kësaj, katër dëshmitarë të ndryshëm iu kishin thënë gazetarëve se, njëri nga serbët e armatosur që kish hapur zjarr kish pasë thënë se UÇK-ja i kishte vrarë vëllanë.[81] Njëri nga këta të katër pohonte se, sipas serbit, para disa muajsh, njerëz të UÇK-së ia kishte zbritur të vëllanë nga treni dhe më pas e kishin vrarë. Një tjetër dëshmitar tha se, serbi dukej më i riu në moshë në atë grup.

Raporti i OSBE-së mbi Kosovën, gjithashtu përmend një person të ketë

thënë se, vëllai i tij ishte vrarë nga UÇK-ja. Raporti citon një nga të mbijetuarit, të cilit i kishte zënë veshi njërin nga serbët të kish thënë "UÇK-ja juaj vrau tim vëlla! Tani unë do të bëj atë që ata bënë me tim vëlla, dakord?" Sipas të dhënave, një plak u përpoq të hynte në bisedime me forcat serbe dhe iu kujtoi atyre çfarë kish ngjarë në maj të vitit 1998, kur policia kishte vrarë nëntë burra nga fshati. Atëherë serbët e armatosur i qenë përgjigjur: "Policia? Epo, ne nuk jemi të policisë, o plak, ne jemi të ushtrisë!" dhe më pas ata kishin shtënë mbi plakun.[82] Një dëshmitar që foli me Providence Journal, bëri një përshkrim të ngjashëm të ngjarjes, ndonëse nuk jemi në gjendje të themi nëse ky është i njëjti person që foli edhe me OSBE-në. Sipas këtij dëshmitari, serbët e armatosur ia prenë fjalën shqiptarit të moshuar, që po mundohej të negocionte me ta dhe thanë, "Eja këtu, ti mor këlysh kurve, plak … Ne nuk jemi të policisë. Ne jemi ushtarë të ushtrisë së Serbisë."[83]

Raporti i OSBE-së e çon në gjashtëdhjetë e gjashtë numrin e të vrarëve më 1 prill, duke përfshirë këtu edhe faktet e gjetura nga OSBE-ja gjatë një vizite në Lubeniq, më 1 korrik 1999. Raporti thotë se, pranë vendit ku ishte kryer vrasja, ekipi i OSBE-së kishte vërejtur tesha të hapërdara, si dhe gëzhoja fishekësh në vendin prej ku thuhej se trupat serbe kishin shtënë. Në një shtëpi aty pranë, u këqyrën pesë vendngjarje, ku ishin djegur kufomat.[84]

11

KOMUNA E PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit e vendosur në një kënd, në jugperëndim të Kosovës, ka pasur një popullsi relativisht etnikisht të përzjerë. Sipas OSBE-së, 78 përqind e popullsisë ishin shqiptarë etnikë, 5 përqind serbë dhe 17 përqind iu përkisnin bashkësive të tjera etnike, si turq dhe rromë. [1] Përgjatë gjithë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, kjo komunë do të ishte më pak e prekur nga pasojat e luftës sesa Gjakova dhe Deçani në veriperëndim. E megjithatë, fshatrat në pjesën verilindore të komunës, në drejtim të Suharekës dhe Rrahovecit, konsideroheshin pika të nxehta për shkak të pranisë së vazhdueshme të UÇK-së.

Komuna e Prizrenit do të ishte skena e krimeve të shumta të kryera gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s, duke përfshirë këtu edhe vetë qytetin e Prizrenit dhe sidomos lagjen Tusus. Të gjithë fshatrat në veri të qytetit në kufi me komunën e Rrahovecit, si Piranë, Krushë e Vogël, Mamushë, Zojiq dhe Randobravë do të goditeshin jashtëzakonisht rëndë për shkak të veprimtarisë së UÇK-së në atë krahinë dhe shfrytëzimin e disa fshatrave si rrugë tranzite nga rebelët. Fshatrat Piranë dhe Krushë e Vogël që shtrihen në veri, përgjatë rrugës kryesore që shpie në Celinë dhe Xërxe, do të trajtohen më vete në kreun mbi rrugën Prizren-Gjakovë.

Armata e Tretë e Ushtrisë Jugosllave, përgjegjëse për Kosovën, kishte një kazermë në Prizren dhe një numër dëshmitarësh mëtonin se ushtria ishte treguar tejet aktive në këtë komunë, duke bashkërenduar aksionet me policinë. Me qendër në Prizren ishte dhe Brigada e 549 e Motorizuar, e komanduar nga koloneli Bozhidar Deliç (shih Forcat e angazhuara në konflikt). Prizreni ishte gjithashtu edhe një nga shtatë bazat rajonale të policisë serbe në Kosovë, e njohur si Sekretarijat Unutrasnjih Poslova



Michael S. Miller/ Human Rights Watch, 2002

(Sekretariati për Punët e Brendshme) ose SUP. SUP-i i Prizrenit mbulonte komunat e Prizrenit, Rrahovecit, Suharekës dhe Gorës. Komandanti i SUP-it për Prizrenin përgjatë gjithë vitit 1998 ishte koloneli Gradimir Zekavica, ndërsa nënkoloneli Millan Gjuriçiç ishte kryetari i seksionit të SUP-it të departamentit të policisë së Prizrenit. [2] Në janar të vitit 1999 do të emërohej një kryetar i ri i Sup-it, koloneli Millosh Vojnoviç, i cili ishte në të njëjtën kohë edhe zëvendës shef i departamentit të policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. [3] Por, duke u bazuar në medaljet e dhëna oficerëve të MUP-it pas luftës, rezulton se koloneli Zekavica kishte qenë komandant edhe gjatë luftës (shih Forcat e angazhuara në konflikt).

QYTETI I PRIZRENIT

Njohur historikisht si një avant-poste i Osmanëve, me një sërë kishash ortodokse serbe të shekullit të katërmbëdhjetë, si dhe një numër xhamish disa shekullore, qyteti i Prizrenit, i vendosur në jug-perëndim të Kosovës, do t'i shpëtonte në një shkallë të madhe shkatërrimeve fizike që pësuan kaq e kaq qytete të tjera në Kosovë. Etnikisht e larmishme, para luftës popullsia e qytetit përbëhej përafërsisht në dy të tretat e saj nga shqiptarë etnikë, por edhe nga një numër i konsiderueshëm serbësh etnikë, rromësh, turqish, vllehësh dhe sllavësh të myslimanizuar. Prizreni nuk njihej si një qendër e rëndësishme e veprimtarisë së UÇK-së dhe, krahasuar me qytete të tjerë të Kosovës, para luftës, marrëdhëniet, si të shqiptarëve ashtu edhe të serbëve, me grupet e ndryshme e ndryshme etnike ishin relativisht paqësore.

Me fillimin e fushatës së bombardimeve të NATO-s, OSBE raportonte se, ushtria dhe policia serbe granatoi disa zona të qytetit dhe rrënoi vendndodhjen historike të "Lidhjes së Prizrenit", një monument i rëndësishëm historik për shqiptarët etnikë të Kosovës. [4] Gjithsesi, me përjashtim të lagjes Tusus, "spastrimi etnik" i Prizrenit u krye në mënyrë më pak të dhunshme me sulmë disi më të përmbajtura, krahasuar me atë që ndodhi në pjesë të tjera të Kosovës. Kësodore, Jamie Shea, zëdhënësi i NATO-s në kohën e sulmeve ajrore, do ta ekzagjeronte, në mos ishte jo mirë i informuar, kur do të deklaronte më 17 maj 1999 se,

Prizreni ishte qyteti që "sipas të gjitha gjasave, kishte vuajtur më shumë muajt e fundit në gjithë Kosovën." [5] Është e vërtetë që forcat serbe spastruan në mënyrë sistematike një pjesë të zonave të qytetit, por shumë shqiptarë etnikë qëndruan në qytet gjatë gjithë kohës së konfliktit. Për shkak të rrezikut të sigurt që iu kanosej jashtë, njerëzit qëndruan të mbyllur nëpër shtëpitë e tyre për javë e muaj me radhë, pa dalë për asnjë çast.

Në prill 1999, të paktën në dy raste, policia dhe ushtria serbe, rrethuan me qindra burra në Prizren dhe i shtrënguan të kryenin punë të detyruar në brigadat xhenjo, në hapjen e llogoreve, pranë kufirit me Shqipërinë. Human Rights Watch intervistoi dy burra që ishin marrë nga shtëpitë më 24 prill, për të shërbyer në brigadat e punës. [6] Fillimisht ata i kishin grumbulluar në qendrën sportive të Prizrenit, pranë kazermave të ushtrisë dhe aty iu kishin dhënë për të veshur uniforma të vjetra të ushtrisë. Paskëtaj i kishin dërguar në komunën e Dragashit, në jug të Prizrenit, ku kishin hapur llogore për një muaj me radhë. Banorë të tjerë të Prizrenit që e kishin braktisur qytetin në mes të prillit, thanë se ishin larguar pikërisht për të shpëtuar nga grumbullime të tilla. Një burrë do të dëshmonte se, ai ishte mbajtur në qendrën sportive për pesë orë, tok me 200-300 njerëz të tjerë, por më pas ishte liruar, kur një doktor kish vërtetuar që ishte i paaftë. [7]

Lagja Tusus

Sulmi i datës 26 maj mbi lagjen Tusus të Prizrenit, gjatë të cilit serbe vranë nga njëzet e shtatë deri tridhjetë e katër njerëz dhe dogjën mbi njëqind shtëpi, përbën episodin më të dhunshëm në qytetin e Prizrenit gjatë kohës së konfliktit. Në gjysmën e parë të muajit qershor, Human Rights Watch intervistoi tre refugjatë në Shqipëri, si dëshmitarë okularë të asaj çka ndodhi në Tusus. [8] Paskëtaj, një hulumtues i Human Rights Watch, vizitoi lagjen e Tususit më 14 qershor, menjëherë pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, duke fotografuar shkatërrimet e bëra dhe intervistuar dëshmitarë të tjerë. Gjithë-gjithë, Human Rights Watch dëgjoi dëshmitë e katërmbëdhjetë banorëve të Tususit.

Dhuna në Tusus do të merrte zjarr pas vrasjes e të paktën dy oficerëve serbë të policisë.

Dhuna në Tusus do të merrte zjarr pas vrasjes e të paktën dy oficerëve serbë të policisë në rrugën Ramiz Sadiku, bulevardi kryesor që e përshkon mes për mes gjithë zonën. Një numër dëshmitarësh i thanë Human Rights se, ata kishin dëgjuar rreth vrasjeve, ndërkohë që një dëshmitar tjetër, L. V., deklaroi se ai i kish parë kufomat, mëngjesin e datës 26 maj. "Njëri (nga policët) ishte shtrirë në shpinë," shpjegoi L.V. "Ndërsa tjetri kishte rënë përmbys, me shpinën shoshë nga plumbat; kurrizi i tij ishte i llangosur me gjak." [9] Kosovapress, organ shtypi i UÇK-së, do të raportonte humbje të rënda në radhët e serbëve, duke pohuar se njëzet e një policë dhe paraushtarakë serbë ishin vrarë në Tusus nga një njësi komando e UÇK-së, një natë para sulmit. [10] Website i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë jep emrat dhe fotografitë e dy policëve të vrarë në Tusus më 26 maj: Millosav Rajkoviç (i lindur në vitin 1975), dhe Zllatomir Stankoviç (i lindur më 1957).[11]

Më 26 maj, rreth orës 7.30 të mëngjesit, forcat serbe kishin ndërmarrë bastisje të dhunshme nëpër gjithë lagjen. F. K., tridhjetë e tre vjeç, banor i Tususit, i tha Human Rights Watch se ai dhe gjashtëmbëdhjetë anëtarët e familjes së tij "kishin zënë vend në qilarin e shtëpisë dhe dëgjuan të shtëna të shumta." Zjarri i armëve, tha ai, "ishte i paprerë, fare afër, ndoshta rreth pesëdhjetë metra larg nga shtëpia ime. Pas gjysmë ore të shtënash të vazhdueshme, ata nisën të djegin dhe shembin shtëpitë në lagjen tonë. Rrënuan gjithçka."[12] Ai tha se zjarri vazhdoi deri në pragmbrëmje, kur ai dhe familja e tij do të largoheshin duke kaptuar murin e oborrit të shtëpisë dhe ecur mes për mes trarëve të djegur, për të mbërritur në rrugën qo do t'i nxirrte nga lagja.

Pjesëtarë të familjeve të tjera do të përshkruanin se si forcat serbe kishin hyrë në shtëpitë e tyre, herë për të vrarë, herë për të bërë kontroll. L. V. një djalë gjashtëmbëdhjetë vjeç, i tha Human Rights Watch:

> Më shumë se pesëmbëdhjetë serbë erdhën në shtëpi. Ata na pyetën, "A ka UÇK këtu?" Kontrolluan në gjithë shtëpinë dhe ndenjën brenda për afro pesë minuta. Ishin trupa speciale të policisë dhe në krah mbanin shenjën e kuqe të flamurit serb. Mua më nxorën nga shtëpia dhe më thanë, "Do të vrasim. Shih për herë të fundit njerëzit e shtëpisë se ne do të vrasim."[13]

Kur L. V.-në e nxorën nga shtëpia, një burrë, i cili sipas tij ishte komandanti

i serbëve, iu tha të tjerëve ta lironin. E ëma e L. V.-së ishte gjithashtu keqtrajtuar; ajo tha se, ato çaste kish menduar se forcat e sigurimit kishin për të marrë me vete, por vetëm ulërima e vjehrrës e kishte shpëtuar. [14] Shtëpinë e tyre do ta vizitonin më shumë se një herë, grupe nga të forcave të sigurimit serb, ngaqë ajo ndodhet mu në qendër të rrugës "Ramiz Sadiku."

Aty ku përfundon rruga "Ramiz Sadiku" ndodhet shtëpia e familjes Abdulmexhidi. J. A. nëntëmbëdhjetë vjeçare, do ta përshrkuante kështu atë çka kish përjetuar familja e saj:

> Policët ia behën në shtëpinë tonë aty nga mesdita dhe i urdhëruan burrat të rreshtoheshin me fytyrë nga muri. Ishin gjashtë serbë me uniforma kamuflazhi në ngjyrë të gjelbërt; fjalën policë e kishin të shkruar në gjoks. Në atë orë të ditës ne ishim mbledhur të gjithë në shtëpi. Ata hynë dhe urdhëruan që të gjithë të dilnin nga shtëpia, me përjashtim të tim eti dhe xhaxhait. [15]

F.A. e ëma, vijoi më tej:

Shtëpi e djegur në Tusus, lagje e Prizrenit. Më 26 maj 1999 forcat policore serbe vërshuan në lagje duke vrarë një numër civilësh që shkon nga njëzet e shtatë deri në tridhjetë e katër vetë si dhe duke djegur një numër të madh shtëpish.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

> Ata na thirrën neve grave nga brenda shtëpisë dhe na kërkuam t'iu jepnim paratë. Thanë se do të vrisnin burrat tanë. Dhe i vunë tim i shoqi grykën e një kallashnikovi në kokë. Unë u dhashë 2000 marka gjermane, ndërsa burrat u dhanë 1500 marka. Paskëtaj të gjithë dolën jashtë. Ata na urdhëruan të largoheshim dhe ndërkohë mbajtën burrat … Tek po largoheshim, pamë se si zunë t'i rrihnin burrat. I shkelmonin në stomak e në shpinë dhe i godisnin me qytat e armëve.[16]

Gjashtë burra, duke përfshirë këtu bashkëshorin e F.A.-së, kunatin dhe të dy djemtë, njëri shtatëmbëdhjetë e tjetri njëzet e një, u mbajtën me dhunë. E bija e F. A.-së përshkroi atë çka ngjau më pas. Ajo na shpjegoi: "Burrat ishin vënë pas murit me duart lart. Kur dolëm në rrugë, dëgjuam të shtënat, breshëritë e kallashnikovit."

F. A. u kthye në shtëpi një ditë më pas dhe e gjeti atë të djegur e të shkrumbosur, ndërsa tavani ishte shembur. Qeni i vogël i shtëpisë ishte goditur për vdekje. Ajo vuri re pllanga gjaku kudo nëpër shtëpi, por nuk gjeti gjurmë të të afërmve. "Dikush më tha se burrat i kishin kyçur në burg, nuk ishin vrarë, por unë e dija që ata kishin vdekur," i tha ajo Human Rights Watch. Pas dy ditësh, ajo i gjeti trupat e tyre në morg.

Banorët e lagjes që ndenjën nëpër shtëpitë e tyre gjatë gjithë kohës që zgjati sulmi, thanë se forcat e sigurimit u larguan nga pasditja, pa rënë muzgu. Rreth orës 4, ndërkohë që trupat serbe ishin larguar, mbërriti nja kamion për të mbledhur trupat e të vdekurve. Grupi i njerëzve të kamionit u tha se përbëhej nga një shofer shqiptar, katër punonjës civilë serbë dhe katër rromë, që ishin marrë si hamenj për të ngarkuar kufomat. "Kamioni ishte plot e përplot me kufoma," tha një dëshmitar. "Ai ishte i hapur nga mbrapa, kështu që shiheshin kollaj. Rromët shkonin shtëpi më shtëpi për të kërkuar kufomat. Ata i merrnin dhe i hidhnin në kamion sikur të ishin thasë."[17] Sipas një dëshmitareje tjetër, që tha se kish parë një numër të madh kufomash të mbështjella me çarçafë të bardhë, në pjesën e mbrapme të kamionit, njëri nga punonjësit civilë mbante në dorë një kamera dhe me të xhironte të vrarët.[18]

Human Rights Watch intervistoi dy njerëz që kishin marrë trupat nga morgu i atij vendi në ditët e mëpasme. M. B. gjashtëdhjetë e pesë vjeç tha se, ai dhe capak miq të tij kishin marrë nga morgu atë ditë të premte nja dy dyzina trupash, duke përfshirë këtu edhe një grua tridhjetë e katër vjeçare të djegur krejt; ajo kishte pasë banuar në të njëjtën rrugë me të.

Ai kujtonte: "Doktori i morgut na tha se duhej të vendosnim: ose t'i merrnim e t'i varrosnim, përndryshe ata do t'i fusnin të gjithë në një varr të përbashkët. Unë mbarta një pjesë të trupave me karrocë."[19] Një tjetër gjashtëdhjetë e pesë vjeçar, F. D., kish shkuar disa ditë me radhë në morg, duke marrë për çdo herë nga dy a tre kufoma. Ai kish marrë pjesë edhe në funeralin e një pjese të të vdekurve, një ditë të dielë, në varrezat pranë xhamisë së vendit.

Me sa duket pjesëmarrësit në sulmin e kryer kanë qenë një përzjerje e forcave speciale të policisë dhe paraushtarakëve.

Me sa duket pjesëmarrësit në sulmin e kryer kanë qenë një përzjerje e forcave speciale të policisë dhe paraushtarakëve. Një grua tha se, ata kishin veshur uniforma kamuflazhi të gjelbra; një pjesë e tyre mbanin maska, ndërsa të tjerët kishin lidhur shami në krye. Një njëmbëdhjetë vjeçar kujton se ata mbanin "kama të mëdhaja" dhe "tymosnin puro."[20] Një tjetër dëshmitar u shpreh për praninë e "grekëve dhe rusëve që s'flisnin as edhe një fjalë serbisht."[21]

Vlerësimet për numrin e përgjithshëm të të vrarëve luahten nga njëzet e shtatë në tridhjetë e katër vetë. Dy dëshmitarë thanë se, çdonjëri prej tyre personalisht kishte parë më shumë se njëzet e pesë kufoma.[22] Kur Human Rights Watch vizitoi Tususin, më 14 qershor 1999, rreth tri javë pas vrasjeve, banorët mëtonin se ishin vrarë tridhjetë e katër njerëz dhe renditën emrat e njëzet e gjashtë prej tyre. E gjithë zona ishte rrënuar fizikisht: rrugë të tëra ishin shkrumbosur dhe ku pothuajse çdo shtëpi ishte shndërruar në një grumbull qymyri. Përafërsisht, njëqind shtëpi ishin dëmtuar keqazi.

Lagja Bilbildere

Një tjetër lagje e Prizrenit, ku sipas raportimeve ishin kryer krime, ishte Bilbildere. Mëngjesin e datës 16 maj 1999, u fol se dy shqiptarë etnikë ishin ekzekutuar pa kurrfarë gjykimi nga paraushtarakët. Human Rights Watch intervistoi tre të afërm të burrave të vrarë, të gjithë anëtarë të së njëjtës familje.

Dëshmitarët thanë se, aty nga fundprilli, pothuaj të gjithë banorët e lagjes u larguan për në Shqipëri, ndërkohë që aty mbeti familja e tyre dhe gjashtë familje të tjera. Tri javë kaluan pa kurrfarë incidenti, derisa një të dielë, më 16 maj, ia behu një grup policësh serbë, që zunë të kontrollin

në shtëpi për armë. Jo shumë kohë pasi ishin larguar policët, mbërriti një grup i madh paraushtarakësh. E. M., një grua njëzet e gjashtë vjeçare, i kallzoi Human Rights Watch rreth asaj çka kish ngjarë:

> Njerëzit e Arkanit, afro njëqind vetë, erdhën rreth orës 9 të mëngjesit. Në krye mbanin shami ngjyrë qielli dhe kishin veshur jelekë specialë që i mbanin të pakopsitur; kësisoj mund të shihje gjokset e tyre. Në qafë mbanin gjerdanë me kryqe dhe emblema të tjera. Pjesa më e madhe kishin rruar kokat; disa mbanin mjekra. Midis tyre ishte dhe një rus me mjekër; ai s'fliste as edhe një fjalë serbisht … Fytyrën dhe pjesën e nën syve e kishin lyer me bojë. Kishin veshur uniforma kamuflazhi në ngjyrë të gjelbër, si të ushtrisë, teksa një grup i vogël i kishin ngjyrë blu të errët … Ata nuk erdhën në shtëpinë tonë, por ishin shpërndarë gjithandej nëpër lagje. Na kishte hyrë frika në palcë.[23]

E. M. tha se, paraushtarakët morën dy kunetërit e saj, Elez Muharremi dhe Enez Muharremi, si dhe djalin e Enezit, Fatmir Muharremi. S'kish kaluar shumë nga koha kur ata i kishin marrë dhe anëtarët e familjes që kishin mbetur në shtëpi, dëgjuan breshëritë e armëve automatike. A. M. e ëma e dy vëllezërve vijoi të shpjegonte: "Dëgjova krismat e armëve. 'Kam frikë se i vranë' i thashë djalit tjetër … ishin breshëri të tëra zjarri nga një pushkë automatike." [24] Pasi paraushtarakët u larguan nga lagja, njerëzit e familjes i gjetën trupat e dy burrave në banjon e një shtëpie aty pranë.

Vëllai i mbijetuar i Enezit, i tha Human Rights Watch:

> *Dëgjova ulërimën e grave që kishin gjetur trupat, kështu që ia dhashë vrapit në drejtim të tyre. Një fqinj më tha, "mos hyr brenda, s'ke për të qenë në gjendje ta durosh dot atë pamje," ndaj dhe unë s'hyra. U nisa për në rajonin e policisë për të lajmëruar, por rrugës hasa tre prej tyre. Ata erdhën me mua te shtëpia ku gjendeshin trupat dhe ne hymë sëbashku në banjë. Aty pamë kufomat, ishin plandosur në dysheme. Kudo të zinte syri gjak. Enezin e kishin qëlluar dy herë, në gjoks dhe në krah; Fatmirin e kishin qëlluar në gjoks dhe në këmbë. Policët nuk i morën trupat për t'i çuar në morg.*[25]

Deri në qershor të vitit 1999, nuk do të kishte kurrfarë lajmi për fatin e kunatit tjetër, Elez Muharremi.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

12

RRUGA PRIZREN-GJAKOVË
Komunat e Rrahovecit dhe Prizrenit

Një nga rajonet më të para që do të goditej nga mësymja e trupave qeveritare serbe dhe jugosllave, pas bombardimeve të NATO-s, ishin një sërë fshatrash në një segment prej afro dhjetë kilometrash përgjatë rrugës Prizren-Gjakovë. Nga Bellaçerka dhe Xërxe në veri, për në Pirane në jug, forcat qeveritare, kryesisht njësi të ushtrisë, do të bombardonin sistematikisht zonën, para se trupat speciale në terren të hynin në fshatra. Ngandonjëherë edhe me ndihmën e serbëve lokalë nga ajo krahinë, burrat në moshë për pushkë do të ndaheshin nga gratë dhe fëmijët. Nga data 24 deri më 26 mars, trupat policore dhe ato paraushtarake ekzekutuan qindra burra, për të cilët nuk ka ndonjë njoftim se kanë pasur mbrojtjen e UÇK-së. Vrasjet e kryera në Bellaçerkë dhe në Krushën e Madhe janë renditur midis gjashtë incidenteve të listës së hartuar nga Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, në akt-akuzën e ngritur nga kjo gjykatë kundër Sllobodan Millosheviçit dhe katër zyrtarëve të tjerë të lartë qeveritarë.

Intensiteti i dhunës në këtë krahinë ka një sërë shkaqesh. Së pari, është mëse e qartë që qeveria dëshironte të spastronte rajonin kufitar me Shqipërinë, me fillimin e fushatës. Kontrolli i kufirit ishte i domosdoshëm për të minimizuar depërtimin e UÇK-së nga Shqipëria, të përgatitej për një invazion të mundshëm të trupave të NATO-s nga toka, si dhe të lehtësonte “spastrimin etnik” të shqiptarëve nga krahina të tjera të Kosovës. Me spastrimin e zonës kufitare, u bë i lehtë dëbimi i shqiptarëve nga Peja, Suhareka, rajoni i Drenicës dhe nga pjesë të tjera të provincës. Kontrolli i rrugës Prizren-Gjakovë për transportimin e trupave dhe pajisjeve ishte qartazi një përparësi strategjike për qeverinë.

Së dyti, shumë nga fshatrat e mësyrë, bie fjala si Krushë e Madhe, ishin të njohur më së miri për mbështetjen e vazhdueshme dhe praninë e UÇK-së përgjatë viteve 1998 dhe 1999. Pranë Retisë ndodhej një bazë e fortifikuar e UÇK-së. Ka fort të ngjarë që armatimet të hynin nëpër këto fshatra nga Shqipëria qysh nga viti 1998, ndaj dhe UÇK-ja shihej shpesh brenda dhe rreth e qark këtij rajoni, ngandonjëherë duke sulmuar edhe policinë në rrugën kryesore.

Por një nga motivet kryesore mund të ketë qenë edhe begatia në këtë rajon. Kjo pjesë jugperëndimore e Kosovës ka tokën më pjellore në të gjithë provincën dhe, nga ana tjetër, ajo është e njohur edhe për banorët e saj relativisht të pasur, gjë që mund të ketë ngashnjyer paraushtarakët të interesuar për plaçkitje dhe vjedhje.

Një incident i rëndë në rrugën në rrethinat e Gjakovës, i përshkruar hollësisht në kreun Fushata Ajrore e NATO-s, ishte bombardimi nga ana e NATO-s e një karvani civilësh. Më 14 prill, një avion i NATO-s bombardoi në mënyrë të përsëritur një karvan refugjatësh në një segment prej dymbëdhjetë miljesh të rrugës midis Gjakovës dhe Deçanit, duke plagosur tridhjetë e gjashtë vetë dhe vrarë shtatëdhjetë e tre civilë, në rrethinat e fshatrave Bistrazin, Gradish, Madanaj dhe Mejë. Fillimisht zëdhënësit e NATO-s dhe të Shteteve të Bashkuara mëtuan se objektivi ishte eksluzivisht një karvan ushtarak dhe se përgjegjës për sulmin mbi civilët mund të ishin trupat serbe. Më pas zyrtarët e NATO-s pranuan se një dyzinë aeroplanësh të NATO-s ishin përfshirë në një sërë sulmësh mbi dy karvane, duke hedhur mbi ta gjithsej nëntë bomba.

BELLAÇERKË

Për herë të parë forcat policore serbe hynë në Bellaçerkë, një fshat me rreth 3000 banorë, një javë para se të nisnin bombardimet e NATO-s. Sipas dëshmive të fshatarëve, ata dogjën disa shtëpi, shtinë mbi gjënë e gjallë dhe vodhën sende të ndryshme nëpër shtëpitë e banorëve. Sipas një fshatari, atëherë u vra edhe një njëzet e tetë vjeçar i quajtur Eqerem Zhuniqi.[1]

Ata çka dëshmitarët besonin se ishin anëtarë të forcave speciale të policisë dhe njësive paraushtarake, hynë sërish në fshat më 25 mars, rreth orës 3 të mëngjesit. Sipas dëshmive të banorëve, bëhej fjalë për një

përzjerje trupash të veshur me uniforma ushtarake ngjyrë blu dhe të gjelbër, një pjesë e tyre të maskuar, ndërsa një numër i madh syresh kishin të lidhur në krah nga një shirit të bardhë. Pa humbur kohë, ata nisën të vidhnin vetura dhe sende të çmuara si televizorë.

Të paktën gjashtëdhjetë burra, në moshë për armë, të trembur për jetën, u larguan sakaq në drejtim të kodrave aty pranë. Ndërsa pjesa tjetër qëndroi në fshat për të parë se ç'do të ngjante. Një grua, N. Z., i tha Human Rights Watch:

> Më 25 mars, një natë pasi kishin nisur bombardimet e NATO-s, unë isha duke fjetur. Rreth orës 3 të mëngjesit, im shoq më zgjoi dhe më tha, "duhet të largohemi, tanket kanë hyrë në fshat." Mora ca tesha, çka munda të gjeja dhe shkova te dera. Ndërkohë që i isha afruar derës, tanket nuk ishin më larg se dhjetë metra nga dera e shtëpisë sonë.[2]

N. Z. dhe njerëzit e familjes qëndruan në shtëpi për afro njëzet minuta, për të vendosur se çfarë do të bënin. Ç'është e vërteta, tanket u larguan nga qendra. Por rreth orës 4.30 të mëngjesit, N. Z. dhe njerëzit e familjes së saj, panë të dilte tym dhe flakë nga shtëpitë në skaj të fshatit. Banorë nga ajo pjesë e fshatit nisën të mblidhen në qendër, duke thënë se trupat qeveritare po iu vinin zjarrin shtëpive. Bash në këtë kohë, familja e N. Z.-së dhe afro 300 apo 400 fshatarë të tjerë, duke përfshirë këtu afërsisht pesëdhjetë burra në moshë për armë, thanë se kishte ardhur çasti për t'u larguar.

Peizazhi rreth e qark Bellaçerkës është relativisht i sheshtë, kështu që grupi i të ikurve u strehua në një golle të pyllëzuar të përroit të Ballajt, jo më larg se një milje nga fshati. Në kohën që ata u fshehën në përruar, uji arrinte deri në gju.

Në krye grupi kish ndërmend të merrte në drejtim të fshatit të Rogovës. Por, kur dëgjuan të vinin të shtëna nga ai drejtim, ndërruan mendje dhe vendosën të merrnin për nga Xërxe. Nga vendi ku ishin panë Bellaçerkën duke u djegur. Rreth orës 6 të mëngjesit, nisi të bëhej ditë, e megjithatë njerëzit e grupit vendosën të qëndronin në shtratin e përroit për shkak të të shtënave.

Diku aty nga ora 8 e mëngjesit, grupi bëri për nga ura e hekurudhës që kalonte mbi përrua. Dymbëdhjetë vetë nga familja e Çlirim Zhuniqit dhe ajo e Xhemal Spahiut ishin rreth pesëdhjetë metra përpara pjesës tjetër të grupit. Ata do të ishin të parët që hasën policët mbi urë.

N. Z. riprodhoi atë që kishte ngjarë:

> Nisëm të ecim në drejtim të Xërxes, pa e ditur se policia ndodhej mbrapa urës. Ne morëm për nga ura, që nuk ishte më shumë se njëzet metra larg. Familja e parë ishte ajo e një burri (Çlirimit), tok me gruan dhe tre fëmijët. Kur panë policët, ata u dorëzuan. Njerëz që ishin aty pranë nesh thanë se edhe ne do të ishte mirë të dorëzoheshim. U vumë në udhë dhe ndërkaq policët zunë të qëllonin mbi ne, por askush nuk u plagos. Gjithë sa ishim u shtrimë përtokë.[3]

Një tjetër grua që ndodhej në atë grup, i tha Human Rights Watch:

> Atje ndodhej një përrua me shkurre, që ishte një vend i mirë për t'u fshehur. Fshati u fsheh në atë vend. Uji i përroit na mbërrinte deri te gjuri. Serbët na gjetën – ndoshta ishin rreth njëzet serbë – nuk munda t'i numëroj ngaqë s'mund t'i shihja të gjithë sa ishin. Ata thanë në serbisht, "Gjithë sa jeni duart lart dhe dilni nga vendi ku jeni fshehur." Unë s'kuptova çfarë po thoshin, por disa nga burrat e njihnin serbishten dhe na shpjeguan edhe ne të tjerëve.[4]

Para se policët t'i afroheshin grupit të madh, njerëzit e familjes Zhuniqi dhe Spahiu u urdhëruan të dilnin nga shtrati i përroit në një lëndinë aty pranë. Një dëshmitar tha se, burrat i shtrënguan të zhvishen. Një tjetër dëshmitar tha se ai pa se si burra me "uniforma të gjelbra dhe shami koke të bardha" qëlluan mbi Çlirimin, të shoqen dhe tre fëmijët e tyre, si dhe mbi pjesëtarët e familjes së Xhemal Spahiut. Ai tha:

Ata i vranë të gjithë me pushkë automatike në një fushë jo më larg se 500 metra nga shtëpia.

> Ata i vranë të gjithë me pushkë automatike në një fushë jo më larg se 500 metra nga shtëpia. Unë munda të shihja (vrasjen) fare mirë. Gjithçka ndodhi vetëm 200-300 metra larg meje. Unë isha fshehur në përrua, pranë urës. Arrita të njoh njërin nga ata (që po qëllonin), i cili ishte nga Hoçë e Madhe.[5]

Sipas dëshmitarëve, një doktor shqiptar nga Bellaçerkë i quajtur Nesim Popaj, tridhjetë e gjashtë vjeç, u përpoq të negocionte me komandantin serb, duke iu lutur atij t'iu kursente jetën fshatarëve. Sipas këtyre dëshmive, Popaj iu shpjegoi se ata nuk ishin anëtarë të UÇK-së, por thjesht fshatarë që dëshironin të jetonin në paqë. Komandanti serb iu përgjigj duke thënë: "Ju jeni terroristë. Nxirrni armët."

Dëshmitarët thanë se, në këtë muhabet e sipër, komandanti serb i kishte vënë shkelmin në zverk Shëndet Popajt, nipit shtatëmbëdhjetë vjeçar të doktorit, i cili kishte rënë përmbys në tokë. Duke i dhënë fund me vrazhdësi diskutimit, komandanti – sipas përshkrimit të dëshmitarëve ai ishte një burrë me shtat mesatar, rreth tridhjetë e pesë vjeç, i veshur me uniformë kamuflazhi në ngjyrë të gjelbër, me tri yje në spaleta – shtiu tri herë mbi Dr. Popajn në sytë e gruas dhe tre fëmijëve të tij dhe më pas, vrau edhe Shëndetin. Dëshmitarët do të përmendnin në mënyrë specifike se komandanti, i cili sipas tyre duhej të ishte kapiten, kishte një tipar tepër të veçantë, gojën tepër të deformuar.

Njëri nga dëshmitarët, një nga katër njerëzit që mbijetuan pas të shtënave, i tha Human Rights Watch:

> Në krye ata vranë doktorin që ishte një nga prijësit e fshatit. Ata shtinë mbi të me armë automatike në një distancë afro një metër, në kohën që doktori ishte duke iu thënë, "ju lutem, mos na vrisni, ne jemi fshatarë që duam të punojmë; nuk jemi me UÇK"-në. Serbët po thoshin, "ju jeni terroristë; nxirrni armët." Ata thanë, "Ku e keni NATO-n që t'ju shpëtojë?" Një kapiten urdhëroi të tjerët. Ai e vrau me dorën e vet doktorin, ndërkohë që ishin duke debatuar. Doktori ishte njeriu më i nderuar në fshat. Kishte studiuar në Perëndim: në Sarajevë, Zagreb dhe në Gjermani. Pasi vranë doktorin, vranë aty për aty edhe nipin e tij. Kapiteni i kishte vënë këmbën në zverk nipit të doktorit. Ai e qëlloi nipin në kokë.
>
> Kapiteni kishte shtat mesatar (përafërsisht një metër e tetëdhjetë centimetra i gjatë. Në kokë mbante helmetë. Nuk kishte maskë dhe në supe kish tri yje të artë. Ai kishte një gojë çuditërisht të shtrembëruar. S'kish as mustaqe dhe as mjekër. Duhej të ishte tridhjetë vjeç, ndoshta tridhjetë e pesë ose aty afër.
>
> Në kohën që policët po më shkëpusnin nga fëmijët, ata u rrekën të vinin tek unë. Kur vranë doktorin, gruaja dhe fëmijët e doktorit ishin aty pranë; s'duhej të ishin më larg se njëzet metra dhe panë gjithçka. Teksa gruaja dhe fëmijët e doktorit zunë të ulërisnin, policët po përpiqeshin t'i mbanin larg vendit të ngjarjes Gjithë-gjithë duhej të ishin rreth njëzet policë. [6]

Më pas forcat e sigurimit ndanë burrat mbi katërmbëdhjetë vjeç e sipër nga gratë dhe fëmijët. Burrave iu kërkua të zhvisheshin, gjë që, sipas fshatarëve,

ishte një përpjekje e qartë për t'i poshtëruar në sytë e grave dhë fëmijëve të tyre. Ndonëse një shpjegim tjetër mund të jetë që, policët prisnin të gjenin uniforma ushtarake nën petkat civile. [7] Trupat serbe, që sipas përshkrimit të një gruaje, kishin veshur uniforma të gjelbra dhe në mëngë mbanin shiritë të bardhë, vijuan më tej duke kontrolluar nëpër teshat e burrave dhe duke marrë gjithë ç'gjenin: letrat e njoftimit, sende të çmuara, si dhe para, duke përfshirë këtu 40.000 marka gjermane që i gjetën një njeriu të vetëm, Muharrem Zhuniqit. Në këtë pikë, ata iu thanë grave dhe fëmijëve të ecnin përgjatë udhës së hekurt, në drejtim të Xërxes. Burrat u urdhëruan të vishen dhe i kthyen mbrapsh, për nga bregu i lumit.

Gratë e fshatit, që ishin vënë në udhë e po ecnin përgjatë shinave, i thanë Human Rights Watch, se s'kish pak që ishin nisur, kur veshët iu zunë shkrepëtimat e zjarrit të armëve, që zgjati disa minuta radhazi, pa pushuar. N. Z. dëshmon: "Nuk kishim bërë ndoshta as dhjetë metra, dëgjuam të shtënat e armëve automatike, që zgjatën për afro tri-katër minuta pa pushim. Sakaq, gratë zunë të ulërisnin, "Na vranë burrat!"

Në një intervistë të veçantë, një tjetër grua do të kujtonte: "Serbët e drejtuan grupin në të cilin ndodhesha edhe unë për kah fshati Xërxe. Ndërkohë që po

Përroi pranë Belaçerkës ku forcat serbe ekzekutuan gjashtëdhjetë e katër shqiptarë etnikë.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

merrnim nga ura, dëgjuam të shtënat e armëve automatike që zgjatën pak minuta. As që guxuam të kthenim kryet e të shihnim çfarë po ndodhte.” [8]

Human Rights Watch foli me dy nga burrat që ishin në grupin e atyre që u urdhëruan të shkonin nga bregu i lumit. Në intervista më vete, ata dëshmuan se serbët hapën zjarr mbi ta me armë automatike. Fillimisht mbijetuan gjashtë burra, por më pas dy prej tyre vdiqën nga plagët e marra.

Human Rights Watch e intervistoi të mbijetuarin e parë më 16 prill, në Kukës, pak ditë pasi ai kishte hyrë në Shqipëri. Atë kohë, ai kishte të fashuar shpatullën e djathtë, krahun e djathtë dhe disa plagë në kokë, që ai tha se i kishte marrë nga të shtënat në Bellaçerkë, si dhe disa plagë sharapnelash në kokë e në krah, që ai pohonte se i kish marrë më vonë, gjatë një granatimi pranë fshatit Nagafc. Pas një vizite që do të bënte më vonë te mjekët në Tiranë, doli se ai kishte një plumb në shpatull.

Burri tha se ai kishte qenë ndër të parët në atë grup që ishte qëlluar. Paskëtaj kishte rënë në ujë dhe qe mbuluar nga trupat e tjerëve që kishin mbi të, gjë që i kishte shpëtuar jetën. Ai i tha Human Rights Watch:

Nga akt-padia e vitit 1999 e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi kundër Sllobodan Millosheviçit, et. Al.

Më ose rreth datës 25 mars 1999, trupa të RFJ dhe Serbisë sulmuan fshatin Bellaçerkë (komuna e Rahovecit). Shumë nga banorët e Bellaçerkës u larguan nga fshati në drejtim të një përroi aty pranë dhe gjetën strehë nën urën e një hekurudhe. Teksa fshatarë të tjerë po i afroheshin urës, një patrullë e policisë serbe hapi zjarr mbi ta dhe vrau 12 persona, duke përfshirë 10 gra e fëmijë. Paskëtaj, policët i urdhëruan fshatarët që kishin mbetur të dilnin nga shtrati i përroit dhe në këtë kohë, ata do të ndanin burrat nga gratë dhe të miturit. Policët i urdhëruan të zhvishen dhe më pas i grabitën sistematikisht nga gjithë sendet e vyera. Gratë dhe fëmijët u urdhëruan të largoheshin. Doktori i fshatit u përpoq të fliste me komandantin e policëve, por ai u qëllua dhe u vra në vend, ashtu si dhe nipi i tij. Burrat e tjerë u urdhëruan të ktheheshin mbrapsh, në shtratin e përroit. Pasi burrat iu bindën këtij urdhëri, policët hapën zjarr mbi ta, duke vrarë afërsisht 65 shqiptarë kosovarë. (Personat e vrarë, të cilëve iu dihet emri, janë vendosur në skedën B, e cila i është bashkangjitur si shtojcë akt-padisë.)

> Pasi vranë doktorin dhe nipin e tij, ata na thanë të ktheheshim te përroi. Pasktëaj, ata nisën sakaq të shtinë mbi ne. Kapiteni nuk nxorri asnjë fjalë nga goja, ai zuri të shtjerë, gjë që nisën të bënin edhe të tjerët, menjëherë pas tij. Të shtënat do të vazhdonin pandërprerje, për afro pesë apo dhjetë minuta. Kur nisën të shtënat, unë rashë i pari, plumbi më kishte marrë në shpatullën e majtë. Njerëzit e vrarë ranë mbi trupin tim. Pasi reshtën të shtënat, ata nisën të shohin rreth e qark, për të parë mos kishte dne ndonjë që merrte frymë. I dëgjova kur thanë, "ky këtu merrka frymë." Verifikuan dhe panë kush kish mbetur gjallë dhe më pas i mbaruan. Unë isha fshehur nën trupat e të vrarëve.
>
> Qëndrova në atë gjendje për afro njëzet minuta. Pas dhjetë minutash dëgjova të shtëna. Po vrisnin njerëz mbi përrua. Kur u ngrita, pashë njerëz të vdekur rreth e rrotull meje. Kishin mbijetuar edhe pse të tjerë, por një pjesë e tyre vdiqën më vonë. Ishin vrarë gjithsejt dyzet e dy njerëz. [9]

Tridhjetë minuta pas hapjes zjarr për herë të dytë, në kohën kur dëshmitari e kish kuptuar se trupat serbe ishin larguar, ai u çua dhe pa, përveç trupave të dyzet burrave të vrarë në lumë, edhe kufomat e shtatë pleqve nga Bellaçerkë, si dhe trupat e dy personave që ai nuk i njihte, të plandosur përtokë, në një fushë rreth njëqind metra larg përroit. Paskëtaj, ai mori të ecë në drejtim të Xërxes, ku iu kumtoi grave të fshatit çka kishte ngjarë.

E gjithë kjo do të vërtetohej nga N. Z., e cila ishte dërguar në Xërxe, tok me gratë e tjera. Ajo i tha Human Rights Watch se një burrë, i mbijetuari i cituar pak më sipër, erdhi në Xërxe. Në fillim, u shpreh ajo, ai qëndroi i heshtur dhe vetëm më pas na shpjegoi atë që kish ngjarë me burrat e tjerë. Ajo e konfirmoi faktin se, ai ishte plagosur në shpatull.

Burri i kunatës së N. Z.-së, u kthye në breg të lumit tok me një grup grash, për të parë nëse kishte ndonjë të mbijetuar tjetër. Ai solli me vete pesë burra, tha N. Z., por dy prej tyre pas pak kohësh vdiqën.

I mbijetuari tjetër, i intervistuar nga Human Rights Watch, kallzoi të njëjtën ngjarje. Ai tha:

> Ata na ndanë dhe në urdhëruan të merrnim për në drejtim të bregut të përroit. Kur u nisëm, ata hapën zjarr mbi ne. Unë sakaq rashë dhe u mbulova nga pesë a gjashtë të vrarë, që më ranë përsipër. Qëndrova në ujë për afro një orë, të vrarët më kishin mbuluar. Kur nuk dëgjova më zhurma, u ngrita. Isha larë i tëri në gjak. Pashë pesë burra që ishin

> lënduar. Më vonë, vetëm tre prej tyre arritën të mbijetojnë. Isha kaq i llahtarisur sa shkova dhe u fsheha në ca shkurre. Pas afro një ore, dy gra, farefis i disa prej atyre personave, erdhën dhe panë trupat. Njëra prej tyre zbuloi trupat e dy djemve të saj; njëri pesëmbëdhjetë dhe tjetri gjashtëmbëdhjetë vjeç. Aty ndodheshin dyzet e pesë të vrarë, të cilët do të varroseshin dy ditë më pas nga njerëzit e fshatit.[10]

Human Rights Watch foli veç e veç me katër individë të ndryshëm, të cilët i kishin parë trupat e të vrarëve ose kishin ndihmuar në varrosjen e tyre në fushën pranë përroit. Një burrë tha se, përveç grupit të të vrarëve në përrua, ai kishte gjetur edhe dymbëdhjetë njerëz që i përkisnin dy familjeve – shtatë fëmijë, tri gra dhe dy burra – pranë urës. Ai i tha Human Rights Watch:

> Pasi serbët u larguan, zbrita te përroi me gruan e njërit prej burrave të fshatit, për të parë çfarë iu kishte ngjarë. Gjeta trupat si dhe pesë njerëz që ishin plagosur por ende gjallë …
>
> I varrosëm trupat dy ditë pasi i kishin vrarë. Ishim tepër të frikësuar dhe s'guxonim t'i varrosnim më parë. I varrosëm në fushë, fare pranë përroit, nën urë. Na u deshën dy netë që t'i varrosim – për arsye sigurie, punonim vetëm natën. Natën e parë, njëzet deri në tridhjetë njerëz punuan tetë orë për t'i varrosur kufomat. Natën e dytë, rreth pesëmbëdhjetë njerëzve iu deshën katër orë për t'i varrosur të gjithë.[11]

Më 6 korrik, viktimat u rivarrosën me nderimet e duhura sipas ritit mysliman, pasi ishin ekzaminuar nga ekspertë britanikë të kriminalistikës, që punonin për llogari të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës në ish-Jugosllavi. Sipas GJNKLJ, nga vendngjarja u ekzumuan shtatëdhjetë e shtatë trupa.[12]

CELINË

Më 25 mars, disa orë pasi kishin nisur bombardimet e NATO-s, trupat serbe dhe jugosllave hynë në fshatin Celinë. Një pjesë e fshatarëve u larguan në drejtim të kodrave aty pranë, por me qindra shqiptarë etnikë mbetën të mbërthyer si në grackë në fshat. Në harkun e tri ditëve më shumë se gjashtëdhjetë e pesë prej tyre u vranë, duke përfshirë këtu njëzet e dy vetë nga e njëjta familje, të cilët u kapën në një grykë të

vogël mbrapa shtëpisë së tyre. Ekipi i ekspertëve kriminalistë të GJNKLJ, do të zhvarroste gjashtëdhjetë e nëntë trupa, në pranverë të vitit 1999.

Hulumtuesit e Human Rights Watch intervistuan tri dëshmitarë për abuzimet në Celinë, çdonjërin prej tyre në një vend të ndryshëm dhe data të ndryshme. Dëshmitë e tyre përputhen në një shkallë të madhe, gjithashtu përkojnë me njoftimet e shtypit për ngjarjet në këtë fshat, si dhe me raportet për të drejtat e njeriut të OSBE-së.

Të tre dëshmitarët, njëri prej tyre ushtar i UÇK-së pas pohimit të bërë vetë, deklaruan se fillimisht kishin dëgjuar zhurmën e tankeve dhe automjeteve të rënda ushtarake pranë Celinës, aty nga ora 1 e mëngjesit e datës 25 mars. Nga ora 4 deri më 6 të mëngjesit, fshati u granatua.

Një pjesë e madhe e burrave, madje disa prej tyre luftëtarë të UÇK-së, të frikësuar për atë çka mund t'iu ndodhte, u larguan në fushat dhe kodrat rreth e qark fshatit. Gratë dhe fëmijët, duke përfshirë këtu banorë shqiptarë edhe nga fshatrat e tjera aty pranë, si ai Opterushës, Zozishtës, Bellaçerkës, Retimljes, Hocës së Vogël dhe Brestocit, shkuan e u fshehën nëpër qilarët apo guvat aty pranë. Forcat qeveritare të sigurimit hynë në Celinës në orën 6 të mëngjesit.

Të gjithë ata që do të dëshmonin për Human Rights Watch, e lanë Celinën mëngjesin e datës 25 dhe u kthyen më pas për të parë trupat e atyre që ishin vrarë. Një burrë pohoi se ai kishte parë disa nga vrasjet e kryera, ndërkohë që ishte fshehur pranë fshatit në një kodrinë. I intervistuar gjerë e gjatë në postën kufitare të Morinës në Shqipëri, ku ai priste familjen që po largohej nga Kosova, tridhjetë vjeçari kallzoi se si kish parë nga maja e kodrës forcat qeveritare kur granatuan xhaminë e Celinës dhe dogjën shkollën. Ish-ushtar i ushtrisë jugosllave (1986-1987), burri pohoi se komandanti i trupave ishte major i ushtrisë. Këtë e bazonte në faktin se kishte parë yjet në supet e tij dhe kish dëgjuar vartësit ta thërrisnin "major". Gjithsesi, vijoi ai, trupat qeveritare ka të ngjarë të kenë qenë paraushtarakë. Kishin veshur uniforma kamuflazhi në ngjyrë të gjelbër, ndërsa në krah kishin lidhur shami të bardha.

Ekipi i ekspertëve kriminalistë të GJNKLJ, do të zhvarroste gjashtëdhjetë e nëntë trupa, në pranverë të vitit 1999.

Dëshmitari i tha Human Rights Watch se, gratë dhe fëmijët e fshatit, tok me burrat që kishin mbetur, u urdhëruan të dilnin nga shtëpitë dhe u shtrënguan të dorëzonin paratë dhe sendet e çmuara që kishin me vete. Një pjesë të njerëzve u dërguan në qilarët e shtëpive të tyre, ndërsa disa gra i nisën për në Xërxe.

Në mbrëmje vonë forcat e sigurimit u larguan nga fshati Celinë dhe

dëshmitari hyri në fshat për të parë çfarë kish ndodhur. Në krye u drejtua për nga shtëpia e tij, ku pa të atin, dy nipër dhe dy miq të familjes të vrarë. Ai tha:

> Im atë ishte vrarë nga një plumb që e kish marrë përmes hundës. Njëri nga djemtë ishte vrarë me një plumb në kokë, ndërsa tjetri nga një plumb që e kish marrë në stomak. Aty ndodhej im atë, dy djemtë e xhaxhait tim dhe dy mysafirë, njëri nga Celinë dhe tjetri nga Bellaçerkë. Njërin nga ata e kish marrë plumbi në ballë, ndërsa tjetrin nga pas kokës, në zverk. Mendova që njëri prej tyre mund të ishte ende gjallë, por ne u kthyem sërish në kodër për t'u fshehur. [13]

Dëshmitari qëndroi në atë zonë për katër ditë me radhë, duke u endur kodrave rreth e qark Nogavacit dhe Hoxhës së Vogël dhe ngandonjëherë, kur nuk shihte ndonjë rrezik, kthehej edhe në Celinë. Siç tha ai, trupat serbe kishin ngritur një shtab lokal në shtëpinë e Burhan Hasanit. Gjatë gjithë kësaj kohe, ai kishte parë një numër kufomash në fshat, madje kishte vëzhguar, në distancë, disa nga ekzekutimet e kryera.

Në krye, tha ai, më 25 mars u vranë tetë njerëz nga familja Dine, ndonëse ai kish parë vetëm trupat nga dritarja e shtëpisë së tyre, pasi ata ishin vrarë. "Pashë vetëm kufomat dhe gjak," tha ai. Një ditë më pas, më 26 mars, fshatarët e mbetur ishin mbledhur në qendër të Celinës. Afro pesëmbëdhjetë burra ishin ndarë nga grupi dhe detyruar të zhvishnin këmishët. Një adoleshent u therr me thikë, ndërsa pjesa tjetër e burrave u vranë me armë automatike dhe më pas u dogjën me gazolinë. Dëshmitari tha:

> Pashë se si të gjithë meshkujt ishin lakuriq nga mesi e lart ... Burrat ishin rreshtuar pranë një garazhi. Ja pesëmbëdhjetë, ja gjashtëmbëdhjetë burra. I njoh të gjithë, vetëm tre prej tyre ishin mysafirë – dy nga Hoxha e Vogël dhe një nga Krusha e Vogël. I pashë kur hoqën këmishët të urdhëruar nga policët. Më pas iu morën paratë.
>
> Pastaj shkuan e nxorrën një djalë nga turma. Në krye treguan thikën. Njëri lëpiu tehun e thikës. Pastaj një tjetër i preu fytin. Ishte një thikë e gjatë sa gjysma e krahut, e zezë dhe me hark. Viktima quhej Alban Rexhepi dhe ishte trembëdhjetë vjeç. Më pas vranë gjithë të tjerët.
>
> Me një kovë të vogël të mbushur plot me gazolinë që e kishin marrë nga një veturë, ata shkuan dhe spërkatën trupat. Pasi u larguan policët,

> pashë edhe dy çuna të tjerë (shqiptarë etnikë), që e kishin parë skenën. Katërmbëdhjetë nga viktimat i njihja – kishim të bënim. Të gjithë ishin djegur. I kishin vrarë me armë automatike. Urdhërin e kish dhënë një burrë i gjatë dhe i shogët.[14]

Kjo dëshmi do të konfirmohej nga një çift pleqsh nga Xërxe, njerëzit e familjes së të cilëve kishin gjetur vdekjen në Celinë, si dhe nga pohimet e bëra nga një dëshmitar tjetër në shtyp. Çifti i pleqve dëgjoi rreth vrasjeve më 27 mars dhe u nis për në Celinë për të ndihmuar në varrim. Sipas tyre, shtatëmbëdhjetë burra ishin vrarë dhe djegur. "Ne i pamë të gjithë trupat," tha gruaja. "Ti mund të shihje me sytë e tu se si ata ishin ekzekutuar dhe më pas trupat ishin djegur."[15] Në një artikull të *New York Times* të shkruar në Shqipëri gjatë kohës së luftës, i bazuar në dëshmitë e refugjatëve, një burrë tha se kish parë pesëmbëdhjetë burra, shumica e tyre nga familja Rexhepi, të digjeshin në Celinë. "Atyre iu kishin hequr këmishët," tha dëshmitari pesëdhjetë vjeçar, dhe "pasi i spërkatën me gazolinë, iu vunë zjarrin."[16]

Në mbrëmje vonë të datës 25 mars, kur forcat e sigurimit nuk ishin më të pranishme, dëshmitari kishte hyrë në fshat për të parë mos kish mbijetuar njeri. Asokohe kish parë shumë kufoma në fushë, ndonëse ai nuk qe në gjendje të sillte ndërmend numrin e saktë të njerëzve që ishin vrarë në atë vend. Nga data 25 deri më datë 27 mars, dëshmitari mëton të ketë parë shtatëdhjetë e dy të vrarë në Celinë, viktimat do të ishin kryesisht nga tri familje (dy shqiptare dhe një rrome): familjet e Myftar Zeqirit dhe Elki Zeqirit, si dhe familja e Faik Saliut, ky i fundit rrom.

Më 28 mars, forcat e sigurimit rrethuan dhe kapën në kodrat përreth dëshmitarin dhe një grup të madh shqiptarësh etnikë, burra e gra tok, të cilët kishin ditë të fshehur. Siç tha dëshmitari, një burrë njëzet e tre apo njëzet e katër vjeç, Agim Ramadani, ishte shkëputur nga grupi dhe ekzekutuar. Një tjetër person, Sakip Rexhepi, tridhjetë e pesë vjeç ishte marrë nga forcat e sigurimit dhe që nga ajo kohë e deri në mes të prillit, koha kur ishte intervistuar dëshmitari, ai ishte zhdukur pa lënë gjurmë. Grupi ishte shpënë në Krushë të Madhe, ku ndodhej një postbllok ushtarak. Vefia Rexhepi, tridhjetë e gjashtë vjeç, i pagojë, u vra pranë një pellgu në rrugë e sipër, ndërsa Nait Elshani, tridhjetë e tre vjeç, u qëllua pranë Krushës së Madhe, tha dëshmitari. Pjesa tjetër e grupit ishte shpënë me autobuz në fshatin kufitar të Zhurit, prej ku u urdhëruan të merrnin më këmbë rrugën për në Shqipëri, më 28 mars. Dëshmitari tha se kishte

njohur fytyrat e tre policëve, njëri prej të cilëve ishte nga Hoxha e Madhe.

Dëshmia e mësipërme konfirmohet në një shkallë të madhe prej dy dëshmitarëve të tjerë nga fshati Celinë. Njëri prej tyre, një burrë dyzet e katër vjeçar i intervistuar në një kamp refugjatësh në Durrës, Shqipëri, i tha Human Rights Watch se ai ishte larguar me familjen nga Celina mëngjesin e datës 25 mars. Rreth orës 6 pasdite, të po asaj dite, ky person ishte kthyer në fshat bashkë me disa fshatarë të tjerë, për të marrë tri kamionët e tij. Edhe pse ai nuk kishte parë as edhe një kufomë, gratë e fshatit i kishin thënë se tetëmbëdhjetë njerëz ishin vrarë dhe më pas djegur, ndërsa anëtarët e familjeve Dina dhe Myftari ishin vrarë gjithashtu.[17] Ai tha:

> Kur u ktheva, njerëzit më thanë se serbët kishin grumbulluar tetëmbëdhjetë burra në një shtëpi, i kishin zhveshur dhe pasi i kishin spërkatur me benzinë, iu kishin vënë flakën. Këtë gjë ma tregoi një grua që e quanin Nerxhivan Rexhepi, e cila më tha se njerëzit e vrarë ishin nga familja e saj. Po ashtu një burrë erdhi e më tha se e njëjta gjë i kishte ndodhur familjes Dina, pesë familjarë të së cilës ishin vrarë. Një tjetër tha se, po kjo gjë kishte ndodhur edhe me familjen Myftari, gjashtëmbëdhjetë njerëz të së cilës ishin vrarë. Flitej gjithashtu se në Celinë ishin vrarë edhe nja pesëdhjetë vetë të tjerë.[18]

Më 27 mars, burri dhe familja e tij ndodheshin në kodra, bashkë me një grup të madh shqiptarësh, të gjithë nga e njëjta zonë, rreth 10.000 apo 15.000 vetë. Policët dhe ushtria të veshur me uniforma kamuflazhi të gjelbra dhe shami të bardha, erdhën dhe e rrethuan grupin, tha dëshmitari, paskëtaj shkëputën nga grupi një pjesë të madhe të burrave në moshë për armë dhe i shtrënguan të zhvisheshin. Një djalosh rreth të njëzetave me mbiemrin Ramadani, u hoq mënjanë dhe u ekzekutua, tha ai. Ndonëse dëshmitari nuk e dinte emrin e viktimës, mbiemri i dhënë prej tij përkon me atë të dhënë nga dëshmitari i parë i Celinës, duke na sugjeruar se ata gjendeshin në të njëjtin grup në kodra. Dëshmitari i dytë tha:

Policët dhe ushtria të veshur me uniforma kamuflazhi të gjelbra dhe shami të bardha, erdhën dhe e rrethuan grupin.

> Ndërkohë që gjysma prej nesh ishin zhveshur, ata nxorën nga grupi dhe hoqën mënjanë një djalë. Dy ushtarë e shpunë buzë një grope, rreth pesëdhjetë metra më tutje. Kishin veshur uniforma të gjelbra

> dhe mbanin shami të bardha. E detyruan të bjerë në gjunjë. Paskëtaj e qëlluan tri herë nga mbrapa kokës me pistoletë. Më pas u kthyen nga ne dhe thanë: "Bëni mirë të na jepni gjithçka që keni, përndryshe do të përfundoni si ky këtu." Donin më shumë nga para. Të gjithë bashkë sa ishim në grup mund t'iu kemi dhënë 500.000 a 600.000 marka.[19]

Paskësaj grupi u shtrëngua të merrte në drejtim të Krushës së Madhe. Sipas dëshmitarit, diku midis Krushës së Madhe dhe fshatit Kushaj, disa djem u detyruan të futen në ujin e ftohtë deri në fyt dhe të qëndrojnë ashtu për një farë kohe. Në Krushën e Madhe, dëshmitarit i kishte zënë veshi që dy njerëz ishin vrarë, ndonëse ai vetë nuk kish qenë i pranishëm në vrasjen e tyre dhe as që i kish parë trupat. Sipas asaj që ai kish dëgjuar nga të tjerët, një nga viktimat kish qenë një memec, i quajtur Vefair Rexhepi, i cili ishte vrarë dhe më pas "kish rënë në ujë" – dëshmi kjo që shkon e përputhet me dëshminë e dëshmitarit të parë. Viktima e dytë ishte Nait Kabashi nga Obtorush, emri i të cilit është i njëjtë me atë të dhënë nga dëshmitari i parë, përveç mbiemrit, i cili ndryshon. Nga Krusha e Madhe grupi do të merrte në drejtim të kufirit me Shqipërinë, hipur në autobuzë dhe kamionë.

Dëshmitari i tretë i Human Rights Watch do të ishte një ushtar i UÇK-së, i intervistuar në Celinë pas hyrjes së trupave të NATO-s.[20] Ai i tregoi Human Rights Watch listën më emrat e shtatëdhjetë e tre njerëzve të vrarë në Celinë, më 25 mars, si dhe të gjashtë personave të zhdukur, që nuk ishin bërë të gjallë deri në mes të qershorit.

Personi në fjalë deklaroi se si kish parë nga një kodër aty pranë, më 25 mars, policët serbë kur kishin sulmuar dhe vrarë njëzet e dy pjesëtarë të familjes Zeqiri, në një grykë të ngushtë mbrapa shtëpisë së tyre. Vetëm një çunak trembëdhjetë vjeç mbijetoi, tha ai. Trupat u varrosën pas një muaji. Po sipas tij, shtatë persona ishin djegur brenda në një veturë, më datë 26 mars. Human Rights Watch iu tregua vetura e djegur, ku sipas dëshmisë kish ndodhur vrasja.

Të dhënat e vjela nga shtypi konfirmojnë në një shkallë të madhe, pohimet e bëra më sipër nga të tre dëshmitarët. Në një artikull, një fshatar nga Celina i kallzoi reporterit shtegun dhe vendin – "që ngjante pothuaj me një tunel, mbi të cilin vareshin shkurre" – ku kishin gjetur vdekjen njëzet e dy vetë; sipas të gjitha gjasave, vendi ku ishte vrarë familja Zeqiri. Paqeruajtësit gjermanë në atë zonë do të pohonin se, në fshat gjendeshin shtatëmbëdhjetë varreza të përbashkëta.[21]

Në artikull, burri nga Celina gjithashtu pohon se ai ishte kapur me bashkëfshatarët e tij, më 28 mars, në pyjet aty pranë dhe "disa (burra) ishin qëlluar." Më vonë, po ky person ishte shtrënguar të futej në një përrua dhe të qëndronte në ujin e ftohtë i zhytur deri në fyt, para se të mbartej me kamionë pranë kufirit me Shqipërinë – pohim ky që përkon me fjalët e dëshmitarit të dytë.

Në një tjetër artikull, të shkruar nga i njëjti gazetar, bëhet fjalë për vrasjen e katërmbëdhjetë personave në fshatin Celinë, më 26 mars. "Në atë grup ishin katërmbëdhjetë burra," tha një dëshmitar. "Dhe unë jam i vetmi që arrita të mbijetoj."[22]

Raporti rreth të drejtave të njeriut i OSBE-së, "Kosovo/Kosova: Siç e pamë, siç na e kallzuan," gjithashtu konfirmon në vija të trasha ecurinë e ngjarjeve. Sipas raportit, një person që ishte fshehur në pyll, më datën 25 mars kishte parë se si trembëdhjetë burra ishin çuar në një ndërtesë dhe më pas nga ndërtesa ishin dëgjuar të shtëna. Dëshmitari do të pohonte se kishte parë policët të bënin një pirg me trupa dhe se si iu kishin kallur zjarrin.

Gjithashtu, fshatarë të tjerë nga Celina i kishin thënë OSBE-së, se si ishin kapur në pyll pas sulmit fillestar dhe të shtrënguar kishin bërë më këmbë rrugën deri në Krushën e Madhe, prej ku kamionët do t'i shpinin në Zhur. Dëshmitarët thanë se, në rrugë e sipër dy persona ishin ekzekutuar, njëri prej tyre ishte memec.[23]

KRUSHA E MADHE DHE KRUSHA E VOGËL

Krusha e Madhe dhe Krusha e Vogël shtrihen rreth një milje larg njëra-tjetrës, në kufi midis komunave të Rahovecit dhe Prizrenit. Sipas të dhënave të OSBE-së, Krusha e Madhe ishte një fshat me afërsisht 2000 banorë, shumica dërrmuese e të cilëve ishin shqiptarë etnikë, ndërsa Krusha e Vogël kishte një numër më të madh banorësh serbë, të cilët përbënin afro 18 përqind. Përgjatë viteve 1998 dhe 1999, UÇK-ja kishte qenë aktive, si brenda ashtu edhe rreth e qark fshatrave.[24] Gazetarët dhe pjesëtarët e misionit OSBE-KVM do të shihnin dhe takonin vazhdimisht në atë zonë luftëtarë të UÇK-së.

Ngjarjet në këto dy fshatra, të cilat përbëjnë masakrat e para të raportuara nga Kosova gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, lypset të paraqiten sëbashku, ngaqë të dy popullsitë u ndërpleksën në kohën e sulmeve. Gjithsesi, për shkak të kohës dhe burimeve të kufizuara, Human Rights Watch u fokusua vetëm mbi Krushën e Madhe, ku gjetën vdekjen më shumë se nëntëdhjetë njerëz, duke intervistuar

tetë dëshmitarë, të cilët kishin vëzhguar vrasjet, si dhe krime të tjera lufte të kryer në atë fshat. Në këtë kapitull, ngjarjet që kanë të bëjnë me Krushën e Vogël janë përmendur shkurtimisht, ndonëse besohet se më shumë se njëqind burra kanë humbur jetën në atë vend. Të dy këta fshatra përmenden në aktpadinë e ngritur kundër Sllobodan Millosheviçit dhe katër zyrtarëve të tjerë të lartë nga Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.

Ashtu siç kishin vepruar me pjesën më të madhe të fshatrave përgjatë rrugës Prizren-Gjakovë, fjala vjen si Bellaçerkë dhe Celinë, policia dhe njësitë e ushtrisë nisën granatimin e Krushës së Madhe e të Vogël, mëngjesin e datës 25 mars, ndërmjet orës 3 dhe 5 të mëngjesit. Një ditë më pas, trupat qeveritare do të hynin në të dy fshatrat. Dëshmitarët nga Krusha e Madhe do të bënin fjalë për një kombinim të forcave speciale të policisë me ato të ushtrisë, të parët të veshur me uniforma blu të errët, me fjalën "policia" të shkruar në shpinë, ndërsa të dytët mbanin uniforma kamuflazhi të gjelbra. Siaps dëshmitarëve, pjesa më e madhe e tyre mbanin fasho të bardha në krah.Ndërsa disa i kishin lyer fytyrat dhe në krye kishin lidhur shami; ndërkohë që një pjesë e tyre kishin flokë të gjatë, të tjerët e kishin kokën të rruar.

Në kohën e sulmit, UÇK-ka nuk ndodhej në atë zonë. Në kaosin e krijuar, një pjesë e mirë e civilëve u përpoqën të fshiheshin nëpër qilarët e shtëpive ose t'ia mbathnin në kodrat apo pyjet aty pranë. Shumë civilë morën në drejtim të fshatit Nogavac, që ndodhej aty pranë, ku ishin mbledhur edhe shumë banorë të tjerë të atyre anëve.[25] Një numër njerëzish kishin gjetur strehë në pyjet midis Krushës së Madhe dhe asaj të Vogël. Më 26 mars, forcat e sigurimit nisën të bastisnin dhe të digjnin shtëpitë e fshatarëve dhe, në përgjithësi, ata arritën të kapin civilët që ishin fshehur jashtë fshatrave.

Viktimat, jo më pak se njëqind vetë, u mbuluan me sanë dhe iu vu zjarri.

Duke iu referuar shtypit dhe OSBE-së, gratë dhe fëmijët që u gjendën nëpër pyje, u ndanë nga burrat dhe u nisën ose në Krushë të Madhe ose në kufi me Shqipërinë. Burrat i futën në shtëpinë e një serbi në Krushën e Vogël, ku u qëlluan me armë automatike. Paskëtaj, viktimat, jo më pak se njëqind vetë, u mbuluan me sanë dhe iu vu zjarri. Ekipi i ekspertëve kriminalistë të GJNKLJ gjeti vetëm katërmbëdhjetë trupa në Krushën e Vogël, por në të njëjtën kohë ata do të raportonin për gjurmë të qarta të trazimit të varreve.[26] Ndërtesa ku ishin kryer vrasjet ishte shembur me lëndë eksplozive. Human Rights Watch e vizitoi Krushën e Vogël më 19 qershor 1999 dhe në vendin ku sipas fshatarëve kishte ndodhur masakra, gjetën një krater të madh.

Midis 26 dhe 28 marsit, në Krushën e Madhe do të gjenin vdekjen më shumë se nëntëdhjetë banorë, në pjesë të ndryshme të fshatit. Bazuar në dëshmitë e ofruara nga tetë dëshmitarë, Human Rights Watch hartoi një listë me emrat e dyzet e tre viktimave. Ekipi i ekspertëve kriminalistë të GJNKLJ ekzumoi nëntëdhjetë e tetë trupa në tri vende të ndryshme të Krushës së Madhe, megjithëse një pjesë e të vrarëve mund të kenë qenë luftëtarë të UÇK-së të vrarë në luftime.[27]

Gjithashtu ekzistojnë dëshmi të pashlyeshme se trupat qeveritare u rrekën të fshinin gjurmët e vrasjeve si në Krushën e Madhe ashtu edhe në atë të Vogël, duke djegur apo shpërngulur disa prej kufomave. Dëshmitarë nga Krusha e Madhe thanë se panë policët të mbartnin trupat me kamionë dhe automjete të ushtrisë, për t'i flakur më pas në lumë. Kohë më vonë trupat e NATO-s do të zbulonin një kamion në lumë, në pjesën e pasme të të cilit kishte kocka. Shtëpia në Krushën e Vogël, ku u ekzekutuan njerëzit, u dogj dhe u hodh në erë.

Krusha e Madhe

Detajet e sakta të vrasjeve në Krushën e Madhe nuk janë krejtësisht të qarta edhe sot e kësaj dite, ngaqë ato ndodhën në kohë të ndryshme dhe pjesë të ndryshme të fshatit. Për shembull, një person i quajtur R. E. i tha Human Rights Watch se, ai kish ndihmuar në varrimin e tre burrave të vrarë në Krushën e Madhe: Selim Taha (rreth të shtatëdhjetave), Daim Taha (rreth të gjashtëdhjetë e pesave), dhe Qamil Taha (rreth të gjashtëdhjetave), të cilët ishin ekzekutuar më 27 mars, ose aty afër. Qamili ishte gjetur në rrugën që të nxjerr nga fshati, ndërsa Selimi dhe Daimi ishin vrarë në oborret e shtëpive të tyre. Gjithashtu, R. E. besonte se Bajram Hoti (rreth të tridhjetave) dhe mësuesi i fshatit Osman Sejfullahu (rreth të pesëdhjetë e shtatave) ishin vrarë. R. E. nuk i kishte parë vrasjet madje as kufomat, por kishte gjetur në rrugë letrat e tyre të njoftimit, dhe rreth e qark pllanga gjaku.[28]

Human Rights Watch e vizitoi për të parën herë Krushën e Madhe më 15 qershor 1999, tri ditë pasi NATO kishte hyrë në Kosovë. Trupat gjermane të KFOR-it nuk lejonin askënd t'i afrohej një shtëpie pa çati në fshat, ku, sipas të dhënave, ishin gjetur kufoma. E megjithatë, një gazetar televiziv gjerman ia doli mbanë të hynte e të hidhte një sy, i cili i tha Human Rights

Watch se aty brenda gjendeshin rreth njëzet skelete të djegur.[29] Në total, ekipi i ekspertëve të GJNKLJ gjeti nëntëdhjetë e tetë trupa në tri vendvarrime të ndryshme rreth e qark fshatit; në të parin dyzet trupa, në të dytin tridhjetë e katër dhe në të tretin njëzet e katër. Edhe pse gjykata nuk i ka bërë ende publike raportet e ekspertëve kriminalistë, disa nga hetuesit, në mënyrë individuale kanë folur me shtypin. John Bunn, shefi i ekipit të ekspertëve kriminalistë të Scotland Yard-it që hetoi në Krushën e Madhe, tha se viktimat në fshat ishin qëlluar nga pas kokës nga një distancë e afërt.[30] Duke treguar dhomën e një shtëpie të djegur në Krushë të Madhe, Sue Black, një antropologe skoceze që punonte me të njëjtin ekip kriminalistësh, tha, "Ata i grumbulluan njerëzit atje, i qëlluan dhe më pas i vunë zjarrin ndërtesës."[31]

Siç është thënë edhe më sipër, ekzistojnë dëshmi të pakundërshtueshme që policët serbë u orvatën t'i fshihnin gjurmët e vrasjeve, duke i djegur ose zhvendosur trupat. Fshatarët i kishin parë policët të hidhnin kufomat e të vrarëve në një lumë aty pranë. Sipas OSBE-së, KFOR-i kishte nxjerrë një kamion nga lumi, në pjesën e pasme të të cilit ishin gjetur kocka.[32]

Ceremoni mortore në Krushën e Madhe ku u vranë më shumë se nëntëdhjetë burra.

FOTO ALBAN BUJARI

Raporti i OSBE-së mbështetet edhe nga një person nga Nogavaci, R. E., i cili kishte ndihmuar në varrosjen e shumë prej të vrarëve në Krushën e Madhe. Ai i tha Human Rights Watch se kishte parë policët serbë duke zhvendosur disa nga trupat:

> Katër ditë pas vrasjeve, policët serbë arritën me buldozerë, një kamion dhe disa automjete ushtarake. Ata i mblodhën kufomat dhe i çuan s'di se ku. Nuk qemë në gjendje t'i filmonim. Nuk kemi as idenë më të vogël se çfarë bënë me trupat.[33]

Sipas dëshmitarëve në Krushën e Madhe që folën me Human Rights Watch, më 26 mars forcat e sigurimit rrethuan të gjithë burrat, gratë e fëmijët që kishin mbetur në fshat, si dhe ata që i kishin kapur të fshehur në rrethina. Gratë i çuan në xhami, ndërsa meshkujt i ndanë në grupe. S. G. një nëntëmbëdhjetë vjeçar nga Krusha e Madhe, i kallzoi Human Rights Watch atë çka kish parë pasi forcat e sigurimit kishin hyrë në fshat:

> Ata i ndanë burrat nga gratë dhe i futën burrat në oborrin e një shtëpie. I rrahën burrat, edhe mua po ashtu. Në krye ata vranë dy djem, pastaj nisën të sjellin të tjerë në grupe të vegjël, për të na vrarë. Por, të moshuarit dhe tepër të rinjtë i lanë të lirë të shkonin. Unë mbijetova ngaqë kur më pyetën se sa vjeç isha, iu përgjigja gjashtëmbëdhjetë vjeç. Kësisoj, ata më lanë të largohesha me grupin e të moshuarve dhe të rinjve.[34]

Një burrë, R. D. që ishte larguar në kodra kur nisi mësymja, tha se forcat e sigurimit i kishin ndarë meshkujt në tri grupe. Ndërkohë që ishte duke u fshehur, ai nuk i pa ndarjet, por në harkun kohor të katër ditëve ai gjeti njëzet e pesë trupa në pjesë të ndryshme të fshatit, pesë prej të cilëve ishin djegur.[35]

Sipas R. D.-së, grupi i parë u dërgua në Nogavac, grupi i dytë në xhaminë e Krushës së Madhe dhe grupi i tretë në këmbët e kodrës jashtë fshatit. Ai tha se, nga tetëmbëdhjetë vetë që kishte grupi, pesëmbëdhjetë ishin vrarë. Ai nuk i kishte parë kur ishin ekzekutuar, por kishte gjetur trupat në rrethinat e fshatit dhe, më pas, pati ndihmuar në varrimin e tyre. Ndër të vrarët, th ai, ishin edhe Fahri Hoti (rreth tridhjetë vjeç), Asaf Hoti (rreth njëzet e

Unë mbijetova ngaqë kur më pyetën se sa vjeç isha, iu përgjigja gjashtëmbëdhjetë vjeç.

gjashtë vjeç), Plahe Hoti (rreth tridhjetë vjeç), Bajram Duraku (rreth njëzet e tetë vjeç), si dhe dy pjesëtarë të tjerë të familjes Duraku, të paidentifikuar.

R. D. tha se, në xhami ishin gjetur gjithashtu të vdekur, dy viktima të tjera. Këtë thënie do ta konfirmonte një tjetër banor i Krushës së Madhe, i cili ishte mbyllur në xhami tok me të tjerët dhe kish qenë i pranishëm në kohën e të shtënave. Ai i tha Human Rights Watch, se ai bashkë me dyzet burra nga fshati ishin vendosur në katin e dytë të xhamisë. Siç tha ai, atyre iu ishin grabitur të gjitha paratë, por pasi i kishin mbajtur një natë të burgosur, të nesërmen i kishin liruar. Teksa po largohej, kishte parë dy persona të vrarë. Ai i tha Human Rights Watch:

"Trupat e tyre ranë sipër meje. Gjakun e tyre e kisha në fytyrë …"

> Po bëhesha gati të dilja nga xhamia. Kishim mbërritur te dera, kur pashë se si ata shtinë mbi dy burra, jo më larg se dhjetë metra nga unë, dhe të gjithë ne dëgjuam britmat e tyre. Unë dëgjova krismat, për çdonjërin nga një krismë dhe pashë kur u shembën përtokë. Nuk e mora vesh pse i qëlluan. Por ma merr mendja, kanë kujtuar se kanë qenë të UÇK-së. Njëri nga të vrarët ishte Besalet Krasniqi (njëzet e tetë vjeç) dhe Bedri Sejfullahu (njëzet e gjashtë vjeç).[36]

Një tjetër banor i Krushës së Madhe, i tha Human Rights Watch se mbrëmjen e 25 marsit, kur filloi mësymja, ai ishte në një fushë aty pranë duke u përkujdesur për bagëtinë. Dikush i kishte thënë se fshatarët ishin duke u mbledhur për t'u mbrojtur, kësisoj ai kish ngarendur në drejtim të fshatit. Në rrugë e sipër, ai ishte qëlluar me një armë që, sipas mendimit të tij, duhej të ishte një nga ato granatëhedhëset që mbahen në sup. Ç'është e vërteta, ai ishte plagosur nga një sharapnel në këmbë dhe në mollaqen e djathtë – të gjitha këto të vërejtura nga Human Rights Watch në Shqipëri, tetë ditë pas kryerjes së sulmit.

Personi në fjalë ishte fshehur në një shtëpi sa për të kaluar natën, bashkë me katër bashkëfshatarë. Të nesërmen, më 26 mars, të pesë burrat ishin kapur nga policia dhe ishin çuar në qendër të fshatit, ku ndodhej edhe pjesa më e madhe e fshatarëve të tjerë. Sipas dëshmitarit, forcat e sigurimit hoqën mënjanë dyzet burra dhe hapën zjarr mbi ta me armë automatike. "Ata shtinë mbi ta me automatikë, ja kështu," i tha ai, Human Rights Watch, duke shkërbyer të shtënurit me automatik. "Gjithçka ndodhi para syve të mi."[37]

Një tjetër person nga Krusha e Madhe, të cilit i ishin vrarë dy vëllezër, i tha Human Rights Watch se, shtatëmbëdhjetë burra ishin vrarë dhe djegur, ndonëse ai nuk kishte qenë i pranishëm kur ishin kryer vrasjet. Nuk është e qartë nëse këta shtatëmbëdhjetë burra bënin pjesë në grupin e dyzetë të vrarëve të përmendur më sipër. I njëjti person i tha Human Rights Watch se, kishte një të mbijetuar, S. H.

S. H. ishte portretizuar në një film dokumentar për Kosovën të prodhuar nga programi televiziv britanik Panorama, i titulluar "Vrasjet në Kosovë". Në film, i mbijetuari shfaqet i shtrirë në shtratin e një spitali, teksa ka të fashuar pjesën më të madhe të trupit, duke përfshirë edhe kryet. Ai është djegur keqazi, por në gjendje të kallzojë atë çka i kish ngjarë në Krushën e Madhe:

> Ata hapën zjarr mbi ne kallashnikov. Me të dëgjuar të shtënat, unë rashë përdhe. Të tjerët u vranë të gjithë. Trupat e tyre ranë sipër meje. Gjakun e tyre e kisha në fytyrë … Një polic tjetër solli vajgurin. Ata e rrëkëllyen mbi trupat e të vdekurve dhe i vunë zjarrin. Paskëtaj, i thashë vetes se duhej të veproja sa më parë, përndryshe do të digjesha i gjallë.[38]

S. H. i shpëtoi flakëve dhe ia doli të largohej nga Kosova e të mbërrinte në Shqipëri.

Dëshmi të vrasjeve në Krushën e Madhe do të ofronte gjithashtu edhe një inxhnier ujrash nga ato anë, i quajtur Milaim Bellanica, i cili kishte pasë filmuar disa prej të vrarëve në fshat, në datën 1 prill, dhe më pas arriti ta nxirrte videokasetën nga Kosova, duke e fshehur atë nën një traktor. Filmi që do të shfaqej nga BBC, më 4 prill, u shkurtua gjatë montazhit, për shkak të pamjeve të rënda që përmbante. Në të shfaqeshin të vrarë me petka civile, të cilët, dukej qartë që ishin qëlluar në kokë ose nën nofull. Në dokumentarin e Panorama-s, Bellanica shprehej se kishte parë gjashtëdhjetë e katër kufoma në Krushën e Madhe, nga të cilët ai ishte në gjendje të identifikonte me emër njëzet e gjashtë prej tyre.

Qeveria jugosllave e denoncoi filmin dhe akuzat për masakrën e kryer në Krushë të Madhe, i quajti "një bombë të re propagandistike" nga Perëndimi, i cili ishte duke përdorur "një skenar të dalëboje të hartuar nga gënjeshtarë të përbindshëm dhe autorë akuzash të neveritshme."[39]

Krusha e Vogël

Të dhënat e shtypit dhe raporti i OSBE-së mbi Kosovën, si dhe dëshmi jo të drejtpërdrejta që ka siguruar Human Rights Watch, na ofrojnë disa hollësi rreth vrasjeve të kryera në Krushën e Vogël. Sipas të dhënave, më 26 mars, përafërsisht njëqind burra u kapën në pyjet jashtë fshatit dhe pasi i shtrënguan t'i mbanin duart lart, i futën në një plevicë. Paskëtaj mbi ta do të shtihej me armë automatike, trupat do të mbuloheshin me kashtë dhe paskësaj do t'u vihej zjarri.

Human Rights Watch intervistoi një banor të Nogavacit, i cili tha se dy të mbijetuar nga masakra e Krushës së Vogël, kishin qëndruar në shtëpinë e tij për afro një javë, fare pak ditë pasi ishte kryer ploja. R. E. tha:

> Dy të mbijetuar nga masakra pranë Krushës së Vogël, jetuan këtu në shtëpinë time për shtatë ditë me radhë. Rreth njëqind djem të rinj u vranë. Këto vrasje nuk u kryen nga po ata serbë që vranë edhe në Krushën e Madhe. Njërit prej të mbijetuarve ia kam harruar emrin, ndërsa tjetri quhet P. R. I pari e kishte fytyrën të djegur.
>
> P. R. më tha se, serbët i kishin burrat nga gratë dhe meshkujt i kishin futur në një shtëpi njëkatëshe, gjysma e së cilës ishte e mbushur me kashtë. Në krye ata shtinë me breshëri automatiku dhe kur menduan se i kishin vrarë të gjithë, i kallën zjarrin shtëpisë. Ata të dy kishin qenë me fat, ngaqë iu kishin rënë përsipër trupat e të vrarëve. P. R. kishte shpëtuar pa u lënduar, ndërsa vëllai i tij kishte mbetur i vrarë. Po kështu edhe një kushëri i tij ishte vrarë, teksa u orvat t'ia mbathte. Shtëpisë nuk i kishte mbetur as nami as nishani.
>
> P. R. mbërriti në shtëpinë time të premten, në orën 4 pasdite. Ai ishte gati pa ndjenja, çapitej si i shushatur, në një gjendje të plotë shock-u. Kishte të shkrumbëzuar një pjesë të flokëve, por fizikisht ai ishte përbukuri. Ai tha se, në fshatin e tij, shqiptarët dhe serbët ishin mësuar të bashkëjetonin. Sipas tij ploja ishte kryer nga fqinjë të armatosur; ai kishte shquar disa prej tyre nga zëri. Në Krushën e Madhe, kishin qenë të pranishëm ushtarët e Arkanit.
>
> I mbijetuari tjetër, miku i P. R.-së, mbërriti pas dy ditësh. S'patëm kohë të ktheheshim në Krushën e Vogël për të varrosur kufomat, ngaqë do të shtrëngoheshim sërish nga serbët të braktisnim shtëpitë tona. [40]

Sipas një artikulli të gazetës londineze *Observer*, të shkruar nga John

Sweeney, tetë burra kishin mbijetuar pas masakrës në Krushën e Vogël dhe qenë përpjekur të largoheshin prej andej.[41] Artikulli, prej të cilit më pas do të xhirohej një dokumentar televiziv, ndër të tjera, thoshte se të mbijetuarit kishin njohur disa prej fqinjëve të tyre serbë në radhët e vrasësve.

Më 3 prill 1999, CNN përcolli një intervistë me një person që kish mbijetuar pas ekzekutimve, i quajtur M. K. Me duart e fashuara dhe fytyrën gjithë blana nga të djegurat, ai tha para kamerës, "Ata rrethuan të gjithë fshatarët. Më pas ndanë burrat nga gratë. Grave iu thanë, "Ju mund të drejtoheni për në kufi … Neve, burrat, na futën në dy oda të mëdhaja dhe aty nisën të shtijnë. Ata na thanë, "Dhe tani, veç NATO-ja mund t'ju shpëtojë."[42]

M. K. tha se, forcat serbe i mbuluan trupat me kashtë dhe më pas iu vunë zjarrin. Ai ia mbathi, kur ata dolën për të marrë sërish gazolinë dhe, ia doli të mbërrijë në Shqipëri, ku do të intervistohej nga CNN.

Në një artikull të paradokohshëm rreth ngjarjeve në Krushën e Vogël, po nga Sweeney, autori paraqet një tjetër dëshmitar, që mëton të ketë parë më 27 mars, trupat serbe të kenë djegur pesëmbëdhjetë a njëzet kufoma në Krushën e Vogël dhe më pas t'i hidhnin në lumin Drin. Gjithsesi ka të ngjarë të bëhet fjalë për një incident të përmendur edhe më parë, i cili ka të bëjë me Krushën e Madhe. Dëshmitari i tha Sweeney-it se, ndërkohë që rrinte i fshehur në pyllishtën pranë lumit ai i kishte parë "serbët të shtinin diçka të lëngët në pjesën e mbrapme të një kamioni. Sikur të donin të digjnin thjesht kamionin dhe kaq, nuk do të kishte qenë e nevojshme të vepronin kësisoj. Sakaq kamioni mori zjarr. Dhe u dogj përgjatë gjithë natës. Sikur kamioni të kishte qenë i zbrazët, nuk do t'i duhej kaq kohë për t'u djegur."[43]

Xërxe

Xërxe është një fshat i vogël, si dhe një nyje strategjike në rrugën Prizren-Gjakovë dhe rrugës për në Rahovec. Para luftës, fshati kishte rreth shtatë familje serbe. Rajoni i policisë ishte përgjegjës dhe mbulonte edhe disa fshatra përqark, duke përfshirë Bellaçerkën, Celinën, Krushën e Madhe, Nogavacin, Potocanin dhe Sapniqin. Me përjashtim të një rasti të njohur, pas të gjitha gjasave, policia dhe ushtria serbe nuk do t'iu krijonte andralla shqiptarëve etnikë të fshatit javën e fundit të marsit e përgjatë prillit dhe vetëm një pjesë fare e vogël e fshatit do të dëmtohej. Krejt ndryshe do të ndodhte me fshatarët e tjerë të zonës rreth e qark, fjala vjen të

Bellaçerkës, të cilët u dërguan në Xërxe dhe u lejuan të mblidheshin atje (shih kreun mbi Bellaçerkën). Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s, shqiptarët drejtonin një pjesë të rëndësishme të dyqaneve të fshatit dhe atyre nuk iu ndalohej t'iu jepnin ushqime dhe ujë mijëra shqiptarëve të zhvendosur, të cilët kalonin përmes Xërxes rrugës për në Shqipëri. Disa prej refugjatëve në Shqipëri, i thanë Human Rights Watch se fshatarët e Xërxes i kishin ndihmuar në kohën e dëbimit të tyre.

Por më 4 maj dhe në ditët në vijim, fshatarët dhe shqiptarë të tjerë të shpërngulur në Xerxe në kërkim të një vendi ku të fusnin kryet, do të përziheshin me dhunë. Në rrugë e sipër, disa prej tyre do të plaçkiteshin ose do t'iu griseshin letërnjoftimet.

Pranë Xërxes, policia dhe ushtria kishin ngritur një postbllok, ndoshta për të kontrolluar me dhjetëra e mijëra shqiptarë etnikë, që po syrgjynoseshin drejt Shqipërisë. Dëshmitarë nga Mitrovica, Peja dhe vende të tjera të Kosovës raportonin për keqtrajtime, ngandonjëherë edhe vrasje, që ndodhnin në postbllokun e sipërpërmendur. Pasi hynë në Kosovë, në qershor të vitit 1999, ekipet e ekspertëve kriminalistë të GJNKLJ zhvarrosën tetëmbëdhjetë kufoma në rrethinat e fshatit.

Ushtria dhe policia mbërritën në Xërxe më 25 mars, një ditë pasi kishin nisur bombardimet e NATO-s. Ata shkuan e zunë ngrehinën e një hambari gruri, prej ku zotëronin një fushëpamje të gjerë për nga jugu, në drejtim të luginës që të shpie në Krushën e Madhe. Snajperët e vendosur në majë të ashensorëve mbartës të grurit, konsideroheshin si një rrezik real nga banorët e zonës dhe, sipas tyre, një person ishte vrarë, ndonëse vdekja e tij mbetet e pakonfirmuar.

Fshatarët thanë gjithashtu se, gjatë kohës së qëndrimit në atë vend, policët kishin vjedhur lopë e qingja për t'i ngrënë, si dhe një numër veturash e kamionësh nga banorët e fshatit. Po ashtu, policët shpesh iu kishin vënë gjoba shqiptarëve për kalimin nëpër rrugët e asaj zone. Sipas dëshmive të ndryshme, magazina e drithit ishte shndërruar në vendgrumbullimi të mallrave të plaçkitura. Fshatarët thanë se, ata i kishin parë policët duke mbartur në magazinë sende të çmuara, si aparate televizivë dhe antena satelitore, për t'i transportuar më pas me kamionët e vjedhur.

Në pjesën më të madhe, policët abuzues nuk ishin të atyre anëve. Fshatarët e Xërxes thanë se, policët lokalë të drejtuar nga një person i quajtur Zvonko, nuk ishin të dhunshëm, madje ngandonjëherë ata i kishin ndihmuar dhe mbrojtur shqiptarët e asaj zone nga policët e tjerë dhe

trupat paraushtarake, që kishin ardhur nga pjesë të ndryshme të Serbisë. Një burrë do të pohonte se, një muaj para se të nisnin bombardimet e NATO-s, Zvonko e kishte ndihmuar të lirohej nga një marrje në pyetje në rajonin e policisë.[44] Një grua tha se, gjatë kohës së bombardimeve, policia lokale kishte qenë "jashtëzakonisht e gjindur". Ajo vijoi:

> Ç'është e vërteta, policët e rregullt na kishin ndihmuar, por kur erdhën policët e tjerë, ata të policisë lokale na thanë se s'mund të na ndihmonin dot më … Policët e rregullt s'e kishin zakon të vinin gjoba, kurse ata të tjerët na gjobisnin sa herë që kalonim nga rruga kryesore. Ata (policët e rregullt) na kishin ardhur në ndihmë në sa e sa raste, për t'iu shtëmëngur ekzekutimeve nga policët dhe ushtarët e ardhur.[45]

Më 4 maj, policia dhe ushtarët nisën të shkojnë derë më derë, në të gjitha shtëpitë e ndodhura në skajet e fshatit dhe të bastisin banorët shqiptarë. Fshatarëve iu dha një orë kohë për të mbledhur plaçkat dhe të merrnin në drejtim të Shqipërisë, gjë që ata do ta bënin të gjithë. Gjatë gjitha kësaj kohe nuk u raportua për asnjë rast që të qe përdorur dhunë.[46]

I vetmi rast serioz dhune i ushtruar në Xërxe para se të nisnin dëbimet do të ishte përdhunimi i një banoreje të fshatit, në datën 5 prill. Human Rights Watch intervistoi dy persona, të cilët dëshmuan se mbi një grua njëzet e dy vjeçare, emri i së cilës nuk u bë i ditur, do të ushtrohej dhunë seksuale nga serbë të panjohur. Një burrë që prejardhjen e kishte nga Bellaçerkë, por që kish qëndruar në Xërxe gjatë kohës së luftës, i tha Human Rights Watch se, ai kishte parë kur një "kapiten i ushtrisë" kishte marrë gruan, e cila ishte një e afërmja e tij. Megjithatë nuk është e qartë nëse fajtori i përkiste ushtrisë, policisë apo trupave paraushtarake.

E ndukën nga leshrat dhe i vunë grykën e pushkës në kokë. Burrit i thanë që tashmë ajo ishte e tyrja.

> Ajo (viktima e supozuar) është njëzet e dy dhe shumë e hijshme. Kapiteni i ushtrisë tha: "Kjo femër nuk ju përket më juve." Ishte mëngjesi i datës 5 prill. Ata hynë në shtëpi dhe e rrëmbyen. E ndukën nga leshrat dhe i vunë grykën e pushkës në kokë. Burrit i thanë që tashmë ajo ishte e tyrja. Një i moshuar (pa emër) shkoi në shtëpinë ku ndodheshin ushtarët për t'u përpjekur ta merrte me vete, por do t'i duhej më shumë se një orë.

> Kur u kthye në shtëpi, ajo ishte jashtëzakonisht e traumatizuar. I ra të fikët dhe nuk i pushonin lotët. Edhe sot e kësaj dite është e sëmurë. Tha se policët e kishin kanosur. Ata i kishin thënë se gratë shqiptare janë të forta – aq të forta sa mund të bëjnë seks me gjithë ushtrinë serbe. I qe dashur të duronte gjithfarësoj fyerjesh. Ishte aq e shock-uar sa s'donte kurrsesi të fliste për atë çka i kish ndodhur. Kishim frikë se mos e patën përdhunuar, por kur e pyetëm, ajo u përgjigj, jo."[47]

Në një intervistë më vete, një grua nga fshati Bellaçerkë që kish pasë qenë strehuar në të njëjtën shtëpi në Xërxe, do të fliste për përdhunimin e supozuar të të njëjtit person, duke pohuar se, pas dhunës së ushtruar mbi të, gruaja kish dashur të vriste veten. Dëshmitarja tha:

> Në Xërxe, serbët rrëmbyen një grua, i vunë thikën në fyt dhe e morën e mbajtën për një orë. Emri i saj është (ashtu si dhe për dëshmitaren mësipër, emri i saj nuk jepet për ta mbrojtur viktimën). Ajo është e gjatë dhe tepër e pashme. Ajo iu tha grave të tjera se ishte përdhunuar. Ajo thoshte vazhdimisht se dontë vriste vetveten. Ishte e martuar dhe serbët e kishin zgjedhur në sytë e të shoqit. Ata i kishin drejtuar një thikë, qenë rrekur ta puthnin, ndërkohë që ajo ishte munduar t'iu shpëtonte nga duart. Serbët kishin thënë, "po lëvizi kush, do t'ju vrasim të gjithëve". Kurrkujt s'ia mbajti të lëvizte nga vendi. Na u desh të ngrinim duart lart. Ajo ishte gruaja më e bukur në të gjithë krahinën …
>
> Kur u kthye ishte në gjendje shock-u, qante e qante, pa pushuar. Ajo dëshironte të vriste veten duke futur gishtat në portollambë. Nuk kish fuqi as të fliste. S'mund ta linim as edhe një çast vetëm, nga frika se mund t'ia hiqte vetes. Qau për orë të tëra dhe shkulte leshrat. Atë mbrëmje i tha vjehrrës që e kishin përdhunuar. E gjithë kjo ndodhi të mërkurën, pak a shumë, këtu e një javë të shkuar.[48]

13

KOMUNA E SUHAREKËS

Qyteti i Suharekës me afro 10.000 banorë (90 përqind e tyre shqiptarë etnikë), si dhe fshatrat rreth e qark, do të ishin vazhdimisht zonë konflikti përgjatë viteve 1998 dhe 1999. Prania e UÇK-së në kodrat përqark qytetit, do ta shndërronte mbarë rajoninnë një objektiv të rregullt të aksioneve të policisë dhe ushtrisë. Shumë prej fshatrave do të pësonin viktima në njerëz, ndërsa pronat e civilëve të ndryshëm do të shkatërroheshin nga duart e policisë, qysh para ndërhyrjes së NATO-s.[1]

Në kohën e bombardimeve të NATO-s, pjesa më e madhe e abuzimeve në Suharekë ndodhën javën e parë, kur shumë nga banorët u dëbuan dhe u kryen një sërë vrasjesh, siç është pasqyruar në kreun e Analizave Statistikore të Dhunimeve. Mijëra njerëz do të dëboheshin në Shqipëri, një pjesë me autobuzë, ose do të largoheshin në zonat aty pranë të kontrolluara nga UÇK-ja, si Gjinoci dhe Budakova. [2] Plaçkitja dhe djegia e pronës private të civilëve do të ishte një dukuri tejet e përhapur.

Ish-punonjës të OSBE-së, si dhe të gjithë ata që iu kishin lëshuar shtëpitë me qira OSBE-së, do të ndiheshin veçanërisht të kanosur. Incidenti më i rëndë do të ishte vrasja në qytetin e Suharekës e të paktën njëzet e katër anëtarëve të familjes së gjerë Berisha, duke përfshirë këtu edhe njëmbëdhjetë fëmijë nga mosha gjashtëmbëdhjetë vjeç e poshtë, për shkak se i kishin dhënë dy shtëpi me qira OSBE-së. Në fshatin Tërnje, gjashtë kilometra në jugperëndim të Suharekës, do të gjenin vdekjen të paktën njëzet e katër persona, duke përfshirë edhe shtatë fëmijë të moshës pesëmbëdhjetë vjeç, madje edhe më të vegjël.

Duke iu referuar zyrës së Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, në Suharekë, gjatë kohës së bombardimeve, në komunën e Suharekës u vranë 430 vetë, ndërsa gjashtëdhjetë e shtatë janë zhdukur dhe nuk gjenden


Në vitin 1989 komuna e Milishevës u shpërbë. Njësitë e saj teritoriale u përfshinë në komunat e Suharekës, Rrahovecit, Gllogofcit dhe Klinës. Në prill të vitit 2000 komuna e Malishevës rifitoi statusin e saj të mëparshëm.
Gllogofc
Malisheve
Shtime
Rrahovec
Suhareke
Prizren
Shterpce
VERIU
Malisheve
Bellanice
Pagarushe
Rrahovec
Reqan
Recan
Suhareke
Terrnje
Topiluga
Prizren
JUGOSLLAVI
KOSOVA
Suhareke
SHQIPERI
MAQEDONI
0 km 5
Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

qysh nga fundi i muajit gusht të vitit 1999.[3] Haki Gashi, kryetari i bashkisë i emëruar nga UÇK-ja pas luftës, tha se, 427 njerëz janë vrarë në komunë, ndonëse rreth tetëdhjetë prej tyre kanë qenë luftëtarë të UÇK-së.[4]

Human Rights Watch nuk i konfirmon këto shifra dhe kërkon të sqarojë nëse numri i luftëtarëve të UÇK-së të vrarë në luftime është ndarë nga ai i atyre të ekzekutuar pa gjyq (kjo e fundit përbën krim lufte njëlloj si vrasja e qëllimtë e civilëve.) Përveç dyzet vrasjeve të kryera në qytetin e Suharekës, të dokumentuara në këtë kapitull (të gjitha të kryera më 25 dhe 26 mars), Human Rights Watch konfirmon vrasjen e paramenduar të njëmbëdhjetë civilëve meshkuj dhe përdhunimin e të paktën dy grave në një fshat (emrat e të cilave nuk do të jepen për të mbrojtur si viktimat ashtu edhe familjet e tyre), vrasjen e të paktën njëzet e katër njerëzve në fshatin Tërnje, si dhe vrasjen e të paktën dymbëdhjetë vetëve në Bellanicë, një fshat ku ishin mbledhur mijëra shqiptarë të shpërngulur. Sipas OSBE-së vrasje të tjera, por në numër më të vogël do të ndodhnin edhe në fshatrat e mëposhtme: Bukosh, Budakovë, Vraniq, Gelanc, Sopinë, Mushtishtë dhe Leshanë. [5]

Ish-punonjës të OSBE-së, si dhe të gjithë ata që iu kishin lëshuar shtëpitë me qira OSBE-së, do të ndiheshin veçanërisht të kanosur.

Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi do të hapte tri varre të përbashkët në qytetin e Suharekës, që përmbanin 103 trupa. Në të parin ndodheshin pesëdhjetë e pesë trupa, në të dytin pesëmbëdhjetë dhe në të tretin tridhjetë e tre. [6]

Duke iu referuar deklaratave të dëshmitarëve, pjesa dërrmuese e abuzimeve në komunë ishin kryer nga policia ose paraushtarakët serbë, të cilët, siç thuhej, vishnin uniforma me ngyra nga më të ndryshmet: blu, gri ose të gjelbra. Një pjesë mbanin maska të zeza, ndërsa të tjerë flokë të gjata. Një numër i madh syresh, gjithnjë sipas dëshmitarëve, kishin lidhur në krah shami të bardha. Një emër i përmendur, të paktën nga katër dëshmitarë, si prijës i trupave lokale, ishte ai i “Mishko” Nisheviq, i cili njihej fort mirë në qytetin e Suharekës si pronari i hotel “Boss”-it dhe, ç’është më e rëndësishmja, si shefi i sigurimit të shtetit për zonën. [7]

Rajoni i policisë në Suharekë ishte në vartësi të Sekretariatit për Punët e Brendshme (SUP) të komunës së Prizrenit, i cili mbulonte veç Suharekës edhe Prizrenin, Rrahovecin dhe Gorën (shih Forcat e konfliktit). Në shkurt të vitit 1998, shef i rajonit të policisë së Suharekës ishte nënkoloneli Dobrivoje Vitosheviç, ndërsa zëvendës i tij ishte nëntogeri Radojko Repanoviç. [8]

Interesant është fakti se, pas valës së parë të dëbimeve të shqiptarëve nga Suhareka nga fundi i marsit, në përgjithësi policia do t'i lejonte shqiptarët të qëndronin në qytet. Madje asokohe do të kishte edhe një përpjekje për regjistrimin e popullsisë, kësodore burrat ishin të detyruar të paraqiteshin në rajonin e policisë çdo ditë.

QYTETI I SUHAREKËS

Prania e OSBE-së në Suharekë (nga nëntor 1998 deri në mars 1999), ndihmoi për krijimin e një klime sigurie për shqiptarët etnikë, si brenda ashtu dhe rreth e qark qytetit. Siç edhe pritej, abuzimet u rritën rreth 20 marsit, në kohën kur OSBE-ja u tërhoq nga Kosova. Sakaq midis trupave të policisë dhe UÇK-së do të ndodhnin një sërë përplasjesh në fshatrat përqark Suharekës dhe, për rrjedhojë, policia serbe do të rrihte e keqtrajtonte një numër shqiptarësh etnikë, banorë të atyre anëve. Tensioni do të rritej veçmas më 22 mars, kur të paktën shtatë shqiptarë etnikë u vranë nga policia ose "u zhdukën pa lënë gjurmë" në rrethana krejtësisht të paqarta.

Dhuna do të bëhej edhe më shqetësuese, fill pas rënies së bombave të para të NATO-s, më 24 mars. Sipas dëshmitarëve, trupat e policisë dhe paraushtarakët zunë pozicione rreth e qark qytetit dhe në mënyrë sistematike zunë t'i shtrëngojnë banorët që të largoheshin. Policët kishin organizuar autobuzë për mbartjen e njerëzve në kufi me Shqipërinë. Një banor i Suharekës, me profesion gazetar i tha Human Rights Watch:

> Më 25 mars, pasi kishin rënë bombat e para, në mëngjes herët dëgjuam të shtëna armësh dhe të shtëna prej një automjeti të koracuar që vinin nga lagja Berishë. Atëkohë mësuam edhe lajmin që ata i kishin masakruar (familjen Berisha), ndërkohë që një pjesë e familjes kishte qenë ende në gjumë. Midis popullsisë kishte pllakosur paniku dhe (qarkullonte një thashethem) një pjesë e qytetit do të shpërngulej në anën tjetër, në krahun tjetër të rrugës. Ne qëndruam dy ditë dhe unë pashë zjarr e tym. Madje pamë të dilte zjarr e tym nga fabrika e kauçukut Ballkan. Menduam se ata duhej të digjnin njerëz në atë vend, për shkak të erës së rëndë që vinte.
>
> Dy ditë më vonë, më 27 mars, paraushtarakë serbë erdhën në anën

tjetër të qytetit, duke kërkuar njerëz me emër, si dhe i vunë zjarrin disa shtëpive ku kish pasë qëndruar OSBE-ja. Popullsisë i hyri data. Në çdo shtëpi kishte rreth njëqind njerëz. Kur ata na u afruan dhe nuk ishin më shumë se njëzet-tridhjetë metra larg nesh, unë thashë: "Ejani të dalim dhe të ikim nga ky qytet."

Incidenti më i rëndë do të prekte familjet e Nexhat dhe Faton Berishës, të cilët i kishin dhënë me qira OSBE-së, shtëpitë e tyre që ndodheshin përbri njëra-tjetrës. Një numër që luhatet ndërmjet njëzet e katër dhe dyzet e dy njerëz nga familja Berisha u vranë, gjashtë prej tyre para shtëpive, ndërsa të tjerët në një qendër tregtare në qendër të qytetit. Vetëm dy gra dhe një foshnjë e seksit mashkull, arritën të mbijetojnë.

Sipas një anëtari të familjes që jetonte në derën ngjitur dhe pa me sytë e tij ngjarjen, policët mbërritën për të parën herë, rreth orës 5 të mëngjesit, të datës 25 mars dhe i kërkuan para Nexhat dhe Faton Berishës. Policët e rrahën Nexhatin dhe morën të gjitha pajisjet që mund të kishte lënë OSBE-ja. Dëshmitari tha se kishte njohur njërin nga policët, të cilin e identifikoi me emrin Miki Petroviç, vëllai i Zoran Petroviçit, i cili, sipas një dëshmitari tjetër, ishte parë në atë zonë. Dëshmitari përshkroi se si forcat e policisë erdhën përsëri, të nesërmen, dhe vranë anëtarët e tjerë të familjes:

Një numër që luhatet ndërmjet njëzet e katër dhe dyzet e dy njerëz nga familja Berisha u vranë.

Në orën 12 të drekës, i behu një tjetër grup policësh, rreth njëzet a tridhjetë dhe rrethuan të dyja shtëpitë (atë të Nexhatit dhe Fatonit). Ne lidheshim me ta përmes telefonit. Të dy familjet ishin mbledhur në shtëpinë e Fatonit, natën e njëzet pesës duke u gdhirë njëzet e gjashtë. Ata erdhën, trokitën dhe i nxorën të gjithë jashtë. Unë i shihja nga dritarja. Gratë dhe fëmijët kaluan nga shtëpia jonë, të tjerët shkuan pranë shtëpisë së Nexhatit. Në një çast, ata zunë të thërrasin burrat – Sedat, Bujar, Nexhat, Nexhmedin, Faton dhe Fatime, nënën e Fatonit. Pa kurrfarë shenje, ata nisën të shtinë mbi ta, duke vjellë zjarr nga armët automatike. Disa persona hynë në shtëpitë dhe iu vunë zjarrin. Përsëri do të shquaja Miki Petroviçin, por jo ndonjë tjetër. U tërbova kur vura re se si ata kishin vrarë njerëzit e familjes sime. Të tjerët ia krisën vrapit në drejtim të qendrës tregtare. Paskëtaj s'mora vesh gjë për fatin e pjesës tjetër familjes, dëgjova vetëm të shtëna të shumta.

Ata kishin veshur uniforma të reja policie, në krah kishin lidhur shami të bardha dhe kishin rruar kokat. Unë nuk e pashë Zoran Petroviçin, por Flaka[9] tha se ajo e kishte parë atë. Shtëpia e Fatonit dhe e Nexhatit u dogj; ajo nuk është veçse dy-tri metra larg shtëpisë sime. U tremba se mos flakët rroknin edhe shtëpinë time. Po mendoja të dilja, por e dija që snajperët ishin në pritje. Atë çast dëgjova të shtëna të shumta dhe gjithandej kishte zjarr, por nuk po e merrja vesh se çfarë po ndodhte. Tok me gjashtë fëmijët shkuam në banjë, aty iu futëm shami në gojë, nga frika se mos na dëgjonin serbët. Policët i kishin marrë trupat e gjashtë të vrarëve dhe i kishin shpënë mbrapa shtëpisë së Nexhatit, por kur çatia mori zjarr e filloi të bjerë copa-copa, kufomat u dogjën. Flaka do të vazhdonte der në mbrëmje. Si doktor që jam,[10] s'më besohej që trupat të mund të digjeshin kaq gjatë. Qëndrova në shtëpi deri pas orës gjashtë të pasdites, kur policët erdhën në shtëpi dhe donin ta digjnin. Ata ishin në grupe të përbërë nga tri vetë dhe shkonin nga njëra shtëpi në tjetrën. Ata hapën portën, nuk e dinin që ne ishim në shtëpi, kështu që shkova dhe iu hapa derën. Në krye, ai desh të më qëllonte sakaq, por unë i fola serbisht. Im vëlla iu dha 1000 marka gjermane e kësisoj na liruan. Morëm veturat dhe shkuam të gjithë sa ishim në Shqipëri; pesë të rritur dhe gjashtë fëmijë.

Kur mbërrita në Shqipëri mora vesh që edhe pjesa tjetër e familjes ishte vrarë, siç më tha Flaka. Ata i kishin futur të gjithë në një kafene të qendrës tregtare. Aty ndodhej familja e djemve të xhaxhait tim, si dhe tri familje të tjera. Pjesëtarët e këtyre familjeve i kishin braktisur shtëpitë nga frika dhe kishin dashur të shkonin në anën tjetër të qytetit, duke kaluar nga qendra tregtare. Serbët i kishin kapur dhe futur në kafene. Në krye ata kishin flakur disa granata brenda në kafene dhe, më pas, njerëzit që kishin mbetur ende gjallë i patën vrarë me armë zjarri. Flaka, Mirela dhe Arbeni[11] edhe pse të plagosur kishin arritur të mbijetonin. Paskëtaj, ata sollën një kamion dhe i ngarkuan të gjithë në të dhe morën në drejtim të Prizrenit. Njerëzit që kishin parë kamionin thanë se prej tij pikonte gjak në rrugë. Flaka, Mirela dhe Arbeni ishin hedhur nga kamioni, diku afër Ljutogllvaës. Njerëzit e atjeshëm i kishin çuar te doktori i UÇK-së. Kësisoj, për gjysmë ore ishin vrarë dyzet e tetë njerëz gjithsejt.[12]

Raporti i OSBE-së për Kosovën përfshin informacione të ofruara nga një

prej të mbijetuarve, Flaka. Ajo tha se më 21 mars, policia kishte marrë në pyetje burrin e saj dhe e kish pyetur, përse e kishte lejuar OSBE-në të qëndronte në shtëpinë e tij. Më 25 mars, sipas fjalëve të dëshmitares së sipërpërmendur, trupat e policisë kontrolluan shtëpinë e saj, rreth orës 5 të mëngjesit. Ata e rrahën të shoqin të saj deri sa e lanë pa ndjenja (dëshmitarja nuk kishte mundur ta shihte këtë skenë) dhe plaçkitën gjithë sendet e vlefshme që kishin pasë lënë njerëzit e OSBE-së.

Sipas dëshmisë së saj të pasqyruar në raportin e OSBE-së, policia u kthye sërish më 26 mars. Ajo shpjegonte se si e qysh, pasi ekzekutimit të të afërmve të saj para shtëpisë, ajo vetë dhe një grup pjesëtarësh të familjes të palënduar, ishin shpënë në anën tjetër të qytetit, ku më pas ishin shtrënguar të hynin në një kafene. Duke cituar dëshminë e saj, raporti vijon si më poshtë:

> Rreth mesditës të datës 26 mars, policia erdhi sërish. Një polic që ajo e njihte (polici përmendet me emër në intervistë) thirri kunatin e saj jashtë, e qëlloi dhe e la të vdekur në vend. Policët iu hakërryen dhe kur pjesëtarët e familjes dolën me vrap nga shtëpia, panë se shtëpia e tyre ishte “”nën rrethim” nga trupat e policisë, civilë serbë dhe magjypë. Një pjesë e familjarëve u qëlluan aty për aty. E intervistuara ndodhej në një grup tjetër tok me pjesëtarë të familjes, të cilët ishin çuar në anën e kundërt të qytetit, ku i mbanin të mbyllur në një kafene.
> Ajo kishte parë me sytë e saj policët të qëllonin me automatikë dhe pushkë, njerëzit që ndodheshin në dhomë. Me vete ajo kishte edhe katër fëmijët e saj – dy vajza, njëra gjashtëmbëdhjetë e tjetra katërmbëdhjetë vjeç dhe dy djemtë, njëri dhjetë e tjetri dy vjeç – të shtrënguar rreth së ëmës. Të gjithë u vranë. Ajo u përpoq të mbronte të birin dy vjeç, duke e futur midis shalëve, por edhe atë e qëlluan dhe e vranë.[13] Edhe ajo vetë kishte marrë një plumb në bark, që kish depërtuar përmes trupit të djalit të madh. Ajo i shtiu të birit në mendje të shtirej sikur kishte vdekur, por në kohën që vrasësit po mblidhnin trupat për t’i nxjerrë jashtë, ata panë që djali merrte ende frymë dhe e qëlluan sërish. Ajo dëgjoi se si i biri klithi vetëm (një herë. Të paktën dymbëdhjetë fëmijë nën moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe dhjetë të rritur, duke përfshirë edhe një grua shtatzënë, mbetën të vrarë. E intervistuara u shti si e vdekur, ndërkohë

Na drejtuan armët në gjoks dhe na kërkuan para e florinj.

> që policia ishte duke mbledhur sendet e çmuara nga trupat e të vdekurve … Më pas, ajo ishte hedhur në një kamion, në majë të pirgut të kufomave, ku gjendeshin edhe fëmijët. Rrugës për në Prizren, ajo ishte hedhur nga kamioni dhe ishte gjetur nga njerëz, të cilët e kishin çuar në territoret e kontrolluara nga UÇK-ja, ku ishin kuruar plagët që kish marrë. Ajo do të shkonte ca kohë duke lëvizur nëpër Kosovë, për t'iu shmangur bombardimeve. Më 9 maj, u largua nga Kosova.[14]

Raporti i OSBE-së na bën me dije gjithashtu se, "rreth datës 26 mars", dy dëshmitarë panë një kamion plot me trupa njerëzish të vdekur, duke përfshirë edhe gra e fëmijë, të hynte në oborrin e shkollës së mesme, ku, më pas, trupave do t'iu vihej zjarri, megjithëse as OSBE-ja as Human Rights Watch, nuk do të konfirmonin që trupat i përkisnin familjes Berisha. Serbët, emrat e të cilëve do të regjistroheshin nga dëshmitarët, ishin parë vazhdimisht duke shkarkuar trupat nga kamioni.[15]

Më datë 25 mars ndodhën edhe vrasje të tjera në lagjen ku banonte familja Berisha. Një grua e quajtur N. E., që jetonte rreth njëqind metra larg shtëpisë së Berishajve, shpjegoi se si forcat e sigurimit hynë në shtëpinë e saj dhe ekzekutuan të birin, Fadil (njëzet e gjashtë vjeç) dhe kunatin, Medi (pesëdhjetë vjeç). N. E. tha:

> Të enjten, më 25 mars, u zgjuam më 5.10 e mëngjesit për shkak të të shtënave të armëve. Iu afruam derës dhe vumë re që ata ishin në shtëpinë e fqinjit tonë. S'shkoi shumë dhe disa prej tyre erdhën tek unë. Ne ishim shtatë vetë gjithsejt, por vetëm dy ishin meshkuj: Fadili dhe Mediu. Ata hynë brenda dhe pyetën të zotin e shtëpisë: "Ku janë fëmijët?" Pastaj zunë tim bir, Fadilin dhe vëllain e tim shoqi, Mediun dhe zunë t'i kontrollonin. Na drejtuan armët në gjoks dhe na kërkuan para e florinj. Iu dhamë gjithë ç'kishim. Ata e hoqën Mediun, jurist me profesion, mënjanë, në dhomën tjetër dhe e pyetën për diçka. Më pas e sollën dhe morën e futën në një dhomë tjetër Mediun dhe Fadilin. Ata zunë të shtinin mu te këmbët tona dhe na thanë të dilnim nga shtëpia.
>
> Ne nuk pamë kur shtinë mbi ta, por dëgjuam të shtënat kur ishim ende brenda në shtëpi. Aty kishte tetë prej tyre (policë), dy nga të cilët hynë në dhomë me njerëzit tanë. Me ne qëndruan gjashtë vetë, katër në dhomë dhe dy te dera. Ata nisën të shtijnë (mbi ne dhe ata), pothuaj në të njëjtën kohë. Ata kishin veshur uniforma kamuflazhi të gjelbra,

shami të bardha dhe kama. Nuk mbanin maska. Nuk mund të them se i njoha të gjithë, por mbaj mend fort mirë njërin prej tyre, atë që urdhëronte. Ai ishte shtatshkurtër, kishte kapele të zezë, lëkurëzeshkët, disi trashaluq, nuk mbante mustaqe as mjekërr dhe duhej të ishte rreth tridhjetë e pesë, dyzet vjeç. Flisnin serbisht, por kur dolëm jashtë dhe aty zunë të na fyejnë, ngandonjëherë përdornin edhe fjalë shqiptare. As Mediu as Fadili s'kishin qenë luftëtarë të UÇK-së. Mediu kish pasë punuar në gjykatë dhe, më vonë, në fabrikën Ballkan. Fadili ishte mësues matematike.[16]

Një tjetër grua, anëtare e kësaj familjeje, që ndodhej në shtëpi në të njëjtën kohë, konfirmoi dëshminë e N. E.-së, si dhe shpjegoi se si kishin gjetur trupat e Fadilit dhe Mediut, kur u kthyen në Kosovë, në qershor. Ajo tha:

Ne i lamë Fadilin dhe Mediun e shkuam në Semetishtë, prej andej në Shqipëri. Kur u ktheva nga Shqipëria, vura re gjurmë të trupave në

Në fund të marsit, trupat policore serbe e detyruan Myrete Berishën, tridhjetë e pesë vjeç, bashkë me tre fëmijët e saj, ta linte Suharekën. Pas katër ditësh rrugë me një karvan traktorësh, ajo mbërriti shëndoshë e mirë në pikën kufitare të Morinës dhe hyri në Shqipëri. Ajo u intervistua nga Human Rights Watch, në Kukës, më 26 prill 1999:

Po mundohesha t'i fshihja tim biri atë çka po ndodhte. Kur policët nisën të shtinin, djali im u tremb për vdekje. Ai po më thoshte se, ata janë policë të këqinj. Unë i thashë, "jo, ata janë të mirë, vetëm se po orvaten të vrasin disa zogj, ngaqë zogjtë po na vjedhin drithin. Më mirë që t'i vrasin." Më duhej të sajoja për gjithçka. Kur më pyeti pse duhej të flinte me rrobat në trup – ai kishte vapë – unë i thashë, "Është më mirë kështu ngaqë mund të largohemi natën për të gjetur një shtëpi më të mirë dhe jashtë mund të bëjë ftohtë." Ai më pyeti, "E përse na duhet shtëpi më e mirë?" Dhe unë i shpjegova se na duhej një banjë më e mirë – ngaqë banjoja jonë nuk ishte dhe aq e mirë - prandaj duhej të merrnim një shtëpi më të mirë, me banjo si ajo e gjyshit. Sigurisht që tani, në kampin e refugjatëve të ngritur nga italianët ai qahet, "Pse më thoje ti që do të gjenim një shtëpi më të mirë; dua të kthehem në Suharekë; shtëpia jonë ishte më e mirë; ne s'kemi fare banjë këtu," e më the e të thashë."

> shtëpi; në dysheme kishte fijëë flokësh. Më 29 gusht, gjetëm trupin e Mediut dhe dje e varrosëm. Ndodhej në një varrezë, rrugës për në Restan. Njerëzit e KFOR-it zhvarrosën trupin e Mediut dhe të disa të tjerëve. Fadili u gjet para dy vjetësh në një varrezë, rrugës për në Peçan. [17]

Duke përshkruar një tjetër incident, një grua foli për katër policë që shkuan në shtëpinë e saj, ku shtinë mbi xhaxhain dhe, sipas të gjitha gjasave, edhe të atin e saj. Ajo i tha Human Rights Watch:

> Më 25 mars, rreth orës 7 të mëngjesit, ne ishim duke ndenjur në këtë dhomë. Bëheshim gjithsejt dhjetë vetë, por vetëm dy ishin meshkuj: im atë, Avdyli (dyzet e shtatë vjeç) dhe im ungj, Osman (dyzet e një vjeç). Në fillim, ata (serbët) po qëndronin jashtë, pranë kësaj dritareje. Më pas, ata shqyen derën, hynë brenda dhe na thanë të dilnim jashtë. Por, te pragu i derës, na ndaluan dhe pyetën në qoftë se kishte mbetur ndonjë lart. Më parë ata i kishin marrë para xhaxhit tim.
>
> Aty ishin katër serbë: i pari, brenda në shtëpi; i dyti, te dera; i treti, në oborr; dhe i katërti; te porta. Mbanin maska, kishin veshur uniforma ngjyrë gri, jo kamuflazhi, me pulla, ndërsa në krahët e zhveshur mbanin shami të bardha. Unë nuk arrita të njoh ndonjërin prej tyre. Na nxorrën jashtë, aty e hoqën mënjanë xhaxhain dhe e qëlluan në oborr. Ime motër është invalide, ndaj dhe im atë po e mbarte. Dolëm në rrugën që të shpie në Peçan. Ndërkohë ata kishin mbledhur njerëz të tjerë nga mëhalla. Pranë shkollës, na ndaluan. Nuk ishim veçse nja njëqind metra larg nga shtëpia jonë. Na rrasën të gjithëve në nëj ndërtesë (të papërfunduar) pa çati. Qëndruam atje dhe ata i thanë tim ati ta linte motrën time, Afërditën (katëmbëdhjetë vjeç) në shesh. Paskëtaj na thanë të dilnim nga godina, ndërsa tim atë e mbajtën atje. Unë dhe motra ime morëm në krahë Afërditën. Na thanë të shkonim tek UÇK-ja, kaq, s'morëm vesh gjë tjetër. S'kishim bërë as dhjetë metra, kur dëgjuam të vinin të shtëna nga ndërtesa. Na u desh të vijonim rrugën për në Peçan. Më pas gjetën trupin e xhaxhit tim në varrezën e familjes Berisha. Edhe sot e kësaj dite nuk e dimë çfarë ndodhi me babain tim.[18]

Një tjetër grua, e bija e së cilës ishte midis atyre që ishin vrarë me familjen Berisha (shih më sipër), shpjegoi se si e qysh dy pjesëtarë të

familjes së saj, njëri prej tyre me profesion mekanik që kish pasë punuar për OSBE-në, ishin vrarë nga serbët, po atë ditë:

Më 25 mars, në orën 5.45 të mëngjesit, u zgjuam nga të shtënat e armëve. Mua më doli gjumi, kurse im shoq, Raifi (pesëdhjetë e shtatë vjeç) ishte ende duke fjetur. U ngjita lart të shihja nëse kishte apo jo policë në shkollë. S'më zuri syri ndonjë prej tyre as në rrugë as në oborrin e shkollës, por gjithandej dëgjoheshin të shtëna armësh. Zbrita sërish dhe befas dëgjova që të shtënat po afroheshin. Zgjova burrin dhe folëm çfarë duhej të bënim. I propozova të ngjiteshim në papafingo, por ai ma ktheu jo, ata mund të digjnin shtëpinë. Po diskutonim nëse duhej të ngjiteshim në papafingo apo të zbrisnim në qilar.

Im shoq ishte ende duke u veshur, kur ata ia behën në oborrin e shtëpisë. Një pjesë e mirë e tyre ndodheshin në oborrin e shtëpisë sonë, ndërsa shumë të tjerë në rrugë. Rreth njëzet vetë a më shumë ndodheshin në oborr. Kishin veshur uniforma ngjyrë gri dhe mbanin shami të bardha; nuk pashë ndonjë me maskë. Ata po ulërinin dhe pyetën për të zotin e shtëpisë. Im shoq doli të fliste me ta, por ata nuk e lanë të hapte gojë. Ata e pyetën: "A keni fëmijë brenda në shtëpi?" Im shoq bërtiti në drejtimin tonë: "Dilni jashtë!" Në çastin që dola, pashë tim shoq shtrirë në shesh. Nuk e mora vesh pse. Më shpunë tek im shoq dhe i thanë atij të ngrihej. Na thanë të dyve të ngrinim duart lart. Ata nuk e lanë tim shoq të thoshte as edhe një fjalë. Na drejtuan armët dhe unë iu përgjërova të mos shtinin, ne ishim të pafajshëm.

Ata merreshin vesh me sho-shoqin nëpërmjet walkie-talkie. Na mbajtën ashtu për pesë minuta, më pas njëri prej tyre tha: "Gratë të largohen!" Unë shkova në shtëpinë e kunatit tim, Kadriut dhe, kur mbërrita atje, pashë Minën, Kadriun dhe Bardhylin (pjesëtarë të familjes) të rreshtuar dhe njëzet serbë që iu kishin drejtuar armët. Kur më panë edhe mua, serbët më thanë të futesha në rresht. Ata nuk e dinin që shokët e tyre më kishin liruar pak më parë. Mina dhe unë zumë të thërrisnim: "Mos na qëlloni!" Ndërsa Bardhyli dhe Kadriu nuk e hapën gojën. Mina donte të shpëtonte të birin, Bardhylin, ndaj dhe iu dha serbëve 1000 marka gjermane e një varëse të artë. Ajo iu tha: "Ju lutem, lëreni të lirë tim bir!"

Njëri prej tyre nisi të ulërasë se ne duhet të largoheshim. Një polic erdhi dhe na nxorri nga porta, jashtë në rrugë. Kur dolëm në rrugë,

> dëgjuam të shtënat, por nuk pamë atë që ndodhi. Ata na thanë të shkonim në Semetishtë. Flisnin vetëm serbisht. Më vonë, gjetën trupat në shtëpinë e Bardhylit.[19]

Human Rights Watch foli më vete me Bardhyl H., njëzet e gjashtë vjeç, i cili e konfirmoi rrëfimin e mësipërm. Veç kësaj, ai rrëfeu edhe historinë e vet, ku përfshihet edhe fshehja në qilar për njëzet e tetë ditë me radhë. Gjatë kësaj kohe ai kishte mbajtur një ditar:[20]

> Një ditë pasi NATO kishte nisur bombardimet, pa shkuar ora 6 e mëngjesit, ne u gjendëm të rrethuar nga policët. Ishim të gjithë duke fjetur, im atë, ime më dhe unë. Ata (forcat serbe të sigurimit) ngjitën shkallët, të tjerët qëndruan në oborr. Njëri prej tyre, që ndodhej te shkallët filloi të bërtasë: "Hajt, hapeni derën, shpejt!" Unë isha në dhomën e gjumit, që ndodhet në katin e parë, ndërsa prindërit e mi ishin në dhomën e ndenjes. Kur dola nga dhoma, pashë prindërit e mi në korridor. Ngarenda poshtë dhe hapa derën. Njëri prej tyre ishte para derës dhe na drejtoi një kalashnjikov. Dolëm jashtë me duart lart. Për njëzet minuta ata abuzuan dhe u sollën me ne, si t'u desh qejfi, duke na bërë lloj-lloj pyetjesh e shtyrë.
>
> Ne kishim dy vetura në garazh. Ata më thanë të hapja dyert dhe më morën çelsat e makinave. Ndërkohë kishin sjellë në oborrin e shtëpisë sonë xhaxhain tim bashkë me gruan, pa kaluar pesmbëdhjetë minuta (shih dëshminë e mësipërme). Neve, burrat, na hoqën mënjanë dhe grave iu thanë të largoheshin. Ime më nisi t'u lutej: "Ju përgjërohem, lereni të lirë tim bir!" Para se të kontrollonin shtëpinë, ime më iu dha para, rreth 1000 marka gjermane.
>
> Ndërkaq, ata nisën t'i shtyjnë gratë të largohen. Pasi gratë u larguan, ata na ngjitën në shtëpi dhe aty nisën të shtijnë mbi ne. Ne kërcyem në korridor dhe për fat, unë nuk isha lënduar. Bëra si bëra dhe përmes shkallëve u ngjita lart në papafingo. Si im atë ashtu edhe xhaxhai ishin goditur dhe vrarë. Kur u ngjita lart, vura re që shtëpia e xhaxhait, e cila është e lidhur me tonën, po digjej. Ndërkohë ata qëlluan edhe shtëpinë tonë që t'i vinin zjarrin edhe asaj. Qëndrova në papafingo rreth dhjetë a pesëmbëdhjetë minuta, por shtëpia kishte marrë zjarr

Mina donte të shpëtonte të birin, Bardhylin, ndaj dhe iu dha serbëve 1000 marka gjermane e një varëse të artë.

dhe po digjej, kësodore kërceva nga ballkoni në oborrin e shtëpisë së xhaxhait. Aty shkova dhe u futa në një barakë, që ende nuk ishte djegur dhe qëndrova deri në mbrëmje. Më pas, hyra në qilarin e shtëpisë, ku qëndrova për njëzet e tetë ditë me radhë. Dhjetë ditët e para ishte e vështirë të gjeja ushqim; e shtyja me sheqer dhe reçel që gjeja në shtëpi. Më pas gjeta ushqim foshnjash dhe e hëngra edhe atë. Por më vështirë ishte të gjeja ujë për të pirë. Pas dhjetë ditësh gjeta një bombolë gazi në shtëpinë e fqinjit dhe me të mund të bëja petulla, patate të skuqura etj. Për ujin, zbrisja në burim me një bidon plastik tri litërsh dhe aty e merrja ujin. Natën, ngandonjëherë dilja në oborr, por gjatë ditës ishte e pamundur sepse ishin policët nëpër rrugë. Paskëtaj, u largova dhe shkova në një vend ku kishte ende njerëz nga Suhareka.

Dhjetë ditët e para ishte e vështirë të gjeja ushqim; e shtyja me sheqer dhe reçel që gjeja në shtëpi.

Atje, në oborrin e shtëpisë (ditën e vrasjes), duhej të ishin njëzet a tridhjetë serbë, sipas të gjitha gjasave paraushtarakë. Nuk qenë policë të rregullt. Ime më tha se uniformat ishin të zeza, por për mendimin tim ishte një blu e errët. Në krah kishin shami të bardha dhe që të gjithë ishin të rinj, jo më shumë se shtatëmbëdhjetë a tetëmbëdhjetë vjeç. Nuk mbanin maska, kurrfarë shenjësh dalluese, ndërsa te shamitë s'kish asgjë të shkruar. Kurrfarë shenjash. Makinat e tyre ishin të markës Zastava. Nuk iu pashë armë të tjera përveç automatikëve. Dhe neve na drejtoheshin vetëm në serbisht.

Trupat qëndruan këtu për një kohë të gjatë, nuk di t'ju them se sa gjatë. Asnjë prej nesh nuk kish pasë qenë luftëtar i UÇK-së. Im atë ishte një burrë i qetë dhe kurrë s'i kishte bërë keq kujt.[21]

Një banor i Suharekës i kallzoi Human Rights Watch se si trupat serbe kishin vrarë të paktën dhjetë vetë në një tjetër incident të ndodhur më 25 mars. Ai tha:

Një ditë pasi kishin nisur bombardimet e NATO-s, në orën 6 të mëngjesit, paraushtarakë serbë, policë dhe serbë civilë, hynë nëpër shtëpitë e shqiptarëve. Policët shkuan derë më derë, mblodhën burrat dhe i sollën e futën në një shtëpi që nuk duhej të ishte më larg se tridhjetë metra nga shtëpia ime. Ne ia dolëm të largohemi. Kur ata iu kërkuan para

dhe florinj, Fadil Berisha iu dha 200 marka gjermane, por aq nuk mjaftonte, ndaj dhe ata e qëlluan. Ahmet Kryeziu (pesëdhjetë e katër vjeç), iu dha 500 marka, por edhe ai do të vritej nga të njëjtat armë. Abdullah Elshani (rreth dyzet e dy vjeç) dhe Osman Elshani (rreth tridhjetë e tre vjeç), u morën dhe u sollën me të tjerët në të njëjtin vend. Edhe ata dhanë paratë dhe më pas u qëlluan. Kështu që dhjetë a njëmbëdhjetë njerëz u vranë në këtë mënyrë, në atë shtëpi. Unë ndodhesha në oborrin e shtëpisë sime, ndoshta njëzet a tridhjetë metra larg. Ata ishin katër a pesë vetë të veshur me uniforma të rregullta policie dhe me mitralozë në duar.[22]

Edhe sot është e paqartë se cili është numri i saktë i njerëzve të vrarë më 25 mars, në qytetin e Suharekës. Por, duke u bazuar në dëshmitë e këtij raporti, janë vrarë të paktën dyzet njerëz, duke përfshirë këtu edhe njëmbëdhjetë fëmijë nga mosha gjashtëmbëdhjetë vjeç e poshtë, si dhe shtatë gra.

Pas datës 29 mars, shumë nga banorët e Suharekës u lejuan të qëndronin në qytet. Shqiptarët etnikë të intervistuar nga Human Rights Watch do të bënin fjalë për abuzime të vazhdueshme gjatë gjithë kësaj kohe, për plaçkitje e djegie, por jo keqtrajtime të rënda fizike. Autoritetet vendore u shpërndanë karta regjistrimi gjithë banorëve shqiptarë, si dhe i urdhëruan meshkujt që të paraqiteshin një herë në ditë në rajonin e policisë. Ushqimi mund të gjendej vetëm në dyqanet pronë e banorëve serbë. Një grua me prejardhje nga Reçani, X. X. (inicialet e së cilës janë ndryshuar), tha se aty nga fillimi i majit, ajo ndodhej në fshatin Shtime:

Janë vrarë të paktën dyzet njerëz, duke përfshirë këtu edhe njëmbëdhjetë fëmijë.

Ne qëndruam atje një natë dhe ata (policët serbë) na dhanë biskota dhe ëmbëlsira. Paskëtaj na thanë të shkonim në Suharekë dhe të vendoseshim në ato shtëpi që nuk ishin djegur ende. Ne qëndruam në Suharekë rreth një javë. Nuk patëm kurrfarë problemi. Burrat duhej të paraqiteshin çdo ditë në rajonin e policisë. Ata ishin porositur të mos strehonin refugjatë apo njerëz të UÇK-së. Në Suharekë na dhanë karta regjistrimi. Serbët na thanë se mund të lëviznim lirisht në qytet, vetëm të hapnim sytë nga bombat. Por vetëm burrat dilnin rrugëve, të tjerët nuk lëviznin nga shtëpia. Në Suharekë ushqimi nuk ishte i mjaftueshëm, kështu që na duhej ta shtynim vetëm

me ushqimin që gjetëm në shtëpi. S'të zinte më syri shitore, ata iu kishin kallur zjarrin dhe i kishin djegur të gjitha.[23]

E megjithatë, një pjesë e shqiptarëve do të dëboheshin nga Suhareka aty nga data 21 maj, madje disa do të mbarteshin me autobuzët e organizuar nga policia. Dëshmitarja e pakmësipërme, X. X., i tha Human Rights Watch:

Dje (21 maj), na thanë të largoheshim. Burri im shkoi si çdo ditë në rajonin e policisë dhe ata i thanë që duhej të iknim. Të gjithë njerëzit nga Suhareka duhej të largoheshin, por ata ishin nga fshatrat aty pranë. Dolëm në rrugën kryesore, ku na prisnin tri autobuzë, të cilët na morën e na shpunë në Zhur. Në autobuzë na trajtuan mirë, s'patëm ndonjë problem. Në kufi, ata më morën 50 marka gjermane.[24]

BELLANICË

Në veri të qytetit të Suharekës, mes kullotash baritore dhe vreshtash, ndodhet fshati i vogël i Bellanicës, me treqind familje dhe afro 3000 banorë, të gjithë shqiptarë etnikë, që merren me bujqësi. Shtëpitë janë të shpërndara në një fushë të madhe të gjelbër, ndërsa në qendër të fshatit ndodhet shkolla dhe një qendër shëndetësore.

Fshatarët e Bellanicës ishin shtrënguar t'i linin shtëpitë në një sërë rastesh, gjatë ofensivës qeveritare në verë të vitit 1998. Me sa dimë, të paktën një fshatar është vrarë asokohe nga granatimet, teksa kthehej në fshta për t'u përkujdesur për gjënë e gjallë. Gjithsesi, në përgjithësi fshatarët nuk ishin bërë objekt i drejt për drejtë i dhunës qeveritare, edhe pse UÇK-ja ishte aktive në atë zonë.

Por gjithçka do të ndryshonte me fillimin e bombardimeve të NATO-s. Në harkun kohor të fare pak ditëve, me mijëra shqiptarë etnikë, pjesa më e madhe e tyre të shpërngulur nga fshatrat përreth, u mblodhën në Bellanicë, ku do të keqtrajtoheshin, rriheshin e plaçkiteshin nga policët e paraushtarakët serbë, para se të dëboheshin në Shqipëri. Ekzistojnë akuza të fuqishme për përdhunime, teksa besohet se më shumë se dy dyzina meshkujsh nga Bellanica e rrethinat janë vrarë.

Në mbarë komunën e Suharekës, Bellanica është një rast i veçantë, ngaqë

si UÇK-ja ashtu edhe trupat serbe i lejuan civilët shqiptarë të mblidheshin në atë vend. UÇK-ja iu kish thënë civilëve që largoheshin nga fshatrat e tyre për shkak të granatimeve, se Bellanica ishte një vend i sigurt. Ndërkohë që policia serbe dhe Ushtria Jugosllave i drejtonin gjithashtu njerëzit e shpërngulur për kah ai fshat, sepse siç thonin ata, atje nuk kishte luftime. Sipas të dhënave të dëshmitarëve, një numër prej 12.000 deri në disa dhjetëra mijëra shqiptarë etnikë kishin shkuar e mbledhur në fushën qendrore bashkë me traktorët dhe mjetet e tjera të transportit. Shumë pak kohë paskësaj, policia serbe dhe paraushtarakët sulmuan fshatin, gjë që na shtyn të mendojmë se Bellanica mund të ketë qenë përdorur nga trupat serbe si një pikë grumbullimi për të gjithë të shpërngulurit e brendshëm, për të lehtësuar dëbimin e mëpasëm nga Kosova, por edhe plaçkitjet dhe grabitjet e ndryshme që shoqëruan "spastrimin etnik".

Fshatarët e komunës së Suharekës zunë të largohen nga fshatrat e tyre, për shkak të abuzimeve të policisë dhe sulmeve të ndryshme që zunë fill menjëherë pas largimit të OSBE-së nga Kosova, më 24 mars. Qysh nga 24 marsi e më pas, që shënonte edhe fillimin e bombardimeve të NATO-s, mijëra refugjatë u shtrënguan të iknin nëpër kodrat dhe pyjet rreth e qark, nga frika e sulmeve apo nga bombardimet e trupave qeveritare. Një pjesë e mirë e të ikurve shkuan e u mblodhën në fshatin Pagarushë, ku ishte vendosur UÇK-ja.

Këta refugjatë do t'i thonin Human Rights Watch se, ishte UÇK-ja që i drejtoi për kah Bellanica, duke nisur nga 25 marsi. Më 31 mars, në kohën kur Pagarusha do të granatohej, mijëra prej tyre u drejtuan për në Bellanicë. Një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçare nga Duheli, i tha Human Rights Watch:

> Qëndruam katër netë në Pagarushë, duke nisur nga data 26 mars. Kur ata (forcat qeveritare) zunë të bombardonin fshatin, më 31 mars, njerëzit ia mbathën. Mbi fshat ranë shumë predha; aq shumë sa s'munda dot t'i numëroj. Dy gra mbetën të vrara gjatë granatimit, njëra ishte nga fshati Banjë, i distriktit të Malishevës, ndërsa tjetra ishte nga Deçani.
>
> Më 31 mars ne u larguam nga Pagarusha dhe u nisëm në drejtim të Bellanicës. Shkuam në Bellanicë ngaqë UÇK-ja na tha të shkonim atje; ata na thanë që në atë vend nuk kishte granatime. Por, me sa duket, ky kishte pasë qenë edhe synimi i ushtrisë; ata dëshironin që ne të gjithë të mblidheshim në atë vend, ndaj dhe nuk kishin bombarduar më parë.[25]

Sipas dëshmisë së një të pranishmi, më 31 mars, jo më pak se 12.000 shqiptarë etnikë të zhvendosur gjendeshin në Bellanicë, pjesa më e madhe e të cilëve qenë gra, fëmijë dhe të moshuar, ngaqë meshkujt në moshë për të luftuar ishin larguar me kohë nëpër kodra. Shumë nga dëshmitarët e tjerë mëtonin se numri ishte ku e ku më i madh, madje shkonte deri më 100.000 vetë, dhe përbëhej kryesisht nga të ardhurit prej fshatrave përqark. Hulumtimi më serioz gazetaresk mbi Bellanicën është kryer nga John Daniszewski i Los Angeles Times, i cili intervistoi më shumë se dy dyzina banorësh të Bellanicës dhe zonës rreth e qark, dhe publikoi një seri artikujsh që fokusoheshin mbi fatin e një familjeje. Në një prej artikujve, "Vdekja e Bellanicës", ai çmonte se 80.000 njerëz nga pesëdhjetë fshatra ishin mbledhur në Bellanicë.[26]

Duke iu referuar artikullit, mbrëmjen e 31 marsit, një luftëtar i UÇK-së i paralajmëroi njerëzit e mbledhur në Bellanicë se UÇK-ja po tërhiqej, duke e lënë vendin të zbuluar për ndonjë sulm të mundshëm. Sipas një vlerësimi, më shumë se 1600 të rinj u larguan nëpër kodrat aty pranë.

Hollësirat e përshkruara në artikull përqasen përbukuri me dëshmitë e njëzet dëshmitarëve të intervistuar nga Human Rights Watch, fillimisht në Shqipëri, ku ata ndodheshin si refugjatë dhe, më pas, në Kosovë, kur ata u kthyen në gusht. Sipas pjesës më të madhe të dëshmitarëve, sulmet e trupave qeveritare nisën më 1 prill, ndonëse tre prej tyre mëtojnë se sulmi zuri fill qysh më 31 mars. Sipas shumicës së dëshmitarëve, më 1 prill, në orën 6 të mëngjesit, në pjesën e poshtme të Bellanicës, nisën të bien predha. Pasdite, ende pa u ngrysur, trupat serbe të veshura me uniforma blu të errët dhe ngjyrë të zezë, një pjesë me maska, të tjerët me surretërit e pikturuar, hynë në fshat, duke shtënë si të tërbuar në ajër. Në qendër të fshatit gumëzhinin tankset dhe automjetet e koracuar.

Veprimtaria më e rëndomtë e policëve dhe e paraushtarakëve ishte plaçkitja.

Një dëshmitar me prejardhje nga Dobërdolani, deklaroi se policët u përpoqën të regjistronin disa prej të shpërngulurve. Po sipas këtij dëshmitari, trupat serbe iu kishin thënë që askush nuk do të pësonte gjë dhe se njerëzit mund të kthehesh in në shtëpitë e tyre, pasi të përfundonte procesi i regjistrimit. E megjithatë, policët shtinë mbi disa të rinj që u rrekën t'ia mbathin.[27]

Gjithsesi, dëshmitarët pajtoheshin në atë çka ndodhi më pas: terrorin dhe banditizmin e ushtruar nga policët dhe paraushtarakët serbë. Sipas fjalëve të dëshmitarëve, në ditët në vazhdim një numër i madh burrash

ishin rrahur e keqtrajtuar, ndërsa një numër i panjohur ishin vrarë brenda në fshat.

Veprimtaria më e rëndomtë e policëve dhe e paraushtarakëve ishte plaçkitja. Çdo person i intervistuar do të thoshte se, trupat qeveritare i kërkonin gjithkujt burra, gra e fëmijë para e arturina në këmbim të jetës. Marka gjermane ishte monedha e këmbimit për të shpëtuar një jetë njeriu. Saherë që njerëzit nuk ishin në gjendje të paguanin, ata vriteshin, pa një pa dy. Një grua i tha Human Rights Watch:

> Ata vinin vazhdimisht te vendi ku qenë grumbulluar traktorët, ku gjeje kryesisht gra e fëmijë. Ata vinin dhe dhe nuk bënin gjë tjetër veçse i hiqnin unazën granatës dhe thonin, "Në qoftë se nuk do të më japësh ca marka gjermane, do të ta hedh aty brenda." Ose rroknin fëmijët për gryke, nxirrnin thikën nga këllëfi dhe të thonin, "Do ta vrasim, në qoftë se nuk na paguani."[28]

Një tjetër grua i tha Human Rights Watch:

> Kam dëgjuar shumë të qara e ulërima, si dhe të shtëna armësh. Ata shtinin mbi njerëzit, kur këta refuzonin t'u jepnin para. Një e dy, ata vinin e na thonin, "Na jepni para përndryshe do t'ju vrasim." Njerëzit që s'kishin para, zor se mund të shpëtonin.
>
> Një herë, policët shkuan te një burrë që ishte te traktori i vet, kundruall meje. I thanë, "Na jep para!" Ai nuk kishte çfarë t'u jepte. Mbaj mend që ishte nga fshati Astrazup. Atëherë, ata e zbritën nga traktori dhe e vranë. Kur ai nuk u dha gjë, ata (katër policët) e zbritën duke e kapur nga duart dhe këmbët nga traktori. Pastaj e çuan mbrapa një shtëpie, e më pas nuk e pashë më. Dëgjova vetëm të shtënat dhe pashë njërin nga policët t'i drejtonte armën e të shtinte. Ai njeri nuk u kthye më te traktori.[29]

Po një tjetër grua tha:

> Njerëzit që u vranë nuk kishin para. Ushtarët nuk i pranonin dinarët (jugosllavë); ata lypnin marka gjermane. Pashë një grua me të birin që e kish të plagosur. Një polic iu qas dhe i tha, "Më jep 1000 DM, përndryshe do ta vras." Ajo iu lut të tjerëve t'i jepnin ca para, në mënyrë

> që të paguante policin. Kësisoj, ajo bëri ca para. Dhe i biri i shpëtoi.[30]

Një burrë pesëdhjetë e tre vjeç nga Duheli tha se, kishte parë se si policët kishin vrarë pesë njerëz. Ai i tregoi Human Rights Watch:

> Gjëja më e frikshme ishte se serbët ishin duke shtënë në ajër dhe fëmijët e mi qenë llahtarisur. Unë i pashë kur vranë pesë njerëz, rreth pesëmbëdhjetë metra larg meje. Kishin qenë duke iu kërkuar para viktimave. Ata qëlloi që s'kishin para dhe serbët i qëlluan për vdekje. Nuk i njihja viktimat.[31]

Një grua, H. S., na kallzoi se si policët i morën djalin shtatëmbëdhjetë vjeç, Ifraim, dhe i lypën para për t'ia kthyer. Ajo tha:

> Pasi u regjistruam, ata erdhën te traktorët dhe kërkuan para. Unë kisha takuar një farefisin tim dhe ndodhesha te traktori i tyre. Ata më kishin marrë djalin shtatëmbëdhjetë vjeç, Ifraim Shala dhe e kishin futur në një bodrum. Ata më thanë: "Yt bir është i UÇK-së, prandaj ose na jep para ose do ta vrasim." M'u desh t'u jepja gjithë arturinat që kisha me vete që të shpëtoja djalin. Ma mbajtën djalin katër orë në bodrum dhe erdhën katër herë të më kërkonin paratë dhe sendet e çmuara, para se të ma lironin djalin. Ata m'u kanosën e më thanë: "Bushtër, na jep gjithë paratë që ke me vete." Kur e nxorën djalin nga bodrumi, ma rrahën. E rrahën me qytën e pushkës. Gjithsejt, e rrahën tri herë.
>
> Të njëjtën gjë iu bënë edhe të tjerëve. Nuk bënin gjë tjetër, veçse sorrollateshin nëpër turmë, duke iu kërkuar para njerëzve. Kur u jepje para, largoheshin, por pas ca i kishe prapë aty, duke të kërkuar sërish para. Kjo gjë do të vazhdonte një copë herë, deri sa njerëzve iu sosën paratë, dhe më pas kërciti druri. Pashë sa e sa njerëz të rriheshin. Një pjesë kishin veshur uniforma ngjyrë blu, të tjerët i kishin të zeza; mbanin jelekë antiplumb dhe në shpinë kishin shkronja cirilike. Kishte edhe me maska, të cilëve mund t'u shihje vetëm sytë.[32]

Human Rights Watch intervistoi dy burra që ishin mbajtur për një periudhë të shkurtër kohore në qilarin e një shtëpie në Bellanicë. Të dy ata i kishin pyetur rreth UÇK-së, i kishin kërcënuar me vdekje, i kishin rrahur, por tek e fundit, i patën liruar.

H. S. gjithashtu kishte qenë dëshmitare, kur forcat e sigurimit kishin vrarë tre vetë ngaqë s'kishin pasur para. Ajo tha:

> Në dritën e traktorit, pashë dy burra nga Marali në një traktor me gjithë rimorkio, ndoshta dy traktorë larg meje. Tre persona të maskuar që kishin qenë edhe te ne për të kërkuar para, shkuan tek ata dhe iu kërkuan para. Ata i ndukën nga teshat dhe iu kërkuan para. Burrat u thanë që s'kishin para. Atëherë ata i qëlluan me një pushkë të shkurtër, aq sa me zor mund t'i dëgjoje krismat. Njëri nga ata të dy ishte pesëdhjetë vjeç, ndërsa tjetri rreth të tridhjetë e pesave. Dëgjova që i kishin vrarë edhe të tjerët, por me sytë e mi nuk i pashë. Ata që kishin para, u lejuan të largoheshin, të tjerët, u ndaluan dhe u rrahën. Gjatë gjithë kohës dëgjonim veç të shtëna dhe kërcënime, bie fjala si: "Deshët NATO-n, e pra, shkoni tani te NATO-ja, shkoni në Shqipëri." [33]

Një grua shtatëdhjetë vjeçare, dha një dëshmi të hollësishme se si hyri policia në shtëpinë e saj dhe i vrau të shoqin, shtatëdhjetë e shtatë vjeç. Siç tha e moshuara, çifti i pleqve kishte vendosur të qëndronte në shtëpi, bashkë me një fëmijë të vogël, ngaqë qenë të lodhur e s'kishin moshë për të dalë fushave:

> Ndezëm zjarrin dhe vumë të ngrohnim gjellën. Sapo ishim ulur, kur, papritur e pakujtuar, çatisën në shtëpi, katër a pesë burra. Im shoq nuk sheh mirë nga sytë, kështu që nuk e mori vesh që ishin ushtarë. Iu tha, "Bujrum!" dhe iu ofroi cigare. Ata ia rrëzuan paketën e cigareve nga dora. Paskëtaj, njëri prej ushtarëve i shtiu dhe e qëlloi në krah. Më pas e qëlluan sërish, këtë herë në kraharor. Im shoq tha, "Oh, moj nëna ime," dhe ra në dysheme.
>
> Bashkë me ne ishte dhe një fëmijë i vogël; atë e shkelmuan, por nuk e vranë. Më pas u ngjitën në katin e dytë, kontrolluan në gjithë shtëpinë dhe më thanë të largohesha. Aty pranë ishte një tank; ndërkohë që po largohesha, ata shtinë me top në drejtim të ndërtesës. Shtëpia u shkatërrua.[34]

Një tjetër dëshmitar, gazetar nga Bellanica, tha se kish parë policët të shtinin mbi një të sëmurë psikik dhe shurdhmemec, ngaqë nuk iu kishte dhënë para. Dëshmitari i sipërpërmendur tha:

> Pak minuta para se të iknim, në shtëpinë e kushëririt tim vranë Agim

> Bytyqin, një të dalë mendsh nga Nishori, i cili duhej të ishte midis tridhjetë e tetë a dyzetë vjeç. E pashë me sytë e mi ngjarjen. Nuk isha më larg se njëzet, tridhjetë metra. Ai as fliste as dëgjonte, ishte shurdhmemec. Ma merr mendja që ata ishin duke i kërkuar para dhe kur ai nuk iu përgjigj, hapën zjarr mbi të me automatik.[35]

Dhe, së fundi, dy dëshmitarë të ndryshëm, të intervistuar veç e veç, raportuan mbi vrasjen e dy personave nga fshati Marali në komunën e Rahovecit, Osman dhe Bekim Vrenezit. Njëri nga dëshmitarët, i afërm i të dyve, i tha Human Rights Watch se, shkuan dhe i morën Osmanin e Bekimin, me pretendimin se ata të dy ishin të UÇK-së. Ai tha:

> Rreth orës 4 a 5 të pasdites, ata i morën që të dy, Osmanin (njëzet e shtatë vjeç) dhe Bekimin (pesëmbëdhjetë) duke thënë se ishin të UÇK-së. Veç kësaj na kërkuan edhe para, por ne nuk kishim ndonjë bankë me vete, para të tjera s'na kishin mbetur që t'ua jepnim. Ata i kishin marrë me kohë gjithë paratë që kishim pasur, 2500 marka gjermane dhe florinjtë. Kishim mbetur pa asnjë qindarkë. Ata thonin vazhdimisht për ata të dy se ishin të UÇK-së. Paskëtaj i morën me vete, kështu që ne s'pamë gjë më sy se çfarë u ndodhi. Kishim frikë t'i linim vetëm njerëzit e shtëpisë. Më vonë do t'i gjenin (të vdekur) ata të UÇK-së, në Bellanicë.[36]

Dëshmitari i dytë, një person nga i njëjti fshat, por pa pasur të bëjë me familjen e të vrarëve, pohon se kishte parë se si ishin vrarë Osman dhe Bekim Vrenezi, afërmendsh ngaqë nuk iu kishin dhënë aq para policëve sa ç'donin ata. Ai i tha këto fjalë Human Rights Watch:

> Në orën 7.30 të darkës, dy persona nga fshati im, Osman Vrenezi, njëzet e shtatë vjeç dhe Bekim Vrenezi, gjashtëmbëdhjetë vjeç,[37] u vranë. Ata u kërkuan para. Osmani dhe Bekimi kishin me vete 900 marka, por policët donin 1000, të cilat, ata nuk i kishin. Unë dëgjova të shtënat dhe i pashë kur u plandosën përtokë.[38]

Human Rights Watch, duke u bazuar në intervistat e njëzet dëshmitarëve, konfirmon dymbëdhjetë vrasje,

Nuk është krejtësisht e qartë se sa njerëz u vranë në Bellanicë, meqenëse

shqiptarët vinin nga një numër i madh e i ndryshëm fshatrash. Dëshmitarët e cituar në artikullin e *Los Angeles Times*, të marrë së bashku, mëtojnë të kenë parë njëzet e dy vetë të vrarë, edhe pse kjo shifër nuk është paraqitur si shuma totale për të gjithë fshatin. Human Rights Watch, duke u bazuar në intervistat e njëzet dëshmitarëve, konfirmon dymbëdhjetë vrasje, ndonëse të paktën njëra prej tyre zihet ngoje gjithashtu edhe në artikullin e *Los Angeles Times*.[39] Një artikull i mëpasëm, i shkruar po nga John Daniszewski, citon kryetarin e bashkisë të Bellanicës, Gani Zogaj, të ketë thënë se, trembëdhjetë burra nga fshati ishin vrarë.[40] Sipas Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës, në fshat ishin gjetur tre trupa.[41] Por, lypset theksuar se, meqë viktimat vinin kryesisht nga fshatrat e atyre anëve, ka fort të ngjarë që të afërmit t'i kenë marrë me vete trupat për t'i varrosur.

Human Rights Watch do të dëgjonte gjithashtu një sërë akuzash serioze për raste përdhunimi të kryera në Bellanicë, por nuk ishte në gjendje të dokumentonte ndonjë rast specifik. Shqiptarët etnikë pohuan se, një numër përdhunimesh kishin ngjarë, por ata nuk kishin dëshirë të flisnin për këtë gjë. Në artikullin e *Los Angeles Times* përmenden raste, kur njerëz të armatosur iu janë kanosur femrave se do t'i përdhunojnë. Një dëshmitar pohon se, dy gra ishin shpënë në një shtëpi të braktisur dhe aty ishin përdhunuar, por kjo akuzë mbetet e pakonfirmuar. Në artikull bëhet fjalë se si gra të ndryshme kanë denoncuar raste ngacmimesh seksuale, për shembull, kur forcat e sigurimit i kanë shtrënguar të heqin këmishët për t'i kontrolluar për para.

Duke nisur nga 1 prilli, të gjithë shqiptarët që ndodheshin në Bellanicë u urdhëruan ta linin fshatin, ndërsa pjesa më e madhe e shtëpive u dogj. Varganët e traktorëve dhe të njerëzve që ecnin më këmbë u nisën në dy drejtime: i pari, në jug të qytetit të Suharekës, më pas Prizren, për të dalë në Morinë, në kufi me Shqipërinë dhe, i dyti, në veriperëndim të Malishevës e më pas, Rahovec, Xërxe, Prizren dhe së fundi, Morinë. Sipas thënieve të dëshmitarëve, njësitë e policisë dhe të ushtrisë ishin të pranishme gjatë gjithë segmenteve rrugorë. Një pjesë e shqiptarëve u detyruan të qëndronin njëzet e katër orë në Malishevë, deri sa policia e Malishevës të organizonte transportin e tyre me tre autobuzë dhe një numër të madh kamionësh, që do t'i shpinin njerëzit në fshatin Zhur, pranë kufirit.

Gjatë udhëtimit për në Shqipëri, disa burra u mbajtën nga forcat e sigurimit dhe nuk u lejuan të kalonin kufirin. Një burrë nga Bellanica shpjegoi se si ishin kapur katër burra në rrugën midis Malishevës dhe

Astrazupit. Tre prej tyre, më vonë, u gjetën të vdekur. Ai tha:

> Ne qemë duke shkuar nga Malisheva në Astrazup, kur ata ndaluan Shaban Zogajn, djalin e një fqinjit tim dhe e morën me vete. Ata e qëlluan me qytën e një automatiku dhe ai u shtri në asfalt. Paskëtaj, ata na thanë të largoheshim, kështu që nuk morëm vesj gjë se ç'ndodhi me të. Kur mbërritëm në Rahovec, ata morën tre djem të rinj: Sami Zogaj (njëzet vjeç), Sali Zogaj (tridhjetë e tre vjeç) dhe Elmi Zogaj (nëntëmbëdhjetë vjeç). (Dëgjuam) që i kishin pushkatuar më 5 prill. Më vonë shkuam të merrnim trupat e tyre në Rahovec dhe i rivarrosëm këtu (në Bellanicë).[42]

Human Rights Watch intervistoi të atin e Shaban Zogajt dhe e pyeti rreth incidentit. Deri në datën 19 gusht, ai nuk kishte kurrfarë lajmi për të birin, se ku mund të ndodhej dhe në ishte gjallë apo jo. Ai tha:

> Në Astrazup, unë isha me traktorin tim dhe mbrapa meje ishin dy traktorë të tjerë dhe një kamion. Sapo u larguam nga Astrazupi, diku pranë pikës së furnizimit me karburant INA, ata na ndaluan sërish dhe morën tim bir, Shabanin (tridhjetë e tre vjeç) nga traktori. Unë vetë nuk e pashë kur ndodhi, ngaqë isha para tij. Pyeta dikë (njerëzit e tjerë të familjes) në qoftë se ishin duke ardhur dhe ai dikushi më tha, jo. E mbajta traktorin dhe qëndrova të pres. Kur ata na mbërritën, pyeta djalin (tjetër): "Jeni të gjithë këtu?" Djali m'u përgjigj: "Babë, kanë mbajtur Shabanin." Shkova te kamioni dhe pyeta robt e familjes, në qoftë se kishte mbetur ndonjë para. Kishim ende 2000 marka gjermane. Mora paratë dhe u ktheva mbrapsh. Im bir, Ismaili, më tha të mos shkoja. Por, unë këmbëngula që doja të shkoja. Ai u përpoq të më mbante, por s'mundi. Atëherë im bir nisi të më përgjërohej e të më thoshte: "Të lutem, mos shko, tashmë e humbëm njërin (pjesëtar të familjes), nuk dua të humbasim edhe një tjetër." Por, unë u nisa të shkoja, ndërsa djali më ndoqi nga pas, duke thënë: "Mos shko, ka marrë fund. Ata e goditën dhe ai u shtri në asfalt." Por, unë s'doja të ndalesha. Shkova fare pranë, por policët më thanë: "Yt bir është djali ynë tani. E dimë ne çfarë do të bëjmë me të." Dhe më kthyen mbrapsh. U orvata t'u jepja paratë që kisha me vete, por s'piu ujë. U ktheva mbrapsh (te njerëzit e familjes) dhe vijuam rrugën. Është e rëndë të lesh njerëzit e

> shtëpisë mbrapa. Do të kishte qenë më mirë sikur ta kishin vrarë para syve të mi. Nuk e di çfarë i ndodhi. Qysh kur u ktheva (në Kosovë), para pesë ditësh, nuk jam përpjekur ta gjej. Nesër do të shkoj në Istog, ku janë duke hapur varre.[43]

Human Rights Watch do të intervistonte një pjesëtar të familjes së tre burrave të familjes Zogaj, i cili e konfirmoi rrjedhën e ngjarjes. Sipas dëshmitarit, Elmiu, Samiu dhe Saliu ishin zbritur nga traktori i tyre në Rahovec, ndërsa pjesa tjetër e familjes ishin shtrënguar të vijonin rrugën. Ai i tha Human Rights Watch:

> Ne i lamë ata në dorën e Zotit. Ata (serbët) do t'i vrisnin pas pesë ditësh. I gjetëm më 19 qershor, në varrezat e Rahovecit. I zhvarrosëm të tri trupat dhe i njohëm nga teshat. Saliun e kishin pasë rrahur në Bellanicë dhe kishte nofullën të thyer. E kishin ekzekutuar nga afër. E kishin qëlluar në kokë. Edhe Samiu ishte goditur në kokë. Elmiun e kishin qëlluar në gjoks. Xhaketat e tyre ishin bërë shoshë nga plumbat.[44]

FSHATI NË KOMUNËN E SUHAREKËS[45]

Më 21 prill, forcat serbe të sigurimit rrethuan një fshat të vogël në komunën e Suharekës, të cilit nuk do t'ia zemë ngoje emrin, për shkak të natyrës së krimeve që ndodhën në atë vend. Të gjithë burrat e fshatit u larguan në kodrat rreth e qark, me përjashtim të njëmbëdhjetë pleqve që ndenjën në fshat, tok me 200 a 300 gra e fëmijë. Të njëmbëdhjetë pleqtë u vranë dhe u hodhën në një nga puset e fshatit. Gratë u mbyllën për tri ditë me radhë nëpër shtëpi private, ku një pjesë e tyre do të përdhunoheshin dhe do të abuzohej seksualisht.

Human Rights Watch do të dëgjonte për të parën herë rreth këtyre abuzimeve, në fund të prillit, teksa ishte duke intervistuar refugjatët në veri të Shqipërisë. Pikërisht atë kohë, gratë e fshatit raportuan se ishin mbajtur për tri ditë me radhë në shtëpi private nga trupat serbe. Madje dy prej grave të intervistuara do ta pranonin hapur që ishin përdhunuar, ndërkohë që disa prej dëshmitareve i dhanë Human Rights Watch emrat e katër grave të tjera, me të cilat, sipas mendimit të tyre, ishte abuzuar seksualisht.

Në kohën që ndodheshin si refugjate në Shqipëri, gratë i thanë Hu-

man Rights Watch se, policia kishte marrë njëmbëdhjetë pleq. Disa nga gratë deklaruan se kishin parë njërin nga pleqtë të vrarë, të plandosur pranë rrugës, ndërkohë që ishin duke dalë nga qyteti, më 24 prill, por ato s'ishin në gjendje të thonin se kush ishte ai. Një plakë dëshmoi se kish dëgjuar policët tek flisnin me sho-shokun dhe i thoshin se si kishin vrarë burrat e i kishin flakur në një pus të thellë. Ndërsa burrat e tjerë qenë zhdukur, thanë ato.

Njëmbëdhjetë burra ishin vrarë e më pas flakur në një pus të fshatit.

Kur Human Rights Watch vizitoi fshatin më 1 gusht, fshatarë të ndryshëm do të konfirmonin vrasjen e njëmbëdhjetë burrave, që kishin përmendur edhe gratë. Trupat e tyre i kishin flakur në një pus të fshatit, që më pas e kishin hedhur në erë. Ekspertët kriminalistë të Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës zbuluan dymbëdhjetë trupa (personi i dymbëdhjetë ishte vrarë më 5 maj).

Sipas fshatarëve të atyre anëve, UÇK-ja kishte pasë qenë aktive në komunën e Suharekës përgjatë gjithë vitit 1998, ndërsa më 1999 edhe në rajonin e Petrovës, me një bazë në Budakovë. Gjatë bombardimeve të NATO-s, do të hynte edhe në fshatin Llanishtë.

Siç thanë fshatarët, policia hyri për herë të parë në fshat, më 5 prill. Asokohe, ata vetëm sa kërkuan para dhe florinj, dogjën edhe ndonjë shtëpi, por gjithsesi nuk ushtruan dhunë drejtpërdrejtë mbi banorët e fshatit. Sipas raportit të OSBE-së, fshatarët kishin ngritur rojën lokale për t'i paraprirë ndonjë sulmi tjetër të trupave qeveritare.[46]

Policët e rrethuan përsëri fshatin, pasdite herët, më 21 prill. Burrat e fshatit, të cilëve iu bashkëngjitën edhe disa të tjerë nga fshatrat përreth, u larguan në kodra për t'u bashkuar me UÇK-në. Një numër i madh burrash nga fshatrat në lindje të Suharekës, u mblodhën pranë Llanishtës, ku ishte ngulitur UÇK-ja. Siç tha një dëshmitar, për tri ditë me radhë në atë zonë u zhvilluan luftime të ashpra, ku gjashtëdhjetë shqiptarë mbetën të plagosur dhe dy të vrarë, ndërsa nga ana e serbëve u vranë pesë policë.[47] Sipas Ministrisë së Brendshme të Serbisë, nëntëmbëdhjetë policë ishin lënduar në "sulmet terroriste" në komunën e Suharekës, ndërmjet 22 dhe 24 prillit, ndonëse nuk është e qartë nëse ata ishin plagosur në luftimet e përmenduar nga dëshmitari.[48] Sipas një dëshmitari, pas tri ditësh, UÇK-ja e nisi popullsinë civile, si dhe 10.000 persona të tjerë, në Petrovë. Ndërsa disa prej civilëve shkuan në Raçak.

Të vetmit njerëz që dinë përnjëmend rreth asaj çka ndodhi në fshat,

pas 21 prillit, janë gratë e fëmijët që mbetën në atë vend, si dhe pengmbajtësit e tyre, serbët. Sipas të mbijetuarve – Human Rights Watch foli me dymbëdhjetë gra – policia kapi gjithë sa ishin 200 deri 300 gra e fëmijë (duke përfshirë këtu edhe pesëdhjetë gra nga fshatrat aty pranë dhe njëmbëdhjetë pleq), të cilët ndodheshin në fushë. Pleqtë u kontrolluan dhe u hoqën mënjanë. Ndërsa gratë u ndanë kuturimthi dhe u mbyllën në tri banesa private.

Gjatë gjithë kësaj kohe, gratë do të kërcënoheshin në mënyrë të vazhdueshme dhe me to do të abuzohej. Policët iu kërkuan të gjitha grave të fusnin në një kovë që e qarkulluan gjithandej, paratë dhe arturinat që kishin me vete. Kur trofeu konsiderohej i paplotë, tha njëra prej dëshmitareve, atëherë polici i vuri thikën në fyt një djali tre vjeç, duke thënë se do ta vriste në qoftë se e ëma nuk ofronte para ose florinj aq sa duhej.[49] Një pjesë e grave u urdhëruan të gatuanin e lanin për trupat serbe, ndërsa disa të tjera u shtrënguan të kryenin marrëdhënie seksuale me pengmbajtësit e tyre.

Ai bëri seks me mua; bëri çfarë deshi.

Dy viktima të përdhunimit të intervistuara nga Human Rights Watch ishin mbyllur në të njëjtën shtëpi, e cila ishte e tejmbushur me gra dhe fëmijë të frikësuar. Edhe gratë e mbyllura në dy shtëpitë e tjera do të përshkruanin të njëjtat kushte. Një nga viktimat përshkroi se si ishte abuzuar seksualisht me të në dy raste, madje në njërin rast, ajo ishte përdhunuar. Ditën e dytë të mbajtjes peng, rreth orës 4 të pasdites, ajo "u zgjodh" mes një grupi të madh grash, nga një person me uniformë kamuflazhi, në ngyrë të blertë. Personi e shpuri atë në një shtëpi tjetër, ku edhe e përdhunoi. Ajo i tha Human Rights Watch:

> (Përdhnuesi) tha "eja këtu." Ai më hoqi mënjanë nga grupi i grave të tjera dhe bëri si t'ia kish qejfi mua. Ai ishte shtatshkurtër, rreth dyzet e ca vjeç, lëkurëzeshkët, jevgjit. Serbët kishin rekrutuar jevgjitë. E dija që ishte jevgjit nga pamja e jashtme: ata janë të zinj, lëkurëzeshkët. Ka shumë prej tyre në Suharekë. Kishte veshur uniformë kamufluazhi, ngjyrë të blertë, të ngjashme me ato të serbëve, me shirita të kuq te spaletat …
>
> Jevgu më mori dhe më çoi në një shtëpi tjetër, rreth pesë minuta larg. Ai ndenji vetëm për vetëm me mua, rreth gjysmë ore, ndoshta edhe një orë. Ai bëri seks me mua; bëri çfarë deshi. Ishte shtëpia e një kushëriri. U larguam rreth orës 5 të pasdites.[50]

Një ditë më pas, një tjetër person i kërkoi asaj të shkonte me të në një shtëpi rreth dhjetë minuta larg. Sipas dëshmisë së gruas, personi nuk i tha asaj se ku po e shpinte dhe pse, por e shtyu me grykën e pushkës të ecte, ndërkohë që ajo nisi të qante.

Ajo i tha Human Rights Watch se, shtëpia ishte plot me njerëz të forcave serbe të sigurimit. Ata i bënë asaj një sërë pyetjesh, duke përdorur fjalë fare të thjeshta e përzjerë me gjeste të ndryshme, ngaqë gruaja mezi e kuptonte serbishten. Ata e pyetën për moshën, nëse kishte fëmijë dhe ku e kishte burrin. Më në fund e pyetën edhe për para. Kur ajo u tha që nuk kishte para, ata e urdhëruan të zhvishej. Ajo nisi të qante e të shkulte flokët, gjë që i bëri ata të qeshnin. Në këto e sipër, ata vunë muzikë.

Pasi u zhvesh, burrat zunë t'i afrohen një e nga një, teksa ajo qëndronte krejt lakuriq para tyre. Ajo i tha Human Rights Watch se, të gjithë ata e kundruan atë, më pas u larguan dhe e lanë vetëm në dhomë me një person që, sipas asaj duhej të ishte komandanti i tyre, dhe një oficer tjetër që ishte lakuriq, në shtrat. Viktima ishte detyruar të shtrihej në shtrat me oficerin, i cili, siç tha ajo, e preku në gjoks, por nuk e detyroi që edhe ajo ta prekte. Komandanti, të cilin ajo e kish njohur për të tillë, ngaqë kishte yje të artë në kapele dhe u jepte urdhëra të tjerëve, ndodhej nja dhjetë këmbë larg, në një pozicion gjysmë i shtrirë. "Unë vetëm qaja gjatë gjithë kohës dhe i shtyja duart atij tjetrit," tha gruaja. "Më në fund, ai m'u drejtua e më tha, s'kam ndërmend të të bëj gjë. Komandanti na kish ngulur sytë e po na shihte."

Pas afro dhjetë minutash, ushtarët u kthyen në dhomë dhe, ndonëse ende lakuriq, gruaja u detyrua t'u shërbente kafenë. Paskëtaj, ata i thanë të vishej dhe të pastronte. Ajo mblodhi pjatat dhe filxhanët e palarë dhe fshiu dyshemenë. Si mbaroi punët, ajo u kthye në shtëpinë ku ndodheshin edhe gratë e tjera. Kur gratë e tjera e pyetën, çfarë i kishte ngjarë, ajo s'pranoi t'u thoshte gjë.

Viktima e dytë e përdhunuar i kallzoi Human Rights Watch se, policët e morën nga shtëpia ku ishte mbyllur dhe e çuan në një shtëpi tjetër. Atje e futën në një dhomë dhe e shtrënguan të zhvishej lakuriq. Njëri pas tjetrit, pesë pjesëtarë të forcave serbe hynë në dhomë për ta parë, por vetëm ai që hyri i fundit e përdhunoi, tha ajo. Ndërkohë që ai i qe turrur, katër të tjerët hynë në dhomë për të parë. Gruaja do të deklaronte gjithashtu se, dikush kishte vendosur njëwalkie-talkie poshtë krevatit që ndodhej në dhomë dhe, gjatë gjithë kohës, serbët i çirreshin përmes walkie-

talkiet për ta frikësuar. Gjithë-gjithë, ata e kishin mbajtur afro gjysmë ore në atë dhomë. Ajo tha:

> Pesë ushtarë erdhën një nga një në dhomën ku unë ndodhesha lakuriq. Vetëm i fundit pati kontakt fizik me mua; të tjerët vetëm sa panë dhe më thanë: "Po të të pyesin të tjerët, thuaju që pate marrëdhënie edhe me ne." Çdo njëri prej tyre qëndroi fare pak minuta me mua … I fundit qëndroi më gjatë se të tjerët. Pas pak, katër të parët hynë në dhomë dhe na panë duke bërë seks; ata qëndruan dhe bënë sehir. Ndenja në dhomë jo më shumë se gjysmë ore.[51]

Gratë që kishin pasë qenë në fshat, i thanë Human Rights Watch, se ato kishin parë ose dëgjuar se si forcat serbe kishin marrë e mbajtur gra gjatë tri ditëve të pengmbajtjes së tyre. Një grua e moshuar tha se, natën e tretë, policët hynë në shtëpinë ku ndodhej, duke iu drejtuar dritën e elektrikëve të dorës grave në fytyrë, teksa shumë prej tyre mundoheshin të mbulonin kryet me shall. Ata gjetën një grua dhe i thanë: "Ti do të vish me ne." Ajo u kthye pas nja dy orësh dhe, kur e pyetën se çfarë kishte ngjarë, tha, "Mos më pyesni për asgjë."[52]

Human Rights Watch foli me një doktor nga Emiratet e Bashkuara Arabe, në kampin e refugjatëve në Kukës, Shqipëri, ku ishin vendosur e rrinin refugjatët në atë fund prilli. Ai tha se tri gra të tjera nga ai fshat kishin shkuar tek ai më 27 prill, për t'i kallzuar që ishin përdhunuar. Doktori tha se, njëra prej tyre shfaqte shenja të dukshme të një tronditjeje të madhe psikike.[53]

Ajo u kthye pas nja dy orësh dhe, kur e pyetën se çfarë kishte ngjarë, tha, "Mos më pyesni për asgjë."

Të shtunën, më 24 prill, të gjitha gratë e fshatit ishin shtrënguar të shkonin në një fshat tjetër, aty pranë, ku i kishin mbyllur në shkollën lokale për dy ditë e dy netë pa ujë e ushqim, ndonëse asnjëra s'do të raportonte për abuzime të tjera fizike. Më 26 prill, Kryqi i Kuq serb, shkoi në shkollë dhe i furnizoi gratë e fëmijët me bukë, qumësht dhe konserva. Më pas, grupi ishte hipur në dy autobuzë dhe ishte çuar në fshatin Zhur, ku qenë detyruar të kalonin kufirin e të hynin në Shqipëri.

Banorët e fshatit u kthyen në shtëpitë e tyre më 16 qershor. Human Rights Watch e vizitoi fshatin më 1 gusht. Vetëm dy nga njëzet e tetë shtëpitë e fshatit nuk ishin dëmtuar në një farë mënyre, kryesisht nga zjarri.

Fshatarët i thanë Human Rights Watch se, dymbëdhjetë burra ishin vrarë gjithsejt në fshat. Njëri prej tyre ishte vrarë më 5 maj, në fushë. Njëmbëdhjetë të tjerët ishin vrarë më 21 prill. Emrat e dhënë përkonin saktësisht me ata që i ishin ofruar Human Rights Watch nga gratë refugjate në Shqipëri. Përputheshin gjithashtu edhe moshat, nga dyzet e nëntë deri më nëntëdhjetë e një vjeç. Sipas fshatarëve, të njëmbëdhjetë trupat ishin gjetur në një pus të fshatit, që më pas ishte hedhur në erë. Human Rights Watch, pa varret e freskët të njëmbëdhjetë burrave, në skaj të fshatit. Sipas raportit të datës 10 nëntor, drejtuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, prokurorja e përgjithshme e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, Carla Del Ponte, thoshte se, ekspertët kriminalistë kishin zbuluar dymbëdhjetë trupa në atë fshat.[54]

Sipas fshatarëve, trupat e para qeveritare që hynë në fshat mbanin uniforma ngjyrë të zezë ose të gjelbër. E megjithatë, ditën e dytë, atyre do t'u shtoheshin edhe njerëz të armatosur me uniforma të gjelbra, që mendohej se ishin personel i ushtrisë. Shumë prej serbëve mbanin shirita ngjyrë kafe në krah; disa prej kriminelëve mbanin flokë të gjatë e mjekra, ndërsa të tjerët kishin maska të zeza, skish. Sipas një dëshmitari, njëri prej policëve me flokë të zezë, kishte një rrip të verdhë në mes të ballit. Njëra nga viktimat e përdhunuara tha se, pjesa më e madhe e serbëve në shtëpinë ku e kishin çuar, mbanin kama të gjata në brez.

TËRRNJE

Human Rights Watch do të fliste me tre dëshmitarë okularë të një vrasjeje masive, të kryer më datë 25 mars në fshatin Tërrnje, i cili ndodhet gjashtë kilometra në jugperëndim të qytetit të Suharekës. Të intervistuar veç e veç, dëshmitarët raportuan për atë çka ata e kishin përjetuar vetë, drejtpërsëdrejti, dhe që do të thoshte se, shifra e të vrarëve nga forcat e sigurimit serb luhatej nga njëzet e katër deri më tridhjetë e gjashtë persona, por në total numri mund të ishte edhe më i madh.[55] Njëri nga dëshmitarët i kishte parë trupat serbe t'i largonin trupat nga vendngjarja, katër ditë më pas.

Të tre dëshmitarët, dy nga Tërrnja dhe i treti me origjinë nga Studenqani, dëshmuan se forcat qeveritare të sigurimit hynë në fshat rreth orës 6 të mëngjesit, të datës 25 mars. Me sa duket, dy shtëpi që

ndodheshin në skaj të fshatit, ishin vënë prej kohësh në shënjestër. Njëri nga dëshmitarët, I. G., i cili kish mbijetuar pas të shtënave në shtëpinë e vet, i tha Human Rights Watch:

> Dy policë hynë në shtëpi, drejt e në dhomën e ndenjjes, ndërsa tetë a dhjetë të tjerë qëndruan jashtë, me pushkët gati. Polici që hyri brenda na tha të dilnim jashtë. Madje s'na lanë të vishnim as këpucët. Dola dhe pashë policët e tjerë (në oborrin e shtëpisë) dhe plot të tjerë jashtë portës së shtëpisë, pa zënë ngoje një tjetër grup që vinte nga shkolla. Policë të tjerë po qëndronin te muri dhe na kishin drejtuar armët. Ata na thanë të uleshim dhe, ne u ulëm në rresht, ndërkohë që im atë ishte i fundit. Im atë m'u afrua dhe më tha se do të hynte në shtëpi, por kur mori të hynte në shtëpi, dy policë që ndodheshin brenda e qëlluan në qafë dhe e vranë në vend.
>
> Paskëtaj, njëri prej tyre erdhi tek unë se, ku ishin burrat e tjerë, ngaqë aty ishin vetëm tri burra, ndërsa pjesa tjetër ishin vetëm gra e fëmijë. Ata nxorën nga xhepat ca emblema të UÇK-së, m'i rrasën në gojë dhe më thanë t'i drejtohesha NATO-s. Pastaj më qëlluan me qytën e pushkës pas koke. Më thyen kafkën, (më vonë) u operova. Rashë përdhe dhe për një moment humba ndjenjat. Kur hapa sytë sërish, pashë tetë policë të rreshtuar që zunë të na qëllojnë me (pushkë) automatike. Vetëm ne të dy do të mbijetonim, unë dhe kushëriri im N. B. nga Studenqani. Njëri nga fëmijët jetoi rreth tridhjetë orë pas masakrës, por vdiq më pas. Mua nuk më kishte marrë asnjë plumb. Pasi i vranë të gjithë, ata shkuan e dogjën tri shtëpi. Vetëm një dhomë ishte në rregull.[56]

Më pas, dëshmitari në fjalë u largua nga shtëpia, në kërkim të njerëzve të tjerë në fshat. Në shtëpinë e familjes Voci, ai pa Ali Vocin përtokë e të vdekur. Në shtëpinë e një të afërmi, ai pa Shemsiun dhe Votimin (një fëmijë shtatë vjeç) gjithashtu të vrarë. Gjithë-gjithë, sipas dëshmitarit, më datë 25 mars ishin vrarë në fshat tridhjetë e gjashtë njerëz, ndërsa nëntë të tjerë ishin vrarë më pas, gjatë luftës. Por, ai mundi të rendiste vetëm emrat e njëzet e katër viktimave.

Human Rights Watch foli me një tjetër të mbijetuar, N. B., i cili e konfirmoi dëshminë e I. G.-së.[57] Ai tha se kishte pasë ardhur në Tërrnje për t'u bashkuar me njerëzit e tij, ngaqë në fshatin e tij, Studenqan kishin nisur të shtënat e granatimet qysh më 20 mars, pasi ishte larguar

OSBE-ja. Ai shpjegoi se si më 25 mars, në Tërrnje, njëri nga personat e armatosur me uniformë të gjelbër, mbante në dorë një emblemë të UÇK-së, duke kërkuar të dinte se cili ishte pronari i shtëpisë. Siç tha N. B., ishte pikërisht ky njeri që urdhëroi të hapej zjarr:

> Njeriu me emblemën (e UÇK-së) në dorë urdhëroi: "Hapni zjarr!" Për një sekondë, ata nisën të shtinë dhe të gjithë ne ramë përdhe. Mua më kapi plumbi në dorën e majtë.[58] Pashë që ishte mbuluar krejt me gjak dhe nuk mund ta lëvizja. Pasi u shemba përtokë, dëgjova një tjetër të shtënë – ata po shtinin mbi mua ngaqë po lëvizja. Por, asnjëri nga plumbat nuk më zuri. Qëndrova në këtë pozicion, tre deri në pesë minuta, dhe kur s'më zuri veshi gjë tjetër, u ngrita. Vura re që një fëmijë nëntë vjeç po lëvizte ende. Shkova te makina ime, që nuk ishte më larg se pesë metra dhe në atë moment I. G., që e kisha në të djathtë, u ngrit më këmbë. Kokën dhe qafën e kish të larë në gjak. Ndërkohë që po pyesnim shoku-shokun se ku ishim goditur, vumë re që të tjerët nuk po lëviznin më.[59]

Dëshmitarët raportuan se shifra e të vrarëve nga forcat e sigurimit serb luhatej nga njëzet e katër deri më tridhjetë e gjashtë persona.

Dëshmitari i tretë ndodhej në një shtëpi tjetër, jo në atë të I. G.-së dhe N. B.-së. Ky person, shtatëdhjetë e një vjeç, i pa forcat e sigurimit – ai nuk ishte në gjendje të përcaktonte nëse ishin të policisë apo të ushtrisë – të hynin në fshat, mëngjesin e datës 25 mars. Ai tha se, ata erdhën dhe dogjën stallën. Më pas, rreth dhjetë a dymbëdhjetë njerëz të armatosur hynë në shtëpinë e tij. Hodhën një granatë dore, por nuk u plagos njeri.

Paskëtaj, trupat u shpërndanë nëpër shtëpitë e tjera të fshatit, duke përfshirë edhe atë të I. G.-së. Pasi kaloi një copë herë, dëshmitari doli nga shtëpia të shihte ç'bëhej rreth e rrotull. Ai pa trupin e vdekur të Shemsi Gashit (dyzet vjeç), nusen e të birit (emri i panjohur), dhe Votim Gashit (shtatë vjeç). Siç tha ai, disa njerëz ishin vrarë në një shtëpi tjetër, duke përfshirë Barie Gashin, Ajmane Gashin, dhe Besarta Gashin, të gjitha pjesëtare të familjes së tij, si dhe Rahime Vocin (pesëdhjetë a pesëdhjetë e pesë vjeç), Ramadan Krasniqin (shtatëdhjetë e tre vjeç), Refie Krasniqin (dyzetë e tetë a dyzetë e nëntë), Behare Krasniqin (shtatzanë, a njëzet e tre a njëzet e katër vjeçe). Dyqind metra më tutje gjendeshin trupat e

nipërve të dëshmitarit, Shaban Gashi (tridhjetë e tetë vjeç), dhe Hamzi Gashi (tridhjetë e pesë vjeç), si dhe të Muhamet Krasniqit (gjashtëdhjetë e tre vjeç), dhe Refik Reshajt (dyzet e nëntë vjeç). Dhe së fundi, Haki Gashi (shtatëdhjetë e tre vjeç) u vra në rrugë dhe Mehmet Limani (pesëdhjetë e pesë vjeç) u vra në oborrin e shtëpisë së dëshmitarit.[60]

E dija që kishin ardhur të merrnin trupat.

Më 29 mars, katër ditë pas vrasjeve të kryera në fshat, N. B. deklaron të ketë parë trupat serbe të zhvendosnin kufomat nga Tërrnje, me kamion. Ai tha:

> Herët në mëngjes dëgjova një kamion të vinte nga Leshane. Dëgjova kur ndaluan, kur hapën dyert metalike dhe e dija që kishin ardhur të merrnin trupat. Dëgjova kur i ngarkuan në kamion dhe dëgjova serbët që ankoheshin për kutërbimin e trupave. I ngarkuan të gjithë dhe u kthyen në Leshane. Gjithashtu ata dogjën veturën, traktorin tim dhe një dhomë tjetër, ku ndodhej Mysliu.
>
> Në darkë, shkova në oborrin e Mysliut dhe pashë që i kishin marrë të gjithë trupat. S'kish mbetur gjë tjetër, veç xhaketës së një fëmije. S'pashë këmbë njeriu në fshat dhe nuk po dija si të veproja. Atëherë vendosa të shkoja në Mamushë, ku fshiheshin njerëzit e ikur nga Studenqani. Mbërrita në mesnatë, por njerëzve iu kishte hyrë data dhe s'pranonin më refigjatë, kështu që i kalova dy netë në xhami. Pas ca erdhën njerëz nga fshati Pagarushë, kësisoj morëm një kamion dhe shkuam në Shqipëri. Ngritëm një flamur të bardhë, për t'u treguar që ishim dorëzuar.[61]

14

KOMUNA E VUSHTRRISË

E pozicionuar në pjesën veriore të Kosovës Qendrore, komuna e Vushtrisë, në periudhën e paraluftës, kishte një popullsi me afro 90.000 banorë, 90 përqind e të cilëve ishin shqiptarë etnikë. Serbët gjendeshin kryesisht në qytetin e Vushtrisë dhe në capak fshatra rreth e qark. Qysh në fillim të vitit 1998, UÇK-ja kishte qenë e pranishme në malet e Çiçavicës, që shkojnë paralelisht me rrugën kryesore dhe hekurudhën që lidh Mitrovicën me Prishtinën. Përgjatë viteve 1998 dhe 1999, do të shënoheshin një sërë sulmesh të UÇK-së në këtë segment rrugor.

Më 25 shkurt 1999, Ushtria Jugosllave ndërmori në territorin e Vushtrisë, atë çka ajo do ta quante "stërvitje dimërore". Siç do të raportonte më vonë OSBE-ja, stërvitja nuk ishte gjë tjetër veçse një operacion i ushtrisë për të pastruar lidhjen rrugore dhe hekurudhore që lidhte veriun e Kosovës me Serbinë, duke e shtyrë UÇK-në lart në male, synim ky që ata ia arritën.[1]

Qyteti i Vushtrisë do të granatohej ditën që nisën bombardimet e NATO-s dhe mijëra banorë të tij do të dëboheshin që javën e parë të fushatës ajrore. Më 3 prill ishin organizuar disa autobuzë për dërgimin e banorëve në Maqedoni. Një tjetër valë shpërnguljesh të dhunshme do të niste më 15 prill.

Incidente sporadikë do të ndodhnin në veriperëndim dhe jugperëndim të Vushtrisë gjatë bombardimeve, ndonëse pjesa më e madhe e civilëve ishin larguar nga ai rajon për shkak të luftimeve. Aty nga fundi i prillit, një numër i madh personash të shpërngulur ishin mbledhur në Kiqiqin e Madh, në veri të Vushtrisë. Më 2 maj, ata do të shpërndaheshin forcërisht në drejtime të ndryshme.


VERIU
Lumi i Bardh
0 km 5
Mitrovice
Bajgore
Melenice
Vesekofc
Kurillove
Podujeve
Mitrovice
Vushtrri
Podujeve
Slakovc
Burgui
Smrekonice
Studime
e Eperme
Cecelija
Vushtrri
Studime
e Ulet
Dumnica
e Eperme
Bukosh
Dumnica
e Luges
Malet
Sitnice
Dumnica
e Ulet
Llap
e Cicavices
Prishtina
Skenderaj
Obiliq
Obiliq
Gllogofc
Prishtina
Fushe
Kosove
JUGOSLLAVI
Vushtrri
KOSOVA
SHQIPERI
MAQEDONI
Michael S. Miller / Human Rights Watch, 2002

Përgjatë gjithë prillit, me dhjetëra, mijëra shqiptarë etnikë të shpërngulur u mblodhën në rajonin e Shalës të po kësaj komune, ku ishin të pranishme forcat e UÇK-së, në veri dhe lindje të qytetit të Vushtrisë. Një ofensivë e trupave qeveritare në fund të prillit dhe fillim të majit do të shpërthente vijat mbrojtëse të UÇK-së e depërtonte në veri të rajonit, pranë fshatrave Bajgorë dhe Melenicë. Të gjithë personat e shpërngulur u larguan kryesisht në dy drejtime: në lindje, në drejtim të Podujevës ose në jug, përgjatë lumit Sllakovc.

Trupat policore dhe paraushtarake bllokuan karvanin e njerëzve që udhëtonte në drejtim të jugut. Më datat 2 dhe 3 maj, diku midis Studimes së Epërme dhe Studimes së Poshtme, policët dhe paraushtarakët, vranë rreth njëqind burra, siç është përshkruar edhe më poshtë. Në muajin maj, si në fshatra ashtu dhe jashtë tyre, do të kryheshin ekzekutime kuturu, duke përfshirë këtu edhe vrasjen e dymbëdhjetë njerëzve nga e njëjta familje. Vetëm në Studimen e Epërme, ekipet e ekspertëve kriminalistë të Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, do të zbulonin nëntëdhjetë e tetë trupa. Sipas banorëve të Vushtrisë, por edhe punonjësve të OKB-së të vendosur në Kosovë pas luftës, një tjetër masakër masive do të ndodhte në qytetin e Vushtrisë në 22 maj, ku do të gjenin vdekjen gjashtëdhjetë e nëntë vetë. Megjithatë, ky incident nuk është përfshirë në këtë raport. ICRC-ja do të regjistronte gjashtëdhjetë e nëntë vetë të zhdukur nga Vushtria po atë ditë, ndonëse nuk është shumë e qartë nëse bëhet fjalë për të njëjtët persona.[2]

Në këtë kapitull është përfshirë gjithashtu edhe trajtimi i shqiptarëve etnikë të mbyllur në burgun e Smrekonicës, në veri të komunës. Pjesa më e madhe e tyre, më shumë se 3000 sipas OSBE-së, [3] u përzunë nga Kosova në fund të majit dhe fillim të qershorit dhe, sipas raportit, të dëmtuar fizikisht gjatë kohës së burgosjes.

STUDIME E EPËRME DHE STUDIME E POSHTME

Sulmi i datës 2 maj mbi vargan

Teksa ndodheshin në Kukës, Shqipëri, gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s, hulumtuesit e Human Rights Watch intervistuan gjashtë shqiptarë kosovarë, të cilët kishin qenë dëshmitarë të sulmit të kryer mbi

varganin e refugjatëve, pranë Studimes së Epërme. Të intervistuar veç e veç, çdonjëri prej tyre do të ofronte dëshmi të qenësishme sesi policët dhe paraushtarakët serbë, kishin zbritur me përdhunë burrat nga traktorët që përbënin varganin e shqiptarëve etnikë dhe më pas kishin qëlluar për vdekje disa prej tyre që ndodheshin nën mbikqyrjen e tyre.[4] Intervista të tjera do të bëheshin edhe me shqiptarë etnikë të asaj krahine, të cilët ishin marrë nga vargani dhe mbyllur në burg (shih pjesën mbi burgun e Smrekonicës). Përfundimisht, në muajin gusht, Human Rights Watch vizitoi Studimen e Epërme dhe Studimen e Poshtme, si dhe intervistoi edhe nëntë fshatarë të tjerë, të cilët vërtetuan versionet e ngjarjeve që kishin dhënë dëshmitarët e parë, por ofruan edhe hollësi të tjera.

Trupat qeveritare shpërthyen vijën e frontit të UÇK-së pranë Bajgorës dhe Meljenicës, dhe depërtuan në brendësi, duke i detyruar të gjithë ata që kishin gjetur strehë në këtë vend, të largoheshin.

Sipas të intervistuarve, forcat serbe urdhëruan një grup shqiptarësh etnikë nga qyteti i Vushtrisë dhe fshatrat rreth e rrotull, të braktisnin shtëpitë diku aty nga fundi i marsit dhe fillimi i prillit. Pesë autobuzë i morën dhe i mbartën shqiptarët etnikë në kufi me Shqipërinë. Disa prej shqiptarëve etnikë u lejuan të qëndronin në zonën përqark Vushtrisë deri më 2 maj, ndërsa të tjerët u shtrënguan të lëviznin kohë pas kohe për shkak të sulmeve të vazhdueshme ose granatimeve të kryera nga forcat serbe.

Së fundi, shumë prej personave të shpërngulur përfunduan në fshatrat që ndodheshin në verilindje të Vushtrisë, të cilat ndodheshin nën kontrollin anësor të UÇK-së, si Bajgorë, Vesekofc, Kurillovë dhe Sllakovc, ku UÇK-ja kishte një spital fushor. Kësisoj e gjithë kjo zonë u tejpopullua dhe një sërë dëshmitarësh do të raportonin se qëndronin në shtëpi ku kishin gjetur strehë më shumë se njëqind vetë, ndërkohë që të tjerë ishin të detyruar të flinin në qiell të hapur.

Në të hyrë të majit, trupat serbe dhe jugosllave ndërmorën një ofensivë dhe granatuan një sërë fshatrash përqark rajonit të Bajgorës. Më 2 maj, trupat qeveritare shpërthyen vijën e frontit të UÇK-së pranë Bajgorës dhe Meljenicës, dhe depërtuan në brendësi, duke i detyruar të gjithë ata që kishin gjetur strehë në këtë vend, të largoheshin pa humbur kohë.[5] Një karvan refugjatësh mori në drejtim të jugut, për nga fshatrat e Sllakovcës dhe Cecelisë, ku do t'iu bashkangjiteshin të tjerë shqiptarë

etnikë, që kishin pasë kërkuar strehë atyre anëve. Duke iu referuar vlerësimeve të dështmitarëve, në këtë pikë, karvani përbëhej nga disa qindra automjete, si dhe tre deri pesë mijë refugjatë, të gjithë të drejtuar për nga fshati Studime e Epërme. Trupat serbe dhe jugosllave i ndiqnin refugjatët gjatë gjithë rrugëtimit të tyre, duke djegur një numër të madh shtëpish në Sllakovc dhe Ceceli.

Ushtarët zunë të na mallkojnë dhe teksa çapiteshin mes nesh, shkelmonin e rrihnin kë t'iu dilte para.

Dështmitarë të ndryshëm i thanë Human Rights Watch se, ata kishin qëndruar për të pushuar dhe diskutuar rreth planeve të tyre në Studimen e Epërme, e cila, deri në datën 2 maj, ishte nën zotërimin e UÇK-së. Sipas disave, forcat e Ushtrisë Jugosllave ishin vendosur në një magazinë në Studimen e Poshtme, një fshat prej nga duhej të kalonin refugjatët për të mbërritur në Vushtrri. S. A., një grua tridhjetë vjeçare nga Novosellë e Begut, që ndodhej mbi traktorin e parë, në krye të varganit, i kallzoi Human Rights Watch, çka ndodhi rreth orës 8 të darkës, në datën 2 maj:

> (Ne) vendosëm të lidhnim një rrobë të bardhë te traktori ynë, për t'iu dhënë të kuptonin se ishim gati për t'u dorëzuar. Por, pa mbërritur në Studimen e Poshtme, ata zunë të shtinin e granatonin mbi ne në një mënyrë të tmerrshme. Unë përdora një dyshek për të mbuluar fëmijët dhe ngamë për në Studimen e Poshtme. Kur mbërritëm te magazinë, pamë në të majtë të rrugës një resht me ushtarë.
>
> Ata na ndaluan, na thanë të zbrisnim nga traktorët, të vendosnim duart pas kokës dhe të uleshim në rrugë. Ushtarët zunë të na mallkojnë dhe teksa çapiteshin mes nesh, shkelmonin e rrihnin kë t'iu dilte para. Një grua e rrahën vetëm ngaqë po i qante foshnja. [6]

Nga ora 8.30 deri më 9 të darkës, ushtarët të shoqëruar nga policët dhe paraushtarakët, do të shkonin nga njëri traktor te tjetri përgjatë gjithë varganit, duke nëmur e iu kanosur refugjatëve. Në të njëjtën kohë, edhe ushtarët që vinin nga Sllakovcë dhe Ceceli, e kishin mbërritur karvanin. Ata kishin veshur uniforma ngjyrë blu ose të blertë. Një pjesë mbanin mjekra, ndërsa të tjerët ishin fytyrëmaskuar.

K. B., një shqiptar tridhjetë e katër vjeç nga Vushtrria, i cili kish pasë qenë i fshehur nëpër fshatra, i tregoi Human Rights Watch, atë që ndodhi më pas:

> Kur ata (policët dhe paraushtarakët) mbërritën tek ajo pjesë e karvanit ku ndodhesha unë, e pyetën tim vëlla ku e kishte uniformën e UÇK-së dhe armën. Ai ua ktheu se nuk kishte, ngaqë nuk qe pjesëtar i UÇK-së. Paskëtaj, ata e goditën me qytën e pushkës dhe erdhën tek unë e më thanë të zbrisja nga rimorkioja. Sapo zbrita, ai më goditi me qytë në mollëzë, ballë e gojë, duke më thyer një dhëmb. Paskëtaj më qëlluan me bajonetë dhe desh më prenë veshin. Më pas më kapën nga bërryli, më vunë automatikun në shpinë dhe më hoqën zvarrë për afro njëzet metra. Aty më shtynë drejt një përroi të vogël dhe teksa kërceva mbi të, rashë përtokë. Kur u ngrita, ata më goditën katër herë nga pas kokës dhe një herë te brinjët. Kohë më vonë, një doktor më tha se, se ata më kishin thyer një brinjë. U rrëzova përsëri dhe ndenja shtrirë për afro dy minuta, paskëtaj u ngrita dhe u ktheva te traktori.
>
> Pasi më kishin rrahur, më zunë sytë tre ushtarë apo policë duke hequr zvarrë dy vajza, ndërmjet shtatëmbëdhjetë dhe njëzet vjeç. I morën me vete dhe i shpunë nja njëzet a tridhjetë metra më tutje, kështu nuk arrita të shihja se ç'ndodhi me to. Kur u kthyen pas pesëmbëdhjetë a njëzet minutash, vura re që i kishin këmishët të grisura në gjoks. [7]

Human Rights Watch e vizitoi dhe më pas i fotografoi plagët e K. B.-së, kur e intervistoi në Kukës, Shqipëri. Majën e veshit të majtë e kishte të çarfalitur, por ia kish qepur një doktor në një nga kampet e refugjatëve, ndërsa njëri nga dhëmbët e përparmë ishte i thyer. Por kishte të tjerë që e kishin pësuar edhe më keq. Z. A., një burrë dyzet e katër vjeç, nga fshati Novosellë, përshkroi atë çka i kish ndodhur familjes së tij:

> Rreth orës 9 të mbrëmjes, paraushtarakët dhe ushtria na ndaluan. Nuk arrija t'i shihja mirë, ngaqë ishte errësuar. Na morën gjithë paratë dhe florinjtë. Dy paraushtarakë me maska dhe shami morën xhaxhain tim Remzi Aliu (pesëdhjetë e katër vjeç) dhe nipin tim, Ramadan Aliu (tridhjetë e tetë vjeç). Iu kërkuan para. Më pas i shpunë nja tridhjetë metra më tutje dhe iu shkrehën breshëri automatikësh. Pas tyre morën Hajrullah Aliun me të shoqen, por ata iu dhanë (policëve dhe paraushtarakëve) 500 marka gjermane, e kësisoj, ata nuk i vranë. [8]

B. A. një nëntëmbëdhjetë vjeçar nga Studimja e Poshtme, kallzoi një ngjarje të ngjashme:

Kur ata (ushtarët që vinin nga Cecelia) na u ofruan, njëri prej ushtarëve serbë rroku nga bërryli tim vëlla, njëzet e shtatë vjeç, dhe e shpuri nja tre metra larg prej traktorit. Ai i kërkoi para dhe menjëherë paskësaj e qëlloi me pistoletë pas krahëve.

"Paskësaj, ai ma drejtoi kallashnikovin te nofulla dhe më tha: 'Ke dy minuta kohë të më japësh 1000 marka.'"

Në të njëjtën kohë, ata morën edhe xhaxhain tim, shtinë mbi të, e shkelmuan dhe ai u shemb përdhe. Pamë dy trupa të plandosur përtokë dhe menduam se duhej të ishin të vdekur. Paskëtaj, ata shkuan e morën edhe tim atë dhe teksa i vunë pistoletën në grykë, i kërkuan paratë. Babai u dha njëqind marka gjermane, atëherë ata i kërkuan njëmijë. I thashë babait t'i jepte sa i kërkonte, kështu që im atë u kthye te traktori dhe i dha atij edhe nëntëqind marka të tjera. Vetëm paskësaj, ata e liruan tim atë, por aty për aty shkuan e mbërthyen kushëririn tim, të cilit i kërkuan gjithashtu para. Kështu që im atë u dha atyre përsëri pesëqind marka dhe ata e liruan kushëririn. Pasi u largua ushtria, dëgjuam xhaxhain që po më thërriste t'i shkoja në ndihmë. Pas pak minutash, im atë tok me gjyshin shkuan e morën dhe e sollën në krah te traktori sepse ai nuk mund të ecte, ngaqë ishte qëlluar në këmbë. Kur e kthyen tim vëlla me fytyrë nga qielli, vunë re që kishte vdekur.[9]

Një tjetër burrë nga Studimja e Epërme, përshkroi se si kishte parë me sytë e tij, kur tre persona i kishin zbritur nga traktori dhe qëlluar për vdekje:

Pranë traktorit tim mund të ishin nja pesëmbëdhjetë paraushtarakë. Ata ndriçuan me një elektrik dore babain e një fëmije katër vjeç. Njëri prej tyre shtyu mënjanë fëmijën me automatik dhe, ndërkohë, shtiu mbi të atin, Agim Gërguli (tridhjetë e shtatë ose tridhjetë e tetë vjeç), baba i katër fëmijëve. Paskëtaj, i kërkuan diçka Enver Gërgulit (dyzet vjeç) një i afërm i imi, por ai ishte shurdhmemec, kështu që nuk iu përgjigj. Ata e mbërthyen nga kravata dhe e zbritën nga traktori. Atëherë kërceva nga traktori dhe iu luta të mos e vrisnin. Ata më thanë t'iu jepja para, përndryshe do ta bënin shurdhmemecin të fliste. Iu dhashë 800 marka dhe ata u larguan të kënaqur. Më pas erdhi një tjetër tip. E hoqi tim vëlla mënjanë, nja dy metra më tutje dhe shtiu mbi të.

Ai u kthye sërish me një elektrik dore dhe pikasi një tjetër kushëri

> timin, Namanin (tridhjetë e nëntë vjeç). E shpuri nga ana tjetër e traktorit dhe i kërkoi para. Unë u dhashë 1400 marka, por ata shtinë mbi të me kalashnikov dhe e vranë nja dy metra më tutje. Për një çast mendova se mund të ishte ende gjallë, ndaj i thashë të hidhej në ujë e të kalonte në anën tjetër. Por aty ndodhej një tip që e kuptoi (çfarë thashë), dhe sakaq ata e qëlluan përsëri me kallashnikovë. Paskësaj, ai ma drejtoi kallashnikovin te nofulla dhe më tha: "Ke dy minuta kohë të më japësh 1000 marka." Po mua s'më kish mbetur as edhe një qindarkë. Gruaja dhe fëmijët ishin te traktori. Ata më thanë t'ia merrja paratë gruas. Po edhe asaj nuk i kishin mbetur më para, kështu që desha s'desha u dhashë paratë e vëllait. Ndërkaq ata po numëronin: "Dy minuta, një minutë … dy sekonda, një sekondë." Atëkohë ia shtyva automatikun, që i ra nga dora dhe unë përfitova e ia dhashë vrapit e kërceva në përrua. Qëndrov aty për afro një minutë, duke menduar se ai do të vinte të më gjente. S'mund të ecja, vetëm se u hoqa zvarrë nëpër shkurre, njëzet, tridhjetë metra larg traktorit. Atëherë i dëgjova të thonin: "Gotovo, gotovo!" (Mjaft, mjaft!") Ata iu hipën makinave dhe morën më të poshtë.[10]

Human Rights Watch intervistoi edhe vëllain e Z. G.-së, M. G., i cili kishte qenë i pranishëm në një vrasje dhe kish humbur një krah si pasojë e një plage të shkaktuar nga një armë zjarri. Ai i tha Human Rights Watch se, traktorin e tij e kishin ndaluar diku midis Studimes së Epërme dhe asaj të Poshtme. Bash në atë kohë, një person i paidentifikuar qe orvatur t'ia mbathte nga karvani dhe e kishin qëlluar. Atëherë policët i kishin kërkuar para M. G.-së, i cili, iu kishte ofruar diçka, e megjithatë ata e kishin qëlluar në krah. Ai tha:

> Ata erdhën te traktori im me një elektrik dore dhe më thanë të zbrisja. Më kërkuan para dhe unë i dhashë 300 DM një polici nga Serbia, me uniformë të mbajtur mirë e i shogët. Pasi i dhashë 300 DM, ai hoqi nga supi automatikun dhe më tha të kthehesha. Mendova që do të më qëllonte dhe, me të vërtetë që ai shtiu mbi mua, dy plumba në krahun e djathtë dhe një në shpinë. Atëherë rashë mbi krahun e majtë dhe u përpoqa të lëvizja krahun e djathtë, por nuk munda, kështu që e mora krahun me dorën tjetër. Ndjeva që krahu po më ftohej. Pasi ata (trupat serbe) u larguan, i kërkova fqinjit ujë dhe ai më dha. Atëherë ai më

pyeti në isha ende gjallë dhe më morën në traktor. Kur dëgjova që ata (trupat serbe) po ktheheshin, ata më shpunë në pyll. Aty kalova natën bashkë me nënën time.[11]

Mëngjesin e ditës së nesërme, vëllezërit e M. G.-së erdhën në pyll bashkë me të atin e tyre dhe trupat e Agimit, Enverit dhe Namanit. Pasi i lanë trupat në varreza, ata e morën M. G.-në dhe e shpunë në oborrin e shtëpisë së tij. Po atë mbrëmje mbërriti një doktor nga Vushtrria, që i kuroi plagët. Më 4 maj, M. G. u çua në Sllakovc, të cilën e kish marrë sërish nën kontroll UÇK-ja, dhe atje një doktor i preu krahun me një kamë të mprehtë – këtë fakt do ta konfirmonte për Human Rights Watch, në mënyrë krejt të pavarur, doktori që kish kryer operacionin.

Dëgjova kur shtinë mbi tim bir, dëgjova dy krisma.

Një tjetër person nga Studimja e Epërme, S. B., do të dëshmonte se si forcat e sigurimit i patën ekzekutuar të birin, i cili ishte martuar po atë ditë, si dhe dy burra të tjerë nga po ai fshat. Ai i tha Human Rights Watch:

Kur erdhën te traktori im, aty ndodheshin tre vetë: im bir, Adnani, Eshref Rashica (rreth tridhjetë vjeç) dhe Ismet Statovci (ja njëzet e shtatë, ja tridhjetë vjeç). Të parin kapën Ismetin, e zbritën nga traktori dhe zunë ta rrihnin. E pyetën se nga ishte. Ai u tha që ishte nga Firaja. Njëri prej tyre tha: "Ç'e zgjat, merre dhe vrite." E vranë me automatik, dëgjova dy krisma. Nuk ishte më larg se tri-katër metra.

Paskëtaj erdhën dhe morën tim bir. E mbërthyen nga krahu i djathtë dhe e shpunë nga ana tjetër e rrugës. Unë shkova pas djalit, por ata më qëlluan me qytën e armës në mollzën e majtë dhe rashë përtokë. Dëgjova kur shtinë mbi tim bir, dëgjova dy krisma. E pashë të shtrirë përdhe. E kishin qëlluar në shpinë. Pastaj morën Eshrefin dhe e vranë edhe atë. I dëgjova duke folur në radio dhe pyetur sho-shoqin se sa njerëz ishin vrarë. Njëri prej tyre tha, shtatëdhjetë e pesë, atëherë ata ia kthyen: "vazhdoni deri sa të mbërrini te njëqinda."[12]

Një fermer pesëdhjetë e nëntë vjeçar nga Studimja e Epërme, i quajtur H. A., i kallzoi Human Rights Watch se si njerëz me uniforma policie kishin shtënë mbi të vëllain e tij dhe të birin, duke vrarë këtë të fundit. Ai tha:

Ata iu afruan traktorit tim dhe morën tim vëlla, Hakiun dhe tim bir,

> Rrahmanin (njëzet e shtatë vjeç) e i zbritën nga traktori. Pasi morën 1100 DM nga vëllai dhe djali tim, ata shtinë mbi të dy. Vëllai im u plagos në kyçin e këmbës së djathtë,[13] ndërsa djali u vra. Nuk ishte as tri metra larg dhe ata qëlluan mbi të mu para syve tanë, para syvve të së ëmës. Njerëzit që kryen vrasjen kishin veshur uniforma policie dhe mbanin maska. Kur im vëlla u shemb përdhe, ata shtinë sërish mbi të dhe i zbrazën një plumb në shpinë.[14] Plumbi e çpoi tej për tej.[15]

Plot dëshmitarë të tjerë të intervistuar nga Human Rights Watch do të tregonin se si njerëz që ata nuk i njihnin ishin ekzekutuar para syve të tyre. Siç thanë ata, ushtarë dhe paraushtarakë, endeshin poshtë e përpjetë karvanit të traktorëve, duke iu rënë në qafë njerëzve, plaçkitur dhe ngandonjëherë edhe ekzekutuar ndonjërin prej refugjatëve. Të gjithë dëshmitarët raportuan se patën dëgjuar të shtëna të përsëritura nga ora 9 deri më 10.30 e të darkës. Rreth orës 11.30 të po asaj nate, erdhën policë nga Vushtrria dhe dhanë urdhër që karvani të vihej në lëvizje në drejtim të Vushtrrisë. Rreth orës 12, të mesditës së datës 3 maj, refugjatët mbërritën në qytet.

Një sërë dëshmitarësh raportuan se kishin parë një numër të madh kufomash përgjatë rrugës për në qytet, por numri i saktë i personave të ekzekutuar nga karvani mbetet i panjohur. Katër dëshmitarë të ndryshëm mëtuan se kishin parë, i pari, njëzet e pesë; i dyti, tridhjetë; i treti, shtatëdhjetë dhe, i katërti, "mbi njëqind" kufoma. Shifrat e ndryshme mund të vijnë nga fakti se, çdonjëri prej dëshmitarëve ishte vendosur në pjesë të ndryshme të karvanit. Kështu, ata që ndodheshin në krye të karvanit, sipas të gjitha gjasave kishin parë më pak se ata që ndodheshin në fund. Hetuesit e Gjykatës për Krimet e Luftës do të zbulonin nëntëdhjetë e tetë trupa në Studimen e Epërme.[16]

Shifra të sakta do të jepnin edhe ata që ndihmuan në varrosjen e viktimave. Për shembull, Z. G. tha se, rreth orës 5 të mëngjesit, të datës 3 maj, duke u kthyer për në Studimen e Epërme, ai kishte parë shtatëdhjetë e dy trupa ndërmjet varrezave dhe vendit ku ishin vrarë të afërmit e tij. Ai tha:

> Në varreza ndodheshin nëntëdhjetë e dy trupa. Të gjitha kufomat ishin çartur – ca pa krahë, ca pa këmbë dhe të tjerat pa krye. Vetëm dy prej kufomave nuk ishin prishur. Ne i mbuluam me batanie. Hapëm disa varre dhe në çdonjërin prej tyre futën nga pesë, gjashtë kufoma. Ishim

> pak burra për të varrosur gjithë ata, na ndihmuan disi edhe ata të UÇK-së, por qe e pamundur t'i varrosnim të gjithë më 3 maj. Mundëm të varrosim vetëm tridhjetë e katër kufoma.[17]

Komandanti i njësisë së UÇK-së që përgjigjej për Studimen e Poshtme dhe atë të Epërme, tha se luftëtarët e tij kishin varrosur nëntëdhjetë e dy viktima të sulmit mbi karvan. Ai tha:

> Aty gjendeshin nëntëdhjetë e dy kufoma, të gjithë nga karvani. Viktimat ishin kryesisht shoferë traktorësh dhe rimorkiosh. Një numër i madh traktorësh ishin braktisur, teksa shiheshin njerëz të vrarë mbi traktorë. Pjesa më e madhe e tyre ishin vrarë nga afër, ndoshta me përjashtim të nja dy a tre vetëve. Për mendimin tim, shumica e njerëzve ishin qëlluar në kokë ose në pjesën e sipërme të trupit. I varrosëm në datat tre, katër dhe pesë maj. Në vendngjarje gjetëm shumë gëzhoja armësh automatike të prodhuara në Jugosllavi, si dhe gëzhoja fishekë pistolete. Ekziston edhe një video e kufomave e xhiruar nga një amator.[18]

Human Rights Watch arriti të sigurojë një kopje të videos dhe ta shohë atë. Në të dukej fshati Studime e Epërme një ditë para sulmit, si dhe ditën e sulmit. Video gjithashtu shfaq pamje të njëzet a njëzet e pesë trupa njerëzish të vrarë, pjesa më e madhe e të cilëve, sipas të gjitha gjasave, janë qëlluar në kokë, megjithëse nga videoja nuk mund të arrihet në një përfundim të sigurt për mënyrën e vdekjes së tyre. Kufomat janë xhiruar veç e veç, në plane të afërta dhe në asnjë rast nuk janë xhiruar bashkë me ndonjë objekt identifikues të peizazhit të fshatit. Veç kësaj, ndërmjet planeve të fshatit dhe planeve të çdonjërës prej kufomave, ka vazhdimisht pauza, të cilat, vijnë si pasojë e ndërprerjes së xhirimit nga njëri plan në tjetrin ose si pasojë e montimit. Gjithsesi, duhet thënë se pozicionet e trupave përkojnë me dëshmitë e ofruara nga dëshmitarët dhe videoja ngjan mëse e besueshme.

Dëshmitë rreth sulmit mbi karvanin të mbledhura nga Human Rights Watch prej dëshmitarëve të ndryshëm, përkojnë me informacionin e ofruar nga gazetarët e huaj që e mbuluan incidentin, si nga Shqipëria gjatë kohës së luftës, ashtu edhe nga Kosova pas qershorit 1999. Marrë së bashku, pesë raporte të medias të shkëputura nga shtypi në gjuhën angleze, përmbledhin nëntë deklarata dëshmitarësh okularë, çdonjëra

prej të cilave bën fjalë për vrasjet e kryera nga policia dhe paraushtarakët, më 2 dhe 3 maj. Njëri nga dëshmitarët do të deklaronte se njëmbëdhjetë pjesëtarë të familjes së tij ishin vrarë.[19] Një grua i tregoi një gazetari të *Independent* (Londër), "Ata ma vranë burrin para syve... Në krye, i rrahën burrat me qytat e pushkëve dhe më pas i vranë. Gjatë gjithë udhëtimit i kam mbajtur sytë mbyllur, ngaqë nuk doja të më rishfaqeshin ato skena."[20]

Burgosjet dhe dëbimet

Qysh kur vargani i të shpërngulurve mbërriti në Vushtrri, shqiptarët qenë drejtuar për kah një kooperativë bujqësore pranë motel Vicianum, ku do të shkonin natën në qiell të hapur, në një vend të rrethuar me gardh, nën mbikqyrjen e policisë dhe capak ushtarëve. Dëshmitarët i thanë Human Rights Watch se, në atë vend ishin mbledhur disa mijëra refugjatë, dhe vendi ishte aq tejpopulluar sa ishte e pamundur të shtrije këmbët dhe jo më të flije. Gjatë gjitha natës, rojet do të endeshin mes refugjatëve, duke iu kontrolluar kartat dhe në një sërë rastesh madje duke i rrahur njerëzit e ushtruar dhunë mbi ta.

Mëngjesin e datës 3 maj, diku aty midis orës 8 dhe 10, rreth tridhjetë policë hynë në kampin e refugjatëve. Tre dëshmitarë të ndryshëm, veç e veç, identifikuan një polic me mbiemrin Petroviç, si oficerin përgjegjës të njësisë së policisë, i cili, sipas tyre ishte komandant policie në Vushtrri. Njëri nga tre dëshmitarët nuk ia dinte emrin, ndërsa dy të tjerët pohuan se emri i tij ishte Dragan.[21]

Dëshmitarët përkonin me sho-shoqin kur thanë se, policët i urdhëruan meshkujt nga mosha tetëmbëdhjetë deri më gjashtëdhjetë vjeç, të ndaheshin nga gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Më pas, policët morën e verifikuan letërnjoftimet e 500 a 600 meshkujve të ndarë nga pjesa tjetër e refugjatëve. Të gjithë shoferët e traktorëve, që bënin pjesë në këtë grup, gjithë-gjithë 200 vetë, u lejuan të ribashkoheshin me familjet e tyre.

Paskëtaj, sipas dëshmitarëve, erdhi një kamion i madh në të cilin hipën pesëdhjetë a gjashtëdhjetë nga meshkujt e mbetur dhe më pas, kamioni do të largohej në drejtim të Mitrovicës. Pas afro dhjetë, njëzet minutash, kamioni u kthye, këtë herë i zbrazur dhe transportoi një tjetër grup meshkujsh në të njëjtin drejtim. Dëshmitarët raportuan se këtë gjë, ky kamion e bëri jo më pak se tetë herë.

Ndërkohë që grupet e burrave transportoheshin me kamion, shoferët e traktorëve u porositën të ngarkonin familjet në mjetet e tyre të transportit dhe të merrnin në drejtim të Mitrovicës. Ata që do të largoheshin të parët nga kampi, i thanë Human Rights Watch se, teksa po udhëtonin në atë drejtim, kishin parë kamionin që ishte përdorur për të mbartur meshkujt, të parkuar jashtë burgut të Mitrovicës. Dëshmitarët pohuan se kishin parë një numër njerëzish që ishin marrë nga kooperativa bujqësore në Vushtrri, duke përfshirë këtu edhe disa prej pjesëtarëve të familjeve të vetë dëshmitarëve.

Një tjetër dëshmitar, që nuk bënte pjesë në karvanin e Studimes së Epërme, deklaroi se kishte parë shqiptarë në dhe pranë burgut të Smrekovnicëc, më 3 maj. S. B., tridhjetë e tetë vjeç nga Bajgora, i intervistuar në Kukës, tha se kishte mbërritur në Smrekovnicë më këmbë, mëngjesin e datës 2 maj, tok me një grup prej afro 3000 fshatarësh nga Bajgora dhe zonat përreth. Rreth orës 5 të pasdites së po asaj dite, policët shkuan në shtëpinë e xhaxhait të tij, ku ai ishte fshehur, dhe e urdhëruan t'i bashkangjitej pjesës tjetër të grupit që ndodhej në oborrin e shkollës së Smrekovnicës, e cila është ngjitur me burgun. S. B. i tha Human Rights Watch, se kish parë disa mijëra njerëz të mbyllur në burg, ndonëse nuk është e qartë se nga e nxori ai këtë shifër dhe, nga ana tjetër, nëse ai i kishte parë gjithë këta njerëz në burg apo rreth e qark burugut. Ai deklaroi gjithashtu se, afro 300 burra që ndodheshin me të në oborrin e shkollës, i morën dhe i mbyllën në burg. Çdo orë, grupe të vegjël njerëzish liroheshin nga burgu dhe, sipas dëshmitarit, të gjithë ata, dukej që ishin rrahur.[22]

Me t'u kthyer në Vushtrri, vargani i përbërë kryesisht nga gra, fëmijë e të moshuar, do të udhëtonte i shoqëruar nga policia përmes Smrekovnicës në Mitrovicë dhe prej andej, i pashoqëruar më nga policia, në Skënderaj, Pejë dhe Klinë, ku karvani i të shpërngulurve do ta kalonte natën. Nga Klina, përmes një rruge të vogël në jug shkuan në Prizren dhe më pas, në Morinë, në pikën e kalimit të kufirit me Shqipërinë, që do ta kaptonin më 4 maj.

Të tjera vrasje

Pasi të shpërngulurit e parë, ata të karvanit, u dëbuan, rreth 15.000 deri më 40.000 shqiptarë etnikë mbetën në një zonë që shkonte nga Cecelia dhe Dumnica, pak kilometra në jug, ku UÇK-ja kishte rifituar

kontrollin mbi territorin. Përveç kësaj, policët iu kishin thënë disa familjeve në Vushtrri, se do të ishte më e sigurt për ta sikur të ktheheshin në Studimen e Epërme e të Poshtme. UÇK-ja do të zinte pozicione edhe në këto fshatra. Megjithatë, menjëherë paskësaj, forcat qeveritare zunë pozicionet në hapësirën rreth e qark fshatrave, gjë që ndërpreu hyrjen në Vushtrri. E vetmja pikë hyrjeje në qytet, ku mund të sigurohej ushqim, bëhej nëpërmjet një përroi, i cili rridhte nga Studimja e Epërme në të Poshtmen dhe prej andej në Vushtrri. Në një numër rastesh, gjatë muajit maj, fshatarët shqiptarë do të goditeshin e vriteshin në përpjkeje e sipër për të hyrë ose dalë nga Vushtrria.[23]

Sipas komandantit të UÇK-së lokale, më 17 maj, rreth orës 8 të mbrëmjes, luftëtarët e tij kishin gjetur gjashtë burra të qëlluar mu pranë përroit. Të gjithë ata ishin goditur nga një rreze prej afro pesëmbëdhjetë deri më njëzet metra. Vetëm dy prej tyre arritën të mbijetojnë.

Human Rights Watch intervistoi njërin nga dy të mbijetuarit, V. Z. Ai tha se ishte duke udhëtuar më këmbë, bashkë me shtatë burra të tjerë nga Studimja e Epërme për t'u kthyer në Vushtrri, ku kishte qëndruar një pjesë të mirë të luftës, te të afërmit e tij. Shtëpia e tij ndodhet pranë përroit që të shpie në qytet, kështu që kur grupi iu afrua, ai vetë u shkëput për një minutë të shkonte e të kontrollonte shtëpinë. Ai e shpjegoi kësisoj atë çka ndodhi më pas:

> Ne morëm të gjithë sëbashku, më të poshtë përroit, në orën 7 të mbrëmjes. Kur iu afruam shtëpisë sime, unë u thashë atyre të vijonin të ecnin sepse doja të kthehesha një minutë e të shija se ç'bëhej me shtëpinë. Atë çast ndodheshim rreth dyqind metra larg shtëpisë. Sapo hodha hapat e parë, mund të isha ndoshta rreth njëzet metra larg të tjerëve, dëgjova breshëri armësh zjarri. Sakaq ngarenda dhe u strehova në një shtëpi guri. Nuk dija ku të shkoja. Qëndrova një copë herë dhe gjatë gjithë kohës dëgjoheshin të shtëna.
>
> Dëgjoja të shtëna armësh dhe kisha frikë se mos i kisha përpara. Atëherë ia dhashë vrapit dhe shkova e u fsheha në disa shkurre, nja 300 a 400 metra larg përroit. Ndërkaq pashë një tjetër grup serbësh që po vinin me traktor nga Sfracaku, por ata nuk më panë. Isha vetëm 150 metra larg tyre, e megjithatë ata nuk më panë. Pashë që ishin me uniforma, por nuk e di se cili prej tyre (ngaqë) isha shtrirë përtokë. Gjatë gjithë kësaj kohe, dëgjova vazhdimisht të shtëna armësh, gjë që mund të ketë vazhduar ndonjë orë.

> Mendova se do të më kishin parë, kështu që e ndava mendjen të rrija e të prisja kur të çatisnin, pasi të kishin mbaruar punë me të tjerët. Mund të shihja vetëm njërin nga personat që ishte duke shtënë, ngaqë e kisha afër. Ai ishte shtrirë barkas në një kopsht me mollë dhe kur më pa, zuri të ulërijë e të shtijë në drejtim tim. Kishte veshur uniformë kamuflazhi në ngjyrë të blertë. Edhe në shtëpinë time, gjendej një person, në katin e dytë.[24]

Një tjetër vrasje do të ndodhte më 23 maj, por për të nuk ka pasur dëshmitarë të drejt për drejtë. Një tjetër komandant i UÇK-së, që deklaroi se kishte qenë drejtues i një batalioni në zonën e Studimes dhe të Samadrexhës, tha se kishte gjetur më 24 maj, diku pranë përroit, trupat e pajetë të tetë grave, që shkonin nga mosha katërmbëdhjetë deri më tridhjetë e një vjeç. Dy prej tyre ishin therrur me thikë dhe disa i kishin teshat të shqyera, gjë që e kish shtyrë atë të mendonte se ishin përdhunuar.[25]

Edhe komandanti i UÇK-së për Studimen, i intervistuar veçazi, do të deklaronte se, më datë 23 maj, rreth 12, luftëtarët e UÇK-së kishin gjetur pranë përroit, trupat e tetë grave dhe vajzave, të moshës nga dymbëdhjetë deri tridhjetë vjeç. Ai tha se, gjashtë prej trupave ishin në përrua, ndërsa dy vajza ishin pak metra më tutje. Komandanti besonte se dy prej vajzave ishin përdhunuar ngaqë këmishët e tyre ishin shqyer, por, sipas tij, trupat nuk i ishin nënshtruar një ekzaminimi mjekësor.[26]

Vrasja e fundit e raportuar do të ndodhte më 31 maj, në kohën kur trupat qeveritare vranë dymbëdhjetë pjesëtarë të familjes Gërxhalliu, që jetonte në Studimen e Poshtme, ngjitur me rrugën kryesore dhe fare pranë përroit. Pas përleshjes me forcat serbe, luftëtarët e UÇK-së kishin gjetur pranë shtëpisë të pushkatuar trupat e tre prej burrave të familjes, Xhemailit, Seladinit dhe Shabanit (djalit të Seladinit). Nëntë pjesëtarë të tjerë të familjes, duke përfshirë këtu edhe gjashtë fëmijë nën moshën katërmbëdhjetë vjeç, ishin vrarë brenda në shtëpi.[27]

Trupat qeveritare vranë dymbëdhjetë pjesëtarë të familjes Gërxhalliu.

Sali Gërxhalliu, njëri prej pjesëtarëve të familjes, gjashtëdhjetë e tetë vjeç, tha se ishte zgjuar mëngjesin e datës 31 maj nga lajmi se tre të afërm të tij ishin vrarë pranë shtëpisë. Atëherë ai lidhi kalin te karroca dhe u nis të mblidhte trupat. Ai tha:

> Kur iu qasa përroit pashë se njëri krah i Seladinit ishte këputur nga zjarri i armëve, teksa ai vetë ishte qëlluar në zverk. Shabanin e kishte marrë plumbi në sy, kështu që mund të shihni frakturën në kafkën e tij. Xhemaili ishte qëlluar në kraharor dhe në pjesën e poshtme të barkut. Të gjithë ishin goditur me plumba. Në trupin e Xhemailit gjendeshin shtatë a tetë plumba; çdonjëri kishte disa plumba në shtat. Atëherë më kapi vaji për njerëzit e mi.[28]

Pasi kishin mbledhur trupat, Sali Gërxhalliu, një miku i tij i quajtur Ismet dhe vajza e Xhemailit, vendosën të hedhin një sy brenda në shtëpi, meqë e kuptuan se asnjëri prej të afërmve nuk kshte ardhur të shihte ç'kishte ngjarë. Vajza e Xhemailit mbajti kalin, teksa Saliu hyri brenda:

> Kështu pra, hyra brenda në shtëpi dhe pashë nëntë prej tyre në një dhomë. Nga dera pashë Salen të shtrirë me duar përpara, Pranë saj ishin dy djem dhe dy gra. Dukeshin sikur po flinin. Djemtë rrinin ulur me këmbët poshtë. Atëherë thashë: "Allah, Allah, qenkan të gjithë të vdekur, që të nëntë." Dola sërish jashtë dhe shpura tri trupat në varreza. Në varreza u takova me të tjerë njerëz dhe u thashë se dymbëdhjetë vetë ishin vrarë. Ata më pyetën nëse duhej t'i varrosnin, por unë u thashë se do të qe më mirë të prisnim një copë herë dhe të thërrisnim policinë.[29]

Sali Gërxhalliu thirri policinë e Vushtrisë që erdhi të hetonte në vendngjarje. Ai u shpreh:

> Policët dhe gjykatësi hetues erdhën e bënë fotografi. Na thanë që do të na jepnin kopje të fotove, gjë që nuk ndodhi. Kur hynë brenda, gjykatësi hetues, një grua nga Mali i Zi, ia plasi së qarës. Njëri nga policët e pyeti, pse po qante. Gruaja tha: "Po fëmijët, çfarë kanë bërë?" Njëri nga policët, Dragan Petroviç ia ktheu: "Kjo është luftë, shoqe." Unë i thashë atij: "Lufta është burrat me burrat, kështu që po ta mbajti shko në pyll dhe lufto me UÇK-në. Këta janë fëmijë që i kanë vrarë në gjumë." Petroviçi pa nga unë, por nuk më foli. Pasi bënë fotografitë, thanë se do t'i varrosnin të vrarët, sepse do të sillnin njerëz nga Mitrovica. Ata shkuan në Vushtrri me veturë, por më pas u kthyen dhe na thanë neve që t'i varrosnim të vrarët.[30]

Dragan Petroviçi do të përmendej edhe nga tre fshatarë të tjerë të atyre anëve, të cilët deklaruan se e kishin parë në Vushtrri të merrej me varganin, pas sulmit të kryer mbi të në Studimen e Epërme e të Poshtme, më 3 maj.

Human Rights Watch foli gjithashtu me djalin e Shukri Gërxhalliut, një burrë dyzet e katër vjeç nga fshati. Ai tha se, më 31 maj, rreth orës 4 të mëngjesit, kishte dëgjuar dy eksplozime të zhurmshme nga bombat e NATO-s. Më pas, rreth orës 7 të mëngjesit, trupat serbe hynë në fshat. Pjesa më e madhe e burrave ia dolën t'ia mbathin, por më vonë ata do të mësonin se, tri vetë nga familja Gërxhalliu, Seladini, Shabani dhe Xhemaili ishin vrarë. Po atë ditë, vonë, djali i Shukriut shkoi në familjen Gërxhalliu dhe pa nëntë kufomat. Ai tha:

Policët dhe gjykatësi hetues erdhën e bënë fotografi.

> Kur hyra në shtëpi, nga dera e dhomës, pashë njërin djalë të Seladinit ulur. Në të djathtë të tij ishte një plakë dhe dy fëmijë, të cilët, dukej që ajo ishte përpjekur t'i mbronte. Pranë saj ishte gruaja e Nexhmedinit me të birin. Të tjerët ishin rrekur të fshiheshin nëpër dhomë.[31]

Prijësi i batalionit të UÇK-së do të fliste gjithashtu me Human Rights Watch për vrasjen e pjesëtarëve të familjes Gërxhalliu, duke pohuar se, ata nuk ishin pjesëtarë të UÇK-së. Ai tha:

> Shkova të shihja të vrarët (e familjes Gërxhalliu). Tre prej tyre ndodheshin jashtë, në të përpjetën e kodrës dhe dukej qartë që i kishin vrarë nga një distancë e afërt. Seladini, Xhemaili dhe Shabani nuk qenë anëtarë të UÇK-së. Nuk kisha dëgjuar më parë për ta. Nëntë të tjerët gjendeshin në dhomë. Kur pashë fëmijët, dola me vrap, nuk mund të rrija dot më gjatë në atë vend. Një pjesë ishin qëlluar në fytyrë, të tjerët në gjoks. I kishin ekzekutuar me kallashnikoë jugosllavë, pamë gëzhojat. Fëmijët shkonin nga mosha pesë deri në tetëmbëdhjetë vjeç. Kishte edhe gra. Ky rast do të hetohej edhe nga vetë serbët. Madje edhe për ta përbënte një ngjarje të jashtëzakonshme. Aty kishte dy pozicione të policisë, njëri në të djathtë, tjetri në të majtë të fshatit. Ata fajësonin njëri-tjetrin: policët thoshin që masakrën e kishin kryer ushtarët dhe anasjelltas. Hetimet do t'i kryente policia ushtarake.[32]

BURGU I SMREKOVNICËS

Më 22 maj, në Kukës, Shqipëri, Human Rights Watch intervistoi gjashtë shqiptarë të Kosovës, të cilët ishin liruar po atë ditë nga burgu i Smrekonicës, pranë Mitrovicës, një burg i sigurisë së ulët, i ndërtuar në vitin 1970. Të gjithë meshkujt bënë fjalë për trajtimin abuziv të bërë nga autoritetet serbe, duke përfshirë këtu edhe rrahjet gjatë kohës së burgimit.

Human Rights Watch vuri re shenja të qarta abuzimesh fizike

Në harkun kohor të dy javëve në vijim, dyzina shqiptarësh etnikë nga Vushtrria dhe Mitrovica, hynë në Shqipëri dhe treguan për mbajtjen e tyre në burgun e Smrekonicës. Të gjithë ata bënë fjalë për rrahje të rregullta nga ana e policisë gjatë kohës së burgosjes, sidomos gjatë marrjes në pyetje rreth veprimtarisë së UÇK-së ose dijenisë që kishin ata për të. [33] Në një pjesë të madhe të të intervistuarve, Human Rights Watch vuri re shenja të qarta abuzimesh fizike, duke përfshirë këtu sy të nxirë dhe vurrata të rënda në kurriz, këmbë e mollaqe, si dhe dëmtime të tjera të lëkurës. Shumë prej burrave ishin shtrënguar të nënshkruanin pohime se, kishin qenë të angazhuar në veprimtari terroriste, si kusht për t'u liruar.

Human Rights Watch intervistoi më shumë se tridhjetë ish të burgosur, dëshmitë e të cilëve, qenë fort të ngjashme. Të gjithë burrat kishin qenë arrestuar në Vushtrri, Mitrovicë ose fshatra të atyre anëve, ku UÇK-ja ishte aktive. Disa ishin arrestuar më 2 maj, pasi ishin marrë nga një karvan refugjatësh pranë Studimes (shih seksionin mbi Studimen e Poshtme).

Të burgosurit ishin mbajtur në kushte që ishin tepër larg edhe standarteve më minimale. Të gjithë ish të burgosurit thanë se, qelitë e tyre kishin qenë jashtëzakonisht të mbipopulluara, madje në disa prej tyre ishte e pamundur të uleshe për shkak të tejpopullimit. Një burrë pesëdhjetë e dy vjeçar nga Resniku tha se, në qelinë e tij, të përmasave katër me tetë metra, ishin mbledhur shtatëdhjetë e gjashtë persona, ndërsa një dyzet e tre vjeçar nga rrethinat e Podujevës tha se, në qelinë e tij, katër me pesë ishin mbyllur tridhjetë e gjashtë vetë.[35] Të burgosurit nuk ishin pajisur me dyshekë ose batanije, ndaj qenë të shtrënguar të flinin drejt e në dysheme.

Të gjithë të burgosurit, pa asnjë përjashtim, ishin pyetur, madje disa

edhe mbi pesë herë, rreth lidhjeve të tyre të mundshme me UÇK-në. Njerëzit do të raportonin se gjatë marrjes në pyetje, ata ishin rrahur, disa keqazi. A. K., njëzet e shtatë vjeç, fillimisht ishte mbajtur për dy javë në një shkollë në Skënderaj dhe më pas ishte transferuar në burgun e Smrekonicës, ku e patën mbajtur edhe dy javë të tjera. Ai i tha Human Rights Watch:

> Jam marrë në pyetje pesë herë: dy herë në shkollë në Skënderaj dhe tri herë në burg (në Smrekonicë). Ata më pyesnin në qoftë se isha pjesëtar i UÇK-së, kë njihja në UÇK, nëse i kisha dhënë para UÇK-së dhe, nëse kisha lidhje me UÇK-në, etj. Saherë që u thosha se nuk njihja njeri në UÇK, ata më rrihnin me shkopinj (të drunjtë), shkopinj kauçuku që përdorte policia ose me qytën e pushkës. Më kanë qëlluar në shpinë dhe në duar.[36]

“Saherë që u thosha se nuk njihja njeri në UÇK, ata më rrihnin me shkopinj (të drunjtë), shkopinj kauçuku që përdorte policia ose me qytën e pushkës.”

Të tjerë të intervistuar gjithashtu do të deklaronin se ishin goditur keqazi në shpinë, kokë, duar e gjunjë gjatë marrjes në pyetje, një pjesë e të cilave qenë kryer në shkollën teknike dhe atë mjekësore të Mitrovicës, që kishin pasë shërbyer si shtabe të policisë gjatë kohës së luftës.

Një ish i burgosur nga fshati Dollak, i cili pasi ishte liruar nga burgu kishte mbërritur në Shqipëri, më 7 qershor, i tha Human Rights Watch:

> Dyzetë e dy nga ne i shpunë në shkollën teknike (të Mitrovicës), ndërsa të tjerët në shkollën mjekësore. Neve na kishin futur në bodrum dhe pa e zgjatur nisën të na rrahin. Në shkollë ndodheshin pesë a gjashtë policë dhe ushtarë. Ne qemë kthyer me fytyrë nga muri, kësodore ishte e vështirë të shihnim. Ata na goditën me shkopinj kauçuku, shifra hekuri dhe qytat e armëve automatike. Madje nuk munguan edhe shkelmat. S’para i përdornin grushtat, përveç një rasti kur qëlluan një djalë në sy. (Human Rights Watch e pa atë person me syrin e mavijosur.)[37]

Ish të burgosurit thanë se të rinj serbë nga Mitrovica i kishin qëlluar me gurë teksa po i mbartnin në ose nga shkolla teknike, madje një pjesë e tyre kishin marrë pjesë edhe në rrahje. Njëri prej tyre tha:

> Të rinj serbë erdhën në bodrum dhe na goditën me shufra hekuri, si dhe shtinë me gurë mbi ne. Ata thanë, "Na lini neve t'i rrahim." Ishin të moshave të ndryshme, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë e kështu me radhë. Kishin qenë në rrugë duke luajtur. Kur na zbritën nga kamioni, ata gjendeshin aty dhe na goditën me gurë. Kalamajtë na shanë nga nënat dhe na quajtën terroristë.[38]

Një tjetër tha: "Një kalama më goditi në shpinë. E kishte dorën më të lehtë se një i rritur. Po ta krahasoje me të rrahurën e policëve ishte si një farë gudulisjeje."[39] Një tjetër ish i burgosur deklaroi se më 28 maj, të burgosurit u kërcënuan me abuzime seksuale. Persona të përshkruar si "paraushtarakë" i detyruan disa prej të burgosurve, kryesisht të rinj rreth katërmbëdhjetë vjeç, të zhvisheshin lakuriq. Paskëtaj, ata iu kanosën gojarisht se do t'i përdhunonin. Sipas dëshmitarit, gjashtë të burgosur të moshave të reja u morën dhe u shpunë diku, por Human Rights Watch nuk hasi ndonjë dëshmi të mëtejshme që të provonte se mbi ta kish pasur abuzime seksuale.[40]

Përveç keqtrajtimit fizik, burrat raportuan se të burgosurve nuk iu ofrohej ushqim i mjaftueshëm, rreth 200 gram bukë në ditë, për person. Të gjithë burrat nga rajoni i Vushtrrisë dëshmuan se, për dyzet e tetë orë me radhë nuk kishin futur në gojë kurrfarë ushqimi, qysh nga momenti që ishin ndaluar në Vushtrri në mbrëmjen e datës 2 maj deri në orën 8 të darkës, së ditës së martë, më 4 maj. Disa ish të burgosur thanë se, ushqimi u përmirësua për afro dhjetë ditë, në kohën kur autoritetet nisën t'u shërbejnë ushqime të ngrohta.

Ende nuk e dimë se sa të burgosur ka pasur në Smrekonicë kur përfundoi lufta, më 12 qershor. Shumë prej të burgosurve të mbyllur në burgje të tjera të Kosovës, fjala vjen si në Lipjan apo në Prizren, u transferuan në në burgje në brendësi të Serbisë, ku shumica e tyre do të qëndronin deri në shtator të vitit 2000. (Shih abuzimet e kryera pas 12 qershorit 1999.)

15

ANALIZË STATISTIKORE E SHKELJEVE

Ndërmjet marsit dhe dhjetorit të vitit 1999, Human Rights Watch kreu më shumë se 600 intervista me viktimat dhe dëshmitarët e shkeljeve të ligjeve ndërkombëtare humanitare në Kosovë. Informacioni i vjelë nga këto intervista është paraqitur në kapituj të ndryshëm të këtij libri, në deponime të cituara nga intervistat dhe gjithë rastet e hulumtuara. Ky kapitull shfrytëzon statistikat që rrjedhin nga intervistat për të shqyrtuar drejtimet dhe modelet e krimeve të kryera, të cilat mund të mos shfaqen qartë nga informacioni i karakterit narrativ. Shifrat dhe grafikat do të japin e marrin në një mënyrë sistematike dhe thelbësore me raportet se, cili është vrarë, kur është vrarë, ku është vrarë dhe nga kush është vrarë.

Ky kapitull i përgatitur bashkë me Programin për Shkencë dhe të Drejtat e Njeriut të Shoqatës Amerikane për Përparimin e Shkencës (AAAS), është i pari projekt në shkallë të madhe lidhur me të dhënat, i kryer nga Human Rights Watch.[1] Ne jemi shpresëplotë se ky projekt do të jetë një kontribut konkret në fushën e analizave statistikore për të drejtat e njeriut.[2]

Intervistat u kryen nga hulumtuesit e Human Rights Watch, zakonisht të shoqëruar nga një përkthyes, në Shqipëri e Maqedoni nga 28 mars më 12 qershor 1999 dhe në Kosovë nga 12 qershori deri më 31 dhjetor 1999. Të intervistuarit ishin përzgjedhur në bazë të dijeve që ata zotëronin lidhur me abuzimet specifike të kryera në provincë. Të gjitha intervistat u kryen me synimin për të përfituar një tregim të hapur nga të intervistuarit lidhur me atë çka ata kishin parë ose përjetuar në Kosovë nga 20 marsi deri më 12 qershor 1999, në vend të pyetsorëve të standartizuar. Pas kthimit në New York, i gjithë dokumentacioni i

Ekzekutime të raportuara nga Human Rights Watch sipas komunave



Të gjitha hartat, tabelat dhe grafikët janë vizatuar nga Matt Zimmerman. ©Human Rights Watch

intervistave do të kodohej nga vullnetar të ushtruar lidhur me tipet e shkeljeve, kohën dhe vendin e shkeljeve, viktimat dhe fajtorët. Kësisoj, u krijua një *database* i vlefshëm edhe për përdorim publik në këtë adresë, http://hrdata.aaas.org.

KUFIZIME TË TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore të paraqitura në këtë kapitull, hedhin dritë mbi natyrën e krimeve të luftës të kryera në Kosovë, por lypset thënë se edhe këto të dhëna kanë disa kufizime. Ç'është më e rëndësishmja, Human Rights Watch nuk do t'u drejtohej kuturu të intervistuarve. Përkundrazi, në mënyrë të qëllimtë, hulumtuesit do t'u drejtoheshin jo vetëm viktimave dhe dëshmitarëve të shkeljeve të kryera, por e sidomos, të gjithë atyre që kishin dijeni për disa nga rastet më të rënda të dhunës së ushtruar, bie fjala, si torturës, përdhunimeve dhe ekzekutimeve. Kësisoj këto të dhëna nuk mund të vlerësohen e paraqiten si të dhëna të përgjithshme e përfundimtare për mbarë Kosovën. Ato s'mund të ofrojnë një informacion shterrues rreth numri në total të të vrarëve, ose të japin një kuadër përmbyllës të shkeljeve të kryera anë e kënd provincës.

Veprimtaria e Human Rights Watch u ushtrua kryesisht në ato komuna të Kosovës që dihej se ishin më të prekurat nga lufta, si ajo e Gllogovacit, Rahovecit, Gjakovës, Prizrenit dhe Skënderajt. Gjithsesi, vëmendje disi e veçantë iu përkushtua komunave në jugperëndim, asaj të Gjakovës e Rahovecit, për shkak se hulumtuesit që u ndodhën në Shqipërinë e veriut gjatë luftës, dokumentuan një valë të jashtëzakonshme refugjatësh, pikërisht në këto zona. Disa prej komunave në pjesën verilindore dhe qendrore të Kosovës, veçanërisht ajo e Podujevës dhe e Fushë Kosovës, ku do të ndodhnin një numër i lartë vrasjesh, janë përmbledhur në këtë kapitull, jo si zë më vete, ose mund t'i hasësh në gjithë raportin.

Dhe së fundi, procesi i kodimit dhe i krijimit të *database*, nuk mund të thuhet se është i përsosur, në mënyrë të veçantë, kur ka të bëjë me përshkrime komplekse, siç ka ndodhur rëndom me shumë prej krimeve të luftës së kryera në Kosovë. Kur është fjala për skenarë të ndërlikuar, nuk është ngaherë e lehtë të përpilosh të dhëna statistikore që regjistrojnë në mënyrë të përpiktë çka ngjarë, ku ka ngjarë dhe, kur ka ngjarë. Rasti i Kosovës bëhet edhe më i komplikuar për shkak të pështjellimit dhe

ambiguitetit që krijohet lidhur me emrat e vendeve në serbisht e në shqip, si edhe për faktin se, disa prej emrave të fshatrave të shfaqen në katër komuna të ndryshme.

Nisur nga shqetësime si ato që përmendëm më sipër, *database* për Kosovën i Human Rights Watch do të kontrollohej e korrigjohej vazhdimisht për të shmangur gabimet, një proces ky që vijon edhe sot e gjithë ditën. Për të pakësuar gabimet, në të gjithë rastet ku numri i viktimave të ekzekutuara do të kalonte shifrën dhjetë, por do të konsiderohej i pasaktë, atëherë kjo shifër do të zbritej nga numri i përgjithshëm i ekzekutimeve të raportuara. Veç kësaj, pesë komunat që renditen në krye të listës për numrin e ekzekutimeve, por edhe disa komuna të tjera, do të rishikoheshin edhe një herë me kujdes, për të shmangur çfarëdolloj lajthitjeje në përllogaritje ose raste që mund të kishin regjistruar më shumë se nj ëherë të njëjtin krim.

Ashtu si edhe vetë raporti në përgjithësi, këto të dhëna pasqyrojnë vetëm krimet e kryera nga 20 marsi (koha kur OSBE u tërhoq nga Kosova)

Grafika nr. 1: numri i shkeljeve që i janë raportuar Human Rights Watch, sipas tipit, për numrat mbi 100.



Shënim: Kjo grafikë nuk mund të përimtohet për të përftuar dendurinë ose dendurinë relative të shkeljeve në Kosovë, për shkak se Human Rights Watch është rrekur të dokumentojë vetëm rastet më të rënda të abuzimeve. Për shembull, ka të ngjarë që t'u mëshohet më fort ekzekutimeve krahasuar me granatimet pa dallim, ngaqë hulumtuesit në mënyrë të qëllimtë kanë kërkuar të pahtësojnë dëshmi rastesh individuale, siç janë vrasjet. Shifrat dhe emrat e plotë të shkeljeve janë: ndarjet e burrave, grave dhe fëmijëve (5122), shpërngulje të dhunshme (4485), burgosje (3478), ekzekutime (3453), rrahje (2439), ngacmime (2183), plaçkitje (2012), granatime padallim (1987), shkatërrime të pronës private (1329), persona të zhdukur (343), punë e detyrueshme (278), si dhe tentativë vrasjeje (180).

deri më 12 qershor 1999 (koha kur NATO hyri në Kosovë). Vini re se, për efekt lehtësie, të gjitha shifrat e dhëna në përqindje, janë rrumbullakosur, sipas numri të plotë që i gjendeshin më pranë.

ZBULIME TË PËRGJITHSHME

Nga blloku i madh i intervistave të kryera nga Human Rights Watch, do të kodoheshin 577 intervista, ngaqë të intervistuarit kishin dijeni të drejt për drejta rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut si dhe të ligjeve humanitare. Nga këto 577 intervista, Human Rights Watch regjistroi më shumë se 35.000 raste shkeljesh të paduplikuara, ndonëse shumë prej këtyre rasteve kanë të bëjnë me vuajtjet e hequra në vijëmësi nga të njëjtët individë. [3] Duhet theksuar se një shkelje mund të ketë të bëjë me një ose edhe më shumë persona. Për shembull, në shumë raste, popullsia e fshatrave ose qyteteve të tërë do të dëbohej, siç ndodhi, fjala vjen, me banorët e fshatit Adë ose banorët e qytetit të Pejës, për të mos folur për pjesëtarët e vrarë të një familjeje të tërë, siç më ndodhi me pjesëtarët e familjes Berisha, në Suharekë. E megjithatë, numri i shkeljeve që i janë raportuar Human Rights Watch nuk mund të shfrytëzohet për të thënë se sa shkeljeve kemi pasur në të gjithë Kosovën.

Shkeljet kryesore të raportuara Human Rights Watch janë përshkruar në grafikën nr. 1, këtu më poshtë. Në të janë pasqyruar vetëm ato shkelje që janë raportuar më shumë se njëqind herë.

Me 5122 raste të raportuara, ndarja e dhunshme e burrave nga gratë e fëmijët [4], do të ishte edhe shkelja më së shpeshti e raportuar. Shpërngulja [5] me 4485 raste shkeljesh do të zinte vendin e dytë, gjë që është mëse e kuptueshme, nisur nga fakti se përbënte dhunën mbizotëruese gjatë konfliktit – sipas UNHCR-së, më shumë se 850.000 shqiptarë të Kosovës u dëbuan nga Kosova dhe mijëra të tjerë u shpërngulën nga një vend në tjetrin brenda provincës. Shkelja e tretë më e dendur do të ishte burgosja[6], me 3478 raste te raportuara, e ndjekur nga ekzekutimet pa gjyq, që përbënin 3453 raste.

Në të ardhmen, raporte nga Human Rights Watch ose organizma të tjerë mund të fokusohen në modelet e këtyre shkeljeve: kur dhe ku kanë ngjarë dhe, në ç'rrethana. Gjithashtu, paraqet interes të dimë nëse disa prej shkeljeve qenë të prirura për të ndodhur në mënyrë të ishulluar apo

të kryheshin sëbashku me shkelje të tjera. Gjithsesi, për hir të thjeshtësisë, ky raport shkon e përqëndrohet vetëm në njërin nga llojet e gjithë këtyre shkeljeve, që tek e fundit, është dhe më i rëndi të gjithë krimeve: ekzekutimet.

Analizë e ekzekutimeve pa gjyq

Duhet theksuar se ekzekutimet e kryera pa gjyq nga aktorët e ndryshëm shtetërorë – është fjala për vrasje të qëllimshme pa proces gjyqësor – kanë zënë kryet e vendit në këtë raport, parë kjo në lidhje me shkeljet e tjera në këtë kapitull, ngaqë hulumtuesit e Human Rights Watch u angazhuan në mënyrë aktive për të dokumentuar vrasjet e qëllimta si një përparësi të punës së tyre. Në të njëjtën kohë, shumë prej ekzekutimeve pa gjyq të kryera në Kosovë, duket sheshit që nuk janë përfshirë në 3453 rastet e përmendura; thjesht për ta sjellë si një shembull, informacioni për shkalljet në shkallë të gjerë në Beleg, Goden, Kaçanik dhe Podujevë nuk u përfshinë në këto të dhëna, madje as në kapitujt gjeografikë. Për më shumë, trupat e atyre njerëzve që i ishin raportuar si të zhdukur Human Rights Watch gjatë periudhës së mbledhjeve të të dhënave, tashmë janë zbuluar. Pavarësisht nga këto shqetësime, blloku i informacioneve rreth ekzekutimeve i mbledhur nga Human Rights Watch është mëse i mjaftueshëm për të nxjerrë disa konkluzione kuptimplotë rreth tipeve të vrasjeve të kryera nga forcat serbe dhe ato jugosllave.

Nga 3453 raste ekzekutimesh të dokumentuara, Human Rights Watch do të siguronte emrat e 916 personave ose 27 përqind të numrit të përgjithshëm të viktimave. Pjesa tjetër e viktimave nuk do të identifikohej nga dëshmitarët.

Gjinia e viktimave të ekzekutuara

Siç është bërë e qartë nga rastet e dokumentuara në kapitujt e tjerë të këtij raporti, trupat serbe dhe jugosllave do të ekzekutonin një numër shumë herë më të lartë meshkujsh sesa femrash.

Nga 3453 viktimat e ekzekutuara që i janë raportuar Human Rights Watch,

njihet gjinia e 2232 vetëve (65 përqind). Nga këto viktima, pra 2232 vetë, 2055 janë meshkuj (92 përqind), ndërsa 177 janë femra (8 përqind). Të dhënat e mësipërme janë përshkruar në grafikën nr. 2, në të djathtë.

Këto zbulime mund të konsiderohen të pritshme sikur të dhënat e tyre të kishin të bënin me vrasjet në luftime ose ekzekutimet në grup të luftëtarëve, ngaqë trupat e UÇK-së përbëheshin kryesisht nga meshkuj. Por, siç e bëjnë të qartë edhe rastet e studiura në kapitujt e mëparshëm, pjesa dërrmuese e viktimave të ekzekutimeve të kryera në grup, ishin civilë që s'kishin marrë pjesë në luftime. Le të marrim, për shembull, rastin e vrasjes së nëntë të burgosurve në burgun e Dubravës ose të afro 300 burrave që u morën nga karvani i refugjatëve dhe u vranë në Mejë.

Grafiku 2: Gjinia e viktimave



Është mëse e qartë që e gjithë kjo ilustron faktin se, shqiptarët meshkuj të Kosovës ishin shënjestër për trupat serbe. Ky zbulim përforcohet edhe nga fakti se gjatë bombardimeve të NATO-s, pjesa më e madhe e burrave ose ishin fshehur në Kosovë, ose qenë bashkuar me UÇK-në, ose jetonin jashtë vendit, ndërkohë që gratë, pas të gjitha gjasave do të qëndronin nëpër shtëpi gjatë gjithë kohës së luftës, ku, për hir të së vërtetës, ishin më të ekspozuara kundrejt abuzimeve.

Mosha e viktimave të ekzekutuara

Nga 3453 viktimat e njohura nga ne të ekzekutuara në grup, Human Rights Watch do të siguronte moshën e 630 njerëzve (18 përqind). Prej viktimave që iu njihet mosha, 530 janë meshkuj (84 përqind) dhe njëqind femra (16 përqind). Fakti që mosha e viktimave njihet vetëm në 18 përqind të rasteve, lypset të merret në konsideratë saherë që do të kryhet ndonjë analizë, meqë paraqitja e të dhënave mund të ketë qenë

disi e anshme. Për shembull, dëshmitarët mund të kenë ofruar vetëm moshat e viktimave më të reja ose të vjetra në moshë, me qëllim që t'i mëshonin sa më fort seriozitetit të krimeve. Gjithsesi, edhe duke u nisur nga kjo mundësi, këto të dhëna reflektojnë disa rezultate interesante që meritojnë të përmenden.

Grafika nr. 3: Mosha e viktimave meshkuj të ekzekutuar



Grafika nr. 4: Mosha e viktimave femra të ekzekutuara



Lehtësisht vihet re që mosha e viktimave meshkuj të ekzekutuar në grup, ndryshon nga ajo e viktimave femra. Për viktimat meshkuj të ekzekutuara, mosha mesatare është 40.3 vjeç. Për viktimat femra, mosha mesatare është 32.7 vjeç. Grafikat 3 dhe 4 krijojnë një kuadër të shpërndarjes së moshës për viktimat meshkuj e femra të ekzekutuara në grup.

Është e qartë që llojet e shkeljeve të ushtruara janë të ndryshme për meshkujt e femrat. Vrasjet e burrave dhe djemve synonin njëlloj gjithë meshkujt nga mosha 10 deri në moshën 70 vjeç, me një rënie të ndjeshme të moshave të shtyra. Ekzekutimet në grup për femrat e moshës 10-30 vjeç, janë të larta, paskësaj moshe bien e rrafshohen në të njëjtin nivel për të gjitha femrat mbi 30.

Për të dy sekset, vrasjet e fëmijëve nën moshën 10 vjeç ishin të ulta. Gjithsesi, fëmijët e seksit femër të asaj grupmoshe, proporcionalisht kishin më gjasa për t'u vrarë se fëmijët e seksit mashkull. Të gjitha këto komente cilësore të bazuara në grafikat 3 dhe 4, pasqyrohen në tabelën e statistikave krahasuese përmbledhëse të Figurës 1, këtu më poshtë.

Siç tregohet edhe në Figurën 1, 75 përqind e viktimave meshkuj të ekzekutuara janë nën moshën 56 vjeç, ndërsa 75 përqind e viktimave femra të ekzekutuara janë nën moshën 50 vjeç. Mosha "mesatare" për meshkujt është 40.3 vjeç, ndërsa për femrat është 32.7 vjeç. Po ashtu, 25 përqind e femrave viktima janë nën 14.5, kurse 25 përqind e meshkujve viktima janë nën 22.

Në vështrimin e parë, rezultatet janë kundërintuitivë. Sipas të gjitha gjasave, bazuar edhe në rastet e studiuara, çdokush pret të shohë një rritje të ekzekutimeve të meshkujve në moshë për armë, të cilët ishin

Figura 1: Krahasimi i statistikave përmbledhëse për moshën

Emri	Kuptimi	Të gjithë	M	F
Maksimum	Vlera më e madhe	90	90	87
Tre të katërtat	75% e vl. janë më pak se kjo vlerë	56	56	50
Gjysma	50% e vl. janë më pak se kjo vlerë	38	40	24
Një e katërta	25% e vl. janë më pak se kjo vlerë	20	22	14.5
Minimumi	Vlera më e vogël	0	0	3
Kuptimi	Mesatarja	39.1	40.3	32.7
n	Numri i vlerave	630	530	100

edhe objektivat e parapëlqyer për vrasje, gjatë mësymjeve nëpër fshatra, siç ndodhi në Qushkë, Bellaçerkë dhe Mejë. Në një sërë rastesh, meshkujt nga mosha 18 deri më 50 vjeç, u ndanë nga gratë e fëmijët dhe u vranë. Gjithsesi, ka një numër shpjegimesh të kënaqshme për mospërputhjet në moshat e viktimave.

Së pari, siç është përmendur edhe më parë, me nisjen e fushatës së bombardimeve të NATO-s, nëpër fshatra gjendeshin gjithnjë e më pak meshkuj në moshë për luftë. Pjesa më e madhe e meshkujve nga mosha 20 deri në 50 vjeç gjendeshin ose të fshehur nëpër kodra (nga frika se mund të vriteshin), ose ishin duke luftuar me kryengritësit, ose jetonin jashtë vendit. Në shumë fshatra ishin lënë vetëm gratë dhe fëmijët, me një numër të pakët pleqsh. Kështu pra, teksa rastet e studiuara na ofrojnë dëshmi konkrete se meshkujt në moshë për armë ishin objekt i ekzekutimeve, kjo gjë nuk pasqyrohet në këto të dhëna, ngaqë meshkujt në moshë për armë ishin relativisht më pak të pranishëm në zonat e ekspozuara kundrejt sulmit.

Së dyti, rastet e studiuara na dëshmojnë se si burrat më së shumti ishin vrarë nga forcat qeveritare të sigurimit, pasi ishin ndarë nga gratë dhe fëmijët, siç kishte ndodhur në Bellaçerkë apo Izbicë. Ndërsa ekzekutimet e femrave, më së shumti do të ndodhnin kur kryheshin vrasje në grup (siç ishte rasti kur ekzekutohej një familje e tërë), dhe jo nga vënia e qëllimtë në shënjestër e femrave. Vrasja e dymbëdhjetë pjesëtarëve të familjes Gërxhalliu, më 31 maj, në Studimen e Epërme [7] apo të pjesëtarëve të familjes Berisha në Suharekë [8], më 25 mars, janë shembuj të qartë të rasteve të shfarosjes së një familjeje të tërë – burra, gra e fëmijë. Me fjalë të tjera, sipas të gjitha të dhënave, gratë janë vrarë më së shumti në grup, ku vrasësit nuk është se i kanë kushtuar ndonjë vëmendje të madhe gjinisë ose seksit, për rrjedhojë viktima të këtyre vrasjeve janë bërë edhe femra në moshë të njomë.

Një mundësi e tretë është se, ekzekutimet e grave qenë të lidhura me ushtrimin e dhunës seksuale, gjë që shpjegon edhe përfshirjen në këto krime të femrave të reja. Për fat të keq, me të dhënat e mbledhura është e vështirë që të provohet kjo teori. Megjithëse Human Rights Watch mblodhi një sërë të dhënash në *database*-in e vet rreth përdhunimeve dhe dhunës seksuale, gjë që, teorikisht e lejon kryerjen e një analize nëse ekzekutimet e femrave dhe dhuna seksuale kanë pasur prirjen të ndodhnin në të njëjtën kohë, për mendimin tonë, ndjeshmëria e mjedisit shqiptar

në shoqërinë kosovare rreth dhunës seksuale, i bën të dhënat për këto krime jo fort të besueshme. Thënë me fjalë të tjera, të dhënat rreth dhunës seksuale janë të paplota, si në dëshmitë e vjela ashtu edhe në database.

Një nga pikat që lypset shqyrtuar në të dhënat rreth moshës është kategoria e vrasjeve. Për shembull, kur iu hedhim një vështrim këtyre të dhënave, ngjan sikur forcat qeveritare nuk kanë ekzekutuar në shkallë të gjerë burra të moshuar dhe femra. E megjithatë, duke pasur parasysh faktin se, në popullsinë kosovare ka shumë më pak të moshuar sesa meshkuj të moshës së mesme e të rinj, atëherë vërejmë se pleqtë e vrarë përbëjnë një përqindje relativisht të lartë. E kundërta e kësaj është e vërtetë për fëmijët nën moshën dhjetë vjeç. Meqë, sipas të gjitha gjasave, në popullsinë kosovare ka më shumë fëmijë të kësaj moshe sesa të rritur e të moshuar, atëherë përqindja e fëmijëve të vrarë është më e vogël se ajo e të rriturve. [9]

Ekzekutimet e kryera në harkun kohor

Përpilimi i skicës së përgjithshme të ekzekutimeve pa gjyq në tërë harkun e tyre kohor, siç i janë raportuar Human Rights Watch, na jep të kuptojmë goxha rreth natyrës sistematike dhe të bashkërenduar të krimeve të kryera

Grafika nr. 5: Ekzekutimet e raportuara në tërë harkun e tyre kohor



në Kosovë. Siç na dëshmon edhe grafika nr. 5, ekzekutimet në grup do të ndodhnin në tri valë të ndryshme e qartë të dallueshme nga njëra-tjetra.

Qysh nga fillimi i ofensivës më 20 mars, ekzekutimet pa gjyq do të njihnin një rritje të shpejtë, e cila do të arrinte kulmin më datat 25-27 mars, menjëherë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s. Kjo valë e parë do të pësonte një rënie të ndjeshme, që do të arrinte pikën më të ulët rreth datave 5-6 prill. Një valë e dytë e ekzekutimeve pa gjyq do të kulmonte rreth 27-28 prillit. Një valë e tretë, por gjithsesi më e vogël se dy të parat, do ta kapte zenithin e vet rreth 10-11 majit, që do të ndiqej sakaq nga një rënie e ndjeshme, e cila do të shterronte më 12 qershor, me përjashtim këtu të një hovjeje të lehtë rreth 30-31 majit.

Të tri valët e mëdha të ekzekutimeve na japin të kuptojmë se, vrasjet nuk ishin aspak rezultat i një dhune të ushtruar kuturu nga forcat qeveritare. Madje, të dhënat që zotërojmë mbështesin dëshminë se, vrasjet ishin planifikuar me kujdes dhe zbatuar në një mënyrë të atillë që i shkonte për shtat objektivave të mëdhenj strategjikë të qeverisë.

Sigurisht, grafika nr. 5, ngërthen vetëm ato ekzekutime që i janë raportuar Human Rights Watch dhe jo numrin total të vrasjeve të kryer në Kosovë. E megjithatë, natyra e vendosur e të tri valëve, si dhe 3453 viktimat e ekzekutimeve, janë një dëshmi e fuqishme e natyrës së qëllimtë dhe të bashkërenduar të krimeve. Edhe pse këtu nuk kanë gjetur pasqyrim të gjithë ekzekutimet, zbulimet e bazuara në të dhëna të pjesshme janë të fuqishme e të qarta.

Figura nr. 2: Komunat më të prekura nga ekzekutimet e raportuara pa gjyq

Komuna	Ekz. të raportuara	Përqindja	Përq. kumulative
1. Gjakova	645	18%	18%
2. Rrahoveci	583	17%	35%
3. Skënderaj	431	12%	47%
4. Lipjan	368	11%	58%
5. Suhareka	248	7%	65%

Shënim: Komunat e tjera ku Human Rights Watch mblodhi të dhëna rreth ekzekutimeve, sipas rendit zbritës, janë: Pejë, Kaçanik, Prizren, Vushtrri, Istog, Lipjan, Prishtinë, Mitrovicë, Deçan, Gjilan, Obiliq, Ferizaj, Podujevë, Leposaviq, Shtimje, Shterpce, Fushë-Kosovë, Glinë, Kamenicë, Zveçan, Novo Brdo, Viti dhe Zubin Potok.

Ekzekutimet sipas komunave

Nga 3453 ekzekutimet e kryera pa gjyq të raportuara Human Rights Watch, 66 përqind e ekzekutimeve kanë ndodhur në pesë komunat e mëposhtme: Gjakovë, Rahovec, Skënderaj, Gllogovac dhe Suharekë. Me përjashtim të Podujevës, ku Human Rights Watch ka hulumtuar më pak, e dhëna e mësipërme pasqyron qartë komunat që do të goditeshin më fort nga lufta dhe operacionet e sigurimit gjatë viteve 1998-1999. Tridhjetë e pesë përqind e ekzekutimeve të raportuara kanë ndodhur vetëm në komunat e Gjakovës dhe Rahovecit, siç shihet edhe në figurën nr. 2, këtu më poshtë.

Edhe një herë, Figura nr. 2, nuk duhet interpretuar si një pasqyrë e gjithë ekzekutimeve të kryera pa gjyq në komunat e sipërpërmendura dhe, aq më pak në mbarë Kosovën, sepse në të janë pasqyruar vetëm ato ekzekutimeve që i janë raportuar Human Rights Watch. Veçanërisht dy komuna, kanë mbetur jashtë, si rrjedhojë e mungesës së një numërimi të plotë, për shkak të kërkimeve të pjesshme që janë zhvilluar në këto zona: Podujevë dhe Fushë-Kosovë. Edhe me këto përjashtime jo të pa rëndësishme, të dhënat mund të merren si një pasqyrim relativisht i kënaqshëm, ngaqë

Grafika nr. 6: Ekzekutimet pa gjyq në komunën e Gjakovës



Human Rights Watch do të dokumentonte në një përqindje të lartë vrasjet më të mëdha të kryera në të katër anët e Kosovës. Këto të dhëna u mblodhën gjatë kohës së luftës në Shqipëri dhe Maqedoni, si edhe brenda në Kosovë pas luftës, kësisoj janë mbuluar të gjitha zonat gjeografike.[10]

Natyra e bashkërenduar e ekzekutimeve pa gjyq të kryera në Kosovë, shpaloset edhe më qartë kur i marrim dhe i shqyrtojmë vrasjet, komunë pas komune. Siç na e dëshmojnë edhe grafikat e mëposhtme, vala e "harbuar" e vrasjeve kishte prirjen të ndodhte komunave brenda një harku të shkurtër kohor, gjë që na jep të kuptojmë se, ekzistonte një urdhër strategjik për të kryer ekzekutime në zona të caktuara ose, më së paku, vendosjen e forcave të njohura për vrazhdësinë dhe shpërfilljen e tyre kundrejt ligjit, me urdhërin për të terrorizuar popullsinë civile, pa iu përmbajtur kurrfarë detyrimi ligjor. Ekzekutimet e karakterit sporadik të kryera në ndonjë komunë, mund edhe të pasqyrohen në grafika, ngaqë Human Rights Watch ka qenë e prirur për t'u fokusuar në incidentet në shkallë të gjerë.

Vala e "harbuar" e vrasjeve kishte prirjen të ndodhte komunave brenda një harku të shkurtër kohor.

Denduria e krimeve të kryera për një hark të shkurtër kohor, në çdonjërën nga komunat, na jep të kuptojmë se, siç është paraqitur edhe

Grafika nr. 7: Ekzekutimet pa gjyq në komunën e Rahovecit



Grafika nr. 8: Ekzekutimet pa gjyq në Skënderaj



Grafika nr. 9: Ekzekutimet pa gjyq në Gllogovac



në grafikën nr. 5, vrasjet nuk ishin një dukuri që ndodhte kuturu. Përkundrazi, fakti që në një periudhë të caktuar kohore vrasjet ishin më të shpeshta se në një tjetër, na sugjeron se, ato qenë rrjedhojë e një politike dhune të paramenduar e të bashkërenduar më së miri. Hulumtimi ynë i papublikuar gjithashtu shkon e mbështet konkluzionin se, ekzekutimet e kryera në çdo komunë kanë qenë specifike dhe të qëllimta.

Ekzekutimet dhe Dëbimet: Një lidhje e pandarë

Dështmia mbi një sulm qendror e të bashkërenduar mbi shqiptarët e Kosovës mbështetet fuqimisht edhe nga një studim tjetër statistikor rreth valës së refugjatëve nga Kosova në Shqipëri. Një studim i prillit 2000, i kryer nga AAAS, zbuloi se, dyndja e refugjatëve në Shqipëri ka ndodhur gjatë tri valëve të ndryshme nga njëra-tjetra.[11] Raporti thotë se, nga fundi i marsit deri në fund të majit të vitit 1999, 95 përqind e refugjatëve shqiptarë kosovarë që hynë në Shqipëri, e ndërmorën këtë gjë përgjatë njërës nga tri "fazat e dalluara qartë", siç edhe është treguar në grafikën nr. 11.

Grafika nr. 10: Ekzekutimet pa gjyq në Suharekë



Duke shpjeguar grafikën, raporti përfundonte:

> Përfundimi ynë është se shpërnguljet nuk ishin spontane: një emigrim masiv i kryer në këtë shkallë dhe në këtë mënyrë mund të jetë kryer vetëm si pasojë e një politike të qendërsuar dhe jo në bazë të vendimeve apo emocioneve individuale, qoftë e shqiptarëve të Kosovës, qoftë e zyrtarëve lokalë të ushtrisë apo policisë jugosllave ...
> Koherenca e fazave dhe bashkërendimi i tyre i dukshëm në disa rajone të gjera të Kosovës, na jep të kuptojmë se, autoritetet jugosllave përvijuan dhe zbatuan një politikë që rrekej të spastronte nga shqiptarët etnikë, të paktën, disa rajone të Kosovës.[12]

Siç mund të duket qartë nga grafika nr. 11, koha e tri valëve të refugjatëve për në Shqipëri e dokumentuar nga AAAS, përkon ngushtësisht me tri valët e ekzekutimeve të dokumentuara nga Human Rights Watch (grafika

Grafika nr. 11: Numri i shqiptarëve kosovarë që kanë në hyrë në Shqipëri nga pika kufitare e Morinës, brenda harkut kohor të dy ditëve. Nga raporti i AAAS "Politikë ose Panik".



nr. 5).[13] Kjo gjë bëhet edhe më e qartë kur të dhënat e AAAS rreth dëbimeve dhe të dhënat e Human Rights Watch rreth ekzekutimeve përqasen në mënyrë të drejtpërdrejtë në grafikën nr. 12.

Siç na tregon grafika nr. 12, ulje-ngritjet e të tri fazave, madje edhe

Grafika nr. 12: Të dhënat e AAAS rreth dëbimeve (sipër) dhe të dhënat e Human Rights Watch rreth ekzekutimeve (poshtë) përgjatë harkut kohor





kulmimi final, dëshmojnë përkimin e ekzekutimeve të raportuara nga Human Rights Watch me dyndjet e refugjatëve drejt Shqipërisë. Thënë me fjalë të tjera, ekzekutimet e kryera në Kosovë përgjatë një harku kohor, duket që shkojnë paralelisht me dëbimet.[14] Diferenca në magnitudë për valën e dytë mund t'i atribuohet faktit se, pjesa më e madhe e ekzekutimeve të dokumentuara nga Human Rights Watch në atë periudhë kohore, ndodhën në komunat e veriut dhe ato në qendër të Kosovës, veçanërisht në Skënderaj dhe Gllogovac. Një përqindje e madhe e të shpërngulurve nga këto komuna shkoi në Maqedoni, ku ata nuk arritën përfshihen në të dhënat e ofruara nga AAAS.

Kjo marrëdhënie fuqimisht e pandashme, na shtyn edhe më tej të besojmë se, ka pasur një strategji të përvijuar dhe zbatuar nga qendra që kishte vënë në shënjestër shqiptarët e Kosovës. Të tri fazat e e vrasjeve dhe dëbimeve, ngjajnë të lidhura ngushtë me objektivat strategjikë e udhëheqjes politike dhe ushtarake në Beograd.

Një shpjegim është se, trupat qeveritare i kryen ekzekutimet me synimin për të lehtësuar e përshpejtuar procesin e dëbimeve – kjo teori mbështetet

Grafika nr. 13: Masa e shqiptarëve të Kosovës me prejardhje nga komunat në jug dhe perëndim, që hynë në Shqipëri brenda harkut kohor të dy ditëve. Nga AAAS "Politikë ose panik."



Grafika nr. 14: Ekzekutimet pa gjyq të kryera në Prizren gjatë gjithë harkut kohor



Grafika nr. 15: Ekzekutimet pa gjyq të kryera në Pejë gjatë gjithë harkut kohor



edhe nga disa raste të studiuara. Në shumë fshatra të dokumentuara edhe në këtë raport, si Celinë dhe Korenicë, policia, ushtria ose trupat paraushtarake i kryen ekzekutimet para ose gjatë procesit të dëbimit të popullsisë civile nga një fshat ose qyteti. Gjithashtu është e kuptueshme se vrasjet do të përftonin një rritje tok me ekzekutimet, ngaqë trupat qeveritare mësynin në ato zona që "lypseshin spastruar". Shpesh qëllonte që këto ishin edhe treva të veprimtarisë së UÇK-së, ku policë dhe ushtarë kishin mbetur të vrarë, duke iu dhënë kësisoj trupave qeveritare përligjjen, pas mendjes së tyre, për të ushtruar dhunë.

Tri fazat e dëbimeve përkojnë plotësisht me tri fazat e ekzekutimeve.

Të tri valët e dëbimeve dhe ekzekutimeve mund të analizohen më tej edhe sipas komunave. AAAS zbuloi se të tri fazat e e dëbimeve (grafika nr. 11) janë të lidhura me rajonet e ndryshme të Kosovës. Në mënyrë specifike mund të themi se, në fazën e parë të dëbimeve, pjesa më e madhe e refugjatëve erdhi nga perëndimi dhe jugperëndimi i Kosovës. Në fazën e dytë, shumica e refugjatëve vinte nga komunat e pjesës veriore dhe qendrore të Kosovës. Në fazën finale, refugjatët vinin kryesisht nga komunat e pjesës perëndimore dhe jugore. Kjo shpërndarje gjeografike është paraqitur në grafikën nr. 13, dhe është marrë nga raporti i AAAS, i cili na tregon masën e refugjatëve në Shqipëri që kishin mbërritur nga komunat e pjesës jugperëndimore të Kosovës (Suharekë, Rahovec, Prizren dhe Gjakovë).

Të dhënat e Human Rights Watch të dëftuara në grafikën nr. 6, janë në përputhje me këto gjetje. Kësodore, komunat në jugperëndim të Kosovës, si ajo e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës dhe e Prizrenit (shih grafikën nr. 14) kanë një numër të madh vrasjesh, pikërisht në periudhën e parë. Komunat në veri, si ajo e Gllogovacit, pas të gjitha gjasave, i panë ekzekutimet të ndodhnin në fazën e dytë. Ndërsa në fazën e tretë, ekzekutimet e raportuara Human Rights Watch-it, do të ndodhnin sërish në një pjesë të madhe, në komunat jugperëndimore, Gjakovë e Prizren.

Natyrisht që ka edhe përjashtime. Për shembull, vrasjet në komunën e veri-qendrore të Skënderajt, (shih grafikën nr. 8), kanë të bëjnë më fort më fazën e parë dhe të tretë sesa me të dytën. Faza e parë shpjegohet me ekzekutimet e datës 28 mars, kur u vranë rreth 146-166 njerëz në fshatin Izbicë, njëra nga ish-bazat më të fuqishme të UÇK-së, e cila u mësy që në krye nga forcat qeveritare. Kurse faza e tretë është e lidhur me vrasjet e

kryera në Rezallë e Qirez, si pjesë e ofensivës qeveritare të ndërmarrë kundër Drenicës.

Po kështu, vrasjet e kryera në Pejë (shih grafikën nr. 15) kanë prirjen të pasqyrojnë fazën e parë dhe të dytë. Vala e dhunës rreth 14 majit, shkon e merr trajtë në vrasjen e shtatëdhjetë njerëzve në fshatrat Qushkë, Zahaq dhe Pavllan. Siç është folur në mënyrë të detajuar në seksionin që bën fjalë për këto fshatra në kapitullin për Pejën, ende mbetet e paqartë përse këto tri fshatra u sulmuan pikërisht në këtë kohë, ndërkohë që gjatë gjithë kohës së luftës nuk qenë prekur, ngaqë siç kish fort të ngjarë, s'kish pasur ndonjëherë prani të UÇK-së. Hamendjet luhaten midis faktit që diçka e tillë të ishte bërë për hakmarrje (familja e gjeneralit të UÇK-së, Agim Çeku, ishte nga Qushka) dhe, mundësisë së gjakimit për plaçkë në tri fshatrat e pacënuara të krahinës, nga ana e paraushtarakëve lokalë.

Ky korrelacion ndërmjet ekzekutimeve dhe dëbimeve do të studiohej gjithashtu edhe nga AAAS, që kreu edhe një studim të dytë rreth vrasjeve në Kosovë, "Vrasjet politike në Kosovë", që u publikua në shtator të vitit 2000, në bashkëpunim me American Bar Association's Central and East Europian Law Initiative (ABA/CEELI). Analiza e raportit rreth vrasjeve anë e kënd Kosovës u bazua në 3353 intervistat e marra nga Human Rights Watch, ABA/CEELI, The Center for Peace Through Justice dhe Physicians for Human Rights. Studimi do të arrinte në përfundimin se, nga 20 marsi deri më 12 qershor 1999, u vranë rreth 10.500 shqiptarë kosovarë, me një interval besimi deri 95 përqind, që shifra e mësipërme mund të luhatet nga 7449 deri më 13.267 vetë.[15]

Studimi krahasoi ekzekutimet e dokumentuara nga këto katër organizata me raportin origjinal të AAAS mbi dëbimet dhe gjeti rezultate shumë të ngjashme me ato që kish paraqitur Human Rights Watch në grafikën nr. 12; domethënë, të tri fazat e dëbimeve përkojnë plotësisht me tri fazat e ekzekutimeve. Pra, siç dëshmon edhe raporti i AAAS-ABA/CEELI, "mënyra e vrasjeve për çdo komunë, ndjek nga afër dyndjet e refugjatëve."

Konkluzionet fort të ngjashme të arritura nga Human Rights Watch dhe raporti i AAAS-ABA/CEELI, kanë të bëjnë, veç pjesërisht, me faktin se, Human Rights Watch i ofroi të dhënat e intervistave raportit të AAAS-ABA/CEELI. E megjithatë, lypset thënë se, intervistat e kryera nga Human Rights Watch përllogarisin vetëm 577 nga 3353 raste të intervistave në total (17 përqind). Ndaj dhe gjetjet e ngjashme duhet të merren si një konfirmim i pavarur i rezultateve.

Fajtorët e ekzekutimeve

Human Rights Watch i pyeti të gjithë dëshmitarët dhe viktimat e dhunës nëse ishin në gjendje të identifikonin se, cilët ishin dhe kujt i përkisnin fajtorët e përzierë në abuzimet e kryera kundër tyre: policisë serbe, ushtrisë jugosllave, paraushtarakëve apo qenë "të tjerë", domethënë, serbë lokalë, NATO ose të UÇK-së. Të dhënat e dala për fajtorët e ekzekutimeve janë paraqitur më poshtë, por ato lypset të merren më fort si një tregues i përafërt i fajtorëve sesa një dëshmi definitive.

Arsyeja kryesore ishte vështirësia e shqiptarëve kosovarë për të identifikuar forcat serbe dhe ato jugosllave. Ndërkohë që disa prej dëshmitarëve dhe viktimave ishin besimplotë në identifikimet e tyre, shumë të tjerë, për shkak të mungesës së njohurive rreth ushtarakëve në përgjithësi, por edhe si rrjedhojë e një mjedisi përgjithësisht të stresuar, ishin të paaftë të bënin dallimin e duhur midis policisë, ushtrisë dhe paraushtarakëve.

Kjo gjë do të bëhej edhe më e vështirë për shkak të arradhës së madhe të forcave qeveritare që u angazhuan gjatë fushatës, bie fjala si, policia ushtarake e ushtrisë, forcat speciale antiterroriste të policisë, paraushtarakët, si dhe grupet e armatosura lokale (shih Forcat e angazhuara në konflikt). E vërteta është se kishte fare pak uniforma standarte dhe, nga ana tjetër, stemat dhe shenjat e tjera dalluese, jo gjithmonë shfaqeshin.

Dhe, për më tepër, skenarët sipas të cilëve u kryen këto abuzime ishin tejet kompleksë: për shembull, një forcë e caktuar mund të ketë granatuar një fshat, një tjetër e ka mësyrë dhe, e treta, ka kryer ekzekutimet. Human Rights Watch i pyeti dëshmitarët se, ç'tip force qeveritare kishte qenë "e pranishme" në skenën ku ishte ushtruar dhuna. Kjo nuk do të thotë medoemos se, aksh force qeveritare kishte qenë që kish kryer në të vërtetë një vrasje të caktuar, por nga ana tjetër kjo mund të konfirmojë dëshminë se, në pjesën më e madhe e operacioneve në shkallë të gjerë qenë angazhuar njësi të kombinuara të ushtrisë, policisë dhe paraushtarakëve.

Nga 3453 ekzekutimet e kryera pa gjyq që iu raportuan Human Rights Watch, dëshmitarët deklaruan se në 1768 raste ekzekutimesh (51 përqind) kishin identifikuar policinë serbe, në 1173 raste (34 përqind) ushtrinë jugosllave dhe në 1154 raste (33 përqind) paraushtarakët. Në çdo ekzekutim të kryer mund të ketë qenë i pranishëm më shumë se një tip përgjegjës për krimin.

Rezultatet janë kundërintuitive ngaqë kapitujt përshkrues të raportit, na sugjerojnë se për pjesën më të madhe të krimeve më të shëmtuara përgjegjës ishin paraushtarakët, megjithëse edhe policia apo ushtria zor se mund të qenë dorëjashtë. Edhe një herë, fakti që dështmitarët hasnin vështirësi në identifikimin e forcave të ndryshme dhe që operacionet e mëdhaja shpesh përfshinin trupa të përziera, pas të gjitha gjasave kanë ndikuar në përftimin e rezultateve kundërthënëvse.

Me identifikimin e fajtorëve është më e lehtë të identifikohen edhe ata që kanë përgjegjësinë e komandantit të një njësie famëkeqe ose të një regjioni ku ndodhën vrasje në masë. Duke vërejtur dendurinë e një numri të madh krimesh të kryera në mënyrë të qëllimtë e krejtësisht të jashtëligjshme, në disa zona të Kosovës brenda një harku të shkurtër kohor, siç edhe është përshkruar në grafikët 6 deri më 10, si dhe në grafikët 14 e 15, ka fort të ngjarë që komandantët e ndryshëm përgjegjës për komunat përkatëse të qenë plotësisht të vetëdijshëm për vrasjet që ndodhën në zonat që ishin nën përgjegjësinë e tyre të drejtpërdrejtë. Pavarësisht nga kjo, nuk gjendet kurrfarë dëshmie që drejtuesit politikë apo ushtarakë të kenë ndëmarrë ndonjë hap për të ndëshkuar përgjegjësit e ekzekutimeve ose, të paktën, të minimizonin kryerjen e vrasjeve të tjera përsa kohë që konflikti vazhdoi.

16

FUSHATA AJRORE E NATO-s

Që nga fillimi i Operacionit të Forcave Aleate – fushata e bombardimeve të NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë – NATO dhe qeveritë aleate, si dhe ofiqarët ushtarakë nënvizuan synimin e tyre të kufizonin numrin e viktimave në radhët e civilëve, si dhe dëmet e tjera kundrejt popullsisë civile. Përmbushja në praktikë e këtij detyrimi ligjor dhe imperativi politik lypte ndërmarrjen e një sërë vendimesh lidhur me objektivat, përzgjedhjen e armëve dhe mjetet e sulmit. Pavarësisht nga masat e marra, duke përfshirë këtu përdorimin në një shkallë të madhe të armëve me precizion të lartë, siç nuk ishin përdorur ndonjëherë më parë në një konflikt të madh në histori, e vërteta është se pati viktima nga radhët e civilëve.

Human Rights Watch kreu një hetim shterrues rreth vdekjes së civilëve si rrjedhojë e fushatës së bombardimeve të NATO-s në Republikën Federale të Jugosllavisë. Duke u nisur nga ky hetim (i përshkruar në mënyrë të detajuar në raportin e shkurtit 2000 "Vdekjet e civilëve gjatë fushatës ajrore të NATO-s"), Human Rights Watch zbuloi se, përgjatë fushatës së bombardimeve shtatëdhjetë e tetë ditore, kishin ngjarë nëntëdhjetë incidente të shkëputur nga njëri-tjetri, në mbarë Republikën Federale të Jugosllavisë, të cilët i kishin marrë jetën civilëve. Tashmë dihet se, rreth 500 civilë jugosllavë kanë humbur jetën në këto incidente. Nga 278 deri 317 e vrasjeve – domethënë 56 deri 60 përqind e numrit të përgjithshëm të të vrarëve – kanë ndodhur në territorin e Kosovës.[1]

Nga numri i përgjithshëm i incidenteve, tridhjetë e dy, me pasojë vdekjen e civilëve, kanë ndodhur në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave kanë

Dëmtime të shkaktuara nga bombardimet e NATO-s përgjatë autostradës Prishtinë-Pejë.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

ardhur si rrjedhojë e sulmeve mbi objektet në lëvizje ose forcat ushtarake në terren.[2] Tek e fundit, në sulmet e kryera në Kosovë do të kishte më shumë të vdekur nga radhët e civilëve se kudotjetër në Republikën Federale të Jugosllavisë – një e treta e incidenteve (tridhjetë e dy nga nëntëdhjetë gjithsejt) përmbledhin vdekjen e më shumë se gjysmës së civilëve në gjithë vendin. Shtatë incidente me pasojë vdekjen e civilëve, të cilët bien në sy për vdekjeprurjen e tyre, kanë ardhur si rezultat i sulmeve mbi vargane ose mjete të transportit. Ngaqë aftësia e pilotëve për të identifikuar siç duhet objektivat në lëvizje shkon e merr një rëndësi të dorës së parë, incidentet e shkaktuara bëjnë që të lindë pyetja: mos vallë fluturimi në lartësi të mëdhaja bëhet pengesë për të identifikuar saktë objektivin dhe kësodore shkakton humbje të panevojshme jetësh të pafajshme? Por, me të mbërritur në këtë pikë, nuk kemi dëshmi të mjaftueshme për t'i dhënë përgjigje përfundimtare kësaj pyetjeje.

Përgjatë fushatës së bombardimeve shtatëdhjetë e tetë ditore, kishin ngjarë nëntëdhjetë incidente të shkëputur nga njëri-tjetri, në mbarë Republikën Federale të Jugosllavisë, të cilët i kishin marrë jetën civilëve. Tashmë dihet se, rreth 500 civilë jugosllavë kanë humbur jetën në këto incidente.

Një tjetër faktor për vlerësimin e numrit të lartë të vdekjes së civilëve në Kosovë është edhe përdorimi i mundshëm nga ana e qeverisë së shqiptarëve etnikë civilë, si "mburoja njerëzore". Ekzistojnë dëshmi që më 13 maj, në fshatin Koricë, forcat serbe dhe ato jugosllave i kanë përdorur civilët e zhvendosur si mburoja njerëzore, për t'ia hedhur tjetërkujt fajin për vdekjen e tetëdhjetë e shtatë civilëve të atjeshëm. (Për të vijuar më tej diskutimin rreth përdorimit të "mburojave njerëzore" nga forcat qeveritare, shih mars-qershor 1999: Një vështrim i përgjithshëm.)

E DREJTA HUMANITARE NDËRKOMBËTARE DHE PËRGJEGJSHMËRIA

Rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, si Konventat e Gjenevës ose shtjellohen si ligje të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Shtetet kanë detyrime të sigurojnë pajtueshmërinë me gjithë klauzolat e së drejtës

humanitare ndërkombëtare, si dhe të parandalojnë shkeljen e tyre. Krimet e luftës përbëjnë disa nga shkeljet më të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, të njohura rëndom si varr thyerje dhe në përgjithësi janë akte të qëllimta e të paramenduara. Këto shkelje lypin detyrime specifike për të gjurmuar dhe ndëshkuar të gjithë ata që janë përgjegjës, pavarësisht nga kombësia e fajtorit ose vendi ku është kryer krimi. Shembuj të krimeve të luftës janë vrasjet e paramenduara, tortura ose trajtimi çnjerëzor i personave jondërluftues, të shkaktuarit në mënyrë të qëllimtë i vuajtjeve të mëdhaja ose të lëndimeve të rënda në trup ose me pasoja për shëndetin e personave jo palë në luftime, apo ndërmarrja e mësymjeve pa bërë dallim, të vetëdijshëm se sulmi do të shkaktojë humbje të konsiderueshme në jetë njerëzish ose dëme kundrejt civilëve.

Human Rights Watch nuk zbuloi dëshmi të krimeve të luftës gjatë hetimeve të kryera lidhur me bombardimet e NATO-s në Kosovë. E megjithatë, hetimi do të arrinte në përfundimin se, NATO-ja ka kryer shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Human Rights Watch iu ka bërë thirrje qeverive të vendeve anëtare të NATO-s që të ngrenë një komision të pavarur e të paanshëm, kompetent që të vjelë informacion konfidencial, i cili të jetë në gjendje të hetojë rastet e shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe përmasat e këtyre shkeljeve, si dhe të shqyrtojë nevojën e ndryshimit të doktrinës së bombardimit të objektivave në pajtueshmëri me të drejtën humanitare ndërkombëtare. Rezultatet e punës së këtij komisioni duhet t'i bëhen të njohura opinionit publik. Gjithashtu, Human Rights Watch i bëri thirrje NATO-s, të ndryshojë doktrinën e bombardimit të objektivave, me synimin për t'ia përshtatur të drejtës humanitare ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh shkeljet e së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryer nga NATO në Kosovë, Human Rights Watch do të shprehte shqetësimin për një numër rastesh në të cilat forcat e NATO-s:

- morën masa të pamjaftueshme për identifikimin e pranisë së civilëve, gjatë kohës së sulmit të karvanëve dhe objektivave të tjerë të lëvizshëm; dhe
- shkaktuan një numër të jashtëzakonshëm viktimash civile duke mos marrë masa të mjaftueshme për verifikimin e faktit se, në objektivat ushtarakë nuk kishte përqëndrim civilësh (siç ishte rasti i Koricës).

STANDARTET E APLIKUAR

E drejta humanitare ndërkombëtare ushtron një sërë kufizimesh, rreth mënyrës së bërjes së një lufte, të cilat, njihen ndryshe edhe si ligjet e luftës. E drejta humanitare ndërkombëtare aplikohet posaçërisht dhe në mënyrë unike në situata që kanë të bëjnë me konflikte të armatosura, me klauzola të përcaktuara qartë që rregullojnë konfliktet e armatosur ndërkombëtarë dhe jo ndërkombëtarë (të brendshëm). Në vlerësimin e përdorimit të forcës ushtarake nga ana e NATO-s në Republikën Federale të Jugosllavisë, ligjet e luftës parashikojnë standartet më të rëndësishme.

Siç është shpjeguar në kreun mbi Standartet Ligjore në Konfliktin e Kosovës, duke nisur nga 28 shkurti 1998, konflikti në Kosovë mund të karakterizohet si një konflikt i brendshëm i armatosur, i cili detyronte si forcat qeveritare ashtu edhe UÇK-në, të respektonin e mbrojnin elementët thelbësorë të së drejtës humanitare ndërkombëtare – ligjet e luftës – dhe në veçanti, Nenin 3, të përbashkët në të katër Konventat e Gjenevës së vitit 1949, Protokolli II të këtyre konventave dhe rregullat kanunore të luftës. Me fillimin e bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, konflikti në Kosovë dhe në të gjithë Republikën Federale të Jugosllavisë, në atë shkallë që përfshinte forcat serbe dhe ato jugosllave, u shndërrua në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, i cili lypte aplikimin e të gjithë korpusit të së drejtës zakonore humanitare.

Protokolli i I shtesë i Konventave të Gjenevës të vitit 1949, ofron bazat për të bërë vlerësimin e bombardimit të NATO-s. Ky protokoll është ratifikuar nga pjesa më e madhe e vendeve anëtare të NATO-s, si dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara, teksa as edhe një vend palë, nuk ka deklaruar se s'pranon të gjithë standartet e rëndësishëm të tij. Parimi themelor i Protokollit I, si dhe të ligjeve të luftës në përgjithësi, është se popullsia civile, ashtu si dhe çdo civil individ duhet të gëzojnë mbrojtjen e të gjitha palëve të angazhuara në konflikt, kundrejt rreziqeve që paraqesin operacionet ushtarake. Kjo ka të bëjë në një pjesë të konsiderueshme me kërkesën se, pala që ndërmerr sulmin duhet të bëjë dallimin midis civilëve dhe trupave të armatosura, si dhe midis objektivave ushtarake dhe atyre civile. Pala sulmuese, pra, duhet të marrë të gjitha masat mbrojtëse të mundshme në mënyrë që të shmangë ose të minimizojë viktimat dhe dëmet kundrejt civilëve, ndaj dhe duke pasur këtë gjë parasysh, nuk mund të sulmojë popullsinë civile drejtpërdrejtë, ose trupat ushtarake dhe popullsinë civile pa bërë një dallim të qartë midis tyre.

Dëmet ndaj objektivave civile dhe viktimat e shkaktuara në radhët e civilëve që janë rastësore përgjatë sulmeve të përligjura kundrejt objektivave ushtarake, njihen në terminologjinë ushtarake si "dëme anësore". Ligjshmëria e një sulmi lypset të marrë parasysh një sërë faktorësh. E para, pala sulmuese duhet të bëjë gjithçka të mundur për të verifikuar që ata synojnë diçka specifike – kësisoj, ata s'mund të godasin qorrazi. E dyta, pala sulmuese duhet të përcaktojë qartë se, objektivi që do të sulmohet është një objektiv i ligjshëm ushtarak. Dhe e treta, pala sulmuese duhet të përcaktojë qartë nëse, sulmi që ajo do të ndërmarrë vë në rrezik popullsinë civile dhe objekte civile, si dhe të peshojë gjithë rreziqet e mundshme kundrejt përfitimit ushtarak që mund të ketë. Sulmet që mendohet se mund të shkaktojnë humbje aksidentale jetësh ose lëndime të ndryshme në radhët e popullsisë civile, apo mund të shkaktojnë dëmtime të objekteve civile, *konsiderohen si sulme të kryera pa bërë dallim*, në qoftë se dëmet e shkaktuara kundrejt civilëve janë "të tejskajshme në raport me përfitimet konkrete dhe të drejtpërdrejta ushtarake të parashikuara" (Protokolli I, neni 57[2]). Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), autoriteti kryesor për të bërë interpretimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare, ka paralajmëruar se, argumenti i proporcionalitetit nuk mund të përligjë kurrsesi numrin e lartë të viktimave në radhët e popullsisë civile ose të dëmtimit të objekteve civile, cilidoqoftë përfitimi i parashikuar ushtarak.

Në hulumtimin e çdonjërit prej incidenteve me pasojë vdekjen e civilëve gjatë luftës në Kosovë, Human Rights Watch u rrek të mbledhë fakte që iu mundësojnë analistëve të kryejnë vlerësimin e legjitimitetit të goditjeve mbi objektivat ushatarake reale ose të perceptuara si të tilla; kujdesi i treguar si dhe procedurat dhe kriteret e ndjekura për të vërtetuar natyrën ushtarake të objektivave; proporcionalitetin e vdekjes së civilëve dhe mjetet e përdorura në sulmet kundrejt objektivave ushtarake, të njohura si të tilla; korrelacioni midis vdekjes së civilëve në vendngjarje dhe natyrës së objektivit të përgjedhur; kohëmatja në përzgjedhjen e objektivit, si faktor të domosdoshëm për minimizimin e viktimave dhe dëmeve kundrejt popullsisë civile; metodat dhe kushtet në të cilat është vënë në përdorim çdo sistem i caktuar armësh; dhe, potencialisht, natyra e përzgjedhjes pa bërë kurrfarë dallimi të disa sistemeve të caktuara të armëve në përgjithësi, si dhe në disa kushte të caktuara.

Në vlerësimin e sulmeve të veçanta, duke i hedhur një sy vëzhgimeve

të përgjithshme mbi drejtimin e fushatës ajrore, çështja që merr një rëndësi të dorës së parë është se, a iu kushtua vëmendja e duhur mbrojtjes së civilëve. A u mor sa e si duhet parasysh mundësia e vdekjes së civilëve në përcaktimin e objektivave, armëve të vëna në përdorim, si dhe mjetet dhe kushtet në të cilat këto armë shkuan e u përdorën? Kjo do të thotë që lypset hedhur një sy përzgjedhjes së objektivave dhe procedurave përmes të cilave kaloi përcaktimi i tyre, gjë që i tejkalon kompetencat e këtij raporti. Kësisoj, gjithçka shkon e përmblidhet në një pyetjeje të madhe, a ishin brenda për brenda asaj çka konsiderohet e lejueshme në kuadër të ligjeve humanitare, objektivat ushtarakë të identifikuar dhe të goditur nga trupat e NATO-s? Analiza që do të vijojë trajton aspektet e luftës ajrore në Kosovë, e parë kjo vetëm në këndin e kostos në jetë civilësh, si një faktor bazë në vlerësimin e kuadrit të madh në përputhje me të drejtën humanitare ndërkombëtare.

RASTET E VDEKJES SË CIVILËVE NË KOSOVË

Incidentet në Kosovë që kanë të bëjnë me vdekjen e civilëve, ofrojnë vetëm një pjesë të kuadrit prej të cilit mund të shqyrtohet luftëbërja e NATO-s. [3] Çështja që shtrohet është nëse NATO-ja iu përmbajt efektivisht imperativit të së drejtës humanitare që popullsia civile të mbrohet prej rreziqeve që rrjedhin nga operacionet ushtarake. Në thelb të çështjes është parimi i imunitetit të civilëve nga sulmet, si dhe parimi i saj përplotësues që iu kërkon palëve në konflikt të bëjnë gjithçka është e mundur për të bërë një dallim të qartë, në të gjitha kohërat, ndërmjet civilëve dhe luftëtarëve. Një numër incidentesh, si rezultat i të cilave humbën jetën një masë e madhe civilësh, ilustrojnë në mënyrë të qartë aspektet problematikë të aksioneve të NATO-s, ndaj dhe paraqiten si më poshtë.

Humbjet më dramatike të jetës së civilëve nga ofensiva e NATO-s në Kosovë, erdhën prej sulmeve mbi karvanet e refugjatëve ose personave në ikje e sipër, të marrë gabimisht për trupa ushtarake.

Humbjet më dramatike të jetës së civilëve nga ofensiva e NATO-s në Kosovë, erdhën prej sulmeve mbi karvanet e refugjatëve ose personave në ikje e sipër, të marrë gabimisht për trupa ushtarake. Sulmet e përsëritura mbi refugjatët në segmentin prej dymbëdhjetë miljesh të rrugës

Gjakovë-Deçan në Kosovë, iu morën jetën shtatëdhjetë e tre civilëve; sulmet pranë Koricës, në Kosovë, vranë rreth tetëdhjetë e shtatë persona të shpërngulur dhe refugjatë; si dhe dy incidente të shkaktuara nga sulmet mbi autobuzë me civilë në Luzanë dhe Savine Vode e rritën më tej numrin e humbjeve nga radhët e civilëve. Gjithashtu nëntëmbëdhjetë civilë vdiqën gjatë dy sulmeve të kryera mbi burgun e Dubravkës.

Në të gjithë këto incidente, shqetësimi kryesor është nëse u morë çdo masë e mundshme për të veçuar, siç lypsej, civilët nga trupat luftuese. Në të njëjtën kohë, lindin një sërë pyetjesh nëse vendimet për të sulmuar mund të jenë bërë mbi bazën e informacioneve të paplota dhe/ose mbi bazën e informacioneve seriozisht të cunguara. Deklaratat publike nga ana e NATO-s në lidhje me sulme të veçanta dhe ndryshimet në mënyrën se si sulmet u karakterizuan, lypin gjithashtu disa analiza, në mënyrë të veçantë ngaqë deklarata të tilla mund të shfaqin prirjen për të përligjur ditën me diell sulme të paligjshme, gjatë të cilave u duk sheshit që viktimat në civilë ishin jashtëmase.

Për më tepër, shtrohet pyetja nëse përpjekjet e vendosura të NATO-s për të shmangur viktimat nga radhët e pilotëve parandalonin fluturimet në lartësi të ulta, gjë që mund të kish ndihmuar për t'i identifikuar në mënyrë më të saktë objektivat. Kjo ka qenë dhe vazhdon të jetë një çështje madhore në debatin publik rreth Operacionit të Forcave Aleate. Për shumë javë, në fazat fillestare të luftës, aeroplanët e NATO-s nuk fluturonin nën 15.000 këmbë. Në qoftë se lartësia në të cilën pilotët e NATO-s fluturonin kishte një efekt të vogël në identifikimin dhe për pasojë në sulmet mbi objektivat, atëherë çështja është krejtësisht irelevante. Por, në qoftë se precizioni do të kishte qenë më i madh (dhe viktimat civile më të pakta) sikur pilotët e NATO-s të fluturonin ulët, kjo mund të argumentohej se ekzistonte një pikë në të cilën NATO ishte e "shtrënguar" t'i bënte pilotët të fluturonin ulët. [4] Në rastet e sulmeve, siç ishte ai i rrugës Gjakovë-Deçan, i përshkruar më poshtë, në të cilin të fluturuarit në lartësi të mëdhaja ngjan të ketë qenë një faktor i dështimit të pilotit për të identifikuar qartazi objektivin, përfundimi është po ai, se nuk qenë marrë masat e duhura për të shmangur viktimat nga radhët e popullsisë civile.

Incidenti i Koricës i përshkruar më poshtë, ngre gjithashtu pikëpyetje të rëndësishme rreth përgjegjësisë së palës jugosllave për vdekjen e disa civilëve, përgjegjësi që i qe mveshur bombardimeve të NATO-s. Në këtë rast, NATO nuk mori masat e duhura në ekzekutimin e goditjeve ajrore.

Por forcat ushtarake jugosllave kanë pjesën e tyre të fajit në vdekjen e tetëdhjetë e shtatë civilëve në Koricë. Ekzistojnë disa dëshmi që civilë kosovarë të shpërngulur ishin mbyllur forcërisht në një kamp ushtarak dhe mbaheshin atje si mburoja njerëzore.

Përgjegjësia e drejtpërdrejtë e jugosllavëve shfaqet në rastin e vrasjeve në burgun e Dubravës, për të cilat autoritetet jugosllave ia hidhnin fajin bombardimeve të NATO-s. Hulumtuesit e Human Rights Watch zbuluan se tetëdhjetë e gjashtë të burgosur, ishin bërë viktima të ekzekutimeve pa gjyq – vrasje të kryera me gjak të ftohtë – nga forcat jugosllave, disa ditë pasi NATO e kish bombarduar burgun. Gjithsesi, sulmi i NATO-s më 21 maj ishte përgjegjës për vdekjen e nëntëmbëdhjetë vetëve në mjediset e burgut, gjë që do t'i paraprinte masakrës së të burgosurve; një sulm më i hershëm i NATO-s kishte vrarë katër civilë në burg.[5]

Shtatë nga tridhjetë e dy incidentet e ndodhura në Kosovë ku gjetën vdekjen një numër civilësh, erdhën si rezultat i sulmeve mbi objektiva që ndodheshin në zona urbane tejet të populluara. Tre incidente ndodhën në Gjakovë, dy në Prishtinë dhe dy në Prizren. Pothuajse në të gjithë këta sulme objektivat ishin barraka, shtabe, fabrika dhe mjedise të tjera të ushtrisë ose të policisë. Në këto raste nuk mund të kishte fort vend dyshimi për vlefshmërinë e objektivave të sulmit, apo që këto vendndodhje përbënin objektiva të ligjshme ushtarake.

Ajo çka përbën objekt diskutimi janë çështjet madhore si ligjore ashtu edhe politike rreth disa incidenteve të caktuara, si në rastet e mëposhtme:

Refugjatët në rrugën Gjakovë-Deçan

Më 14 prill, përgjatë orëve të ditës, avionët e NATO-s do të bombardonin në mënyrë të përsëritur një karvan refugjatësh në një segment rrugor prej dymbëdhjetë miljesh, midis Gjakovës dhe Deçanit, në Kosovën perëndimore, duke lënduar tridhjetë e gjashtë vetë dhe vrarë shtatëdhjetë e tre civilë – Human Rights Watch do të ishte në gjendje të dokumentonte të gjithë rastet e vdekjeve. Sulmet nisën rreth orës 13.30 dhe vijuan për rreth dy orë, duke shkaktuar vdekjen e civilëve në një sërë vendndodhjesh përgjatë rrugës së karvanit, pranë fshatrave Bistrazinë, Gradishë, Madanaj dhe Mejë. Fillimisht zëdhënësi i NATO-s dhe ai i Shteteve të Bashkuara deklaruan se, objektivi ishte ekskluzivisht autokolonë

ushtarake dhe se përgjegjës për sulmin mbi civilët mund të ishin forcat serbe. Zëdhënësi i Pentagonit Ken Bacon tha se, komandanti i NATO-s, gjenerali Wesley Clark kishte marrë raporte që thoshin se, "pasi autokolona ishte goditur, njerëz me uniforma ushtarake kishin dalë dhe sulmuar civilët." "Pilotët pohojnë se kanë sulmuar vetëm automjete ushtarake," NATO tha, duke shtuar se "incidenti që është raportuar do të hetohet plotësisht, pasi të jenë rishikuar të gjithë detajet e misionit." Gjithashtu, ekzistojnë raporte të ndryshme të NATO-s, rreth flasifikimit të provave nga serbët, të cilët i kanë marrë dhe vendosur kufomat në vendin e bombardimit. Veçanërisht, ministri gjerman i Mbrojtjes, Rudolph Scharping, do t'ia hidhte fajin forcave jugosllave për viktimat në radhët e civilëve. [6]

Më 15 prill, NATO nisi të rishikojë qëndrimin e vet. Ajo tha se, "sipas të gjitha gjasave" një avion i NATO-s, kishte lëshuar një bombë mbi një automjet civil, i cili po udhëtonte me një autokolonë ushtarake. Referenca për autokolonën ushtarake do të modifikohej: "Automjete të ushtrisë apo ushtrisë serbe mund të kenë qenë në ose në afërsi të autokolonës." NATO e pranoi se, kishte bombarduar gabimisht automjete civile: "Pas një hetimi paraprak, NATO konfirmoi se, pas të gjitha gjasave, njëri nga aeroplanët e saj kishte hedhur një bombë mbi një automjet civil, i cili ishte duke udhëtuar ditën e djeshme me një autokolonë."

Më datë 15 prill, gazetarë amerikanë shkuan në vendngjarje. Ata intervistuan refugjatë që kishin mbijetuar pas sulmit dhe vëzhguan traktorë të shkatërruar, kufoma te djegura të identifikuara si refugjatë, kratere bombash, shrapnela dhe mbeturina bombash me markën U.S. Sipas të dhënave, kolona e refugjatëve kish pasë qenë e ndarë në grupe të mëdhaja. Në harkun kohor të pak ditëve, NATO lëvizi nga pozicioni këmbëngulës se, forcat e saj kishin sulmuar vetëm

Shtatëdhjetë e tre civilë u vranë dhe tridhjetë e gjashtë u plagosën duke përfshirë këtu edhe këtë shqiptar etnik që paraqitet në foto kur NATO-ja bombardoi një karvan njerëzish të shpërngulur nga shtëpitë e tyre në rrugën ndërmjet Gjakovës dhe Deçanit më 14 prill. "Katërmbëdhjetë njerëz që ndodheshin në traktorin tim u vranë," tha ai.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

automjete ushtarake dhe, shpjegoi se, dy autokolona kishin qenë objektivi i saj, se refugjatët kishin pasë qenë në fund autokolonave ushtarake dhe se, numri i civilëve të vrarë ishte i kufizuar. Më 16 prill, zëdhënësi i NATO-s Jamie Shea dhe gjenerali Giuseppe Marini deklaruan se, "në një rast dhe vetëm një, ne kemi prova për humbje jetësh nga radhët e civilëve. Në të gjithë rastet e tjera, ne jemi të sigurt se kemi goditur automjete ushtarakë."

Ndryshimet e raportuara në rregullat e angazhimit të NATO-s, dëshmojnë se, aleanca e njihte faktin që nuk kishte marrë masat e duhura para se të ndërmerrte këtë sulm.

Përfundimisht, NATO pranoi se, piloti i një avioni F-16 të Sh. B., kishte hapur zjarr gabimisht mbi atë çka ai kishte besuar se kishin pasë qenë kamionë ushtarakë dhe për këtë shprehu "keqardhjen më të thellë". Pak ditë më vonë, më 19 prill, NATO e modifikoi sërish qëndrimin e vet, si gabim të një piloti të vetëm dhe, deklaroi se, rreth një dyzinë avionësh ishin përfshirë në një sërë sulmesh mbi dy autokolona, duke hedhur mbi to, në total nëntë bomba. Shpjegime pas shpjegimesh do të vijonin edhe në ditët në vazhdim, ditë të tëra pas incidentit; NATO dhe Shtetet e Bashkuara dukeshin të paafta të rindërtonin saktë atë çka kish ndodhur. Në shtyp do të flitej gjerësisht për përdorimin e minave kasetë, gjë që Shtetet e Bashkuara do ta mohonin.[7]

Në vijim të artikujve të shtypit rreth këtij incidenti dhe kontrollit rreth dëmeve të pasosura, të ushtruar nga ana e zëdhënësve të NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara, Human Rights Watch siguroi prova të mëtejshme rreth incidentit nga ana e qeverisë jugosllave.[8] Deri më sot nuk është prodhuar kurrfarë dëshmie që të tregojë përgjegjësinë e palës serbe për secilën nga vdekjet e civilëve, edhe pse Tanjug-u do të raportonte për vdekjen e tre "policëve" serbë gjatë bombardimeve, të cilët, sipas tij, ndodheshin "për të siguruar kalimin pa probleme të autokolonës."[9] Ky fakt na jep të kuptojmë se, ushtria dhe policia ishin të pranishme midis automjeteve të refugjatëve, por Human Rights Watch nuk gjeti kurrfarë baze që të mbështeste pohimin se, autokolonat përbëheshin kryesisht nga automjete ushtarake.[10]

Në shtator, gjenerali Clark do të deklaronte se, NATO-ja në mënyrë të vazhdueshme kishte vëzhguar lëvizjen nëpër rrugë të automjeteve ushtarake jugosllave "të përziera me autokolonat e civilëve." Pas incidentit në rrugën Gjakovë-Deçan, gjenerali Clark tha se, "ne duhet të tregojmë kujdes shumë, shumë të madh para se të godasim objektet lëvizëse në

rrugë.[11] Një tjetër oficer i NATO-s, koloneli Ed Boyle, tha: "Ngaqë ishim tepër të shqetësuar për dëmet e mundshme anësore, CFAC (Komandanti i Komponentit të Forcave Ajrore të Kombinuara) i asaj kohe, gjenerali (Michael) Short, nxorri një qarkore ku thuhej se, për të shmangur dëmet anësore, në rast se automjetet ushtarake do të ishin të përzierë me automjetet civile, ata nuk duhej të sulmoheshin."[12] Se kur ishte lëshuar në të vërtetë kjo urdhëresë dhe, pse ajo nuk kish shërbyer për të shmangur tri incidentet e paskëtajshme, mbeten pyetje të rëndësishme që edhe sot lypin përgjigje. Gjithsesi, ndryshimet e raportuara në rregullat e angazhimit të NATO-s, dëshmojnë se, aleanca e njihte faktin që nuk kishte marrë masat e duhura para se të ndërmerrte këtë sulm, në mosidentifikimin e pranisë së civilëve dhe në hamendësimin se objektivat e synuar ishin shënjestra të ligjshme ushtarake.

Civilët e shpërngulur në pyjet e Koricës

Më 13 maj, afro një muaj pas incidentit në rrugën Gjakovë-Deçan, rreth tetëdhjetë e shtatë civilë kosovarë të shpërngulur nga shtëpitë e tyre u vranë dhe gjashtëdhjetë u plagosën, pasi një numër bombash u hodhën gjatë natës mbi një kamp refugjatësh në një zonë të pyllëzuar përgjatë rrugës Prizren-Suharekë, pranë fshatit Koricë. Deri më sot ka pasur një sërë raportesh kontradiktorë rreth numrit të të vdekurve, që shkon nga 48 në 87 vetë.[13] Qeveria jugosllave deklaroi se sulmuesit kishin përdorur mina kasetë dhe *Libri i Bardhë*, i publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme përfshinte fotografi, sipas së cilës, të marra nga vendngjarja, që tregonin mbeturina municioni taktik (TMDs). Zëdhënësit e NATO-s e mohuan prerazi përdorimin e minave kasetë,[14] dhe Human Rights Watch nuk ka qenë në gjendje të konfirmojë, në mënyrë të pavarur, që gjatë këtij sulmi ishin shtënë vërtet në përdorim mina kasetë.

Në një deklaratë zyrtare të datës 15 maj, zëdhënësi i NATO-s, gjeneralmajoriWalter Jertz e pranoi autorësinë e sulmit, duke shprehur keqardhjen më të thellë për "viktimat aksidentale në radhët e civilëve." E megjithatë, ai këmbënguli se, sulmi kishte qenë kundër forcave të ushtrisë jugosllave në terren:

> Ai ishte një objektiv i ligjshëm ushtarak. Mëtimet e serbëve për një sulm të ndërmarrë me mina kasetë kundër një objektivi jo ushtarak janë

> krejtësisht të gënjeshtërta. NATO e kish identifikuar Koricën si një kamp ushtarak dhe postkomandë. Pajisje ushtarake, duke përfshirë këtu një transportues trupash të motorizuar dhe më shumë se dhjetë copë bateri artilerie ishin vëzhguar në atë vend. Para se të ndërmerrnin sulmin, avionët e vëzhgimit kishin pikasur pozicione ushtarake të gërmuara në atë vend. NATO nuk mund të konfirmojë shifrën e viktimave të dhëna nga autoritetet serbe dhe as arsyet e ndodhjes së civilëve në atë vend, në kohën e sulmit.[15]

Deklarata e NATO-s do të theksonte dhe më tej faktin se, në atë vend ishin identifikuar pozicione ushtarake dhe se bombat e përdorura përfshinin predha drejtimmarrëse me rreze lazer dhe jo bomba të thjeshta gravitacionale:

> Fill para nisjes së sulmit, në orën 23.30, me orën lokale, natën e së enjtes, një avion pararojë patrullimi konfirmoi objektivin, kësisoj aparaturat e sistemit të identifikimit dhe të sulmit të avionit të tij, pasi kishte identifikuar pozitivisht objektivin që ngjasonte me llogore ushtarake, lëshoi dy bomba drejtimmarrëse me rreze lazer. Pasi e kreu sulmin, ai sinjalizoi shokun që kishte në krah të sulmonte të njëjtin objektiv, duke vënë kështu në përdorim edhe dy bomba të tjera me lazer. Pas dhjetë minutash afërsisht, një avion i tretë e goditi objektivin me … gjashtë bomba gravitacionale. Pra, në total, mbi objektivin u hodhën dhjetë bomba.[16]

Po atë ditë, zëdhënësi i Pentagonit Kenneth Bacon, në një njoftim për shtypin tha se, incidenti do të rishikohej, por askush të mos mendonte se do të kishte ndryshime madhore në kryerjen e operacioneve ajrore:

> Aksidenti në Korica nuk e lëkund kurrsesi vendosmërinë e NATO-s … NATO shpreh keqardhjen më të thellë për viktimat në radhët e civilëve … Ne përpiqemi me të gjitha forcat tona të shmangim viktimat, por rreziku është në natyrën e luftës, ndaj dhe aksidentet nuk mund të shmangen … ky mision, si çdo mision tjetër, do të rishikohet, kësisoj piloti dhe komandantët e tij të nxjerrin gjithë mësimet e mundshme prej tij dhe të vazhdojnë në rrugën e nisur. Por unë s'mund t'ju them që do të ketë ndryshime rrënjësore. Ne s'mund të anashkalojmë objektiva të ligjshëm ushtarakë dhe t'i fshijmë nga lista, jo këtë gjë s'do ta bëjmë.[17]

Më 16 maj, një refugjat kosovar i pranishëm gjatë sulmit të NATO-s mbi Koricë, i tha Deutsche Welle se, policët jugosllavë i kishin përdorur rreth 600 kosovarë të shpërngulur si mburoja njerëzore para se të fillonte sulmi. "Na u tha se diçka e keqe do ta na ndodhte po të largoheshim nga ai vend," tha dëshmitari, i intervistuar nga gazetari i shërbimit në shqip të radiostacionit. Ai tha se policët serbë ua kishin hedhur fjalën rreth asaj që kish për të ndodhur. "Tani keni për të parë në lëkurën tuaj se çdo të thotë sulmi i NATO-s," citoi refugjati njërin prej policëve të kishte thënë. Refugjati tha se kishte shkuar të flinte nën një traktor dhe ishte zgjuar vetëm nga tronditja e një eksplozioni dhe të qarat e ulërimat e grave dhe të fëmijëve. Ai tha se, ai dhe disa të tjerë ia kishin dalë të kaptonin murin dy metrat të lartë që rrethonte vendin dhe ia kishin mbathur në drejtim të fshatit, ndërkohë që paraushtarakët serbë kishin hapur zjarr mbi ta.[18] Në bazë të dëshmive që zotërojmë nuk është e mundur të konkludojmë se, policët serbë apo trupat e ushtrisë jugosllave i kishin shtrënguar me forcë civilët të grupoheshin rreth e qark tyre, madje as të nxjerrim motivin e një aksioni të tillë.

Ligjet e luftës shprehimisht e ndalojnë përdorimin e mburojave njerëzore. Neni 28 i Konventës së IV të Gjenevës kushtëzon që "Prania e një personi të mbrojtur nuk mund të përdoret për t'i imunizuar disa pika apo zona nga operacionet ushtarake." Protokolli I, neni 51 [7], e shtjellon kësisoj:

> Prania ose lëvizjet e popullsisë civile qoftë edhe të individëve të ndryshëm civilë nuk duhet të përdoret për të imunizuar pika të caktuara ose zona nga operacionet ushtarake dhe, sidomos, në përpjekje për të mbrojtur objektiva ushtarakë nga sulmet ose për të mbrojtur, favorizuar apo ndaluar ndërmarrjen e operacioneve ushtarake. Palët në konflikt nuk duhet t'u japin drejtime të caktuara lëvizjeve të popullsisë civile qoftë edhe të individëve të ndryshëm civilë, me synimin për t'i përdorur ata si mburoja për të mbrojtur objektivat ushtarakë nga sulmet apo ndërmarrja e operacioneve ushtarake.

E megjithatë, në nenin 51 [8], protokolli thekson se, të tilla shkelje të ligjeve të luftës nuk e çlirojnë kurrsesi kundërshtarin nga detyrimet për të respektuar imunitetin e civilëve. Një vështrim i ri autoritativ mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare pohon: "Në qoftë se njëra palë në

konflikt e thyen këtë rregull, kjo nuk do të thotë se të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe pala tjetër në zbatimin e rregullave në një sulm ushtarak ... Kësodore, komanda ushtarake lypset të marrë parasysh faktin që, kolona e refugjatëve është përdorur nga pala kundërshtare si mburojë njerëzore."[19]

Atëherë pyetja që shtrohet për NATO-n është nëse, përcaktimi i objektivit u bë duke e ditur se qindra civilë të shpërngulur ishin të pranishëm në atë zonë pyjore – gjë për të cilën nuk kemi ndonjë dëshmi – dhe, e dyta, a u morën të gjitha masat e nevojshme për të verifikuar që objektivi i caktuar nuk kish gjithë ata civilë të përqëndruar në atë vend. Nga kjo pikëpamje, numri tejet i lartë i civilëve të vrarë, lidhur me atë çka vetë NATO do ta përshkruante si një aksident të vajtueshëm, na jep të kuptojmë se verifikimi nuk ishte kryer siç duhet.

Bombardimi i burgut të Dubravës

Një tjetër rast që kemi të bëjmë me një mashtrim nga ana e autoriteteve jugosllave lidhet me vdekjen e civilëve dhe bombardimin nga ana e NATO-s që shkatërroi kompleksin e madh të burgut të Dubravës, pranë Istogut. Duke iu referuar NATO-s dhe ish të burgosurve të Dubravës të intervistuar nga Human Rights Watch, ushtria jugosllave dhe trupat policore serbe ishin strehuar përbri burgut, i cili vazhdonte të funksiononte me kapacitet të plotë edhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s, si vend për shlyerjen e kohës së dënimit për kriminelë ordinerë dhe të burgosur politikë.

Instituti i Riedukimit në Istog, siç quhej zyrtarisht, u godit dy herë nga NATO, duke shkaktuar vdekjen e një numri civilësh midis të burgosurve dhe rojeve të burgut. Në sulmin e parë, të kryer më 19 maj, në orën 1.15 të pasdites, u raportua se humbën jetën tre të burgosur dhe një roje. Sulmi i dytë ndodhi më 21 maj, gjatë të cilit u vranë jo më pak se nëntëmbëdhjetë të burgosur. Një hetim i ndërmarrë nga Human Rights Watch, i bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve okularë, u zbulua se, pas sulmit të datës 21 maj, të burgosurit qenë rreshtuar dhe mbi ta qe hapur zjarr nga policët serbë dhe rojet e burgut brenda iu mureve të burgut, për pasojë tetëdhjetë e ca të burgosur mbetën të vrarë. (Për një dokumentacion më të hollësishëm rreth vrasjeve, shih seksionin mbi burgun e Dubravës, në kapitullin mbi komunën e Istogut.)

Fillimisht qeveria jugosllave do të raportonte se, si pasojë e sulmit të datës 21 maj mbi Institutin e Riedukimit të Dubravës, ishin vrarë nëntëmbëdhjetë vetë.[20] Ndërsa katër ditë më vonë, shtypi jugosllav, duke referuar agjencisë zyrtare të lajmeve Tanjug, raportonte se, "gjatë bombardimit disa ditor të Institutit të Riedukimit në Istog, rreth 100 të burgosur kishin vdekur, kurse 200 të tjerë ishin plagosur." Më 27 maj, Tanjug citonte Vlladan Bojiç, një gjykatës të qarkut të Pejës, i cili thoshte se nëntëdhjetë e gjashtë kufoma ishin nxjerrë nga rrënojat. Më 29 maj, qeveria jugosllave do të deklaronte, "Numri i viktimave në Institutin e Riedukimit të Istogut po vjen duke u rritur."[21] Më 30 maj, raportonte se, në total numri i të vrarëve arrinte në nëntëdhjetë e tre vetë.[22] Në korrik, qeveria jugosllave deklaronte se, bombat e NATO-s kishin vrarë nëntëdhjetë e pesë të burgosur dhe kishin lënduar 196 të tjerë.[23]

Teksa NATO e pranoi pa asnjë mëdyshje sulmin ajror mbi Istog dhe i përligji sulmet në terren si goditje mbi objektiva ushtarakë "në afërsi të burgut,"[24] Human Rights Watch ka arritur në përfundimin se, trupat jugosllave ishin po aq përgjegjëse për pjesën më të madhe të vdekjeve që ndodhën fill pas bombardimeve. Sipas dëshmitarëve okularë, më 22 maj, ofiqarët e burgut urdhëruan që rreth 1000 të burgosur të viheshin në rresht në oborrin e burgut. Pas pak minutash, mbi ta u hap zjarr dhe u vërvitën granata nga muret e burgut si dhe kullat e rojeve, duke vrarë jo më pak se shtatëdhjetë vetë. Njëzet e katër orë më pas, rojet e burgut, forcat speciale të policisë, ndoshta edhe paraushtarakë, sulmuan të burgosurit që ishin fshehur në godinat e burgut, bodrume dhe kanalet e ujërave të zeza, duke vrarë edhe dymbëdhjetë persona të tjerë.

Gazetarët që vizituan burgun e Dubravës më 21 maj, menjëherë pas bombardimit të mëngjesit, bënë të ditur se kishin parë ndërmjet dhjetë dhe njëzet trupa.[25] Autoritetet serbe e hapën sërish burgun për gazetarët më 24 maj. Duke raportuar për BBC-në, Jacky Roëland tha se, ishte krejtësisht e paqartë se si kishin vdekur viktimat në burg, por ndërkohë, tre ditë pas vizitës së parë të gazetarëve, numri i të vrarëve ishte ngjitur në dyzet e katër. Pamja e trupave të të burgosurve nuk përkonte aspak me pretendimet e qeverisë se, ata kishin vdekur gjatë bombardimeve. Vizitat e gazetarëve në burg, me mbarimin e luftës, do të konfirmonin faktin se të burgosurit ishin ekzekutuar pas bombardimeve.[26]

Duke marrë parasysh numrin e viktimave civile gjatë dy sulmeve të kryera mbi burgun e Dubravës, duket sheshit se NATO nuk kishte marrë

masat e duhura të kujdesit në ekzekutimin e goditjeve ajrore mbi objektivat ushtarake aty pranë, ndaj dhe për pasojë, lypset të mbajë përgjegjësi për vdekjen e civilëve që ndodhi si rezultat i drejtpërdrejtë i sulmeve të kryera. Por, nga ana tjetër, forcat jugosllave mbajnë përgjegjësi të plotë për vdekjen e tetëdhjetë e gjashtë nga nëntëdhjetë e pesë viktimat e pranuara nga autoritetet jugosllave në burgun e Dubravës, sepse të gjithë këta ishin të burgosur që u ekzekutuan pa gjyq, pasi ishin kryer sulmet ajorore të NATO-s.

Përdorimi nga NATO i minave kasetë

Një nga çështjet që ka ngjallur interesin e opinionit publik rreth Operacionit të Forcave Aleate është përdorimi nga ana e NATO-s i minave kasetë. Prej përdorimit të minave kasetë nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe, njihen shtatë incidentë tashmë të konfirmuar, si dhe pesë të dyshuar, që kanë shkaktuar vdekjen e civilëve. Marrë sëbashku, në të gjithë territorin e Jugosllavisë, nëntëdhjetë nga 150 civilë, vdiqën nga minat kasetë të NATO-s.

Incidenti më i rëndë që shkaktoi vdekjen e një numri civilësh, nga përdorimi i minave kasetë, ndodhi më 7 maj, në Nish, Serbi. Sulmi i mesditës mbi aerodromin e Nishit, i cili ndodhet brenda zonës urbane, shkaktoi vrasjen e katërmbëdhjetë civilëve dhe plagosjen e njëzet e tetë të tjerëve. NATO, nga ana e saj, e konfirmoi sulmin e ndërmarrë mbi aerodromin e Nishit,[27] ndërsa më 8 maj, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Solana, e pranoi përgjegjësinë e NATO-s për sulmin e kryer, duke deklaruar se, “NATO e ka pranuar se dëmi i shkaktuar në treg dhe klinikë është shkaktuar nga një predhë e NATO-s, që nuk ra mbi objektiv.”[28] Sipas burimeve nga komanda e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara, një CBU-87, në bordin e të cilit gjendeshin mina kasetë, nuk arriti t’i lëshonte bombat mbi aerodrom, por i lëshoi ato menjëherë pasi u çlirua nga sulmi i një avioni armik, duke e projektuar municionin nga një distancë e madhe mbi qytet.[29]

Pas incidentit të Nishit, Shtëpia e Bardhë, pa shumë bujë e zhurmë, i dërgoi një urdhëresë Pentagonit, ku i kërkohej të ndalohej përdorimi i minave kasetë (të paktën nga forcat e Shteteve të Bashkuara).[30] Human Rights Watch e konsideron këtë vendim të drejtë, por duke pasur parasysh rrezikun, ka shprehur shqetësimin e vet se, minat kasetë janë përdorur

më së shumti gjatë sulmeve mbi objektiva që gjendeshin në qytete. Ndalimi në mes të majit i përdorimit të mëtejshëm të minave kasetë, ndërkohë që lufta vazhdonte, pati një impakt të qartë në uljen e nivelit të vdekjeve në radhët e civilëve; edhe pse bombardimet me predha jo drejtimmarrëse (në rast të kundërt do të hynin në përdorim minat kasetë), erdhën duke u intensifikuar nga fundi i muajit. E megjithatë, forcat ajrore britanike vijuan të hidhnin mina kasetë (kronologjia zyrtare na flet për përdorimin e tyre të paktën në këto data, 17 maj, 31 maj, 3 qershor dhe 4 qershor),[31] gjë që dëshmon për nevojën e hartimit të normave ndërkombëtare dhe jo thjesht kombëtare, që do të rregullojnë përdorimin e minave kasetë.

17

ABUZIMET PAS 12 QERSHORIT 1999

HYRJE

Miratimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, më 10 qershor 1999, dhe arritja e Marrëveshjes Ushtarako-Teknike midis NATO-s dhe qeverive të Serbisë e Republikës Federale të Jugosllavisë, i dha fund si bombardimeve të NATO-s ashtu edhe dëbimeve në masë e vrasjeve nga ana e forcave serbe dhe jugosllave të sigurimit. Në përputhje me termat e marrëveshjes, forcat paqeruajtëse nën drejtimin e NATO-s (KFOR) hynë në provincë më 12 qershor, teksa Ushtria Jugosllave si dhe trupat e policisë (dhe paraushtarakët) serbë, nisën tërheqjen në disa faza, gjë që u pasua nga ndërprerja e goditjeve ajrore të NATO-s. Më 20 qershor, forcat serbe dhe ato jugosllave të sigurimit kishin kryer tërheqjen e plotë, duke e lënë Kosovën nën kontrollin e NATO-s.

Largimi i forcave serbe dhe atyre jugosllave të sigurimit i dha fund persekutimit sistematik dhe gjithnjë e më të përgjakshëm të shqiptarëve të Kosovës, për shumë se një dekadë. E megjithatë nuk i dha fund dhunës apo shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë. Pakicat serbe dhe rrome të provincës - të cilët kundrohen kolektvisht nga shqiptarët etnikë si bashkëfajtorë aktivë në mizoritë e kryera nga forcat qeveritare – u shndërruan menjëherë në shënjestër të hakmarrjes. Ndërkohë që mijëra prej tyre tashmë ishin larguar bashkë me forcat qeveritare. Ata që mbetën u shtrënguan ta braktisnin provincën ose të përqëndroheshin në enklava, pas zjarrvëniesh sistematike e të gjithanshme të shtëpive të serbëve e të rromëve, rrahjeve, burgosjeve dhe vrasjeve. Në korrik të vitit 2001, numri i serbëve dhe rromëve

Gruaa e moshuar serbe në pritje për të lënë Prizrenin në përbërje të një karvani civilësh serbë të shpërngulur më 14 qershor 1999.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

kosovarë të zhdukur pa lënë gjurmë, kapte shifrën e 1000 vetëve.[1]

Shumë shpejt dhuna do të shtrihej dhe pjesë e saj do të bëheshin sulmet edhe kundër pakicave të tjera, duke përfshirë këtu sidomos myslimanët që flisnin sllavisht dhe më pak shqiptarët, kroatët dhe turqit etnikë. Objekt i sulmeve do të bëheshin edhe shqiptarët tok me familjet e tyre, që kundroheshin si kolaboracionistë të qeverisë serbe dhe asaj jugosllave. Në të njëjtën kohë, dhuna politike ndërmjet partive politike shqiptare, si dhe fraksioneve e rivaliteteve midis ish-oficerëve të Ushtrisë për Çlirimin e Kosovës (ngandonjëherë të lidhura me probleme ekonomike dhe afera korruptive), shpunë në vrasjen e disa personaliteteve, gjë që do të vijonte dhe pas zgjedhjeve bashkiake më 28 tetor 2000.

SULMET MBI MINORITETET

Fill pas mbërritjes së trupave të KFOR-it në Kosovë, UÇK-ja dhe civilët shqiptarë ndërmorrën një fushatë të gjerë djegiesh dhe plaçkitjesh të shtëpivë që iu përkisnin serbëve, rromëve e pakicave të tjera, duke shkatërruar në të njëjtën kohë një numër të madh kishash ortodokse dhe manastiresh. Njerëzit që i ndërmorrën këto sulme do t'i kombinonin shkatërrimet me vrasje, abuzime dhe frikësime, përmes të cilave synonin t'i shtrëngonin pjesëtarët e pakicave të linin shtëpitë dhe bashkësitë, proces ky që vijon edhe sot e kësaj dite. Pjesëtarë të pakicave etnike në Kosovë janë mbajtur peng, rrahur e ngandonjëherë edhe torturuar, ndërkohë që 1000 serbë e rromë janë zhdukur dhe nuk dihet gjë për fatin e tyre, të cilët janë rrëmbyer fill pas mbarimit të konfliktit. Të moshuarit e të pamundurit që kanë mbetur nëpër shtëpia, gjithnjë e më shpesh kanë përballuar barrën e kësaj dhune dhe fushatës së kërcënimeve që e ka shoqëruar atë, ndërkohë që sot, shumë prej tyre jetojnë virtualisht si të burgosur brenda mureve të shtëpive të tyre. Rrjedhojat demografike kanë qenë të mëdhaja: Jo më pak se 150.000 pjesëtarë të minoriteteve në Kosovë janë larguar nga provinca në drejtim të Serbisë dhe Malit të Zi, pjesa më e madhe e tyre brenda gjashtë javëve të para pas hyrjes së trupave të KFOR-it.[2] Përveç largimit të popullsisë jo shqiptare

Pjesëtarë të pakicave etnike në Kosovë janë mbajtur peng, rrahur e ngandonjëherë edhe torturuar, ndërkohë që 1000 serbë e rromë janë zhdukur.

nga provinca, ka pasur raste të konsiderueshme zhvendosjesh brenda për brenda Kosovës, ku një numër i madh serbësh, por nga pakica të tjera, janë përqëndruar në enklava, si ajo në veri të Mitrovicës apo në Fushë Kosovë.

Edhe pse dëshira për hakmarrje e shpagim mund të shërbejë deri diku për të shpjeguar dhunën, sidomos në rastet e djegies së shtëpive dhe plaçkitjes së pronës, gjithsesi, hulumtuesit e Human Rights Watch mendojnë se një pjesë e madhe e dhunës së ushtruar është e motivuar politikisht; fjala vjen, zhvendosja nga Kosova e banorëve jo shqiptarë etnikë me synimin për të përligjur më mirë një shtet të pavarur. Gjithashtgu ekzistojnë dëshmi të qarta se, disa prej njësive të UÇK-së janë përgjegjëse për dhunën e ushtruar kundër minoriteteve, duke nisur nga vera e vitit 1999 e për të vijuar gjatë gjithë 2000 dhe në fillim të 2001. Gjithsesi, lypset thënë se Human Rights Watch nuk ka ndonjë dëshmi se për këtë ekziston një politikë e bashkërenduar midis drejtuesve politikë dhe atyre ushtarakë të ish-UÇK-së, të cilët, nga ana tjetër, i kanë dënuar sulmet kundër pakicave etnike në një sërë deklaratash publike.[3]

Një pjesë e madhe e dhunës së ushtruar është e motivuar politikisht; fjala vjen, zhvendosja nga Kosova e banorëve jo shqiptarë etnikë.

Vullneti i pothuaj të gjithë shqiptarëve kosovarë për ta kyçur gojën kundrejt këtyre sulmeve, qoftë nga frika qoftë nga fakti se ata besojnë në fajësinë kolektive të serbëve e të rromëve, ka krijuar një mjedis që e toleron dhunën kundër minoriteteve. Intervistat e Human Rights Watch me shqiptarë kosovarë nga i gjithë spektri i shoqërisë, na sugjerojnë se ekziston një frymë mbizotëruese e pikëpamjes se, mizoritë e kryera gjatë kohës së luftës do të thotë se, sot serbët nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në Kosovë dhe të gëzojnë pronat e pasuritë e tyre, pavarësisht nëse kanë qenë apo jo të angazhuar në krime. Nga ana tjetër, shumë nga të intervistuarit do të shprehnin, privatisht, mospajtimin e tyre me dhunën e ushtruar kundër minoriteteve.

Nuk ka ndonjë shifër për numrin e shtëpive të shkatërruara në periudhën e pasluftës, që iu përkasin pjesëtarëve të pakicave etnike, por hulumtuesit e Human Rights Watch gjatë vizitave të tyre në verë të vitit 1999, në ish-bashkësitë e përziera në të gjithë territorin e Kosovës, vunë re gjithandej shtëpi të djegura e të palçkitura. Qysh nga qershori i vitit 1999, shtatëdhjetë e gjashtë kisha, manastire dhe vende të shenjta që i përkasin besimit ortodoks janë dëmtuar ose shkatërruar, sipas të dhënave

të ofruara nga Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë.[4] Hulumtuesit e Human Rights Watch vizituan një pjesë të objekteve të kultit.

Pas shumë vrasjeve dhe rrëmbimeve që kanë ndodhur në provincë, që nga qershori i vitit 1999, ka të ngjarë të qëndrojë më fort synimi i dëbimit nga Kosova të popullsisë serbe e rrome sesa ai i hakmarrjes. Në një numër të madh rastesh, janë bërë përpjekje të drejtpërdrejta dhe sistematike për t'i shtrënguar serbët e rromët të largohen nga shtëpitë e tyre.[5] Për shembull, Human Rights Watch ka dokumentuar një sërë abuzimesh të ushtruara kundrejt grash të moshuara serbe në ish-bashkësitë e përziera të komunave të Prizrenit e Gjilanit dhe ka marrë të dhëna për përpjekjet e shumta që janë bërë për t'i përzënë serbët nga shtëpitë e tyre në Prishtinë e Lipjan. Rromë janë nxjerrë nga shtëpitë në Prishtinë e gjetkë përmes kërcënimeve dhe abuzimesh të tjera.

Granatimet dhe sulmet me raketa ndaj shtëpive të pjesëtarëve të minoriteteve janë një tjetër metodë për t'i "bindur" banorët që të largohen. Sulme të kësaj natyre janë raportuar në komunat e Lipjanit, Vitisë, Gjilanit, Obiliqit, Rahovecit, Fushë Kosovës, Pejës, Prizrenit dhe Vushtrisë. Sulme

Fëmijë serb duke u larguar nga Prizreni tok me familjet e tyre më 14 qershor 1999. Pjesa më e madhe e popullsisë serbe të komunave të Prizrenit, Prishtinës, Pejës, Ferizajt dhe Istogut i braktisën shtëpitë e tyre me mbarimin e luftës për shkak të sulmeve hakmarrëse.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

kundër rromëve janë regjistruar në komunat e Shtimjes, Prishtinës dhe Pejës. Shtëpitë e Goranëve, një tjetër etnik grup sllavësh myslimanë, kanë qenë objekt sulmesh me granata në komunën e Gorës, ndërkohë që edhe sllavë myslimanë të tjerë, si boshnjakët, janë bërë objekt sulmesh me granata në Prizren, Pejë dhe Istog. Në Prishtinë, familje serbësh dhe rromësh kanë marrë telefonata kërcënuese, si dhe janë vizituar nga civilë të armatosur, por edhe persona me uniformën e UÇK-së, gjatë të cilave, atyre iu është kërkuar shkoqur e qartë të largohen. Sulmi me dy granata në një treg të Fushë Kosovës, plot e përplot me civilë serbë, në shtator të vitit 1999, gjatë të cilit u vranë dy vetë si dhe u plagosën dyzet e shtatë, lypset parë në të njëjtin kontekst. Madje edhe ata që zgjedhin rrugën e largimit nuk se janë të imunizuar prej dhunës; në tetor 1999, një karvan prej 150 serbësh që po largohej nga Kosova, i shoqëruar nga trupat e KFOR-it, u sulmua në Pejë. Makinat u goditën me gurë, ndërsa udhëtarët e tyre u nxorën me përdhunë dhe u rrahën, para se automjeteve t'u vihej flaka. Jo më pak se pesëmbëdhjetë serbë mbetën të plagosur gjatë sulmit.

Sipas një sondazhi të kryer nga UNHCR, më shumë se 150.000 vetë nga 210.000 gjithsejt të shpërngulur nga Kosova për në Serbi dhe Mal të Zi, janë larguar pas 12 qershorit.[6] Përafërsisht 143.000 persona nga 210.000 të shpërngulurit nga Kosova për në Serbi dhe Mal të Zi janë serbë, ndërsa rreth 25.000 janë rromë. Disa mijëra serbë dhe rromë hynë në Maqedoni në të njëjtën kohë, teksa një numër i panjohur u largua në drejtim të vendeve të treta. Veç kësaj, siç është përmendur, ka pasur zhvendosje të konsiderueshme popullsie që iu përkisnin minoriteteve të tjera, brenda për brenda Kosovës, në enklava monoetnike (të cilat nganndonjëherë përbënin një ndërtesë të vetme) përgjithësisht nën mbrojtjen e KFOR-it. Një numër i konsiderueshëm njerëzish nga pakicat e tjera, që s'kishin pasur të bënin me krimet e kryera kundër shqiptarëve, siç qenë Goranët, sllavë myslimanët dhe kroatët janë shpërngulur nga shtëpitë e tyre, të shtrënguar prej kanosjeve, abuzimeve madje edhe sulmeve të dhunshme. Shpjegimi sepse të gjithë këta që nuk qenë përfshirë në sulmet kundër shqiptarëve u bënë objekt i sulmeve të tyre është kompleks: një shpjegim mund të jetë se, duke qenë sllavisht folës, pjesëtarët e këtyre pakicave janë shoqërizuar me Jugosllavinë në përgjithësi dhe Serbinë në veçanti. Për më tepër, të gjithë këto minoritete mund të jenë konceptuar në bazë të asaj që kanë pasë gëzuar një status të privilegjuar në Kosovë, sidomos pas dhunës së ushtruar kundër shqiptarëve nga viti 1990 e këndej.

Pjesa më e madhe e popullsisë serbe në komunat e Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Ferizajt dhe Istogut i kanë braktisur shtëpitë e tyre, ashtu siç kanë vepruar edhe ata që banonin në qytetin e Gjilanit. Duke iu referuar një raporti të vitit 2000 të ndëragjencisë së Task Force-s ad hoc mbi minoritetet, vetëm 700 deri më 800 serbë kanë mbetur në Prishtinë, krahasuar me rreth 20.000 që qenë në vitin 1998.[7] Task Force do të raportonte gjithashtu se, në qytetin e Prizrenit kanë mbetur vetëm 120 serbë dhe njëzet e tre gjithsejt në qytetin e Ferizajt. Serbët e zhvendosur brenda për brenda Kosovës janë përqëndruar kryesisht në ato qytete apo fshatra që në rrjedhë të kohërave janë banuar në shumicë dërrmuese nga vetë serbët dhe që shpejt e shpejt u vunë nën mbrojtjen e KFOR-it. Këtu përfshihen Fushë Kosova, Babimoçi, Plemetina, Shtërpëca, Graçanica (në komunën e Prishtinës), Hoça e Madhe (në komunën e Rahovecit), Dobrotina dhe kudo gjetkë në komunën e Lipjanit (ku popullsia serbe kap shifrën e 9500 vetëve), komuna e Gjilanit (sipas vlerësimeve banohet nga 12.500 serbë), pjesa veriore e Mitrovicës, si dhe pjesa veriore e komunave të Leposaviqit dhe Zubin Potokut.[8] Veç kësaj, sipas UNHCR-së, nga 6000 refugjatë serbë të ardhur nga Kroacia e të vendosur në Kosovë, mbeten capak qindra, pasi të dy qendrat e grumbullimit të tyre u dogjën.

Siç është përmendur edhe më sipër, rromët e zhvendosur nga Kosova për në Serbi e Mal të Zi, janë jo më pak se 25.000 vetë, pa llogaritur këtu disa mijëra që gjenden në kampet e Maqedonisë. Gjithashtu edhe përbrenda Kosovës ka pasur zhvendosje të konsiderueshme, ndërsa numri i popullsisë së mbetur është i panjohur.[9] Qendra Europiane për të Drejtat e Rromëve (ERRC), një organizatë me qendër në Budapest, raportonte në korrik të vitit 1999 se, nga gjithë bashkësitë e rromëve që ajo kishte vizituar, asnjëra nuk kishte as gjysmën e popullsisë që kish pasur në periudhën e para konfliktit. Në shkurt të vitit 2000, vlerësimet e bëra nga Task Force ad hoc për Minoritetet, dëftonin se në qytetin e Prishtinës numri i rromëve të mbetur ishte diçka ndërmjet 115 deri më 140 vetë. Ndërsa raporti i hartuar nga po kjo Task Force, në nëntor 1999, e vlerësonte asokohe numrin e rromëve në komunën e Prishtinës nga 300 deri në 600 vetë.[10]Në fillim të vitit 2000, gjendja e popullsisë rrome në zona të ndryshme paraqitej kësisoj: Fushë Kosovë (ndërmjet 1700 deri në 2800 vetë), Obiliq (rreth 1200 vetë), Lipjan (rreth 1500 vetë), Ferizaj (4200 vetë), dhe Prizren (4-5000 vetë).[11]

Dhuna e ushtruar kundër rromëve ashkali shqipfolës, vijoi edhe pas zgjedhjeve bashkiake të 28 tetorit 2000. Më 8 nëntor, katër burra ashkali u

ekzekutuan nga mësymës të panjohur, në rrethinat e fshatit Dashevc, pranë Skënderajt. Ashkalitë, që jetonin në çadra, sapo ishin kthyer në shtëpitë e tyre, me ndihmën e UNHCR-së.[12] Në përgjigje të vrasjeve, kreui UNMIK-ut Bernard Kouchner u shpreh "Diku në Kosovë, ekstremistët duan të minojnë procesin e kthimit të njerëzve përsëmbari në shtëpitë e tyre."[13]

Edhe pjesëtarë të minoriteteve të tjera janë gjithashtu zhvendosur brenda për brenda Kosovës ose e kanë braktisur provincën një herë e mirë. Në nëntor të vitit 1999, 293 kroatë etnikë u evakuan nga Kosova për në Zagreb, pasi ata qenë ankuar për abuzimet e kryera kundër tyre, zjarrvënie dhe faktin që, nuk lejoheshin të flisnin gjuhën kroatisht.[14] Popullsia e kroatëve etnikë në Janjevo ishte vendosur nën mbrojtjen e rreptë të KFOR-it dhe në këtë pikë gjendja dukej e qëndrueshme. Gjithsesi, fill pas heqjes së rojeve të përhershme të KFOR-it, në mars 2000, sulmet kundër bashkësive kroate dhe rrome u intensifikuan dhe, do të pakësoheshin vetëm pas rivendosjes së trupave mbrojtëse të KFOR-it.

Popullsia sllave myslimane e Kosovës (shpesh të cilësuar si Boshnjakë) është gjithashtu larguar nga Prishtina, në një masë të konsiderueshme, kryesisht në drejtim të Bosnjës. Nga 3500 deri më 4000 që përllogaritej para luftës, tashmë kanë mbetur rreth 1600 deri më 1800 vetë.[15] Popullsia sllavo myslimane e Prizrenit (të cilët e quajnë veten Torbesh), që sipas përllogaritjeve shkon nga 23.000 deri më 25.000 vetë, i është nënshtruar një trysnie të fortë për t'u larguar, duke përfshirë këtu sulmet me granata, vrasjen e një familjeje të përbërë nga katër vetë në janar dhe atë të një burri në shkurt, si rrjedhojë e së cilës, një pjesë e tyre do të largohej.[16] Popullsia sllavo myslimane në Pejë ngjan pak a shumë e sigurt, e megjithatë pjesëtarë të ndryshëm të kësaj bashkësie i janë nënshtruar sulmeve të ndryshme: në prill, një grup i përbërë nga pesëmbëdhjetë shqiptarë sulmoi dhe rrahu një grua boshnjake shtatëdhjetë vjeçare. (Sipas të gjitha gjasave, gruaja ishte marrë gabimisht për serbe.) Sulme janë ndërmarrë edhe mbi shtëpitë e etnisë Gorani, të cilët dallohen nga sllavo myslimanët boshnjakë.

Që në fillim të qershorit 1999, grupe të armatosura shqiptarësh etnikë, përgjithësisht të paidentifikuar, kanë kryer rrëmbime serbësh e rromësh, në të gjithë territorin e Kosovës. Në disa raste, ata i kanë mbajtur të burgosur personat e rrëmbyer dhe pasi i kanë marrë në pyetje e rrahur, më pas i kanë liruar. E megjithatë, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kruq (ICRC), deri në prill të vitit 2001, për afro 500 nga personat e rrëmbyer nuk kishte asnjë të dhënë.[17]

Sipas Ranko Gjinoviç, president i Shoqatës së Familjeve të Personave të Zhdukur e të Rrëmbyer në Kosovë e Metohi, nga janari i vitit 1998 deri në nëntor 2000, rreth 1230 persona jo shqiptarë rezultonin të zhdukur. Njëzet përqind e këtyre personave ishin zhdukur para ndërhyrjes së NATO-s, 5 përqind gjatë fushatës ajrore, dhe 75 përqind pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, do të shprehej Gjinoviç.[18] Lypset thënë se kjo shifër mund të jetë ca e tepruar, duke pasur parasysh se disa prej emrave në listën e shoqatës janë shënuar nga dy herë, si dhe një pjesë e atyre që deklaroheshin të zhdukur ishin të burgosur dhe më pas janë liruar.

Në maj të vitit 2000, ICRC publikoi një libër me listën e emrave të personave të zhdukur në Kosovë, të regjistruar deri më atë kohë. Sipas ICRC-së, 450 persona ishin zhdukur nga 10 qershori i vitit 1999 deri më 31 mars 2000. Human Rights Watch pasi e pa listën e ICRC-së, vuri re që, sipas emrave, të paktën 309 prej tyre ishin pjesëtarë të pakicave (jo shqiptare).[19] Kjo listë ishte e përafërt me shifrat e dhëna nga Qendra Ligjore Humanitare, e cila kishte regjistruar 318 persona të zhdukur, jo të etnisë shqiptare, nga 24 marsi deri më 10 gusht 1999.[20] Numri në total i të zhdukurve të dhënë nga ICRC-ja për periudhën deri në prill të vitit 2001 ishte 3525 vetë, por kurrfarë dëshmie tjetër për dhunën etnike.[21]

Përdhunimi i grave nga pakicat e tjera etnike është raportuar qysh nga qershori i vitit 1999. Në mënyrë të veçantë objekt i kësaj dhune kanë qenë gratë rrome. Qendra Europiane për të Drejtat e Rromëve ka regjistruar tri raste përdhunimi të grave rrome të kryer nga persona me uniformën e UÇK-së. Kjo qendër kishte intervistuar një dëshmitar okular, i cili kishte dëshmuar se motra dhe gruaja e tij ishin përdhunuar nga katër vetë me uniformën e UÇK-së, në qytetin e Gjakovës, më 29 qershor 1999. Ata kishin intervistuar edhe të afërmen e një gruaje nga Mitrovica, që ishte përdhunuar më 20 qershor 1999, nga gjashtë persona me uniformën e UÇK-së.[22]

Më 26 qershor 1999, KFOR-i regjistroi denoncimin e një mesogruaje serbe nga Gjilani, që ishte përdhunuar nga dy shqiptarë kosovarë.[23] Dy gra shqiptare do të dëshmonin se i kishin parë të dy burrat kur kishin hyrë në apartamentin e gruas. OSBE-ja do të regjistronte rastin e përdhunimit të një gruaje rrome, në qytetin e Prizrenit, në tetor 1999, nga një grup burrash shqiptarë.[24] Njëri nga fajtorët, që u arrestua më pas nga KFOR-i, dyshohej për përdhunimin edhe të një rromeje tjetër, po në atë zonë. Raporti i muajit shkurt i Task Force mbi Minoritetet, kishte dokumentuar përdhunimin e një gruaje shtatzanë ashkali, në qytetin e

Ferizajt, në nëntor 1999, si dhe përdhunimin apo tentativat për përdhunim të një numri grash rrome në rajonin e Gjakovës, po atë muaj.

Sipas statistikave të KFOR-it, për afro pesë muaj, duke nisur nga mbërritja e KFOR-it më 12 qershor dhe deri në fillim të nëntorit 1999, në Kosovë kishin ndodhur 379 vrasje, prej të cilave 135 ishin serbë. Për personat nga pakicat e tjera etnike nuk ka të dhëna të veçanta, por gjithsesi shifrat e dhëna nxjerrin në pah, si mungesën e ligjit në Kosovën e pas luftës, ashtu edhe dhunën ndërmjet shqiptarëve dhe paraushtarakëve e civilëve serbë që vijoi përgjatë gjithë verës, sidomos në Kamenicë, Mitrovicë dhe disa zona të tjera. Nga 30 janari deri më 27 maj 2000, KFOR-i do të raportonte nëntëdhjetë e pesë vrasje në Kosovë.[26] Njëzet e gjashtë nga viktimat ishin serbë, shtatë rromë, dy sllavo myslimanë, pesëdhjetë e dy shqiptarë, ndërsa etniciteti i tetë prej viktimave të tjera mbetet i panjohur. Ndonëse statistikat shënojnë një rënie në numrin e vrasjeve, ajo çka ia vlen të theksohet është fakti se, vrasjet (tok me një sërë krimesh të tjera të rënda si mësymjet, zjarrvëniet dhe rrëmbimet) vijojnë të godasin në mënyrë disproporcionale pakicat etnike, të cilat, sot e kësaj dite, përbëjnë më pak se 10 përqind të popullsisë së Kosovës.[27]

Disa prej akteve më të rënda të dhunës kundër pakicave etnike kanë ndodhur në qytetin e ndarë të Mitrovicës dhe rreth e qark tij, i cili ka qenë gjithashtu skena e disa prej shpërnguljeve më masive të popullsisë, brenda për brenda Kosovës. Në vijim të shpërnguljes së rreth 8000 shqiptarëve gjatë kohës së luftës nga pjesa në veri të lumit Ibar (sot e banuar në shumicë mbizotëruese nga serbët), më shumë se 2000 serbë do të shpërnguleshin nga pjesa jugore e lumit (sot e banuar në shumicë mbizotëruese nga shqiptarët). Po kështu 8000 deri 10.000 rromë janë shtrënguar të largohen nga zona në jug të lumit. Pavarësisht nga përpjekjet gjithsesi të vonuara të KFOR-it dhe policisë së O.K.B.-së për të siguruar rendin e qetësinë në qytet, abuzimet, kërcënimet dhe incidentet e tjera e kanë pakësuar numrin e pakicave etnike në të dy krahët e lumit Ibar.

Praktikisht qyteti është i ndarë, ku të bie në sy një prani e madhe paqeruajtësish të KFOR-it, të ngarkuar me detyrën për t'i mbajtur larg njëra-tjetrës bashkësitë etnike, si dhe të mbrojë xhepat e ishulluar të serbëve e rromëve në pjesën jugore të qytetit dhe të shqiptarëve, sllavo myslimanëve e turqve në pjesën veriore (pjesa më e madhe e tyre janë përqëndruar në lagjen e ashtuquajtur të "boshnjakëve"). Aktet më të rënda të dhunës në Mitrovicë do të shpërthenin pas sulmit me raketa, më 2 shkurt 2000, kundër një autobuzi të UNHCR-së, të shoqëruar nga trupat

e KFOR-it, që udhëtonte nga enklava serbe e Banjës për në Mitrovicë. Si rrjedhojë e sulmit do të humbisnin jetën dy serbë të moshuar e do të mbesnin të plagosur tre të tjerë, ndërkohë që do të ndizte fitilin e dhunës në pjesën veriore të qytetit, prej së cilës do të mbeteshin të vrarë tetë persona nga pakica jo serbe, ndërsa më shumë se 1700 shqiptarë, sllavo myslimanë dhe turq do të largoheshin për në pjesën jugore të qytetit. Pas këtij sulmi, për afro dy muaj linja e autobuzëve të UNHCR-së që ndërlidhte enklavat e pakicave etnike nuk do të funksiononte.

Pas ngjarjeve të pranverës së vitit 2000, pakicat etnike mbetën një shënjestër e dhunës ndëretnike të ushtruar me vrazhdësi, e cila synonte t'i shtrëngonte ata të braktisnin Kosovën. Raporti i majit i Task Force ad hoc për Minoritetet përshkruante se, "serbja e fundit e mbetur në Klobukar (një fshat në komunën e Novo Bërdos) ishte goditur me thikë në gjoks, më 14 shkurt, teksa trupi i saj u zbulua vetëm një ditë më pas, mes rrënojave të shtëpisë së djegur."[28] Më 26 shkurt, Josip Vashiq, një doktor i njohur dhe anëtar i Këshillit Kombëtar Serb ishte qëlluar për vdekje në një nga rrugët e Gjilanit.[29] Më 11 mars, teksa punonte tokën në fshatin Bërnicë e Poshtme, në afërsi të Prishtinës, një serb njëzet e nëntë vjeçar ishte qëlluar për vdekje. Më 27 mars, një rrom i seksit mashkull ishte gjetur i mbytur me litar në Istog. Më 28 mars, një serbe e moshuar ishte rrahur në shtëpinë e saj në Prizren. Si pasojë plagëve të marra, gruaja do të vdiste më pas në spital. Më 3 prill 2000, Metodije Halauska, një plak tetëdhjetë e gjashtë vjeçar, me origjinë çeke, u rrëmbye nga shtëpia e tij në Prishtinë, u rrah për vdekje dhe më pas u qëllua me pistoletë nga pas kokës. Më 8 prill, trupi i paidentifikuar i një gruaje të moshuar, u gjet në gërmadhat e një shtëpie serbe të djegur në Pejë.[30] Po atë ditë, dy adoleshentë rromë, njëri shtatëmbëdhjetë dhe tjetri tetëmbëdhjetë, si dhe një grua dyzet e tetë vjeçare e po kësaj etnie, u gjetën të vrarë në Pejë. Më 9 prill, një serb u ekzekutua në një restorant në qytetin e Gjilanit. Po atë javë u vranë edhe tri serbë të tjerë.

Javët para dhe pas përvjetorit të parë të hyrjes së NATO-s në Kosovë do të ishin veçanërisht të përgjakura. Sulmet me granata, mina këmbësorësh dhe të shtëna "të orientuara" kundër serbëve, do të shënonin njëmbëdhjetë të vrarë dhe mëse një dyzinë të plagosurish. Më 22 maj, një fermer serb shtatëdhjetë vjeçar do të qëllohej për vdekje në fshatin Gojbujë (komuna e Vushtrisë).[31] Dy ditë më pas, një serb pesëdhjetë vjeç do të vritej në qytetin e Vitisë. Më 28 maj, dy burra dhe djalë katër vjeç do të vriteshin, ndërsa dy burra të tjerë do të plagoseshin nga të shtëna me armë në Cërnicë (komuna e Gjilanit).[32] Më 31 maj, nga të shtënat në Babimoç, një serb do të vritej,

ndërsa një tjetër do të mbetej i plagosur. Më 1 qershor, një grup serbësh nga fshati Kllokot (komuna e Gjilanit) që ktheheshin nga një varrim, u ndodhën nën zjarrin e shqiptarëve etnikë, për pasojë një grua u vra ndërsa tre burra u plagosën.[33] Më 2 qershor, dy serbë duke udhëtuar me makinë në një rrugë që lidh dy fshatra të banuara nga serbë, mbetën të vrarë kur makina e tyre hasi në një minë. Një grua dhe dy fëmijë që gjendeshin në të njëjtën makinë u plagosën. Para pak kohësh, rruga kish qenë pastruar nga minat.[34] Më 6 qershor, një sulm me granata në një enklavë serbe në Graçanicë do të shkaktonte pesë të plagosur.[35] Më 15 qershor, dy serbë mbetën të vrarë dhe një tjetër u plagos pasi automjeti i tyre hasi në një minë pranë fshatit Lepinë (komuna e Lipjanit). Zëdhënësi i KFOR-it e përshkroi këtë ngjarje si "një sulm të qëllimtë e të planifikuar me kujdes."[36]

Edhe të qenurit në shërbim të ndonjë organizate ndërkombëtare do të rezultonte i pamjaftueshëm për pjesëtarët e pakicave etnikë për të qenë i imunizuar nga dhuna. Në tetor 1999, një zyrtar i O.K.B.-së nga Bullgaria u qëllua për vdekje në një nga rrugët kryesore të Prishtinës; siç do të raportohej më vonë, ishte marrë gabimisht për serb. Po atë muaj, në apartamentin e një përkthyeseje serbe në Prishtinë që punonte për O.K.B.-në, do të hidhej një granatë, që do ta plagoste lehtazi. Edhe më parë, për shkak të kërcënimeve, ajo kishte qenë shpesh e shtërnguar të ndërronte banesë. Më 15 maj, trupi i njëzet e pesë vjeçarit Petar Topoljski, përkthyes serb i UNMIK-ut, u gjend në fshatin Rimanishtë, jo larg Prishtinës.[37] Topoljski kishte rreth një javë që nuk ishte dukur në punë, pasi emri, fotografia dhe adresa e tij ishin publikuar në të përditshmen kosovare "Dita", bashkë me akuzën se ai ishte paraushtarak serb dhe se kish marrë pjesë në dëbimet në masë të shqiptarëve nga provinca. (Kjo gazetë u mbyll përkohësisht nga UNMIK-u për tetë ditë, pasi botuesi i gazetës s'pranoi të kërkojë falje publike për botimin e atij artikulli, të botonte një shënim ku të tërhiqte akuzën, ose të pranonte që në të ardhmen të mos bënte më akuza të ngjashme. Pas heqjes së dënimit, gazeta e ribotoi artikullin.)

DHUNA E USHTRUAR KUNDËR SHQIPTARËVE ETNIKË

Ashtu siç ngjarjet e Mitrovicës dhe statistikat e vrasjeve e dëshmojnë qartë, dhuna nuk ka prekur vetëm pjesëtarët e pakicave etnike jo

shqiptare. Më 12 qershor 2000, dy shqiptarë etnikë u vranë dhe një i tretë u plagos në një sulm nga mësymës serbë në fshatin Qubrel. Siç është përmendur edhe më sipër, dhuna në pjesën veriore të Mitrovicës, që pasoi sulmin me raketa mbi autobuzin e UNHCR-së, në muajin shkurt, shkaktoi tetë vrarë, si dhe detyroi pothuaj dymijë të tjerë të braktisin vatrat e tyre. Sikur të mos mjaftonin sulmet e serbëve kundër shqiptarëve në Mitrovicë, në Kosovë ka pasur edhe një dhunë të konsiderueshme të ushtruar prej shqiptarëve-kundër-shqiptarëve. Shqiptarët e akuzuar si "kolaboracionistë" të autoriteteve serbe, janë rrahur dhe shpesh shtrënguar të largohen nga banesat e tyre, sidomos në komunat e Prizrenit, Gjakovës dhe Klinës. Shqiptarët e besimit katolik dhe familjet e të gjithë atyre që kanë pasë punuar për shtetin serb, kanë ndeshur një sërë vështirësish.[38]

Gjithashtu edhe personat e moderuar të politikës shqiptare janë kërcënuar. Në tetor 1999, Veton Surroi dhe Baton Haxhiu, botuesi dhe kryeredaktori i të përditshmes kryesore në gjuhën shqipe, "Koha Ditore" u akuzuan nga KosovaPress, agjencia zyrtare e lajmeve e UÇK-së, si "vampirë pro-serbë", që "nuk kanë vend në Kosovën e lirë." Më tej, në artikull thuhej se, "nuk ka asgjë për t'u habitur në qoftë se ata bëhen viktima të ndonjë akti të mundshëm e të kuptueshëm hakmarrjeje" – një nxitje e qartë për të ushtruar dhunë kundër dy gazetarëve. Sulmi verbal erdhi si pasojë e artikujve editorialë të botuar në *Koha Ditore*, si dhe një komenti të fuqishëm të Surroit, ku dënoheshin sulmet kundër pakicave kombëtare dhe përfundohej me fjalët se, klima e krijuar nga sulme të kësaj natyre, ka të ngjarë të ketë pasoja të rënda negative për demokracinë në Kosovë, gjë që do të prekë të gjithë banorët e saj, minoritetet dhe shqiptarët.

Shqiptarët e akuzuar si "kolaboracionistë" të autoriteteve serbe, janë rrahur dhe shpesh shtrënguar të largohen nga banesat e tyre.

Edhe lufta për të zënë kryet e vendit midis fraksioneve të ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), shpuri gjithashtu në akte dhune. Vrasja e një politikani të LDK-së, si dhe rrëmbimi e marrja në pyetje e një tjetri në rajonin e Drenicës, në nëntor të vitit 1999, do të pasoheshin nga një mori vrasjesh, stil ekzekutimi të disa prej luftëtarëve më në zë të UÇK-së.[39] Sipas *New York Times*-it, nga qershori 1999 deri në maj të 2000, ishin vrarë njëzet e tre pjesëtarë të UÇK-së.[40] Edhe pse shpesh vrasjet i atribuohen rivaliteteve në radhët e krimit të organizuar, disa prej vrasjeve, si ajo në maj e politikanit të moderuar dhe ish-udhëheqësit të shquar

të UÇK-së, Ekrem Rexha (i njohur si komandant "Drini"), kanë një dimension të qartë politik.[41] Më 15 qershor 2000, njerëz të armatosur që mbanin shenjat e UÇK-së, vranë Ali Dresaj, një politikan të lartë të LDK-së.[42]

Dhuna kundër anëtarëve të partive politike do të vijonte edhe pas zgjedhjeve vendore më 28 tetor 2000, ndonëse jo gjithmonë ka qenë e qartë nëse këto vrasje ishin të motivuara politikisht. Një anëtar i LDK-së në Klinë, Hazir Raci, u vra tri ditë pas zgjedhjeve.[43] Më 16 nëntor, një anëtar i Këshillit të ri Bashkiak të Pejës, që i përkiste LDK-së, Shkëlzen Hysi, u sulmua dhe u plagos në banesën e vet.[44] Më 23 nëntor, Xhemail Mustafa, njëri nga themeluesit e LDK-së dhe këshilltar i Ibrahim Rugovës, u vra nga dy persona të panjohur, më orën 3 të pasdites, jashtë apartamentit të tij në lagjen Dardania, në Prishtinë.

PËRGJIGJA E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

Deklaratat e udhëheqësve të vendeve anëtare të NATO-s, si dhe zyrtarëve të lartë të O.K.B.-së, në muajt e parë kritikë pas hyrjes së

Ky shqiptar kosovar u mbajt mbyllur për dy ditë në Prizren nga trupat e UÇK-së dhe u rrah keqazi. Më 18 qershor 1999 ai dhe një numër të burgosurish të tjerë u liruan nga trupat gjermane të KFOR-it.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

trupave të NATO-s në Kosovë, pohonin se ajo çka po ndodhte në atë vend ndryshonte krejtësisht nga dhuna në pranverë; se ajo çka shihte e dëgjonte bota ishin akte hakmarrjeje individuale; se nuk mund të vihej kurrfarë shenje barazie midis persekutimeve të kryera nga Serbia kundrejt pakicës shqiptare dhe persekutimeve të minoriteteve në Kosovën e pas luftës. Në hyrje të raportit prej 400 faqesh të OSBE-së, ku përshkruheshin në mënyrë të detajuar abuzimet kundrejt pakicave kombëtare në Kosovën e pas luftës, Bernard Kouchner, kreu i UNMIK-ut, shkruante: "Nuk do të ishte e ndershme të bëheshin krahasime me situatën para ose gjatë luftës … as që mund të bëhet fjalë për hesape politike … krimet që kemi parë janë thjesht akte individësh."[46] Gjatë vizitës në Kosovë, më 29 korrik 1999, Sekretarja e Shtetit e SH.B.A.-së Madeline Albright u pyet rreth vrasjes së katërmbëdhjetë fermerëve serbë në fshatin Graçko. Përgjigja e saj ishte se, "s'ka pikë dyshimi që ky ishte një incident rrënqethës. Ne s'mund të harrojmë se ç'gjëra të tmerrshme kanë ndodhur në këtë vend më parë, por tashmë është ngritur një sistem për t'i mbrojtur ata. Prandaj dhe ata duhet të qëndrojnë."[47] Ambiguiteti në përgjigjen e saj, tipizonte reagimin ambivalent të ushëheqësve Perëndimorë kundrejt dhunës së ushtruar kundër pakicave etnike në Kosovë.

Në muajt e parë pas hyrjes në Kosovë, NATO nuk ia doli të ndërmarrë aksione të vendosura për të ndaluar shpërnguljen e detyruar dhe vrasjet e në radhët e pakicave etnike.

Në muajt e parë pas hyrjes në Kosovë, NATO nuk ia doli të ndërmarrë aksione të vendosura për të ndaluar shpërnguljen e detyruar dhe vrasjet e në radhët e pakicave etnike. Fillimisht, KFOR-i ishte përgjegjës vetëm për rendin e sigurinë, por ai do t'i shmangej kryerjes së detyrave të policisë qytetare, ndaj dhe të ndaluarit do të ishin fare të pakët. Gjithsesi, pjesa më e madhe e të ndaluarve do të liroheshin shumë shpejt. Lirimi i tyre do të përligjej me mungesën e një kuadri ligjor, i cili do të garantonte mbajtjen e mëtejshme në burg. Kësisoj, qysh ditët e para të pranisë së strukturave të O.K.B.-së dhe NATO-s në Kosovë, dhuna e kriminaliteti (duke përfshirë këtu edhe sulmet kundër minoriteteve), praktikisht nuk njohën kurrfarë pengese. Përpjekjet më të fundit të kryera nga policia e O.K.B.-së janë vështirësuar nga një gjyqësor vendas plot të meta, vullnetmangët për të arrestuar apo dënuar shqiptarët e pandehur, veçanërisht në gjithë ato raste që kanë të bëjnë me dhunë kundër minoriteteve. Rrjedhojë e pashmangshme ka qenë krijimi i një mjedisi mosndëshkues në mbarë provincën.

Çështja e dhunës kundër minoriteteve ka tërhequr në mënyrë të konsiderueshme vëmendjen e aktorëve ndërkombëtarë në Kosovë. Krijimi dhe drejtimi nga ana e UNHCR-së dhe OSBE-së, më 14 korrik 1999, së Task Force ad hoc, s'ka dyshim që ka luajtur një rol të dorës së parë në zhvillimin e nismave humanitare, si dhe për mbrojtjen më mirë të pakicave kombëtare. Një raport i Task Force, i nëntorit 1999, rreshtonte një sërë masash të përvijuara për të përmirësuar elementët e sigurisë për popullsinë e rrezikuar në Kosovë, ku përfshiheshin: "përforcimi i dyerve, instalimi në shtëpi i aparaturave për thirrje urgjence, si dhe vendosja e një *hotline* për të lidhur agjencitë e sipërpërmendura me KFOR-in."[48] Gjithashtu, raporti bën të ditur se, "UNHCR-ja ka ngritur një rrjet shpërndarës special humanitar për grupet minoritare në nevojë, si dhe sisteme të brendshme për të ofruar ndihmë mjekësorë grupeve minoritare që iu mohohet kjo lloj ndihme."[49] Tashmë nuk ka pikë dyshimi se, pa mbrojtjen e KFOR-it, enklavat e pakicave etnike në Rahovec, Graçanicë dhe Prizren as që kishin për të mbijetuar.

Tek e fundit, përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare kundrejt abuzimeve të kryera kundër pakicave kombëtare ka qenë e vonuar dhe e pabarabartë, në mënyrë të veçantë në fushën e sigurisë. Tërheqja e njësive policore serbe dhe atyre ushtarake jugosllave, ndërkohë që i dha një fund të shumë-e-mirëpritur abuzimeve kundër shqiptarëve kosovarë, shkoi e la një vakuum sigurie për civilët serbë dhe pakicat e tjera etnike, që do të mbushej vetëm pjesërisht nga paqeruajtësit e KFOR-it dhe policia e O.K.B.-së. Sidomos në dy muajt e parë kritikë të ndërhyrjes ndërkombëtare, në vend nuk kishte më shumë se një grusht policësh të O.K.B.-së, duke ia lënë barrën e kryerjes së detyrave të policisë qytetëse trupave të KFOR-it. Me synimin për ta ngushtuar sa më shumë këtë boshllëk, Franca dhe Italia sollën njësi paraushtarake të policisë, ndërsa kontigjentet e tjera vunë në përdorim policinë ushtarake për të kryer funksionet e policisë qytetëse, duke përfshirë këtu edhe hetimin për ankesat e ndryshme të qytetarëve.

Përgjigja e KFOR-it ndaj sulmeve dhe kanosjeve kundër minoriteteve gjatë mujave të parë të operacioneve do të ishte jo e njëtrajtshme. Ndërkohë që në disa zona minoritetet do të kishin mbrojtje njëzet e katër orëshe, në disa të tjera ato do të shtrëngoheshin të braktisnin shtëpitë e tyre. Në një llogari të fundit, rezultatet e KFOR-it në parandalimin e rrëmbimeve, burgosjeve dhe vrasjeve të serbëve e rromëve do të ishin të dobëta, gjatë kësaj periudhe përnjëmend kritike. Madje një oficer i KFOR-it në Kosovën lindore i tha Human Rights Watch se, në fund të qershorit 1999, njësia e tij

hoqi dorë nga regjistrimi i rasteve të rrëmbimeve për shkak të shpeshtësisë së tyre. Në një pjesë të madhe rastesh, oficerët e KFOR-it të të gjithë kontigjenteve do të shprehnin pikëpamjen se, kryerja e këtyre krimeve ishte diçka e pashmangshme. Përpjekjet e kryera nga njëri prej hulumtuesve të Human Rights Watch për të raportuar një rast abuzimi në fshatin Ljubizhdë, më 30 qershor 1999, te kontigjenti gjerman i KFOR-it, lypën vizita të shumta në postën e policisë vendore e më pas në shtabin qendror të kontigjentit në Prizren, ku oficeri i një celule civilo-ushtarake të implementimit (CMIC) u duk krejtësisht i çinteresuar për rastin në fjalë.

Mangësia e një politike të qëndrueshme nga ana e KFOR-it, si dhe përgjigjet shpesh jo adekuate, mund të shpjegohen, pjesërisht, me shqetësimin për të mbrojtur trupat e veta, interpretimet e ndryshme rreth mandatit prej çdo kontigjenti, por edhe me mungesën e përvojës në kryerjen e detyrave të policisë qytetëse. Është gjithashtu e rëndësishme të rikujtojmë këtu se, para se të hynte në Kosovë, më 12 qershor 1999, KFOR-i ishte përgatitur të haste në qëndresë të armatosur të ushtrisë dhe civilëve serbë. Kjo gjë dëshmohet nga mbingarkesa e armëve të rënda, ku përfshiheshin tankset dhe artileria, që NATO-ja kishte rreshtuar në kufijtë e Maqedonisë e Shqipërisë dhe që më pas do të vendoseshin në të gjithë truallin e Kosovës. Atëherë është mëse e arsyeshme të hamendësojmë që, kjo forcë e armatosur, hë për hë, nuk ishte psikologjikisht e përgatitur që të mbronte popullsinë, së cilës, për mendimin e tyre nuk i mbetej rrugë tjetër veçse të nënshtrohej dhe, të cilën, ata e kundronin si përgjegjëse për krijimin e krizës së refugjatëve. Veç kësaj, duke qenë se pjesa më e madhe trupave të para ishin kryesisht të armatosura rëndë, fillimisht KFOR-i nuk ishte pajisur të organizonte patrulla të vogla nëpër fshatrat me popullsi të përzierë dhe, as t'u përgjigjej protestave të dhunshme apo çfarëdo trazire qytetare.

Nga ana tjetër, gjatë muajve të parë dhe

Fëmijë shqiptar etnik enden mbi rrënojat e kishës ortodokse serbe në Gjakovë, e hedhur në erë në korrik 1999.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

më kritikë të operacionit, nuk qenë siguruar mjete të mjaftueshme për trupat e policisë qytetëse, nga strukturat qeverisëse të O.K.B.-së. Në fund të korrikut të vitit 1999, në Kosovë ndodheshin rreth 200 policë si pjesë e trupës ndërkombëtare, pjesa më e madhe e të cilëve qenë angazhuar në ngritjen e zyrave të shtabeve dhe hartimin e procedurave të ushtrimit. Teksa që dështimi për mëkëmbjen e shpejtë të policisë, pjesërisht mund të ketë qenë rrjedhojë e mangësive logjistike nga ana e qeverive kontribuese, paaftësia për të arrestuar e gjykuar përgjegjësit e akteve kriminale kundër pakicave etnike e krimeve të tjera, sidomos gjatë muajve të parë të misionit të administratës civile ndërkombëtare, nuk bëri gjë tjetër, veçse rrënjosi një kulturë të mosndëshkimit për këto akte të dhunës. Ndërkohë më 19 tetor 2000, UNMIK-u hodhi në terren 4162 oficerë policie, duke përfshirë ndër ta edhe policinë e kufirit, shifër që gjithsesi mbetej në kuotën e forcës së autorizuar prej 4718 vetësh.[50] Më 16 dhjetor 2000, akademia e policisë e administruar nga OSBE-ja (një kurs ushtrimi tetë javor me elementët bazë) diplomoi njëmbëdhjetë të shkolluarit e parë për Shërbimin e Policisë së Kosovës (SHPK), duke e çuar në 2851 numrin e të diplomuarve. Dyzet e pesë përqind e 312 kadetëve të porsadiplomuar nuk janë shqiptarë etnikë. Ndërsa pesëdhjetë e nëntë prej tyre janë femra.[51]

Ofiqarë të lartë të NATO-s dhe të OKB-së janë të vetëdijshëm se persona të lidhur me ish-UÇK-në apo pasardhësen e UÇK-së, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, janë të implikuar në akte dhune kundër minoriteteve.

Ndërkohë që edhe pse me vonesë, policia e OKB-së dhe Shërbimi i Policisë së Kosovës, kanë nisur të kryejnë detyrat e veta, përpjekjet e tyre janë ndrydhur nga vonesat në mëkëmbjen e një sistemi gjyqësor efektiv. Pjesërisht vonesa ka të bëjë me sherret ndërmjet UNMIK-ut dhe gjykatësve shqiptarë rreth sistemit ligjor që lypset aplikuar në Kosovë. Edhe pse disa qindra gjykatës lokalë tashmë janë caktuar, paaftësia e Kombeve të Bashkuara për të bindur gjykatësit prej pakicave etnike të zënë vendet që u takojnë, si dhe trysnia mbi gjykatësit shqiptarë, kanë rezultuar në një sistem gjyqësor në lindje e sipër, të cilit i mungon vullneti për të ndaluar apo për të shpallur fajtorë të akuzuarit shqiptarë, sado serioze janë akuzat apo të palëkundshme janë dështmitë. Nga ana tjetër, serbët dhe pjesëtarët e minoriteteve të tjera që merren si të pandehur, shpesh e shohin veten në gjendjen e paraburgimit dhe gjithnjë e më shpesh dënohen edhe në ato raste kur provat janë të dobëta.[52] Disa prej zyrtarëve të OKB-së, sot e

pranojnë se, ashtu si Shërbimi i Policisë së Kosovës kërkon një shkallë të kontrolli e mbikqyrjeje nga ana e ndrëkombëtarëve, edhe sistemi gjyqësor ka nevojë për gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë për t'iu siguruar një proces gjyqësor të drejtë e të paanshëm të gjithë të akuzuarve, por edhe paditësve. Sot për sot, funksionimi i çalë i sistemit gjyqësor është duke bërë pak për të mbajtur nën fre ciklin e një klime mosndëshkimi e pasigurie në Kosovë.[53]

Refreni familjar që vjen nga OKB-ja është se, situata e pasigurisë në Kosovë është rrjedhojë e mungesës së burimeve. Sigurisht është e vërtetë që në vend ende ka një mungesë të ndjeshme në radhët e policisë qytetëse, si dhe fonde të pamjaftueshme për të paguar siç duhet gjykatësit dhe prokurorët. Por Kombet e Bashkuara dhe OSBE-ja kanë një personel të përbërë prej qindra vetësh në zyrat e tyre qendrore në Prishtinë, ndërkohë që KFOR-i ka një prani ushtarake prej 42.000 trupash, prej të cilëve 32.000 u përkasin vendeve anëtare të NATO-s. Zbrazëtinë më të ndjeshme e përbën mungesa e vullnetit politik. Ofiqarë të lartë të NATO-s dhe të OKB-së janë të vetëdijshëm se persona të lidhur me ish-UÇK-në apo pasardhësen e UÇK-së, Trupat Mbrojtëse të Kosovës[54], janë të implikuar në akte dhune kundër minoriteteve dhe veprimtari të tjera kriminale, por ata vetë kanë zgjedhur të rrinë e bëjnë sehir.[55] Për zyrtarët e NATO-s ka qenë një brengë e madhe shmangia nga ngritja e akuzave ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së për dhunën e ushtruar kundrejt pakicave. Ç'është e vërteta, gjenerali Wesley Clark, Komandanti Suprem i NATO-s në Europë, në gusht të vitit 1999, shkoi tepër larg kur tha se nuk ka asnjë dëshmi të angazhimit të UÇK-së në këso sulmesh, duke u shprehur, "Unë s'kam ndërmend të drejtoj gishtin kundër UÇK-së."[56]

Pavarësisht nga deklaratat e gjeneralit Clark për UÇK-në, oficerët e NATO-s në terren i thanë Human Rights Watch se, shërbimet e tyre inteligjente kanë nxjerrë në shesh bash të kundërtën. Policia e Kombeve të Bashkuara ka mbledhur një sërë të dhënash rreth abuzimeve të kryera nga persona të lidhur me UÇK-në dhe TMK-në, të cilat janë përmbledhur e pasqyruar në një raport të brendshëm të UNMIK-ut, të shkurtit të vitit 2000.[57] Pavarësisht nga këto dëshmi, një numër i vogël njerëzish janë arrestuar ose janë akuzuar për rolin që kanë luajtur në këto veprimtari, madje nuk është ushtruar as ndonjë trysni e fortë mbi udhëheqësit e ish-UÇK-së apo të TMK-së për të frenuar abuzimet e kësaj natyre në radhët e tyre.

Me përjashtim të shqetësimeve të lidhura me sulmet e vazhduara nga

grupe të armatosura shqiptarësh në Serbinë jugut dhe në Maqedoni,[58] qeveritë e vendeve anëtare të NATO-s, në përgjithësi nuk kanë shprehur ndonjë vullnet për t'u përballur me rolin ambig të luajtur nga elementë të ish-UÇK-së në Kosovë, qysh nga qershori i vitit 1999. U desh pothuajse një vit, para se zyrtarë të lartë ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Kofi Annan, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, lordin Robertson dhe të dërguarin e posaçëm të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara James O'Brien, të pranonin se sulmet kundër pakicave etnike në Kosovë ishin të një natyre sistematike.[59] Mungesa e vullnetit nga ana e aleancës ushtarake më të fuqishme në botë qoftë edhe për të sugjeruar se njësitë e UÇK-së lokale mund të jenë angazhuara në këtë veprimtari, si dështimi i derisotëm për të ndërmarrë aksione kundër këtyre njësive, na sugjeron fuqimisht se, udhëheqësit politikë në Uashington, Londër, Paris, Berlin e kudogjetkë, si dhe ata të Kombeve të Bashkuara, dëshirojnë t'i shmangen çfarëdo konfrontimi me udhëheqjen politike e ushtarake të ish-UÇK-së. Ky dështim i tyre bëhet edhe më i rëndë, duke pasur parasysh faktin se, Këshilli i Sigurimit autorizoi Kombet e Bashkuara dhe NATO-n të administrojnë dhe sigurojnë Kosovën. Deri ditën kur qeveritë e vendeve anëtare të NATO-s nuk do të vendosin t'i ndalojnë personat përgjegjës për aktet e dhunës dhe krimeve në Kosovë, pavarësisht nga lidhjet e tyre politike, cikli i mosndëshkimeve dhe pasiguria kanë gjasa të vijojnë.

TË BURGOSURIT SHQIPTARË KOSOVARË NË SERBI QYSH NGA FUNDI I LUFTËS

Më 10 qershor 1999, fill pas nënshkrimit të Marrëveshjes Tekniko Ushtarake midis NATO-s dhe Ushtrisë Jugosllave që i jepte fund luftës, rreth 2000 shqiptarë kosovarë u mbartën nga burgjet e Kosovës në burgjet e Serbisë dhe më konkretisht në Sremska Mitrovica, Nish, Prokuplje dhe Pozharevac.[60] Pjesa më e madhe e të burgosurve ishin civilë të arrestuar në mënyrë të paligjshme nga forcat serbe të sigurimit përgjatë luftës. Sipas shtypit serb, Ministria e Drejtësisë së Serbisë urdhëroi transferimin e të burgosurve "për të siguruar jetët e tyre."[61]

Në mars të vitit 2001, përfaërsisht 1400 të burgosur shqiptarë kosovarë u liruan, ndërkohë që 150 prej tyre falë një Ligji Amnistie të miratuar në

shkurt të 2001.[62] Pjesa tjetër e të burgosurve, të regjistruar e të vizituar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq – rreth 480 vetë – ndodheshin në faza të ndryshme të procedurave ligjore të ndërmarra kundër tyre.

Një pjesë e shqiptarëve kosovarë që ndodhen në burgjet serbe me akuza politike mund të kenë qenë të angazhuar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Por shumica dërrmuese e tyre janë rrëmbyer prej policisë serbe gjatë aksioneve të spastrimit, të cilët kanë pasur urdhëra të qarta për të arrestuar një numër sa më të madh shqiptarësh. Siç doli edhe në gjyqin e organizuar në pranverë të vitit 2000, kundër 143 burrave nga Gjakova, policia kishte arrestuar njerëz që kishin pasë qenë të fshehur nëpër shtëpitë e tyre.[63] Rrahjet gjatë kohës së arrestimit ishin një gjë mëse e zakontë, duke përfshirë këtu edhe arrestimin e studentit veprimtar dhe zëdhënës të UÇK-së, Albin Kurti, më 27 prill 1999, ndonëse trajtimi që do t'i bëhej më pas në burgjet e Serbisë do të ishte disi më i mirë.[64]

Të burgosurit e transferuar nga burgu i Lipjanit në Serbi, më 10 qershor, i kallzuan Human Rights Watch se si rojet e burgut iu kishin lidhur duart dhe më pas i kishin hipir nëpër autobuzë, duke rrahur këdo që lëvizte sadopak. Njëri prej të burgosurve tha:

> Na lidhën me litarë dhe na ndanë në grupe me nga pesëdhjetë vetë. E kishim të pamundur të uleshim. Sakaq ata zunë të tërhiqen dhe të shtien në ajër. U trembëm se menduam që do të na vrisnin në vend. Që nga ora 6 e mëngjesit deri në orën 12.00, të datës 10 qershor nuk na dhanë as për të ngrënë as për të pirë. Paskëtaj na futën nëpr autobuzë me kryet ulur. Gjysma prej nesh ndodhej përtokë. Bënte ftohtë. Ata godisnin këdo që lëvizte.[65]

Përgjatë vitit 1999 dhe 2000, qeveria serbe do të lironte në mënyrë sporadike një pjesë të burgosurve, zakonisht pasi ata ishin nxjerrë të pafajshëm nga gjykata. Më 25 qershor 1999, 166 burra u liruan dhe u kthyen në Kosovë nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar.[66] Më 4 tetor, u liruan nga burgu i Sremska Mitrovicës edhe pesëdhjetë e katër persona të tjerë.[67] Nga data 27 deri më 29 janar, u liruan edhe dyzet e nëntë persona të tjerë, pasi ishin mbajtur për më shumë se shtatëmbëdhjetë muaj në burg. Midis tyre ishte edhe shkrimtari dhe gazetari Halil Matoshi.[68]

Por, nga ana tjetër, përgjatë viteve 1999 dhe 2000 do të vazhdonin dënimet e shqiptarëve nga gjykatat serbe. Më 22 maj 2000, 143 burra

nga Gjakova u gjykuan dhe u dënuan me 1632 vjet burg, të marrë sëbashku, për komplot kundër shtetit dhe terrorizëm, nga një proces gjyqësor, i cili sipas grupeve për të drejtat e njeriut në Serbi, binte ndesh standarteve ndërkombëtare.[69] (Më 23 prill 2001, Gjykata e Lartë e Serbisë i liroi të pandehurit, duke ia kaluar rishikimin e çështjes gjykatës së rrethit.) Më 10 korrik 2000, pesë studentë shqiptarë kosovarë të universitetit të Beogradit u gjykuan për akte terrorizmi dhe u dënuan me afate burgimi që shkonin nga gjashtë deri më dymbëdhjetë vjet, pavarësisht se nga dëshmitë e gjyqit ata iu ishin nënshtruar tortura për t'i shtrënguar të pohonin.[70] Human Rights Watch mbikqyri procesin gjyqësor tri ditor dhe vuri re një sërë shkeljesh proceduriale, bie fjala si, përplasje midis prokurorit dhe kryetarit të gjykatës, pranimin e dëshmive të dyshimta dhe transmetimin në televizionin shtetëror të pohimeve të rregjistruara paraprakisht.[71] Ditën e tretë të gjyqit, më 25 nëntor 1999, pasi njëri nga të pandehurit bëri një përshkrim të hollësishëm të torturave që ishin ushtruar mbi të gjatë kohës së paraburgimit, kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Dragisha Sljipçeviç iu përgjigj: "Meqenëse në këtë proces është i pranishëm edhe publiku do të doja të të thoja: Si ta merr mendja ty, mos vallë policia në vendet europiane vepron ndryshe me të burgosurit?"

"Meqenëse në këtë proces është i pranishëm edhe publiku do të doja të të thoja: Si ta merr mendja ty, mos vallë policia në vendet europiane vepron ndryshe me të burgosurit?"

-GjykatÎsi Dragisha SljipÁeviÁ

Në mënyrë të vazhdueshme të gjithë të burgosurve politikë iu është mohuar e drejta për të pasur një proces gjyqësor të drejtë e të paanshëm. Gjykatat i kanë dënuar shqiptarët kosovarë mbi bazën e kallzimeve të nxjerra me pahir dhe në mënyrë të përsëritur, gjykatësit s'kanë pranuar paraqitjen e provave që mund t'i çlironin të pandehurit nga akuza. Prova kryesore e prokurorëve kundër të pandehurve shpesh ka qenë tejet i diskredituari dhe aspak i besueshmi "testi i parafinës", i cili rreh të pikasë gjurmët e barutit në duart e të pandehurit.

Dy organizata me qendër në Beograd, Qendra Ligjore Humanitare dhe Grupi 484, kanë monitorurar gjerësisht proceset gjyqësore që kanë vazhduar përgjatë pranverës dhe verës së vitit 2000. Në një deklaratë për shtyp, ku kërkonin lirimin e shqiptarëve kosovarë të mbajtur në mënyrë të paligjshme gjatë kohës së konfliktit në Kosovë, QLH, pahtësonte:

> Shkelje të rënda të një procesi të ndershëm gjyqësor nga organizmat e drejtësisë serbe dhe institutet e korrektimit kundër shqiptarëve etnikë të arrestuar gjatë periudhës nga 24 marsi më 10 qershor të këtij viti, me akuzën për terrorizëm dhe akte të tjera kriminale kundër rendit kushtetues të RF të Jugosllavisë ...[72]

QLH raportonte se në shumë raste të monitoruara prej saj, periudha e paraburgimit ishte e tejzgjatur, avokatëve iu mohohej e drejta të takonin klientët e tyre, ndërsa data e gjykimit caktohej para se mbrojtja të kishte parë akuzën. Gjithashtu QLH do të bënte thirrje për lirimin e njëzet e pesë të miturve, njëmbëdhjetë grave, rreth 200 personave të plagosur si dhe pesëdhjetë të tjerëve në gjendje të rëndë shëndetësore, midis shqiptarëve kosovarë, që mbaheshin në burgjet serbe në fund të vitit 1999.[73]

Në gjykatat serbe do të trajtoheshin edhe disa raste të spikatura. Më 9 dhjetor 1999, një gjykatë e Nishit do të dënonte me dymbëdhjetë vjet burg për veprimtari antishtetërore,[74] mjeken dhe poeteshën e mirënjohur shqiptare Dr, Flora Brovina. Ajo akuzohej se kishte furnizuar me ushqime, veshmbathje dhe pajisje mjekësore UÇK-në, si dhe për planifikimin e akteve terroriste. Në qershor, Gjykata e Lartë e Serbisë vendosi që rasti i saj të rigjykohej nga gjykata e Nishit, kësisoj procesi gjyqësor rifilloi më 14 shtator 2000. Më 2 nëntor 2000, Vojisllav Koshtunica, i porsa zgjedhur President i Jugosllavisë nxori një amnisti për të dhe Flora Brovina u kthye në Kosovë.

Dr. Brovina, themeluese dhe kryetare e Lidhjes së Grave Shqiptare, u arrestua nga policë serbë me petka civile, para apartamentit të saj, në Prishtinë, më 20 prill 1999. Fillimisht ajo u mbajt në burgun e Lipjanit, në Kosovë, ndërsa më 10 qershor u transferua në burgun e Pozharevacit. Gjatë kohës së burgimit ajo ishte kejuar të vizitohej nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, avokatët e saj dhe bashkëshorti, por në takime duhej të flitej vetëm serbisht.[75] Sipas raportimeve, gjyqi i saj ka pasur një sërë parregullsish të karakterit procedurial.[76]

Gjithashtu, sipas raporteve familjet e shqiptarëve kosovarë në një sërë rastesh kanë paguar mitë për lirimin e familjarëve të tyre nga burgjet e Serbisë. Në një artikull të *Washington Post* thuhej se, familjet kanë paguar deri në 10. 000 dollarë për një të burgosur.[77] Në një raport mbi të burgosurit nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) thuhet se, avokatët serbë iu kanë premtuar familjarëve të shqiptarëve të burgosur t'i lirojnë ata kundrejt një pagese që shkonte nga 10.000 deri në 50.000 marka gjermane.[78]

Nga ana tjetër, disa prej avokatëve në Serbi që kanë përsipër të mbrojnë shqiptarët e burgosur janë kërcënuar për të mos thënë që mbi ta është ushtruar edhe dhunë fizike. Më 3 dhjetor 1999, një jurist shqiptar që punonte më Qendrën Ligjore Humanitare, Teki Bokshi, u rrëmbye në autostradën pranë Beogradit, teksa kthehej nga burgu u Sremska Mitrovicës, ku kishte të vizitonte një klientët shqiptarë. Sipas Qendrës Ligjore Humanitare, Bokshi u ndalua tok me dy kolegë të tij nga policë me petka civile që kishin një veturë Mercedes ngjyrë hiri, me targa zyrtare.[79] Bokshi u lëshua pas një jave.

Më 16 mars, një tjetër jurist i Qendrës Ligjore Humanitare, Hysni Bytyqi bashkë me të shoqen u rrahën keqazi nga mësymës të panjohur në apartamentin e tyre në Beograd. Bytyqit, i cili ishte parashikuar të mbronte, një ditë më pas, gjashtë shqiptarë kosovarë të akuzuar për terrorizëm, iu desh t'i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjikale për shkak të plagëve të marra në kokë. Bytyqi ishte kërcënuar në mënyrë të përsëritur nga avokatë serbë në Kosovë, të cilët ai i kishte akuzuar se merrnin mitë për lirimin e të burgosurve shqiptarë.[80]

Në shkurt 2001, parlamenti i porsa zgjedhur jugosllav kaloi një Ligj për Amnistimin e të burgosurve politikë, ndonëse ligji nuk aplikohej për të gjithë ata që ishin akuzuar se kishin kryer akte terroriste. Në mes të marsit të vitit 2001, 157 shqiptarë kosovarë u liruan prej këtij ligji. [81]

Megjithë lirimet e kryera, çështja e të burgosurve shqiptarë kosovarë në burgjet e Serbisë vazhdontë mbetet një problem tejet delikat në Kosovë, sidomos midis familjeve të të burgosurve. Sipas raportit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, mbajtja e tyre në burg ka "një efekt gërryes kundrejt përpjekjeve, si të faktorit ndërkombëtar ashtu edhe atij vendor, për vendosjen e paqes në Kosovë."

Është e qartë që Millosheviçi u përpoq t'i përdorte të burgosurit në daç si një karrem për pazar, në daç si një mjet për t'i vënë shkopinjtë në rrota administratës ndërkombëatre në Kosovë. E vërteta është se, përgjatë viteve 1999 dhe 2000, shqiptarët do të ishin tejet të acaruar me paaftësinë e bashkësisë ndërkombëtare për të liruar të burgosurit.

Pas zgjedhjes në tetor të vitit 2000, presidenti jugosllav Vojisllav Koshtunica garantoi se do të respektonte të drejtat e njeriut dhe rivendoste shtetin ligjor në Jugosllavi. Ndreqja e padrejtësive gjyqësore, si ato kundër të burgosurve politikë shqiptarë të Kosovës, përbën një pjesë të qenësishme të angazhimit të tij për të mbajtur premtimet. Duke iu referuar Kushtetutës dhe ligjit federal të Jugosllavisë, presidenti jugosllav ka të gjitha fuqitë ligjore të falë të gjithë ata të akuzuar apo dënuar qofshin për krime federale, madje edhe ato që kanë të bëjnë me veprimtari armiqësore dhe akte terroriste kundër shtetit.

18

PUNA E GJYKATËS KUNDËR KRIMEVE TË LUFTËS

Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi u krijua në maj të vitit 1993 për të ndjekur krimet e luftës të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991.[1] Që nga 15 marsi 2001, janë ngritur akt-padi për gjashtëdhjetë e dy persona, tridhjetë e gjashtë prej të cilëve janë arrestuar, njëzet janë gjykuar dhe dy janë liruar.[2]

Referenca e parë publike e kësaj Gjykate për Kosovën është ajo e datës 10 mars 1998, fill pas sulmit në shkallë të gjerë të ndërmarrë nga qeveria serbe në rajonin e Drenicës, kur prokurori i Gjykatës deklaroi se juridiksioni i saj "shtrihet dhe mbulon edhe dhunën e kryer së fundi në Kosovë."[3] Tri ditë më pas, qeveria e Shteteve të Bashkuara njoftoi se do të ofrojë 1.075.000 $ për të mbështetur hetimet e Gjykatës në Kosovë.

Më 12 qershor 1998, në takimin e Londrës, Grupi i Kontaktit i kërkoi Gjykatës të ndërmerrte "një hetim të shpejtë dhe të plotë" për të gjithë rastet e mundshme të shkeljeve të së drejtës humanitare në Kosovë. [4] Më 7 korrik, kryeprokurorja e asaj kohe e Gjykatës, Louise Arbour, i dërgoi një letër Grupit të Kontaktit, në të cilën ajo riafirmonte vullnetin dhe mandatin e Gjykatës për Kosovën:

> Prokurori mendon se, natyra dhe shkalla e konfliktit tregojnë se "një konflikt i armatosur" ekziston tashmë në Kosovë, brenda suazës së ligjeve ndërkombëtare. Për rrjedhojë, ajo synon të ngrejë akuza për krime kundër njerëzimit apo për krime lufte, në qoftë se dëshmitë për këto krime nuk do të mungojnë.[5]

Përgjatë gjithë vitit 1998, një numër politikanësh të lartë Perëndimorë

Hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës rrethojnë me të bardhë vrimat e plumbave në fshatin Qyshk.

© FRED ABRAHAMS/HUMAN RIGHTS WATCH

dhe përfaqësues organizmash politike e mbështetën publikisht punën e Gjykatës për Kosovën. Më 31 gusht, ambasadori amerikan për çështjen e krimeve të luftës, David Scheffer, deklaroi se ai nuk ishte në gjendje të vizitonte Beogradin dhe Kosovën, ngaqë i ishte mohuar viza hyrëse. Gjatë një konference shtypi në Zagreb, në Kroaci, ai tha:

> Shtetet e Bashkuara janë duke bashkëpunuar plotësisht me Gjykatën në procesin hetimor rreth konfliktit në Kosovë. Ne jemi duke punuar që Gjykatës t'i sigurohet informacion i rëndësishëm në kohën e duhur, në mënyrë që hetimet të mund të vijojnë në mënyrë eficiente. Ne dëshirojmë që edhe qeveritë e tjera të bashkëpunojnë dhe t'i ofrojnë gjithë informacionin e duhur Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës lidhur me konfliktin në Kosovë.[6]

Në fillim të korrikut, Gjykata dërgoi ekipin e parë të hetuesve në Republikën Federale të Jugosllavisë dhe në Kosovë për të hetuar rreth konfliktit, i cili do të ndiqej nga ekipe më të vogla dhe për periudha më të shkurtëra kohe, në shtator.

Autoritetet jugosllave refuzuan të njihnin e të pranonin juridiksionin e Gjykatës dhe penguan në çdo hap punën e hetuesve duke iu mohuar dhënien e vizave ose duke i ndaluar të hynin e kryenin hetime në Kosovë. Vetëm një numër i pakët hetuesish ia dolën të hynin në Kosovë më 1998 dhe fillim të vitit 1999, por edhe atyre iu ndalua zyrtarisht nga autoritetet jugosllave të intervistonin persona apo të mblidhnin dëshmi. Autoritetet jugosllave e bazonin refuzimin e tyre për të bashkëpunuar me Gjykatën, duke e paraqitur konfliktin në Kosovë si një problem të brendshëm me "terroristët", pikëpamje kjo e hedhur poshtë në mënyrë të përsëritur nga Gjykata, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, si dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu edhe Human Rights Watch.[7]

Në tetor të vitit 1998, një ekip ekspertësh finlandezë të sponsorizuar nga Bashkimi Europian u lejua nga autoritetet jugosllave dhe gjykatat vendore të Kosovës të ekzumonin kufomat nga gjashtë vendvarrime në Kosovë: Abria e Epërme, Rahovec, Gollubofc, Gllogjan, Kleçkë dhe Volujak. Tri vendvarrimet e para përmbanin trupat e viktimave që supozohej se ishin kryer nga forcat serbe dhe ato jugosllave; ndërsa tri vendvarrimet e fundit mendohej të kishin viktimat e krimeve të kryera nga UÇK-ja.[8]

Ekipi finlandez u lejua të kryejë hetime në Kleçkë dhe Volujak – të dy

vendvarrime të krimeve të supozuara të UÇK-së. Por, teksa më 10 dhjetor, u orvat të hynte në Abrinë e Epërme, ku Human Rights Watch kishte arritur në përfundimin se trupat serbe kishin vrarë njëzet e një anëtarë të një familjeje etnike shqiptare, në shtator të vitit 1998,[9] ekipi i ekspertëve finlandezë u bllokua në rrugë e sipër nga një kolonë e policisë serbe. Rreth dhjetë automjete të fortifikuar transportuesisht trupash, ku ndodheshin forca policore të armatosura rëndë, kërkuan me forcë të shoqëronin ekipin e ekspertëve në Abrinë e Epërme, që ndodhej në thellësi të një territori të kontrolluar në mënyrë të pjesshme nga UÇK-ja.[10]

Policët serbë ngulmuan që ekipi i huaj të shoqërohej nga një ofiqar i drejtësisë serbe dhe anëtarët e një ekipi ekspertësh kriminalistë të ardhur enkas nga Beogradi dhe s'pranuan ta lejonin ekipin të vijonte udhën i pashoqëruar nga policia, gjë që drejtuesit e ekipit të ekspertëve iu kundërvunë, ngaqë një gjë e tillë mund të provokonte një konfrontim me UÇK-në. Përgjatë negociatave që zhgjatën rreth dy orë midis ekipit të ekspertëve dhe policisë jugosllave, një polic me petka civile dhunoi sheshit imunitetin diplomatik të ambasadorit finlandez Timothy Lahelma, duke hapur derën veturës diplomatike, rrëmbyer aparatin fotografik nga duart dhe nxjerrë prej tij filmin. Sipas anëtarëve të ekipit të ekspertëve, të intervistuar më pas nga Human Rights Watch, policët serbë duke iu druajtur sulmit të UÇK-së, do të orvateshin në mënyrë të vazhdueshme të lëviznin e fshiheshin pas automjeteve me targa diplomatike, që i përkisnin kontigjentit të BE-së të Misionit Diplomatik të Vëzhguesve në Kosovë (KDOM). Për të parandaluar një përballje midis UÇK-së dhe policisë serbe ekipi i ekspertëve vendosi të heqë dorë nga përpjekja për të hyrë në Abrinë e Epërme.

Më 18 janar 1999, tri ditë pas vrasjes së dyzet e pesë shqiptarëve etnikë në Raçak (shih sfondin), kryeprokurorja Arbour u rrek të hynte në Kosovë përmes Maqedonisë, me synimin për të hetuar mizoritë e kryera në Raçak. Duke qenë se ajo nuk kishte vizë jugosllave, ngaqë i ishte mohuar prej autoriteteve, asaj iu ndalua hyrja në vend. Me t'u kthyer në Hagë, Arbour deklaroi troç e shkoqur se, ajo do të hetonte rreth masakrës së Raçakut "me ose pa lejen e autoriteteve për të hyrë në vend". Lidhur me frikën për manipulimin e provave, ajo u shpreh:

> Dëshmi për manipulim të provave – po qe se këto dëshmi bëhen të disponueshme është në fakt një rrethanë e mrekullueshme e dëshmimit të fajit. Në qoftë se arrin të ngjitesh deri te burimi prej nga ka dalë

> urdhëri për manipulimin e provave, kjo të lejon të mbërrish në një përfundim të patundshëm se kjo gjë është bërë për të fshehur të vërtetën, gjë që dëshmon ndjenjë të fortë faji.[11]

Dy ditë pas vrasjeve, ekipi i ekspertëve finlandezë të kriminalistikës u lejua të kryente autopsinë e dyzet viktimave të Raçakut, sëbashku me ekipe nga Jugosllavia dhe Bjellorusia. Raporti i tyre i datës 17 mars 1999, nuk ofronte kurrfarë detajesh rreth zbulimeve post-mortem. Raporti përfundonte se "nuk u gjetën tregues të tjerë përveç atyre që kishin të bënin me njerëz të paarmatosur."[12]

Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s në Jugosllavi, Gjykata hapi një zyrë në Tiranë, Shqipëri, për të intervistuar refugjatët. Kjo zyrë bashkëpunoi ngushtësisht me organizmat qeveritarë dhe organizatat jo qeveritare në Shqipëri e Maqedoni, për mbledhjen e informacionit rreth shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

Më 7 prill, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara lëshoi një deklaratë që përmendte me emra nëntë komandantë të Ushtrisë Jugosllave, duke cilësuar se, "Ushtria Jugosllave dhe forcat e Ministrisë Punëve të Brendshme janë duke kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit" – krime për të cilat Gjykata mund të ngrejë akt-padi.[13] Në deklaratë thuhej:

> Asnjë komandant i Ushtrisë Jugosllave apo i Ministrisë së Punëve të Brendshme është i imunizuar dhe nuk mund të ndiqet penalisht, sot ose në të ardhmen. Çdo komandant i Ushtrisë Jugosllave apo i njësive të Ministrisë së Punëve të Brendshme që planifikon, nxit, urdhëron apo ndihmon e mbështet krime lufte, krime kundër njerëzimit ose ushtron genocid, është përgjegjës individualisht për krime të kryera në Kosovë. Brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare nuk ka ndonjë statut që ta kufizojë atë të ndërmarrë hapa kundër krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit apo kundër genocidit.[14]

Deklarata në fjalë identifikonte personat e mëposhtëm si komandantët e sipërpërmendur:

- Kolonel Millosh Mandiç, Komandant, Brigada e 252-të e korracuar, e dislokuar në Kosovën qendrore (Vendndodhja e garnizonit: Kraljevo, Serbi);

- Gjeneral major Vladimir Llazareviç, Komandant, Korpusi i Prishtinës;
- Kolonel Mladen Cirkoviç, Komandant, Brigada e 15-të e korracuar, Shtabi në Prishtinë;
- Kolonel Krsman Jeliç, Komandant, Brigada e 243-të e mekanizuar, Shtabi në Ferizaj;
- Kolonel Bozhidar Deliç, Komandant, Brigada e 549-të e motorizuar, Shtabi në Prizren dhe në Gjakovë;
- Kolonel Radojko Stefanoviç, Komandant, Brigada e 52-të e Artilerisë së Përzierë, Shtabi në Gjilan;
- Kolonel Millosh Gjosan, Komandant, Bateria e 52-të e Mbrojtjes Kundërajrore-Regjimenti i Raketave, Shtabi në Gjakovë;
- Major Zheljko Pekoviq, Komandant, Batalioni i 52-të i Policisë Ushtarake, Shtabi në Prishtinë.

Më 27 maj 1999, Gjykata bënte të ditur emrat e të akuzuarve, të cilët ishin ndër zyrtarët më të lartë kundër të cilëve ajo kishte ngritur ndonjëherë akt-padi deri në atë ditë: atë kundër Presidentit të Jugosllavisë Sllobodan Millosheviç dhe katër ofiqarëve të lartë për "vrasje, persekutime dhe internime në Kosovë" për periudhën midis 1 janarit dhe fundmajit 1999. Të pandehurit janë:

- Sllobodan Millosheviç, President i Republikës Federale të Jugosllavisë, Kryekomandant i Ushtrisë Jugosllave dhe President i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes;
- Milan Milutinoviç, President i Serbisë dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes;
- Dragoljub Ojdaniç, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave;
- Nikolla Shahinoviç, Zëvendëskryeministër i Republikës Federale të Jugosllavisë;
- Vllajko Shtojiljkoviç, Ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë.

Sllobodan Millosheviç, Millan Milutinoviç, Dragoljub Ojdaniç dhe Vllajko Stojiljkoviç u akuzuan se kishin shkelur ligjet ose zakonet e luftës (vrasje dhe persekutim për arsye politike, racore ose fetare) dhe krime kundër njerëzimit (shpërngulje më dhunë dhe vrasje). Nikolla Shahinoviç u

akuzua për të njëjtat krime në bazë të përgjegjësisë së tij personale.[15] Padia fillestare nuk lidhej me krimet e kryera në Bosnjë apo në Kroaci, por kishte të bënte vetëm me krimet e kryera në Kosovë gjatë pesë muajve të parë të vitit 1999.

Fill pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, në qershor 1999, Gjykata shkoi e hapi një zyrë në Prishtinë, për të kryer sa më mirë detyrën tejet të vështirë të hetimeve. Faza e parë e zhvarrosjeve zgjati nga qershori deri më 1 tetor 1999. Gjashtë javë më pas, e porsaemëruara kryeprokurore, Carla Del Ponte, i paraqiti Këshillit të Sigurimit, në New Jork, rezultatet paraprake të hetimeve. Ajo raportoi që, përsa i takon periudhës deri më 10 nëntor 1999, Gjykata kishte mbaruar punë në 195 nga 529 vendvarrimet që ndodhen në Kosovë, duke ekzumuar 2108 kufoma. Del Ponte, vuri në dukje, që kjo shifër nuk përfaqëson numrin në total të

RRADHA E SIPËRME NGA E MAJTA NË TË DJATHTË: *Ish-presidenti jugosllav Sllobodan Millosheviç, ish-ministri serb i punëve të brendshme Vllajko Stojiljkoviç, ish-zëvendëskryeministri jugosllav Nikolla Shahinoviç.*RRADHA E POSHTME NGA E MAJTA NË TË DJATHTË: *Ish-shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë jugosllave Dragoljub Ojdaniç, presidenti i serbisë Millan Milutinoviç, (korrik 2001).*

FOTO AFP

kufomave. Ekzumimi vazhdonte ndërsa Gjykata "kishte zbuluar gjithashtu dëshmi të falsifikimit të provave."[16] Faza tjetër e zhvarrosjeve nisi në prill dhe zgjati deri në tetor 2000. Sipas fjalimit të Del Pontes të mbajtur para Këshillit të Sigurimit në nëntor 2000, ekipet e ekspertëve të Gjykatës kishin ekzaminuar edhe 325 vendvarrime të tjera, duke ekzumuar edhe 1577 trupa, si dhe mbetjet e pjesshme të 258 të tjerëve. Del Ponte deklaroi se, numri i përkohshëm i trupave të ekzumuar për rreth dy vjet është "afro 4000 trupa ose gjymtyrë trupash." Me këtë rast, ajo do të shtonte se, një shifër e saktë nuk do të jetë kurrë e mundur "për shkak të përpjekjeve të qëllimta për t'i djegur trupat apo për t'i zhdukur ata në një mënyrë ose një tjetër."[17]

Më 29 shtator 1999, Del Ponte e përcaktoi punën e Gjykatës në Kosovë si një përparësi absolute.[18] Ajo bëri të ditur se, fokusi kryesor i punës së tyre do të ishte hetimi dhe gjykimi i Millosheviçit dhe udhëheqësve të tjerë të paditur qysh në maj. Paskëtaj mund të ngrihen padi edhe për persona të tjerë që kanë pasur poste drejtuese në politikë apo në ushtri. Veç kësaj, Gjykata është duke hetuar fajtorët e disa prej krimeve më tronditëse – të ashtuquajturit "fajtorë të bujshëm." Këtu hynin të gjithë ata që kishin kryer përdhunime ose kishin ushtruar dhunë seksuale gjatë kohës së konfliktit.

Por, nga ana tjetër, Gjykata do të pranonte se "nuk kishte as mandatin as mundësitë" për të qenë hetuesi kryesor dhe njëkohësisht agjencia që duhej të kryente ndjekjen penale në Kosovë.[19] Pjesa më e madhe e krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur do të lypte angazhimin edhe të policisë vendore dhe sistemit gjyqësor në Kosovë, aktualisht nën mandatin e Misionit të Kombeve të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Në fjalimin e nëntorit 2000 para Këshillit të Sigurimit, Del Ponte nënvizoi nevojën për të arrestuar Sllobodan Millosheviçin, i cili, në shtator, kishte humbur garën elektorale për t'u rizgjedhur President, ndërsa më 5 tetor 2000 ishte larguar forcërisht nga detyra. Del Ponte i kërkoi Kombeve të Bashkuara të ushtronin trysni mbi autoritetet e reja jugosllave që të bashkëpunonin në arrestimin e Millosheviçit dhe ekstradimin e tij në Hagë, duke thënë se, "do të ishte e pakonceptueshme të lejohej që Millosheviçi t'i shmangej përgjegjësisë e të mos përgjigjej për rrjedhoja e veprimeve të veta."[20] Nga ana tjetër, ajo i bëri thirrje Këshillit të Sigurimit të modifikonte statusin e Gjykatës, në mënyrë që ajo të kishte mundësi për t'u marrë me abuzimet kundër serbëve dhe pakicave të tjera në Kosovë, në situatën e

krijuar pas luftës. Sipas statutit aktual, me përjashtim të genocidit, juridiksioni i Gjykatës shtrihet vetëm mbi krimet e kryera gjatë një konflikti të armatosur.

Pjesa më e madhe e krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur do të lypte angazhimin edhe të policisë vendore dhe sistemit gjyqësor në Kosovë.

Pas ardhjes në pushtet, në tetor të vitit 2000, Presidenti i ri jugosllav Vojislav Koshtunica deklaroi se, bashkëpunimi me Gjykatën "nuk ishte një prioritet." E megjithatë, në nëntor ai pranoi që Gjykata të rihapte zyrën e vet në Beograd. Ministri i Jashtëm i porsa emëruar, Goran Svilanoviç, tha, "Ne nuk mund dhe nuk duhet t'i shmangemi ballafaqimit me rrjedhojat e luftës dhe përgjegjësisë së krimeve të kryera." [21] Ndonëse një numër përfaqësuesish të qeverisë serbe ishin shprehur në të mirë të bashkëpunimit me Gjykatën, Koshtunica nga ana e tij e kishte denigruar këtë organizëm ndërkombëtar si një institucion anti-serb. Qëndrimi i tij negativ kundrejt Gjykatës do të ndryshonte disi, pas trysnisë së fortë të ushtruar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara.

Në tetor 2000, Kongresi i Shteteve të Bashkuara parashtroi direktiva tepër strikte për Aktin e Asistencës në kuadër të Operacioneve të ndihmës për vendet e Huaja për vitin 2001, duke e ndaluar qeverinë e Shteteve të Bashkuara të vazhdonte e të ndihmonte Beogradin, veç në rast se Jugosllavia do të pranonte të bashkëpunonte me Gjykatën, duke përfshirë këtu "dorëzimin dhe transportimin e të akuzuarve ose ndihmë në kapjen e tyre." Sipas legjislacionit në fuqi, administrata e Bushit duhej që brenda datës 31 mars 2001, të vendoste nëse lypsej të ndalonte ndihmën e Shteteve të Bashkuara, gjë që efektivisht do të thoshte të bllokoje afro 50 milion $ të caktuara për Jugosllavinë.

Në fund të janarit 2001, Del Ponte vizitoi Beogradin për t'u takuar me përfaqësuesit e qeverisë së re jugosllave. Pas kthimit në Hagë, gjatë një konference për shtyp, prokurorja tha, se ishte e zhgënjyer me nivelin e bashkëpunimit që i ishte ofruar, edhe pse mbetej "optimiste me masë." Për takimin me Presidentin Koshtunica ajo u shpreh, "nuk hapi rrugën e një dialogu të frytshëm."[22]

Bashkëpunimi i qeverisë jugosllave me Gjykatën u përmirësua paksa para 31 marsit, që ishte edhe afati i fundit i vendosur nga qeveria e Shteteve të Bashkuara. Qeveria jugosllave nisii debatin rreth një ligji të ri, i cili i hapte rrugë bashkëpunimit të plotë me Gjykatën e Hagës dhe dorëzimit të të akuzuarve, nga an tjetër Gjykata e Hagës lejohej të kryente

hetime brenda territorit të Jugosllavisë, duke përfshirë këtu edhe dëgjimin e dëshmitarëve dhe mundësinë për të hyrë në arkiva e shtënë në dorë dokumantacionin e duhur.[23] Veç kësaj, dy serb të Bosnjës të akuzuar për krime lufte përfunduan në duart e Gjykatës. I pari, Bllagoje Simiç, ish-kryetari i bashkisë së Samacit iu dorëzua vetë Gjykatës së Hagës, më 12 mars 2001. Dhjetë ditë më pas, Millomir Stakiq, ish-kryetar i bashkisë së Prijedorit, u arrestua nga policia serbe dhe iu dorëzua Gjykatës së Hagës.[24]

Më 1 prill, policia serbe dhe trupat speciale arrestuan ish-Presidentin Sllobodan Millosheviç me akuzën për korrupsion. Por qeveria nuk mori përsipër t'ia dorëzonte Gjykatës së Hagës. Të paktën publikisht, deri në fund të prillit, hetimet e kryera nuk u morën me rolin që ai kishte pasur në krimet e luftës apo krimet kundër njerëzimit të kryera gjatë luftrave që pasuan shpërbërjen e Jugosllavisë.

Më 2 prill, qeveria e Shteteve të Bashkuara vendosi se kushtet për të vazhduar ndihmën ekonomike ishin plotësuar. Gjithsesi, mbështetja e plotë e Shteteve të Bashkuara për thirrjen e një konference ndërkombëtare të donatorëve, do të rezervohej në varësi të ecurisë së bashkëpunimit me Gjykatën e Hagës. Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Richard Boucher tha se, qeveria e Shteteve të Bashkuara "priste" që Jugosllavia t'ia dorëzonte Millosheviçin Gjykatës dhe se vazhdimi i ndihmës nuk do të "bazohej në një hap të vetëm."[25] Deri në prill të vitit 2001, të paktën tetë persona të akuzuar nga Gjykata e Hagës besohej se jetonin në Serbi, duke përfshirë këtu katër ish-zyrtarët e lartë serbë dhe jugosllavë të akuzuar bashkë me Millosheviçin, si dhe tre oficerë të Ushtrisë Jugosllave të cilët ishin akuzuar lidhur me pushtimin e Vukovarit, në Kroaci, në nëntor të vitit 1991.

Më 28 qershor, nën një trysni të fortë ndërkombëtare, qeveria serbe e transferoi Millosheviçin në Gjykatën e Hagës. Ai u shfaq para trupit gjykues për t'iu përgjigjur akuzave të ngritura kundër tij, më 2 korrik, por nuk pranoi avokat mbrojtës dhe e denoncoi procesin si një gjyq politik.

GJYKIMET KUNDËR KRIMEVE TË LUFTËS BRENDA VENDIT

Megjithëse shumica dërrmuese e atyre që ishin akuzuar për krime lufte e braktisën Kosovën, fill pas mbarimit të luftës, në vend mbeti një numër fare i pakët të dyshuarish. Individë të ndryshëm janë

hetuar dhe gjykuar nga gjykatat vendase kosovare. Deri në gusht të vitit 2000, rreth dyzet persona të akuzuar për krime lufte në Kosovë, ndodheshin në gjendje arresti. Numri i saktë i të burgosurve ishte i panjohur, ngaqë një pejsë e këtyre personave është liruar, ndërsa të tjerët ia kanë mbathur nga spitalet apo burgjet ku mbaheshin, duke përfshirë këtu trembëdhjetë persona që u arratisën nga burgu në pjesën veriore të Mitrovicës, në shtator 2000, si dhe një person që arriti të shpëtojë nga kampi ushtarak amerikan Bondsteel.[26] Të paktën tre prej të akuzuarve ishin rromë, ndërsa pjesa tjetër qenë serbë. Sipas statistikave të policisë të dhëna edhe shtypit, deri më dhjetor 2000, organet vendore të drejtësisë kishin ngritur akt-padi për krime lufte njëzet e dy persona dhe nëntë për genocid.[27]

Në qershor 2000, UNMIK-u bëri të ditur krijimin e Gjykatës për Krimet e Luftës dhe Krimet kundër Etnive në Kosovë (KWECC), e cila do të merrej me gjykimin e krimeve të luftës të kryera gjatë konfliktit. Mandati i Gjykatës ishte që të mbulonte ngjarjet nga janari i vitit 1999 e këndej dhe të përfshinte gjithë krimet e motivuara etnikisht të kryera pas bombardimeve të NATO-s, por kjo ide nuk funksionoi plotësisht.

Përgjatë viteve 2000 dhe 2001, një pjesë e proceseve gjyqësore kundër krimeve të luftës u kryen në gjykatat vendore me pjesëmarrjen edhe të gjykatësve ndërkombëtarë. Më 20 shtator 2000, përfundoi njëri prej gjyqeve kundër krimeve të luftës, duke dënuar me njëzet vjet burg Milosh Jokiç, për vrasjen e një njeriu dhe urdhërimin për të vrarë një të dytë. Në qershor 2001, gjykatat të përbëra nga gjykatës ndërkombëtarë dënuan tre serbë me burg për krime kundër shqiptarëve etnikë. Zoran Stanojeviç, një ish-polic, u dënua me pesëmbëdhjetë vjet burg për pjesëmarrje në masakrën e Raçakut, Çedomir Jovanoviç, pjesëtar i një grupi paraushtarak, u dënua me njëzet vjet burg për krimet e kryera në komunën e Rahovecit dhe Angjelko Kollasinac, ish-kryetar i bashkisë së Rahovecit, u dënua me pesë vjet burg për të njëjtën akuzë. Të tre vendimet e dhëna u kritikuan rëndë nga vëzhguesit për të drejtat e njeriut, për mangësira të theksuara proceduriale gjatë procesit të gjykimit.

Gjykatat vendore vuajnë nga mungesa e fondeve, organizimi i keq dhe manipulimet politike.

E vërteta është se UNMIK-u është në hall se si duhet të veprojë me proceset gjyqësore vendore për krimet e luftës. Nga njëra anë, administrata ndërkombëtare kërkon që sistemi gjyqësor të fillojë e të funksionojë, teksa

trysnia nga bashkësia shqiptare për të nxjerrë përgjegjësit e krimeve para gjyqit është e madhe. Nga ana tjetër, gjykatat vendore vuajnë nga mungesa e fondeve, organizimi i keq dhe manipulimet politike, kësisoj për të akuzuarit serbë për krime lufte shanset për të pasur një gjykim të ndershëm në një sistem të mbizotëruar nga shqiptarët janë fare të pakta.[28] Në janar 2000, raporti i OSBE-së për sistemin gjyqësor në Kosovë arrinte në përfundimin se, lidhur me gjyqet për krime lufte kundër serbëve "ka shqetësime serioze për anshmëri nga ana e gjykatave."[29]

Pas luftës në Kosovë, edhe gjykatat serbe kishin nisur disa procese gjyqësore për krime të kryera gjatë konfliktit të armatosur. Dy shqiptarë kosovarë, Bekim dhe Luan Mazreku ishin paditur si luftëtarë të UÇK-së, se kishin përdhunuar gra serbe dhe kishin ekzekutuar civilë serbë në fshatin Kleçkë, në Kosovë, në vitin 1998 (shih më sipër, Abuzimet e UÇK-së).[30] Më 18 prill 2001, pas një procesi që zgjati një vit, të dy këta persona u cilësuan fajtorë për terrorizëm dhe u dënuan me maksimumin e mundshëm, njëzet vjet burg. Duke cituar një trup gjykues të anshëm, ku e drejta për t'u mbrojtur ishte e kufizuar, si dhe përdorimin e forcës për të nxjerrë pohimin, Qendra Ligjore Humanitare që monitoroi gjyqin, arriti në përfundimin se gjykata "nuk paraqiti asnjë provë që dëshmon se vëllezërit Mazreku i kishin kryer krimet për të cilat akuzoheshin."[31]

Më 19 korrik 2000, një gjykatë në qytetin Pozharevac, në Serbi, dënoi dy policë serbë për vrasjen e tre shqiptarëve etnikë në Kosovë në vitin 1999.[32] Boban Petkoviç nga Hoça e Madhe u dënua me katër vjet e nëntë muaj burg për vrasjen e Ismail Durgutit, Sezair Miftarit dhe gruas së Sezairit, Shefkije, më 9 maj 1999. Xhorxhe Simiç u dënua me një vit burg si bashkëpunëtorë i vrasësve.

Më 20 dhjetor 2000, një gjykatë ushtarake e Nishit dënoi dy rezervistë të Ushtrisë Jugosllave, Nenad Stamenkoviç dhe Tomisha Joviç, me nga katër vjet e gjysmë burg për vrasjen e dy civilëve shqiptarë kosovarë në fshatin Shushicë. Kapiteni i ushtrisë Dragisha Petroviç u gjykua dhe u dënua për nxitjen e vrasjeve të civilëve, me katër vjet e dhjetë muaj. Në një vlerësim për këtë çështje, Qendra Ligjore Humanitare e përshëndeti dënimin, por e kritikoi masën e dënimit si "tepër të butë." Të akuzuarit ishin dënuar për vrasje dhe jo për krime lufte, thanë përfaqësuesit e Qendrës, të cilët i qenë referuar nenit 142 të Kodit të Procedurës Penale të Jugosllavisë.[33] Kryegjykatësi, koloneli Radenko Milladinoviç, u shpreh se, dënimi kishte qenë i butë duke pasur parasysh që ushtarët kishin

pasë vuajtur nga "psikoza e luftës" në kohën kur kishin kryer krimin.[34]

Më 19 prill 2001, Ushtria Jugosllave njoftoi se gjykatat ushtarake kishin nisur njëzet e katër procese gjyqësore kundër një numri ushtarësh që dyshohej se kishin kryer krime lufte në Kosovë.[35] Më 24 prill, zëdhënësi i ushtrisë njoftoi se, prokurori ushtarak kishte urdhëruar nisjen e hetimeve kundër "ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve ... për krime me pasojë vdekjen dhe plagosjen e civilëve, si dhe për privimin e tyre nga të drejtat themelore të njeriut përgjatë veprimeve luftarake në provincën e Kosovës më 1998 dhe 1999."[36]

Sipas Radios B92, më 24 maj 2001, shefi i ri i policisë në Serbi, Sreten Lukiç, i cili kishte pasë qenë shef i policisë në Kosovë më 1998 dhe 1999, njoftoi se gjashtëdhjetë e gjashtë oficerë policie ishin duke u hetuar për krime kundër shqiptarëve etnikë të kryera gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s. Më 14 korrik 2001, ministri i Drejtësisë i Serbisë, Vladan Batiç, se gjyqet për krime lufte të kryera nga qytetarët serbë do të fillonin pas pak javësh.

HETIMET KUNDREJT NATO-s DHE UÇK-së

Në përputhje me mandatin për të hetuar të gjitha palët, më 14 maj 2000, Gjykata e Hagës formoi një komitet të brendshëm për të shoshitur e vlerësuar akuzat se NATO-ja kishte kryer shkelje të së drejtës humanitare gjatë fushatës së bombardimeve kundër Jugosllavisë, si dhe për të vendosur nëse Gjykata lypsej të niste hetimet. Në një raport të bërë publik më 8 qershor, komiteti u shpreh kundër hetimeve të mëtejshme, si për fushatën e bombardimeve në tërësi ashtu edhe për incidente të shkëputura. Raporti konkludonte "Qoftë për faktin se ligji nuk është në mënyrë të mjaftueshme i qartë, qoftë për faktin se hetimet ka pak të ngjarë të mbledhin prova të mjaftueshme për akuza të qenësishme si kundër të akuzuarve të nivelit të lartë ashtu edhe për ata të një niveli më të ulët, për krime veçanërisht të rënda."[37]

Carla Del Ponte shprehej se zyra e saj do të hetonte si udhëheqësit ushtarakë ashtu edhe ata civilë "të çdonjërës prej palëve në konflikt".

Në korrik të vitit 2001, hetimet e Gjykatës së Hagës kundër UÇK-së vijonin. Në një deklaratë të bërë më 29 shtator 1999, Carla Del Ponte shprehej se zyra e saj do të hetonte si udhëheqësit ushtarakë ashtu edhe

ata civilë "të çdonjërës prej palëve në konflikt", që mund të ketë kryer krime gjatë konfliktit të armatosur.[38] Në një konferencë për shtyp të mbajtur në Prishtinë, më 21 qershor 2000, Del Ponte theksoi se, ndonëse puna e saj ishte fokusuar mbi udhëheqjen serbe dhe atë jugosllave, hierarkia e lartë e UÇK-së ishte gjithashtu objekt hetimesh. Duke iu shmangur praktikës së mëparshme që rëndom nuk ofronte hollësira rreth hetimeve në proces e sipër, Del Ponte bëri të ditur se "pesë episode" krimesh të supozuara të UÇK-së ishin duke u hetuar, megjithëse ajo nuk pranoi të specifikonte se për ç'incidente bëhej fjalë.

Del Ponte kritikoi gjithashtu abuzimet e pas luftës në Kosovë kundër serbëve dhe rromëve, duke i cilësuar ato si "fara që mbjellin hakmarrjen në të ardhmen dhe zgjasin mungesën e stabilitetit në rajon."[39] Në fjalimin e mbajtur në nëntor 2000, para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Del Ponte kërkoi që të amendohej statuti i Gjykatës, në mënyrë që zyra e saj të mund të ndiqte krimet që ndodhnin në Kosovë edhe pas mbarimit të konfliktit.

Katër muaj më pas me shpërthimin e konfliktit në luginën e Preshevës, në Serbinë e jugut dhe rajonet veriore të Maqedonisë, Del Ponte bëri të ditur se mandati i Gjykatës së Hagës i mbulonte që çke me të ngjarjet që po ndodhnin në ish-Jugosllavi, në mënyrë specifike në Kosovë, Serbinë e jugut dhe Maqedoni. Në një konferencë për shtyp të mbajtur në Hagë, më 21 mars 2001, kryeprokurorja u shpreh, "vazhdimi i dhunës në këto zona (Kosovë, Serbinë e jugut dhe Maqedoni) i përmbush përnjëmend kriteret ligjore për ta përcaktuar "konflikt të armatosur", si dhe për të ndjekur synimet kriminale, ashtu siç parashtrohet në statutin e gjykatës." Ajo do të bënte të ditur gjithashtu se zyra e saj kishte hapur dy dosje hetimesh: e para kishte të bënte me të gjitha veprimtaritë kundër serbëve dhe pakicave të tjera etnike në Kosovë nga grupe të armatosura shqiptarësh të panjohur, qysh nga qershori i vitit 1999 e deri më sot dhe, e dyta, me veprimtarinë e Ushtrisë për Çlirimin e Preshevës, Medvegjës e Bujanovcit (UÇPMB) në Serbinë e jugut, qysh nga nëntori i vitit 1999 e deri në ditët e sotme.[40]

19

STANDARTET LIGJORE NË KONFLIKTIN E KOSOVËS

HYRJE

Human Rights Watch ka raportuar gjerësisht rreth abuzimeve ndaj të drejtave të njeriut në Kosovë që nga viti 1990, vit në të cilin u hoq autonomia e Kosovës, deri në vitin 1997.[1] Abuzimet e policisë, arrestimet arbitrare dhe shkeljet e proceseve të ndershme gjyqësore që karakterizonin trajtimin nga shteti të shqiptarëve etnikë gjatë asaj periudhe ishin shkelje të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, tek i cili Republika Federale e Jugosllavisë është palë, të cilat, përveç kësaj, ndaloheshin nga e drejta e brendshme jugosllave. Rritja e kundërshtimit të armatosur ndaj rendit të drejtpërdrejtë abuziv të Beogradit, në formën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe intensifikimi i luftimeve ndërmjet forcave qeveritare dhe rebelëve të armatosur nga pranvera e vitit 1998, ndryshoi natyrën e konfliktit, llojet e abuzimeve të kryera dhe ligjin e aplikueshëm.

Nga 28 shkurti i vitit 1998, luftimet ndërmjet forcave të ndryshme të sigurimit serb e jugosllav dhe UÇK-së mund të karakterizohen si një konflikt i armatosur jo ndërkombëtar (i brendshëm), në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare (ligjet e luftës). E drejta e aplikueshme gjatë kësaj periudhe përfshin nenin 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, Protokollin e II-të të këtyre konventave dhe të drejtën zakonore të luftës – të gjitha këto aplikohen si ndaj forcave qeveritare ashtu dhe ndaj rebelëve të armatosur. Shkeljet e dokumentuara të së drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe përfshin ekzekutimin e jo ndërluftuesve, përdorimin jo proporcional të forcës ushtarake, sulmet pa dallim kundër civilëve dhe shkatërrimin sistematik

Refugjatë shqiptarë kosovar duke hyrë në Shqipëri.

© JOANNE MARINER /HUMAN RIGHTS WATCH

të pasurisë së civilëve nga policia speciale serbe dhe ushtria jugosllave, si dhe dhunimet e serbëve nga UÇK, si psh. shpërnguljet me forcë, marrja e pengjeve dhe ekzekutimet e menjëhershme.

Me fillimin e bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, konflikti në Kosovë dhe në të gjithë Republikën Federale të Jugosllavisë, për aq sa përfshiu NATO-n dhe forcat serbe e jugosllave, u kthye në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, ndaj të cilit u aplikua i tërë korpusi i së drejtës humanitare ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe, NATO bëri shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare në fushatën e saj të bombardimeve në RFJ (shih Fushata Ajrore e NATO-s). Forcat e sigurimit serb dhe jugosllav ishin përgjegjëse gjatë kësaj periudhe për shpërnguljet masive dhe për numrin e madh të vrasjeve të civilëve etnikë shqiptarë në periudhën mars-qershor 1999. Tërheqja e forcave serbe dhe jugosllave nga Kosova dhe pushimi i fushatës së bombardimeve të NATO-s më 12 qershor 1999, përfundoi gjendjen e konfliktit të armatosur në Kosovë. Protokolli I parashikon se aplikimi i Konventave të Gjenevës do të pushojë me përfundimin e operacioneve ushtarake.

KOSOVA SI NJË KONFLIKT I BRENDSHËM I ARMATOSUR

E drejta humanitare ndërkombëtare bën një dallim të rëndësishëm ndërmjet konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jo ndërkombëtare (të brendshme), e cila përcakton ligjin e aplikueshëm. Neni 2, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, përcakton se një konflikt ndërkombëtar i armatosur duhet të përfshijë një luftë të deklaruar ose çdo konflikt tjetër të armatosur i cili mund të lindë "ndërmjet dy ose më shumë Palëve të Larta Kontraktuese" të Konventës. Komentari zyrtar i Konventave të Gjenevës përkufizon gjerësisht "konfliktin e armatosur" si çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy shteteve që pason me një ndërhyrje të forcave të armatosura.[3]

Një konflikt i brendshëm i armatosur është më i vështirë për t'u përkufizuar, përderisa shpeshherë debatohet nëse veprimet luftarake brenda një shteti kanë arritur nivelin e një konflikti të armatosur ose jo, në kontrast me tensionet e brendshme, trazirat, kryengritjet, ose aktet e izoluara të dhunës. Komentari zyrtar i nenit 3 të përbashkët të Konventave

të Gjenevës, i cili rregullon konfliktet e brendshme të armatosura, përmend një seri kushtesh që, pavarësisht se nuk janë të detyrueshme, parashikojnë disa orientime përkatëse. Kushti i parë dhe më i rëndësishëm ndërmjet këtyre është nëse një palë në revoltë kundër qeverisë *de jure*, në rastin konkret UÇK, "zotëron një forcë të organizuar ushtarake, një autoritet që përgjigjet për aktet e saj, e cila vepron brenda një territori të përcaktuar dhe ka mjetet e respektimit dhe sigurimit te respektimit të Konventës."[4]

Kushtet e tjera te nënvizuara në komentarin e konventës trajtojnë kundërpërgjigjen e qeverisë ndaj rebelimit. Një tjetër tregues i ekzistencës së konfliktit të brendshëm të armatosur është njohja nga ana e qeverisë të detyrimit të saj për të përdorur forcat e rregullta të armatosura kundër një rebelimi.[5]

Konfliktet e brendshme të armatosura që kanë arritur një shkallë të lartë të veprimeve luftarake rregullohen nga Protokolli II i vitit 1977 i Konventave të Gjenevës, i cili është më i shtjelluar se Neni 3 i Përbashkët në mbrojtjen që i bën civilëve (shih më poshtë). Protokolli II vihet në zbatim kur konflikti i armatosur:

> Ndodh në territorin e një Pale të Lartë Kontraktuese ndërmjet forcave të tij të armatosura dhe forcave disidente të armatosura ose grupet e tjera të armatosura, të cilat, nën një komandë të përgjegjshme, ushtrojnë një kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit të tij, që t'i mundësojë kryerjen e operacioneve ushtarake të qëndrueshme dhe intensive dhe të zbatojnë këtë Protokoll.[6]

Së fundi, konfliktet e brendshme të armatosura rregullohen gjithashtu nga e drejta zakonore ndërkombëtare, si psh. normat zakonore ndërkombëtare të shpallura në Rezolutën 2444 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.[7] E miratuar me votë unanime më 19 Dhjetor 1969, kjo rezolutë njeh në mënyrë të qartë parimin e së drejtës zakonore të imunitetit të civilëve dhe parimin plotësues, i cili i kërkon palëve ndërluftuese që të dallojnë civilët nga forcat ndërluftuese në të gjitha kohët. Hyrja e kësaj rezolute nënvizon se këto parime themelore të së drejtës humanitare aplikohen "në të gjitha konfliktet e armatosura," që nënkuptojnë si konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu dhe ato të brendshme.[8]

Duke interpretuar juridiksionin e saj mbi shkeljet e zakoneve të luftës

të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, ICTY (Gjykata Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi) ka mbajtur pikëpamjen se ky juridiksion përfshin "shkeljet e Nenit 3 të Përbashkët dhe rregullat e tjera zakonore ndaj konfliktit të brendshëm" dhe "shkeljet e marrëveshjeve që janë të detyrueshme për palët në konflikt që konsiderohen *qua* e drejtë traktatesh, psh. Marrëveshjet, të cilat nuk janë kthyer në të drejtë zakonore ndërkombëtare," si psh. Protokolli II i Konventave të Gjenevës.[9]

APLIKUESHMËRIA E NENIT 3 TË PËRBASHKËT DHE E PROTOKOLLIT II

Që prej 28 shkurtit 1998, veprimet luftarake ndërmjet UÇK-së dhe forcave qeveritare arritën nivelin e një konflikti ndaj të cilit aplikohen detyrimet e Nenit 3 të Përbashkët. Duke pasur parasysh intensitetin e mëvonshëm të konfliktit deri në qershor të vitit 1999, Human Rights Watch është duke vlerësuar gjithashtu, veprimet e UÇK-së dhe të forcave qeveritare bazuar në standartet e mishëruara në Protokollin II të Konventës së Gjenevës.[10]

Më 28 shkurt, forcat speciale të policisë serbe nisën sulmin e tyre të parë në shkallë të gjerë në fshatrat e Drenicës: Likosan dhe Cirez, të cilat dyshoheshin se strehonin anëtarët e UçK-së (shih. "Sfondi"). Ndërmjet kësaj date dhe tërheqjes së forcave serbe e jugosllave nga Kosova në qershor 1999, UÇK dhe qeveria u angazhuan në veprime luftarake të vazhdueshme që përfshinin sulme ushtarake, fronte luftarake dhe përdorimin e helikopterëve të sulmit dhe artilerisë (këto dy të fundit u përdorën ekskluzivisht nga qeveria). UÇK zotëronte armë të lehta dhe artileri të lehtë.

Që prej 28 shkurtit 1998, veprimet luftarake ndërmjet UÇK-së dhe forcave qeveritare arritën nivelin e një konflikti ndaj të cilit aplikohen detyrimet e Nenit 3 të Përbashkët.

Pavarësisht se UÇK ishte fillimisht një ushtri guerrile pa ndonjë hierarki të fuqishme të centralizuar dhe me ndasi të fuqishme rajonale, për qëllimet e së drejtës humanitare ndërkombëtare, rebelimi ishte një force e organizuar ushtarake. UÇK kishte shtatë "zona operacionale" me nga një komandant, shef shtabi, brigada dhe batalione. Shtabi i Përgjithshëm, megjithëse pa pasur një kontroll të plotë mbi

komandantët rajonalë, koordinonte aksionet ushtarake dhe aktivitetet politike, një strukturë e cila lejonte vendimet që do t'u transmetoheshin luftëtarëve.

Gjatë vitit 1999, korrespondentët veteranë të luftës, ashtu si dhe hulumtuesit e Human Rights Watch të cilët kishin vendosur kontakte me UÇK-në, herë pas here vinin re disiplinë ndërmjet luftëtarëve që kontrollonin postblloqet dhe tendencën e tyre për të aplikuar politika dhe procedura të ngjashme (p.sh. lidhur me krijimin e mundësisë për gazetarët që të hynin në zonat e kontrolluara nga UÇK). Kjo disiplinë ishte një tregues se luftëtarët merrnin urdhëra politike dhe se luftëtarët përgjigjeshin së paku para komandantëve rajonalë. Po kështu, kishte raste kur vihej re një mungesë e qartë disipline dhe stërvitjeje, e cila dëshmon për disa dobësi strukturore brenda UÇK-së. Pavarësisht nga kjo, në mesin e vitit 1998 u bë e qartë se udhëheqja e UÇK-së ishte e aftë të organizonte sulme sistematike në zona të gjera të Kosovës. Gjithashtu, ajo koordinonte mbështetjen logjistike dhe financiare nga diaspora shqiptare në Europën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara. Armët vinin rregullisht nga veriu i Shqipërisë. Ky koordinim u rrit më tej ndërsa lufta bëhej më e ashpër dhe pavarësisht se UÇK mbante gjithmonë një karakter të qartë rajonal.

Që prej prillit e deri në mesin e muajit korrik 1998, UÇK zotëronte afërsisht 40% të territorit të Kosovës, megjithëse pjesa më e madhe e këtij territori u vendos përsëri nën kontrollin e forcave qeveritare prej gushtit 1998. Megjithatë, deri në atë kohë UÇK kishte pasur në zotërim një numër qytetesh dhe fshatrash strategjikë dhe kontrollonte postblloqet përgjatë disa rrugëve të rëndësishme të Kosovës; që prej shtatorit 1998 zona e tyre e kontrollit ishte reduktuar në disa pjesë të Drenicës dhe një numër të shpërndarë zonash të izoluara në perëndim, veçanërisht natën. [11]

Megjithëse struktura e komandës së UÇK-së u dëmtua si rezultat i sulmit të forcave qeveritare gjatë verës, bërthama e organizimit vazhdonte të ekzistonte. Një organizatë e veçantë shqiptare e armatosur e njohur si FARK (Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës), e cila kishte një bazë të veçuar në Shqipërinë e Veriut dhe ishte kryesisht e pranishme në Metohi (Dukagjin), rajon i Kosovës, ishte një komplikim i mëtejshëm i situatës. Në shtator 1998, u bë e qartë se ky grup alternativ, që përfshinte kryesisht shqiptarë etnikë me një eksperiencë të shkuar në Ushtrinë Jugosllave dhe policinë serbe, nuk pajtohej me strategjinë ushtarake të

UÇK-së, duke kritikuar mungesën e saj të profesionalizmit. Megjithatë, FARK dhe UÇK nuk u angazhuan kurrë në veprime luftarake kundër njëra-tjetrës.

Siç përmendet në kapitullin Forcat në Konflikt, zëdhënësi i UÇK-së deklaronte vazhdimisht vullnetin e organizatës për të respektuar rregullat e luftës, gjë e cila është një ndër faktorët që duhet të merren në konsideratë në përcaktimin nëse ekziston një konflikt i brendshëm i armatosur ndaj të cilit mund të aplikohen standartet e Protokollit II.[12] Në një intervistë të dhënë për gazetën në gjuhën shqipe *Koha Ditore* në qershor 1998, zëdhënësi i UÇK-së Jakup Krasniqi tha:

UÇK njeh Konventat e Gjenevës dhe konventat që aplikohen në kohë lufte.

-ZÎdhÎnÎsi i U«K-sÎ Jakup Krasniqi

> Që në fillim ne kishim rregullat tona të brendshme për operacionet që kryenim. Këto rregulla përcaktojnë qartë se UÇK njeh Konventat e Gjenevës dhe konventat që aplikohen në kohë lufte.[13]

Komunikata e UÇK-së numër 51, e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së më 26 gusht, deklaronte se: "UÇK si një Ushtri e institucionalizuar dhe e organizuar, po ngrihet profesionalisht dhe është e gatshme për të fituar luftën."[14]

Në nëntor të vitit 1998, hulumtuesit e Human Rights Watch zhvilluan një takim me dy përfaqësues të UÇK-së, Hashim Thaçin dhe Fatmir Limajn, për të diskutuar për angazhimet e UÇK-së në zbatimin e ligjeve të luftës. Përfaqësuesit e UÇK-së pranuan se në një situatë të tillë lufte kishte pasur dhe "probleme". Por ata theksuan se UÇK ishte e angazhuar për të zbatuar Konventat e Gjenevës dhe se respektonte të drejtën humanitare ndërkombëtare. Megjithatë, pavarësisht nga kërkesat e përsëritura, përfaqësuesit refuzuan të jepnin ndonjë provë të angazhimit të deklaruar të UÇK-së. Ata thonin se UÇK kishte një kod sjelljeje të ushtarëve të saj, por ai nuk mund të shihej. Ata pretendonin se për ushtarët që kishin kryer abuzime ishin vendosur masa disiplinore, por nuk dhanë detaje. Të ndaluarit ishin trajtuar në mënyrë njerëzore, theksonin ata, por të ndaluarit nuk mund të vizitoheshin për "arësye sigurimi."

Ka pasur raste të raportuara, por të pavërtetuara, të masave disiplinore nga komandantët e UÇK-së për ushtarët e tyre në rastet kur këta të fundit kishin kryer dhunime ose kishin goditur gazetarët e huaj, por nuk ka pasur raste të raportuara që luftëtarët e UÇK-së të jenë ndëshkuar

për rastet kur ata kanë pasur si objekt vrasjesh civilët serbë ose shqiptarë, kur kanë abuzuar me personat e ndaluar ose kur kanë shkelur Nenin 3 të Përbashkët ose Protokollin II.

Së fundi, përmes fjalëve dhe veprimeve të saj, qeveria jugosllave njohu në mënyrë të qartë UÇK-në si një forcë të organizuar të armatosur. Përveç policisë speciale dhe të rregullt serbe, e cila vepron në mënyrë të ngjashme me një organizatë ushtarake, qeveria ishte e detyruar që të përdorte forcat e saj të rregullta ushtarake, Ushtrinë Jugosllave, kundër rebelëve. Gjatë periudhës 28 shkurt – 12 qershor 1999, kushtet e nenit 3 dhe Protokollit II u përmbushën. Për pasojë, Human Rights Watch është duke vlerësuar veprimet e qeverisë dhe UÇK-së bazuar në parimet e përmendura në Nenin 3 të Përbashkët dhe Protokollin II.

Neni 3 i Përbashkët dhe Mbrojtja e Palëve Jo Luftuese

Neni 3 i Përbashkët i të katër Konventave të Gjenevës është konsideruar si një konventë brenda konventës. Ajo është dispozita e vetme e konventave të Gjenevës që aplikohet drejtpërsëdrejti ndaj konflikteve të brendshme të armatosura (ashtu si dhe ndaj konflikteve ndërkombëtare).

Neni 3 i Përbashkët, Seksioni 1 përcakton se:

> Në rastin e konfliktit të armatosur të një karakteri jo ndërkombëtar që ndodh në territorin e një Pale të Lartë Kontraktuese, secila palë në konflikt do të jetë e detyruar të zbatojë, si minimum, dispozitat e mëposhtme:
> (1) Personat që nuk kanë marrë pjesë aktivisht në veprimet luftarake, përfshirë anëtarët e forcave të armatosura që kanë lënë armët dhe ata që kanë dalë jashtë luftimit për shkak të sëmundjeve, plagëve, ndalimit ose ndonjë shkaku tjetër, në çdo rrethanë duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore, pa ndonjë diferencim të pafavorshëm, bazuar në racën, ngjyrën, besimin fetar, seksin, lindjen ose pasurinë, ose çdo kriter tjetër të ngjashëm.
>
> Për pasojë aktet e mëposhtme janë të ndaluara dhe duhet të ndalohen në çdo kohë dhe në çdo vend të çfarëdoshëm në lidhje me personat e mësipërm:

(a) dhunimi i jetës së personit, veçanërisht vrasjet e çdo lloji, plagosjet, trajtimi çnjerëzor dhe tortura;
(b) marrja e pengjeve;
(c) marrja nëpër këmbë e dinjitetit personal, veçanërisht trajtimi poshtërues dhe degradues;
(d) nxjerrja e vendimeve gjyqësore dhe kryerja e ekzekutimeve pa një gjykim të mëparshëm të shpallur nga një gjykatë e rregullt e cila jep të gjitha garancitë gjyqësore që njihen si të domosdoshme për popujt e civilizuar.

Neni 3 i Përbashkët vendos në këtë mënyrë detyrime ligjore fikse mbi palët në një konflikt të brendshëm të armatosur për të siguruar trajtimin njerëzor të personave, të cilët nuk kanë më një rol aktiv në veprimet luftarake.

Neni 3 i Përbashkët aplikohet kur situata e një konflikti të brendshëm të armatosur ekziston objektivisht në territorin e një Shteti Palë; ai sjell detyrime të qarta për të gjitha palët në një konflikt të brendshëm, përfshirë rebelët, pavarësisht se ata nuk kanë zotësinë ligjore për të nënshkruar Konventat e Gjenevës. Në Jugosllavi, forcat qeveritare dhe të UÇK-së ishin palë në konflikt dhe për pasojë kishin detyrime në bazë të Nenit 3 të Përbashkët.

Neni 3 i Përbashkët vendos në këtë mënyrë detyrime ligjore fikse mbi palët në një konflikt të brendshëm të armatosur për të siguruar trajtimin njerëzor të personave, të cilët nuk kanë më një rol aktiv në veprimet luftarake.

Detyrimi për të zbatuar nenin 3 është absolut për të gjitha palët në konflikt dhe i pavarur nga detyrimi i palës kundërshtare. Kjo nënkupton se qeveria jugosllave nuk mund të përjashtojë veten nga plotësimi i detyrimeve të nenit 3 me justifikimin se UÇK është duke shkelur nenin 3 dhe anasjelltas.

Zbatimi i nenit 3 nuk vendos ndonjë status mbi palën rebele, nga e cila mund të pasonte njohja e detyrimeve plotësuese ligjore jashtë nenit 3. Po kështu, me qëllim zbatimin e nenit 3, nuk është e nevojshme për cilëndo qeveri që të njohë statusin e palës ndërluftuese për UÇK-në.

Në kontrast me konfliktet ndërkombëtare, ligji që rregullon konfliktet e brendshme të armatosura nuk njeh privilegjin e anëtarëve të forcave ndërluftuese[15] dhe për pasojë nuk parashikon ndonjë status të posaçëm

për këta persona, edhe në rast se ata kapen rob. Në këtë mënyrë, qeveria jugosllave nuk ishte e detyruar që t'i njihte anëtarëve të kapur të UÇK-së statusin e të burgosurit të luftës. Po kështu, anëtarëve të forcave të armatosura qeveritare të cilët ishin kapur nga UÇK nuk ishte e nevojshme që t'u njihej ky status. Megjithatë, secila palë mund të jetë dakort që trajtojë të burgosurit e saj si të burgosur lufte dhe të gjitha palëve u është kërkuar që të trajtojnë në mënyrë humane ushtarët e kapur rob dhe civilët. Ekzekutimet pa gjyq, ndaj personave ndërluftues apo civilëve, kanë kanë shkelur ndalimin e vendosur për "vrasjet e çdo lloji."

Duke pasur parasysh faktin se forcat e UÇK-së nuk kishin "privilegjin e personave ndërluftues" ata mund të gjykoheshin dhe të ndëshkoheshin nga gjykatat jugosllave për krimin e tradhëtisë, rebelimit dhe kryerjen e krimeve të tjera në bazë të ligjeve të brendshme.

Protokolli II dhe Mbrojtja e Personave jo Luftues

Protokolli II shtjellon sanksionimin që i bën Neni 3 i Përbashkët trajtimit njerëzor dhe parashikon një listë më të plotë të mbrojtjeve të civilëve në konfliktet e brendshme të armatosura. Pavarësisht se nuk është një listë gjithëpërfshirëse, ajo ndalon praktikat, urdhërat dhe veprimet e mëposhtme:

- Urdhërat për eliminimin e të mbijetuarve, si p.sh. kërcënimet ndaj luftëtarëve ose urdhërat për të kryer veprime luftarake mbi këtë bazë.

- Aktet e dhunës kundër të gjithë personave, përfshirë luftëtarët e kapur, të dorëzuar ose që janë nxjerrë jashtë luftimit.

- Torturën, çdo formë ndëshkimi fizik, ose trajtim tjetër çnjerëzor të personave në çfarëdo rrethane.
- Plaçkitjen dhe shkatërrimin e pasurisë civile. Ky ndalim është vendosur për të shpëtuar civilët nga vuajtjet që rrjedhin nga shkatërrimi i pasurisë së tyre reale dhe personale: shtëpitë, mobiljet, veshjet, ushqimet, pajisjet dhe kështu me radhë. Plaçkitja përfshin aktet e organizuara dhe aktet individuale të kryera pa miratimin e autoriteteve ushtarake.[16]

· Marrjen e pengjeve.[17]

· Dhunimin e kufomave.[18] Dëmtimi i personave të vdekur nuk lejohet kurrë dhe shkel rregullat e luftës.

Protokolli II përmend gjithashtu se fëmijëve duhet t'i kushtohet kujdes dhe ndihmë sipas kërkesës. Neni 4, paragrafi 3, thekson se asnjë fëmijë nën 15 vjeç "nuk duhet të rekrutohet nga forcat ose grupet e armatosura."

Mbrojtja e Popullsisë Civile

Dallimi ndërmjet civilëve dhe luftëtarëve është i rëndësishëm për ligjet që rregullojnë si konfliktet e brendshme të armatosura ashtu dhe konfliktet ndërkombëtare. Përgjithësisht në situatat e konflikteve të brendshme të armatosura, civil është cilido person që nuk është anëtar i forcave të armatosura ose i një grupi të armatosur të organizuar të një pale në konflikt. Për pasojë, "popullsia civile përfshin të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë aktivisht në veprimet luftarake."[19]

Anëtarët e përhershëm të forcave të armatosura serbe dhe jugosllave dhe luftëtarët e UÇK-së janë objektiva ushtarake legjitime dhe subjekte sulmesh legjitime, individualisht ose kolektivisht, deri në momentin që ata dalin jashtë luftimit, që nënkupton dorëzimin, plagosjen ose kapjen e tyre.[20]

Policët që nuk kanë detyra luftimi nuk janë objektiva ushtarake legjitime. Po kështu, nuk janë objektiv ushtarak legjitim personeli qeveritar i autorizuar për të mbajtur armë si p.sh. agjentët doganorë.[21] Megjithatë, policët me detyra luftimi, mund të jenë objektivë të përshtatshëm ushtarakë dhe subjekte për sulme të drejtpërdrejta.

Civilët nuk mund të jenë subjekt i sulmeve të qëllimshme të individualizuara për sa kohë që ata nuk përbëjnë kërcënim direkt për kundërshtarin.[22] Termi "civil" përfshin gjithashtu disa punonjës të njësisë ushtarake, të cilët nuk janë anëtarë të forcave të armatosura por që i ndihmojnë ata.[23] Ndërsa gjatë kohës që janë civilë këta punonjës nuk mund të jenë objektiva ushtarake, këta punonjës të njësive ushtarake ose ata që ndihmojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ndërluftuesit marrin përsipër rrezikun e vdekjes ose të plagosjes që shoqëron sulmet kundër

objektivave legjitime ushtarake në kohën që ata janë brenda objektivave ushtarakë ose pranë tyre.

Gjithashtu, të dy palët mund të shfrytëzojnë si ndërluftues personat që angazhohen në një formë tjetër në aktivitetet civile. Këta civilë humbasin imunitetin e tyre nga sulmet për aq kohë sa marrin pjesë drejtpërsëdrejti në veprimet luftarake.[24] "Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në veprimet luftarake nënkupton aktet e luftës, të cilat për shkak të natyrës dhe qëllimit të tyre mund të shkaktojnë dëme aktuale ndaj personelit dhe pajisjeve të forcave të armatosura të armikut," dhe përfshin veprimet mbrojtëse.[25]

Dallimi ndërmjet civilëve dhe luftëtarëve është i rëndësishëm për ligjet që rregullojnë si konfliktet e brendshme të armatosura ashtu dhe konfliktet ndërkombëtare.

"Veprimet luftarake" nuk mbulojnë vetëm kohën kur personi civil përdor një armë, por gjithashtu kohën që ai mban armën, si dhe situatat në të cilat ai merr përsipër veprime luftarake pa përdorimin e armës.[26] Shembuj janë parashikuar në një Manual të Forcave Tokësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të cituara nga ICRC (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq), ku përfshihen disa veprime luftarake si:

> sabotazhi, shkatërrimi i pajisjeve të komunikimit, keqorientimi i qëllimshëm i trupave nga udhërrëfyesit dhe lirimi i të burgosurve të luftës … Po kështu është dhe rasti i një personi që vepron si anëtar i personelit të një arme ose personi që siguron informacion rreth objektivat ushtarakë për sistemet e armëve që kanë për synim përdorimin e menjëhershëm kundër armikut si p.sh., zbuluesit e artilerisë ose anëtarët e skuadrave vëzhguese në terren. Kjo mund të përfshijë mbështetjen e drejtpërdrejtë logjistike për njësitë e angazhuara drejtpërsëdrejti në luftë, si p.sh., dërgimi i municioneve në një pozicion zjarri. Nga ana tjetër, civilët që japin mbështetje jo të drejtpërdrejtë për forcat e armatosura, si p.sh. punonjësit e një fabrike që i shërben mbrojtjes ose ata që angazhohen në shpërndarjen ose ruajtjen e pajisjeve ushtarake në prapavijë, nuk përbëjnë një kërcënim të menjëhershëm për kundërshtarin dhe për pasojë nuk mund të jenë subjekt i sulmeve të qëllimshme individuale.[27]

Personat që mbrohen nga Neni 3 i Përbashkët përfshijnë si forcat qeveritare

ashtu edhe forcat e UÇK-së që janë dorëzuar, plagosur, sëmurë, të paarmatosur ose kapur rob. Këto forca konsiderohen *hors de combat*, dmth. jashtë luftimit.

Përcaktimi i Objektivave Ushtarake

Dallimi themelor ndërmjet civilëve dhe ushtarakëve aplikohet, gjithashtu, ndaj natyrës së objekteve_që mund të jenë objekte sulmi legjitime. Për të konsideruar një objekt ushtarak si legjitim, objekti ose objektivi, i zgjedhur për nga natyra, vendndodhja, qëllimi ose përdorimi, duhet të kontribuojë efektivisht në aftësinë ose aktivitetin ushtarak të armikut dhe shkatërrimi ose neutralizimi i plotë ose i pjesshëm i tij duhet të japë sipas rrethanave një avantazh ushtarak të përcaktuar.[28]

Objektiva ushtarake legjitime janë armët e ndërluftuesve, karvanet, instalimet dhe pajisjet. Përveç kësaj:

> një objekt i përdorur përgjithësisht për qëllime civile, si p.sh. një banesë, autobuz, grup taksish ose një aerodrom civil apo stacion hekurudhor, mund të kthehet në objektiv ushtarak nëse vendndodhja e tij përmbush kriteret e Protokollit I, neni 52(2).[29]

Për të përcaktuar një objekt ushtarak legjitim, objektivi duhet të:1) kontribuojë efektivisht në aftësinë ose aktivitetin ushtarak të armikut dhe, 2) shkatërrimi ose neutralizimi i plotë ose i pjesshëm i tij duhet të japë, sipas rrethanave, një avantazh ushtarak të përcaktuar.

Ligjet e luftës i karakterizojnë të gjitha objektet si civile me përjashtim të rasteve kur ato plotësojnë dy kriteret e mësipërme. Objektet që normalisht shfrytëzohen për qëllime civile, si p.sh., kishat, shtëpitë dhe shkollat, konsiderohen se nuk janë objektiva ushtarake. Nëse këto objekte ndihmojnë faktikisht veprimet luftarake të armikut, ato humbasin imunitetin e tyre nga sulmi i drejtpërdrejtë. Supozimi se një objekt ka një natyrë civile mund të mos përfshijë objekte të tilla si sistemet e transportit dhe komunikimit që kanë qëllim ushtarak. Në këto rrethana është e nevojshme që të analizohet nëse një objekt ose shërbim i caktuar plotëson dy kriteret e mësipërme.

Sulmuesi duhet të bëjë gjithçka "të mundur" për të verifikuar nëse

objektivat që do të sulmohen nuk janë civile. Termi "të mundur" nënkupton "atë çfarë është e praktikueshme ose mundësisht e praktikueshme duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në një kohë të caktuar, përfshirë ato rrethana që kanë lidhje me suksesin e operacioneve ushtarake."[30]

Ndalimi i Sulmeve Rastësore dhe Parimi i Proporcionalitetit

Sidoqoftë, edhe sulmet kundër objektivave ushtarake legjitime kufizohen nga parimi i proporcionalitetit. Ky parim vendos një detyrim ndaj forcave ndërluftuese për te zgjedhur mjetet e sulmit që shmangin ose minimizojnë dëmet ndaj civilëve. Në veçanti, sulmuesi nuk duhet të nisë një sulm në qoftë se viktimat civile që mund të rrjedhin prej tij mund të balancojnë rëndësinë e objektivit ushtarak për sulmuesin. Parimi i proporcionalitetit kodifikohet në Protokollin I, neni 51[5]:

> Ndërmjet të tjerave tipet e mëposhtme të sulmeve duhet të konsiderohen si rastësore …
> (b) një sulm i cili konsiderohet se mund të shkaktojë humbje rastësore të jetës së civilëve, plagosje të civilëve, dëmtime të objekteve civile, ose një kombinim të këtyre, i cili mund të jetë joproporcional në lidhje me avantazhin konkret dhe të drejtpërdrejtë të parashikuar.

Në qoftë se një sulm konsiderohet se mund të shkaktojë viktima ose dëmtime rastësore në radhët e civilëve, duhet të plotësohen dy kërkesa përpara se të fillojë sulmi. Së pari, duhet të ekzistojë një avantazh ushtarak "konkret dhe i drejtpërdrejtë" i parashikuar. "I drejtpërdrejtë" nënkupton "pa kushtin ndërhyrës të veprimit…. Një avantazh i parëndësishëm që do të fitohet në një kohë të pacaktuar në të ardhmen nuk duhet të jetë një vlerësim i përshtatshëm mase përkundrejt humbjeve në radhët e civilëve."[31]

Krijimi i kushteve "ndihmëse për dorëzim nëpërmjet sulmeve që rastësisht dëmtojnë popullsinë civile"[32] është shumë i parëndësishëm dhe i pamjaftueshëm nga ana ushtarake për t'u konsideruar si një avantazh ushtarak "konkret dhe i drejtpërdrejtë". Një avantazh ushtarak mund të konsistojë vetëm në marrjen e territorit dhe në shkatërrimin ose dobësimin e forcave të armatosura të armikut."[33]

Kërkesa e dytë e parimit të proporcionalitetit është se dëmtimi i parashikuar i civilëve dhe dëmtimi i objekteve civile nuk duhet të jetë jo proporcional, që nënkupton se është "tepër i madh" në krahasim me avantazhin e pritshëm "konkret dhe të përcaktuar ushtarak."

Dëmi tepër i madh është një koncept relativ. Për shembull, prania e një ushtari në ikje nuk mund të shërbejë si justifikim për shkatërrimin e një fshati të tërë. Në qoftë se shkatërrimi i një ure është i një rëndësie madhore për pushtimin e një zone strategjike, "është e kuptueshme se disa shtëpi mund të goditen, por nuk mund të neutralizohet një zonë e tërë urbane."[34] Nuk ka kurrë justifikim për viktimat tepër të mëdha në radhët e civilëve, pavarësisht nga vlera e objektivit ushtarak.[35]

Sulmuesi nuk duhet të nisë një sulm në qoftë se viktimat civile që mund të rrjedhin prej tij mund të balancojnë rëndësinë e objektivit ushtarak për sulmuesin.

Sulmet rastësore përcaktohen në Protokollin I, neni 51 [4], si psh:

a) ato që nuk drejtohen ndaj një objektivi specifik ushtarak;
b) ato që përdorin një metodë ose mjete luftimi të cilat nuk mund të drejtohen ndaj një objektivi specifik ushtarak; ose
c) ato që përdorin një metodë ose mjete luftimi efektet e të cilave nuk mund të kufizohen në mënyrën e kërkuar nga ky Protokoll; dhe për pasojë, në çdo rast të tillë, kanë si natyrë goditjen pa dallim të objektivave ushtarake dhe të civilëve ose objekteve civile.

Mbrojtja e Civilëve nga Shpërnguljet

Ka vetëm dy përjashtime në ndalimin e shpërnguljes së civilëve, për arsye që lidhen me luftën: sigurimi i tyre ose arësyet e rëndësishme ushtarake. Neni 17 i Protokollit II parashikon se:

Shpërngulja e popullsisë civile nuk duhet të urdhërohet për arësyet që lidhen me konfliktin me përjashtim rasteve kur sigurimi i civilëve të përfshirë ose arësyet e rëndësishme ushtarake kërkojnë një gjë të tillë. Në qoftë se duhet të kryhen këto shpërngulje, atëherë duhet të merren të gjitha masat e mundshme me qëllim që popullsia civile të pritet në kushte të kënaqshme banimi, higjiene, shëndetësore, sigurimi dhe ushqimi.

Termi "arësye të rëndësishme ushtarake" zakonisht i referohet evakuimit për shkak të operacioneve që priten të ndodhin. Masa e përkohshme e evakuimit është e përshtatshme në qoftë se në një zonë të caktuar ekziston rrezik si rezultat i operacioneve ushtarake ose ajo mund të jetë subjekt i bombardimeve intensive. Gjithashtu, ajo mund të lejohet nëse prania e personave të mbrojtur në një zonë pengon operacionet ushtarake. Rikthimi i shpejtë i të evakuarve në shtëpitë e tyre kërkohet në momentin që kanë pushuar veprimet luftarake në këtë zonë. Autoriteti që bën evakuimin ka barrën që të provojë se rivendosja e detyruar e tyre është në përputhje me këto kushte.

Shpërngulja ose kapja e civilëve vetëm për t'i mohuar një bazë sociale armikut nuk ka të bëjë fare me sigurimin e civilëve.

Shpërngulja ose kapja e civilëve vetëm për t'i mohuar një bazë sociale armikut nuk ka të bëjë fare me sigurimin e civilëve. Po kështu, shpërngulja nuk justifikohet me "arësye ushtarake të rëndësishme," të cilat kërkojnë "vlerësimin më të kujdesshëm të rrethanave"[36] sepse këto rrethana krijojnë mundësinë e abuzimit. Komentari i ICRC-së për Protokollin II parashikon:

> Në mënyrë të qartë, arësyet e rëndësishme ushtarake nuk mund të justifikohen nga motivet politike. Për shembull, duhet të ndalohet lëvizja e një popullsie me qëllim ushtrimin e një kontrolli më efektiv mbi një grup etnik disident.[37]

Zhvendosja ose shpërngulja në masë e civilëve me qëllim mohimin e një baze sociale të vullnetshme për forcat kundërshtare ndalohet përderisa ajo i kundërpërgjigjet këtij motivi tërësisht politik.

Edhe nëse qeveria duhet të tregojë se shpërngulja ishte e nevojshme, ajo ka ende detyrimin e pavarur për të marrë "të gjitha masat e mundshme" për të pritur popullsinë civile "në bazë të kushteve të kënaqshme të banimit, higjienës, shëndetit, sigurimit dhe ushqimit."

E DREJTA E BRENDSHME JUGOSLLAVE

Kushtetuta Federale e Jugosllavisë e shpallur në vitin 1992, krijoi Jugosllavinë si një shtet demokratik "të themeluar bazuar në rendin ligjor."[38] Të 49 nenet të seksionit mbi të drejtat dhe liritë i garantojnë

të gjithë qytetarëve jugosllavë të drejtat bazë civile dhe politike, si p.sh. liria e fjalës, liria e grumbullimit dhe e drejta për një proces gjyqësor të ndershëm.

Ligjet jugosllave u garantojnë të gjithë të pandehurve të drejtën për një proces gjyqësor korrekt. Neni 23 i kushtetutës federale pengon arrestimin arbitrar dhe i detyron autoritetet që të informojnë menjëherë të ndaluarin për arësyet e ndalimit të tij/saj dhe t'i garantojnë mundësinë që të ketë mbrojtje ligjore. Neni 24 i detyron autoritetet që të informojnë me shkrim të ndaluarin për arësyet e arrestimit të tij/saj brenda 24 orësh. Arrestimi paragjyqësor i urdhëruar nga një gjykatë e shkallës së ulët nuk mund të kalojë të tre muajt, me përjashtim të rasteve kur afati zgjatet nga një gjykatë e një shkalle më të lartë dhe për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh. Neni 25 konsideron të paligjshme torturën, si dhe çdo mënyrë tjetër shtrëngimi për dhënien e dëshmive apo deklaratave. Gjithashtu, konsiderohet vepër penale përdorimi i forcës kundër një të arrestuari.

Seksioni 1, Neni 11 i kushtetutës garanton të drejtën e minoriteteve "për të ruajtur, nxitur dhe shprehur atributet e tyre etnike, kulturore, gjuhësore etj., si dhe për të përdorur simbolet e tyre kombëtare, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare." Seksioni 1, Neni 20 thekson se: "Qytetarët duhet të jenë të barabartë pavarësisht nga kombësia e tyre, rraca, seksi, gjuha, besimi fetar, besimet politike dhe të tjera si këto, arsimimi, origjina sociale, pasuria dhe statusi tjetër personal."

Kushtetuta Federale e Jugosllavisë e shpallur në vitin 1992, krijoi Jugosllavinë si një shtet demokratik "të themeluar bazuar në rendin ligjor."

Nenet 46 dhe 47 i garantojnë minoriteteve të drejtën për arsimim dhe për të pasur mjete informimi në gjuhën e tyre, si dhe të drejtën për të krijuar shoqata arsimore dhe kulturore. Megjithatë, Neni 48 vendos kufizime në lidhje me grumbullimin e lirë nëpër shoqata të minoriteteve, të cilat janë të ndjeshme ndaj një interpretimi të gjerë dhe arbitrar.

Anëtarët e minoriteteve kombëtare kanë të drejtën që të krijojnë dhe nxisin marrëdhënie në mënyrë të lirë me bashkëkombasit e tyre brenda Republikës së Jugosllavisë dhe jashtë kufijve të saj me bashkëkombasit e tyre në shtetet e tjerë, si dhe të marrin pjesë në organizatat ndërkombëtare jo qeveritare, *me kusht që këto marrëdhënie nuk i sjellin dëm Republikës Federale të Jugosllavisë ose një republike anëtare.*

Kushtetuta jugosllave garanton gjithashtu se qeveria do të respektojë të drejtën ndërkombëtare. Neni 10 parashikon se: "Republika Federale e Jugosllavisë do të njohë dhe garantojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarit të njohura nga e drejta ndërkombëtare." Neni 16 shton:

> Republika Federale e Jugosllavisë do të plotësojë me mirëbesim detyrimet që përfshihen në traktatet ndërkombëtare në të cilat ajo është palë kontraktuese. Traktatet ndërkombëtare që janë ratifikuar dhe shpallur në përputhje me këtë Kushtetutë dhe që përgjithësisht kanë pranuar rregullat e së drejtës ndërkombëtare do të jenë pjesë përbërëse e rendit ligjor të brendshëm.

Në lidhje me respektimin nga ana e ndërluftuesve të së drejtës ndërkombëtare, ligji jugosllav është gjithashtu shumë i qartë. Ligji Jugosllav "mbi Mbrojtjen", neni 19, i detyron ushtarët që të respektojnë të drejtën ndërkombëtare që ka të bëjë me të plagosurit, të burgosurit dhe civilët. Neni thotë:

> Anëtarët e Ushtrisë Jugosllave që marrin pjesë në një konflkt të armatosur janë të detyruar në bazë të të gjitha rrethanave që të respektojnë rregullat e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe rregullat e tjera mbi trajtimin e të plagosurve dhe të burgosurve dhe mbi mbrojtjen e civilëve.[39]

Gjithashtu, ligji serb mbi Punët e Brendshme i adresohet veprimeve të policisë. Neni 33 parashikon se punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të detyruar që të zbatojnë të gjithë urdhërat e ministrit ose të eprorit të tyre, "me përjashtim të atyre që urdhërojnë kryerjen e një akti që përbën vepër penale."[40]

BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË

Raportet e Human Rights Watch mbi Kosovën

Kosovë: Përdhunimet si një armë e "Spastrimit Etnik," 3/300
Vrasjet e civilëve gjatë fushatës ajrore të NATO-s, 2/00
Një fshat i shkatërruar: Krimet e Luftës në Kosovë, 10/99
Abuzimet e kryera kundër Serbëve dhe Rromëve në Kosovën e Re, 8/99
"Spastrimi etnik" në komunën e Gllogofcit, 7/99
Përdorimi nga ana e NATO-s i minave kasetë, 5/99
Të dhëna të shpejta nga Kosova #1-50, 3-6/99
Një javë terror në Drenicë, 2/99
Burgosjet dhe abuzimet në Kosovë, 12/98
Shkeljet ligjore të të drejtave të njeriut në Kosovë, 10/98
Persekutimet vijojnë: Shkeljjet e të drejtave të njeriut në Kosovë, 12/96
Abuzime me të drejtat e njeriut për popullsinë jo serbe në Kosovë, Sanxhak & Vojvodinë, 10/94
Plagë të hapura: Shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, 3/94
Abuzimet vazhdojnë në ish-Jugosllavi: Serbi, Mal i Zi & Bosnjë-Hercegovinë, 7/93
Abuzimet me të drejtat e njeriut në Kosovë, 10/92
Të drejtat e njeriut në një Jugosllavi në shpërbërje e sipër, 1/91
Jugosllavia: Krizat në Kosovë, 3/90

Raporte të tjera për Kosovën

American Association for the Advancement of Science (AAAS) dhe Institute for Legal and Policy Studies, *Politikë apo Panik? Largimi i shqiptarëve etnikë nga Kosova, mars-maj 1999*, Prill 2000.

American Bar Association (CEELI program) dhe AAAS, *Vrasjet politike në Kosovë/ Kosovo,* Shtator 2000.

Masakër në Qushkë, dokumentar i American RadioWorks, www.americanradiowork.org.

Raportet e Amnesty International gjenden edhe në www.amnesty.org.

Balkan Human Rights Web Page, www.greekhelsinki.gr/.

Bar Human Rights Committee of England andWales, *Kosovë 2000: Drejtësi, jo hakmarrje,* Shkurt 2000.

Council for the Defense of Human Rights and Freedoms, raporte të ndryshme, të vlefshëm në: www.albanian.com/kmdlnj/.

European Roma Rights Center, *Rromët në konfliktin e Kosovës*, Shkurt 2000.

Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, *Statusi i pakicave kombëtare në Kosovë,* maj 1998.

Raportet e Humanitarian Law Center gjenden në www.hlc.org.yu.

Independent International Commission për Kosovën, *Raporti i Kosovës*, tetor 2000.

International Crisis Group, *Kërkesat e realitetit: Duke dokumentuar shkeljet e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në Kosovë, më 1999*, qershor 2000.

International Crisis Group, *Shqiptarët e Kosovës në burgjet e Serbisë: Punët e papërfunduara në Kosovë,* janar 2000.

International Helsinki Federation, raporte dhe deklarata të ndryshme gjenden në www.ihf.hr.org.

International Press Institute, *Lajmet nga Kosova dhe lufta propagandistike,* shtator 1999.

Lawyers Committee for Human Rights, *Mbrojtja e refugjatëve dhe e të kthyerve: Parimet ligjore,* qershor 1999.

Lawyers Committee for Human Rights, *Kosovë: Mbrojtja dhe Rindërtimi i paqes – Mbrojtja e Refugjatëve, të të kthyerve, të zhvendosurve të brendshëm dhe minoriteteve,* gusht 1999.

Lawyers Committee for Human Rights, *Një paqe e thyeshme: Duke hedhur themelet për drejtësi në Kosovë,* tetor 1999.

Medecins Sans Frontiere, *Kosovë: Përllogaritja e të dëbuarve,* prill 1999.

Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE), *Kosovo/Kosova: Si e pamë/ si na e treguan, Pjesa e I dhe e II,* dhjetor 1999.

Physicians for Human Rights, *Krimet e Luftës në Kosovë: Një vlerësim i bazuar në popullsinë për shkeljet e të drejtave të njeriut kundrejt shqiptarëve të Kosovës*, gusht 1999.

Society for Threatened Peoples, *Kosova: Luftë, dëbime, masakra*, gusht 1998.

United Nations High Commissioner for Refugees and OSCE, *Vlerësim i gjendjes së pakicave etnike në Kosovë* (korrik 1999, nëntor 1999, shkurt 2000, qershor 2000).

United Nations Special Rapporteur rreth gjendjes së të drejtave të njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë, Republikën e Kroacisë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë, *Raport periodik rreth gjendjes së të drejtave të njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë, Republikën e Kroacisë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë* (24 shtator 1999) dhe Addendum (1 nëntor 1999).

United States Department of State, *Spastrimi etnik – Një vështrim i hollësishëm*, dhjetor 1999, *Zhbërja e historisë: Spastrimi etnik në Kosovë,* maj 1999.

United States Department of State, *Raport i misionit për vlerësimin e gjendjes ligjore në Kosovë,* prill 2000.

SHËNIME

Kreu 2. Sfondi

1. Për një përshkrim më të mirë të evoluimit të UÇK-së, shih Tim Judah, *Kosova, Luftë dhe hakmarrje* (New Haven dhe London: Yale University Press, 2000).
2. Ruza Petroviç dhe Marina Bllagojeviç, *Migrimi i serbëve dhe malazezëve nga Kosova dhe Metohia*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë, 7 qershor 1988.
3. Për hollësira të mëtejshme, shih Helsinki Watch (tani Human Rights Watch), *Jugosllavia: Kriza në Kosovë*, mars 1990.
4. Petroviç dhe Bllagojeviç, Migrimi i serbëve dhe malazezëve nga Kosova dhe Metohia.
5. Judah, *Kosova, Luftë dhe Hakmarrje*, f. 49.
6. Laura Silber dhe Allan Little, *Jugosllavia: Vdekja e një kombi*, (New York: Penguin USA, 1995).
7. Më 25 gusht 2000, Ivan Stamboliç u rrëmbye nga persona të panjohur në parkun Kosutnjak, të Beogradit. Deri në gusht të vitit 2001, vendndodhja e tij nuk dihej. Familja e Stamboliçit akuzoi Millosheviçin dhe të shoqen e tij Mirjana Markoviç, ish-ministrin e Brendshëm të Serbisë Vllajko Stojiljkoviç si dhe ish-shefin e Sigurimit të Shtetit Rade Markoviç, si organizatorë të rrëmbimit, ngaqë i druheshin kthimit të tij në politikë.
8. Tim Judah, "Udha e Kosovës për në luftë," *Survival*, 1 korrik 1999.
9. Pas gjashtë muajsh në burg, më 28 gusht, Vllasi u akuzua për "veprimtari kundërrevolucionare", si dhe u fajësua për vdekjen e njëzet e katër shqiptarëve etnikë, të cilët ishin vrarë nga policia më 28 mars 1989 (shih më poshtë), edhe pse në këtë kohë ai ndodhej në burg. Vllasi u dënua, por u lirua pas afro një viti. (Shih Helsinki Watch (sot Human Rights Watch) dhe International Helsinki Federation for Human Rights, *Jugosllavia: Kriza në Kosovë*, mars 1990.)
10. Ibid., nga Helsinki Watch dhe International Helsinki Federation for Human Rights, *Jugosllavia: Kriza në Kosovë*, mars 1990.
11. Programi për realizimin e Paqes, Lirisë, Barazisë, Demokracisë dhe Begatisë në Provincën Autonome Socialiste të Kosovës, pika 6, Republika e Serbisë, 30 mars 1990.
12. Nën trysninë e Perëndimit, mbështetja e Shqipërisë për pavarësinë e Kosovës do të ndalej me ndryshimin e qeverisë më 1992.

13. Për dokumenta të tjera rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut pas heqjes së autonomisë së Kosovës, *shih* Human Rights Watch, "Shkeljet e të drejtave të njeriut për popullsinë jo serbe në Kosovë, Sanxhak e Vojvodinë," *Raport i Human Rights Watch*, vëll. 6, nr. 6, tetor 1994, Human Rights Watch; *Plagë të hapura: Shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë*, (New York: Human Rights Watch, 1994); Human Rights Watch, "Shkeljet vazhdojnë në ish-Jugosllavi: Serbi, Mal i Zi, Bosnjë e Hercegovinë," *Raport i Human Rights Watch*, vëll. 5, nr. 11, korrik 1993; Helsinki Watch (sot Human Rights Watch), "Shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë," Raport i Human Rights Watch, vëll. 8, nr. 63, tetor 1992; *Të drejtat e njeriut në një Jugosllavi duke u shpërbërë, 1/91, Jugosllavia: Kriza në Kosovë*, 3/90.
14. Qeveria serbe ndërtoi banesa për serbët e shpërngulur në të gjithë Kosovën. Shqiptarët etnikë i konsideruan të porsaardhurit "kolonizatorë."
15. Shqiptarëve kosovarë iu kërkohej t'i paguanin LDK-së tri përqind të të ardhurave të tyre vjetore.
16. Ivo H. Daalder, "Kosova: Bosnja déjà vu," *Washington Post*, 17 prill 1998.
17. Judah, *Kosova: Luftë dhe hakmarrje*, f.113.
18. Në përgjigje të kërkesës së bazuar në Aktin e së Drejtës dhe Lirisë për Informim, Human Rights Watch mori një telegram të paklasifikuar të dërguar nga ambasada e Shteteve të Bashkuara në Beograd, më 2 dhjetor 1996, që nxirrte në pah "mungesën e vetëdijës (midis shqiptarëve) se politika e Shteteve të Bashkuara kundrejt Kosovës nuk, e përsëris nuk, mbështet pavarësinë e saj." Zyrtari që kishte dërguar telegramin ishte i shqetësuar se, "98 përqind e shqiptarëve nuk e dinë se Shtetet e Bashkuara nuk e mbështesin pavarësinë e Kosovës" dhe ai kishte kërkuar nga Uashingtoni për ta bërë më të qartë këtë qëndrim, në mënyrë të veçantë në programet e radios Voice of America.
19. LDK-ja i hodhi poshtë ofertat për të mbështetur kundërshtarët e Millosheviçit, në zgjedhjet e vitit 1992, siç ishte rasti i Milan Paniç, ngaqë ata mendonin se synimi i tyre për pavarësi ishte më i realizueshëm me Millosheviçin në pushtet, i cili urrehej nga bashkësia ndërkombëtare. Një të qëndrim të ngjashëm, ata të do të mbanin edhe në zgjedhjet e tetorit 2000, kur shqiptarët druheshin se fitorja e Vojisllav Koshtunicës do të ndërpriste rrugën e tyre drejt pavarësisë.
20. Për dokumenta rreth shkeljeve në Shqipëri nga viti 1992 deri më 1996, *shih* Human Rights Watch, Të drejtat e njeriut në Shqipërinë paskomuniste, maj 1996. Destabilizimi i Shqipërisë kulmoi më 1997 me rënien e të ashtuquajturave skema piramidale, pasojë e të cilave do të ishin humbjet financiare prej shumë milionash dhe disa muaj anarki. Depot e armëve u plaçkitën në të gjithë vendin dhe dhjetëra mijëra armatime të lehta u mbartën në Kosovë.
21. Marrëveshja e Dayton-it e ndau ish-Republikën Jugosllave të Bosnjës dhe Hercegovinës në dy entitete: Republika Srpska dhe Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Pas spastrimit etnik në shkallë të gjerë të kryer gjatë luftës, Republika Srpska kishte një popullsi pothuaj ekskluzivisht serbe.
22. Ndërmjet të vrarëve ishin Stana Radusinoviç, një emigrant serb nga Shqipëria dhe Bllagoje Okuliç, një refugjat serb nga Knini, të cilët u vranë teksa ishin ulur në

kafenenë e një pronari serb në qytetin e Deçanit. Dy policë serbë Zoran Dashiç dhe Safet Koçan u plagosën.

23. Intervistë me ish-komandantin e UÇK-së për rajonin e Llapit, Rrustem Mustafa (a.k.a. Remi), botuar në të përditshmen kosovare *Zëri*, midis 21 prillit dhe 4 majit 2000.
24. Më 16 qershor, një polic serb, Goran Mitroviç, u plagos me armë zjarri në një stacion autobuzi në Podujevë. Një ditë më pas, një tjetër polic, Predrag Georgoviç u qëllua për vdekje në fshatin Shipol, ndërsa kolegu i tij Zoran Vujkoviç, u plagos. Gjithashtu u sulmua rajoni i policisë në fsahtin Lluzhanë. Paskëtaj, më 2 gusht, katër rajone policie në Podujevë dhe në Prishtinë u sulmuan, por nuk u lëndua njeri. Gjashtë ditë më pas, pati një sërë shpërthimesh në një vendbanim serb pranë Deçanit.

    Më 28 gusht, në rajonin e policisë në Llollopak, pranë Pejës, u hodhën tri granata, të cilat nuk shkaktuan viktima, por dëme materiale të rëndësishme. Po atë ditë, një inspektor i policisë serbe, Ejup Bajgora, u vra me një breshëri automatiku pranë shtëpisë në Lupqin e Poshtëm, në afërsi të Podujevës. Më 26 tetor, një oficer i policisë serbe, inspektori Milosh Nikiç dhe Dragan Arkiç, nëpunës i zyrës së punësimit, u vranë në një pritë pranë fshatit Surkish, në afërsi të Podujevës, nga njerëz të panjohur. *Shih* Human Rights Watch, "Persekutimet vazhdojnë: Shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë," Raporti i Human Rights Watch, vëll. 8, nr. 18, dhjetor 1996.
25. Për një përshkrim të dhunës policore më 1996, *shih* Human Rights Watch, Persekutimi vazhdon.
26. Marrëveshja e fjalëzuar në mënyrë të vagullt bënte thirrje për "normalizimin e sistemit arsimor në Kosovë, për të rinjtë shqiptarë," dhe "kthimin e studentëve dhe mësuesve shqiptarë nëpër shkolla."
27. Sipas qeverisë së Shteteve të Bashkuara, sanksionet kundër Jugosllavisë nuk do të hjiqeshin deri sa ajo të plotësonte kushtet e mëposhtme: zbatimi i të gjitha pikave të Marrëveshjes së Dejtonit, bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës për Krimet në ish-Jugosllavi, rregullimi i marrëdhënieve me të gjithë shtetet pasuese të ish-Jugosllavisë dhe rikthimi i të drejtave politike dhe civile në Kosovë. Ky qëndrim ishte theksuar në një sërë rastesh nga diplomatët europianë dhe ata të Shteteve të Bashkuara.
28. Shih Human Rights Watch, *Persekutimi vazhdon*.
29. Intervistë e Human Rights Watch me zëvendësministrin Rade Drobac, Beograd, Jugosllavi, 19 korrik 1996.
30. Paqeruajtësit e O.K.B.-së ishin vendosur në Maqedoni qysh në vitin 1991 për të ruajtur unitetin e shtetit, e cila shihet edhe sot e kësaj dite e një rëndësie jetike për Ballkanin e jugut, midis shteteve konkurruese. Për informacion lidhur me ta drejtat e njeriut në Maqedoni, *shih* Human Rights Watch, *Një kërcënim për stabilitetin: Të drejtat e njeriut në Maqedoni*, (New York, Human Rights Watch, prill 1996), dhe Human Rights Watch, *Dhuna policore në Maqedoni*, (New York, Human Rights Watch, prill 1998).
31. *Shih* Human Rights Watch, "Demokracia e shkurajuar: Zgjedhjet dhe të drejtat e

njeriut në Serbi," *Raport i Human Rights Watch*, vëll. 9, nr. 11, shtator 1997.

32. Tre luftëtarët ishin Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe Daut Haradinaj.
33. Deklaratë nga Grupi i Kontaktit për Kosovën, Moskë, 25 shkurt 1998.
34. Konferencë për shtyp nga Përfaqësuesi Special i Shteteve të Bashkuara Robert S. Gelbard, Beograd, Prishtinë, Serbi dhe Mal i Zi, 22 shkurt 1998.
35. Konferencë për shtyp nga Përfaqësuesi Special i Shteteve të Bashkuara Robert S. Gelbard, Beograd, Prishtinë, Serbi dhe Mal i Zi, 23 shkurt 1998. Gjatë një fjalimi të mbajtur në Institutin e Paqes në Washington, Gelbard përsëriti qëndrimin e tij dhe dënoi aksionet e armatosura të terroristëve shqiptarë.
36. Për listën e të gjithë atyre organizatave që konsiderohen grupe terroriste nga qeveria e Shteteve të Bashkuara, shih: www.state.gov/www/global/terrorism/, mars 2001.
37. Adem Jashari, luftëtar i njohur i UÇK-së, i shndërruar në hero dhe martir i popullit të tij pas vdekjes, ishte dënuar në mungesë nga një gjykatë e Prishtinës, më 11 korrik 1997, për akte terroriste, bashkë me katërmbëdhjetë shqiptarë të tjerë etnikë, nga një gjykatë që, jashtë çdo dyshimi, ishte tepër larg standarteve ndërkombëtare. Shih deklaratën për shtyp, "Human Rights Watch/Helsinki dënon proceset politike në Kosovë," 15 korrik 1997.
38. Shih Human Rights Watch, *Shkeljet e të drejtës humanitare në Kosovë*, (New York: Human Rights Watch, 1998).
39. "Zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme në konferencë për shtyp," Tanjug, 7 mars 1998.
40. Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, "Deklaratë e Prokurores lidhur me juridiksionin e kësaj gjykate mbi Kosovën," Hagë, 10 mars 1998.
41. Deklaratë për shtyp nga James P. Rubin, zëdhënës i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, 2 mars 1998.
42. Takim i Grupit të Kontaktit, Londër, 9 mars 1998, Deklaratë për Kosovën. E vlefshme edhe në www.secretary.state.gov/www/travels/980309_kosovo.html, mars 2001.
43. Grupi i Kontaktit përshtati katër masa, ndonëse ai nuk e specifikoi se si ato do të zbatoheshin: a) shqyrtimin nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara vendosjen e një embargoje të plotë armësh kundër RFJ, duke përfshirë edhe Kosovën; b) Refuzimi për të furnizuar me pajisje RFJ, të cilat mund të përdoren për represion të brendshëm apo terrorizëm; c) Mosdhënia e vizave për zyrtarë të lartë të RFJ-së dhe përfaqësues të Serbisë përgjegjës për aksione represive nga forcat e sigurimit të RFJ-së në Kosovë; d) Një moratorium mbi kreditë për mbështetjen financiare nga ana e qeverisë e eksporteve në tregti dhe investime, duke përfshirë financimet qeveritare për privatizimin në Serbi.
44. Më 10 mars 1998, zyra e Prokurorit të Gjykatës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, deklaroi se dhuna në Kosovë ishte brenda mandatit të kësaj gjykate.
45. Deklaratë e Grupit të Kontaktit për Kosovën, Bonn, 25 mars 1998.
46. Deklaratë e Grupit të Kontaktit për Kosovën, Romë 29 prill 1998.

47. Anëtarët e grupit të shqiptarëve të Kosovës, i njohur edhe si G5, ishin : Ibrahim Rugova, Pajazit Nushi (kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut), Mahmut Bakalli (ish-kryetar i Partisë Komuniste të Kosovës), Fehmi Agani (një nga udhëheqësit e LDK-së, i cili u vra nga policia serbe gjatë bombardimeve të NATO-s) dhe Veton Surroi (botues i gazetës së pavarur *Koha Ditore*).
48. Qendra e Medias Prishtinë, *Dialog dhe jo separatizëm e terrorizëm*, Botim i tretë i amenduar, (Prishtinë: Qendra e Medias Prishtinë, 1998), fq. 96-97.
49. Konkluzione të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Europian, 25 maj 1998.
50. Në librin Kosova, Luftë dhe Hakmarrje, Tim Judah mëton se Rugovës i ishte premtuar një takim me Clinton-in, në rast se ai do të pranonte të takohej me Millosheviç-in. Judah, *Kosova, Luftë dhe Hakmarrje*, f.154.
51. Negociatat dështuan ngaqë kryesisht shqiptarët, që kishin formuar një grup të madh të quajtur G15, s'pranuan të bisedonin gjatë një ofensive që shkaktoi viktima të rënda në radhët e civilëve.
52. Shih Human Rights Watch, *Shkeljet e të drejtës humanitare në Kosovë*.
53. Për informacion rreth ligjit universitar, *shih* Human Rights Watch, "Forcimi i autoritarizmit në Serbi: Spastrimet në universitete," *Raport i Human Rights Watch*, vëll. 11, nr. 2, janar 1999. Për informacion rreth medias në Serbi, veçanërisht rreth ligjit mbi median elektronike, shih "Kufizime për median elektronike në RF të Jugosllavisë," raport nga Free2000, shtator 1998, komiteti ndërkombëtar për mbrojtjen e shtypit të lirë në Serbi, degë e Shoqatës së Meidas Elektronike të Pavarur (ANEM), me qendër në Serbi. Shih http://www.free2000.opennet.org/, mars 2001.
54. Deklaratë e Bashkimit Europian për Kosovën, Bruksel, 9 qershor 1998.
